

LIGJ PËR SHOQËRITË TREGTARE

TEKST I KONSOLIDUAR ¹

Teksti në

gjuhën

Maqedonase

 Закон за

трговските друштва

PJESA E PARË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet/rregullohen: tregtari (sipas veprimtarisë, formës, natyrës dhe vëllimit të veprimtarisë, regjistrimit); tregtari-individ; kryegjësja bazë; pjesët dhe aksionet; marrëveshja për shoqërinë; përkatësisht statuti i shoqërisë; para shoqëria; kohëzgjatja e shoqërisë; cilësia e personit juridik të shoqërisë (subjektiviteti juridik); filijalat; përgjegjësia për obligimet e shoqërisë; përgjegjësia e veçantë e bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve; personat të cilët munden, përkatësisht personat të cilët nuk munden të themelojnë shoqëri; kushtet me të cilat personi i huaj mund të bëhet bashkëpronar, përkatësisht aksionar; të drejtat e personave të huaj; shuarja e shoqërisë; depozitimet (monetare dhe jomonetare); ndalesa për lirimin nga obligimi i pagesës, përkatësisht futjes së depozitimit; pjesëmarrja në fitim, e drejta për informimin e bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit; regjimi juridik i pronës së shoqërisë; mbrojtja e të drejtave të bashkëpronarëve, përkatësisht të aksionarëve para gjyqit; vlerësimi i ligjshmërisë; shenjat e shoqërisë tregtare (firma, selia, lënda e punës); përfaqësimi (përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi me autorizim dhe i autorizuari me punësim); i autorizuari tregtar; agjenti tregtar; regjistri tregtar; regjistrimet në regjistrin tregtar dhe shpallja e tyre; kushtet e themelimit, administrimit, mbikëqyrjes; zvogëlimit dhe zmadhimet të kryegjësë bazë; raportet ndërmjet bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve; dhe çështje të tjera me rëndësi për format e ndryshme të shoqërive tregtare-shoqëria publike tregtare, shoqëria komanditore, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, shoqëria aksionare dhe shoqëria komanditore me aksione; punët e mëdha dhe punët e shoqërisë me palën e interesuar; librat tregtar; llogaritë vjetore dhe raportet financiare dhe shoqëria me palën e interesuar; librat tregtar; llogaritë vjetore dhe raportet financiare dhe revizioni i tyre; dividenda; pjesëmarrja në shoqëri të tjera tregtare (shoqëri të lidhura); llogaritë vjetore të konsoliduara dhe raportet financiare të konsoliduara; transformimi i shoqërisë nga njëra në formë tjetër të shoqërisë; bashkëngjitja, bashkimi dhe ndarja e shoqërisë; likuidimi i shoqërisë; bashkësia e interesit afarist; shoqëria e fshehtë, shoqëria tregtare e huaj dhe tregtari-individ i huaj; filijalat e shoqërisë së huaj, përkatësisht të tregtarit-individ të huaj dhe përfaqësitë e filialeve të huaja; kontrollin dhe

Teksti në

gjuhën Angleze

 Law on Trade

Companies

mbikëqyrjen; dispozitat ndëshkuese si dhe të regjimit kalimtar për zbatimin e këtij ligji.

Zbatimi i ligjit

Neni 2

Ky ligj zbatohet për tregtarin individ, për shoqërinë tregtare, për shoqërinë afariste të interesit dhe për filialën e organizuar nga shoqëria tregtare e huaj, përkatësisht nga tregtari - individ i huaj, të regjistruar në regjistrin tregtar, si dhe për shoqërinë e fshehtë.

Kuptimi i nocioneve të përdorura

Neni 3

(1) Shprehjet e caktuara që përdoren në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1) "Aksionar" është pronari i një ose më tepër aksioneve i cili nuk ka përgjegjësi për obligimet e shoqërisë aksionare dhe shoqërisë komanditore me aksione;

2) "Aksion" është letër me vlerë (të cilën mund ta lëshojë shoqëria aksionare dhe shoqëria komanditore me aksione) në të cilën paraqitet një pjesë nga kryegjëja bazë dhe në të cilën shprehen të drejtat e aksionarit, i cili si pronar i aksioneve, nuk është kreditor i shoqërisë e as pronar i një pjese të pronës së shoqërisë;

3) "Aktet dhe dokumentet të kapshme për opinionin" janë aktet dhe dokumentet të cilat shoqëria tregtare, në mënyrë adekuate, duhet t'i bëjë të kapshme për bashkëpronarët, përkatësisht për aksionarët, për personat e interesuar dhe opinionin e gjerë;

4) "Depozitimi në shoqëri" janë para, sende, të drejtat të cilat bashkëpronari, përkatësisht aksionari ia lejon ose bart shoqërisë tregtare në procedurën për themelimin ose në procedurën për rritjen e kryegjësë bazë të shoqërisë, përkatësisht edhe punë e shërbime kur kjo me këtë ligj lejohet, dhe hua, respektivisht pagesë shtesë, të cilat në pajtim me dispozitat e këtij ligji transformohen në depozitë;

4-a. "Hua që transformohet në depozitë në shoqëri në procedurë të zmadhimit të kryegjësë themelore të shoqërisë" është kur huaja ekskluzivisht është dhënë nga bashkëpronari, përkatësisht nga aksionarit i vetëm i shoqërisë që është në pronësi të tij të plotë;

5) "Kujdesi i tregtarit të rregullt dhe të vetëdijshëm" është standard juridik për përcaktimin e përgjegjësisë së personave - përgjegjës për administrimin dhe mbikëqyrjen e shoqërive, me të cilin përcaktohet me çfarë kujdesi këta persona duhet t'i kryejnë punët e besuara në shoqëri, përkatësisht të sillen me kujdesin e njeriut të aftë (në punën e shoqërisë), mjeshtrit (profesional), për këtë ata kanë përgjegjësi për pakujdesi të rëndomtë gjatë kryerjes së punëve të besuara, përveç nëse, me ligj tjetër nuk është përcaktuar se mbajnë përgjegjësi vetëm për pakujdesi të madhe;

6) "Grupi votues" është grupi i aksionarëve - pronarë të klasit të aksioneve të cilët kanë të drejtë, për mbrojtjen e interesave të veçanta, të marrin vendime të veçanta në kuvend të veçantë ose në kuadër të kuvendit të përgjithshëm;

7) "Kryegjëja" është mbetja e pjesëmarrjes në pronën mbi mjetet e shoqërisë pas marrjes së të gjitha obligimeve të shoqërisë, komponenta kryesore të të cilës janë kryegjëja bazë, shuma e paguar mbi shumën nominale, përkatësisht premia e aksioneve, fitimi revalorizues dhe i akumuluar dhe rezervat tjera;

8) "Data e evidentimit" është data prej kur caktohet identiteti i bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve dhe të drejtat e tyre që dalin nga pjesa, përkatësisht aksioni (e drejta për njoftim, votim dhe shpërndarje) dhe të drejta të tjera kur kjo është e caktuar me ligj, me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin;

9) "Aktet tjera të shoqërisë" janë aktet e përgjithshme të cilat miratohen në shoqërinë aksionare dhe në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me të cilat, në mënyrë të përgjithshme, rregullohen raportet në shoqëri që nuk janë rregulluar me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht me statutin, të cilat duhet doemos të jenë në pajtim me to (rregullorja, vendimi, rregullorja e punës e të tjera);

10) "Dividenta" është pjesa e fitimit të shoqërisë që u shpërndahet bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve të shoqërisë në pajtim me të drejtat e caktuara me pjesët, përkatësisht në secilin lloj dhe klasë të aksioneve;

11) "Marrëveshja e shoqërisë" është akti me të cilin themelohen shoqëria publike, shoqëria komanditore, shoqëria më përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria komanditore me aksione, e cila njëkohësisht është akti bazë i përgjithshëm me të cilin rregullohen raportet, organizimi dhe funksionimi i këtyre shoqërive pas themelimit të tyre, e cila miratohet me pajtimin e të gjithë themeluesve, kurse ndryshohet me shumicën e përcaktuar me këtë ligj, përkatësisht me marrëveshjen e shoqërisë;

12) "Marrëveshja për rregullimin e raporteve ndërmjet shoqërisë dhe anëtarit ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarit të këshillit drejtues, përkatësisht administruesit" është marrëveshje me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet shoqërisë dhe anëtarit ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarit të këshillit drejtues, përkatësisht administruesit;

13) "Marrëveshja për rregullimin e raporteve me personin udhëheqës" është marrëveshje me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet shoqërisë, të përfaqësuar nga organi administrues, dhe personit udhëheqës;

14) e fshirë ²

15) "Shuma emetuese e aksionit" është vlera e aksioneve të lëshuara, e përbërë nga shuma nominale e aksionit, e zmadhuar me preminë e lëshimit, nëse premia është paraparë, gjatë së cilës shuma e premisë nuk hyn në shumën nominale të kryegjësë bazë;

16) "Përfaqësuesi ligjor" është anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, anëtari i këshillit drejtues, përkatësisht administruesi, të cilët sipas këtij ligji, e përfaqësojnë shoqërinë;

17) "Deklarata e vërtetuar te noteri" është deklaratë, nënshkrimi i së cilës është vërtetuar te noteri;

18) "Raporti i vlerësimit" është raport i shkruar në të cilin vlerësuesi i autorizuar me qasje dhe metoda përkatëse sipas standardeve ndërkombëtare për vlerësim, ka përcaktuar vlerën e sendeve dhe të

drejtave (depozitimin jomonetar) dhe raste të tjera të përcaktuara me këtë ligj;

19) "Anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve" është personi fizik i cili është anëtar i këshillit të drejtorëve, të cilit këshilli i drejtorëve ia ka besuar administrimin e përditshëm të shoqërisë;

20) "Deklarata për themelim" është akti me të cilin themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nga një person dhe i cili sipas kuptimit juridik është përkatës me marrëveshjen e shoqërisë;

21) "Prona e shoqërisë" është tërësia e të drejtave, pronësore dhe të drejta të tjera reale që shoqëria i fiton mbi të mirat (paratë, sendet dhe të drejtat) që bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët i kanë depozituar në shoqëri ose të cilat shoqëria i ka fituar me punën e vet;

22) "Obligacionet konvertibile" janë lloje të obligacioneve të cilat mund të shndërrohen në aksione të shoqërisë që i ka lëshuar obligacionet, gjatë një opsioni të caktuar në kuadër të procedurës për rritjen e kushtëzuar të kryegjësë bazë;

23) "Personi" është çdo person fizik dhe juridik, përveç nëse nuk theksohet se është person fizik ose juridik;

24) "Vendbanimi" është vendi me adresën (rruga dhe numri) e banimit të personit fizik si dhe shteti nëse personi fizik është i huaj;

25) "Anëtari i pavarur joekzekutiv i këshillit të drejtorëve" përkatësisht i këshillit mbikëqyrës. është personi fizik i cili, përkatësisht anëtari i familjes më të ngushtë të të cilit:

(1) në pesë vjetët e fundit nuk ka pasur interes material ose raporte pune me shoqërinë, drejtpërdrejt, si partner afarist, si anëtar i organit të administrimit, organit të mbikëqyrjes ose si person udhëheqës;

(2) në pesë vjetët e fundit nuk ka pranuar ose nuk pranon të ardhura plotësuese përveç rrogës nga shoqëria;

(3) nuk ka lidhje të ngushta familjare me ndonjërin nga anëtarët e organeve të administrimit, organit të mbikëqyrjes ose personat udhëheqës të shoqërisë, dhe

(4) nuk është aksionar i cili posedon më tepër se një të dhjetën e aksioneve të shoqërisë;

26) "Anëtari joekzekutiv i këshillit të drejtorëve", sipas rregullës, është personi fizik - anëtar i këshillit të drejtorëve i cili nuk ka funksion ekzekutiv në shoqëri dhe autorizimet e të cilit kanë të bëjnë në radhë të parë, me administrimin e përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e administrimit;

27) "Depozitimi jomonetar" paraqet shumën e sendeve (të tundshme e të patundshme) dhe të drejtat të cilat bashkëpjesëmarrësit, përkatësisht aksionarët i depozitojnë në shoqëri;

28) "Vendosja përmes letërkëmbimit" është formë me të cilën bashkëpronarët deklarohen, përkatësisht marrin vendime për çështjet e caktuara në marrëveshjen e shoqërisë pa mbajtjen e tubimit të bashkëpronarëve;

29) "Revizori i autorizuar" është personi i cili kryen punë revizori si revizor i autorizuar sipas Ligjit për revizion;

30) "Vlerësuesi i autorizuar" është personi i cili kryen vlerësimin si vlerësues i autorizuar dhe është i regjistruar në regjistrin e vlerësuesve të autorizuar, i caktuar në bazë të ligjit;

31) "Kapitali i lejuar" është shuma e përcaktuar në statutin e shoqërisë aksionare për të cilën mund të rritet kryegjëja bazë me vendimin e organit të administrimit përmes dhënies së aksioneve të reja në bazë të depozitimeve në shoqëri;

32) "Leja nga organi kompetent" është leje, pëlqim, vendim ose akt tjetër nga organi kompetent shtetëror ose nga organi tjetër i autorizuar, përveç nëse me këtë ligj nuk emërtohet akti i organit shtetëror ose i organit tjetër të autorizuar;

33) "Personi përgjegjës në shoqërinë tregtare publike" është bashkëpronari, i autorizuar të administrojë dhe ta përfaqësojë shoqërinë, nëse administrimi nuk i është besuar personit të tretë (administruesit); në shoqërinë komanditore dhe në shoqërinë komanditore me aksione ai është komplementari, nëse administrimi nuk i është besuar personit të tretë (administrues); në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar - administruesi, përkatësisht administruesit, anëtari i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori; dhe në shoqërinë aksionare - anëtari i organit administrues, përkatësisht anëtari i këshillit mbikëqyrës dhe personat udhëheqës në shoqëritë tregtare;

34) "Organi i administrimit" është organi i shoqërisë aksionare të cilit i është besuar administrimi me shoqërinë si këshillit të drejtorëve në sistemin njëshkallësh të administrimit, këshillit drejtues ose administruesit në sistemin dyshkallësh të administrimit, përkatësisht administruesit, përkatësisht administruesve ose organit në të cilin ata janë të organizuar në shoqërinë komanditore, në shoqërinë komanditore me aksione dhe në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar;

35) "Organi mbikëqyrës" është organi në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, përkatësisht në shoqërinë aksionare (këshilli mbikëqyrës ose kontrollori), autorizimet e të cilit janë për mbikëqyrjen e punës së shoqërisë, veçanërisht të punës së organeve të administrimit;

36) "Kryegjëja bazë" është shuma e përgjithshme e të gjitha depozitimeve të bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve, për të cilën shuma e kryegjësë bazë është e barabartë me shumën e vlerës nominale të të gjitha depozitimeve, përkatësisht shumën nominale të të gjitha aksioneve të shoqërisë aksionare;

37) "Themeluesi i shoqërisë tregtare" është çdo person, i cili për themelimin e shoqërisë tregtare, ka nënshkruar marrëveshje për shoqërinë, statut, përkatësisht deklaratë për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nga një person;

38) "Depozitimi monetar" është shuma e parave, e shprehur me valutë të vendit ose të huaj, të cilat bashkëpronari, përkatësisht aksionari e depoziton në shoqëri;

39) "Vlera e aksionit në treg" është vlera e aksionit që formohet në tregun e organizuar (institucionalizuar) të letrave me vlerë;

40) "Ndërmarrja" paraqet shumën e të drejtave, sendeve dhe raporteve faktike që kanë vlerë pronësore, të cilat i takojnë veprimtarisë tregtare të tregtarit, për të cilën këto elemente e përbëjnë aktiven e tregtarit, por i përfshijnë edhe obligimet e tij. Ndërmarrja paraqet objekt juridik të plotë dhe të pavarur i cili mund të jetë në qarkullim;

41) "Lënda e punës" është veprimtaria përkatësisht, janë veprimtaritë e përcaktuara me marrëveshjen e shoqërisë, statutin, përkatësisht deklaratën për themelimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar

nga një person, të klasifikuara sipas veprimtarive të përcaktuara me Klasifikimin nacional të veprimtarive;

42) "Aksionet me të drejtë vote" të përfaqësuara në kuvend. janë aksionet me të drejtë vote, pronarët e të cilave marrin pjesë personalisht ose janë të përfaqësuar përmes të autorizuarit në kuvendin e thirrur;

43) "Prokuristi" është personi fizik i autorizuar nga tregtari ta administrojë ndërmarrjen e tij për shpërbllim, dhe gjatë kësaj, t'i kryejë të gjitha veprimtaritë dhe punët për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, ndërsa nuk ka të drejtë t'i tjetërsojë dhe ngarkojë patundshmëritë e tregtarit, përveç nëse nuk ka autorizim të veçantë për këtë;

44) "Aksionet e fituara vetjake" janë aksione të lëshuara nga shoqëria aksionare të cilat i fiton në baza të ndryshme, për të cilat të drejtat që përmbahen në to pushojnë;

45) "Selia e shoqërisë" është vendi, me adresën (rruga dhe numri), e shënuar në marrëveshjen e shoqërisë, statutin, përkatësisht deklaratën për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nga një person dhe të regjistruara në regjistrin tregtar;

46) "Statuti i shoqërisë" është akti me të cilin themelohet shoqëria aksionare, por njëkohësisht është edhe akti bazë me të cilin rregullohen raportet, organizimi dhe funksionimi i kësaj shoqërie dhe miratohet me pajtimin e të gjithë themeluesve, kurse ndryshohet me shumicën e përcaktuar me këtë ligj, përkatësisht me statutin e shoqërisë në tekstin e mëtejshëm: statutin);

47) "Ndryshimet e statusit" shënojnë bashkëngjitjen, bashkimin dhe ndarjen e shoqërive tregtare me mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj;

48) "Regjistri tregtar" është regjistri bazë, në të cilin bëhen regjistrimet e përcaktuara me këtë ligj;

49) "Pjesa në shoqëri" është tërësia e të drejtave dhe obligimeve të cilat bashkëpronari i fiton në bazë të depozitimit në kryeqjënë bazë në shoqërinë publike tregtare, shoqërinë komanditore dhe shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për këtë çdo bashkëpronar ka pjesë e cila nuk mund të paraqitet në letër me vlerë.

(2) Në këtë ligj shprehja në njëjës përfshin shumësin, ndërsa shumësi mund të shprehet për njëjës, përveç kur me fjalët "vetëm" ose "përveç" nuk përjashtohet njëjësi ose shumësi.

PJESA E DYTË

TREGTARI

Tregtar sipas veprimtarisë

Neni 4

(1) Tregtar sipas këtij ligji është secili person i cili në mënyrë të pavarur dhe të përhershme në formë të profesionit kryen veprimtari tregtare për realizimin e fitimit me prodhim, tregti dhe ofrimin e shërbimeve të tregut me:

1) blerjen e sendeve të tundshme me qëllim për t'i shitur në formën

fillestare, të përpunuar ose të ripunuar;
2) shitjen e sendeve të tundshme në formë të përpunuar ose të ripunuar nga prodhimi vetanak;
3) tregti me letra me vlerë dhe administrim me fonde;
4) veprimtari bankare, këmbëse dhe veprimtari tjera financiare;
5) veprimtari sigurimi;
6) transport të personave dhe mallit;
7) punë komisionesh, shërbime shpeditimi, shërbime deponimi (magazinimi) dhe lizing;
8) përfaqësim dhe ndërmjetësim tregtar;
9) veprimtari hoteliere - turistike, veprimtari informative, marketing dhe shërbime tjera intelektuale;
10) prodhimin e filmave, video - kasetave, shkrime audiovizuale, softuer si dhe veprimtari tjera të ngjashme;
11) veprimtari botuese dhe të shtypit dhe punë të tjera lidhur me tregtinë me libra dhe krijime artistike; dhe
12) blerje, ndërtim dhe rregullim të sendeve të patundshme me qëllim të shitjes dhe dhënies me qira.

(2) Veprimtaritë që tregtari i kryen sipas paragrafit 1 të këtij neni, klasifikohen sipas veprimtarive të përcaktuara në Klasifikimin nacional të veprimtarive.

Tregtar sipas formës

Neni 5

Shoqëritë tregtare të përcaktuara me këtë ligj janë tregtarë sipas formës.

Tregtar sipas natyrës dhe vëllimit të veprimtarisë

Neni 6

(1) Tregtar, sipas këtij ligji konsiderohet secili person i cili, në formë të profesionit udhëheq ndërmarrje, e cila sipas natyrës dhe vëllimit të veprimtarisë kërkon organizim dhe udhëheqje në mënyrë si udhëhiqen veprimtaritë tregtare edhe pse nuk janë të shënuara në nenin 2 të këtij ligji, me kusht firma të jetë e regjistruar në regjistrin tregtar.

(2) Dispozita nga paragrafi 1 e këtij neni zbatohet edhe në fushën e bujqësisë dhe pylltarisë, vetëm për ndërmarrjet për përpunimin dhe ripunimin e prodhimeve vetanake bujqësore ose të drurit.

Tregtar sipas regjistrimit

Neni 7

Nëse firma është regjistruar në regjistrin tregtar, nuk mund të theksohet se ndërmarrja që udhëhiqet me atë firmë nuk është tregtare.

Personat fizik që nuk konsiderohen si tregtarë

Neni 8

(1) Tregtarë, sipas këtij ligji, nuk konsiderohen:

1) personat fizik që kryejnë veprimtari bujqësore ose të pylltarisë (bujqit individual), përveç nëse veprimtaria e tyre mund të udhëhiqet si ndërmarrje, sipas nenit 4 paragrafit 1 të këtij ligji;

2) zejtarët dhe personat fizik që kryejnë shërbime, përveç nëse

veprimtaria e tyre mund të përcaktohet si ndërmarrje, sipas nenit 4 paragrafit 1 të këtij ligji; dhe

3) personat fizik që kryejnë shërbime hoteliere me dhënien me qira të dhomave në vendbanimet e tyre.

(2) Personat fizik që merren me profesione të lira (avokatët, noterët, mjekët, e tjerë) nuk konsiderohen si tregtarë sipas këtij ligji.

Zbatimi i dispozitave të tregtarit për persona

Neni 9

Dispozitat e këtij ligji për obligimet e tregtarit zbatohen edhe për personat që kryejnë veprimtari tregtare, edhe pse sipas rregullave për kryerjen e saj, nuk u lejohet ta kryejnë ose nuk i plotësojnë kushtet për kryerjen e saj.

Të dhënat e kapshme për tregtarin

Neni 10

Secili tregtar në njoftimin e përditshëm, në formë të shkruar, elektronike ose mënyrë tjetër, është i obliguar në mënyrë të lehtë, të drejtpërdrejtë ose në mënyrë përherë të kapshme, t'i shfrytëzojë ose t'i bëjë të kapshme të dhënat si vijojnë:

1) firmën;

2) selinë;

3) numri unik amë i subjektit (tregtarit) të shënuar në regjistrin tregtar, përkatësisht numrin amzë të personit të huaj që e ka organizuar filijalën (në tekstin e mëtejme: NUAS);

4) telefoni, faksi dhe adresa për komunikim në mënyrë elektronike për komunikim të shpejtë dhe efikas; dhe

5) kur tregtari veprimtarinë e kryen në bazë të lejes, licencës dhe të ngjashme - të dhënat për organin, përkatësisht institucionin që i ka lëshuar, ndërsa nëse mbahet edhe regjistër i veçantë - numri i regjistrit; të dhënat për arsimimin, përkatësisht kualifikimin e personave që i kryejnë këto veprimtari (nëse kushtëzohet kryerja e veprimtarisë edhe me marrjen a arsimimit përkatës, përkatësisht kualifikimit përkatës; të dhënat për rregullat profesionale për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe për mjetet e qasjes tek ato.

Veprimtaria tregtare me vëllim të vogël

Neni 11

I fshirë 3

PJESA E TRETË

TREGTARI - INDIVID

Nocioni

Neni 12

(1) Tregtari - individ është personi fizik i cili, në formë të profesionit, kryen njërën nga veprimtaritë tregtare të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Tregtari - individ përgjigjet për obligimet e tija personalisht, dhe në mënyrë të pakufizuar me tërë pronën e vet.

(3) Si tregtar - individ mund të regjistrohet në regjistrin tregtar secili person afarist i aftë fizikisht, me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë.

(4) Cilësia e tregtarit - individ fitohet me regjistrimin në regjistrin tregtar.

(5) Dispozitat e këtij ligji për shoqërinë tregtare, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për tregtarin - individ, përveç nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Kufizimet

Neni 13

Nuk mund të regjistrohet si tregtar - individ personi fizik:

- 1) për të cilin është hapur procedura falimentuese;
- 2) për të cilin, me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, vërtetohet se me paramendim ka shkaktuar falimentim, për këtë arsye kreditorët nuk kanë mundur t'i arkëtojnë kërkesat e tyre derisa zgjat ndalesa për kryerjen e veprimtarisë të përcaktuar me vendimin gjyqësor; dhe
- 3) të cilit organi kompetent, në bazë të ligjit ia ka ndaluar të kryejë ndonjërin nga veprimtaritë e përcaktuara me këtë ligj, derisa zgjat ndalesa.

Regjistrimi në regjistrin tregtar

Neni 14

(1) Tregtari - individ regjistrohet në regjistrin tregtar në Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë. Në fletëparaqitje për regjistrim shënohen:

- 1) emri dhe mbiemri, numri unik amë i qytetarit (në tekstin e mëtejshëm: NUAQ) dhe vendbanimi;
- 2) firma me të cilën kryhet veprimtaria;
- 3) selia prej nga kryhet veprimtaria; dhe
- 4) lënda e punës.

(2) Fletëparaqitja për regjistrim të tregtarit individ në regjistrin tregtar, parashtrohet në formë elektronike të nënshkruar me nënshkrim elektronik në pajtim me Sistemin për e-regjistrim, nga personi fizik i cili kërkon që të regjistrohet si tregtar individ ose i autorizuari i tij me autorizim të posaçëm në të cilin shënohen të dhënat që regjistrohen në regjistrin tregtar ose përmes agjentit regjistruar.

(3) Me fletëparaqitjen për regjistrim parashtrohet nënshkrim i verifikuar elektronik i tregtarit individ në pajtim me Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik.

(4) Një person fizik i regjistruar si tregtar - individ nuk mundet njëkohësisht, me çfarëdo baze, të jetë i regjistruar si tregtar - individ me firmë tjetër.

Firma

Neni 15

Firma e tregtarit - individ përmban emrin e tij personal, emrin e babait dhe mbiemrin si dhe shenjë "NT".

Bartja e firmës

Neni 16

(1) Firma e tregtarit - individ mund të bartet te personi i tretë vetëm bashkërisht me ndërmarrjen e tij. Në firmën e bartur bashkëngjiten emri personal, emri i babait dhe mbiemri i tregtarit - individ të ri.

(2) Tregtari - individ bën shpallje në së paku një gazetë ditore dhe në lokalet afariste se ka për qëllim bartjen e firmës te personi tjetër. Nëse në afat prej 30 ditësh nga shpallja për bartjen e firmës asnjë kreditor me parashkresë në gjyq nuk kundërshton bartjen e firmës, konsiderohet se kreditorët janë pajtuar me bartjen. Parashtresën me të cilën kundërshtohet bartja e firmës, kreditori ia paraqet tregtarit - individ.

(3) Nëse pronari i mëparshëm ose trashëguesit e tij ligjor këtë e lejojnë, personi i cili e merr firmën e tregtarit - individ, përveç emrit të tij personal, emrit të babait dhe mbiemrit, mundet në firmë ta mbajë edhe emrin personal dhe mbiemrin e pronarit të mëparshëm, si një nga shenjat e firmës.

(4) Bartja e firmës regjistrohet në regjistrin tregtar.

(5) Fletëregjistrimit për bartjen e firmës i bashkëngjiten:

1) marrëveshja për bartjen e firmës - të vërtetuar te noteri; dhe

2) dëshmi se të gjithë kreditorët janë pajtuar me bartjen e firmës, përveç nëse në afatin nga paragrafi 2 të këtij neni asnjë kreditor me parashkresë në gjyq nuk ka kundërshtuar bartjen e firmës.

Ndërprerja e punës

Neni 17

(1) Tregtari - individ ndërprerjen e punës e paraqet në organin kompetent për të hyra publike.

(2) Tregtari - individ, së paku tre muaj para paraqitjes për ndërprerjen e punës te organi nga paragrafi 1 i këtij neni e shpall ndërprerjen e punës dhe e shënon ditën e ndërprerjes së punës, së paku në një gazetë ditore dhe në lokalet afariste. Tregtari - individ i njofton kreditorët e njohur, një nga një, me shkrim.

(3) Dispozita nga paragrafi 2 i këtij neni zbatohet edhe kur tregtari - individ ka për qëllim ndërmarrjen ta shesë ose ta depozitojë në shoqëri.

Fletëparaqitja për çregjistrim

Neni 18

(1) Në regjistrin tregtar regjistrohet edhe shuarja e tregtarit individ.

(2) Tregtari - individ paraqet fletëparaqitje për çregjistrim të tregtarit - individ në regjistrin tregtar. Fletëparaqitjes për çregjistrim i bashkëngjiten:

1) deklarata për shuarjen e tregtarit - individ;

2) dëshmia se llogaria e tregtarit - individ është e mbyllur; dhe

3) e shfuqizuar 4

(3) Cilësia e tregtarit - individ shuhet me shlyerje nga regjistri i tregtarit - individ në regjistrin tregtar.

Neni 18-a

(1) Parashtrimi i fletëparaqitjes për regjistrim nga neni 14 paragrafi (1), shtojcat nga nenet 14 paragrafi (3), 16 paragrafi (5) dhe 18 paragrafi (2), fletëparaqitja për regjistrim të bartjes së firmës nga neni 16 paragrafi (5) dhe fletëparaqitja për shlyerje të regjistrimit nga neni 18 paragrafi (2) të këtij ligji, bëhet nëpërmjet Sistemit për e-regjistrim edhe personalisht ose nëpërmjet agjentit regjistruar në pajtim me Ligjin për sistem njësportel dhe për mbajtje të regjistrit tregtar dhe regjistrit të personave tjerë juridikë.

(2) Marrëveshja për bartje të firmës nga neni 16 paragrafi (5) pika 1 të këtij ligji nuk verifikohet te noteri, nëse parashtrohet nëpërmjet Sistemit për e-regjistrim dhe nëse është e nënshkruar me nënshkrim elektronik të palëve kontraktuese ose nëse parashtrohet nëpërmjet agjentit regjistruar të verifikuar me nënshkrim elektronik të agjentit regjistruar. ⁵

PJESA E KATËRT

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA PËR SHOQËRITË TREGTARE, PËRFAQËSIMI, REGJISTRI TREGTAR DHE PROCEDURA PËR REGJISTRIM

KAPITULLI I PARË

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA PËR SHOQËRITË TREGTARE

Nocioni

Neni 19

(1) Shoqëria tregtare është person juridik në të cilën një ose më tepër persona depozitojnë para, sende ose të drejta në pronë që e shfrytëzojnë për punë të përbashkët dhe bashkërisht e ndajnë fitimin dhe humbjen nga puna.

(2) Shoqëria tregtare në mënyrë të pavarur dhe të përhershme kryen veprimtari për realizimin e fitimit.

Format e shoqërive tregtare

Neni 20

(1) Shoqëri tregtare, sipas formës, pa dallim nëse kryen veprimtari tregtare ose tjetër, është:

- 1) shoqëria publike tregtare;
- 2) shoqëria komanditore;
- 3) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar;
- 4) shoqëria aksionare; dhe
- 5) shoqëria komanditore me aksione.

(2) Shoqëria tregtare mund të themelohet vetëm në formë dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(3) Themeluesi lirisht zgjedh formën e shoqërisë tregtare, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Kryegjëja bazë, pjesët dhe aksionet, bashkëpronarët dhe aksionarët

Neni 21

(1) Prona e krijuar me depozitim në shoqërinë tregtare shprehet me para dhe e paraqet kryegjënë bazë të shoqërisë. Kryegjëja bazë e shoqërisë tregtare shprehet me denarë ose me valutë të huaj dhe obligativisht shënohet në memorandum.

(2) Të drejtat dhe obligimet që bashkëpronari i fiton në bazë të depozitimit në kryegjënë bazë të shoqërisë tregtare janë pjesë e tij në shoqëri (në tekstin e mëtejme: pjesa).

(3) Të drejtat dhe obligimet që aksionari i fiton në bazë të depozitimit të kryegjësë bazë të shoqërisë aksionare, përkatësisht të shoqërisë komanditore me aksione janë pjesë e tij në shoqëri për të cilën fiton aksione (në tekstin e mëtejme: aksionet).

(4) Personat që depozitojnë në shoqërinë publike tregtare, në shoqërinë komanditore, në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar dhe komplementaret në shoqërinë komanditore me aksione janë bashkëpronarë të shoqërisë (në tekstin e mëtejme: bashkëpronarë).

(5) Personat që depozitojnë në shoqërinë aksionare dhe komanditorët në shoqërinë komanditore me aksione janë aksionarë të shoqërisë (në tekstin e mëtejme: aksionarë).

Marrëveshja e shoqërisë, respektivisht statuti i shoqërisë

Neni 22

(1) Shoqëria tregtare ka marrëveshje për shoqërinë, respektivisht statut të shoqërisë (në tekstin e mëtejme: statuti).

(2) Marrëveshja e shoqërisë lidhet, përkatësisht statuti miratohet në formë të shkruar. Ndryshimet dhe plotësimet e marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht të statutit bëhen në formë të shkruar.

(3) Përmbajtjen e marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht statutit themeluesit e përcaktojnë sipas ligjit.

(4) Ndryshimet dhe plotësimet e marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht statutit që përmbajnë të dhëna që regjistrohen në regjistrin tregtar obligativisht shpallen. Gjatë secilit ndryshim dhe plotësim, përpunohet tekst i spastruar i marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht statutit në të cilin futen ndryshimet dhe plotësimet e bëra. Një ekzemplar i tekstit të spastruar paraqitet në Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë i cili e mban regjistrin tregtar. Nëse me ndryshimin e marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht statutit ose ndonjë dispozite të tyre duhet pëlqimi i organit kompetent të caktuar me gjyq, fletëparaqitjes i bashkëngjitet edhe pëlqimi.

(5) Që të bëhen përgatitjet për themelimin e shoqërisë tregtare, themeluesit mund të lidhin marrëveshje për veprimet që duhet t'i kryejnë paraprakisht. Palët kanë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar për moskryerjen e obligimeve të marra me marrëveshje, përveç nëse ndryshe nuk janë marrë vesh.

Parashoqëria

Neni 23

(1) Parashoqëria krijohet me lidhjen e marrëveshjes për shoqërinë, përkatësisht miratimin e statutit dhe marrjen e depozitimeve, vlera e përgjithshme e të cilave nuk mund të jetë më e vogël nga shuma më e vogël e kryegjësë bazë për shoqërinë tregtare përkatëse të përcaktuar me këtë ligj.

(2) Për raportet juridike ndërmjet themeluesve, para regjistrimit të shoqërisë tregtare në regjistrin tregtar, zbatohet marrëveshja e lidhur e shoqërisë, përkatësisht statuti i miratuar. Për raportet juridike ndërmjet themeluesve që nuk janë rregulluar me këtë ligj dhe me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht me statutin zbatohen dispozitat e Ligjit për raportet obligative me të cilat rregullohet marrëveshja e partneritetit (marrëveshja për bashkësinë).

(3) Të drejtat e fituara në emër të shoqërisë tregtare para regjistrimit në regjistrin tregtar janë pronë e pandarë e përbashkët e themeluesve, përveç nëse themeluesit ndryshe nuk janë marrë vesh. Për obligimet e marra në emër të shoqërisë para regjistrimit të saj në regjistrin tregtar (para shoqëria) ka përgjegjësi personalisht ai i cili i ka marrë në emër të shoqërisë, ndërsa nëse obligimet i kanë marrë më tepër persona, ata kanë përgjegjësi të pakufizuar dhe solidare me tërë pronën e tyre.

(4) Nëse, pas regjistrimit në regjistrin tregtar, shoqëria tregtare i merr obligimet dhe vendoset në vend të debitorit, për borxhin e marrë nuk duhet pajtimi i kreditorit nëse obligimi merret në afat prej tre muajve nga regjistrimi i shoqërisë në regjistrin tregtar dhe nëse shoqëria ose debitori në këtë afat për këtë e njoftojnë kreditorin.

(5) Nëse obligimet e marra në emër të shoqërisë tregtare para regjistrimit të saj në regjistrin tregtar janë më të mëdha se kryegjësja bazë e përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin, themeluesit janë të obliguar ta paguajnë dallimin që mungon.

(6) Me regjistrimin e shoqërisë tregtare në regjistrin tregtar, para shoqëria shuhet. Pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, të drejtat dhe obligimet e marra nga para shoqëria janë të drejta dhe obligime të shoqërisë tregtare.

Kohëzgjatja e shoqërisë

Neni 24

(1) Shoqëria tregtare themelohet në kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar.

(2) Nëse me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin nuk është caktuar kohëzgjatja e shoqërisë tregtare, konsiderohet se shoqëria është themeluar për kohë të pacaktuar.

Shoqëria si person juridik

Neni 25

(1) Shoqëria tregtare si person juridik mund të fitojë të drejta dhe të marrë obligime, të fitojë pronësi dhe të drejta të tjera reale, të lidhë marrëveshje dhe punë të tjera juridike, të padisë dhe të jetë e paditur në gjyq, arbitrazh ose gjyq tjetër të zgjedhur dhe të merr pjesë në procedura të tjera.

(2) Shoqëria tregtare fiton cilësinë e personit juridik me regjistrim në regjistrin tregtar.

(3) Shoqërisë tregtare i shuhet cilësia e personit juridik me shlyerjen nga regjistrimi në regjistrin tregtar.

Filijala

Neni 26

(1) Shoqëria tregtare mund të kryejë veprimtari dhe punë nga lënda e punës së shoqërisë jashtë selisë përmes një ose më tepër filialeve.

(2) Filijala organizohet me vendimin që e merr organi kompetent i shoqërisë tregtare në pajtim me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin.

(3) Në vendimin për organizimin e filialeve shënohen firma dhe selia e themeluesit, lënda e punës së shoqërisë tregtare dhe të filialeve, veprimtaria kryesore sipas Klasifikimit nacional të veprimtarive dhe personave të filialeve - të autorizuar për përfaqësimin e shoqërisë. Filijala mund t'i kryejë të gjitha veprimtaritë nga lënda e punës së shoqërisë.

(4) Filijala nuk ka cilësinë e personit juridik. Nga puna e filialeve, të drejta dhe obligime fiton shoqëria tregtare.

(5) Filijala punon me firmën e shoqërisë tregtare që e ka organizuar, në të cilën obligativisht shënohen selia e saj dhe fjala "filiale". Filijala mundet firmës së shoqërisë t'i shtojë edhe emërtimin e vet.

(6) Filijala shuhet nëse organi kompetent i shoqërisë tregtare që e ka organizuar merr vendim për shuarjen e filialeve ose nëse shoqëria tregtare pushon së ekzistuari.

(7) Organizimi dhe shlyerja e filialeve shënohet në fletën e regjistrit në të cilën është regjistruar shoqëria tregtare. Shënimi shpallet në mënyrën e njëjtë si regjistrimet në regjistrin tregtar.

Përgjegjësia për obligimet

Neni 27

(1) Shoqëria tregtare mban përgjegjësi për obligimet e veta me tërë pronën e vet.

(2) Bashkëpronarët në shoqërinë tregtare publike dhe komplementaret në shoqërinë komanditore dhe në shoqërinë komanditore me aksione mbajnë përgjegjësi për obligimet e shoqërisë në mënyrë të pakufizuar dhe solidare me tërë pronën e tyre.

(3) Bashkëpronarët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionarët e shoqërisë aksionare si dhe komanditorët e shoqërisë komanditore dhe të

shoqërisë komanditore me aksione nuk mbajnë përgjegjësi për obligimet e shoqërisë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Përgjegjësia e veçantë e bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve

Neni 28

(1) Bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët e shoqërisë tregtare mbajnë përgjegjësi të pakufizuar dhe solidare për obligimet e shoqërisë në rastet kur:

- 1) kanë keqpërdorur shoqërinë si person juridik për të arritur qëllimet që për ata si individ, janë të ndaluara;
- 2) kanë keqpërdorur shoqërinë si person juridik që t'u shkaktojnë dëm kreditorëve të tyre;
- 3) në kundërshtim me ligjin, kanë disponuar me pronën e shoqërisë si me pronën e vet personale; ose
- 4) për dobi të vet ose për dobi të cilido personi tjetër e kanë zvogëluar pronën e shoqërisë, ndërsa e kanë ditur ose është dashur doemos ta dinë se shoqëria nuk është e aftë t'i kryejë obligimet e veta ndaj personave të tretë.

(2) Paragrafi 1 i këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohet edhe për përgjegjësinë e bashkëpronarit të fshehtë.

Personat të cilët mundën, përkatësisht personat të cilët nuk mundën të themelojnë shoqëri

Neni 29

(1) Shoqëri tregtare mund të themelojnë personat fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj.

(2) Shoqëri tregtare nuk mund të themelojnë:

- 1) shoqëritë tregtare llogaria e hapur e të cilave të cilido bartës i qarkullimit pagesor është e bllokuar dhe personat që janë anëtarë të organit të administrimit, organit mbikëqyrës, përkatësisht janë drejtorë të atyre shoqërive, derisa zgjat bllokimi i llogarisë së shoqërisë ose derisa ndaj të njëjtës nuk hapet procedurë e falimentimit apo likuidimit;
- 2) shoqëritë ndaj të cilave është hapur procedurë e likuidimit, derisa zgjat procedura;
- 3) personat që janë anëtarë të organit të administrimit, organit mbikëqyrës, përkatësisht janë drejtorë të atyre shoqërive, të cilave në procedurë të përcaktuar me ligj u është kumtuar ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, derisa zgjat ndalimi;
- 4) personi që është bashkëpronar në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të themeluar nga një person (SHPKNJP), llogaria e së cilës është e bllokuar derisa zgjat bllokimi i llogarisë së shoqërisë ose derisa ndaj të njëjtës nuk hapet procedurë e falimentimit apo likuidimit dhe
- 5) bashkëpronarët, drejtorët dhe anëtarët e organit të menaxhimit dhe organit të mbikëqyrjes të shoqërive për të cilat në pajtim me nenin 552-b të këtij ligji është filluar procedurë për shlyerje derisa zgjat ajo procedurë dhe në periudhë prej tre vjetësh nga dita e shpalljes së shlyerjes së shoqërisë në ueb faqen e Regjistrisë Qendrore përveç themeluesve, përkatësisht bashkëpronarëve që janë organizata financiare ndërkombëtare anëtare e të cilave është Republika e Maqedonisë dhe pjesëmarrja e së cilës në kryeqjënë themelore të shoqërisë është nën 50%.

5) personat për të cilët me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor është konstatuar se kanë kryer vepër penale likuidim të rrejshëm, shkaktim likuidimi me punë të pandërgjegjshme, keqpërdorim të procedurës së likuidimit, dëmtim ose privilegje të kreditorëve dhe u është kumtuar ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, derisa zgjasin pasojat juridike të ndalimit. ⁶

(3) Secili person mund të bëhet themelues i më tepër shoqërive, nëse me këtë ligj nuk ndalohet.

(4) Themelues të shoqërisë tregtare publike, përkatësisht themelues si komplementarë të shoqërisë komanditore ose të shoqërisë komanditore me aksione nuk mund të bëhen personat fizik që nuk kanë aftësi afariste.

(5) Personi fizik njëkohësisht mund të jetë bashkëpronar me përgjegjësi të pakufizuar vetëm në një shoqëri tregtare. Shoqëria publike tregtare, shoqëria komanditore dhe shoqëria komanditore me aksione nuk mund të bëhen bashkëpronarë me përgjegjësi të pakufizuar në shoqëri tjetër të atillë.

(6) Me fletëparaqitjen për regjistrim të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, themeluesit deponojnë deklaratë personale në formë elektronike, nëpërmjet sistemit njësportel se nuk ekziston ndonjë nga kufizimet e këtij neni ose kufizim tjetër i përcaktuar me këtë ose me ligj tjetër, për të themeluar shoqëri.

Personat të cilët nuk mund të udhëheqin dhe personat që janë të penguar ose kanë pushuar që t'i kryejnë funksionet e tyre në organin e udhëheqjes në shoqëritë tregtare

Neni 29-a

(1) Personat nga neni 29 paragrafi (2) pikat 1 dhe 3 të këtij ligji nuk mund të jenë drejtorë, anëtarë të organit të menaxhimit dhe organit të mbikëqyrjes së shoqërisë tregtare derisa tek ato ekzistojnë këto kufizime, kurse personi nga pika 5 të këtij paragrafi nga dita e fillimit të procedurës për shlyerje dhe në periudhë prej tre vjetësh nga dita e shpalljes së shlyerjes së shoqërisë në ueb faqen e Regjistrit Qendror.

(2) Personat që janë të penguar ose kanë pushuar që t'i kryejnë funksionet e tyre në organet e udhëheqjes në shoqëritë tregtare, janë personat të cilët, për çfarëdo shkak, janë të penguar ose kanë pushuar që t'i kryejnë funksionet e tyre gjatë mandatit në organet e udhëheqjes, pandërprerë në afat më të gjatë se 30 ditë.

(3) Personat nga paragrafi (2) i këtij neni, janë të detyruar që menjëherë nga ndodhja e shkakut për shuarje apo pengesë, të emërojnë të autorizuar në pajtim me nenin 66 paragrafi (2) të këtij ligji, ose ta njoftojnë organin që e kryen zgjedhjen e tyre, për caktimin e ushtruesit të përkohshëm të funksioneve nga paragrafi (2) i këtij neni. Vendimi për caktimin e ushtruesit të përkohshëm të funksioneve, dërgohet për regjistrim në regjistrin tregtar.

(4) Në rastin kur në shoqëri nuk është caktuar ushtruesi i përkohshëm i funksioneve nga paragrafi (2) i këtij neni, në mënyrën e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, ose në mënyrën e përcaktuar për ndonjërin nga format e veçanta, shoqëritë tregtare në pajtim më dispozitat e këtij ligji, secili person që ka interes juridik mundet me propozim të kërkojë që

gjykata të caktojë person tjetër fizik, i cili do të jetë ushtrues i përkohshëm i funksioneve nga paragrafi (2) i këtij neni, me pajtim paraprak të personit që duhet të caktohet. Gjykata me detyrë zyrtare, vendimin e plotfuqishëm për caktimin e këtyre personave, menjëherë e dorëzon te Regjistri qendror, për regjistrim në regjistrin tregtar.

(5) Gjatë regjistrimit në regjistrin tregtar nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, Regjistri qendror e shënon vërejtjen se funksionet personave nga paragrafi (2) i këtij neni u pezullohen.

(6) Personat që janë caktuar si ushtrues të përkohshëm të funksioneve nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, i kryejnë vetëm punët e paprolongueshme të shoqërisë deri në pushimin e shkaqeve për shuarjen ose pengimin, përkatësisht deri në zgjedhjen e anëtarit të ri të organit të administrimit të shoqërisë, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Regjistri i personave të cilët nuk mund të themelojnë dhe të udhëheqin me shoqëri tregtare dhe i personave që janë të penguar ose kanë pushuar që t'i kryejnë funksionet e tyre në organin e udhëheqjes në shoqëritë tregtare në Republikën e Maqedonisë

Neni 29-b

(1) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, mban regjistër elektronik të personave të cilët nuk mund të themelojnë dhe të udhëheqin dhe personave që janë të penguar ose kanë pushuar që t'i kryejnë funksionet e tyre në organet e udhëheqjes në shoqëritë tregtare në Republikën e Maqedonisë.

(2) Bartësi i qarkullimit pagesor nëpërmjet regjistrimit unik të llogarive të transaksionit (RULLT) e njofton Regjistrin Qendror për çdo bllokim të krijuar në llogarinë e transaksionit të pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor në kohë reale, si dhe për zhbllokim të së njëjtës. Regjistri Qendror menjëherë pas marrjes të informacionit nga RULLT-i bën regjistrimin ose e shlyen regjistrimin e personit nga regjistri i paragrafit (1) të këtij neni, në pajtim me të dhënat të cilat i posedon për personat në regjistrin tregtar.

(3) Organet kompetente të cilat shqiptojnë ndalime nga neni 29, paragrafi (2), pika 3 të këtij ligji e njoftojnë Regjistrin Qendror për shqiptimin e ndalimeve pa prolongim.

(4) Për personat nga neni 29, paragrafi (2) dhe neni 29 - a paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, në regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni, Regjistri Qendror pa prolongim e regjistron emrin, mbiemrin dhe NUAQ të personave fizikë, përkatësisht firmës, selinë dhe NUAP të personave juridikë dhe selinë e tyre të regjistruar.

(5) Pas pushimit të kufizimeve, përkatësisht shkaqeve për shuarje ose pengesë të personat e përcaktuar në nenin 29, paragrafi (2) dhe neni 29-a paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, Regjistri Qendror pa prolongim i shlyen nga regjistri i paragrafit (1) të këtij neni të gjitha të dhënat e regjistruara për ta.

(6) Të dhënat e regjistruara në regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni janë publike dhe çdo person mund të kërkojë informacion për të njëjtat nga Regjistri Qendror.

(7) Ministri i Ekonomisë më afërsisht do t'i përcaktojë mënyrën e udhëheqjes, formën dhe përmbajtjen e Regjistrimit të personave të cilët nuk mund të themelojnë dhe të udhëheqin dhe personave që janë të penguar ose kanë pushuar që t'i kryejnë funksionet e tyre, në organin e udhëheqjes në shoqëritë tregtare në Republikën e Maqedonisë.

Personi i huaj - bashkëpronar, përkatësisht aksionar

Neni 30

(1) Bashkëpronar, përkatësisht aksionar mund të bëhet edhe secili person i huaj.

(2) Personi i huaj mund të fitojë pjesë ose aksione me kushte dhe mënyrë të parapara për shtetasit e Republikës së Maqedonisë dhe për personat juridik të regjistruar në regjistrin tregtar në territorin e Republikës së Maqedonisë, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Pjesëmarrja e personit të huaj në shoqërinë e re të themeluar dhe në shoqërinë tregtare të përhershme nuk është e kufizuar, përveç nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Shoqëria tregtare me pjesëmarrje të huaj i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet si shoqëria tregtare pa pjesëmarrje të huaj, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

Të drejtat e personave të huaj

Neni 31

(1) Të drejtat e fituara në bazë të depozitimeve të personave të huaj në shoqërinë tregtare nuk mund të zvogëlohen me ligj ose dispozitë tjetër.

(2) Pjesa e fitimit të shoqërisë tregtare që i takon personit të huaj, përkatësisht shuma në rast të tjetërsimit të plotë ose të pjesërisht të pjesës ose aksioneve të personit të huaj, mundet me urdhëresë të personit të huaj, lirisht, pa leje të dërgohet jashtë me valutë të depozitimit nëse shoqëria disponon me mbulesë në para, me kushte të përcaktuara me ligj.

(3) Nëse zbatohet falimentim ose likuidim i shoqërisë tregtare, pas përfundimit të procedurës falimentuese, përkatësisht likuiduese, personi i huaj ka të drejtë ta kthejë depozitimin e futur jomonetar me kushtet e përcaktuara me ligj.

(4) Privilegjet dhe kushtet e veçanta të volitshme për depozitimin dhe afarizmin e personave të huaj përcaktohen me ligj.

Deklarata për themelim, ndryshime të statusit dhe për transformim

Neni 32

(1) Themeluesit e shoqërisë tregtare si dhe anëtarët e parë të organeve të administrimit, përkatësisht administruesi, përveç anëtarëve të parë të organeve të administrimit gjatë themelimit simultan të shoqërisë aksionare, fletëregjistrimit për themelimin e shoqërisë tregtare në regjistrin tregtar i bashkëngjisin deklaratën në të cilën shënohen veprimet e kryera më qëllim sipas rregullit të themelohet shoqëria tregtare dhe me

të cilën konfirmojnë se shoqërinë tregtare e kanë themeluar sipas ligjit dhe të dhënat në shtojcë (dokumentet dhe dëshmitë) që ia bashkëngjisin fletëregjistrimit për themelimin e shoqërisë tregtare janë të sakta dhe në pajtim me ligjin. Deklarata mund të parashtrohet në formë elektronike nëpërmjet sistemit njësportel, në pajtim me Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrimin elektronik, Ligjin për Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe dispozitat për sistemin njësportel.

(2) Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet edhe me rastin e ndryshimit të marrëveshjes për shoqërinë, përkatësisht të statutit. Deklaratën e japin anëtarët e organeve të administrimit, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, nëse shoqëria tregtare ka organ të mbikëqyrjes, të cilët e kryejnë këtë funksion gjatë ndryshimeve të marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht statutit.

(3) Në rast të bashkëngjitjes, bashkimit ose ndarjes së shoqërisë tregtare, përkatësisht transformimit të shoqërisë nga një formë në formë tjetër, deklarata nga paragrafi 1 i këtij neni, me përmbajtjen përkatëse për bashkëngjitjen, bashkimin, ndarjen, përkatësisht transformimin nga një formë në formë tjetër të shoqërisë, e paraqesin anëtarët e organeve të administrimit, administruesi, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, që e kryen funksionin në shoqërinë që bashkëngjitet dhe në shoqërinë të cilës i bashkëngjitet, në shoqëritë që bashkohen, në shoqërinë që ndahet dhe në shoqërinë që e merr pjesën e pronës dhe të obligimeve të shoqërisë që ndahet me shpërndarje me marrje dhe veçim me marrje, përkatësisht në shoqërinë që transformohet.

(4) Refuzohet regjistrimi në regjistrin tregtar për themelim, të ndryshimeve të marrëveshjes për shoqërinë, përkatësisht statutit, ndryshimit statusor të shoqërisë tregtare, përkatësisht transformimit nga një formë në tjetër të shoqërisë, nëse nuk paraqitet deklaratë përkatëse nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

(5) Deklarata nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni parashtrohet si shtojcë nëpërmjet Sistemit për e-regjistrim, e nënshkruar me nënshkrim personal elektronik ose nëpërmjet agentit regjistruar.

Vërtetimi i pavlefshmërisë së shoqërisë

Neni 33

- (1) Pavlefshmëria e shoqërisë mund të vërtetohet vetëm në rastet si vijon:
- 1) mosekzistim i marrëveshjes për shoqërinë, përkatësisht të statutit ose nëse marrëveshja e shoqërisë, përkatësisht statutit nuk është lidhur, përkatësisht miratuar në formën e caktuar me këtë ligj;
 - 2) nëse gjatë themelimit të shoqërisë, në marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin nuk janë shënuar veç e veç depozitimet e regjistruara të bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve, shuma e përgjithshme e kryegjësë së regjistruar, ose nuk janë shënuar firma dhe lënda e punës së shoqërisë ose lënda e punës së shoqërisë nuk është në pajtim me ligjin ose zakonet e mira afariste;
 - 3) nuk është paguar, përkatësisht futur shuma më e vogël e përcaktuar me ligj e kryegjësë bazë;
 - 4) e fshirë 
 - 5) paaftësisë afariste të të gjithë themeluesve, dhe
 - 6) nëse numri i themeluesve të shoqërisë është më i vogël nga numri i themeluesve i caktuar me këtë ligj për formën e caktuar të shoqërisë.

(2) Secili bashkëpronar ose aksionar, përkatësisht administrues, anëtar i organit të administrimit, përkatësisht anëtar i këshillit mbikëqyrës, kontrollor, revizor i autorizuar ose kreditor mundet me padi të kërkojë nga gjyqi ta vërtetojë pavlefshmërinë e shoqërisë tregtare.

(3) Gjyqi do ta vërtetojë pavlefshmërinë e shoqërisë tregtare vetëm nëse deri në marrjen e vendimit për këtë, cenimi i ligjit nuk është mënjeluar ose nuk do të mënjanohet në afatin e caktuar nga gjyqi, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre muaj. Padia mund të paraqitet në afat prej tre vjetëve nga dita e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar. Në padinë dhe obligimet e organeve të administrimit për paraqitjen e padisë në gjyqin i cili e ka bërë regjistrimin në regjistrin tregtar të shoqërisë për të cilën kërkohet vërtetimi i pavlefshmërisë në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga neni 415 i këtij ligji. Organet e administrimit të shoqërisë tregtare paraqesin kopje të vërtetuar të padisë, pa shtyrje nga dita kur është bërë paraqitja në Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë, i cili e shënon në regjistrin tregtar udhëheqjen e kontestit, ndërsa pavlefshmërinë e shoqërisë e shënon pasi të dorëzohet vendimi i plotfuqishëm me të cilin konfirmohet se shoqëria është e pavlefshme. Vendimi i plotfuqishëm me të cilin refuzohet kërkesa paditëse për vërtetimin e pavlefshmërisë së shoqërisë tregtare shënohet në regjistrin tregtar.

(4) Vendimi i plotfuqishëm me të cilin pavlefshmëria e vërtetuar e shoqërisë tregtare rezulton me veprim juridik ndaj personave të tretë ditën vijuese nga dita e shpalljes së tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(5) Në aspektin e punëve të marra juridike pavlefshmëria e shoqërisë tregtare nuk ndikon te personat e tretë.

(6) Bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët kanë obligim ta paguajnë depozitimin për të cilin kanë marrë obligim ta paguajnë, ndërsa ende nuk e kanë paguar, deri në shumën e duhur për përmbushjen e obligimeve të shoqërisë.

(7) Pas shpalljes së vendimit të plotfuqishëm nga paragrafi 4 i këtij neni, gjyqi cakton likuiduesin që zbaton likuidimin e shoqërisë tregtare.

Depozitimet në kryegjënë

Neni 34

(1) Depozitimet që depozitohen, përkatësisht futen gjatë themelimit të shoqërisë tregtare, përkatësisht gjatë rritjes së kryegjësë bazë i lihen në disponim shoqërisë.

(2) Depozitimet mund të jenë në monetë (në tekstin e mëtejshëm: depozitime monetare), në sende (të tundshme dhe të patundshme) dhe të drejta me vlerë pronësore, të cilat mund të vlerësohen dhe të shprehen me para (në tekstin e mëtejshëm: depozitime jomonetare) ose vetëm në monetë, vetëm në sende ose vetëm në të drejta. Depozitat mund të përbëhen edhe nga hua, respektivisht pagesa plotësuese shtesë, kur subjektet nga neni 3, paragrafi (1), pika 4-a janë huadhënës. Me përjashtim, bashkëpronarët e shoqërisë publike tregtare, përkatësisht komplementaret e shoqërisë komanditore mund të depozitojnë edhe punë edhe shërbime.

(3) Depozitimet nuk mund t'u kthehen bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve të shoqërisë, përveç në rastet e caktuara me këtë ligj.

Depozitimi jomonetar

Neni 35

(1) Kur në shoqërinë tregtare futet depozitimi jomonetar, në marrëveshjen e shoqërisë, në statut, përkatësisht në vendimin për rritjen e kryegjësë bazë futet firma, emri, përkatësisht emri i personit që e fut depozitimin jomonetar, përshkrim i hollësishëm i depozitimit jomonetar dhe vlera e tij e përcaktuar e shprehur në para.

(2) Depozitimi jomonetar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, shoqërisë aksionare, shoqërisë komanditore dhe shoqërisë komanditore me aksione vlerësohet nga vlerësuesi i autorizuar (një ose më tepër), i caktuar nga themeluesit, bashkëpronarët, aksionarët, përkatësisht organet e shoqërisë nga lista e vlerësuesve të autorizuar.

(3) Vlerësuesi mund të kërkojë nga personi që e fut depozitimin dhe nga organi administrues i shoqërisë t'i ofrojë të gjitha sqarimet dhe të dhënat e duhura për ta bërë vlerësimin. Vlerësuesi ka të drejtë për kompensim në para për shpenzimet dhe shërbimin e kryer.

(4) Vlerësuesi ka përgjegjësi personale dhe të pakufizuar me tërë pronën e tij për saktësinë e të dhënave në raportin vlerësues, për vlerën e përcaktuar të depozitimit jomonetar dhe mban përgjegjësi penale nëse nuk e zbaton kodeksin për etikën e vlerësuesve të autorizuar dhe standardeve ndërkombëtare për vlerësim për arsye se jo realisht i ka vlerësuar depozitimet jomonetare që i merr shoqëria tregtare.

(5) Në shoqërinë tregtare mund të futen vetëm depozitimet jomonetare të cilëve me vlerësim mund t'u caktohet vlera në para.

(6) Vlerësuesi i autorizuar bën raportin për vlerën e përcaktuar të depozitimit jomonetar, në pajtim me standardet ndërkombëtare për vlerësim. Raporti për vlerësim përmban përshkrimin e depozitimit jomonetar, metodës me të cilën është bërë vlerësimi i depozitimit, përkatësisht shndërrimit të borxhit në depozitim dhe se vlera e përcaktuar me këto metoda përkon me shumën nominale të pjesës, përkatësisht aksioneve si dhe premisë që kërkohet për ato. Raportit i bashkëngjitet dëshmia për pronësi të sendeve të tundshme e të patundshme për të cilat me ligj është caktuar obligimi për evidentim (regjistrim). Ekzemplari i raportit për vlerësimin e depozitimit jomonetar me fletëregjistrimin paraqitet në regjistrin tregtar bashkë me marrëveshjen e shoqërisë, statutin, vendimin për rritjen e kryegjësë bazë ose me akt tjetër përkatës me të cilin, sipas këtij ligji, bëhet futja e depozitimeve jomonetare.

(7) Gjatë regjistrimit në regjistrin tregtar nuk kontrollohet saktësia e të dhënave, përkatësisht e vlerës së përcaktuar.

(8) Vlera e depozitimit jomonetar, e caktuar në marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin, përkatësisht vendimin për rritjen e kryegjësë bazë nuk mund të jetë më e madhe nga vlera e përcaktuar në raportin vlerësues.

(9) Nëse depozitimi jomonetar është me vlerë më të ulët nga ajo që e ka treguar depozituesi i depozitimit jomonetar nga vlera e përcaktuar në raportin për vlerësim, depozituesi i depozitimit jomonetar doemos duhet dallimin ta kompensojë me pagesë në para, nëse themeluesit e tjerë, përkatësisht bashkëpronarët ose aksionarët këtë e pranojnë.

(10) Personat që kanë fituar pjesë, përkatësisht aksione në këmbim me depozitime jomonetare kanë përgjegjësi personale dhe të pakufizuar me tërë pronën e tyre ndaj shoqërisë tregtare për vlerën e depozitimeve jomonetare të përcaktuar në raportin për vlerësim në afat prej pesë vjetëve nga dita e shpalljes së regjistrimit në regjistrin tregtar të marrëveshjes së shoqërisë, statutit, përkatësisht vendimit për rritjen e kryegjësë bazë.

Pjesëmarrja në fitim

Neni 36

Bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët marrin pjesë në ndarjen e fitimit që u takon në shoqërinë tregtare, me kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin.

Shpallja e regjistrimeve

Neni 37

(1) Të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar shpallen në tërësi në faqen e internetit të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë, përveç në rast kur me këtë ligj ose me ligj tjetër përcaktohet që të dhënat të shpallen pjesërisht, të mos shpallen, ose caktohet mënyrë tjetër e shpalljes së tyre. Shpenzimet për shpallje janë në llogari të subjektit të regjistrimit.

(2) Në rast kur gjykata ka miratuar vendim të prerë në pajtim me të cilin duhet të realizohet regjistrimi, ndryshimi ose shlyerja e të dhënave në regjistrin tregtar, gjykata me detyrë zyrtare në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë e dërgon vendimin për regjistrimin e tij në regjistrin tregtar, përkatësisht për shpalljen e të dhënave të tij në faqen e internetit të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë kur kjo përcaktohet me këtë ligj. Në shpallje në faqen e internetit të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë theksohen aktet në bazë të të cilave është realizuar regjistrimi dhe theksohet e drejta e shikimit të këtyre akteve në regjistrin tregtar.

(3) Subjekti i regjistrimit, me shpenzim të vet dhe me zgjedhje të vet, të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar mund t'i shpallë edhe në shtypin ditor.

(4) Personat e tretë mund të thirren vetëm në të dhënat për të cilat në pajtim me këtë ligj përcaktohet shpallja e tyre në faqen e internetit të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë nga dita e shpalljes së tyre.

(5) Personat e tretë mund të thirren vetëm në të dhënat për të cilat në pajtim me këtë ligj përcaktohet shpallja e tyre në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nga dita e botimit të tyre.

(6) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" sipas nevojës botojnë edicione speciale me të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar.

(7) Kur me këtë ligj përcaktohet detyrimi që shpallja të kryhet në gazetë ditore, shpallja kryhet në gazetë ditore që shpërndahehet në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Paraqitja e të dhënave ndaj personave të tretë

Neni 38

(1) Të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar mund të paraqiten ndaj personave të tretë vetëm pas shpalljes së tyre sipas këtij ligji, përveç nëse shoqëria tregtare vërteton se personi i tretë ka ditur për ato para shpalljes. Në aspektin e punëve juridike të marra para skadimit të 15 ditëve llogaritur nga dita vijuese e ditës së shpalljes, të dhënat dhe përmbajtja e dokumenteve nuk mund të paraqiten ndaj personave të tretë të cilët do të dëshmojnë se për ato nuk kanë pasur mundësi të dinë.

(2) Nëse ekziston jopërpuethshmëri e të dhënave të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" me të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar, papërpuethshmëria nuk mund të paraqitet ndaj personave të tretë. Personat e tretë mund të thirren në të dhënat e shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" përkatësisht në faqen e internetit të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë përveç nëse shoqëria dëshmon se ata kanë qenë të njoftuar me të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar.

E drejta për informim e bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit

Neni 39

(1) Për realizimin e të drejtave të caktuara me ligj, marrëveshjen e shoqërisë dhe me statut, secili bashkëpronar përkatësisht aksionar i shoqërisë, edhe kur nuk merr pjesë në administrim, ka të drejtë të informohet personalisht për punën e shoqërisë dhe të drejtën e qasjes në librat, aktet dhe dokumentet e tjera të shoqërisë.

(2) Secili bashkëpronar përkatësisht aksionar ka të drejtë të kërkojë kopje të akteve dhe dokumenteve që janë lëndë e shqyrtimit dhe vendosjes në tubimin e bashkëpronarëve ose vendosjes përmes letërkëmbimit, përkatësisht në kuvend. Shoqëria tregtare është e obliguar t'u sigurojë kopje pa kompensim. Në të gjitha rastet tjera kompensimi nuk mund të jetë më i madh nga shpenzimet reale.

(3) Nëse bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit nuk i mundësohet realizimi i të drejtës nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, bashkëpronari, përkatësisht aksionari ka të drejtë mbrojtjeje të të drejtave të tij në gjyq sipas kushteve dhe mënyrës të caktuara me ligj.

(4) Secila dispozitë e marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht statutit, që nuk përkon me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni konsiderohet e pavlefshme.

Obligimi për pagesën e depozitimit dhe regjimi juridik i pronës së shoqërisë

Neni 40

(1) Bashkëpronarët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përkatësisht aksionarët e shoqërisë aksionare, kanë përgjegjësi ta paguajnë depozitimin monetar, përkatësisht ta fusin depozitimin jomonetar në shoqërinë që e kanë regjistruar dhe nuk mund të lirohen nga ky obligim, përveç rasteve kur kjo është e caktuar me këtë ligj.

(2) Depozitimet e futura në shoqëri i takojnë shoqërisë.

(3) Kreditori i bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit nuk mund ta përmbushë kërkesën e tij ndaj bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit nga prona e shoqërisë.

(4) Kreditori i shoqërisë nuk mund t'i përmbushë kërkesat e tij nga prona e bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit, përveç rasteve të caktuara me këtë ligj.

Zgjidhja e kontesteve me marrëveshje ose arbitrazh

Neni 41

(1) Bashkëpronarët përkatësisht aksionarët e shoqërisë tregtare mund të merren vesh që kontestet për marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin, së pari t'i zgjidhin me marrëveshje, duke përfshirë ndërmjetësimin (mediatorë) dhe negociatat.

(2) Bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët nëse nuk mundën që kontestet nga paragrafi 1 i këtij neni t'i zgjidhin me marrëveshje, ato mund t'i zgjidhin me arbitrazh nëse kështu merren vesh.

Mbrojtja e të drejtës në gjyq

Neni 42

Nëse organi i shoqërisë tregtare cenon të drejtën e bashkëpronarëve përkatësisht aksionarëve, që del nga bashkëpronësia, secili bashkëpjesëmarrës, përkatësisht aksionar mund të kërkojë mbrojtjen e kësaj të drejte në gjyq që është kompetent sipas Ligjit për gjyqet.

Vlerësimi i ligjshmërisë

Neni 43

(1) Nëse marrëveshja e shoqërisë, statutit dhe akteve të tjera të përgjithshme të shoqërisë, përkatësisht dispozitat e tyre janë në kundërshtim me ligjin, janë të pavlefshme.

(2) Gjyqi me propozim të bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit, të anëtarit të organit të administrimit, përkatësisht të anëtarit të këshillit mbikëqyrës ose kontrollorit, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, e vlerëson ligjshmërinë e akteve, përkatësisht dispozitave të akteve nga paragrafi 1 i këtij neni. Propozim mund të paraqesë edhe çdo person që paraprakisht dëshmon se ka interes juridik.

(3) Nëse gjyqi vlerëson se akti nga paragrafi 1 i këtij neni, përkatësisht dispozita e tij është në kundërshtim me ligjin, merr vendim me të cilin vërteton se akti, përkatësisht dispozita është në kundërshtim me ligjin.

(4) E drejta nga paragrafi 2 e këtij neni mund të realizohet pas mbarimit të procedurës për regjistrim në regjistrin tregtar.

KAPITULLI I DYTË

SHENJAT E SHOQËRIVE TREGTARE

SEKSIONI 1

FIRMA

Nocioni i firmës

Neni 44

(1) Firma e shoqërisë tregtare është emri me të cilin shoqëria punon dhe merr pjesë në qarkullim juridik.

(2) Firma e shoqërisë tregtare caktohet dhe ndryshohet me mënyrën e caktuar me deklaratë për themelimin e shoqërisë nga një person, me marrëveshjen e shoqërisë, respektivisht statutin.

(3) Firma e shoqërisë tregtare dhe ndryshimet e saja regjistrohen në regjistrin tregtar.

Parimi i vërtetësisë

Neni 45

Të dhënat e përmbajtura në firmë doemos duhet të jenë të vërteta.

Përmbajtja e firmës

Neni 46

(1) Firma përmban shenjën që tregon lëndën e punës të shoqërisë tregtare, selinë dhe formën e shoqërisë.

(2) Firma mund të përmbajë shtesa (vizatime, piktura, simbole, shenja etj.) që shërbejnë për shënimin më të afërt të shoqërisë tregtare, përveç atyre që krijojnë ose mund të krijojnë huti në aspektin e lëndës së punës të shoqërisë tregtare përshtypjes dhe identitetit ose lidhshmërisë me shoqëri tjetër tregtare ose që çojnë në cenimin e të drejtave të pronësisë industriale ose të drejtave tjera të shoqërive tjera tregtare, përkatësisht personave të regjistruar në vend dhe jashtë vendit.

(3) Firma mund të përdoret edhe si markë tregtare, në mënyrë dhe kushte të caktuara me ligj.

Përmbajtës të palejuar të firmës

Neni 47

(1) Firma nuk mund të përmbajë emra, flamuj, stema ose amblema tjera shtetërore të shteteve tjera ose organizatave ndërkombëtare pa lejen e tyre, dhe nuk mund të imitohen në aspektin heraldik.

(2) Firma nuk mund të përmbajë shenja zyrtare të kontrollit dhe garancionit për kualitet.

(3) Firma nuk mund të përmbajë edhe fjalë që krijojnë përzierje ose ngjashmëri me firmën e shoqërisë tjetër, emrin, përkatësisht titullin e institucionit ose subjektit tjetër.

Përdorimi i emrit "Maqedoni" ose emrit të njësisë së vetadministrimit lokal

Neni 48

(1) Emri "Maqedoni" dhe fjalët që dalin nga kjo si dhe shkurtesat e tij, flamuri dhe stema mund të mbajnë firmat vetëm me lejen e Ministrisë së drejtësisë.

(2) Leje nga organi kompetent i njësisë së vetadministrimit lokal duhet kur në firmë përdoren fjalë në të cilat përfshihet emri i njësisë së vetadministrimit lokal.

Përdorimi i emrit të personit

Neni 49

(1) Në firmë mund të futet emri dhe mbiemri i ndonjë personi fizik vetëm me pëlqimin e tij ose nëse personi fizik ka vdekur, me pëlqimin e familjarëve deri në shkallën e tretë të vijës së drejtë.

(2) Në firmë mund të futet emri dhe mbiemri i personit historik ose tjetër të njohur, vetëm me pajtimin e personit ose nëse ka vdekur me pajtimin e familjarëve të tij deri në shkallën e tretë të vijës së drejtë, nëse ata nuk ekzistojnë pëlqim jep Ministria e drejtësisë.

(3) Nëse në ndonjë mënyrë cenohet nderi dhe prestigji i personit fizik emri dhe mbiemri i të cilit është futur në firmë, me kërkesë të tij, ose nëse ka vdekur me kërkesë të trashëgimtarëve të tij, gjyqi me padi e ndalon përdorimin e atillë. Nëse në afat prej tetë ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për ndalim nuk paraqitet kërkesë për ndryshimin e firmës, gjyqi cakton likuiduesin i cili zbaton likuidimin e shoqërisë tregtare.

Përdorimi i gjuhës maqedonase dhe gjuhëve të tjera

Neni 50

(1) Firma e shoqërisë tregtare duhet të jetë në gjuhën maqedonase, me shkrim cirilik.

(2) Firma e shoqërisë tregtare me seli në njësinë e vetadministrimit lokal ku së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare - tjetër nga maqedonishtja mund të jetë edhe në atë gjuhë dhe përdoret vetëm së bashku me mbishkrimin e firmës në gjuhën maqedonase, me shkrim cirilik.

Firma e shoqërisë në falimentim dhe në likuidim

Neni 51

Firmës së shoqërisë tregtare ndaj të cilës është hapur procedura falimentuese ose likuiduese, obligativisht i shtohet shenja "në falimentim" respektivisht "në likuidim" dhe kështu regjistrohet në regjistrin tregtar.

Mënyra e përdorimit të firmës

Neni 52

(1) Shoqëria tregtare në punën e saj, doemos duhet ta përdorë firmën ashtu si është regjistruar në regjistrin tregtar.

(2) Shoqëria tregtare mund të përdorë edhe emër të shkurtuar të firmës, i cili doemos duhet të përmbajë shenjën sipas të cilës shoqëria dallohet nga shoqëritë e tjera tregtare, shenjën e shkurtuar të formës së shoqërisë me seli të përcaktuar me këtë ligj.

(3) Emri i shkurtuar i firmës regjistrohet në regjistrin tregtar.

(4) Firma ose emri i shkurtuar i firmës doemos duhet të paraqitet në lokalet afariste.

Kushtet për bartjen e firmës

Neni 53

(1) Firma mund të bartet te tjetri vetëm bashkë me ndërmarrjen ose me pjesën më të madhe të ndërmarrjes.

(2) Për bartjen e firmës e cila përmban emrin e personit fizik duhet pëlqimi i atij personi, ose nëse ka vdekur pëlqimi i familjarëve të tij deri në shkallën e tretë të vijës së drejtë.

Firmat dhe ndryshimet në shoqëri

Neni 54

Nëse në shoqërinë tregtare vjen bashkëpronar i ri ose nga shoqëria del ndonjë bashkëpronar, firma ekzistuese mundet të përdoret edhe më tej.

Parimi i unifikimit të firmës

Neni 55

Secila pjesë e shoqërisë tregtare doemos duhet të dalë në qarkullim juridik me firmën e njëjtë me mundësi që firmës t'i shtohet shenja që tregon se fjala është për një pjesë të shoqërisë.

Parimi i përjashtimit

Neni 56

(1) Firma e re e shoqërisë tregtare duhet qartë të dallohet nga të gjitha firmat e shoqërive të regjistruara në regjistrin tregtar.

(2) Në regjistrin tregtar nuk mund të regjistrohet firma që është e njëjtë me firmën e regjistruar më parë ose firma e cila qartë nuk dallohet nga firma e regjistruar më parë. Në këtë kihet kujdes me detyrë zyrtare.

(3) Nëse bashkëpjesëmarrësi në shoqërinë publike tregtare ose komplementari në shoqërinë komanditore dhe shoqërinë komanditore me aksione e ka emrin dhe mbiemrin e njëjtë me të cilin tjetri është regjistruar ose paraqitur në regjistrin tregtar, doemos duhet emrit dhe mbiemrit të tij t'i vëre shtesë sipas të cilës firma e tij qartë do të dallohet nga firmat e regjistruara ose të paraqitura.

(4) Dallimi i qartë është ai që mund të vërehet me kujdes që është e zakonshme në qarkullimin afarist.

(5) Shoqëritë tregtare të lidhura dhe shoqëritë tregtare të cilat me çfarëdo baze dhe në kuadër të lëndës së punës janë të lidhura me personin e

vendit ose të huaj, munden me pëlqimin e tij të përdorin shenja të përbashkëta në firmë ose ta shënojnë lidhshmërinë në mënyrë të zakonshme.

Parimi i përparësisë

Neni 57

(1) Nëse për regjistrim në regjistrin tregtar paraqiten firma të njëjta, ose firma të cilat dukshëm nuk dallohen në mes tyre, do të regjistrohet ajo firmë e cila është paraqitur më herët.

(2) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni, do të regjistrohet firma e paraqitur më vonë nëse paraqitësi i fletëparaqitjes së mëvonshme dëshmon se në kohën e paraqitjes së mëhershme e ka përdorur në treg atë firmë, respektivisht shenjat qenësore të saj si shenjë të ndërmarrjes së vet ose si markë tregtare për shënimin e prodhimeve të veta ose shërbimeve dhe se këtë e ka bërë para paraqitësit të fletëparaqitjes së mëhershme.

Mbrojtja e të drejtave të pronarit të firmës së paraqitur më herët

Neni 58

(1) Tregtari që me përdorimin e përmbajtjes së ngjashme të firmës të regjistruar në regjistrin tregtar, i cenon të drejtat e tregtarit tjetër ose e rrezikon pozitën e tij në konkurrencën tregtare, ose ekziston rreziku të drejtat dhe pozita e tij në konkurrencën tregtare të cenohen ose rrezikohen, ose nëse tregtari tjetër (me përdorimin e firmës) në mënyrë të paautorizuar e shfrytëzon prestigjin e tij afarist, ose e përvetëson atë, mund të paraqesë padi dhe të kërkoj t'i ndalohet tregtarit tjetër ta përdorë firmën si dhe ta kompensojë dëmin e shkaktuar me përdorimin e firmës.

(2) Nëse në afat prej tetë ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për ndalesë nuk paraqitet kërkesë për ndryshimin e firmës, gjyqi cakton likuiduesin për likuidimin e shoqërisë tregtare.

(3) Padia mund të paraqitet në afat prej tri vjetëve nga dita e shpalljes së regjistrimit të firmës.

(4) Vendimi i plotfuqishëm i gjyqit me të cilin pranohet fletë padia, gjyqi e shpall me shpenzime të të paditurit në gazetën që e cakton paditësi.

Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të ngjashme dhe të drejtave të pronësisë industriale

Neni 59

Pa dallim nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 58 të këtij ligji, tregtari mundet t'i mbrojë të drejtat e veta në aspektin e përdorimit dhe regjistrimit të firmës në regjistrin tregtar dhe në bazë të ligjit me të cilin rregullohet mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme dhe të ligjit me të cilin rregullohet pronësia industriale.

SEKSIONI 2

SELIA

Nocioni

Neni 60

Selia e shoqërisë tregtare është vendi në të cilin është regjistruar në regjistrin tregtar.

Ndërrimi i selisë

Neni 61

- (1) Shoqëria tregtare mundet ta ndërrojë selinë.
- (2) Ndryshimi i selisë bëhet në mënyrë dhe sipas procedurës së caktuar me deklaratën për themelimin e shoqërisë nga një person, me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht me statutin.
- (3) Ndërrimi i selisë së shoqërisë tregtare regjistrohet në regjistrin tregtar.

SEKSIONI 3

LËNDA E PUNËS

Liria e kryerjes së veprimtarisë

Neni 62

- (1) Shoqëria tregtare mundet si lëndë të punës t'i kryejë të gjitha veprimtaritë që nuk ndalohen me ligj.
- (2) Nëse për veprimtari të caktuara me ligj është përcaktuar se mund të kryhen vetëm në bazë të pajtueshmërisë, lejes apo me akt tjetër të organit shtetëror apo të organit tjetër kompetent, ato veprimtari mund të kryhen vetëm në bazë të pajtueshmërisë, lejes apo aktit tjetër të atij organi.
- (3) Shoqëria tregtare mundet pa regjistrim në regjistrin tregtar të kryejë edhe veprimtari të tjera të duhura për ekzistimin e saj dhe për kryerjen e punëve nga lënda e punës, por të cilat nuk bëjnë pjesë drejtpërdrejt në kuadër të punëve nga lënda e punës.

Plotësimi i kushteve të veçanta

Neni 63

- (1) Shoqëria tregtare mund të fillojë të kryejë veprimtari që është lëndë e punës së shoqërisë pas regjistrimit të lëndës së punës në regjistrin tregtar dhe pas marrjes së lejes nga organi kompetent për plotësimin e kushteve të përcaktuara për kryerjen e veprimtarisë në kuadër të lëndës së punës nëse kjo është e përcaktuar me ligj.
- (2) Leja nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ka rëndësi për regjistrimin e lëndës së punës të shoqërisë tregtare në regjistrin tregtar.

Efektet nga veprimet dhe punët e marra juridike

Neni 64

(1) Shoqëria tregtare mund të marrë punë juridike dhe veprime vetëm në kuadër të lëndës së punës të regjistruar në regjistrin tregtar.

(2) Punët juridike që i kontraktin, përkatësisht punët juridike që i merr shoqëria tregtare, përkatësisht ndaj personave të tretë, me të cilat tejkalohe lënda e punës së shoqërisë, të regjistruar në regjistrin tregtar, janë të plotfuqishme përveç nëse shoqëria tregtare dëshmon se personi i tretë ka ditur ose sipas rrethanave, doemos duhet të dijë për tejkalimin. Regjistrimi i lëndës së punës në regjistrin tregtar nuk do të thotë se personi i tretë ka ditur ose doemos duhet të dijë për tejkalimin.

KAPITULLI I TRETË

PËRFAQËSIMI

SEKSIONI 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përfaqësues sipas ligjit

Neni 65

(1) Përfaqësues i shoqërisë tregtare sipas ligjit është personi fizik i cili sipas dispozitave të këtij ligji caktohet ta përfaqësojë formën e veçantë të shoqërisë (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi sipas ligjit).

(2) Emërimi, pushimi i mandatit dhe të dhënat për përfaqësuesin sipas ligjit si dhe kufizimet e autorizimit të tij ndaj personave të tretë regjistrohen në regjistrin tregtar. Gjatë regjistrimit të përfaqësuesit sipas ligjit në regjistrin tregtar deponohet nënshkrimi të verifikuar me nënshkrim elektronik personal, ose me nënshkrim të agjentit regjistruar. Personat e huaj mund të deponojnë nënshkrim të vërtetuar te organi kompetent në vendin shtetas të të cilit janë.

(3) Lëshimi në procedurë ose çfarëdo parregullsie gjatë dhënies së autorizimit për përfaqësim ose gjatë shpalljes së të dhënës lidhur me përfaqësuesin sipas ligjit, nuk mund të shfrytëzohet për personat e tretë, përveç nëse shoqëria tregtare dëshmon se personat e tretë kanë ditur për këtë.

(4) Përfaqësuesi sipas ligjit nuk mundet, pa autorizimin e veçantë të shoqërisë tregtare, të paraqitet si palë kontraktuese dhe me shoqërinë tregtare të lidhë marrëveshje në emër të vet dhe për llogari të vet, në emër të vet për llogari të personave të tjerë, ose në emër dhe për llogari të personave të tjerë.

Përfaqësuesi me autorizim

Neni 66

(1) Përfaqësuesi i shoqërisë tregtare sipas nenit 65 të këtij ligji mund ta autorizojë personin tjetër.

(2) Autorizimi mund të jepet në suaza të ingerencave të përfaqësuesit që janë regjistruar në regjistrin tregtar.

(3) Autorizimi nga paragrafi 1 i këtij neni jepet në pajtim me dispozitat e Ligjit për raportet obligative, përveç nëse me këtë ligj ndryshe nuk përcaktohet.

(4) Kufizimet nga paragrafi 4 i nenit 65 të këtij ligji vlejnë edhe për të autorizuarin nga ky nen.

I autorizuari me punësim

Neni 67

(1) Personi i punësuar në shoqërinë tregtare i cili kryen punë të cilat sipas rrjedhës së rregullt të punës, përfshijnë edhe lidhjen e marrëveshjeve të caktuara, përkatësisht marrjen e punëve të caktuara juridike, është kompetent si i autorizuar i shoqërisë të lidhë edhe marrëveshje të këtilla dhe të marrë veprime juridike të këtilla në kuadër të punëve që i kryen.

(2) Kufizimet nga paragrafi 4 i nenit 65 të këtij ligji vlejnë edhe për të autorizuarin me punësim.

SEKSIONI 2

PROKURA

Nocioni i prokurës

Neni 68

(1) Prokura është autorizim tregtar përmbajtja dhe vëllimi i të cilit përcaktohen me këtë ligj.

(2) Prokurë mund të jep vetëm personi i cili sipas këtij ligji, konsiderohet si tregtar.

(3) Prokura jepet në mënyrën e caktuar në deklaratë për themelimin e shoqërisë tregtare nga një person, me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin.

(4) Prokura jepet në formë të shkruar.

Prokuristi

Neni 69

(1) Prokura mund t'i jepet secilit person fizik afarist të aftë, pa dallim nga detyra dhe punët që i kryen, përveç nëse në deklaratën për themelimin e shoqërisë nga një person, me marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht statutin nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Prokura nuk mund t'i jepet personit juridik.

(3) Raportet ndërmjet shoqërisë tregtare dhe prokuristit si dhe shpërblimi rregullohen me marrëveshje.

Prokura individuale dhe grupore

Neni 70

- (1) Prokura mund t'i jepet një personi fizik (prokura individuale) ose dy apo më tepër personave fizik së bashku (prokura grupore).
- (2) Nëse prokura i jepet dy apo më tepër personave fizik, secili nga ata persona është prokurist i cili pavarësisht e përfaqëson shoqërinë tregtare në kuadër të autorizimeve të caktuara me këtë ligj.
- (3) Prokura e dhënë dy apo më tepër personave konsiderohet si prokurë grupore vetëm nëse kjo është e shënuar qartë në prokurë.
- (4) Në prokurën grupore, deklaratat vullnetare, punët dhe veprimet juridike janë të plotfuqishme nëse kryhen nga të gjithë prokuristët së bashku, përkatësisht nëse janë pajtuar të gjithë prokuristët. Punët juridike dhe veprimet që i kryen njëri prokurist konsiderohen të plotfuqishme nëse prokuristët tjerë për ato japin pajtim të prerë ose nëse prokuristët e tjerë në mënyrë plotësuese japin pëlqim.
- (5) Deklarata e vullnetit ose puna juridike dhe veprimi i kryer nga njëri prokurist konsiderohet se është kryer nga të gjithë prokuristët.
- (6) Në prokurën grupore, kuptimi i fakteve të rëndësishme juridike ose faji i njërit prokurist shkakton veprim juridik të dhënësi i prokurës, pa dallim nëse për këtë kanë ditur ose janë fajtorë prokuristët e tjerë.

Gjerësia e autorizimeve nga prokura

Neni 71

- (1) Prokuristi mund t'i lidhë të gjitha marrëveshjet dhe t'i kryejë të gjitha punët juridike dhe veprimet në emër dhe për llogari të shoqërisë tregtare në kuadër të lëndës së punës të shoqërisë, ta administrojë ndërmarrjen nga dhënësi i prokurës dhe ta përfaqësojë shoqërinë në procedurat para organeve shtetërore dhe të administratës, organizatave dhe institucioneve me autorizime publike dhe gjyqeve.
- (2) Prokuristi nuk mund t'i tjetërsojë dhe ngarkojë patundshmëritë e shoqërisë tregtare dhe nuk mund të jep deklaratat dhe të kontrakttojë punë juridike, përkatësisht të ndërmarrë veprime juridike me të cilat do të fillojë procedura falimentuese ose tjetër që mund të sjellë shuarjen e shoqërisë. Prokuristi nuk mund t'i japë autorizim për lidhjen e marrëveshjeve dhe punë të tjera juridike personit tjetër.

Kufizimi i prokurës

Neni 72

- (1) Kufizimi i prokurës, që nuk parashihet me këtë ligj, nuk ka veprim juridik ndaj personave të tretë, pa dallim nëse ka ditur personi i tretë për këtë, ose nga rrethanat, doemos duhet të dijë për kufizimin e prokurës.
- (2) Kufizimi i prokurës në punën e një ose më tepër filialeve ka veprim juridik ndaj personave të tretë vetëm nëse është regjistruar në regjistrin tregtar.

Lidhja e marrëveshjes me vetveten

Neni 73

Marrëveshja që prokuristi, në emër të shoqërisë tregtare, e lidh me vetveten si palë tjetër kontraktuese, pa dallim nëse e bën në emër të vet

dhe për llogari të vet, në emër të vet dhe për llogari të huaj, ose në emër dhe për llogari të personit tjetër, është e pavlefshme nëse prokuristi për këtë nuk ka qenë i autorizuar në mënyrë të prerë.

Nënshkrimi i prokuristit

Neni 74

(1) Prokuristi e nënshkruan shoqërinë tregtare në mënyrë që nën firmë e nënshkruan emrin dhe mbiemrin e vet me shtesë që qartë tregon për pozitën e tij si prokurist ose me shtesën "n.p.".

(2) Në prokurën grupore secili prokurist nënshkruhet në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Bartja e prokurës

Neni 75

(1) Prokura nuk mund të bartet te personi tjetër fizik.

(2) Nuk ka veprim juridik dispozita për prokurë ose deklarata e shoqërisë tregtare me të cilën prokuristi autorizohet ta bartë prokurën as deklarata e shoqërisë me të cilën bartja e prokurës lejohet paraprakisht ose në mënyrë plotësuese.

Shfuqizimi i prokurës

Neni 76

(1) Prokura mund të shfuqizohet në çdo kohë, pa dallim nga baza juridike me të cilën është dhënë.

(2) Është e pavlefshme dispozita e marrëveshjes me të cilën shoqëria tregtare tërhiqet nga e drejta ta shfuqizojë prokurën, si dhe dispozita me të cilën e drejta për shfuqizimin e prokurës lidhet me afat ose kusht.

(3) Me dispozitat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk përjashtohen as zvogëlohen të drejtat e prokuristit të parapara me marrëveshje në bazë të së cilës i është dhënë prokura.

Prokura e tregtarit - individ

Neni 77

(1) Tregtari-individ e jep personalisht prokurën dhe autorizimi për dhënien e prokurës nuk mund t'i bartet ndonjë personi të tretë.

(2) Prokura që e ka dhënë tregtari - individ nuk shfuqizohet në rast të vdekjes së dhënësit të prokurës, as nëse dhënësit të prokurës i është marrë ose kufizuar aftësia për të vepruar.

(3) Për tregtar - individ në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e kësaj pjese të këtij ligji me të cilat rregullohet çështja e prokurës të cilën e japin shoqëritë tregtare.

Regjistrimi i prokurës

Neni 78

(1) Shoqëria tregtare, përkatësisht tregtari-individ i regjistrojnë dhënien e prokurave individuale dhe grupe, të gjitha kufizimet e prokurës dhe shfuqizimin në regjistrin tregtar.

(2) Në regjistrin tregtar regjistrohet emri dhe mbiemri i prokuristit dhe NUAQ i tij.

(3) Fletëregjistrimit i bashkëngjitet edhe vendimi për dhënien e prokurës, përkatësisht vendimi me të cilin kufizohet, përkatësisht shfuqizohet ajo, dhe dëshmi për nënshkrimin e vërtetuar te noteri (i cili përmban emrin dhe mbiemrin e plotë të prokuristit).

(4) Fletëparaqitja dhe shtojcat nga paragrafi (3) i këtij neni, nuk verifikohen te noteri, nëse parashtrohen nëpërmjet Sistemit për e-regjistrim, të nënshkruara personalisht me nënshkrim elektronik ose nëpërmjet agjentit regjistruar.

SEKSIONI 3

PROKURISTI TREGTAR DHE AGJENTI TREGTAR

Nocioni i të autorizuarit tregtar

Neni 79

(1) Prokuristi tregtar është personi i punësuar në shoqërinë tregtare ose personi tjetër fizik, i cili për shpërbllim autorizohet nga përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ta udhëheqë ndërmarrjen, ose pjesë të saj, sipas autorizimit të dhënë.

(2) Prokura tregtare jepet me shkrim me nënshkrime të vërtetuara te noteri ose jepet në formë elektronike e nënshkruar me nënshkrimin elektronik në pajtim me Sistemin për e-regjistrim.

Autorizimet e prokuristit tregtar

Neni 80

(1) Prokuristi tregtar autorizohet t'i lidhë të gjitha marrëveshjet dhe t'i ndërmerr të gjitha veprimet juridike të zakonshme në qarkullim gjatë udhëheqjes së ndërmarrjes ose një pjesë të saj në kuadër të autorizimit të dhënë.

(2) Prokuristi tregtar nuk mundet pa autorizim të veçantë nga dhënësi i autorizimit, të tjetërsojë ose ngarkojë patundshmëritë e tij, ta obligojë me kambiale ose çeqe, të merr obligime me garancion, të merr hua për të, të caktojë kompetenca në gjyqin e zgjedhur ose të udhëheqë kontest.

(3) Kufizimet e autorizimit të prokuristit tregtar, përveç atyre të shënuara në paragrafin 2 të këtij neni, nuk kanë veprim juridik ndaj personave të tretë të cilët për ato nuk kanë ditur dhe nuk duhet doemos ta dinë.

(4) Kufizimet nga paragrafi 4 i nenit 65 vlejnë edhe për prokuristin tregtar.

(5) Prokuristi, afër nënshkrimit të vet, shënon se është i autorizuar dhe nuk guxon të shtojë asgjë, që do ta identifikonte si prokurist.

Agjenti tregtar

Neni 81

(1) Shoqëria tregtare, përkatësisht tregtari-individ mundet personin e punësuar te ai ose personin tjetër fizik ta autorizojë si agjent tregtar.

(2) Prokura, agjentit tregtar i jepet në formë të shkruar.

(3) Agjenti tregtar autorizohet në emër dhe për llogari të dhënësit të autorizimit të lidhë marrëveshje për shitjen e mallit të tij, ta dërgojë atë mall, të shesë me kredi nëse ka autorizim të veçantë për këtë, t'i pranojë deklaratat e blerësve për mallin që është lëndë e atyre marrëveshjeve, të japë deklarata dhe të ndërmarrë veprime të tjera për ruajtjen e të drejtave të dhënësit të autorizimit që dalin nga marrëveshja e lidhur në emër dhe për llogari të tij.

(4) Kufizimet e autorizimit të agjentit tregtar nuk kanë veprim juridik ndaj personave të tretë të cilët për ato nuk kanë ditur dhe nuk duhet doemos të dinë.

(5) Agjenti tregtar nuk mundet pa autorizim të veçantë, të shesë mall që paguhet me pritje ose këste.

(6) Kufizimet e caktuara në paragrafin 4 të nenit 65 të këtij ligji, vlejnë edhe për agjentin tregtar.

KAPITULLI I KATËRT

REGJISTRI TREGTAR DHE PROCEDURA E REGJISTRIMIT

Nocioni i regjistrit tregtar

Neni 82

(1) Regjistri publik si libër tregtar përmban të dhënat dhe shtojcat (dokumente dhe dëshmi) për subjektet e regjistrimit për të cilët regjistrimi është rregulluar me ligj.

(2) Regjistri tregtar përbëhet nga dosja regjistruese (klaser) në të cilën regjistrohen të dhënat për regjistrim dhe përmbledhjen e shtojcave në të cilën bashkëngjiten dokumentet dhe dëshmitë të secilit subjekt të regjistruar. Të gjitha shkresat futen në përmbledhjen e shtojcave të subjektit të regjistruar.

(3) Të dhënat e regjistruara dhe shtojcat e dorëzuara (dokumente dhe dëshmi) në regjistrin tregtar ruhen përherë.

(4) Agjenti regjistrues shtojcat e konvertuara (dokumente dhe dëshmi) ka për obligim t'i ruajë 5 vjet, e pastaj të njëjtat t'i dorëzojë në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë.

Uniteti i regjistrit tregtar

Neni 83

(1) Regjistri tregtar mbahet në mënyrë të vetme në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Mënyra e mbajtjes së regjistrit tregtar

Neni 84

(1) Regjistrimet në regjistrin tregtar bëhen në formë elektronike dhe regjistri tregtar mbahet në formë me shkrim dhe në formë elektronike.

(2) Parashtrimi i të gjitha të dhënave që regjistrohen në regjistrin tregtar, bëhet në formë elektronike përmes Sistemit për regjistrim elektronik dhe në pajtim me Ligjin për sistem njësportel dhe për mbajtjen e regjistrit tregtar dhe regjistrit të personave tjerë juridikë.

(3) Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, parashtrimi i të dhënave për regjistrim në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor ose vendimit të organit shtetëror ose organit tjetër kompetent dhe të dhënave për regjistrim për subjekte që nuk janë përfshirë me këtë ligj, ndërsa regjistrohen në regjistrin tregtar, bëhet në formë të shkruar.

Parimi i publikimit

Neni 85

(1) Të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar janë publike.

(2) Secili person me shpenzimin e vet, mund të kërkojë t'i jepet fotokopje ose përshkrim i vërtetuar me të dhënat e regjistruara në pjesën e regjistrit.

(3) Secili mund të paraqesë kërkesë të bëjë inspektim në përmbledhjen e shtojcave ose t'i sigurohet fotokopje nga shtojcat e përmbledhjes me shpenzimin e tij, përveç përmbledhjes së shtojcave të shoqërisë tregtare publike dhe shoqërisë komanditore. Qasje në përmbledhjen e shtojcave të këtyre shoqërive mund të bëjë secili bashkëpronar dhe person i cili ka interes juridik.

(4) Për të dhënat në pjesën regjistruese të subjektit të regjistrimit, me kërkesë të palës së interesuar, jepet vërtetim se ka pasur regjistrim dhe i njëjti është shlyer.

(5) Me kërkesë të secilit person, jepet vërtetim se nuk ka regjistrim në regjistrin tregtar.

(6) Të gjitha apo disa nga të dhënat që janë të regjistruara në regjistrin tregtar, me zgjedhjen e paraqitësit të kërkesës, mund t'i jepen edhe vetëm në formë elektronike përmes sistemit njësportel, në pajtim me Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe me nënshkrim elektronik, Ligjin për Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe dispozitat për sistemin njësportel.

Kompetencë reale

Neni 86

(1) Regjistrin tregtar e udhëheq Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë.

Procedura e regjistrimit

Neni 87

Procedura për regjistrim në regjistrin tregtar udhëhiqet sipas procedurës së posaçme administrative të përcaktuar me rregullat e sistemit një sportel.

Besueshmëria e regjistrimit

Neni 88

(1) Secili që në qarkullim juridik vepron me vetëdije dhe beson në të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar, nuk mban pasoja të dëmshme juridike që do të ndodhin.

(2) Askush nuk mund të thirret në atë se nuk i di të dhënat e regjistruara në regjistrin tregtar, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Shpenzimet e procedurës për regjistrim

Neni 89

I fshirë 8

Subjektet që regjistrohen në regjistrin tregtar

Neni 90

(1) Subjektet që regjistrohen në regjistrin tregtar (subjektet e regjistrimit) janë:

- 1) tregtari-individ,
- 2) shoqëria tregtare publike; paraqesë shtojca të tjera (dokumente dhe dëshmi), përveç atyre që me këtë ligj përcaktohet se doemos duhet t'i bashkëngjiten fletëregjistrimit.
- 3) shoqëria komanditore;
- 4) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar;
- 5) shoqëria aksionare;
- 6) shoqëria komanditore me aksione,
- 7) bashkësia ekonomike e interesit; dhe
- 8) filiala e shoqërisë së huaj tregtare (në tekstin e mëtejme: shoqëria e huaj), përkatësisht filijala e tregtarit - individ të huaj.

(2) Të gjitha subjektet e regjistrimit në regjistrin tregtar i regjistrojnë të dhënat e përcaktuar me këtë ligj.

(3) Të dhënat që regjistrohen në regjistrin tregtar mbahen për secilin subjekt të regjistrimit veç e veç.

(4) Në regjistër regjistrohen edhe të gjitha ndryshimet e të dhënave, për të cilat me këtë ligj përcaktohet se regjistrohen në regjistrin tregtar.

Afati i paraqitjes së fletëregjistrimeve në regjistrin tregtar

Neni 91

(1) Subjektet për të cilët është përcaktuar regjistrim i detyrueshëm në regjistrin tregtar janë të obliguar në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e arritjes së kushteve për paraqitjen e fletëregjistrimit në regjistrin tregtar të paraqesin fletëregjistrimin, përveç nëse me këtë ligj dhe me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Pas kalimit të tre muajve nga dita e arritjes së kushteve për paraqitjen e fletëregjistrimit, Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë nuk do t'i regjistrojë të dhënat dhe fletëregjistrimin do ta refuzojë përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Nëse për shkak të lëshimit të paraqitjes së fletëregjistrimit në afatin e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni ky anëtar do të pësojë dëm, për dëmin mban përgjegjësi personalisht dhe në mënyrë të pakufizuar me tërë pronën e tij, personi fizik i cili ka pasur obligim ta paraqesë fletëregjistrimin.

Hapja e procedurës

Neni 92

(1) Procedura për regjistrim në regjistrin tregtar ngrihet me parashtrimin e fletëparaqitjes së formularit të përcaktuar ku është përfshirë kërkesa për regjistrim. Fletëparaqitja parashtrohet nga parashtruesi i autorizuar në formë elektronike e nënshkruar me nënshkrim elektronik përmes Sistemit për e-regjistrim dhe e parashtruar në pajtim me Ligjin për sistem njësportel dhe për mbajtjen e regjistrit tregtar dhe regjistrin të personave tjerë juridikë. Me përjashtim, fletëparaqitja për regjistrim në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor ose vendimit të organit kompetent shtetëror ose të organit tjetër, si dhe fletëparaqitja për regjistrimin e subjekteve që nuk janë përfshirë me këtë ligj, parashtrohet të shkruar.

(2) Fletëregjistrimi i shoqërisë tregtare paraqitet nga organi i administrimit, përkatësisht personi i autorizuar i organit të administrimit, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Fletëparaqitjen nga paragrafi (2) i këtij neni, mund ta parashtrojë edhe i autorizuari me autorizim të dhënë nga parashtruesi i autorizuar, me shkrim të verifikuar te noteri, ose e dhënë në formë elektronike e regjistruar me nënshkrimin e tij elektronik, ose e verifikuar me nënshkrim elektronik të agentit regjistruar i cili e parashtron fletëparaqitjen për regjistrim përmes Sistemit për regjistrim.

(4) Nëse fletëparaqitja parashtrohet nëpërmjet agentit regjistruar nëpërmjet Sistemit për e-regjistrim, autorizimi nga paragrafi (3) i këtij neni nuk verifikohet te noteri.

(5) Në procedurë për regjistrim në regjistrin tregtar, si dhe në qarkullimin juridik nuk është i detyrueshëm përdorimi i vulës zyrtare. Vërtetimi i cilitdo qoftë dokumenti me vulë zyrtare të shoqërisë nuk guxon të përcaktohet me ligj ose akt tjetër normativ ose kjo të kërkohej nga organi shtetëror.

(6) Për saktësinë dhe ligjshmërinë e të dhënave mban përgjegjësi paraqitësi i autorizuar nga paragrafi 1 i këtij neni, përkatësisht personat e caktuar me këtë ligj.

Paraqitja e shtojcave

Neni 93

(1) Me fletëregjistrimin në regjistrin tregtar paraqiten edhe shtojcat e duhura (dokumente dhe dëshmi) në të cilat përmbahen të dhënat që regjistrohen në regjistrin tregtar.

(2) Nëse futet depozitim jomonetar me sende të patundshme, paraqitet edhe dëshmia e pronësisë me shënimin e kryer në librin publik për evidentimin e sendeve të patundshme, ndërsa nëse futet send i tundshëm për të cilin me ligj është përcaktuar obligimi për evidentim (regjistrim) - dëshmi për pronësinë ndaj sendit të tundshëm. Gjatë depozitimit të letrave me vlerë në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronësi të letrave të tilla me vlerë me shënim në Depozitarin Qendror për letra me vlerë se të njëjtat depozitohen në shoqërinë tregtare dhe se pronari nuk mund të disponojë me të njëjtat.

Për këtë qëllim pronari i letrave me vlerë te Depozitari Qendror për letra me vlerë dorëzon Deklaratë të noteri se letrat me vlerë depozitohet në shoqërinë tregtare dhe se pajtohet që ndaj të njëjtave të evidentohet kufizimi për disponim deri në bartjen e të njëjtave në shoqërinë tregtare.

9

(3) Nëse me ligj përcaktohet paraqitja e lejes nga organi kompetent, me fletëparaqitje paraqitet edhe kjo dëshmi.

(4) Në fletëregjistrim mund të futen edhe të dhëna të tjera, përveç atyre të cilat me këtë ligj regjistrohen në regjistrin tregtar, ose të kërkohet nga subjekti regjistrimit të paraqesë shtojca të tjera (dokumente dhe dëshmi), përveç atyre që me këtë ligj përcaktohet se doemos duhet t'i bashkëngjiten fletëregjistrimit.

(5) Shtojcat nga ky nen mund të parashtrohen edhe nëpërmjet Sistemit për e-regjistrim vetëm në formë elektronike të nënshkruara me nënshkrim elektronik, në pajtim me Sistemin për e-regjistrim dhe Ligjin për sistem njësportel dhe për mbajtje të regjistrit tregtar dhe regjistrit të personave tjerë juridikë.

Shqyrtimi i fletëparaqitjes

Neni 94

(1) Para marrjes së vendimit për regjistrim në regjistrin tregtar, konfirmohet a janë plotësuar kushtet për regjistrim, të parapara me këtë ligj. Gjatë regjistrimit nuk analizohet ligjshmëria dhe vërtetësia e përmbajtjes së shtojcave (dokumenteve dhe dëshmive) që paraqiten gjatë regjistrimit në regjistrin tregtar as ligjshmëria e procedurës me të cilën ato janë miratuar as nuk analizohen të dhënat që regjistrohen në regjistrin tregtar, a janë të vërteta apo në pajtim me ligjin. Për vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre mban përgjegjësi personi, përkatësisht personat e caktuar me këtë ligj.

Më shumë kërkesa në një fletëparaqitje

Neni 95

I fshirë 10

Tërheqja e fletëparaqitjes

Neni 96

I fshirë

Vendimi në procedurën për regjistrim

Neni 97

I fshirë

Realizimi i vendimit

Neni 98

I fshirë

Dorëzimi i vendimit

Neni 99

I fshirë

Mospajtim i vendimit me të dhënat e shënuara në regjistrin tregtar

Neni 100

I fshirë

Mjete juridike

Neni 101

I fshirë

E drejta për ankesë

Neni 102

I fshirë

Zëvendësimi i vendimit pas ankesës së deklaruar

Neni 103

I fshirë

Fakte dhe dëshmi të reja

Neni 104

I fshirë

Procedura lidhur me ankesën

Neni 105

I fshirë

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës së shkallës së dytë

Neni 106

I fshirë

Aktpadi për përcaktimin e pavlefshmërisë së regjistrimit

Neni 107

(1) Me aktpadi mund të kërkohet përcaktimi i pavlefshmërisë së regjistrimit të bërë në sajë të dokumentit falso, nëse në dokumentin, në sajë të të cilit është bërë regjistrimi janë theksuar të dhëna të pavërteta, nëse dokumenti është konfirmuar ose është dhënë në procedurë të realizuar në mënyrë të paligjshme, nëse në mënyrë të paligjshme është realizuar veprim për të cilin të dhënat regjistrohen në regjistrin tregtar ose nëse ekzistojnë shkaqe tjera të parapara me ligj.

(2) Aktpadinë mund ta paraqesë person i cili ka interes juridik për përcaktimin e pavlefshmërisë së regjistrimit.

(3) Pavlefshmëria e regjistrimit nuk ndikon në veprimet juridike që janë ndërmarrë në emër të shoqërisë tregtare.

Veprimi sipas vendimit për pavlefshmërinë e konstatuar

Neni 108

(1) Kur gjykata konstaton pavlefshmërinë e regjistrimit, në pajtim me nenin 107 të këtij ligji, Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, në bazë të vendimit të plotfuqishëm, me detyrë zyrtare merr vendim për fshirjen e regjistrimit të pavlefshëm.

(2) Shlyerjen e regjistrimit nga regjistri tregtar Regjistri Qendror e shpall në faqen e vet të internetit. Vendimi nga neni 107 i këtij ligji prodhon veprim juridik ndaj personave të tretë në ditën e ardhshme nga dita e shpalljes së tij.

(3) Pavlefshmëria e regjistrimit nuk ndikon në çështjet juridike të ndërmarra në emër të shoqërisë tregtare.

Veprimi sipas vendimit fuqiplotë të gjykatës

Neni 109

(1) Vendimi fuqiplotë, i miratuar në sajë të aktpadisë ose propozimit, që ka të bëjë me regjistrimin e bërë në Regjistrin tregtar, me detyrë zyrtare, gjykata e cila e ka marrë vendimin ia dërgon Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

(2) Sanksioni për kundërvajtje ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës sipas vendimit të plotfuqishëm, gjykata me obligim zyrtar do ta dorëzojë në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

(3) Regjistri qendror të Republikës së Maqedonisë do ta bëjë regjistrimin e sanksionit për kundërvajtje ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në regjistrin nga neni 29-b i këtij ligji.

PJESA E PESTË

FORMA TË SHOQËRIVE TREGTARE

KAPITULLI I PARË

SHOQËRI TREGTARE PUBLIKE

SEKSIONI 1

NOCION DHE THEMELIMI

Nocioni

Neni 110

(1) Shoqëri tregtare publike (në tekstin e mëtejshëm: shoqëri publike) është shoqëria publike në të cilën bashkohen dy ose më tepër persona fizik dhe juridik të cilët kreditorëve të obligimeve të shoqërisë u përgjigjen pa kufizime dhe në mënyrë solidare me tërë pronën e tyre.

(2) Shoqëria publike themelohet me marrëveshje për shoqërinë të kontraktuar midis themeluesve.

Firma

Neni 111

Firma e shoqërisë publike përmban edhe fjalët: "Shoqëri tregtare publike" ose shenjën "SHTP".

Marrëveshje për shoqërinë

Neni 112

(1) Marrëveshja për shoqërinë përmban dispozita për:

- 1) emrin dhe mbiemrin, NUAQ (numrin unik amë të qytetarit), profesionin, numrin e pasaportës, respektivisht të letërnjoftimit (nëse bashkëpjesëmarrësi është person i huaj) ose të dokumentit tjetër për përcaktimin e identitetit - të vlefshme në vendin e tij dhe nënshtetësinë e tij dhe vendin ku jeton, respektivisht firmën, selinë, (NUAS), nëse bashkëpjesëmarrësi është person juridik,
- 2) firmën dhe selinë e shoqërisë publike,
- 3) lëndën e punës së shoqërisë publike,
- 4) llojin dhe lartësinë e deponimit të çdo pjesëmarrësi,
- 5) mënyrën e pjesëmarrjes të çdo bashkëpjesëmarrësi në punën e shoqërisë publike,
- 6) mënyrën e administrimit të punës dhe të përfaqësimit të shoqërisë publike dhe mënyrën e marrjes së vendimeve,
- 7) mënyrën e shpërndarjes së fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjes; dhe
- 8) çështje tjera të përcaktuara me këtë ligj në të cilat rregullohen marrëdhëniet midis bashkëpjesëmarrësve.

(2) Nënshkrimet e bashkëpjesëmarrësve të marrëveshjes për shoqërinë vërtetohen te noteri.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, nënshkrimet e bashkëpronarëve të shoqërisë nuk verifikohen te noteri, nëse marrëveshja

parashtrohet si shtojcë nëpërmjet Sistemit për e-regjistrim, në formë elektronike, e nënshkruar me nënshkrim elektronik nga bashkëpronarët e marrëveshjes ose nëpërmjet agjentit regjistruar.

Kushtet e veçanta për ushtrimin e veprimtarisë

Neni 113

Shoqëria publike mund të ushtrojë veprimtari që është e ndërlidhur me profesion për të cilin nevojitet kualifikim përkatës nëse ndonjëri nga bashkëpjesëmarrësit ose të punësuarit ka kualifikim përkatës, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar që të gjithë bashkëpjesëmarrësit ose numri më i madh i bashkëpjesëmarrësve të shoqërisë publike ta kenë kualifikimin e përshkruar për veprimtarinë që është e ndërlidhur me profesion të caktuar.

Regjistrimi

Neni 114

Themelimi i shoqërisë publike regjistrohet në Regjistrin tregtar. Paraqitjen për regjistrimin e themelimit të shoqërisë publike e paraqesin të gjithë bashkëpjesëmarrësit e shoqërisë publike të autorizuar për përfaqësim.

Të dhënat që regjistrohen dhe shtojca ndaj paraqitjes për regjistrim

Neni 115

(1) Në regjistrin tregtar regjistrohen:

- 1) firma dhe selia e shoqërisë publike;
- 2) emri dhe mbiemri, NUAQ (numri unik amë i qytetarit), profesioni, numri i pasaportës, respektivisht i letërnjoftimit (nëse bashkëpjesëmarrësi është person i huaj) ose i dokumentit tjetër për përcaktimin e identitetit - të vlefshme në vendin e tij dhe nënshtetësia e tij dhe vendi ku jeton, respektivisht firma, selia, (NUAS), nëse bashkëpjesëmarrësi është person juridik;
- 3) lënda e punës së shoqërisë publike;
- 4) lloji dhe lartësia e deponimit të çdo pjesëmarrësi;
- 5) mënyra e përfaqësimit të shoqërisë publike; dhe

(2) Paraqitjes i bashkëngjiten:

- 1) marrëveshja për shoqërinë;
- 2) kopja e pasaportës ose e letërnjoftimit për persona të huaj fizik ose të dokumentit tjetër për përcaktimin e identitetit - të vlefshëm në vendin e tij, përkatësisht dëshmi për regjistrim nëse themeluesi është person juridik;
- 3) leje ose akt tjetër të organit shtetëror ose të organit tjetër kompetent nëse ky obligim është i përcaktuar me ligjin për regjistrim të shoqërisë publike në regjistrin tregtar;
- 4) dëshmi për pronësi në të cilën është bërë shënimi në librin publik për evidencë të gjërave të patundshme, e nëse vihet lëndë e tundshme për të cilën me ligj është përcaktuar obligimi për evidentim (regjistër) - dëshmi për pronësinë mbi lëndën e tundshme e kur depozitohen letrat me vlerë në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronarin e letrave të tilla me vlerë me shënim në pajtim me nenin 93 paragrafi (2) i këtij ligji.
- 5) deklarata nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik, përkatësisht deklarata nga personi fizik, se nuk ekziston pengesë që të bëhet

themelues i shoqërisë publike, në pajtim me nenin 29 të këtij ligji dhe 6) deklarata në pajtim me nenin 32 të këtij ligji.

(3) Bashkëpjesëmarrësit, respektivisht personat të cilët, sipas marrëveshjes për shoqërinë, janë të autorizuar për përfaqësim bashkëngjisin nënshkrime në pajtim me nenin 65, paragrafi 2 dhe 3 të këtij ligji.

(4) Çdo ndryshim të të dhënave nga paragrafi 1 të këtij neni si dhe aderimi i çdo pjesëmarrësi në shoqërinë publike, respektivisht tërheqja e bashkëpjesëmarrësit nga shoqëria publike regjistrohen në regjistrin tregtar me vendim për ndryshimin e marrëveshjes për shoqërinë.

Seksioni 2

MARRËDHËNIET JURIDIKE MIDIS BASHKËPRONARËVE TË SHOQËRISË PUBLIKE

Dispozita e përgjithshme

Neni 116

(1) Marrëdhëniet juridike midis bashkëpronarëve të shoqërisë publike rregullohen me marrëveshje për shoqërinë.

(2) Ndaj marrëdhënieve juridike midis bashkëpronarëve të shoqërisë publike që nuk janë të rregulluara me marrëveshjen e shoqërisë zbatohen dispozitat e këtij ligji.

(3) Ndaj marrëdhënieve juridike midis bashkëpronarëve të shoqërisë publike që nuk janë rregulluar me këtë ligj dhe me marrëveshjen e shoqërisë, zbatohen dispozitat nga Ligji për marrëdhënie obligative me të cilët rregullohet marrëveshja për partneritet (marrëveshja për bashkësinë).

Depozitet në shoqëri

Neni 117

(1) Depozitet e bashkëpronarëve në shoqërinë publike mund të jenë të ndryshme.

(2) Bashkëpronari mundet në shoqërinë publike të depozitojë para, sende, të drejta, punë dhe shërbime.

(3) Vlera e depozitit monetar, bashkëpronarët me marrëveshje e përcaktojnë në para.

Pasojat e vonimit

Neni 118

(1) Bashkëpronari i cili depozitin në monedha nuk e ka paguar me kohë ose i cili paratë të pranuar për shoqërinë publike nuk i ka paguar me kohë në arkë të shoqërisë publike ose për vete ka marrë para nga shoqëria publike ose është vonuar t'i arkëtojë depozitimet tjera në

monedha është i obliguar shoqërisë tregtare t'i paguajë kamatë ndëshkuese ligjore nga dita kur ka pasur obligim ta paguajë depozitin në monedha ose kur doemos t'i dorëzojë paratë ose kur paratë pa arsyetim i ka marrë. Shoqëria publike mund të kërkojë edhe kompensim për dëm.

(2) Pa marrë parasysh se depoziti është monetar ose jomonetar, shoqëria publike mund të kërkojë kompensim për dëmin.

Zmadhimi, plotësimi dhe tërheqja e depozitit

Neni 119

(1) Bashkëpronari i shoqërisë publike nuk është i obliguar depozitin e tij ta zmadhojë mbi shumën e caktuar me marrëveshjen e shoqërisë, në rast të humbjes nuk është i detyruar ta plotësojë nëse është zvogëluar pa fajin e tij.

(2) Tërheqjen e depozitit, bashkëpronari mund të kërkojë vetëm në rast të ndërprerjes së marrëdhënies bashkë pronësor në shoqërinë publike.

Kompensimi i harxhimeve dhe i dëmit

Neni 120

(1) Nëse bashkëpronari i shoqërisë publike bën harxhim për të cilin, sipas rrethanave mund të konsiderohet se është i duhur ose nëse ka përjetuar dëm drejtpërdrejtë nga kryerja e punëve të shoqërisë publike ose për shkak të rrezikut i cili është i lidhur në mënyrë të pandarë me atë, shoqëria publike është e obliguar t'ia kompensojë harxhimet dhe dëmin e përjetuar.

(2) Për harxhimet e bëra dhe dëmin e shkaktuar, shoqëria publike paguan edhe kamata, llogaritur nga dita kur harxhimet kanë qenë të bëra, gjegjësisht prej kur është shkaktuar dëmi.

(3) Bashkëpronari mundet për harxhimet e domosdoshme për kryerjen e punëve të shoqërisë, të kërkojë shoqëria t'i paguajë paradhënie.

Ndalimi i konkurrencës

Neni 121

(1) Bashkëpronari i shoqërisë publike nuk guxon, pa pëlqimin e dhënë të bashkëpronarëve tjerë të bëjë punë që janë në kuadër të lëndës së punës të shoqërisë publike as të jetë bashkëpronar i cili personalisht përgjigjet, të jetë anëtarë i organit ose i punësuar në shoqëri që i është konkurrense shoqërisë publike ose që do të mund t'i jetë konkurrense.

(2) Ndalesa nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ka të bëjë për bashkëpronarin i cili, gjatë hyrjes në shoqërinë publike, për atë i ka informuar bashkëpronarët, përveç nëse në marrëveshjen e shoqërisë nuk është caktuar bashkëpronari ta lëshojë punën ose të tërhiqet nga ajo.

Pasojat nga konkurrenca e palejueshme

Neni 122

(1) Nëse bashkëpronari e thyen ndalesën nga neni 121 paragrafi 1 i këtij ligji, shoqëria publike mundet nga ai të kërkojë kompensim të dëmit.

Shoqëria mundet në vend të kompensimit të dëmit të kërkojë, bashkëpronari punët e bëra për llogari të veten t'i pranojë si punë të lidhura për shoqërinë publike, gjegjësisht shoqërisë t'ia dorëzojë të gjithë atë që e ka pranuar nga punët e kryera për llogari të tjerëve ose t'ia jep të drejtën e tij atij që duhet ta pranojë nga puna e tillë.

(2) Për realizimin e të drejtave të shoqërisë publike nga paragrafi 1 i këtij neni vendosin bashkëpronarët tjerë. E drejta për realizimin e kërkesave të shoqërisë vjetërsohet për tre muaj duke llogaritur nga dita kur bashkëpronarët tjerë kanë kuptuar për cenimin e ndalesës nga neni 121 paragrafi 1 i këtij ligji, por jo më gjatë se pesë vite nga dita e cenimit të ndalesës.

(3) Realizimi i të drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e përjashton të drejtën e bashkëpronarëve tjerë të kërkojnë ndërprerjen e shoqërisë publike.

Bartja e pjesës

Neni 123

(1) Pjesa në shoqërinë publike mund t'i bartet personit të tretë vetëm me pajtim të të gjithë bashkëpronarëve.

(2) Bartja e pjesës bëhet me punë juridike në formë të shkruar.

(3) Bartja e pjesës vepron ndaj shoqërisë publike pasi që puna juridike për bartjen do t'i dërgohet shoqërisë publike dhe kur njëri nga personat e autorizuar për administrim me shoqërinë publike do të vërtetojë në formë të shkruar se është pranuar.

Pengu i pjesës

Neni 124

(1) Bashkëpronari në shoqërinë publike mundet pjesën e vet ta jep në peng me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve.

(2) Bashkëpronari, pjesa e të cilit është dhënë peng, mbetet bashkëpronar në shoqërinë dhe i realizon të gjitha të drejtat të cilat i ka si bashkëpronar sipas marrëveshjes së shoqërisë.

Administrimi me shoqërinë publike

Neni 125

(1) Secili bashkëpronar është i autorizuar të administrojë me shoqërinë publike.

(2) Nëse bashkëpronarët merren vesh administrimin me shoqërinë publike t'ia besojnë njërit ose më tepër bashkëpronarëve, bashkëpronarët tjerë janë të përjashtuar nga administrimi i shoqërisë publike.

Mënyra e realizimit të administrimit të besuar

Neni 126

(1) Administruesit janë të autorizuar të sillen në mënyrë të pavarur në administrimin e shoqërisë publike. Nëse udhëheqësi i kundërvihet ndonjë

veprimi para se të jetë kryer, ekzekutimi i veprimit ndërpritet deri sa bashkëpronarët nuk sjellin vendim për atë.

(2) Nëse sipas marrëveshjes së shoqërisë, udhëheqësit veprojnë bashkërisht, atëherë vendimet sillen në pëlqim të të gjithë udhëheqësve. Secili nga udhëheqësit mundet punët e pashtyeshme t'i kryejë në mënyrë të pavarur nëse me atë pengohet shkaktimi i dëmit për shoqërinë publike. Për punët e ndërmarra udhëheqësi duhet pa shtyrje t'i informojë udhëheqësit tjerët të shoqërisë publike.

Bartja e autorizimit për administrim

Neni 127

(1) Bashkëpronari mund t'ia bart autorizimin për administrim me shoqërinë publike personit të tretë nëse me atë pajtohen bashkëpronarët tjerë, në atë mënyrë të caktuar me marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Autorizimin për administrim, bashkëpronari nuk mund t'ia bartë personit të tretë nëse ajo nuk është e lejuar me marrëveshjen për shoqërinë.

(3) Për punën e udhëheqësit nga paragrafi 1 të këtij neni përgjigjet bashkëpronari i cili e ka bartë autorizimin për administrim, sipas dispozitave të Ligjit për marrëdhëniet obligative me të cilat rregullohet marrëveshja për peng.

Vëllimi i autorizimit për administrim dhe mënyra e sjelljes së vendimeve

Neni 128

(1) Autorizimi për administrim jepet për çështjet të cilat bien në punën e rregullt të shoqërisë publike.

(2) Vendimet të cilat i tejkalojnë autorizimet, e udhëheqësve, bashkëpronarëve i sjellin njëzëshëm, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është e përcaktuar më ndryshe. Nëse me marrëveshjen e shoqërisë është e caktuar vendimet të sillen me shumicë votash, atëherë secili bashkëpronar i shoqërisë publike ka një votë, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar më ndryshe.

Vendosja përmes letrës

Neni 129

Me marrëveshjen e shoqërisë mund të jetë e përcaktuar, vendimet të cilët i sjellin të gjithë bashkëpronarët të sillen me vendosje përmes letrave nëse asnjë prej bashkëpronarëve nuk kërkon që të thirren bashkëpronarët në mbledhje të bashkëpronarëve. Në rast të vendosjes përmes letrës, rezultatet e deklaratimit konstatohen në raportin e përgatitur në formë të shkruar, i cili i bashkëngjitet librit për vendime. Raportit i bashkëngjiten përgjigjet e pyetjeve të parashtruara të secilit bashkëpronar.

Prishja e autorizimit për administrim

Neni 130

(1) Bashkëpronari mund ta prish autorizimin e besuar për administrim me shoqërinë publike nëse për atë ekziston shkas i arsyeshëm. Si shkas i arsyeshëm konsiderohet pengimi nga bashkëpronarët tjerë ta kryejë administrimin e besuar ose kur ajo nuk i është mundësuar për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

(2) Bashkëpronari mund ta prish autorizimin e besuar për administrimin me shoqërinë publike vetëm nëse bashkëpronarëve tjerë u jep afat të prolonguar që mundëson ata të ndërmarrin gjithçka që është e duhur për administrim, përveç nëse ekziston shkas i arsyeshëm për shkak të së cilës ai mund të tërhiqet nga autorizimi edhe para skadimit të atij afati.

(3) Afati i prolonguar nga paragrafi 2 i këtij neni zgjat më së paku tre muaj.

Revokimi i udhëheqësve

Neni 131

(1) Nëse të gjithë bashkëpronarë janë udhëheqës ose një e më shumë udhëheqës janë zgjedhur nga radhët e bashkëpronarëve ose janë emëruar me marrëveshjen e shoqërisë, revokimi bëhet me vendim të njëzëshëm të bashkëpronarëve. Bashkëpronari i revokuar mund të tërhiqet nga shoqëria publike, me kërkesë t'i paguhen të drejtat e tija nga marrëdhënia e bashkëpronarit në shoqërinë publike.

(2) Nëse janë një ose më shumë bashkëpronarë udhëheqës dhe nuk janë emëruar me marrëveshjen e shoqërisë, secili prej tyre mund të revokohet me kushtet që janë paraparë në marrëveshjen e shoqërisë ose, nëse ajo nuk është rast, me vendim të njëzëshëm të të gjithë bashkëpronarëve.

(3) Udhëheqësi i cili nuk është bashkëpjesëmarrës mund të revokohet me kushtet e parapara në marrëveshjen e shoqërisë ose, nëse nuk është ai rast, me vendim të bashkëpronarëve të sjellur me shumicë votash.

(4) Nëse revokimi i udhëheqësit është bërë pa shkas të arsyeshëm, ajo mund të jetë bazë për kërkesë të kompensimit të dëmit.

E drejta e informimit

Neni 132

(1) Bashkëpronarët të cilët nuk janë udhëheqës kanë të drejtë të fitojnë raport për gjendjen e librave dhe dokumenteve tjera të shoqërisë publike dhe të parashtrojnë pyetje me shkrim për administrimin me shoqërinë publike, të cilëve doemos duhet t'u përgjigjet me shkrim.

(2) Gjatë realizimit të të drejtës nga paragrafi 1 të këtij neni bashkëpronarët e shoqërisë publike të cilët nuk janë udhëheqës kanë të drejtë në seli të shoqërisë publike, vetë të njihen me librat tregtarë, me marrëveshjet, korespodencën, procesverbalet dhe me dokumentet tjera të krijuara ose të pranuar në shoqërinë publike.

(3) E drejta nga paragrafi 2 i këtij neni e inkadron edhe të drejtën të merren akte dhe kopje nga dokumentet e duhura.

E drejta e shpërblimit

Neni 133

Bashkëpronari mund të ketë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrjen e tij personale në punët e shoqërisë publike të përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë.

Pjesëmarrja në fitim dhe humbje

Neni 134

(1) Fitimi dhe humbja ndahen midis bashkëpronarëve të shoqërisë publike në përpjesëtim me pjesën e secilit bashkëpronar në shoqëri nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar më ndryshe.

(2) Gjatë llogaritjes së pjesëmarrjes në fitim, e cila i takon bashkëpronarit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, depozitet që bashkëpronari i ka futur në shoqërinë gjatë vitit afarist llogariten në përpjesëtim me kohën që ka kaluar nga arkëtimi. Nëse bashkëpronari gjatë vitit afarist e ka zvogëluar pjesëmarrjen e vet në pronë, ashtu që pjesëmarrja e zvogëluar llogaritet në përpjesëtim me kohën që ka kaluar nga zvogëlimi i bërë.

SEKSIONI 3

MARRËDHËNIET E SHOQËRISË PUBLIKE ME PERSONAT E TRETË

Përfaqësimi i shoqërisë

Neni 135

(1) Secili bashkëpronar është i autorizuar ta përfaqësojë shoqërinë publike.

(2) Bashkëpronarët munden me marrëveshjen e shoqërisë të autorizojnë një ose më shumë bashkëpronarë për përfaqësimin e shoqërisë publike. Në atë rast, bashkëpronarët tjerë janë të përjashtuar nga përfaqësimi.

(3) Nëse më shumë bashkëpronarë janë të autorizuar ta përfaqësojnë shoqërinë publike, secili nga përfaqësuesit mund ta përfaqësojë shoqërinë publike në mënyrë të pavarur. Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet edhe përfaqësimi kolektiv.

(4) Përfaqësuesit e shoqërisë publike, varësisht nga ajo se autorizimet e tyre a janë për përfaqësim të pavarur apo kolektiv, shoqërinë publike e nënshkruajnë në mënyrë të pavarur ose kolektive.

(5) Autorizimi për përfaqësimin e shoqërisë publike është i plotë. Kufizimi i autorizimit për përfaqësim të bashkëpronarit nuk ka veprim juridik ndaj personave të tretë, pa marrë parasysh se a e kanë ditur ose, duke marrë parasysh rrethanat, doemos ta kenë ditur për përkufizimin.

Prishja dhe marrja e autorizimit për përfaqësim

Neni 136

(1) Përfaqësuesi mund ta prish autorizimin për përfaqësim në afat që nuk mund të jetë më i shkurtër se tre muaj nga dita kur me shkrim i ka informuar bashkëpronarët tjerë se e prish autorizimin për përfaqësim. Përjashtimi ose përkufizimi i kësaj të drejte është i pavlefshëm.

(2) Gjyqi mundet me ankesë të bashkëpronarëve tjerë, me arsye të rëndësishme t'ia merr autorizimin për përfaqësim bashkëpronarit. Si shkas i arsyeshem, në kuptim të këtij neni, konsiderohet secili cenim i rëndë i obligimit të bashkëpronarit ose paaftësisë së tij në mënyrë të rregullt ta përfaqësojë shoqërinë.

Përgjegjësia personale e bashkëpronarëve

Neni 137

(1) Për obligimet e shoqërisë publike secili bashkëpronar u përgjigjet kreditorëve të shoqërisë publike në mënyrë direkte, me tërë pronën e vet dhe në mënyrë solidare me të gjithë bashkëpronarët tjerë.

(2) Dispozita në marrëveshjen e shoqërisë në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, është e pavlefshme.

(3) Kreditori i shoqërisë publike mund të kërkojë realizim të obligimit të shoqërisë publike nga bashkëpronarët edhe atë pasi që shoqëria publike nuk do ta realizojë obligimin në afatin e caktuar në thirrjen me shkrim nga kreditori.

(4) Bashkëpronari i cili hyn në shoqërinë publike e cila ekziston, për obligimet e shkaktuara para bashkëngjithjes së tij në shoqërinë publike përgjigjen njëjtë si dhe bashkëpronarët tjerë.

Vjetërsimi i kërkesës

Neni 138

(1) Kërkesa nga bashkëpronari për obligimet e shoqërisë publike vjetërsohet për pesë vite pas pushimit të shoqërisë publike, gjegjësisht pas daljes së bashkëpronarit nga shoqëria publike, përveç nëse kërkesa nga shoqëria publike nuk vjetërsohet në afat më të shkurtë, në pajtim me ligj.

(2) Vjetërsimi fillon të rrjedh pas skadimit të ditës kur pushimi i shoqërisë publike ose dalja e bashkëpronarit të jetë regjistruar në regjistrin tregtar. Nëse shoqëria publike përfundon me falimentim, vjetërsimi fillon të rrjedh nga dita e regjistrimit në regjistrin tregtar me shlyerjen e shoqërisë publike. Nëse kërkesa arin pas regjistrimit në regjistrin tregtar, vjetërsimi fillon të rrjedh nga dita e arritjes.

Ndërprerja e vjetërsimit të kërkesës

Neni 139

(1) Ndërprerja e vjetërsimit të kërkesave ndaj shoqërisë së ndërprerë vepron ndaj bashkëpronarëve të cilët shoqërisë publike i kanë takuar gjatë kohës së ndërprerjes.

(2) Ndërprerja e vjetërsisë së kërkesave lidhur me shoqërinë publike e cila ende nuk ka pushuar nuk vepron ndaj bashkëpronarit që ka dalë, ndërsa pushimi i vjetërsimit të kërkesave që është paraqitur vetëm ndaj bashkëpronarit të caktuar nuk vepron kundër bashkëpronarëve tjerë.

SEKSIONI 4

NDËRPRERJA E SHOQËRISË PUBLIKE DHE NDËRPRERJA E BASHKËPRONËSISË

Bazat e ndërprerjes

Neni 140

(1) Shoqëria publike pushon me:

- 1) skadimin e afatit për të cilin është themeluar;
- 2) vendim-i sjellur nga të gjithë bashkëpronarë;
- 3) falimentim i shoqërisë publike,
- 4) vdekje e cilit do qoftë nga bashkëpronarëve, gjegjësisht pushimi i bashkëpronarit-person juridik, përveç nëse me marrëveshje të shoqërisë nuk është përcaktuar më ndryshe;
- 5) falimentim i cilit do prej bashkëpronarëve;
- 6) pushim të ndonjërit prej bashkëpronarëve të shoqërisë publike të marrëveshjes së shoqërisë, përveç nëse me marrëveshje të shoqërisë të mos jetë përcaktuar më ndryshe;
- 7) vendim të plotfuqishëm të gjyqit;
- 8) humbjen e aftësisë për punë të njërit prej bashkëpronarëve, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë të mos jetë përcaktuar më ndryshe; dhe
- 9) marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë, ndërsa shoqëria publike nuk e ndërron veprimtarinë.

(2) Shoqëria publike pushon edhe në raste tjera të përcaktuara me këtë dhe tjetër ligj.

(3) Në marrëveshjen e shoqërisë mund të jenë të parapara edhe baza tjera për pushimin e shoqërisë publike.

Pushimi i bashkëpronarit

Neni 141

(1) Nëse shoqëria publike është themeluar në afat të pakufizuar, bashkëpronari mundet, në pajtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e shoqërisë, ta prish marrëveshjen e shoqërisë me afat të prolonguar që nuk mund të jetë më i shkurtë se tridhjetë ditë as më i gjatë se gjashtë muaj, duke konsideruar nga dita e fundit të vitit afarist. Pushimi doemos t'i kumtohet secilit bashkëpronarë. Afati i prolonguar mund të vazhdohet me marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Dispozitat e marrëveshjes së shoqërisë me të cilën përjashtohet e drejta e bashkëpronarit ta prish marrëveshjen e shoqërisë ose me të cilat përkufizohet kjo e drejtë janë të pavlefshme.

(3) Dispozitat nga paragrafi 1 të këtij neni zbatohen edhe ndaj shoqërisë publike e cila, sipas marrëveshjes së shoqërisë zgjat gjatë jetës të secilit nga bashkëpronarët ose e cila është vazhduar edhe pas skadimit të kohës të caktuar për zgjatjen e sajë.

Pushimi në bazë të vendimit të gjyqit

Neni 142

(1) Nga arsyet e rëndësishme, gjyqi mundet me ankesë të bashkëpronarit të shoqërisë publike, të vendosë, shoqëria publike të pushojë para

skadimit të kohës për të cilën është themeluar, gjegjësisht të ndërpresë edhe pa pushim nëse koha e zgjatjes së sajë nuk është e përcaktuar. Ankesa paraqitet kundër bashkëpronarëve tjerë.

(2) Si shkas i arsyeshëm nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet veçanërisht nëse ndonjë nga bashkëpronarët tjerë, me pakujdesi të madhe, me pavëmendje ose me paramendim cenon ndonjë nga obligimet e tija themelore ose nëse realizimi i obligimit të tillë ose realizimi i qëllimit të shoqërisë publike bëhen të pamundshme ose nëse qëllimi është realizuar.

(3) Padia nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet në afat prej 90 ditësh nga dita e njoftimit për shkakun, por jo më gjatë se një vit nga dita e krijimit të shkakut.

(4) Dispozitat e marrëveshjes së shoqërisë me të cilat përjashtohet ose me të cilat, në kundërshtim me dispozitat nga paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni, kufizohet e drejta e bashkëpronarit të kërkojë pushimin e shoqërisë publike konsiderohen si të pavlefshme.

(5) Me ankesën nga paragrafi 1 të këtij neni, bashkëpronari mund të kërkojë nga gjyqi në vend që të vendosë të pushojë shoqëria publike, ta përjashtojë nga shoqëria publike bashkëpronarin që është i fajshëm.

Pushim për shkak cenimit të rëndë ose për shkak të sjelljes

Neni 143

Secili bashkëpronar mund pa afat të prolonguar ta ndërpresë bashkëpronësisë e vet në shoqërinë publike nëse cili do qoftë bashkëpronar tjetër i shoqërisë publike rëndë e cenon marrëveshjen e shoqërisë ose me sjelljen e tij e sjell në rrezik bashkëpunimin e mëtejshëm me atë ose realizimin e qëllimit të shoqërisë publike.

Mbrojtja e kreditorit të bashkëpronarit

Neni 144

(1) Kreditori i bashkëpronarit, i cili gjatë gjashtë muajve të fundit nuk mund t'i përmbushë kërkesat e veta gjatë procedurës për kryerjen me detyrim nga prona e tundshme e bashkëpronarit dhe në bazë të dokumentit ekzekutiv, ta sekuestrojë pjesën e tij dhe ta dërgojë kërkesën për pagesë asaj që do t'i kishte takuar nga shoqëria mbasi që ajo të ndërprehet, mundet me informim të shkruar deri te të gjithë bashkëpronarët tjerë ta prish marrëveshjen e shoqërisë pa marrë parasysh se a është themeluar ajo shoqëri në kohë të caktuar ose të pacaktuar. Kreditori mund ta kërkojë nga shoqëria vetëm atë që bashkëpronarit do t'i kishte takuar pas pushimit të shoqërisë.

(2) Shoqëria publike nuk pushon nëse shoqata ose bashkëpronarët tjerë e paguajnë borxhin pas dhënies së urdhëresës për sekuestrim nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Nëse shoqëria ose bashkëpronarët tjerë në shoqërinë publike ia paguajnë kreditorit të bashkëpronarit borxhin nga paragrafi 1 i këtij neni, pjesëmarrja e bashkëpronarit në shoqërinë publike pushon nëse bashkëpronarët nuk vendosin më ndryshe.

Vazhdimi i ekzistimit të shoqërisë edhe pas pushimit të bashkëpronësisë të ndonjërit nga bashkëpronarët

Neni 145

(1) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të parashikohet shoqëria publike të vazhdojë të ekzistojë edhe kur do të pushojë bashkëpronësia e ndonjërit nga bashkëpronarët. Në atë rast, bashkëpronarët tjerë i plotësojnë të drejtat nga pjesa e bashkëpronarit që ka dalë nga shoqëria publike, e në rast të vdekjes të bashkëpronarit në shoqërinë publike, trashëgimtarët e tij fitojnë pozitën e bashkëpronarëve nëse për atë paraqesin dëshirë dhe nëse ajo është përcaktuar si mundësi me marrëveshjen e shoqërisë ose nëse me atë në mënyrë plotësuese pajtohen bashkëpronarët tjerë. Trashëguesit e japin deklaratën për fitimin e pozicionit të bashkëpronarit në shoqërinë publike në afat prej tre muajve nga dita e vendimit të plotfuqishëm për shpalljen e trashëgimtarëve.

(2) Nëse trashëgimtarët nuk fitojnë pozicionin e bashkëpronarëve ose nëse ato nuk dëshirojnë të fitojnë pozicionin e bashkëpronarit, shoqëria publike ua paguan të drejtat nga pjesa e bashkëpronarit të ndjerë trashëgimtarëve.

Vazhdimi me punë i shoqërisë publike kur shoqëria do të ngel me një bashkëpronar

Neni 146

(1) Nëse në shoqërinë publike e cila ka dy bashkëpronar, njëri nga bashkëpronarët përjashtohet nga shoqëria, sipas kushteve dhe procedurës së paraparë me këtë ligj, ose nëse mbin njërin prej bashkëpronarëve zbatohet falimentim, bashkëpronari mund, në afat prej një viti, të gjejë bashkëpronar tjetër dhe të vazhdojë të punojë si shoqëri publike ose ta shndërrojë shoqërinë publike në ndonjë formë tjetër të shoqërisë tregtare.

(2) Përcaktimi i obligimeve dhe i pjesës së bashkëpronarit që është përjashtuar ose që ka pushur me falimentim, bëhet me zbatimin adekuat të dispozitave të këtij ligji me të cilat është rregulluar largimi i bashkëpronarit nga shoqëria.

(3) Nëse pas skadimit të afatit nga paragrafi 1 të këtij neni, bashkëpronari nuk sillet sipas paragrafit 1 të këtij neni, gjyqi, sipas detyrimit zyrtar, zbaton procedurë të likuidimit.

Regjistrimi i pushimit të shoqërisë publike në regjistrin tregtar

Neni 147

(1) Pushimi i shoqërisë publike, të gjithë bashkëpronarë e paraqesin për regjistrim në regjistrin tregtar, përveç nëse shoqëria publike pushon me falimentim, gjegjësisht në bazë të vendimit tjetër të plotfuqishme të gjyqit.

(2) Nëse shoqëria publike pushon me vendim të gjyqit, gjyqi i cili e ka sjellur vendimin, sipas detyrimit zyrtar, e dërgon edhe te regjistri tregtar.

KAPITULLI I DYTË

SHOQËRIA KOMANDITORE

SEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Nocioni

Neni 148

(1) Shoqëria komanditore është shoqëri tregtare në të cilën ngelin dy ose më shumë persona fizik dhe juridik prej të cilëve më së paku një bashkëpronar përgjigjet për obligimet e shoqërisë personalisht me tërë pronën e vet, gjegjësisht pakufi dhe në mënyrë solidare nëse janë më së paku dy bashkëpronar (në tekstin e mëtejme: komplementar), e më së paku një bashkëpronar përgjigjet për obligimet e shoqërisë vetëm deri në shumën e depozitit të regjistruar në shoqëri (në tekstin e mëtejme: Komanditor). Depoziti i komanditorit nuk mund të jetë me punë dhe shërbime.

(2) Komplementaret marrin pjesë më së paku me një të pestën në shumën e përgjithshme të depozitave.

Pranimi i dispozitave për shoqërinë tregtare

Neni 149

Nëse me dispozita e këtij kapitulli nuk është përcaktuar ndryshe, ndaj shoqërisë komanditore zbatohen dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohet shoqëria publike.

SEKSIONI 2

THEMELIMI DHE REGJISTRIMI NË REGJISTRIN TREGTAR

Marrëveshja për shoqërinë

Neni 150

Shoqëria komanditore themelohet me marrëveshje për shoqëri në formë të shkruar me nënshkrime të verifikuara të bashkëpronarëve me nënshkrim elektronik të agjentit regjistruar, ose në formë elektronike të regjistruar me nënshkrim elektronik të bashkëpronarëve të shoqërisë përmes Sistemit për e-regjistrim.

Përmbajtja e marrëveshjes për shoqërinë

Neni 151

(1) Marrëveshja për shoqëritë përmban dispozita për:

- 1) firmën dhe selinë e shoqërisë komanditore;
- 2) lëndën e punës së shoqërisë komanditore;
- 3) emri dhe mbiemri, NVAQ, veprimtaria, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i letërnjoftimit nëse bashkëpronari është person i huaj fizik ose të

ndonjë dokumenti tjetër për vërtetimin e identitetit të vlefshme në vendin e tij dhe shtetësinë e tij si dhe vendi i banimit, gjegjësisht firma, selia, NUAS, nëse bashkëpronari është person juridik;

4) shumta e përgjithshme e depozitit të bashkëpronarëve dhe përcaktimi i cilësisë së bashkëpronarëve si komplementare, gjegjësisht komanditore;

5) mënyrën e përfaqësimit të shoqërisë komanditore;

6) lloji dhe raporti i depozitimeve të secilit bashkëpronar; dhe

7) mënyra dhe koha e arkëtimit, gjegjësisht të futjes së depozitit;

8) mënyrën e ndarjes së fitimit dhe mënyra e mbulimit të humbjes;

9) mënyra e pjesëmarrjes personale në punët e shoqërisë komanditore, administrimit me shoqërinë komanditore dhe mënyrës së sjelljes së vendimeve; dhe

10) dispozita tjera të përcaktuara me këtë ligj me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis bashkëpronarëve.

(2) Ndërimi i marrëveshjes së shoqërisë bëhet me pajtimin e të gjithë komplementareve dhe të shumicës së komanditorëve sipas madhësisë së depozitit të tyre.

Firma

Neni 152

Firma e shoqërisë komanditore i përmban edhe fjalët "shoqëri komanditore" ose shenjën "SHK".

Të dhënat të cilat regjistrohen dhe shkresat me fletëparaqitjen

Neni 153

(1) Në regjistrin tregtar regjistrohen:

- 1) emri dhe mbiemri, NUAQ, veprimtaria, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i letërnjoftimit nëse bashkëpronari është person i huaj fizik ose të ndonjë dokumenti tjetër për vërtetimin e identitetit të vlefshme në vendin e tij dhe shtetësinë e tij si dhe vendi i banimit, gjegjësisht firma, selia, NAS, nëse bashkëpronari është person juridik;
- 2) firmën dhe selinë e shoqërisë komanditore;
- 3) lëndën e punës së shoqërisë komanditore;
- 4) deklarata nga përfaqësuesi ligjor, përkatësisht deklarata nga personi fizik, se nuk ekziston pengesë që të bëhet themelues i shoqërisë, në pajtim me nenin 29 të këtij ligji;

(2) Fletëregjistrimin e themelimit të shoqërisë komanditore në regjistrin tregtar e dërgojnë komplementaret.

(3) Fletëparaqitjes për regjistrim i bashkëngjiten:

- 1) marrëveshja për shoqërinë;
- 2) kopje e pasaportës ose e letërnjoftimit për personat e huaj fizik ose të ndonjë dokumenti tjetër për përcaktimin e identitetit të vlefshëm në vendin e tyre, gjegjësisht dëshmi për regjistrim nëse themelues është person juridik;
- 3) dëshmi për pronësi në të cilën janë bërë shënime në librin publik për evidentimin të sendeve të patundshme, e nëse depozitohet lëndë e tundshme për të cilën me ligj është paraparë obligimi për evidencë (regjistër) - dëshmi për pronësi të sendit të tundshëm e nëse depozitohen letra me vlerë në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronësi të letrave të tilla me vlerë me shënim se të njëjtat depozitohen në shoqërinë tregtare dhe se pronari nuk mund të disponojë me të njëjtat. Për këtë

qëllim, pronari i letrave me vlerë te Depozitari qendror për letra me vlerë dorëzon Deklaratë të verifikuar te noteri se letrat me vlerë janë depozituar në shoqërinë tregtare dhe se pajtohet që ndaj të njëjtave të bëhet kufizim i evidentuar për disponim deri në bartjen e të njëjtave në shoqërinë tregtare.

4) deklarata nga përfaqësuesi sipas, gjegjësisht deklarata nga personi fizik, të vërtetuar në noter, gjegjësisht bashkëngjitja e dëshmisë se nuk ekziston pengesë të jetë themelues i shoqërisë, në pajtim me nenin 29 të këtij ligji; dhe

5) deklarata në pajtim me nenin 32 të këtij ligji. dhe

6) leja ose ndonjë akt tjetër të organit shtetëror ose të ndonjë organi tjetër kompetent nëse ai obligim është përcaktuar me ligjin për regjistrim të shoqërisë komanditore në regjistrin tregtar.

(4) Bashkëpronarët, gjegjësisht personat të cilët, sipas marrëveshjes për shoqërinë, janë të autorizuar për përfaqësim të shoqërisë komanditore paraqesin nënshkrime në pajtim me nenin 65, paragrafi 2 dhe 3 nga ky ligj.

(5) Secili ndryshim i të dhënave nga paragrafi 1 të këtij neni si dhe hyrja e bashkëpronarit në shoqërinë komanditore, gjegjësisht dalja e bashkëpronarit nga shoqëria komanditore regjistrohet në regjistrin tregtar.

(6) Publikimi i regjistrimit të themelimit të shoqërisë komanditore në regjistrin komanditor, përveç të dhënave të duhura, mund t'i përfshijë vetëm theksimin e numrit të komanditorëve dhe të shumës së përgjithshme të depozitave të tyre. Emri dhe mbiemri, gjegjësisht firma e komanditorit nuk mund të publikohet pa pëlqimin e tij.

(7) Dispozita nga paragrafi 6 të këtij neni zbatohet edhe kur komanditori hyn në shoqërinë komanditore ekzistuese, gjegjësisht del nga shoqëria komanditore si dhe kur ndërrohet lloji i depozitit ose shuma deri në të cilën komanditori përgjigjet.

SEKSIONI 3

MARRËDHËNIET JURIDIKE MIDIS BASHKËPRONARËVE

Liria e marrëveshjes

Neni 154

(1) Marrëdhëniet juridike midis bashkëpronarëve rregullohen me marrëveshje për shoqërinë.

(2) Nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk janë rregulluar disa çështje të veçanta, zbatohen dispozitat e këtij ligji të shoqërisë publike, nëse në këtë seksion nuk është përcaktuar më ndryshe.

Obligimi për pjesëmarrje personale

Neni 155

(1) Në pjesëmarrje personale në punët e shoqërisë komanditore është i obliguar vetëm komplementari.

(2) Me marrëveshjen e shoqërisë, për pjesëmarrje personale në punët e shoqërisë komanditore mund të obligohet edhe komanditori.

(3) Për pjesëmarrjen personale në punët e shoqërisë komanditore të komplementarit dhe komanditorit mund t'u takojë edhe shpërblim.

Administrimi me shoqërinë

Neni 156

(1) Me shoqërinë komanditore administrojnë komplementaret. Komanditorët nuk kanë të drejtë të administrojnë komanditorët.

(2) Komanditori nuk mund t'u kundërvihet vendimeve të komplementareve, përveç atyre vendimeve dhe procedurave që kanë të bëjnë ose që merren jashtë punës së rregullt të shoqërisë komanditore.

Zbatimi i dispozitave për kompensimin e harxhimeve, të dëmeve dhe për ndalimin e konkurrencës

Neni 157

Dispozitat nga nenet 120,121, 122 nga ky ligj zbatohen ndaj komanditorëve, përveç nëse me marrëveshje për shoqërinë nuk është përcaktuar më ndryshe.

E drejta e shikimit

Neni 158

(1) Komanditori ka të drejtë të kërkojë regjistrim ose kopje të llogarive vjetore të shoqërisë, gjegjësisht shikim në librat tregtar për shkak të kontrollit të validitetit të tyre, e drejta t'i lajmërohet përmbajtja e librave tregtar shoqërisë komanditore dhe të dokumenteve tjera si dhe e drejta me shkrim të paraqet pyetje që kanë të bëjnë në administrimin me shoqërinë komanditore, të cilave doemos t'u përgjigjet me shkrim.

(2) Gjyqi mund me propozim të komanditorit, t'i ofrojë shoqërisë komanditore të komanditorit t'i dorëzojë shkresë ose kopje të llogarive vjetore ose t'i mundësojë shikim në librat tregtar dhe në dokumentet tjera të shoqërisë.

Bartja e pjesëve

Neni 159

(1) Pjesëmarrjet në shoqërinë komanditore mund t'i barten personit të tretë vetëm me pëlqim me shkrim me nënshkrime të verifikuara të agjentit regjistruar, ose në formë elektronike të regjistruar me nënshkrim elektronik të bashkëpronarëve të shoqërisë përmes Sistemit për regjistrim.

(2) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet:

1) pjesët e komanditorëve lirisht të barten midis bashkëpronarëve;

2) pjesët e komanditorëve t'u jepen personave të tretë me pëlqimin e të gjithë komplementareve dhe në pajtim të shumicës së komanditorëve sipas madhësisë së depozitit të tyre; dhe

3) komplementari ta jep një pjesë të pjesës së tij komanditorit ose

personit të tretë me pëlqim të të gjithë komplementareve, me pëlqim të shumicës së komanditorëve dhe sipas madhësisë së depozitit të tyre.

Pjesëmarrja në fitim dhe në mbulimin e humbjes

Neni 160

(1) Fitimi ndahet midis bashkëpronarëve të shoqërisë komanditore në përpjesëtim me pjesën e secilit bashkëpronar në shoqëri, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar më ndryshe.

(2) Fitimi i shtohet depozitit të komanditorit deri sa depoziti i tij nuk e arrin shumën që është obliguar me marrëveshjen e shoqërisë ta arkëtojë si depozit të tij.

(3) Komanditori merr pjesë në mbulimin e humbjeve të shoqërisë komanditore deri në lartësinë e depozitit të regjistruar, nëse nuk është përcaktuar më ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë.

(4) Komanditori nuk është i obliguar ta kthejë fitimin e marrë për shkak të humbjes së më vonshme të shoqërisë komanditore.

SEKSIONI 4

MARRËDHËNIET JURIDIKE TË SHOQËRISË KOMANDITORE ME PERSONA TË TRETË

Përfaqësimi i shoqërisë

Neni 161

(1) Komanditori nuk mund ta përfaqësojë shoqërinë komanditore. Nëse në marrëveshjen e shoqërisë është përcaktuar se komanditori e përfaqëson shoqërinë komanditore, ajo dispozitë është e pavlefshme.

(2) Komanditori nuk mundet as në bazë të autorizimit ta përfaqësojë shoqërinë komanditore.

(3) Nëse veprohet në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, komanditori përgjigjet pakufi dhe në mënyrë solidare me tërë pronën e tij me komplementaret për obligimet e shoqërisë komanditore.

Përgjegjësia e komanditorëve

Neni 162

(1) Komanditori nuk përgjigjet për obligimet e shoqërisë komanditore nëse e ka futur tërë depozitin për të cilin është obliguar me marrëveshjen e shoqërisë. Nëse komanditori nuk e ka tërë depozitin për të cilin është obliguar me marrëveshjen e shoqërisë, përgjigjet para kreditorëve të shoqërisë komanditore pa kufi dhe në mënyrë të solidarizuar me bashkëpronarët tjerë të shoqërisë deri në shumën e depozitit të kontraktuar të zvogëluar për pjesën e futur.

(2) Nëse komanditori në bazë të marrëveshjes me bashkëpronarët tjerë të shoqërisë komanditore, e zvogëlon shumën e depozitit të vet, deri në regjistrimin e shumës së re të depozitit në regjistrin tregtar përgjigjet ndaj personave të tretë deri në shumën e parë të depozitit.

(3) Nëse komplementar bëhet komanditori, përgjigjet si komanditor nga dita e publikimit të regjistrimit në regjistrin tregtar si komanditor.

(4) Personi që hyn në shoqëri në cilësinë e komanditorit, përgjigjet edhe për obligimet që shoqëria i ka marrë para se të fiton cilësinë e komanditorit.

SEKSIONI 5

SHUARJA E SHOQËRISË KOMANDITORE

Bazat e pushimit

Neni 163

Bazat për pushimin e shoqërisë komanditore janë:

- 1) skadimi i afatit për të cilën është themeluar;
- 2) vendimi sjellur nga të gjithë bashkëpronarë (komplementarë dhe komanditorë);
- 3) falimentimi i shoqërisë komanditore,
- 4) vdekje e cilit do qoftë nga komplementaret, gjegjësisht me pushimin e bashkëpronarit-person juridik, përveç nëse me marrëveshje të shoqërisë nuk është përcaktuar më ndryshe;
- 5) falimentim të cilit do prej bashkëpronarëve;
- 6) pushim të ndonjërit prej komplementareve, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar më ndryshe;
- 7) vendim të plotfuqishëm të gjyqit;
- 8) humbje të aftësisë së punës e komplementarit, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar më ndryshe;
- 9) marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë, ndërsa shoqëria komanditore nuk e ndërron veprimtarinë; dhe
- 10) raste tjera të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshjen e shoqërisë.

Vdekja ose dalja e komanditorit

Neni 164

(1) Shoqëria komanditore nuk pushon me vdekjen e komanditorit, gjegjësisht me pushimin e komanditorit i cili është person juridik.

(2) Nëse për shkak daljes së të gjithë komanditorëve në shoqërinë komanditore ngelin së paku dy komplementarë, shoqëria komanditore mund të vazhdojë të punojë si shoqëri publike.

(3) Ndërrimi nga paragrafi 2 i këtij neni paraqitet për regjistrim në regjistrin tregtar në afat prej tridhjetë ditëve nga dita e daljes së komanditorit të fundit. Me fletëregjistrimin bashkëngjitet marrëveshja e shoqërisë publike.

(4) Nëse kalon afati nga paragrafi 3 i këtij neni, shoqëria komanditore pushon.

Trashëgimtar i komplementarit

Neni 165

Nëse me marrëveshjen e shoqërisë përcaktohet se shoqëria komanditore edhe përsëri vdekjes së njërit prej komplementareve, vazhdon me punë

me trashëgimtarin e tij i cili është i mitur, ai ka status të komanditorit deri në moshën madhore, ndërsa e përfaqëson përfaqësuesi i tij ligjor.

KAPITULLI I TRETË

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË PËRKUFIZUAR

SEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Nocioni

Neni 166

(1) Shoqëria me përgjegjësi të përkufizuar është shoqëri tregtare në të cilën një ose më shumë persona juridik marrin pjesë me nga një depozit në kryeqendrë bazë të shoqërisë të marrë vesh prej më parë.

(2) Depozitet e bashkëpronarëve mund të jenë me madhësi të ndryshme.

(3) Bashkëpronarët nuk përgjigjen për obligimet e shoqërisë.

Themeluesit

Neni 167

(1) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të jetë e themeluar nga një ose më shumë persona fizik dhe juridik.

(2) Shoqëria me përgjegjësi të përkufizuar mund të ketë më së shumti 50 bashkëpronarë.

(3) Nëse numri i bashkëpronarëve të shoqërisë e tejkalon numrin 50, bashkëpronarët, gjegjësisht organet e shoqërisë doemos të ndërmarrin veprime për harmonizimin e numrit të bashkëpronarëve në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, edhe atë në afat prej një viti prej ditës kur numri i bashkëpronarëve është rritur mbi 50.

(4) Nëse nuk merren veprime për harmonizimin e numrit të bashkëpronarëve në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, bashkëpronarët, gjegjësisht organet e shoqërisë janë të obliguar, në afatin e paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, të ndërmarrin veprime për shndërrimin e shoqërisë në shoqatë aksionare ose të zbatohen likuidimi i shoqërisë.

Obligimet e bashkëpronarëve

Neni 168

Bashkëpronarët ndaj shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar janë të obliguar në dhënien edhe të obligimeve tjera të përcaktuara me marrëveshjen e shoqërisë.

Firma

Neni 169

(1) Firma e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar doemos t'i përmbajë edhe zgjedhjet: "shoqëria me përgjegjësi të kufizuar" ose shkurtesa "SHPK".

(2) Kur shoqëria ka një bashkëpunëtor firma i përmban fjalët: "shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me një njeri" ose shkurtesa: "SHPKNJP".

SEKSIONI 2

THEMELIMI I SHOQËRISË

Mënyra e themelimit të shoqërisë

Neni 170

(1) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (në tekstin e mëtejme në kapitullin e tretë seksioni i pestë: shoqëria) themelohet me marrëveshjen e shoqërisë që e lidhin të gjithë themeluesit me shkrim ose në formë elektronike.

(2) Nëse shoqërinë e themelon një person, marrëveshja për shoqërinë zëvendësohet me deklaratë të themeluesit për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (në tekstin e mëtejme: deklaratë për themelim të shoqërisë), me shkrim ose në formë elektronike të nënshkruar me nënshkrim elektronik në pajtim me Sistemin për e-regjistrim.

(3) Marrëveshja për shoqërinë, respektivisht deklarata për themelimin e shoqërisë me shkrim, verifikohet me nënshkrime të bashkëpronarëve me nënshkrim elektronik të agentit regjistruar, ose në formë elektronike nënshkruhet me nënshkrim elektronik të bashkëpronarëve të shoqërisë përmes Sistemit për e-regjistrim.

(4) Themeluesit e lidhin marrëveshjen për shoqërinë personalisht ose nëpërmjet të autorizuarit, i cili doemos duhet të ketë autorizim të verifikuar te noteri, përveç në rast kur autorizimi është nënshkruar me nënshkrim elektronik në pajtim me Sistemin për e-regjistrim. Autorizimi nuk nevojitet, nëse përfaqësuesi i themeluesit në bazë të ligjit është i autorizuar që për të ta lidhë marrëveshjen për shoqërinë, përkatësisht të japë deklaratë për themelimin e shoqërisë.

(5) Themelimi i shoqërisë me grumbullimin e bashkëpronarëve, gjegjësisht me regjistrim të depozitimeve përmes apelit publik nuk është e lejuar.

Përmbajtja e marrëveshjes së shoqërisë, gjegjësisht deklaratës për themelimin e shoqërisë

Neni 171

(1) Marrëveshja e shoqërisë, gjegjësisht deklarata për themelimin e shoqërisë doemos t'i përmbajë:

- 1) emri dhe mbiemri, NVAQ, numrin e pasaportës, gjegjësisht numrin i letërnjoftimit nëse bashkëpronari është person i huaj fizik ose të ndonjë dokumenti tjetër për vërtetimin e identitetit të vlefshme në vendin e tij dhe shtetësinë e tij si dhe vendi i banimit, gjegjësisht firma, selia, NUAS, nëse bashkëpronari është person juridik;
- 2) firmën dhe selinë e shoqërisë;
- 3) lënda e punës së shoqërisë;

- 4) kohëzgjatjen e shoqërisë;
- 5) shumën e kryegjësë bazë dhe shumën e depozitit të secilit bashkëpronar veç e veç, e nëse depoziti është monetar-përshkrim më të hollësishëm dhe caktimi i vlerës së sajë;
- 6) mënyra dhe koha e arkëtimit të depozitave monetare që nuk arkëtohen në tërësi;
- 7) emrin dhe mbiemrin, NVAQ të udhëheqësit, gjegjësisht udhëheqësve (në tekstin e mëtejme: udhëheqësi), numri i pasaportës, gjegjësisht numrin e letërnjoftimit për person të huaj fizik ose të ndonjë dokumenti për përcaktimin e identitetit të vlefshëm në vendin e tij dhe shtetësinë e tij si dhe vendin e banimit;
- 8) përfaqësimi i shoqërisë;
- 9) të drejtat dhe obligimet të cilat bashkëpronarët i kanë ndaj shoqërisë, përveç arkëtimit të depozitimeve të tyre, si dhe të drejtat dhe obligimet të cilat i ka shoqëria ndaj themeluesve;
- 10) mënyra dhe matësit e ndarjes së fitimit dhe mënyra e mbulimit të humbjes;
- 11) administrimi i shoqërisë; dhe
- 12) pushimi i shoqërisë.

(2) Me marrëveshjen e shoqërisë, gjegjësisht me deklaratën për themelimin e shoqërisë përveç çështjet nga paragrafi 1 të këtij neni, mund të rregullohen edhe marrëdhënie dhe çështje tjera.

(3) Dispozitat në marrëveshjen e shoqërisë, gjegjësisht në deklaratën e themelimit të shoqërisë, në kundërshtim me këtë ligj, janë të pavlefshme.

SEKSIONI 3

KRYEGJËJA BAZË E SHOQËRISË

Përbërja dhe shuma e kryegjësë bazë

Neni 172

(1) Kryegjëja bazë e shoqërisë përbëhet nga shuma e depozitove të bashkëpronarëve.

(2) Kryegjëja bazë nuk mund të jetë më e vogël se 5.000 euro në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të asaj valute e cila është publikuar nga Banka Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e arkëtimit, përveç nëse themeluesit nuk janë marrë vesh ajo të jetë dita e nënshkrimit të marrëveshjes së shoqërisë, gjegjësisht të deklaratës për themelimin e shoqërisë. Shuma e kryegjësë bazë doemos të jetë e shprehur me numrin e plotë i cili është i përpjesëtuar me njëqind.

Obligimi për zmadhimin e kryegjësë bazë të zvogëluar

Neni 173

(1) Nëse kryegjëja bazë zvogëlohet nga cila do qoftë arsye nën shumën e caktuar në nenin 172, paragrafi 2 të këtij ligji, shuma doemos të jetë e zmadhuar deri në shumën e paraparë me këtë ligj në afat prej gjashtë muajve nga dita e miratimit të llogarisë vjetore, përveç nëse shoqëria, në atë afat, nuk shndërrohet në formë tjetër të shoqërisë.

(2) Nëse në afatin e caktuar me paragrafin 1 të këtij neni shuma e kryegjësë bazë nuk zmadhohet deri në shumën e caktuar në nenin 172, paragrafi 2 nga ky ligj, secili person që ka interes juridik mundet me

propozim deri në gjyqin të kërkojë pushimin e shoqërisë prej se paraprakisht do ta paralajmërojë përfaqësuesin e tij sipas ligjit atë gjendje ta harmonizojë me ligjin.

Depozitimet e bashkëpronarëve

Neni 174

- (1) Depoziti i bashkëpronarit mund të jetë monetar dhe monetar.
- (2) Futja e depozitave në formë të punës dhe shërbimeve, duke inkuadruar edhe shërbime dhe punë të cilat më janë kryer, janë në kundërshtim me këtë ligj.
- (3) Depozitimet regjistrohen në tërësi.
- (4) Depoziti i veçantë nuk mund të jetë më i vogël se 100 euro në kundërvlerë denarë. Depoziti doemos të jetë i shprehur me tërë numrin i cili është i përpjesëtueshëm me numrin njëqind.
- (5) Secili bashkëpronar gjatë themelimit të shoqërisë mund të ndërmerr vetëm një depozit. Një depozit mund bashkërisht të jetë i marrë nga më shumë persona.

Arkëtimi dhe deponimi i depozitimeve

Neni 175

- (1) Para dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrimin e themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, bashkëpronari nuk ka obligim për pagimin e depozitës me të holla, as për futjen e depozitës pa të holla.
- (2) Në rastin e pagimit të depozitës me të holla para dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar, pagimi bëhet në llogarinë e përkohshme të shoqërisë te bartësi i qarkullimit me pagesë në Republikën e Maqedonisë.

Depozitimi monetar

Neni 176

- (1) Nëse depoziti të cilin e merr shoqëria është monetar, në marrëveshjen e shoqërisë, gjegjësisht në deklaraten për themelim të shoqërisë më për së afërmi përcaktohen:
 - 1) bashkëpronari i cili e deponon depozitin monetar,
 - 2) depoziti monetar që deponohet,
 - 3) vlera sipas së cilës shoqëria e merr depozitin monetar,
 - 4) kushtet e volitshme që i pranohen bashkëpronarit i cili e deponon depozitin monetar nëse bashkëpronarët merren vesh për kushte të tilla.
- (2) Me marrëveshjen e shoqërisë bashkëngjitet raporti për vlerësimin e depozitit monetar nga vlerësues i autorizuar. Ndaj depoziteve monetare zbatohen dispozitat nga neni 53 të këtij ligji.

Përcaktimi i vlerës së depozitit jomonetar

Neni 177

Nëse vlera e depozitave të veçanta jomonetare është më e vogël se 5.000 euro në kundërvlerë në denarë dhe nëse vlera e përgjithshme e depozitit jomonetar në tërësi nuk e tejkalon gjysmën e kryegjësë bazë, bashkëpronarët mundin njëzërit të vendosin të mos e vlerësojnë vlerën e depozitit jomonetar. Në atë rast, bashkëpronarët para dërgimit të fletëregjistrimit të themelimit të shoqërisë, përpilojnë raport për depozitet jomonetare në të cilën theksojnë se vlera e depozitit jomonetar nuk është më e vogël se lartësia e depozitit të marrë.

Kushtet e veçanta të bashkëpronarit

Neni 178

Nëse bashkëpronarit të shoqërisë i jepet kompensim për depozit jomonetar që e vendos në shoqëri dhe ajo vlerë i jepet depozitit të tij ose nëse ndonjë bashkëpronarit i jepen kushte të veçanta në shoqëri, në marrëveshjen e shoqërisë në hollësi dhe në tërësi theksohet bashkëpronari i shoqërisë i cili e vendos depozitin monetar, përshkrimi i asaj që, në atë mënyrë, vendoset edhe vlera e shprehur në para si dhe kushtet e veçanta që i përfiton bashkëpronari i shoqërisë.

Kushtet për kthimin e depozitit të deponuar

Neni 179

(1) Nëse shoqëria nuk themelohet në afat prej gjashtë muajve, duke llogaritur nga dita e vendosjes të depozitit të parë, në mënyrë të përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë, secili themelues që e ka vendosur depozitin mundet me propozim të kërkojë nga gjyqi t'ia caktojë të drejtën t'i kthehet depoziti i tij jomonetar i vendosur dhe t'i obligojë themeluesit tjerë t'ia kthejnë, e për kthimin e depozitit monetar ta obligojë bankën ku është vendosur depoziti monetar.

(2) Nëse themeluesit vendosin ta themelojnë shoqërinë sipas vendimit të plotfuqishëm të gjyqit nga paragrafi 1 i këtij neni, zbatohet procedurë e re për vendosjen e depozitave në shoqëri.

Kompensimi i harxhimeve për themelimin e shoqërisë

Neni 180

(1) Themeluesit i bartin harxhimet për themelimin e shoqërisë në përpjesëtim me depozitet e tyre, nëse nuk është përcaktuar më ndryshe me marrëveshjen e shoqërisë. Kompensim për harxhimet për themelimin e shoqërisë nuk mund të paguhet nga kryegjësja bazë e as t'i llogaritet kryegjësja bazë si depozit.

(2) Kompensimi i harxhimeve për themelimin e shoqërisë mund të lejohet vetëm deri në lartësinë e kompensimit më të lartë të përcaktuar në marrëveshjen e shoqërisë.

(3) Kompensimi i harxhimeve nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paguhet vetëm nga fitimi që do të realizohet me punën e shoqërisë, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe. Bashkëpronarët mund të vendosin këto pagesa të kenë prioritet në raport me pjesëmarrjes në ndarjen e fitimit.

Përgjegjësia e bashkëpronarëve dhe udhëheqësve për dëmin

Neni 181

(1) Bashkëpronarët dhe udhëheqësit të cilët gjatë themelimit të shoqërisë kanë dhënë të dhëna jo të sakta për shkak të të cilave kryegjëja bazë nuk e ka arritur shumën e marrëveshjes, janë të obliguar të gjithë t'i arkëtojnë shumat të cilat nuk janë arkëtuara dhe t'i kompensojnë pagesat që janë kryer gjatë themelimit të shoqërisë, ndërsa nuk janë pranuar si harxhime për themelimin e shoqërisë. Bashkëpronarët dhe udhëheqësit përgjigjen edhe për dëmet tjera që kanë qenë të shkaktuara me marrëveshjen.

(2) Bashkëpronarët dhe udhëheqësit i përgjigjen shoqërisë, si borxhli solidar, dhe të jetë për dëmin që është shkaktuar për shkak të mos vendosjes ose vendosjes jo të rregullt të depozitit jomonetar, për shkak të vlerësimit tepër të lartë të vlerës së tyre ose për shkak të së cilës do sillte dhe veprim tjetër të dëmshëm të marrë në procedurën për themelim të shoqërisë për të cilën gjyqi do të konstatojë se janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar.

(3) Nga përgjegjësia e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni lirohet ai bashkëpronar, gjegjësisht udhëheqës i cili nuk e ka ditur për faktet mbi të cilat mbështetet përgjegjësia as për ato doemos të ketë ditur dhe kush ka vepruar me kujdes si tregtar i rregullt dhe i ndërgjegjshëm.

(4) Nëse kompensimi i dëmit është i domosdoshëm për shkak të plotësimit të obligimeve ndaj personave të tretë, shoqëria nuk mund të tërhiqet nga e drejta të kërkojë kompensim të dëmit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, as që mund të merret vesh sa i përket kësaj të drejteje.

(5) E drejta të kërkojë kompensim të dëmit nga paragrafët 1, 2 dhe 4 të këtij neni vjetërsohet në afat prej pesë viteve nga dita e publikimit të regjistrimit të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar.

SEKSIONI I 4

DËRGIMI I FLETËREGJISTRIMIT TË THEMELIT NË REGJISTRIN TREGTAR

Fletëregjistrimi dhe të dhënat të cilat regjistrohen në regjistrin tregtar

Neni 182

(1) Themelimi i shoqërisë regjistrohet në regjistrin tregtar.

(2) Fletëregjistrimin e themelimit të shoqërisë e paraqet udhëheqësi, gjegjësisht udhëheqësi i autorizuar nga udhëheqësit tjerë nëse shoqëria ka më tepër udhëheqës.

(3) Në regjistrin tregtar regjistrohen:

1) firma dhe selia e shoqërisë;

2) lënda e punës së shoqërisë;

3) emri dhe mbiemri, NUAQ, numri i pasaportës, gjegjësisht numri I letërnjoftimit nëse bashkëpronari është person i huaj fizik ose të ndonjë dokumenti tjetër për përcaktimin e identitetit të vlefshëm në vendin e tij dhe shtetësinë e tij si dhe vendin e banimit, gjegjësisht firmën, selinë,

NUAS, nëse bashkëpronari është person juridik;

4) shuma e kryegjësë bazë;

5) dita e lidhjes së marrëveshjes së shoqërisë, gjegjësisht dita e nënshkrimit të deklaratës për themelimin e shoqërisë;

6) kohëzgjatja e shoqërisë nëse ajo është përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë ose me deklaratën për themelimin e shoqërisë;

7) emri dhe mbiemri i udhëheqësit, të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrollorit, nëse shoqëria ka organ për mbikëqyrje, NUAQ, veprimtaria, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i letërnjoftimit për personin e huaj fizik ose të ndonjë dokumentit tjetër për përcaktimin e identitetit - të vlefshëm në vendin e tij dhe shtetësia e tij si dhe vendi i banimit;

8) autorizimi për përfaqësim të shoqërisë; dhe

9) internet faqja nëse shoqëria ka faqe të tillë.

(4) Secili ndryshim i të dhënave nga paragrafi 3 i këtij neni si dhe hyrja e bashkëpronarit në shoqëri, gjegjësisht dalja e bashkëpronarit nga shoqëria, regjistrohen në regjistrin tregtar.

Shkresat me fletëparaqitjen për regjistrim

Neni 183

(1) Fletëregjistrimit për themelimin e shoqërisë i bashkëngjiten:

1) marrëveshja e shoqërisë, gjegjësisht deklarata për themelimin e shoqërisë, me të gjitha shkresat duke e futur edhe autorizimin për autorizuesin;

2) kopje nga pasaporta ose nga letërnjoftimi nëse themelues është personi fizik ose të ndonjë dokumenti për vërtetimin e identitetit - të vlefshëm në vendin e tij, gjegjësisht dëshmi për regjistrimin nëse themelues është person juridik;

3) nëse vendosen depozitë jomonetare, marrëveshjet me të cilat ato përcaktohen dhe zbatohen, raportin e vlerësuesit, përveç kur, në pajtim me nenin 177 të këtij ligji, nuk bëhet vlerësim dhe dëshmi për pronësi në të cilën është kryer shënim në librin publik për evidencë të sendeve të patundshme, e nëse vendoset send i tundshëm për të cilin me ligj është përcaktuar obligimi për evidencë (regjistër) - dëshmi për pronësi të sendit të tundshëm e nëse depozitohen letra me vlere në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronësi të letrave të tilla me vlere me shënim se të njëjtat depozitohen në shoqërinë tregtare dhe se pronari nuk mund të disponojë me të njëjtat. Për këtë qëllim, pronari i letrave me vlerë të Depozitari qëndror për letra me vlere dorëzon Deklaratë të verifikuar të noteri se letrat me vlerë janë depozituar në shoqërinë tregtare dhe se pajtohet që ndaj të njëjtave të bëhet kufizim i evidentuar për disponim deri në bartjen e të njëjtave në shoqërinë tregtare.

4) Vendimi për zgjedhjen e udhëheqësit, nëse nuk është zgjedhur me marrëveshjen e shoqërisë, në të cilën theksohet emri dhe mbiemri, NUAQ, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i letërnjoftimit për personin e huaj fizik ose të ndonjë dokumenti tjetër për përcaktimin e identitetit - të vlefshëm në vendin e tij dhe shtetësinë e tij si dhe vendin e banimit;

5) Deklaratë të secilit udhëheqës të shoqërisë se e pranon zgjedhjen, e nëse me marrëveshje të shoqërisë është përcaktuar se shoqëria e cila ka më shumë se një udhëheqës do ta përfaqësojë vetëm një nga udhëheqësit, bashkërisht ose pa prokurist, dhe deklaratë se pranohet përfaqësimi i shoqërisë në mënyrë të përcaktuar në marrëveshjen e shoqërisë;

6) Vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrollorit, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, në të cilën janë theksuar emri dhe mbiemri, NUAQ, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i

letërnjoftimit për person të huaj fizik ose të ndonjë dokumenti tjetër për përcaktimin e identitetit - të vlefshëm në vendin e tij dhe shtetësia e tij si dhe vendbanimi;

7) Dëshmia e pronësisë në të cilën është bërë shënimi në librin publik për evidencë të sendeve të patundshme, e nëse vendoset send i tundshëm për të cilin me ligj është përcaktuar obligimi për evidencë (regjistër) - dëshmi për pronësi për sendin e tundshëm;

8) Leje ose akt tjetër të organit shtetëror ose të organit tjetër kompetent nëse ai obligim është përcaktuar me ligj për regjistrim të shoqërisë në regjistrin tregtar;

9) deklarata nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik, përkatësisht deklarata nga personi fizik, se nuk ekziston pengesë që të bëhet themelues i shoqërisë, në pajtim me nenin 29 të këtij ligji; dhe **11**

10) Deklaratë, në pajtim me nenin 32 nga ky ligj.

(2) Udhëheqësi, gjegjësisht personat të cilët sipas marrëveshjes së shoqërisë, janë të autorizuar për përfaqësim paraqesin - nënshkrime a në pajtim me nenin 65, paragrafi 2 dhe 3 nga ky ligj.

(3) Shtojcat nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohen në formë elektronike, në pajtim me Sistemin për e-regjistrim dhe Ligjin për sistem njësportel dhe për mbajtje të regjistrit tregtar dhe regjistrit të personave tjerë juridikë.

SEKSIONI 5

MARRËDHËNIET JURIDIKE MIDIS SHOQËRISË DHE BASHKËPRONARËVE

Nënseksioni 1

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E BASHKËPRONARËVE NË SHOQËRI

Të drejtat e bashkëpronarit

Neni 184

(1) Secili bashkëpronar në shoqëri ka të drejtë:

1) të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë;

2) të marrë pjesë në ndarjen e fitimit;

3) të jetë i informuar për punën e shoqërisë;

4) të ketë shikim në librat dhe në dokumentet tjera të shoqërisë; dhe

5) të një pjesë të ngelur të falimentimit, përkatësisht të masës falimentuese.

(2) Bashkëpronari ka edhe të drejta tjera të përcaktuara me ligj. Bashkëpronarët në marrëveshjen për shoqëritë mund të përcaktojnë edhe të drejta tjera.

(3) Të drejtat nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni bashkëpronari i realizon në vëllim, mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me marrëveshjen për shoqërinë.

E drejta e pjesëmarrjes në fitim

Neni 185

(1) Bashkëpronarët kanë të drejtën e pjesës adekuate të fitimit, përveç nëse e drejta e pjesëmarrjes në fitim nuk është kufizuar ose përjashtuar me marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Fitimi ndahet midis bashkëpronarëve në përpjesëtim me pjesën e tyre në shoqëri, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Bashkëpronari bëhet kreditor i shoqërisë deri në lartësinë e shumës së fitimit të lejuar, por të papaguar.

(4) Me marrëveshjen e shoqërisë përcaktohet mënyra e vendosjes për shpërndarje, koha kur bëhet ajo, mundësia që udhëheqësi të vendosë për ndarje sipas kriterëve dhe kahjeve të përcaktuara nga tubimi i bashkëpronarëve, mënyra me të cilën bëhet evidentimi për ndarje dhe përcaktohet shuma për të cilën secili bashkëpronar i veçantë ka të drejtë që përkufizimet gjatë ndarjes dhe çështje tjera, përveç atyre për të cilat në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjen për shoqërinë, është përcaktuar që të vendoset në tubimin e bashkëpronarëve.

Obligimi për arkëtimin e depozitimit

Neni 186

(1) Bashkëpronari është i obliguar që depozitimin e paraparë ta arkëtojë në tërësi, në pajtim me marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Të gjithë bashkëpronarët e bëjnë pagesën e depozitimit në monedha në përpjesëtim me depozitimet e tyre të marrë, përveç nëse nuk është përcaktuar më ndryshe me marrëveshjen e shoqërisë ose me vendimin e bashkëpronarëve.

(3) Bashkëpronarët nuk mund të jenë të liruar as që mund t'u lehtësohet e as t'u anulohet realizimi i obligimit për arkëtimin e depozitimit në monedha. Obligimi për arkëtimin e depozitimit në monedha nuk mund të kompensohet me kërkesën ndaj shoqërisë, përveç nëse bëhet fjalë për hua e cila transformohet në depozitë në shoqëri, respektivisht pagesa plotësuese për të cilat do të merret vendim për transformimin e pagesa shtesë në depozitë në shoqëri.

(4) Bashkëpronari mund të jetë i liruar nga obligimi për arkëtimin e depozitimit në monedha në rast të zvogëlimit të kryegjësë bazë, më së paku në shumën për të cilën zvogëlohet kryegjësja bazë.

(5) Nëse gjatë themelimit të shoqërisë nuk është paguar tërë shuma e depozitimit në monedha, shuma e ngelur arkëtohet në mënyrë e përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë. Pjesa e ngelur e depozitimit doemos duhet që në afat prej një viti nga dita e shpalljes së regjistrimit të themelimit të shoqërisë. Deri në pagimin e shumës së përgjithshme të depozitës me të holla, bashkëpronari i përgjigjet shoqërisë në lartësinë e depozitës së marrë në pajtim me marrëveshjen e shoqërisë.

(6) Bashkëpronari i cili është vonuar me kryerjen e obligimit të tij që në kohë ta paguajë depozitimin, është i detyruar të paguajë kamatë ndëshkuese me ligj.

(7) Dispozitat nga marrëveshja e shoqërisë si dhe çështjet dhe veprimet tjera juridike në kundërshtim me dispozitat të këtij neni, janë të pavlefshme.

Afati plotësues për arkëtimin e depozitit dhe për pagimin e kamatës

Neni 187

(1) Në rast të vonimit të arkëtimin të depozitit, shoqëria, në afat plotësues më së paku tridhjetë ditë, do ta thërrasë bashkëpronarin që ta realizojë obligimin. Në ftesën të cilën e dërgon udhëheqësi i shoqërisë bashkëpronarit i tregohet se lëshimi i arkëtimin në afatin plotësues tërheq përjashtimin e tij nga shoqëria. Thirrja i dërgohet bashkëpronarit me rekomandim ose i dorëzohet në dorë. Nëse ftesa u dërgohet më shumë bashkëpronarëve, afati plotësues doemos duhet të jetë i barabartë për të gjithë.

(2) Shoqëria mund të paraqesë ankesë kundër bashkëpronarit me të cilën kërkohet që ai ta paguajë depozitimin ose pjesën e depozitimit dhe e cila nuk e përjashton mundësinë që bashkëpronari të jetë i përjashtuar nga shoqëria.

Përjashtimi i bashkëpronarëve për shkak të vonimit dhe përgjegjësia e paraparakëve

Neni 188

(1) Nëse skadon afati plotësues për arkëtimin e depozitimit nga paragrafi 1 neni 187 i këtij ligji, udhëheqësi shpall se bashkëpronari në dobi të shoqërisë e ka humbur pjesën e tij dhe pjesën e pjesërishme të depozitimit. Me atë bashkëpronari konsiderohet i përjashtuar. Për përjashtimin nga shoqëria bashkëpronari informohet në formë të shkruar me letër rekomanduese ose letër të dorëzuar personalisht në dorë.

(2) Bashkëpronari i përjashtuar i humb të gjitha të drejtat në shoqëri, por edhe më tej është i obliguar ta arkëtojë pjesën e paarkëtuar të depozitimit. Me atë nuk përjashtohet edhe përgjegjësia e tij për dëmin e shkaktuar shoqërisë për shkak të lëshimit të arkëtimin.

(3) Për arkëtimin e shumës së paarkëtuar dhe për kamatën ndëshkuese me ligj të bashkëpronarit të përjashtuar, përgjigjet drejtpërdrejtë paraparakuesi i tij dhe të gjithë paraparakuesit e mëparshëm të tij nëse ka të tillë. Arkëtimi, në fillim, kërkohet nga paraparakuesi i drejtpërdrejtë i bashkëpronarit të përjashtuar. Nëse ai nuk e paguan depozitin në afat prej një muajve nga dita e dërgimit të thirrjes, kërkohet pagimi nga paraparakuesi I tij.

(4) Paraparakuesi I bashkëpronarit të përjashtuar, me arkëtimin e pjesës së ngelur të depozitimit, e fiton pjesën e bashkëpronarit të përjashtuar.

Shitja e pjesës së bashkëpronarit të përjashtuar

Neni 189

(1) Nëse bashkëpronarët paraparakë të bashkëpronarit të përjashtuar nuk e arkëtojnë pjesën e ngelur të depozitit, shoqëria mund ta shesë pjesën e bashkëpronarit të përjashtuar me ankand publik, përveç nëse me çmimin që përgjigjet me vlerën e saj dhe në pajtim me bashkëpronarin e përjashtuar nuk e merr ndonjëri nga bashkëpronarët e shoqërisë. Pjesa mund të dorëzohet dhe të shndërrohet në monedha në mënyrë tjetër vetëm me pajtimin e bashkëpronarit të përjashtuar.

(2) Nëse me shitjen e pjesës përmes ankandit publik arrihet çmim që është më i lartë nga ai që bashkëpronari i përjashtuar ia ka borxh shoqërisë, shuma që do të ngelë pas përmbushjes së harxhimeve për shitje dhe kamata ndëshkuese ligjore, përdoret për arkëtimin e depozitimit deri në shumën e cila nuk është arkëtuar, ndërsa pjesa e ngelur i paguhet bashkëpronarit të përjashtuar.

Tërheqja e pjesës, përkatësisht arkëtimi i depozitit nga bashkëpronarë tjerë

Neni 190

(1) Nëse sipas dispozitave të nenit 189 të këtij ligji, shndërrimi i pjesës në monedha nuk është e mundur në cilëndo mënyrë në afat prej gjashtë muajsh, shoqëria mund ta tërheqë pjesën ose bashkëpronarët tjerë të shoqërisë mund që në përpjesëtim me pjesët e tyre në shoqëri ta arkëtojnë depozitin e bashkëpronarit të përjashtuar në tërësi. Në përpjesëtim me shumën e arkëtuarë në këtë mënyrë, bashkëpronarëve u rriten depozitat.

(2) Në rast të tërheqjes të pjesës, përkatësisht arkëtimin të depozitit në tërësi nga ana e bashkëpronarëve tjerë, bashkëpronari i përjashtuar ka të drejtë në pjesën e depozitit të tij.

Pagesat plotësuese

Neni 191

(1) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet që të gjithë ose bashkëpronarët e veçantë të obligohen të japin pagesa plotësuese mbi shumën e depozitit vetëm kur ajo është e mundur për mbulimin e humbjeve ose për nevojat e përkohshme të domosdoshme nga mjetet e parave.

(2) Nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar vendimi për pagesa plotësuese të merret me shumicë prej së paku të dy të tretave nga votat e dhëna, bashkëpronarët vendimin e marrin njëzëshëm.

(3) Pagesat plotësuese nuk i zmadhojnë depozitimet e bashkëpronarëve as kryejnë bazë të shoqërisë, përveç kur me vendim për pagesa shtesë plotësuese është përcaktuar që të njëjtat të transformohen në depozitë në shoqërinë në pajtim me dispozitat e këtij ligji për zmadhimin e kryejnë thellore.

(4) Pagesat plotësuese të bashkëpronarëve doemos duhet të jenë në përpjesëtim me pjesët e tyre në shoqëri, përveç nëse bashkëpronarët nuk pajtohen në përpjesëtim tjetër.

(5) Bashkëpronari nuk mund që obligimin e vet për dhënien e pagesës plotësuese ta kompensojë me kërkesën ndaj shoqërisë.

(6) Bashkëpronari i shoqërisë që është vonuar me obligimin për dhënien e arkëtimin plotësues është i obliguar që shoqatës t'i paguajë kamatë ndëshkuese ligjore dhe t'ia kompensojë dëmin që me atë ia ka shkaktuar, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe.

(7) Nëse pushojnë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni për obligimet e bashkëpronarëve për dhënien e pagesave plotësuese, bashkëpronarëve doemos duhet t'u kthehen pagesat plotësuese. Kthimi nuk guxon të bëhet para skadimit të tre muajve, duke llogaritur nga dita kur vendimi për

kthimin e pagesave plotësuese do të jetë e publikuar në mënyrë të paraparë. Kthimi i pagesave plotësuese është i lejuar vetëm kur bashkëpronarët plotësisht e kanë paguar depozitin. Kthimi i pagesave plotësuese para arkëtimit të plotë të depozitit është i pavlefshëm.

Të ardhurat e palejuara

Neni 192

(1) Bashkëpronari në interes të të cilit shoqëria ka paguar shumë të caktuar në kundërshtim me ligjin, me marrëveshjen e shoqërisë ose me vendim të bashkëpronarëve, është i obliguar që shumën e pranuar t'ia kthejë shoqërisë. Bashkëpronari mund ta mbajë atë shumë që e ka pranuar në besim të mirë si pjesë e fitimit.

(2) Për kthimin e shumës së paguar të palejuar me pagesën e të cilës është zvogëluar kryegjëja bazë e shoqërisë (të ardhurat e palejuara), përveç bashkëpronarit i cili e ka pranuar shumën, në mënyrë solidare përgjigjen edhe udhëheqësi, anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, si dhe personat tjerë udhëheqës në shoqëri të cilët gjatë kryerjes së pagesës nuk janë sjellë me kujdesin e duhur.

(3) Nëse shuma e plotë e të ardhurave të palejuara nuk mund të paguhet nga personat e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, shumën për të cilën është zvogëluar kryegjëja bazë e kompensojnë bashkëpronarët në përpjesëtim me depozitimet e tyre në shoqëri.

(4) Personat e përmendur në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, nuk mund që as plotësisht as pjesërisht të jenë të liruar nga obligimi për kthimin e shumës së plotë të të ardhurave të palejuara.

(5) E drejta e shoqërisë nga paragrafët 1, 2 dhe 3 nga ky nen që të kërkojë kthimin e të ardhurave të palejuara vjetërsohet në afat prej pesë vjetësh nga dita e pranimi të pagesës së palejuar, përveç nëse shoqëria dëshmon se personi e ka ditur ose duke marrë parasysh rrethanat, doemos duhet ta ketë ditur se të ardhurat janë të palejuara.

Nënseksioni 2

PJESËT

Përcaktimi i madhësisë së pjesës

Neni 193

(1) Pjesëmarrja e bashkëpronarit në shoqëri përcaktohet sipas madhësisë së depozitit që e ka marrë bashkëpronari, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është më ndryshe e përcaktuar.

(2) Bashkëpronari mund të ketë vetëm një pjesë në shoqëri. Nëse bashkëpronari ka edhe pjesë tjetër, pjesa e tij zmadhohet për pjesën e marrë.

Vërtetimi për pjesë

Neni 194

(1) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet obligimi i shoqërisë që bashkëpronarëve t'u japë vërtetim për pjesën. Vërtetimi për pjesën jepet si shkresë e gjendjes së regjistruar në librin e pjesëve.

(2) Vërtetimi për pjesë dhënë bashkëpronarit në shoqëri, nuk është letër me vlerë.

(3) Shoqëria nuk mund të japë dokumente të cilat japin të drejtën e pagesës nga fitimi vjetor.

Libri i pjesëve

Neni 195

(1) Udhëheqësi i shoqatës është përgjegjës për mbajtjen e librave të pjesëve në të cilën pas regjistrimit të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, për secilin bashkëpronar futen të dhënat për: emrin dhe mbiemrin, NVAQ, numri i pasaportës, përkatësisht numri i letërnjoftimit nëse bashkëpronari është person i huaj fizik ose të ndonjë dokumenti për përcaktimin e identitetit të vlefshëm në vendin e tij dhe shtetësinë e tij, si dhe vendi i banimit, përkatësisht firmën (emri), selinë NUAS nëse subjekti është person juridik, data kur është bërë bashkëpronar, shuma e depozitimit që bashkëpronari i ka marrë dhe që në bazë të asaj e ka arkëtuar ose ka marrë obligim të arkëtojë, mënyrën dhe kohën e arkëtimeve, pagesat plotësuese që i ka arkëtuar, përshkrimi dhe deklarata për vlerën e kontraktuar të depozitit jomonetar që është futur ose ka marrë obligim ta vendosë në të ardhmen, të gjitha obligimet që e ngarkojnë pjesën, numrin e votave që i ka gjatë marrjes së vendimeve të bashkëpronarëve si dhe të drejtat dhe obligimet e veçanta që dalin nga pjesa.

(2) Në librin e pjesëve, pa shtyrje barten të gjitha ndryshimet në drejtim të regjistrimit të bërë si dhe ndarja dhe ngarkesat e pjesës. Përjashtimi dhe dalja e bashkëpunëtorit, ndryshimi i pronarit të pjesës lidhur me shndërrimin e pjesës në para si dhe marrja e depozitave të reja, zvogëlimi i depozitave dhe kthimi i pagesave plotësuese, udhëheqësi i regjistron pa shtyrje dhe pa fletëregjistrim, ndërsa ndryshimet tjera, ngarkesat dhe ndarjet vetëm në bazë të fletëparaqitjes së rregullt të cilitdo qoftë bashkëpronar. Në afat prej tri ditësh nga dita e ndryshimit të bërë në librin e pjesëve, udhëheqësi është i obliguar të paraqesë fletëparaqitje për ndryshimin e regjistrimit në regjistrin tregtar nëse me këtë ligj është përcaktuar se e dhëna që është bartur në librin e pjesëve regjistrohet në regjistrin tregtar.

(3) Udhëheqësi është përgjegjës për mbajtjen e librit të pjesëve në mënyrë azhurnuar dhe për saktësinë e të dhënave të bartura në librin e pjesëve. Udhëheqësi është personalisht përgjegjës dhe pakufi ndaj shoqërisë, ndaj bashkëpronarëve dhe ndaj kreditorëve për dëmin e shkaktuar për mbajtjen e librit të pjesëve në mënyrë të paazhuruar dhe të pasaktë.

(4) Me marrëveshjen e shoqërisë përcaktohet mënyra e mbajtjes së librit të pjesëve.

Veprimi i regjistrimit në librin e pjesëve

Neni 196

(1) Në raport me shoqërinë, bashkëpronari i shoqërisë është vetëm ai i cili është regjistruar në librin e pjesëve.

(2) Konsiderohet se regjistrimi në librin e pjesëve është bërë me ditën kur shoqërisë do t'i përfundojë fletëregjistrimi, nëse ajo i plotëson kushtet që kërkohen për regjistrim të tillë, pa marrë parasysh kohën kur regjistrimi është bërë saktë. Fletëregjistrimi bëhet në formë të shkruar.

(3) Nëse udhëheqësi refuzon të bëjë regjistrimin në librin e pjesëve në afat prej tetë ditësh nga dita e paraqitjes së fletëparaqitjes, bashkëpronari, përkatësisht personi tjetër i cili ka interes juridik mund që pas skadimit të këtij afati, t'i paraqesë propozim gjykatës që të marrë vendim për regjistrim në librin e pjesëve.

(4) Pas vendimit të plotfuqishëm të gjykatës udhëheqësi është i obliguar që në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ta ekzekutojë vendimin dhe të bëjë regjistrimin në librin e pjesëve.

Disponimi me pjesën

Neni 197

(1) Bashkëpronarët disponojnë me pjesët sipas kushteve e përcaktuara në marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Pjesët në shoqëri mund të barten në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë.

(3) Bashkëpronari i shoqërisë mund ta bartë pjesën e vetë, në tërësi ose vetëm një pjesë të pjesës.

(4) Pjesa bartet me marrëveshje për bartjen e pjesës së vërtetuar në noter.

(5) Secila bartje e pjesës që bëhet në mënyrën dhe sipas kushteve që janë në kundërshtim me këtë ligj ose me marrëveshjen e shoqërisë, është jovalide.

(6) Bashkëpronari i shoqërisë mund ta japë peng pjesën e vet sipas kushteve të përcaktuara me marrëveshjen e shoqërisë. Ndaj pengut të pjesës nuk zbatohen dispozitat nga neni 200, paragrafi 1 i këtij ligji.

(7) Bashkëpronarët në shoqëri të cilët kanë borxh në bazë të tatimeve të papaguara, doganave dhe kontributeve nuk mund të blejnë, as të kryejnë bartje të pjesëmarrjeve në shoqërinë e vet tregtare, ose në shoqëri tjera tregtare.

(8) Paragrafi (7) i këtij neni, nuk zbatohet për bashkëpronarët me status organ i administratës shtetërore dhe fonde të themeluara nga shteti, të cilat kanë fituar pjesëmarrje në shoqërinë në bazë të ligjit.

Kushtet nën të cilat bartet pjesa e personit të tretë

Neni 198

(1) Pjesa mund t'i bartet personit të tretë vetëm nëse bashkëpronari e ka arkëtuar plotësisht depozitin e vet.

(2) E drejta e blerjes me përparësi e pjesës realizohet sipas kësaj radhitje: bashkëpronarët tjerë dhe personi i përcaktuar nga shoqëria.

(3) Nëse bashkëpronarët tjerë ose personi i përcaktuar nga shoqëria nuk deklarohen në afat prej tridhjetë ditësh nga paraqitja e qëllimit për bartjen e pjesës, bashkëpronari është i lirë në realizimin e të drejtës së bartjes së

pjesës së vet, nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk janë përcaktuar kushte të veçanta.

Bartja e pjesës përmes trashëgimisë

Neni 199

(1) Bartja e pjesës me trashëgimi nuk mund të kufizohet.

(2) Nëse bashkëpronari vdes, përfaqësuesi ligjor i pasurisë së ngelur do t'i realizojë të gjitha të drejtat dhe do t'i marrë të gjitha obligimet të cilat dalin nga marrëdhënia e bashkëpronësisë duke i përfshirë edhe të gjitha të drejtat dhe obligimet tjera, të cilat sipas marrëveshjes së shoqërisë i ka realizuar, përkatësisht i ka ndërmarrë bashkëpronari i vdekur.

(3) Për bartjen e pjesës përmes trashëgimisë dhe për marrjen me përfitimin të ndonjë prone si tërësi me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet se trashëgimtari, përkatësisht marrësi është i obliguar që pjesën t'ia bartë ndonjërit prej bashkëpronarëve ose personit të cilin do ta caktojë shoqëria edhe atë, nëse palët nuk merren vesh ndryshe, sipas çmimit që i përgjigjet vlerës së pjesës sipas bilancit të fundit të gjendjes. Nëse shoqëria në afat prej tridhjetë ditësh prej se ka kuptuar për të nuk e fton trashëgimtarin, përkatësisht marrësin që ta bartë pjesën e vet, obligimi për bartje përfundon.

Kalimi i të drejtave dhe obligimeve nga bashkëpronari mbi personin i cili e ka fituar pjesën

Neni 200

(1) Në rast të bartjes së pjesës, të drejtat dhe obligimet e raportit bashkëpronësor të bashkëpronarit kalojnë mbi personin i cili e ka fituar pjesën. Ndaj personit i cili e ka fituar pjesën, sa i takon marrëdhënieve në shoqëri, vlejnë edhe të gjitha veprimet juridike që janë ndërmarrë ndaj bashkëpronarit si dhe veprimet juridike që ai i ka ndërmarrë para se i paraqitur shoqërisë bartja e pjesës në librin e pjesëve.

(2) Për realizimin e veprimeve që në bazë të pjesës, doemos duhet të realizohen ndaj shoqërisë sipas obligimit që ekziston gjatë kohës kur shoqërisë i është paraqitur fletëregjistrimi në bartjen e asaj pjese në librin e pjesëve, në mënyrë solidare përgjigjen personi i cili e ka fituar pjesën dhe personi juridik paraprak për obligimet të cilat kanë ekzistuar me ditën e bartjes së pjesës, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e depozitit në kryegjënë bazë të shoqërisë, në bazë të të cilit është fituar pjesa në shoqëri.

(3) E drejta që të kërkohet realizimi i veprimeve nga paragrafi 2 i këtij neni ndaj personit juridik paraprak të personit që e ka fituar pjesën parashkruhet në afat prej pesë vjetësh nga dita e paraqitjes së fletëregjistrimit të bartjes së pjesës në librin e pjesëve.

(4) Peroni që ka fituar pjesë është i obliguar t'i paraqesë shoqërisë fletëparaqitje për ndryshimin e pronësisë mbi pjesën për shkak të regjistrimit në librin e pjesëve.

(5) Fletëparaqitja nga paragrafi 4 i këtij neni përmban deklaratë nga personi i cili ka fituar pjesën se pajtohet të jetë bashkëpjesëmarrës në shoqëri dhe se plotësisht dhe pa kusht i pranon dispozitat e marrëveshjes së shoqërisë.

Ndarja e pjesës

Neni 201

(1) Pjesa mund të ndahet vetëm në rast të bartjes së pjesës, trashëgimi juridike nga bashkëpronari i cili ka pushuar dhe gjatë trashëgimisë. Për ndarjen e pjesës nevojitet pajtimi i të gjithë bashkëpronarëve, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Dispozitat nga ky ligj për shumën më të vogël të depozitit zbatohen edhe në rastin e ndarjes së pjesës.

(3) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përjashtohet ndarja e pjesës, përveç në rastin e bartjes së pjesës midis bashkëpronarëve të shoqërisë.

(4) Në bartjen e pjesës nga pjesa në përpjesëtim zbatohen dispozitat nga ky ligj për bartjen e pjesës.

Pronari i pjesës

Neni 202

(1) Më shumë bashkëpronarë mund të kenë një pjesë.

(2) Personat nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohen si një bashkëpronarë, të drejtat e tyre mund t'i realizojnë vetëm përmes përfaqësuesit të përbashkët, e për obligimet të cilat dalin nga pjesa përgjigjen në mënyrë të solidarizuar.

(3) Secili nga pronarët e pjesës doemos duhet t'i sigurojë shoqërisë të dhëna të cilat sipas këtij ligji kërkohen për secilin bashkëpronar.

(4) Pronarët e pjesës janë të obliguar të nënshkruajnë autorizim me shkrim për emërimin e një përfaqësuesi të përbashkët dhe t'ia dërgojnë shoqërisë. Nëse përfaqësuesi i emëruar voton ose merr ndonjë veprim tjetër lidhur me pjesën, shoqëria e pranon votimin ose veprimin tjetër pa u lëshuar në shqyrtimin e mëtejme të autorizimit të tij nga bashkëpronarët.

(5) Nëse bashkëpronarët e pjesës nuk ia paraqesin shoqërisë përfaqësuesin e përbashkët, çështjet juridike dhe veprimet të cilat shoqëria i ndërmerr janë të plotfuqishme, nëse i ndërmerr ndaj njërit nga bashkëpronarët edhe ato veprojnë ndaj të gjithë bashkëpronarëve.

(6) Shoqëria i dërgon të gjitha informimet për punën e shoqërisë dhe ia paguan fitimin e ndarë vetëm përfaqësuesit të përbashkët dhe nuk ka obligim atë ta bëjë ndaj secilit bashkëpronar.

Fitimi me pjesë personale

Neni 203

(1) Shoqëria mund të fitojë pjesë personale nën këto kushte:

- 1) nëse për pjesën që fitohet në tërësi është paguar depoziti;
- 2) nëse pjesa fitohet nga prona e shoqërisë që e tejkalon shumën e kryegjësë bazë, e nëse shoqëria ka krijuar rezerva për fitimin e pjesëve personale, ndërsa me atë nuk e zvogëlon kryegjësë bazë të shoqërisë ose nivelin e rezervave, të përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë, të cilat nuk mund të përdoren për pagimin e bashkëpronarëve.

(2) Me vendimin e bashkëpronarëve, të marrë me më së paku, me votën e shumicës së tre të katërtën nga numri i përgjithshëm i votave që i japin pjesët, shoqëria mund të blejë pjesë që marrin pjesë në kryegjëse bazë, deri më së shumti një të tretën.

(3) Pjesa e fituar në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, shoqëria është e obliguar që në afat prej një viti nga dita e blerjes, ta huazojë ose me zbatimin e rregullave për zvogëlimin e kryegjëse bazë, ta tërheqë.

(4) Të drejtat nga pjesa e vet pushojnë.

Marrja e pjesës së bashkëpronarit përmes pengut

Neni 204

(1) Shoqëria mund të marrë peng pjesën e bashkëpronarit në shoqëri për të cilën në tërësi është paguar depoziti i marrë.

(2) Bashkëpronari i cili e ka dhënë pjesën peng në shoqëri i realizon të gjitha të drejtat dhe i merr të gjitha obligimet që dalin nga marrëdhënia bashkëpronësore.

(3) Shoqëria mund të marrë peng pjesë vetëm nëse shumën e përgjithshme të kërkesave e siguron me peng të pjesës që është më e ulët se vlera e pjesës ose nëse vlera e pjesës që merret peng është më e ulët nga ajo, shuma e kërkesës të mos jetë më e madhe nga prona e shoqërisë që e tejkalon kryegjëse bazë.

Tërheqja e pjesës

Neni 205

(1) Pjesa mund të tërhiqet vetëm në rastet e paraparë në marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Pjesa mund të tërhiqet pa pëlqimin e bashkëpronarit nëse kushtet për tërheqje kanë qenë të përcaktuara në marrëveshjen e shoqërisë para se bashkëpronari ta fitojë pjesën.

(3) Nëse tërheqja e pjesës shkakton zvogëlimin e kryegjëse bazë, tërheqja mund të bëhet vetëm përmes tërheqjes së kryegjëse bazë.

(4) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prej një personi nuk mund të fitojë pjesë personale as mund ta tërheqë pjesën.

Nënseksioni 3

PUSHIMI I MARRËDHËNIES BASHKËPRONËSORE

Bazat për pushimin e marrëdhënies bashkëpronësore

Neni 206

(1) Marrëdhëniet bashkëpronësore në shoqëri pushon me:

- 1) vdekjen e personit fizik-bashkëpronar;
- 2) pushimin e personit juridik-bashkëpronar;

- 3) daljes së bashkëpronarit nga shoqëria;
- 4) përjashtimin e bashkëpronarit nga shoqëria;
- 5) falimentimin e bashkëpronarit;

(2) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohen edhe baza tjera për pushimin e marrëdhënies bashkëpronësore.

(3) Marrëdhëniet pronësore prej marrëdhënieve bashkëpronësore rregullohen me bilancin e gjendjes që përgatitet në fund të muajit kur ka pushuar marrëdhënia bashkëpronësore.

Largimi i bashkëpronarit nga shoqëria

Neni 207

(1) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet se bashkëpronari të mund të dalë nga shoqëria. Në atë rast në marrëveshjen e shoqërisë doemos duhet të përcaktohen kushtet, procedura dhe pasojat nga dalja e bashkëpronarit nga shoqëria.

(2) Bashkëpronari mundet që me ankesë të kërkojë dalje nga shoqëria nëse për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme. Konsiderohet se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për dalje të bashkëpronarit nga shoqëria:

- 1) nëse bashkëpronarët tjerë ose organ i shoqërisë i shkaktojnë dëm ose nëse me pjesëmarrjen e mëtejme të tij në shoqëri, si bashkëpronar, do të përballojë dëme të papara,
- 2) nëse është i penguar në realizimin e të drejtave të tij në shoqëri, dhe
- 3) nëse ndonjë organ në shoqëri i jep obligime të tepërta.

(3) Padia parashtrohet në afat prej 90 ditësh nga dita e njoftimit për shkakun, por jo më gjatë se një vjet nga dita e krijimit të shkakut.

(4) Bashkëpronari nuk mund të tërhiqet prej më parë nga e drejta e paragrafit 2 të këtij neni.

Përjashtimi i bashkëpronarit nga shoqëria

Neni 208

(1) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet që bashkëpronari të mund të përjashtohet nga shoqëria. Në atë rast, në marrëveshjen e shoqërisë përcaktohen kushtet, procedura dhe pasojat nga përjashtimi i bashkëpronarit nga shoqëria.

(2) Bashkëpronari, përkatësisht shoqëria, me ankesë mund të kërkojë që bashkëpronari tjetër të përjashtohet nga shoqëria nëse për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme. Konsiderohet se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme nëse bashkëpronari tjetër:

- 1) I shkakton dëm shoqërisë ose ndonjërit bashkëpronar ose nëse me pjesëmarrjen e mëtejme të tij në shoqëri, si bashkëpronar, shoqëria ose bashkëpronarët përjetojnë me dëm;
- 2) Sillet në kundërshtim me vendimet e bashkëpronarëve, të marra në mbledhjen e bashkëpronarëve ose me vendosjen përmes letrave;
- 3) Nuk merr pjesë në administrimin e shoqërisë dhe me atë e pengon dhe e kufizon punën e rregullt të shoqërisë ose realizimin e të drejtave të bashkëpronarëve tjerë;
- 4) Me qëllim ose në mënyrë të vrazhdë i cenon dispozitat e marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht nuk i kryen obligimet që i ka si bashkëpronar; ose

5) Në mënyrë tjetër nuk i kryen obligimet e marra me marrëveshjen e shoqërisë.

(3) Padia parashtrohet në afat prej 90 ditësh nga dita e njoftimit për shkakun, por jo më gjatë se një vjet nga dita e krijimit të shkakut.

(4) Bashkëpronari nuk mund të tërhiqet prej më parë nga paragrafi 2 i këtij neni.

Veprimi i daljes dhe përjashtimit të bashkëpronarit nga shoqëria

Neni 209

(1) Me daljen ose me përjashtimin e bashkëpronarit përfundon marrëdhënia e tij bashkëpronësore dhe të gjitha të drejtat të cilat dalin nga ajo.

(2) Bashkëpronari i cili del nga shoqëria, përkatësisht bashkëpronari i përjashtuar ka të drejtën e kompensimit të pjesës së tij sipas vlerës së tregut që e ka patuar pjesa gjatë kohës së daljes, përkatësisht përjashtimit të bashkëpronarit. Nëse depoziti ka qenë jomonetar, bashkëpronari ka të drejtë që ajo që ka futur t'i kthehet, nëse ajo e drejtë është përcaktuar në marrëveshjen e shoqërisë ose nëse për atë pajtohen bashkëpronarët tjerë në afat që nuk mund të jetë më i shkurtër se tre muaj nga dita e daljes, përkatësisht përjashtimit nga shoqëria. Bashkëpronari nuk mund të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar për shkatërrimin e rastësishëm, dëmtimit ose zvogëlimit të vlerës së asaj që e ka deponuar si edhe nëse deri te ajo ka ardhur me përdorim të rregullt.

(3) Nëse bashkëpronari i rregullt ka qenë i obliguar të realizojë ndonjë obligim tjetër ndaj shoqërisë, shoqëria nuk ka pëlqim që me paragrafin 2 të këtij neni t'ia kompensojë pjesën e tij deri sa ai nuk e realizon obligimin ndaj shoqërisë dhe nuk ia kompenzon dëmin nëse ka qenë i shkaktuar nga mosrealizimi i obligimit të marrë.

(4) Në cilën mënyrë do të bëhet vlerësimi, përkatësisht zgjidhja sipas së cilës do të caktohet kompensim për pjesën e përcaktojnë, me marrëveshje, bashkëpronari që del, përkatësisht bashkëpronari i përjashtuar dhe shoqëria.

(5) Nëse bashkëpronari i cili del, përkatësisht nëse bashkëpronari i përjashtuar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, nuk e pranon propozimin e shoqërisë, kompensimi i pjesës së bashkëpronarit që ka dalë, përkatësisht të bashkëpronarit të përjashtuar, e vlerëson vlerësuesi i autorizuar, i përcaktuar nga gjykata.

(6) Marrëdhënia bashkëpronësore në rast të daljes, përkatësisht përjashtimit përfundon kur do t'i paguhet bashkëpronarit kompensimi nga paragrafët 2 dhe 5 të këtij neni.

SEKSIONI 6

AKTET, DOKUMENTET DHE INFORMIMI I BASHKËPRONARËVE

Aktet dhe dokumentet të cilat shoqëria doemos duhet t'i ruajë

Neni 210

Shoqëria, në selinë e saj, doemos duhet t'i ruajë këta akte dhe dokumente:

- 1) Kopjen e marrëveshjes së shoqërisë dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tyre me tekstet e pastruara;
- 2) shkresat (dokumente dhe dëshmi) që janë paraqitur në regjistrin tregtar;
- 3) librin e pjesëve;
- 4) librin e vendimeve;
- 5) listën e azhurnuar me emër dhe mbiemër dhe vendbanim të udhëheqësit të shoqërisë, të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollorit, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës;
- 6) procesverbalet e të gjitha mbledhjeve të bashkëpronarëve dhe të gjitha vendimet që janë marrë nga bashkëpronarët me vendosje përmes letrës si dhe procesverbalet nga organi i administrimit, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës;
- 7) kopje të llogarisë vjetore dhe të raportit vjetor për punën e shoqërisë gjatë vitit të kaluar afarist;
- 8) deklaratat të bashkëpronarëve, të dhëna në formë të shkruar, për pranimin e dispozitave nga marrëveshja e shoqërisë;
- 9) dokumentet për peng dhe hipotekë;
- 10) marrëveshjen kolektive në nivel të shoqërisë;
- 11) korespodencën e plotë të shkruar të shoqërisë me bashkëpronarët e saj
- 12) raportin e revizorit të autorizuar dhe raportin e vlerësuesit të autorizuar, nëse ka të tillë; dhe
- 13) akte dhe dokumente tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me marrëveshjen e shoqërisë.

Qasja e bashkëpronarëve në aktet, dokumentet dhe informatat

Neni 211

(1) Shoqëria duhet që aktet dhe dokumentet të cilat i ruan dhe informatat të cilat i ka, t'ia japë në disponim secilit bashkëpronar ose bashkëpronarit të mëparshëm, për periudhën kur ai ka qenë bashkëpronar i shoqërisë, përfaqësuesit të bashkëpronarit dhe trashëguesit të bashkëpronarit të vdekur, për shikim dhe kopjim (në tekstin e mëtejme: qasje në aktet, dokumentet dhe informatat) gjatë orarit të punës së shoqatës.

(2) Si parakusht për sigurimin e qasjes në akte, dokumente dhe informata nga paragrafi 1 të këtij neni, shoqëria mund të kërkojë që bashkëpronari ose bashkëpronari i mëparshëm për periudhën kur ai ka qenë bashkëpronar i shoqërisë, përfaqësues i bashkëpronarit ose trashëgimtar i bashkëpronarit të vdekur ta dëshmojë cilësinë e bashkëpronarit, përfaqësues i bashkëpronarit, ose trashëgimtar i bashkëpronarit të vdekur.

(3) Shoqëria mund të kërkojë nga personat nga paragrafi 1 të këtij neni që t'i mbulojnë harxhimet e vërteta (për kopjim e ngjashëm), për qasje në aktet, dokumentet dhe informatat e shoqërisë.

Qasja në aktet, dokumentet dhe informatat me vendim të gjykatës

Neni 212

(1) Secilit bashkëpronar ose bashkëpronarit të mëparshëm për periudhën kur ai ka qenë bashkëpronar i shoqatës, përkatësisht përfaqësuesit të bashkëpronarit ose trashëguesit të bashkëpronarit të vdekur doemos duhet t'i sigurohet e drejta e shikimit në akte dhe dokumente tjera nga neni 210 të këtij ligji, në selinë e shoqërisë, në mënyrën e paraparë në marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Nëse personit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk i mundësohet e drejta nga paragrafi 1 i këtij neni, ka drejtë, që me propozimin, të kërkojë nga gjykata të marrë vendim për realizimin e kësaj të drejte. Gjykata në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e paraqitjes së propozimit nga paragrafi 1 i këtij neni, do të konstatojë se personi nga paragrafi 1 i këtij neni a ka të drejtë për shikim në aktet dhe dokumentet tjera dhe nëse konstaton se qasja nuk i është mundësuar, do ta obligojë shoqërinë t'i mundësojë qasje.

(3) Personi që ka patuar qasje në aktet dhe dokumentet tjera nuk mund që informatat e marra publikisht t'i shpallë ose t'i prezantojë nëse me atë i shkakton dëm shoqërisë, përveç në rast nëse realizon ndonjë të drejtë të përcaktuar me ligj, me marrëveshjen e shoqërisë dhe akt tjetër të shoqërisë.

(4) Nëse me publikimin e akteve, dokumenteve ose informatave, personi nga paragrafi 1 i këtij neni i shkakton dëm shoqërisë, përgjigjet për kompensimin e dëmit, përveç në rastet nga paragrafi 3 i këtij neni.

SEKSIONI 7

VENDOSJA E BASHKËPRONARËVE NË SHOQËRI

Nënseksioni 1

VENDOSJA E BASHKËPRONARËVE

Lloji i sjelljes së vendimeve nga ana e bashkëpronarëve

Neni 213

(1) Bashkëpronarët i marrin vendimet në shoqëri në mbledhje të bashkëpronarëve ose me vendosje përmes letrave.

(2) Çështjet për të cilat bashkëpronarët vendosin në mbledhje të bashkëpronarëve ose përmes letrave, mënyra, kushtet dhe procedura e marrjes së vendimeve përcaktohen me marrëveshjen e shoqërisë.

Nënseksioni 2

MBLEDHJA E BASHKËPRONARËVE

Përbërja e mbledhjes së bashkëpronarëve

Neni 214

(1) Mbledhjen e bashkëpronarëve e përbëjnë të gjithë bashkëpronarët.

(2) Udhëheqësi i shoqërisë i cili nuk është bashkëpronar mund të marrë pjesë në punën e mbledhjes, pa të drejtën e votës.

Kompetencat e mbledhjes së bashkëpronarëve

Neni 215

(1) Mbledhja e bashkëpronarëve i bën këto punë:

- 1) i miraton llogarinë vjetore dhe raportet financiare vjetore si dhe raportin vjetor për punën e shoqërisë gjatë vitit të kaluar afarist dhe vendos për ndarjen e fitimit dhe për mbulimin e humbjeve;
- 2) i zgjedh dhe i revokon udhëheqësin, përkatësisht udhëheqësit tjerë, nëse shoqëria zgjedh më shumë udhëheqës dhe vendos për lidhjen e marrëveshjes midis shoqërisë dhe udhëheqësit;
- 3) i zgjedh dhe i revokon anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht zgjedh dhe revokon kontrollorin, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës;
- 4) vendos për masat për shqyrtimin dhe kontrollin lidhur mbi udhëheqjen e punës;
- 5) merr vendim që të ngrihet procedurë për kompensimin e dëmit që e ka përjetuar shoqëria lidhur me themelimin dhe administrimin e saj ndaj udhëheqësit, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës ose kontrollorin (nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës) dhe vendos për emërimin e përfaqësuesit për udhëheqjen e kontesteve, nëse shoqërinë nuk mundet ta përfaqësojë udhëheqësi, përkatësisht udhëheqësit ose anëtarët e këshillit mbikëqyrës;
- 6) lejon lidhjen e marrëveshjeve për furnizim që është më e madhe se një e pesta nga kryegjëja bazë;
- 7) lejon lidhjen e marrëveshjeve që shoqëria i lidh me bashkëpronar të vetin, udhëheqës ose me anëtarët e tyre të familjes në vijë të drejtë pa kufizim dhe në vijën anësore deri në brezin e tretë, përveç nëse ato marrëveshje lidhen me kushtet e zakonshme të punës së shoqërisë;
- 8) vendos për ndërrimin e marrëveshjes së shoqërisë; dhe
- 9) bën punë tjera të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Tubimi i bashkëpronarëve, në rast kur Qeveria e Republikës së Maqedonisë është bashkëpronar i vetëm në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, krahas punëve nga paragrafi (2) i këtij neni jep pëlqim për aktin për përcaktim të lartësisë së pikës për përlogaritje të rrogave të të punësuarve në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar.

(3) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet që tubimi i bashkëpronarëve të vendosë edhe për çështjet tjera.

(4) Me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet që bashkëpronarët të vendosin për çështjet nga paragrafi 1 të këtij neni përmes letrave.

Personat të cilët mund ta konvokojnë mbledhjen e bashkëpronarëve

Neni 216

(1) Mbledhjen e bashkëpronarëve e thërret udhëheqësi, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë, e drejta për thirrjen e mbledhjes nuk i është dhënë personit tjetër.

(2) Mbledhja e bashkëpronarëve thirret së paku një herë në vit. Mbledhja e bashkëpronarëve thirret në formë të shkruar dhe në afatet e parapara me këtë ligj dhe me marrëveshjen e shoqërisë çdo herë kur atë e kërkojnë interesat e shoqërisë.

(3) Mbledhja e bashkëpronarëve doemos duhet të thirret pa shtyrje edhe atëherë kur atë në formë të shkruar, me theksimin e arsyeve, do ta kërkojnë një e më shumë bashkëpronarë depozitimet e të cilëve bashkërisht përbëjnë së paku një të dhjetën nga kryegjëja bazë.

(4) Nëse organi i cili është i autorizuar ta thërrasë mbledhjen e bashkëpronarëve nuk e thërret mbledhjen në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dërgimit të kërkesës nga paragrafi 3 të këtij neni, bashkëpronarët që do ta dërgojnë kërkesën, vetë mund ta konvokojnë kuvendin e bashkëpronarëve gjatë së cilës e konstatojnë edhe rendin e ditës të mbledhjes.

(5) Mbledhjen e bashkëpronarëve mund ta thërrasë edhe këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, nëse shoqëria ka organin mbikëqyrës.

(6) Nëse me kërkesën e një ose më shumë bashkëpronarëve depozitat të cilëve së bashku përbëjnë së paku 51% nga kryegjëja bazë, udhëheqësi, përkatësisht këshilli mbikëqyrës nuk thërret mbledhje të bashkëpronarëve në afat prej njëzet e katër orëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, bashkëpronarët mund të paraqesin propozim për thirrjen e mbledhjes në gjykatë.

Mënyra e thirrjes dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes së bashkëpronarëve

Neni 217

(1) Mbledhja e bashkëpronarëve thirret me ftesë me shkrim, përkatësisht me informim tjetër me shkrim që dërgohet me letër të rekomanduar, me postë tjetër të shpejtë ose në mënyrë tjetër të përshtatshme me dëshmi për pranimin nga secili bashkëpronar, nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe. Nga dita kur ftesa me shkrim, përkatësisht informimi tjetër me shkrim është dërguar deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes së bashkëpronarëve doemos duhet të kalojnë së paku 30 ditë. Në thirrje, përkatësisht në informimin tjetër me shkrim shkruhet edhe rendi i ditës.

(2) Ftesa, përkatësisht njoftimi për konvokimin e mbledhjes së bashkëpronarëve i përmban të dhënat në vijim:

- 1) firmën dhe selinë e shoqërisë;
- 2) vendin dhe datën e mbajtjes së mbledhjes;
- 3) të dhënat e përcaktuara në marrëveshjen për themelimin e shoqërisë, me rëndësi për prezencën në mbledhjen dhe për mënyrën e votimit;
- 4) rendin e ditës sipas të cilit do të punojë mbledhja dhe
- 5) mënyrën në të cilën janë të arritshme materialet që janë përgatitur për mbledhjen që është konvokuar.

(3) Nëse mbledhja e bashkëpronarëve nuk është thirr me rregull, përkatësisht nuk është thirr në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, mund të vendoset vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë bashkëpronarët dhe nëse nuk e kundërshtojnë mbajtjen e mbledhjes.

(4) Secili bashkëpronar ka të drejtë të kërkojë që ndonjë çështje në mënyrë plotësuese të hyjë në rend dite të mbledhjes. Bashkëpronari doemos duhet t'i njoftojë bashkëpronarët tjerë me propozimin e vet më së paku tri ditë para mbajtjes së mbledhjes. Çështjet të cilat nuk janë theksuar në thirrje, përkatësisht për të cilat bashkëpronarët tjerë nuk janë njoftuar në mënyrë plotësuese tri ditë para mbajtjes së mbledhjes së bashkëpronarëve, mund të futen në rend dite dhe të shqyrtohen në

mbledhjen e bashkëpronarëve vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë bashkëpronarët dhe nëse ata nuk kundërshtojnë.

(5) Mbledhja e bashkëpronarëve mbahet në selinë e shoqërisë, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe.

Kufiri i të drejtës së votës së bashkëpronarit

Neni 218

(1) Secila shumë e depozitit që i përgjigjet vlerës prej 100 euro, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e lidhjes së marrëveshjes së shoqërisë, përkatësisht në ditën e marrjes së vendimit për ndryshimin e kryegjësë bazë, jep një votë gjatë së cilës pjesët nën 100 euro të paraqitura në denarë nuk merren parasysh gjatë përcaktimit të së drejtës së votës.

(2) Në marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohet që bashkëpronarët të kenë edhe të drejtë të ndryshme të votës nga ajo që është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, me atë që secili bashkëpronar doemos duhet të ketë të drejtë në më së paku një votë.

Kuorumi i marrjes së vendimeve

Neni 219

(1) Kuvendi i bashkëpronarëve mund të punojë dhe të vendosë (kuorum për punë) nëse në mbledhje e bashkëpronarëve janë të pranishëm bashkëpronarët të cilët kanë shumicë nga votat që i japin depozitimet në pajtim me nenin 218 të këtij ligji, nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar shumicë më e madhe.

(2) Në kuvendin e bashkëpronarëve, përkatësisht me vendosje përmes letrës, vendimet merren me shumicë të votave nga kuorumi nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse me këtë ligj dhe me marrëveshjen e shoqërisë nuk është përcaktuar shumicë më e madhe.

Kufizimet gjatë realizimit të së drejtës së votës

Neni 220

(1) Në kuvendin e bashkëpronarëve, përkatësisht me vendosje përmes letrës bashkëpronari nuk mund të votojë, përkatësisht nuk mund të shprehet për vendim që e liron nga obligimi ose nga përgjegjësia ose që i pranon ndonjë përparësi ose privilegj ose me të cilën vendoset për lidhjen e çështjeve juridike midis bashkëpronarit dhe shoqërisë, për ngritjen e procedurës gjyqësore në të cilën palë do të jenë bashkëpronari dhe shoqëria dhe në rastet tjera të përcaktuara në marrëveshjen e shoqërisë.

(2) Për çështjet nga paragrafi 1 të këtij neni bashkëpronari nuk mund të votojë as përmes përfaqësuesit.

(3) Dispozitat në marrëveshjen e shoqërisë, të kundërta me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, janë të pavlefshme.

Përfaqësimi i bashkëpronarit

Neni 221

(1) Nëse shoqëria ka më shumë se dy bashkëpronarë, bashkëpronari mund të jetë i përfaqësuar nga bashkëpronari tjetër ose person tjetër në mbledhjen e bashkëpronarëve.

(2) Kur bashkëpronari e realizon të drejtën e votës përmes bashkëpronarit tjetër ose personi tjetër, ai doemos duhet t'i japë autorizim atij personi. Autorizimi jepet në formë të shkruar dhe vërtetohet në noter. Në autorizim paraqitet vëllimi i autorizimit të autorizuesit.

(3) Zvogëlimi ose revokimi i autorizimit në autorizim nga paragrafi 2 të këtij neni doemos duhet të bëhet me deklaratë të vërtetuar në noter.

(4) Përfaqësuesit ligjorë i personit fizik dhe përfaqësuesit sipas ligjit të personit juridik që i përfaqësojnë bashkëpronarët në mbledhjen e bashkëpronarëve pa autorizim dhe janë të obliguar të paraqesin dëshmi se janë përfaqësues ligjorë, përkatësisht përfaqësues sipas ligjit.

(5) Veprimet në emër të bashkëpronarit mund t'i kryejë përfaqësues me autorizim me shkrim, të vërtetuar në noter ose te ndonjë organ tjetër adekuat te i cili bëhet vërtetimi i autorizimit në vendin shtetas i së cilës është personi i huaj fizik, përkatësisht në vendin ku e ka themeluar shoqërinë.

Nënseksioni 3

VENDOSJA PËRMES LETRËS

Mënyra e vendosjes përmes letrës

Neni 222

(1) Nëse me marrëveshjen e shoqërisë është përcaktuar se bashkëpronarët vendosin përmes letrës, propozimvendimi i bashkëpronarëve u informohet bashkëpronarëve në formë të shkruar me arsyetim dhe caktohet afati i duhur për deklaram, i cili nuk mund të jetë më shumë se 24 orë (gjatë ditëve të punës), por jo më pak se tetë ditë prej ditës kur është konstatuar se propozimvendimi u është informuar në formë të shkruar. Propozimvendimi doemos duhet të jetë i shprehur qartë.

(2) Vendimi mund të merret edhe në afat më të shkurtër nga paragrafi 2 i këtij neni nëse për vendimin janë shprehur të gjithë bashkëpronarët ose nëse vendosja bëhet në mënyrë elektronike.

(3) Vendosja përmes letrës dhe vendosja në mënyrë elektronike, nëse mënyra e tillë e vendosjes përcaktohet në marrëveshjen e shoqërisë dhe nëse mund të sigurohet siguria, në mënyrë të dokumentuar dhe mundësia për kontroll të vendosjes së kryer përmes letrës si dhe qasja për secilin bashkëpronar të shprehet personalisht në mënyrë elektronike.

(4) Nëse bashkëpronari nuk përgjigjet, përkatësisht nuk shprehet në afatin nga paragrafi 2 të këtij neni, konsiderohet se ka votuar kundër propozimit.

(5) Nëse me marrëveshjen e shoqërisë është përcaktuar që bashkëpronarët të votojnë për çështje të caktuara përmes letrës, secili bashkëpronar mund të japë propozim që të thirret mbledhja të bashkëpronarëve në të cilën do të vendoset lidhur me çështjen.

Nënseksioni 4

PËRGJEGJËSIA PËR MARRJEN E VENDIMEVE DHE LIBRI I PJESËVE

Përgjegjësia e bashkëpronarëve për vendimet e marra

Neni 223

Bashkëpronarët e shoqërisë, nëse në mbledhjen e bashkëpronarëve ose me vendosjen përmes letrës, marrin vendim për të cilin kanë ditur ose për të cilin duke marrë parasysh rrethanat, doemos duhet të kenë ditur se i cenojnë interesat e shoqërisë, përgjigjen pakufi dhe në mënyrë të solidarizuar për dëmin e shkaktuar me vendimin e tillë.

Libri i vendimeve

Neni 224

(1) Vendimet e marra në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht vendimet që i kanë marrë bashkëpronarët me vendosje përmes letrës, udhëheqësi i evidenton në librin e vendimeve. Vendimet evidentohen në librin e vendimeve menjëherë pas marrje dhe vërtetohen me nënshkrim me më së paku të një bashkëpronari i cili ka marrë pjesë në marrjen e tyre. Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të bashkëpronarëve në të cilën janë marrë vendimet, përkatësisht materiali për deklaram me të cilin dokumentohet vendosja përmes letrës si dhe vendimet e marra janë pjesë përbërëse e librit të vendimeve.

(2) Secili bashkëpronar ka të drejtë për shikim në librin e vendimeve dhe mundet që nga udhëheqësi të kërkojë edhe kopje të vendimeve të marra në mbledhje të bashkëpronarëve, përkatësisht me vendosje përmes letrës.

(3) Në shoqërinë e themeluar nga një person, vendimet evidentohen në librin e vendimeve menjëherë pas marrjes dhe vërtetohen me nënshkrimin e bashkëpronarit të vetëm.

(4) Mënyra e mbajtjes së librit të vendimeve më për së afërmi rregullohet me marrëveshjen e shoqërisë.

Nënseksioni 5

PAVLEFSHMËRIA DHE MOHIMI I VENDIMIT TË MARRË NË MBLEDHJEN E BASHKËPRONARËVE OSE ME VENDOSJE PËRMES LETRËS

Pavlefshmëria e vendimit

Neni 225

(1) Me ankesë mund të kërkojë vërtetimi i pavlefshmërisë së vendimit të marrë në mbledhjen e bashkëpronarëve ose të vendimit të marrë me vendosje përmes letrës nëse:

1) mbledhja e bashkëpronarëve në të cilën është marrë vendim nuk është thirrë në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen e shoqërisë, përkatësisht nëse në mbledhje nuk janë thirrë në rregull të gjithë bashkëpronarët e

shoqërisë, përveç në rast nga neni 217, paragrafi 2 nga ky nen;
2) vendimi nuk është marrë në mënyrë dhe formë të përcaktuar me këtë ligj ose me marrëveshjen e shoqërisë; dhe
3) përmbajtja e vendimit është në kundërshtim me ligjin, me traditat e mira afariste ose me dispozitat e marrëveshjes së shoqërisë.

(2) Ankesën për përcaktimin e pavlefshmërisë nga paragrafi 1 të këtij neni mund ta paraqesë:

1) bashkëpronari i cili ka marrë pjesë në punën e mbledhjes së bashkëpronarëve dhe kundërshtimin e vet në marrjen e vendimit e ka deklaruar në procesverbal ose kur vendoset përmes letrës, kundërshtimin e vet e ka paraqitur në shoqëri në formë të shkruar, dhe
2) bashkëpronari të cilit i është pamundësuar të marrë pjesë ose të votojë në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht të vendosë përmes letrës.

(3) Ankesë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqesë edhe secili udhëheqës, anëtarë i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollor (nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës), nëse me vendim u urdhërohet të bëjnë diçka për shkak të të cilit do të mund të përgjigjen për dëmin, përkatësisht me çka do të kishin bërë vepër penale.

(4) Ankesa dërgohet në afat prej gjashtëdhjetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

(5) Ankesa dërgohet kundër shoqërisë. Shoqëria përfaqësohet nga udhëheqësi. Nëse ankesë paraqet udhëheqësi, shoqëria në kontestin përfaqësohet nga anëtarë i këshillit mbikëqyrës, të caktuar nga ana e këshillit, përkatësisht nga kontrollori, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës. Nëse shoqëria nuk ka organ mbikëqyrës ose nëse ankesën e kanë bërë udhëheqësi i përbashkët, anëtarë i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, shoqërisë gjykata i cakton përfaqësues të përkohshëm për kontestin.

(6) Gjykata, me propozim të personave nga paragrafi 3 të këtij neni, me masë të përkohshme mund ta ndalojë zbatimin e vendimit për të cilën, me ankesën, kërkohet të përcaktohet pavlefshmëria nëse është e saktë se me ekzekutimin e tij shoqërisë mund t'i shkaktohet pasojë e dëmit të pakompenzueshëm.

Pasojat juridike nga pavlefshmëria

Neni 226

(1) Nëse gjykata, me vendim të plotfuqishëm, konstaton se vendimi i marrë në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht me vendosjen përmes letrës është e pavlefshme, vendimi ka veprim ndaj të gjithë bashkëpronarëve, udhëheqësin, anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollorit, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, edhe atëherë kur ata nuk kanë qenë palë në procedurë.

(2) Nëse gjykata ka konstatuar se vendimi i cili është regjistruar në regjistrin tregtar është i pavlefshëm, gjykata doemos, sipas detyrimit zyrtar ta dërgojë vendimin në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë për ta regjistruar vendimin e plotfuqishëm në regjistrin tregtar. Regjistrimi i vendimit të gjykatës doemos duhet të publikohet në të njëjtën mënyrë siç është publikuar paraprakisht regjistrimi.

(3) Nëse gjykata ka konstatuar pavlefshmërinë e vendimit për ndryshimin e marrëveshjes së shoqërisë, regjistrin tregtar, së bashku me vendimin, i dërgohet edhe teksti i pastër nga marrëveshja.

Mohimi i vendimeve

Neni 227

(1) Vendimi në mbledhjen e bashkëpronarëve dhe vendimi i marrë me vendosje përmes letrës mund të kontestohet me ankesë. Vendimi mund të kontestohet për shkak të asaj se bashkëpronari me votimin në mbledhje të bashkëpronarëve ose me vendosje përmes letrës ka fituar për vete ose dikujt tjetër i ka mundësuar të fitojë interes, në dëm të shoqërisë ose bashkëpronarëve tjerë.

(2) Mund të kontestohet edhe vendimi i mbledhjes së bashkëpronarëve i cili është themeluar në mosdhënien e informimit e cila ka ndikuar në marrjen e vendimit.

(3) Ankesa paraqitet kundër shoqërisë në afat prej gjashtëdhjetë ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

(4) Nuk mund të kontestohet vendimi i mbledhjes së bashkëpronarëve dhe i marrë me vendosje përmes letrës nëse vendimi vërtetohet me vendim të ri, kurse vendimi i ri nuk kontestohet në afat nga paragrafi 3 të këtij neni.

(5) Dispozita nga neni 225, paragrafi 5 nga ky ligj zbatohet edhe në kontestimin e vendimit të bashkëpronarëve.

Autorizim për mohim

Neni 228

Vendimin e marrë në kuvendin e bashkëpronarëve, gjegjësisht me vendosje përmes korrespondimit, mund ta mohojë:

1) çdo bashkëpronar, i cili ka marrë pjesë në punën e kuvendit të bashkëpronarëve, përkatësisht me vendosje përmes korrespondimit dhe i cili kundërshtimin e tij për vendimin e ka deklaruar në procesverbal, përkatësisht kundërshtimin e tij në formë të shkruar e ka dërguar te shoqëria;

2) bashkëpronarë i cili nuk ka marrë pjesë në punën e kuvendit të bashkëpronarëve, përkatësisht në vendosjen përmes korrespondimit, sepse në kundërshtim ligjit dhe marrëveshjen për shoqërinë, nuk i është lejuar pjesëmarrja në punën e tij, nëse kuvendi i bashkëpronarëve nuk është konvokuar në mënyrë të rregullt, përkatësisht vendosja përmes korrespondimit nuk është zbatuar në mënyrë të rregullt ose nëse çështja për të cilën është vendosur në kuvendin e bashkëpronarëve ose me vendosje përmes korrespondencës, nuk është shpallur ose formuluar në mënyrë të rregullt; dhe

3) çdo administrues dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollor, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, nëse me zbatimin e vendimit do të kishte bërë veprim ndëshkues, joligjor ose për të cilin do të përgjigjej për dëmin.

Nënseksioni 6

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË BASHKËPRONARËVE MINORITARË

Emërimi i revizorit të autorizuar

Neni 229

(1) Bashkëpronar, përkatësisht bashkëpronarët, depozitet e të cilëve së bashku përbëjnë së paku një të dhjetën e kryegjësë bazë, kanë të drejtë të caktojnë revizor të autorizuar që të kryejë revizionin e posaçëm të llogarisë përfundimtare vjetore dhe raporteve financiare.

(2) Nëse shoqëria refuzon që revizori i autorizuar ta bëjë revizionin nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykatësi, me propozimin e çdo bashkëpronari të shoqërisë, mund të emërojë revizor të autorizuar që të kryejë revizion të posaçëm.

(3) Bashkëpronari, përkatësisht bashkëpronarët nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, në kohën derisa bëhet revizioni, nuk mund t'i bartin pjesët e tyre pa pëlqimin e shoqërisë.

(4) Për kompensimin e punës së revizorit të autorizuar, i cili është emëruar nga gjykatësi, vendos gjykata. Gjyqi, propozimin për emërimin e revizorit të autorizuar, mund ta kushtëzojë me dhënien e garancisë për mbulimin e shpenzimeve për revizion nga bashkëpronari, përkatësisht bashkëpronarëve që kanë kërkuar të kryhet revizioni.

(5) Nëse me revizionin dëshmohej rregullshmëria e llogarisë vjetore, përkatësisht nëse dëshmohej se librat tregtarë janë mbajtur me rregull, shpenzimet bien mbi bashkëpronarin, përkatësisht bashkëpronarët të cilët kanë kërkuar të bëhet revizioni.

(6) Nëse me revizionin nuk vërtetohet se llogaria vjetore e tregon në mënyrë objektive gjendjen dhe suksesin e shoqërisë, harxhimet bien në llogari të shoqërisë.

Raporti i revizorit të autorizuar

Neni 230

(1) Revizori është i obliguar që raportin e revizionit të kryer, pa shtyrje, t'ia dërgojë administruesit dhe këshillit mbikëqyrës, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës.

(2) Bashkëpronarët, të cilët kanë kërkuar të kryhet revizioni, kanë të drejtë që në selinë e shoqërisë, të bëjnë kontrollin e raportit nga revizioni i kryer dhe të dokumentacionit që i është bashkangjitur.

(3) Administruesi dhe organi mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, janë të obliguar që në kuvendin e ardhshëm të bashkëpronarëve, ta paraqesin raportin e revizionit të kryer dhe të kërkojnë që kuvendi të prononcohet për të. Në kuvendin e bashkëpronarëve, ftohet edhe revizori i cili e ka kryer revizionin. Administruesi dhe këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, doemos duhet t'i kumtojnë të gjitha parregullsitë e dëshmuara, si edhe të prononcohen për masat që kanë qëllim t'i ndërmarrin ose që propozojnë të ndërmerrin. Këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, doemos duhet të prononcohet nëse shoqëria ka të drejtë të kërkojë kompensim dëmi. Nëse nga raporti i revizionit të kryer del se janë bërë cenime të rënda të ligjit ose të marrëveshjes për shoqërinë, doemos duhet që në një afat jo më shumë se tetë ditë, të konvokohet tubimi i bashkëpronarëve.

Nënseksioni 7

ADMINISTRIMI ME SHOQËRINË

Kushte për zgjedhje të administruesit

Neni 231

(1) Me shoqërinë administron administrues, përkatësisht administratorë (në tekstin e mëtejme: administrues).

(2) Kur në shoqëri ka tre ose më shumë administrues, ata së bashku mund të administrojnë me shoqërinë, si organ administrues i shoqërisë, në mënyrë të përcaktuar në marrëveshjen për shoqërinë Përbërja, organizimi, puna dhe kompetencat e organit administrues të shoqërisë, përcaktohen në marrëveshjen për shoqërinë.

(3) Administrues mund të zgjedhet person fizik i cili ka aftësi afarizmi (është i aftë për punë).

(4) Administrues nuk mund të zgjedhet person të cilit, me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, pjesërisht ose tërësisht i është ndaluar të kryejë profesion, veprimtari ose detyrë që është e lidhur me funksionin administrues të shoqërisë, derisa zgjat ndalesa.

Neni 231-a

Drejtor i shoqërisë me pronësi dominante ose të tërësishme shtetërore, mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;

2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën e arsimit VII/1;

3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;

5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, si vijon: TOEFEL IBT-së paku 74 pikë, IELTS (IELTS)-së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal)-së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE) (Cambridge English: First)-të dhënë, BULATS (BULATS)-së paku 60 pikë dhe

6) ka kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet.

Zgjedhja dhe mandati

Neni 232

(1) Për zgjedhje të administruesit vendosin bashkëpronarët.

(2) Gjatë themelimit të shoqërisë, administruesi i parë mund të emërohet me marrëveshjen për shoqërinë.

(3) Nëse administrues zgjedhet bashkëpronar, mandati mund t'i zgjasë derisa i zgjat raporti bashkëpronësor.

(4) Nëse në marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar koha për të cilën zgjedhet administrues i cili nuk është bashkëpronar, konsiderohet se është zgjedhur për një kohë prej katër vjetësh.

(5) Administruesi mund të rizgjdhjet, pa dallim se sa mandate ka qenë i zgjedhur, përveç nëse në marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar ndryshe.

Zvogëlimi i numrit të administruesve

Neni 233

(1) Nëse shoqëria ka më shumë administrues dhe nëse numri i tyre zvogëlohet nën numrin e përcaktuar me marrëveshjen për shoqërinë, administruesit tjerë janë të obliguar që në pajtim me marrëveshjen për shoqërinë, në afat prej tridhjetë ditësh nga dita kur numri i administruesve është zvogëluar nën numrin e përcaktuar me marrëveshjen për shoqërinë, të konvokojnë tubimin e bashkëpronarëve ose me vendosjen me korrespondim, të organizojnë zgjedhjen e administruesve deri në numrin e përcaktuar në marrëveshjen për shoqërinë.

(2) Nëse shoqëria mbet pa administrues, kurse bashkëpronarët nuk kanë zgjedhur administrues në afat prej tridhjetë ditësh nga dita kur shoqëria ka mbetur pa administrues, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori konvokon kuvendin e bashkëpronarëve. Nëse shoqëria nuk ka organ mbikëqyrës, kuvendi i bashkëpronarëve do të konvokohet nga gjykata, me propozim të të cilit çdo person që ka interes juridik. Gjkata në afat prej tetë ditësh nga pranimi i propozimit, do t'i përcaktojë personin fizik dhe afatin në të cilin ai person do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për mbajtjen e kuvendit të bashkëpronarëve. Nëse shoqëria mbet pa administrues, deri në zgjedhjen e administruesit të ri, gjykata, me propozim të bashkëpronarit ose të personit i cili ka interes juridik, mund të vendosë administrues të përkohshëm nga radhët e bashkëpronarëve të shoqërisë, jo më shumë se gjashtë muaj. Administruesi i përkohshëm, deri në zgjedhjen e administruesit, i kryen vetëm punët e domosdoshme.

Regjistrimi i administruesit

Neni 234

(1) Administruesi, autorizimi i tij për përfaqësim të shoqërisë dhe të gjitha ndryshimet, pa shtyrje, regjistrohen në regjistrin tregtar.

(2) Fletëregjistrimit i bashkëngjiten:

- 1) vendimi për zgjedhjen e administruesit, përveç nëse emërimi nuk është bërë me marrëveshjen për shoqërinë;
- 2) vendimi për revokim nëse administruesi paraprak është revokuar;
- 3) dorëheqja me shkrim nëse administruesit paraprak i ka pushuar mandati me dorëheqje;
- 4) akti me të cilin përcaktohet lloji dhe sasia e përfaqësimit;
- 5) e shfuqizuar ¹²
- 6) nënshkrimi i administruesit, përkatësisht nënshkrimet e personave të autorizuar për përfaqësim të vërtetuar, të bashkëngjitura dhe të dhëna në pajtim me nenin 65, paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji.

Autorizimet e administruesit

Neni 235

(1) Autorizimet e administruesit përcaktohen me marrëveshjen për shoqërinë. Nëse me marrëveshjen për shoqërinë nuk janë përcaktuar autorizimet e administruesit, ai mund t'i ndërmarrë të gjitha punët dhe

veprimet juridike, që janë të lidhura dhe të zakonshme për udhëheqjen e punëve dhe që janë në interes të shoqërisë.

(2) Në raportet me persona të tretë, administruesi është i autorizuar që në të gjitha rrethanat të veprojë, në emër të shoqërisë, me përjashtim të autorizimeve që, sipas këtij ligji dhe marrëveshjes për shoqërinë, i kanë bashkëpronarët.

(3) Nëse janë zgjedhur më shumë administrues, të gjithë administruesit e shoqërisë kanë autorizime dhe të drejta të njëjta në lidhje me udhëheqjen e punëve të shoqërisë, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Bashkëpronar, i cili është zgjedhur për administrues ose për anëtar të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, si bashkëpronar ka të drejta dhe obligime të njëjta si edhe bashkëpronarët në shoqëri dhe nuk ka të drejtë që gjatë realizimit të drejtave të veta dhe gjatë kryerjes së detyrave, të thirret në autorizimet, të drejtat dhe obligimet që i ka si administrues i shoqërisë ose si anëtar i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë.

Autorizimi për përfaqësim

Neni 236

(1) Shoqërinë në raportet me persona të tretë e përfaqëson administruesi. Administruesi nënshkruhet ashtu që, pasi paraqet firmën shoqërisë, shënon statusin e vet të administruesit dhe e vendos nënshkrimin e vet.

(2) Nëse shoqëria ka më shumë se një administrues, shoqërinë e përfaqësojnë të gjithë administruesit, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar ndryshe. Deklarimi i vullnetit ndaj shoqërisë e shprehur ndaj njërit administrues, konsiderohet se është bërë për të gjithë administruesit.

(3) Administruesi është i obliguar t'i respektojë përkufizimet e autorizimeve për përfaqësim, të përcaktuara në marrëveshjen për shoqërinë, në vendimin e kuvendit të bashkëpronarëve ose në vendimin e marrë përmes korrespondencës.

(4) Përkufizimet nga paragrafi 3 i këtij neni nuk kanë ndikim juridik ndaj personave të tretë, edhe pse përkufizimet kanë qenë të shpallura.

(5) Administruesi i cili ka ditur se ndërmerr veprim në emër të shoqërisë, pa pasur autorizim për këtë, është personalisht përgjegjës ndaj shoqërisë për dëmin që ka pësuar nga ky veprim.

Mënyra e punës së administruesve

Neni 237

(1) Nëse janë zgjedhur më shumë administrues, ndërsa me marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar ndryshe, asnjëri nga administruesit në mënyrë të pavarur nuk mund të ndërmarrë veprime të duhura për udhëheqjen e punëve të shoqërisë, përveç nëse me vonimin ose me mosndërmarrjen e veprimit të caktuar, ekziston rrezik t'i bëhet dëm shoqërisë ose në mënyrë tjetër mund të kërcënohen interesat e shoqërisë.

(2) Nëse me marrëveshjen për shoqërinë çdonjëri nga administruesit është i autorizuar që vetë të ndërmarrë veprime të duhura për udhëheqjen e punëve të shoqërisë, çdonjëri nga administruesit mund të shprehë

kundërshtim për veprim të ndërmarrë, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërinë, nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Nëse administruesit nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen nga paragrafi 2 i këtij neni, vendim për çështjen e mosmarrëveshjes merr kuvendi i bashkëpronarëve.

(4) Kundërshtimi nga paragrafi 2 i këtij neni nuk ka ndikim juridik ndaj personave të tretë.

Ndalimi i konkurrencës

Neni 238

(1) Pa pëlqimin e kuvendit të bashkëpronarëve, administruesi i shoqërisë, nuk mund që:

- 1) për llogarinë e vet ose të huaj, të kryejë punë që bëjnë pjesë në lëndën e punës së shoqërisë;
- 2) të jetë bashkëpronar me përgjegjësi të pakufizuar në shoqëri tjetër, e cila ka lëndë të njëjtë ose të ngjashme të punës së shoqërisë;
- 3) të jetë anëtar i organit administrues ose anëtar i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollues në shoqëri tjetër, e cila ka lëndë të njëjtë ose të ngjashme të punës së shoqërisë;
- 4) në zyrat e shoqërisë të kryejë punë për llogarinë e vet ose të huaj.

(2) Nëse administruesi vepron në kundërshtim me ndalesat nga paragrafi 1 i këtij neni, shoqëria, mundet nga administruesi:

- 1) të kërkojë kompensim të dëmit; ose
- 2) të kërkojë që shoqërisë t'ia lë çështjen juridike që e ka lidhur për llogarinë e vet dhe t'ia japë dobinë e cila buron nga çështja juridike, e lidhur për llogarinë e vet ose të huaj.

(3) Nëse administruesi nuk e kompenson dëmin ose nuk i ja lë shoqërisë çështjen juridike të lidhur për llogarinë e vet ose nuk i ja jep shoqërisë dobinë e cila buron nga çështja juridike e lidhur për llogarinë e vet ose të huaj ose shoqërisë nuk ia bart kërkesën që ka pësuar nga kjo administruesit tjetër, si edhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës dhe cildo bashkëpronar mund të paraqesë padi për realizim të kërkesave nga paragrafi 2 i këtij neni.

(4) E drejta për realizimin e kërkesave nga paragrafi 2 i këtij neni, parashkruhet në afat prej nëntëdhjetë ditësh nga dita kur administruesit tjerë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës dhe cildo bashkëpunëtor, kanë kuptuar për veprimin në bazë të të cilit ekziston e drejtë kompensimi e dëmit, përkatësisht të drejtë të kërkojë t'ia lë çështjen juridike, që e ka lidhur në llogari të vet dhe t'ia japë dobinë që buron nga çështja juridike të lidhur për llogarinë e vet ose të huaj. Pas skadimit të afatit prej pesë vjetësh, nga dita e ndodhjes së cenimit të ndalesës, e drejta për realizimin e kërkesave nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk mund të realizohet.

(5) Në rast të cenimit të ndalesave nga paragrafi 1 i këtij neni, administruesi mund të revokohet pa lajmërim paraprak dhe pa të drejtë kompensimi të dëmit, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen për rregullimin e raporteve ndërmjet administruesit dhe shoqërisë.

Konflikti i interesave

Neni 239

(1) Për çdo marrëveshje ose aktivitet tjetër afarist të shoqërisë, në të cilat shoqëria është palë dhe në të cilat administruesi, anëtari i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, ka interes, bile edhe në mënyrë indirekte, patjetër duhet të veprojnë konform neneve 457, 459 dhe 460 të këtij ligji. Administruesi, anëtari i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, i cili ka interes është i obliguar menjëherë ta paraqesë atë.

(2) Nëse bashkëpronar, anëtar i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollues, kupton se është përmbushur ndonjëri nga kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, për këtë menjëherë e lajmëron kuvendin e bashkëpronarëve, këshillin mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesin. Administruesi, anëtari i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, ka të drejtë të deklarohet, por nuk mund të marrë pjesë në debatin ose në vendosjen lidhur me marrëveshjen ose me aktivitetin tjetër afarist, as në marrjen e vendimit për dhënien e lejes nga paragrafi 460 i këtij ligji.

(3) Nëse kuvendi i bashkëpronarëve, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, nuk japin leje ose nëse vendimi me të cilin kanë dhënë ose kanë refuzuar të japin leje, është në kundërshtim me ligjin, përkatësisht në marrëveshjen për shoqërinë, nuk mund të theksohen kërkesa ndaj personave të tretë, përveç nëse shoqëria dëshmon se personi i tretë ka ditur për mosekzistimin e lejes ose për paligjshmërinë e vendimit, përkatësisht për kundërshtimin e saj me marrëveshjen për shoqërinë ose duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat, doemos është dashur të dijë për të.

Përgjegjësia për mbajtjen e librave tregtare dhe për përgatitjen e llogarisë vjetore

Neni 240

(1) Administruesi është përgjegjës për mbajtjen e rregullt të librave tregtare të shoqërisë, në pajtim me ligjin dhe me rregullat të tjera.

(2) Administruesi është përgjegjës për përgatitjen me kohë të llogarisë vjetore dhe raportin vjetor për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist dhe është i detyruar, që më së voni në afatin e përcaktuar me këtë ligj, t'ia paraqesë kuvendit të bashkëpronarëve.

(3) Dokumentet nga paragrafi 2 i këtij neni, si edhe propozimi i vendimeve, marrja e të cilave propozohet nga ana e administruesit dhe, sipas nevojës, edhe raporti i revizionit, ju dërgohen bashkëpronarëve, në mënyrën dhe afatin e përcaktuar me marrëveshjen për shoqërinë.

(4) Në lidhje me dokumentet nga paragrafi 3 i këtij neni, bashkëpronarët mund të parashtrajnë pyetje me shkrim dhe të kërkojnë sqarime plotësuese, të cilave administruesi është i obliguar t'iu përgjigjet gjatë mbajtjes së kuvendit të bashkëpronarëve.

Kujdesi i detyruar dhe përgjegjësia e administruesit

Neni 241

(1) Administruesi është i detyruar t'i udhëheqë punët e shoqërisë, me kujdesin e tregtarit të rregullt dhe të ndërgjegjshëm dhe ta ruajë sekretin afarist të shoqërisë.

(2) Administruesi personalisht dhe pakufi është përgjegjës, ndërsa nëse shoqëria ka dy ose më shumë administrues, ata përgjigjen edhe në mënyrë solidare, ndaj shoqërisë dhe ndaj personave të tretë për punën në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe dispozitat tjera dhe për mosrespektimin e marrëveshjes për shoqërinë. Nëse ka më shumë administrues, ata përgjigjen pakufi dhe në mënyrë solidare.

(3) Administruesi doemos duhet që veçanërisht ta kompensojë dëmin, nëse në kundërshtim me këtë ligj dhe me marrëveshjen për shoqërinë, kryen ndarje të pronës së shoqërisë, përkatësisht nëse bashkëpronarëve pjesërisht ose tërësisht ua kthen borxhet, ua paguan kamatën ose fitimin ose nëse shoqëria fiton pjesë vetjake, nëse e merr peng ose nëse e tërheq pjesën.

(4) Administruesi është personalisht përgjegjës edhe për dëmin që do t'ia shkaktojë shoqërisë me punën juridike që e ka lidhur me shoqërinë në emrin e vet ose të huaj, por për llogarinë e vet, nëse për të paraprakisht nuk ka marrë pëlqim nga organi mbikëqyrës, ndërsa nëse shoqëria nuk ka organ mbikëqyrjeje, pëlqim nga administruesit tjerë, nëse bashkëpronarët në shoqëri kanë zgjedhur më shumë administrues.

(5) Në rast kontesti administruesi doemos duhet të dëshmojë se ka vepruar në interes të shoqërisë dhe me vëmendje të tregtarit të rregullt dhe të ndërgjegjshëm. Nëse më shumë administrues kanë marrë pjesë në veprën e njëjtë dhe ekziston mosmarrëveshje për dëmin e bërë, gjykata konstaton kontributin e çdo administruesi në shkaktimin e dëmit.

(6) Përveç padisë për kompensimin e dëmit që personalisht e kanë pësuar, bashkëpronarët, veçmas ose në grup, mund të ngritin padi kundër administruesi për kompensimin e dëmit të shoqërisë. Paditësit mund të kërkojnë kompensimin e dëmit që e ka pësuar shoqëria.

(7) Është jovalide secila dispozitë e marrëveshjes për shoqërinë, me të cilën ngritja e padisë kushtëzohet me mendimin ose aprovimin paraprak të kuvendit të bashkëpronarëve ose e cila do të përmbante dorëheqjen paraprake nga ngritja e padisë.

(8) Cilido vendim i kuvendit të bashkëpronarëve, nuk mund të ketë ndikim për mos ngritjen e padisë për përgjegjësinë e administruesit për gabimet e bëra në kryerjen e detyrave të veta.

(9) Padia për përgjegjësi nga paragrafët 3, 4 dhe 6 dhe të këtij neni, parashkruhet për tre vjet, konsideruar nga dita e veprimit të dëmshëm të kryer, përkatësisht nga dita e dëmit të shkaktuar ose nëse ka qenë fshehur, nga dita e zbulimit të tij. Nëse veprimi është kualifikuar si vepër penale, padia parashkruhet për dhjetë vjet.

Revokimi i administruesit dhe pushimi i mandatit për shkak të dorëheqjes

Neni 242

(1) Administruesi në çdo kohë mund të revokohet me vendimin e bashkëpronarëve, në mënyrën si kanë vendosur për zgjedhjen e tij, me ose pa arsyetim. Çdo dispozitë tjetër në marrëveshjen për shoqërinë, konsiderohet jovalide.

(2) Me propozimin e bashkëpronarit, gjykata mund të marrë vendim për revokimin e administruesit i cili është edhe bashkëpronar.

(3) Administruesi mund të paraqesë dorëheqje në cilëndo kohë, me paraqitjen e njoftimit të shkruar të të gjithë bashkëpronarët, nëse interesat e shoqërisë nuk imponojnë diçka tjetër.

(4) Konsiderohet se drejtorit i ka pushuar mandati me ditën që e ka shënuar në dorëheqjen, e parashtruar me shkrim ose në formë elektronike të gjithë bashkëpronarëve. Drejtori e verifikon nënshkrimin e dorëheqjes te noteri. Nëse dorëheqja është dhënë në formë elektronike, atë drejtori duhet ta nënshkruajë me nënshkrim elektronik në pajtim me Sistemin për e-regjistrim. Për dorëheqjen e parashtruar nuk vendoset për pranimin e saj. Nëse interesat e shoqërisë këtë e imponojnë, bashkëpronarët mund ta obligojnë drejtorin ta kryejë funksionin deri në zgjedhjen e drejtorit të ri, por jo më gjatë se 30 ditë. Në regjistrin tregtar parashtrohet dorëheqja me shkrim ose në formë elektronike në pajtim me Sistemin për e-regjistrim që të bëhet shlyerja e regjistrimit të drejtorit në regjistrin tregtar. Nëse shoqëria është me një drejtor, e shoqëria nuk ka zgjedhur drejtor, gjykata vendos drejtor të përkohshëm, në mënyrë të caktuar me këtë ligj.

(5) Administruesi i revokuar ka të drejtë kompensimi të dëmit, nëse kjo është përcaktuar me marrëveshjen për rregullimin e raporteve ndërmjet administruesit dhe shoqërisë.

Administrimi i shoqërisë nga një person

Neni 243

(1) Me shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar nga një person, udhëheq vetë bashkëpronari ose administrues i zgjedhur nga ai vetë. Nëse bashkëpronari i vetëm është person juridik, me shoqërinë administron person i zgjedhur nga ai.

(2) Bashkëpronari i vetëm, si administrues, e udhëheq shoqërinë në mënyrën për të cilën konsideron se është e përshtatshme për realizimin e interesit të shoqërisë. Dispozitat e këtij ligji që janë në lidhje me përgjegjësinë e shoqërisë ndaj personave të tretë dhe ndaj administruesit, si përfaqësues sipas ligjit, në lidhje me personat e tretë, zbatohen në bashkëpronarin e vetëm si themelues i shoqërisë dhe si administrues i shoqërisë.

(3) Kontratat ndërmjet bashkëpronarit të vetëm dhe shoqërisë, në të cilën bashkëpronari i vetëm është njëkohësisht edhe administrues, doemos duhet të shënohen në procesverbal ose të jenë të kontraktuara në formë të shkruar.

(4) Dispozitat e këtij ligji, që kanë të bëjnë me administruesin për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që kanë dy ose më shumë bashkëpronarë, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në administruesin e zgjedhur nga bashkëpronari i vetëm.

Nënseksioni 8

MBIKËQYRJE MBI PUNËN E SHOQËRISË

Dispozitat themelore

Neni 244

(1) Mbikëqyrje mbi punën e shoqërisë mund të kryejë këshill mbikëqyrës ose kontrollues, ndërsa nëse në shoqëri nuk është themeluar organ mbikëqyrës, mbikëqyrjen e kryejnë drejtpërdrejt bashkëpronarët, veçmas ose bashkërisht.

(2) Dispozitat e këtij ligji, me të cilat rregullohet këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, zbatohen vetëm nëse me këtë ligj, përkatësisht me marrëveshjen për shoqërinë, është përcaktuar shoqëria të ketë organ mbikëqyrës.

Sektori i parë

ORGANET E MBIKËQYRJES

Zgjedhja e organeve të mbikëqyrjes

Neni 245

Me marrëveshjen për shoqërinë mund të parashihet themelimi i këshillit mbikëqyrës, përkatësisht zgjedhja e kontrolluesit të shoqërisë, i cili përcjell zbatimin e marrëveshjes për shoqërinë, kujdeset për punimin me pronën e shoqërisë dhe ruajtjen e saj, kontrollon mënyrën në të cilën bëhet administrimi me shoqërinë nga administruesit dhe i paraqet raport kuvendit të bashkëpronarëve.

Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të organit për mbikëqyrje

Neni 246

(1) Kuvendi i bashkëpronarëve i zgjedh dhe i revokon anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesin, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar ndryshe. Këshilli i parë mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, mund të emërohen me marrëveshjen për shoqërinë.

(2) Në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar nga një person, nëse bashkëpronari ka vendosur të themelojë organ mbikëqyrjeje, anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesin, i zgjedh dhe i revokon me vendimin e vet bashkëpronari i vetëm.

(3) Anëtarë të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrollues nuk mund të zgjidhen:

- 1) administruesi dhe të punësuarit në shoqërinë;
- 2) bashkëshortët, personat që janë farefis në vijë të drejtë dhe anësore deri në brezin e tretë me administruesin;
- 3) personat të cilëve gjykatësi, me vendim ua ka ndaluar kryerjen e punëve revizuese derisa zgjat ndalesa, ose
- 4) person fizik, i cili është anëtar në pesë këshilla mbikëqyrës në shoqëri aksionare ose në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Përbërja dhe mandati i këshillit mbikëqyrës

Neni 247

(1) Këshilli mbikëqyrës përbëhet së paku prej tre anëtarësh.

(2) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës zgjidhen për katër vjet, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të rizgjidhen, pa dallim se sa mandate është zgjedhur, përveç nëse në marrëveshjen për shoqërinë nuk është përcaktuar ndryshe.

Organizimi dhe puna e këshillit mbikëqyrës

Neni 248

(1) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës zgjedhin kryetarin e këshillit mbikëqyrës nga radhët e veta. Kryetari i këshillit mbikëqyrës i konvokon dhe kryeson me seancat e këshillit mbikëqyrës dhe organizon punën e tij.

(2) Të gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës kanë të drejta, obligime dhe përgjegjësi të njëjta.

(3) Marrja e vendimeve dhe mënyra e punës së këshillit mbikëqyrës rregullohen me marrëveshjen për shoqërinë.

(4) Këshilli mbikëqyrës takohet së paku tre herë gjatë një viti afarist.

Kompetenca të organit të mbikëqyrjes

Neni 249

(1) Këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, bën mbikëqyrjen e punës së shoqërisë. Në kryerjen e mbikëqyrjes së punës së shoqërisë, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, mund t'i kontrollojë dhe vlerësojë librat tregtarë të shoqërisë, aktet dhe dokumentet tjera të shoqërisë, pronën dhe posaçërisht arkën dhe gjendjen e letrave me vlerë të shoqërisë. Kryerjen e këtyre punëve, këshilli mbikëqyrës mund t'ia besojë anëtarit të vet ose punë të veçuara t'ia besojë ekspertit i cili nuk është anëtar i këshillit mbikëqyrës.

(2) Këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, kontrollon llogarinë vjetore të shoqërisë dhe raportet tjera financiare, propozimin për shpërndarjen e fitimit dhe vlerëson raportin vjetor për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist dhe për atë e njofton kuvendin e bashkëpronarëve. Në raport, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, posaçërisht thekson se në çfarë mënyre dhe sasi e ka kontrolluar udhëheqjen e punëve të shoqërisë në vitin kalendarik dhe në çfarë përfundime ka arritur, pasi që ka bërë kontrollin e llogarisë vjetore dhe të raportit vjetor për punën e shoqërisë, në vitin paraprak afarist.

(3) Këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi, patjetër duhet ta konvokojë kuvendin e bashkëpronarëve nëse atë e kërkon interesi i shoqërisë.

(4) Në marrëveshjen për shoqërinë mund të përcaktohen punë që nuk mund të kryhen pa lejen e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesit.

Zbatimi i dispozitave për ndeshjen e interesave, për ndalesë të konkurrencës dhe për përgjegjësi

Neni 250

Dispozitat nga nenet 238, 239 dhe 241 të këtij ligji, me të cilat rregullohen ndalesa e konkurrencës, ndeshja e interesave dhe përgjegjësia e administruesit, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe mbi anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesin.

Sektori i dytë

KRYERJA E MBIKËQYRJES SË DREJTPËRDREJTË NGA ANA E BASHKËPRONARËVE

Autorizime kontrolluese të bashkëpronarit

Neni 251

(1) Bashkëpronarët, përmes kuvendit të bashkëpronarëve, kryejnë mbikëqyrje të rregullt nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit të llogarisë vjetore dhe të raportit vjetor për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist.

(2) Çdo bashkëpronar ka të drejtë edhe personalisht të njoftohet për punët e shoqërisë, t'i shqyrtojë llogaritë vjetore dhe raportet për punën dhe librat tjera tregtare, aktet dhe dokumentet tjera të shoqërisë, raportet për punën e shoqërisë që i paraqet administruesi, raportet e revizuesve të autorizuar, si edhe të kryejë formë tjetër kontrolli të punës së shoqërisë, në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në marrëveshjen për shoqërinë.

(3) Kur realizimi i të drejtës për mbikëqyrje nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është penguar ose pamundësuar nga organi kompetent i shoqërisë ose nga personi udhëheqës, për realizim të të drejtës, me propozimin e bashkëpronarit, vendos gjykata.

(4) Çdo bashkëpronar, këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesit ose personit tjetër që bën revizion, në çdo kohë, me shkrim, mund t'i tërheqë vërejtjen për punë të caktuara nga fushëveprimi i tij.

(5) Nëse puna është e rëndësishme dhe urgjente, ndërsa administruesi, me propozimin e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesit, nuk e ka konvokuar kuvendin e bashkëpronarëve, kuvendin e konvokon, pa shtyrje, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesi. Nëse shoqëria nuk ka këshill mbikëqyrës, përkatësisht kontrollues, kuvendin e bashkëpronarëve e konvokojnë bashkëpronarët nga paragrafi 4 i këtij neni.

Seksioni 8

NDRYSHIMI I MARRËVESHJES PËR SHOQËRINË

Nënseksioni 1

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES PËR SHOQËRINË

Vendimi për ndryshimin e marrëveshjes për shoqërinë

Neni 252

(1) Marrëveshja për shoqërinë mund të ndryshohet vetëm me vendimin e bashkëpronarëve, të marrë së paku me shumicën e tre të katërtave nga numri i përgjithshëm i votave që i kanë bashkëpronarët në shoqëri. Në marrëveshjen për shoqërinë mund të përcaktohet shumicë më e madhe dhe mund të parashihen edhe kushte plotësuese për ndryshimin e saj.

(2) Vendimin për ndryshimin e lëndës së punës së shoqërisë, të përcaktuar në marrëveshjen për shoqërinë, bashkëpronarët e sjellin njëzërit, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërisë nuk është e përcaktuar ndryshe.

(3) Vendimi për rritjen e obligimeve të përcaktuara të bashkëpronarëve, që dalin nga marrëveshja për shoqërinë ose për zvogëlimin e të drejtave të bashkëpronarëve që u takojnë sipas marrëveshjes për shoqërinë, merret me pëlqimin e gjithë bashkëpronarëve të shoqërisë, të cilët janë të prekur nga rritja e obligimeve, përkatësisht zvogëlimi i të drejtave.

(4) Dispozitat nga marrëveshja për shoqërinë që janë në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, janë jovalide.

(5) Bashkëpronarët, me vendimin për ndryshim të marrëveshjes për shoqërinë, autorizojnë administruesin, përkatësisht këshillin mbikëqyrës, përkatësisht kontrolluesin, nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, të përpilojë tekst të pastruar të marrëveshjes për shoqërinë, në të cilin i inkorporon ndryshimet e bëra me vendimin për ndryshim të marrëveshjes për shoqërinë.

Ndikimi juridik i vendimit për ndryshimin e marrëveshjes për shoqërinë

Neni 253

(1) Fletëparaqitja për regjistrimin e vendimit për ndryshim të marrëveshjes për shoqërinë, për shkak të regjistrimit në regjistrin tregtar, e paraqet administruesi ose person i autorizuar nga ai me prokurë, të verifikuar te noteri përveç kur autorizimi është dhënë në formë elektronike dhe i nënshkruar me nënshkrim elektronik në pajtim me Sistemin për e-regjistrim.

(2) Fletëparaqitjes për regjistrim në regjistrin tregtar i bashkëngjitet vendimi për ndryshimin e marrëveshjes për shoqërinë dhe teksti i pastruar i marrëveshjes për shoqërinë.

(3) Regjistrimi i vendimit për ndryshim të marrëveshjes për shoqërinë në regjistrin tregtar shpallet me theksimin e numrit të vendimit dhe datës kur është marrë.

(4) Vendimi për ndryshim të marrëveshjes për shoqërinë ka ndikim juridik ndaj bashkëpronarëve nga dita e marrjes së tij.

Nënseksioni i dytë

ZMADHIMI I KRYEGJËSË BAZË

Mënyrat e rritjes së kryegjësë bazë

Neni 254

(1) Rritja e kryegjësë bazë bëhet me vendimin e kuvendit të bashkëpronarëve, që ka cilësinë e vendimit me të cilin bëhet ndryshimi i marrëveshjes për shoqërinë.

(2) Rritja e kryegjësë bazë mund të bëhet me ndërmarrjen e depozitave të reja ose me futjen e rezervave dhe të fitimit të shoqërisë në kryegjënë bazë.

(3) Kryegjësja bazë mund të rritet vetëm nëse të gjitha depozitat e mëparshme janë paguar tërësisht.

Kushtet për rritjen e kryegjësë bazë

Neni 255

(1) Me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë, përcaktohen; shuma e rritjes së kryegjësë themelore, mënyra në të cilën personat që do të ndërmarrin depozitë, do të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit dhe prej kur në vitin afarist në të cilin është rritur kryegjësja bazë, do ta realizojnë këtë të drejtë, shumën e pjesës së kryegjësë bazë që duhet të paguhet para paraqitjes së fletëregjistrimit në regjistrin tregtar, afati në të cilin duhet të paguhet depozitat dhe mënyra e pagimit, lloji i depozitave jomonetare, nëse rritja bëhet me futjen e depozitave jomonetare, obligimet plotësuese dhe kushtet tjera në të cilat bëhet rritja e kryegjësë bazë.

(2) Vetëm me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë, nga personat të cilët i regjistrojnë dhe i ndërmarrin depozitat deri në shumën e rritjes, mund të kërkohet pagimi i depozitit të ndërmarrë mbi shumën nominale, si edhe për depozitat e reja të përcaktohen të drejtat e posaçme. Nëse kërkohet pagimi mbi shumën nominale të depozitit të regjistruar, teprica patjetër duhet të paguhet para paraqitjes së fletëregjistrimit për rritjen e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar.

(3) Nëse rritja e kryegjësë bazë bëhet me futjen e depozitave jomonetare, kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të prerë me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë, me ç'rast patjetër duhet të përcaktohet afati në të cilin duhet të futen depozitat jomonetare. Depozitat jomonetare doemos duhet të futen në shoqërinë para se të paraqitet fletëregjistrimi për rritjen e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar.

(4) Dispozitat e këtij ligji për shumën e depozitit më të ulët, mënyra e pagimit, arritja e pagimit të depozitit, si edhe për pasojat juridike për vonimin e pagesës, zbatohen edhe mbi depozitet e reja.

(5) Nëse rritja e kryegjësë bazë bëhet me futjen e depozitave jomonetare, dispozitat nga neni 35 i këtij ligji për vlerësimin e depozitit jomonetar dhe për përgjegjësinë e bashkëpronarit, i cili e fut depozitin jomonetar, zbatohen edhe në depozitat e reja.

Ndërmarrja e depozitave të reja nga ana e bashkëpronarëve

Neni 256

(1) Depozitat e reja shoqëria ua ofron bashkëpronarëve ekzistues ose personave të tjerë, të cilët nuk janë bashkëpronarë.

(2) Bashkëpronarët ekzistues kanë të drejtë përparësie në ndërmarrjen e depozitave të reja, proporcionalisht me depozitat e ndërmarra deri atëherë në kryegjënë bazë të shoqërisë, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërinë, përkatësisht me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Administruesi, me letra të rekomanduara, u ofron bashkëpronarëve ndërmarrje të depozitave në shumë proporcionale me rritjen e kryegjësë bazë që u takon sipas paragrafit 2 të këtij neni. Nëse bashkëpronari, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dërgimit të letrës së rekomanduar, nuk e ndërmerr depozitin, administruesi, sipas procedurës së njëjtë do tua ofrojë bashkëpronarëve të tjerë. Nëse bashkëpronarët tjerë nuk e ndërmarrin depozitën për tetë ditë nga dita e dërgimit të letrës, administruesi me zgjedhjen e vet, por në interes të shoqërisë, do tua ofrojë personave të cilët nuk janë bashkëpronarë, nëse në marrëveshjen për shoqërinë ose në vendimin për rritjen e kryegjësë bazë nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Depozita mrret me deklaratë për marrjen e depozitës që jepet në formë të shkruar ose formë elektronike. Deklarata, krahas shumës së depozitës së marrë, përmban të dhëna për të gjitha obligimet tjera që dalin nga marrëveshja për shoqërinë, respektivisht nga vendimi për rritjen e kryegjësë themelore. Nëse personi që merr depozitë nuk është bashkëpronar, deklarata e përmban dhe pëlqimin e tij se bëhet bashkëpronar dhe se i merr të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me marrëveshjen për shoqërinë. Deklarata e dhënë me shkrim parashtrohet e verifikuar me nënshkrime të bashkëpronarëve me nënshkrim elektronik të agjentit regjistruar, ose në formë elektronike të regjistruar me nënshkrim elektronik të bashkëpronarëve të shoqërisë përmes Sistemit për regjistrim.

Regjistrimi i rritjes së kryegjësë bazë për ndërmarrje të depozitave të reja

Neni 257

(1) Pas pagimit të depozitave monetare, përkatësisht futjes së depozitave jomonetare me të cilat rritet kryegjëja bazë, në pajtim me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë, dërgohet fletëparaqitje për regjistrimin e rritjes së kryegjësë bazë në regjistrin tregtar.

(2) Fletëregjistrimit i bashkëngjiten:

- 1) vendimi për rritjen e kryegjësë bazë,
- 2) deklaratat për ndërmarrjen e depozitave, të verifikuar te noteri,
- 3) lista e personave që kanë ndërmarrë depozita të reja, të nënshkruara nga paraqitësi i fletëparaqitjes, në të cilën shënohen shumat e depozitave të ndërmarra dhe depozitat e paguara në çka janë paguar dhe dëshmi se janë paguar, të cilat i bashkëngjiten listës, ndërsa nëse depozitat i ndërmarrin bashkëpronarë ekzistues të shoqërisë shuma e përgjithshme e depozitave të tyre,
- 4) kontrata me të cilën është kryer futja e depozitave jomonetare, nëse kryegjëja bazë rritet me futjen e depozitave jomonetare; dhe
- 5) dëshmia për pronësi në të cilën është bërë shënimi në librin publik për evidentimin e sendeve të patundshme, ndërsa nëse depozitohet lëndë e tundshme, për të cilën me ligj është paraparë obligimi për evidencë (regjistër) dëshmi për pronësinë mbi sendin e tundshëm e nëse depozitohen letra me vlerë në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronësi të letrave të tilla me vlerë me shënim se të njëjtat depozitohen në shoqërinë tregtare dhe se pronari nuk mund të disponojë me të njëjtat. Për këtë qëllim, pronari i letrave me vlerë te Depozitari qendror për letra

me vlerë dorëzon deklaratë të verifikuar te noteri se letrat me vlerë janë depozituar në shoqërinë tregtare dhe se pajtohet që ndaj të njëjtave të bëhet kufizim i evidentuar për disponim deri në bartjen e të njëjtave në shoqërinë tregtare.

(3) Fletëparaqitjen për regjistrimin e rritjes së kryegjësë themelore në regjistrin tregtar, e paraqit administruesi, përkatësisht personi të cilin ai do ta autorizojë me prokurë, të verifikuar te noteri.

(4) Para se të shpallet regjistrimi i rritjes së kryegjësë bazë në regjistrin tregtar, shoqëria nuk guxon që në shpalljet dhe korrespondencat e saj afariste, ta përmendë rritjen e kryegjësë bazë.

(5) Në shpalljen e regjistrimit se është rritur kryegjëja bazë e shoqërisë, shënohet përmbajtja e regjistrimit, e nëse në shoqëri janë futur depozita jomonetare shënohen edhe kontratat me të cilat është kryer futja e depozitave jomonetare. Në shpalljen për regjistrimin mjafton vetëm të referohet në dokumentet që i janë bashkangjitur fletëregjistrimit.

Rritja e kryegjësë bazë nga rezervat

Neni 258

(1) Bashkëpronarët mund të marrin vendim për rritjen e kryegjësë bazë me shndërrimin e rezervave në kryegjë bazë, e cila ka cilësinë e vendimit për ndryshimin e marrëveshjes për shoqërinë. Rritja e depozitave kryhet proporcionalisht me depozitat e deriatëhershme të bashkëpronarëve.

(2) Bashkëpronarët mund ta marrin vendim për rritjen e kryegjësë bazë, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, vetëm pas miratimit të llogarisë vjetore dhe sipas së cilës shoqëria nuk ka humbje rrjedhëse dhe të pambuluara nga vitet paraprake dhe pas miratimit të raportit të revizuesit të autorizuar me të cilin vërtetohen faktet në llogarinë vjetore. Nëse nga dita e miratimit të llogarisë vjetore dhe raportit të revizorit të autorizuar, kalojnë më shumë se tetë muaj para paraqitjes së fletëregjistrimit të vendimit për rritjen e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar, doemos duhet të përpilohet raport i ri për bilancin e gjendjes dhe të kryhet revizion nga revizori i autorizuar.

(3) Për rritjen e kryegjësë bazë mund të shfrytëzohen fitimi dhe rezervat e shoqërisë, në pajtim me qëllimet për të cilat janë dedikuar. Kur bashkëpronarët do të vendosin që kryegjënë bazë ta rrisin nga fitimi, gjatë vendosjes për shpërndarjen, fitimin e shpërndajnë në rezerva, me shënim se do të shfrytëzohet për rritjen e kryegjësë bazë.

(4) Rritja e kryegjësë bazë të shoqërisë kryhet me rritjen e shumave nominale të pjesëve ekzistuese në shoqërinë. Gjatë kësaj, në mënyrë përkatëse, zbatohen dispozitat nga neni 174, paragrafi 4 i këtij ligji.

(5) Rritja e kryegjësë bazë doemos duhet të zbatohet ashtu që shuma e përgjithshme e depozitave të rritura t'i përgjigjet kryegjësë bazë të rritur të shoqërisë.

(6) Pjesët e rritura të bashkëpronarëve të shoqërisë doemos duhet të jenë në proporcion të njëjtë si edhe ato para rritjes së kryegjësë bazë të shoqërisë.

(7) Në rritjen e kryegjësë bazë në mënyrë të barabartë marrin pjesë edhe pjesët personale që i ka fituar shoqëria.

(8) Nëse me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë nuk është përcaktuar ndryshe, pjesët e rritura marrin pjesë në fitimin e shoqërisë që është realizuar gjatë tërë vitit afarist, në të cilin është marrë vendimi për rritjen e kryegjësë bazë.

(9) Dispozita nga vendimi për rritjen e kryegjësë bazë, që është në kundërshtim me dispozitat e këtij neni është e pavlefshme.

Regjistrimi i rritjes së kryegjësë bazë nga rezervat

Neni 259

(1) Fletëparaqitja për regjistrimin e rritjes së kryegjësë bazë në regjistrin tregtar nga mjetet e rezervave të shoqërisë, patjetër duhet të dorëzohet pa shtyrje.

(2) Fletëparaqitjes për regjistrim i bashkëngjiten:

1) vendimi për rritjen e kryegjësë bazë me shndërrimin e rezervave në kryegjë bazë;

2) llogaria e miratuar vjetore në bazë të së cilës është miratuar vendimi për rritjen e kryegjësë themelore, për të cilën revizori ka shprehur mendim revizori pa rezerva ose mendim me rezerva i cili nuk e vë në pyetje objektivitetin e llogarisë vjetore;

3) deklarata nga administruesi, e verifikuar te noteri, se nga dita për të cilën vlen llogaria vjetore, deri në ditën e dorëzimit të fletëparaqitjes, nuk kanë ndodhur ndryshime në pronën e shoqërisë, që do ta kishin penguar marrjen e vendimit për rritjen e kryegjësë bazë.

(3) Do të bëhet regjistrim i vendimit për rritje të kryegjësë bazë në regjistrin tregtar nëse llogaria e dorëzuar vjetore nuk është më e vjetër se tetë muaj nga dita e fundit për të cilën vlen, deri në ditën e dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrimin e rritjes së kryegjësë bazë në regjistrin tregtar.

(4) Gjatë regjistrimit nuk kontrollohet dhe nuk vërtetohet nëse llogaria e dorëzuar vjetore është e saktë dhe e përpiluar në pajtim me ligjin.

(5) Gjatë regjistrimit, shënohet se kryegjëja bazë është rritur nga mjetet e shoqërisë.

Inkuadrimi i bashkëpronarëve të rinj në shoqëri prej një personi

Neni 260

(1) Nëse shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nga një person, për shkak të rritjes së kryegjësë bazë, i bashkëngjitet person i cili do të deponojë depozitë të re dhe do të bëhet bashkëpronar i ri, bashkëpronarët janë të obliguar ta harmonizojnë organizimin dhe punimin e shoqërisë, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, që vlejnë për shoqëri me dy ose më tepër bashkëpronarë.

(2) Pas harmonizimit nga paragrafi 1 i këtij neni, administruesi është i obliguar të dorëzojë fletëparaqitje për regjistrimin e harmonizimit në regjistrin tregtar.

Nënseksioni i tretë

ZVOGËLIMI I KRYEGJËSË BAZË

Mënyra e zvogëlimit të kryegjësë bazë

Neni 261

(1) Kryegjësja bazë e shoqërisë mund të zvogëlohet vetëm me vendimin e bashkëpronarëve për zvogëlimin e kryegjësë bazë, i cili ka cilësi të vendimit për ndryshim të marrëveshjes për shoqërinë. Në vendim përcaktohet sasia dhe qëllimi i zvogëlimit të kryegjësë bazë si edhe mënyra në të cilën do të zbatohet ai zvogëlim.

(2) Si zvogëlim i kryegjësë bazë konsiderohet çdo zvogëlim i shumës së kryegjësë bazë, i përcaktuar në marrëveshjen për shoqërinë, pavarësisht nga ajo se zvogëlimi zbatohet me kthimin e borxheve të bashkëpronarëve, zvogëlimi i shumave nominale të depozitave ose lirimi i plotë, përkatësisht i pjesërishëm i bashkëpronarëve të shoqërisë ose, të paraardhësve të tyre juridikë, nga obligimi që tërësisht t'i paguajnë depozitat.

(3) Kryegjësja bazë e shoqërisë nuk guxon të zvogëlohet nën 5.000 euro në kundërvlerë në denarë. Nëse zvogëlimi i kryegjësë bazë zbatohet me kthimin e depozitave të paguara ose me lirimin e bashkëpronarëve nga obligimi për pagimin e tërësishëm të depozitave, shuma e depozitave të tjera që mbesin në shoqërinë, nuk guxon të zvogëlohet nën 2.500 euro në kundërvlerë në denarë, me atë që njëkohësisht merret vendim për rritjen e kryegjësë bazë, së paku 5.000 euro në kundërvlerë në denarë.

Regjistrimi dhe shpallja e qëllimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë

Neni 262

(1) Administruesi dorëzon fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të vendimit për qëllimin e zvogëlimit të kryegjësë bazë.

(2) Administruesi menjëherë pas regjistrimit të vendimit për qëllimin e zvogëlimit të kryegjësë bazë në regjistrin tregtar, publikon shpallje për qëllimin e zvogëlimit të kryegjësë bazë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë". Në shpallje shoqëria publikon se është dakord që kreditorëve, në bazë të kërkesës së tyre, t'ua paguajë kërkesat ose t'u japë sigurim. Nëse pas skadimit të nëntëdhjetë ditëve nga dita e publikimit të shpalljes, nuk paraqitet kërkesë për pagesën e kërkesës, llogaritet se të gjithë kreditorët janë dakord me qëllimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë.

(3) Kreditorëve të njohur u dërgohet lajmërim me shkrim.

Regjistrimi i zvogëlimit të kryegjësë bazë

Neni 263

(1) Fletëparaqitja për regjistrimin e vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë, dorëzohet për shkak të regjistrimit në regjistrin tregtar pas skadimit të afatit që u është dhënë kreditorëve për paraqitjen e kërkesave të tyre.

(2) Fletëparaqitjes i bashkëngjiten:

1) kopje nga shpallja me të cilën është njoftuar për qëllimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë, të publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

2) dëshmi se shoqëria u ka dhënë kreditorëve që janë paraqitur sigurim se kërkesat e paraqitura do të paguhen;

3) deklarata e administruesit se të gjithë kreditorëve të njohur u është dërguar njoftimi për qëllimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë dhe se shoqërisë nuk i janë lajmëruar kreditorë të tjerë, përveç atyre të cilëve shoqëria ua ka paguar kërkesat ose u ka dhënë sigurim se kërkesat e paraqitura do t'u paguhen; dhe

4) kopje nga libri i pjesëve.

(3) Nëse dëshmia që e dorëzuar për atë se shoqëria i ka paguar kërkesat e kreditorëve ose se u ka dhënë sigurim se kërkesat e paraqitura do t'u paguhen nuk është e vërtetë, administruesi u përgjigjet personalisht dhe pakufi me të gjithë pronën e tij për dëmin që do tua shkaktojë atyre kreditorëve të cilëve u ka dhënë të dhëna të pasakta, por vetëm për shumën që nuk ka mund t'u paguhet nga prona e shoqërisë.

(4) Nuk përgjigjet për dëmin administruesi i cili do të dëshmojë se nuk ka ditur se dëshmitë dhe deklaratat që i ka dhënë janë të pavërteta.

Pagimi i bashkëpronarëve dhe lirimi nga obligimet

Neni 264

(1) Pagesat e bashkëpronarëve në bazë të zvogëlimit të kryegjësë bazë, janë të lejuara pasi të bëhet regjistrimi i vendimit për ndryshimin e marrëveshjes për shoqërinë në regjistrin tregtar.

(2) Në ditën e regjistrimit të vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar, bëhet i plotfuqishëm lirimi nga obligimi për pagimin e depozitave të mbetura të papaguara për zvogëlimin e kryer të kryegjësë bazë.

Seksioni 9

PUSHIMI I SHOQËRISË

Bazat e pushimit

Neni 265

(1) Baza për pushim të shoqërisë janë:

1) skadimi i kohës të përcaktuar në marrëveshjen për shoqërinë;

2) vendimi i bashkëpronarëve;

3) bashkëngjitja e shoqërisë me shoqëri tjetër, bashkimi me shoqëri tjetër, përkatësisht me ndarje;

4) falimentimi i shoqërisë; dhe

5) vendimi i gjyqit.

(2) Shoqëria pushon edhe në raste tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

(3) Në marrëveshjen për shoqërinë mund të parashihen edhe baza të tjera për pushimin e shoqërisë.

(4) Në rastet e pushimit të shoqërisë në bazë të pikave 1, 2 dhe 5 nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet procedurë për likuidimin e shoqërisë.

Baza për pushimin e shoqërisë nga një person

Neni 266

(1) Shoqëria me një person, në të cilën pronar i pjesës është person fizik, pushon me vdekjen e atij personi nëse pas procedurës të zbatuar trashëgimore, trashëgimtarët nuk kërkojnë që shoqëria të vazhdojë me punë.

(2) Për pjesën e bashkëpronarit të vdekur, deri në mbarimin e procedurës trashëgimore, të drejtën e votës e realizon përfaqësuesi i përbashkët, i caktuar nga trashëgimtarët e bashkëpronarit të vdekur me prokurë me shkrim, të verifikuar te noteri.

(3) Nëse pronari i një pjese në shoqëri nga një person është person juridikë, shoqëria pushon me pushimin e personit juridik, përveç nëse në procedurën për falimentim pjesën e ndërmerr person tjetër.

Vendimi i bashkëpronarëve për pushimin e shoqërisë

Neni 267

(1) Vendimin për pushim të shoqërisë, bashkëpronarët e marrin me së paku shumicën e tri të katërtave nga numri i përgjithshëm i votave.

(2) Dispozita në marrëveshjen për shoqërinë, e kundërt me paragrafin 1 të këtij neni, është e pavlefshme.

Pushimi i shoqërisë në bazë të vendimit të gjykatës

Neni 268

(1) Gjykata, sipas ankesës së një ose më shumë bashkëpronarëve, depozitat e të cilëve kushtojnë së paku një të dhjetat e kryegjësë bazë, me vendim mund të shqiptojë pushimin e shoqërisë nëse arritja e qëllimit të shoqërisë që del nga lënda e punës, bëhet e pamundshme ose nëse ekzistojnë shkaqe tjera më të rëndësishme për pushimin e shoqërisë.

(2) Ankesë paraqitet kundër shoqërisë në afat prej nëntëdhjetë ditësh nga dita e kuptimit të shkakut, por jo më se një vit nga dita e ndodhjes së shkakut.

Regjistrim i pushimit të shoqërisë në regjistrin tregtar

Neni 269

(1) Fletëparaqitjen për regjistrimin e pushimit të shoqërisë në regjistrin tregtar për shkak të skadimit të kohës për të cilën është themeluar shoqëria ose për shkak të vendimit të bashkëpronarëve për pushimin e shoqërisë, administruesi doemos duhet ta paraqesë pa shtyrje.

(2) Nëse administruesi nuk vepron sipas paragrafit 1 të këtij neni, ai është personalisht dhe pakufi përgjegjës për dëmin që do ta shkaktojë.

(3) Pas zbatimit të likuidimit, përkatësisht të procedurës për falimentim, bëhet regjistrimi i shlyerjes së shoqërisë në regjistrin tregtar. Kërkesën për regjistrim e paraqet likuiduesi, përkatësisht gjykatësi falimentues. Vendimi për shlyerjen e regjistrimit të shoqërisë, shpallet në llogari të shoqërisë. Shpenzimet e regjistrimit të shlyerjes dhe shpallja janë në llogari të shoqërisë.

KAPITULLI I KATËRT

SHOQËRIA AKSIONARE

SEKSIONI 1

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Nocioni

Neni 270

(1) Shoqëri aksionare është shoqëria tregtare në të cilën aksionarët marrin pjesë me depozitime në kryegjënë bazë, e cila është e ndarë në aksione.

(2) Aksionarët nuk përgjigjen për obligimet e shoqërisë aksionare.

(3) Nga dispozitat e këtij ligji, me të cilat rregullohet shoqëria aksionare mund të shmanget në mënyrë dhe kushte të rregulluara me këtë ligj dhe me ligje të tjera.

Firma

Neni 271

Firma e shoqërisë aksionare (në tekstin e mëtejme në kapitullin e katërt, pjesa e pestë: shoqëria) domosdo t'i përmbajë edhe fjalët "shoqëri aksionare" ose shenjën "SHA".

Numri i aksionarëve

Neni 272

Shoqëria mund të ketë një ose më shumë aksionarë.

Shuma më e vogël nominale e kryegjësë bazë dhe e aksionit

Neni 273

(1) Shuma më e vogël nominale e kryegjësë bazë, kur shoqëria themelohet në mënyrë simultane, pa thirrje publike për regjistrim të aksioneve bën 25.000 euro në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, të shpallur në ditën para miratimit të statutit, gjegjësisht në ditën para marrjes së vendimit për ndryshim të kryegjësë bazë, ndërsa kur shoqëria themelohet në mënyrë suksesive, përmes thirrjes publike për regjistrim të aksioneve, ajo bën së paku 50.000 euro në kundërvlerë në denarë përveç nëse me ligj tjetër nuk caktohet shumë tjetër më e vogël e kryegjësë themelore.

(2) Shuma nominale e aksionit, nuk mund të jetë më e vogël se 1 euro, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, një ditë para miratimit të statutit, respektivisht në ditën para marrjes së vendimit për ndryshim të kryegjësë bazë.

SEKSIONI 2

AKSIONE

Lëshimi, bartja dhe evidentimi i aksioneve

Neni 274

(1) Aksionet lëshohen, barten dhe mbahen në formë të shënimit elektronik, në Depozituesin Qendror për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Depozituesi Qendror për letra me vlerë), në pajtim me ligj.

(2) Aksionet janë të bartshme pa kufizim me lirisht tregtohen në tregun sekondar të letrave me vlerë.

(3) Aksionet, ndaj shoqërisë, janë të pandashme.

Shuma nominale dhe emetuese e aksioneve

Neni 275

(1) Çdo aksion, patjetër të ketë shumë nominale në emër të së cilës është aksioni.

(2) Aksionet e lëshuara nën shumën e tyre nominale, janë të pavlefshme. Për dëmin që do të pasojë nga lëshimi i aksioneve nën shumën e tyre nominale, lëshuesit përgjigjen në mënyrë solidare.

(3) Aksionet mund të lëshohen nën shumën nominale (shumë emetuese).

Ndarja dhe bashkimi i aksioneve

Neni 276

(1) Shoqëria, mundet me ndryshim të statutit, të kryen ndarje të aksioneve dhe, njëkohësisht ta zvogëlojë shumën e tyre nominale, nën kusht kryegjëja bazë të mbesë e pandryshuar.

(2) Shoqëria, mundet me ndryshim të statutit, të kryen bashkim të aksioneve dhe, njëkohësisht ta zmadhojë shumën e tyre nominale, nën kusht kryegjëja bazë të mbesë e pandryshuar.

Gjini dhe klasa të aksioneve

Neni 277

(1) Shoqëria lëshon aksione të rëndomta, por mund të lëshojë edhe aksione të tjera me të drejta të ndryshme.

(2) Aksionet që japin të drejta të njëjta, përbëjnë gjini të njëjtë të aksioneve. Sipas të drejtave, aksionet mund të jenë të rëndomta dhe prioritare.

(3) Aksionet prioritare, mund të jenë të më tepër klasave dhe, nuk mund të lëshohen me shumë më të vogël nominale nga shuma nominale e aksioneve të rëndomta. Aksionet prioritare nga klasa e njëjtë, japin të drejta të njëjta.

(4) Për lëshimin e aksioneve, për të cilat janë të lidhura të drejta të posaçme (aksione prioritare) shoqëria, mund të kërkojë edhe pagesa të posaçme plotësuese të njëhershme edhe atë, gjatë lëshimit të aksioneve.

Të drejta të përmbajtura në aksionet

Neni 278

(1) Aksionet e rëndomta, janë aksione të cilat u japin pronarëve të vetë:

- 1) të drejtë vote në kuvendin e shoqërisë;
- 2) të drejtë pagimi të një pjese nga fitimi (dividendë); dhe
- 3) të drejtë pagimi të një pjese nga mbetja e masës likuiduese, gjegjësisht falimentuese të shoqërisë.

(2) Aksionet prioritare, kur kanë të drejtë vote, përveç të drejtave nga paragrafi 1 i këtij neni, japin edhe të drejta të tjera të privilegjuara si që janë, e drejta në dividendë në shumë në para paraprakisht të përcaktuar ose, në përqindje të shumës nominale të aksionit, të drejtë përparësie gjatë pagimit të dividendës, e drejtë pagimi të mbetjes nga masa likuiduese, respektivisht falimentuese dhe, të drejta të tjera të përcaktuara në statut dhe në vendimin për lëshimin e aksioneve, në pajtim me ligj. Aksionet prioritare të cilat nuk japin të drejtë vote, e fitojnë këtë të drejtë kur me këtë ligj, gjegjësisht statutin kjo është përcaktuar.

(3) Të drejtat nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të realizohen veçmas ose bashkërisht.

Klasa të aksioneve prioritare

Neni 279

(1) Aksionet prioritare mund të jenë kumulative dhe participative.

(2) Aksioni prioritar kumulativ, i jep pronarit të drejtë arkëtimi të dividendave të akumuluar të papaguara, para arkëtimit të çfarëdo dividendave të pronarit të aksioneve të rëndomta.

(3) Aksioni participativ prioritar, i jep pronarit, përveç dividendës së konfirmuar (fikse), i jep edhe të drejtë të pagimit të dividendës e cila u takon pronarëve të aksioneve të rëndomta.

E drejtë vote

Neni 280

(1) Çdo aksion i cili jep të drejtë votë, jep të drejtë për një votë në kuvendin e shoqërisë (në tekstin e mëtejshëm: kuvendi).

(2) Çdo aksion i rëndomtë, jep të drejtë vote në kuvend.

(3) Aksionet prioritare, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund të jenë të lëshuara si aksione me të drejtë vote dhe, si aksione pa të drejtë vote. Shuma e përgjithshme nominale e aksioneve prioritare pa të drejtë vote, nuk mund të jetë më e lartë se 30% nga kryegjëja bazë e shoqërisë. Shuma e përgjithshme nominale e aksioneve prioritare, me dhe pa të drejtë vote, nuk mund të jetë më e lartë se shumën e përgjithshme nominale e aksioneve të rëndomta në kryegjëne bazë të shoqërisë.

(4) Është i ndaluar lëshimi i aksioneve i gjinisë së njëjtë, të cilat për shumë të njëjtë nominale, japin të drejtë vote të ndryshme në kuvend.

Aksione pa para ose aksione me çmim të privilegjuar

Neni 281

I fshirë 13

Vendimi për lëshimin e aksioneve

Neni 282

Vendim për lëshimin e aksioneve merr kuvendi i shoqërisë, me shumicë votash që nuk mund të jetë më pak se dy të tretat e aksioneve me të drejtë vote, të përfaqësuara në kuvend, përveç nëse me statutin nuk është përcaktuar shumicë më e madhe.

Libri i aksioneve (libri aksionar)

Neni 283

(1) Aksionet shënohen në librin e aksioneve të shoqërisë (në tekstin e mëtejme: libri aksionar) i cili mbahet në Depozituesin Qendror për letra me vlerë në formë elektronike, me shënimin e emrit dhe mbiemrit të aksionarit, NVAQ, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i letërnjoftimit, nëse aksionari është person i huaj fizik ose, të ndonjë dokumenti tjetër për vërtetimin e identitetit valide në vendin e tij dhe shtetësinë e tij, si dhe vendi i banimit, gjegjësisht firma, selia, NUAS, nëse bashkëpronari është person juridik dhe, informata të tjera.

(2) Në librin aksionar shënohen edhe të dhënat që janë përcaktuar në vendimin për lëshimin e aksioneve, të gjitha ngarkesat e aksioneve, të përcaktuara me ligj dhe me statut dhe, ndalesat e shqiptuara me vendim të gjyqit.

(3) Ndaj shoqërisë, aksionar konsiderohet çdo person i shënuar në librin aksionar, në mënyrë të përcaktuar me ligj.

(4) Regjistrimi inicial dhe regjistrimi i aksioneve të lëshuara gjatë rritjes së kryegjësë bazë, në librin aksionar bëhet me urdhëresë të shoqërisë. Ndryshimet në librin aksionar bëhen sipas bartjes së kryer të aksioneve, me tregti në bursë ose sipas bartjes së kryer në mënyrë tjetër të lejuar me ligj.

(5) Në kërkesë të shoqërisë, Depozituesi Qendror për letra me vlerë, e njofton shoqërinë për ndryshimet e kryera në librin aksionar.

(6) Çdo aksionar, ka të drejtë, në kërkesë të tij, t'i mundësohet shqyrtim i të gjitha të dhënave të shënuara në librin aksionar të shoqërisë, në të cilën është aksionar. Shqyrtimin e mundëson Depozituesi Qendror për letra me vlerë. Aksionarit i cili kërkon shqyrtim urgjent në librin aksionar, domosdo t'i mundësohet shqyrtim në afat jo më të gjatë se një ditë pune, nga dita e shqyrtimit të kërkuar të paraqitur në formë të shkruar. Në rastet tjera, aksionari i cili kërkon shqyrtim në librin aksionar, e paralajmëron ditën në të cilën ka ndërmend të bën shqyrtim. Të dhënat nga shqyrtimi, mund të shfrytëzohen vetëm për realizimin e të drejtave të aksionarit.

(7) Secili aksionar ka të drejtë që të marrë fotokopjen e të dhënave të regjistruara në librin e aksionarëve të shoqërisë në të cilën është aksionar, sipas kërkesës së dorëzuar paraprakisht në Depozitarin qendror të letrave me vlerë. Fotokopja e bërë dhe të dhënat e fotokopjes mund të përdoren vetëm për realizimin e të drejtave të aksionarit.

Lëshimi i letrave të tjera me vlerë dhe derivate financiare

Neni 284

(1) Shoqëria në pajtim me ligjin dhe statutin mundet në shumën e kryegjësë themelore, të emetojë obligacione të cilat nuk janë obligacione konvertibile, obligacione të cilat kreditorëve u japin të drejtë që t'i zëvendësojnë me aksione në periudhë të caktuar në opsion të caktuar ose në çdo kohë derisa zgjat obligacioni dhe obligacionet të cilat nuk sigurojnë të drejtë të përparësisë për blerje të aksioneve të cilat shoqëria i emeton. Obligacionet mund të emetohen në shumë më të madhe se kryegjësja themelore vetëm nëse emetimi i obligacioneve është tërësisht i siguruar me pengun e pronës së shoqërisë ose në mënyrë tjetër. ¹⁴

(2) Shoqëria, në pajtim me ligjin dhe me statutin, mundet në gjysmën e shumës së kryegjësë themelore të lëshojë obligacione konvertibile, të cilat kreditorëve u japin të drejtë që t'i zëvendësojnë me aksione në periudhë të caktuar në opsion të caktuar ose në çdo kohë derisa zgjat obligacioni dhe të lëshojë obligacione të cilat nuk sigurojnë të drejtë të përparësisë për blerje të aksioneve të cilat shoqëria i lëshon.

(3) Aksionarët kanë të drejtë përparësie gjatë fitimit të fletëobligacioneve nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Fletëobligacionet blihen me para të gatshme.

(5) Dispozitat e këtij ligji, të cilat vlejnë për të drejtën e përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja të lëshuara, përkatësisht zbatohen edhe gjatë realizimit të të drejtës të përparësisë për regjistrimin e fletëobligacioneve konvertibile të lëshuara të reja.

(6) Shoqëria mundet, në pajtim me ligjin, të lidhë kontrata opcionale për blerje dhe për shitje të aksioneve dhe fletëobligacioneve dhe kontrata fjuçers, në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara në statut.

(7) Mënyra dhe kushtet nën të cilat shoqëria i lëshon letrat me vlerë, i lidh kontratat opcionale për blerje dhe shitje të aksioneve dhe fletëobligacionet, si edhe të kontratave fjuçers, përcaktohen me statutin.

SEKSIONI 3

THEMELIMI DHE REGJISTRIMI I SHOQËRISË

Nënseksioni 1

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Themelues

Neni 285

(1) Shoqëria mundet, të jetë e themeluar nga një dhe më shumë persona.

(2) Themelues të shoqërisë janë personat të cilët e kanë nënshkruajtur statutin.

(3) Statuti mund të jetë në formë të shkruar me nënshkrime të verifikuara të bashkëpronarëve me nënshkrim elektronik të agjentit regjistruar, ose në formë elektronike të nënshkruar me nënshkrim elektronik të bashkëpronarëve të shoqërisë përmes Sistemit për e-regjistrim.

Mënyrat e themelimit

Neni 286

(1) Themeluesit e themelojnë shoqërinë në mënyrë simultane ose suksesive.

(2) Shoqëria konsiderohet e themeluar, kur do të jetë e regjistruar në regjistrin tregtar.

Përmbajtja e statutit

Neni 287

(1) Statuti përmban dispozita për:

- 1) firmën dhe selinë e shoqërisë;
- 2) lënda e punës së shoqërisë;
- 3) shuma e kryegjësë bazë;
- 4) vlera nominale e aksioneve, numri i aksioneve nga çdo gjini dhe klasë, të drejtat, obligimet, kufizimet dhe volitshmëritë;
- 5) kohëzgjatja e shoqërisë, nëse shoqëria themelohet për kohë të caktuar;
- 6) përparësitë të cilat i mbajnë për vete themeluesit;
- 7) procedura për konvokimin dhe mbajtjen e kuvendit;
- 8) emri dhe mbiemri, NUAQ, numri i dokumentit të udhëtimit, gjegjësisht numri i letërnjoftimit nëse themeluesi është person i huaj fizik ose, të dokumentit tjetër për verifikimin e identitetit, valide në vendin e tij dhe, shtetësia e tij, si edhe vendi i banimit, respektivisht firma, selia, NUAS, nëse themelues është person juridik;
- 9) lloji, përbërja dhe mënyra e zgjedhjes të organit administrues, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës dhe, kompetenca e tyre;
- 10) emri dhe mbiemri i anëtarëve të parë të organit administrues, respektivisht i këshillit mbikëqyrës, NUAQ i tyre, numri i dokumentit të udhëtimit, gjegjësisht numri i letërnjoftimit për person të huaj fizik ose, të dokumentit tjetër për verifikimin e identitetit, valide në vendin e tij dhe, shtetësia e tyre, si edhe vendi i banimit, respektivisht firma, selia, NUAS, nëse anëtarët e parë e organit administrues, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës emërohen me statutin; dhe
- 11) forma dhe mënyra e shpalljes, që i kryen shoqëria.

(2) Përveç dispozitave nga paragrafi 1 i këtij neni, statuti përmban edhe dispozita për çështjet të cilat, në pajtim me këtë ligj, rregullohen me statutin.

(3) Përveç dispozitave nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, statuti mund të përmban edhe dispozita të tjera të rëndësishme për shoqërinë, nëse nuk janë të ndaluara me ligj.

(4) Çështje të tjera, që janë me rëndësi për shoqërinë, por nuk janë rregulluar me statutin, mund të rregullohen në pajtim me këtë ligj, me akte tjera të shoqërisë.

Raporti ndërmjet ligjit, statutit dhe akteve tjera

Neni 288

(1) Çdo dispozitë nga statuti ose nga akt tjetër i shoqërisë, që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, është e pavlefshme.

(2) Nëse ndonjë dispozitë nga akt tjetër i shoqërisë, nuk është në pajtim me statutin, zbatohen dispozitat e statutit.

Volitshmëri të posaçme të themeluesve dhe shpenzimet për themelimin

Neni 289

(1) Çdo volitshmëri e posaçme e themeluesve dhe e personave të tretë, përcaktohet me statutin.

(2) Shuma e shpenzimeve që në llogari të shoqërisë, u kthehet themeluesve ose, personave të tretë si kompensim ose, u jepet si shpërblim për themelim ose, për pjesëmarrje në përgatitjet për themelimin e shoqërisë, përcaktohet me statutin.

(3) Nëse volitshmëritë e posaçme, shpenzimet ose kompensimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, nuk janë përcaktuar në statut, ndaj shoqërisë nuk kanë ndikim juridik kontratat dhe veprimet juridike me të cilat jepen volitshmëri të tilla ose, me të cilat paguhen shpenzimet dhe kompensimet.

(4) Pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, nuk mundet me ndryshim të statutit, të mënjanohet jovaliditeti i kontratave, gjegjësisht i veprimeve juridike nga paragrafi 3 i këtij neni.

Pagesa e aksioneve

Neni 290

(1) Aksionet e lëshuara mund të paguhen me para, me deponimin e depozitit monetar ose kombinuar.

(2) Aksionet paguhen në para në llogari të përkohshme te banka e themeluesve.

(3) Nëse depozitët paguhen në para, para dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrim të shoqërisë në regjistrin tregtar, domosdo të paguhet së paku 25% nga vlera nominale e çdo aksioni, ndërsa nëse, aksioni lëshohet për shumë më të lartë se shuma nominale e aksionit, domosdo të paguhet edhe shuma e tërë e që e tejkalon shumën e saj nominale. Pagimi i të mbeturave kryhet në një ose më shumë kështe, në bazë të vendimit për lëshim të aksioneve, në afat jo më të gjatë se tre vjet nga dita e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar afat më i shkurtër. Para dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrim, shuma e përgjithshme e të gjitha pagesave në para, nuk mund të jetë më e vogël, se 12.500 euro, respektivisht prej 25.000 euro në kundërvlerë në denarë përveç nëse me tjetër ligj nuk caktohet shumë tjetër e përgjithshme më e vogël e të gjitha pagesave në para parashtrimit të fletëparaqitjes për regjistrim.

(4) Nëse aksioni paguhet pjesërisht në para, e pjesërisht me deponimin e depozitit jomonetar, para dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrim të shoqërisë në regjistrin tregtar, domosdo, në tërësi, të paguhet ajo pjesë që paguhet në para.

Depoziti jomonetar dhe deponimi i tij

Neni 291

(1) Para dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrim për themelim të shoqërisë, depoziti jomonetar deponohet në tërësi. Nëse vlera e depozitit jomonetar të deponuar, në kohën e dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrim për themelimin e shoqërisë, nuk e arrin shumën e depozitit të ndërmarrur, aksionari domosdo ta paguajë dallimin në para, para regjistrimit të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar.

(2) Deponimi i tërësishëm i depozitave jomonetare, patjetër të kryhet ashtu që shoqëria, do të mundet lirisht të disponojë me to, prej ditës së regjistrimit të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar.

(3) Ndërmarrja e depozitit jomonetar, për shkak të këmbimit me aksione, kryhet sipas kontratës për ndërmarrje të aksioneve.

(4) Nëse, deponimi i depozitit jomonetar të themeluesit, përbëhet në ndërmarrje të obligimit t'i bartë shoqërisë gjë (lëndë), bartja domosdo të kryhet më së voni në afat prej pesë vjet nga dita e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar. Në depozitin jomonetar, i cili deponohet në shoqëri, nuk mund të realizohet e drejtë e ndaljes për kërkesë e cila nuk vlen për depozitin jomonetar. Vlera e caktuar e depozitit jomonetar që deponohet, patjetër t'i përgjigjet shumës nominale të aksioneve, e nëse aksionet lëshohen për shumë më të lartë se shuma e tyre nominale, vlera e caktuar e depozitit jomonetar, domosdo t'i përgjigjet asaj shume më të lartë.

(5) Nëse personi nga paragrafi 4 i këtij neni, nuk e përmbush obligimin nga paragrafi 4 i këtij neni, është i obliguar ta paguajë vlerën e gjësë (lëndës) për të cilën është ndërmarrur obligimi të bartet në shoqërinë si depozit jomonetar.

(6) Nëse në statut, gjegjësisht në vendimin për lëshimin e aksioneve, është përcaktuar, aksionet që i ndërmarrin aksionarët, pjesërisht ose tërësisht, të mos i paguajnë me depozit monetar por me deponimin e depozitave ekzistuese ose të ardhshme jomonetare, në statut patjetër të përcaktohen depozitët jomonetare që deponohen, personat të cilët në shoqëri deponojnë depozitë jomonetare dhe shuma nominale e aksioneve të cilat do t'ju jepen për depozitet e deponuara ose, kompensimi që duhet të jepet për depozitët jomonetare, që konsiderohet pjesë e depozitit të deponuar jomonetar.

(7) Pa ndikim ndaj shoqërisë janë kontratat për deponimin e depozitit jomonetar dhe veprimet juridike me të cilat ajo realizohet, nëse nuk janë përcaktuar në mënyrën nga paragrafi 3 i këtij neni. Nëse shoqëria është regjistruar në regjistrin tregtar, kontratat dhe veprimet të cilat nuk kanë ndikim juridik ndaj shoqërisë, nuk ndikojnë në plotfuqishmërinë e statutit. Nëse kontrata për deponimin e depozitit jomonetar, është pa ndikim juridik ndaj shoqërisë, aksionari është i obliguar, ta paguajë në para shumën e tërësishme nominale të aksioneve ose, shumën më të lartë për të cilën ato janë lëshuar.

(8) Pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, nuk mundet me ndryshim të statutit, të mënjanohet pavlefshmëria e kontratës, gjegjësisht veprimet juridike nga paragrafi 7 i këtij neni.

(9) Vlera e depozitit jomonetar, që deponohet në këmbim për aksione, përcaktohet me raport për vlerësim, i përpiluar nga vlerësues i autorizuar,

në pajtim me nenin 35 të këtij ligji.

Ndalesa gjatë pagimit të aksioneve

Neni 292

(1) Pagesa e aksioneve të lëshuara dhe letrave tjera me vlerë, në formë të punës ose shërbimeve, duke përfshirë edhe punë dhe shërbime të cilat janë kryer, është në kundërshtim me këtë ligj.

(2) Shoqëria nuk mund t'i huazojë para ose, në mënyrë tjetër ta kreditojë regjistruesin e aksioneve gjatë pagesës së tyre.

Nënseksioni 2

THEMELIMI SIMULTAN

Nocioni

Neni 293

(1) Shoqëria mund të themelohet ashtu që, themeluesit vetë ose së bashku me persona të tjerë, i ndërmarrin pa thirrje publike, të gjitha aksionet dhe e nënshkruajnë statutin.

(2) Themeluesit i ndërmarrin aksionet me deklaratë, të dhënë në formë të shkruar, se e themelojnë shoqërinë dhe se e ndërmarrin obligimin e pagesës së aksioneve. Deklarata mund t'i bashkëngjitet statutit ose të jetë e përmbajtur në statutin, që është i nënshkruajtur nga themeluesit. Në deklaratë shënohet personi i cili i ndërmerr aksionet, numri dhe gjinia e aksioneve që i ndërmerr dhe shuma e tyre nominale, dhe shënohet mënyra, koha dhe vendi i pagimit të aksioneve.

Emërimi i anëtarëve të parë të këshillit të drejtorëve, respektivisht të këshillit mbikëqyrës

Neni 294

(1) Themeluesit, me statutin i emërojnë anëtarët e këshillit të parë të drejtorëve, gjegjësisht anëtarët e këshillit të parë mbikëqyrës.

(2) Anëtarët e parë të këshillit të drejtorëve, respektivisht të këshillit mbikëqyrës emërohen më gjatë deri në mbajtjen e kuvendit të parë vjetorë.

Raporti për rrjedhën e themelimit (raport themelues)

Neni 295

(1) Themeluesit përpilojnë raport në formë të shkruar, për rrjedhën e themelimit të shoqërisë (në tekstin e mëtejme: raporti themelues).

(2) Në raportin themelues, tregohen rrethanat esenciale, me rëndësi për themelimin e shoqërisë. Gjatë çka, posaçërisht tregohen:

- 1) shuma e depozitave të paguara jomonetare;
- 2) çështjet juridike në bazë të të cilave shoqëria ka fituar depozitë jomonetare;
- 3) shpenzimet e furnizimit ose prodhimit, në tre vitet e fundit, për

depozitet jomonetare që deponohen;

4) nëse në shoqëri është deponuar ndërmarrje, fitimi i saj që e ka treguar në tre vitet e fundit, gjegjësisht për kohë më shkurtë se tre vjet, e shprehur në llogarinë vjetore në vitin paraprak afarist, mbi të cilën është kryer revizion nga revizori i autorizuar;

5) numri i aksioneve që gjatë themelimit kanë qenë të ndërmarrja në llogari të anëtarit të këshillit administrues, respektivisht këshillit mbikëqyrës; dhe

6) a po dhe në cilën mënyrë, anëtarë i këshillit administrues, respektivisht i këshillit mbikëqyrës, ka përfituar volitshmëri të posaçme, gjegjësisht dëmshpërblim ose kompensim për pjesëmarrje në themelimin e shoqërisë.

Kontest për raport themelues dhe raport për revizionin e themelimit

Neni 296

(1) Nëse gjatë themelimit të shoqërisë ose, në lidhje me raportin themelues ndodh mosmarrëveshje, çdo themelues, regjistruar dhe ndërmarrës i aksioneve, ka të drejtë të kërkojë të bëhet revizion i themelimit, e posaçërisht të të dhënave të raportit themelues.

(2) Revizionin nga paragrafi 1 i këtij neni, e kryen revizori i autorizuar. Organi i udhëheqjes së shoqërisë obligohet që t'ia japë revizorit të gjitha sqarimet dhe dokumentet të cilat janë të nevojshme për realizimin e revizionit.

(3) Revizori i autorizuar, i kontrollon të dhënat e dhëna nga themeluesit, në lidhje me aksionet e ndërmarrja me deponimin e depozitave jomonetare, shuma e përgjithshme nominale e aksioneve të ndërmarrura a i përgjigjet vlerës së caktuara të depozitave jomonetare të deponuara dhe nëse mundet shoqëria me to të disponojë lirisht.

(4) Revizori i autorizuar, për revizionin e kryer paraqet raport për revizionin e themelimit në të cilin i njofton konstatimet dhe përfundimet e tij. Revizori paraqet përgjigjësi materiale dhe penale për konstatimet, për tërësinë dhe për pajtueshmërinë e të dhënave të cilat janë lëndë e revizionit, me ligjin, me rregullat tjera dhe me standardet ndërkombëtare revizore si edhe, për kontrollimin e vlerës së çmuar të depozitave jomonetare të deponuara, gjegjësisht për atë se vlera e çmuar e tyre nuk është thelbësisht më e vogël se shumatat nominale të aksioneve të cilat jipen për to dhe, se me depozitet jomonetare të deponuara, shoqëria mundet lirisht të disponojë.

(5) Shpenzimet për revizionin bien në barrë të kërkuarës të revizionit.

Fletëparaqitje për regjistrim

Neni 297

(1) Themelimi i shoqërisë regjistrohet në regjistrin tregtar.

(2) Fletëparaqitjen për regjistrim e dorëzon te Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, organi administrues, respektivisht anëtar i autorizuar i organit administrues, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Për lëshimet dhe për pasojat e dëmshme nga mosparaqitja e fletëparaqitjes në kohë, personat nga paragrafi 2 i këtij neni, u përgjigjen

themeluesve personalisht, pakufi dhe në mënyrë solidare, me tërë pronën e tyre.

Të dhëna për regjistrim

Neni 298

(1) Në regjistrin tregtar shënohen:

- 1) firma dhe selia e shoqërisë;
- 2) lënda e punës së shoqërisë;
- 3) shumta e kryegjësë bazë dhe numri i aksioneve të lëshuara;
- 4) numri i përgjithshëm i aksioneve të paguara;
- 5) emri dhe mbiemri, NUAQ, numri i dokumentit të udhëtimit, gjegjësisht numri i letërnjoftimit nëse themeluesi është person i huaj fizik ose, të dokumentit tjetër për verifikimin e identitetit, valide në vendin e tij dhe, shtetësia e tij, si edhe vendi i banimit, respektivisht firma, selia, NUAS, nëse themelues është person juridik;
- 6) emri dhe mbiemri i të gjithë anëtarëve të organit administrues, respektivisht i këshillit mbikëqyrës, dhe NUAQ i tyre, numri i dokumentit të udhëtimit, gjegjësisht numri i letërnjoftimit për person të huaj fizik ose, të dokumentit tjetër për verifikimin e identitetit, valide në vendin e tij dhe, shtetësia e tyre, si edhe vendi i banimit, respektivisht firma, selia, NUAS, nëse anëtar i këtyre organeve është person juridik;
- 7) kohëzgjatja e shoqërisë, nëse shoqëria është themeluar për kohë të caktuar; dhe
- 8) autorizimet për përfaqësim të anëtarëve të organit administrues dhe të personave të tjerë, të autorizuar për përfaqësimin e shoqërisë.

(2) Çdo ndryshim i të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç të dhënave nga paragrafi 1, pika 5 e këtij neni, shënohen në regjistrin tregtar.

(3) Fletëparaqitjes për regjistrim i bashkëngjiten:

- 1) statuti;
- 2) kopje e dokumentit të udhëtimit ose e letërnjoftimit për person të huaj fizik ose, të dokumentit tjetër për verifikim të identitetit. valid në vendin e tij dhe shtetësia e tij, gjegjësisht dëshmi për regjistrimin, nëse themelues është person juridik;
- 3) dëshmi për shumën e paguar nga banka në të cilën është bërë pagesa e aksioneve,
- 4) nëse ndërmerren aksione me deponimin e depozitit jomonetar kontratat me të cilat verifikohen dhe zbatohen ato, raporti i vlerësuesit dhe dëshmi për pronësi në të cilin është bërë evidentimi në librin publik për evidentimin e sendeve të patundshme, ndërsa nëse deponohet send i tundshëm, për të cilin me ligj është përcaktuar obligim për evidentim (regjistër) dëshmi për pronësi mbi sendin e tundshëm e nëse depozitohen letra me vlerë në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronësi të letrave të tilla me vlerë me shënim se të njëjtat depozitohen në shoqërinë tregtare dhe se pronari nuk mund të disponojë me të njëjtat. Për këtë qëllim, pronari i letrave me vlerë te Depozitari qendror për letra me vlerë dorëzon deklaratë të verifikuara të noterit se letrat me vlerë janë depozituar në shoqërinë tregtare dhe se pajtohet që ndaj të njëjtave të bëhet kufizim i evidentuar për disponim deri në bartjen e të njëjtave në shoqërinë tregtare.
- 5) vendimet për zgjedhje të anëtarëve të organit administrues, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës, nëse ato nuk janë emëruar me statutin;
- 6) nëse në themelimin janë dhënë volitshmëri të posaçme, kontratat me të cilat ato verifikohen dhe zbatohen;
- 7) paralogaria e shpenzimeve të themelimit të shoqërisë, në të cilën

shprehen zërat veçmas dhe shpenzimet e përgjithshme;

8) raporti themelues dhe raporti për revizionin e themelimit, nëse raport i tillë ka qenë i përgatitur; dhe

9) leje ose akt tjetër i organit shtetërorë ose, i organit tjetër kompetent, nëse ai obligim është i përcaktuar me ligj për regjistrim të shoqërisë në regjistrin tregtar;

10) deklarata nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik, përkatësisht deklarata nga personi fizik, se nuk ekziston pengesë që të bëhet themelues i shoqërisë, në pajtim me nenin 29 të këtij ligji; dhe

11) deklaratë, konform nenit 32 nga ky ligj.

(4) Anëtarët ekzekutivë të këshillit të drejtorëve, respektivisht anëtarët e këshillit administrues, si edhe personat tjerë të cilët, sipas statutit, janë të autorizuar për përfaqësim, dorëzojnë nënshkrime të verifikuara, të bashkëngjitur dhe të dhënë në pajtim me nenin 65, paragrafin 2 dhe 3 të këtij ligji.

(5) Themeluesit e shoqërisë përgjigjen për autenticitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të përmbajtura në fletëparaqitjen dhe, për bashkëngjitjet të cilat me këtë ligj është përcaktuar se i bashkëngjiten fletëparaqitjes për regjistrim të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar.

Përgjegjësia e themeluesve

Neni 299

(1) Themeluesit e shoqërisë përgjigjen pakufi dhe solidarisht për dëmin që do ta pësojnë shoqëria dhe kreditorët për shkak të veprimeve joligjore, të dhënave të rrejshme ose të paplota, që i kanë dhënë në lidhje me themelimin e shoqërisë, respektivisht që janë të përmbajtura në raportin themelues dhe që shënohen në regjistrin tregtar ose, që janë të përmbajtura në bashkëngjitjet për të cilat, me këtë ligj është përcaktuar se i bashkëngjiten fletëparaqitjes për regjistrim të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar.

(2) Themeluesit nuk mund të thirren në atë se nuk u ka qenë e njohur se ka dallim në të dhënat, nëse e kanë nënshkruar deklaratën nga neni 32 të këtij ligji.

(3) Nëse themeluesit kanë shkaktuar dëm me deponimin e depozitave jomonetare ose, kanë bërë shpenzime të paarsyeshme në lidhje me themelimin, ato kanë obligim që dëmin ta kompensojnë si debitorë solidarë. Themeluesi i cili është sjellur si tregtar i rregullt dhe i ndërgjegjshëm, nuk përgjigjet për atë dëm.

(4) Përveç themeluesve, në mënyrë të njëjtë për dëmin përgjigjen edhe personat, për llogarinë e të cilëve themeluesit i kanë ndërmarrë aksionet. Ato persona nuk mund të thirren sepse nuk u kanë qenë të njohura rrethanat që i kanë ditur ose, që domosdo është dashur t'i kenë të ditur themeluesit të cilët kanë vepruar në llogari të tyre.

Përgjegjësi për persona të tjerë

Neni 300

Përveç themeluesve dhe, personave për llogarinë e të cilëve themeluesit i kanë ndërmarrur aksionet e shoqërisë, si debitor solidar i ja kompenzon dëmin edhe:

1) ai që ka pranuar pagesë e cila, përkundërt ligjit, nuk është pranuar si

shpenzim i themelimit, dhe ka ditur ose, sipas rrethanave, patjetër është dashur të dijë se bëhet fjalë për fshehje qëllimore ose me vetëdije ka marrë pjesë në atë fshehje;

2) ai që me deponimin e depozitit jomonetar, me qëllim ose nga pakujdesia e jashtëzakonshme i ka bërë dëm shoqërisë ose, e ka mundësuar bërjen e demit; dhe

3) ai që, para regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar ose, në dy vitet e para pas regjistrimit, publikisht do të shpallë se do të lëshojë aksione në qarkullim nëse ka ditur ose, me kujdes të tregtarit të rregullt dhe të ndërgjegjshëm domosdo është dashur të dijë për pasaktësinë ose për jo tërësinë e të dhënave në lidhje me themelimin e shoqërisë ose, për dëmin e shkaktuar shoqërisë, nëpërmjet deponimit të depozitit jomonetar.

Përgjegjësia për deklarata të rrejtshme

Neni 301

(1) Nëse në procedurën për themelimin e shoqërisë, janë dhënë deklarata të rrejtshme, themeluesit ose personat tjerë të cilët i kanë dhënë deklaratat e rrejtshme ndaj shoqërisë, janë përgjegjës pakufi dhe solidarisht. Nëse është dhënë deklaratë e rrejtshme për shumën e paguar, përgjegjësia e përfshin edhe obligimin t'i paguhet shoqërisë dallimi plotësues i shumës për të cilën është ndërmarrë obligimi të jetë e paguar.

(2) Nëse është dhënë deklaratë e rrejtshme, për shpenzimet për themelimin, përgjegjësia përfshin obligim t'i paguhet ose t'i kompensohen shoqërisë të gjitha shpenzimet që i tejkalojnë shpenzimet e numëruara në raportin themelues.

(3) Shoqëria nuk mund të heqë dorë ose, të ofrojë marrëveshje për kërkesat e veta, në të cilat ka të drejtë sipas këtij neni, kur arkëtimi i këtyre kërkesave është i domosdoshme për arkëtimin e kërkesave të kreditorëve të shoqërisë, përveç nëse kreditorët nuk dakordohen për zgjidhje tjetër.

Ndalesa për lëshimin e aksioneve

Neni 302

(1) Para regjistrimit të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, nuk mund të lëshohen aksione.

(2) Veprimi përkundërt paragrafit 1 të këtij neni është i pavlefshëm.

(3) Ai që do të veprojë në kundërshtim me dispozitën nga paragrafi 1 i këtij neni, është i obliguar ta kompensojë dëmin që do të jetë i shkaktuar.

Nënseksioni 3

THEMELIMI SUKSESIV

Nocioni

Neni 303

(1) Shoqëria, mund të themelohet ashtu që, themeluesit do ta miratojnë statutin, do të regjistrojnë numër të caktuar të aksioneve dhe, do të drejtojnë thirrje publike për regjistrimin e aksioneve.

(2) Aksionet që nuk regjistrohen në bazë të thirrjes publike, ndërmerren dhe, paguhen me zbatim përkatës të dispozitave të këtij ligji, që vlejné për ndërmarrjen e aksioneve kur shoqëria themelohet në mënyrë simultane.

Thirrje publike

Neni 304

(1) Thirrja publike, me të cilën thirret në regjistrim të aksioneve, përgatitet në pajtim me dispozitat e statutit, të miratuar nga themeluesit.

(2) Thirrja publike për regjistrim të aksioneve, përveç firmës, selisë dhe lëndës së punës së shoqërisë që themelohet, domosdo të përmbajë edhe të dhëna për:

- 1) datën kur është miratuar statuti, në bazë të të cilit lëshohet thirrja publike;
- 2) shuma e kryegjësë bazë;
- 3) depozitimet jomonetare;
- 4) numri, gjinia, e nëse lëshohen më tepër gjini, respektivisht klasa, shënohen të gjitha gjinitë dhe klasat e aksioneve që ofrohen për regjistrim, shuma e tyre nominale dhe çmimi me të cilin shiten si edhe, numri dhe gjinia, gjegjësisht klasa e aksioneve, aksionet që kanë qenë të ndërmarrja pa regjistrim dhe të drejtat të cilat aksionet e lëshuara i japin, volitshmëritë, kufizimet dhe kushtet tjera në lidhje me gjininë dhe klasën e aksioneve që lëshohen;
- 5) emri dhe mbiemri i çdo themeluesit, NUAQ, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i letërnjoftimit, nëse themeluesi është person i huaj fizik, ose të dokumentit tjetër për verifikimin e identitetit, valide në vendin e tij dhe shtetësinë e tij si edhe vendin e banimit, gjegjësisht firma, selia, NUAS, nëse themelues është person juridik;
- 6) selia e bankës te e cila regjistrohen aksionet dhe, udhëzim se atje mund të shqyrtohet statuti, prospekti, e sipas rastit edhe, raporti themelues dhe raporti i revizionit të themelimit, nëse raport i tillë pas kërkesës së themeluesve, respektivisht personave të tjerë, në pajtim me këtë ligj, ka qenë i përgatitur;
- 7) dita kur fillon dhe kur mbaron regjistrimi i aksioneve;
- 8) dita kur mbaron obligimi për regjistruesin, nëse themelimi i shoqërisë deri atëherë, nuk është i paraqitur për regjistrim në regjistrin tregtar;
- 9) kur dhe sa nga aksionet e regjistruara, duhet të paguhen para dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrim të shoqërisë në regjistrin tregtar, gjegjësisht kur konsiderohet se regjistrimi i aksioneve është i suksesshëm, si edhe pasojat që paraqiten në se këstet nuk paguhen tërësisht dhe në kohë;
- 10) të dhënat për volitshmëritë e posaçme;
- 11) shpenzimet që janë bërë gjatë themelimit të shoqërisë, pagesat e posaçme, kompensimet dhe shpërblimet si edhe, shpenzimet maksimale që mund të jenë të arkëtuara nga themeluesit, në rast të themelimit të pasuksesshëm të shoqërisë;
- 12) mënyra e konvokimit të kuvendit themelues; dhe
- 13) shuma më e lartë e shpenzimeve të themelimit, që bien në barrë të shoqërisë.

(3) Thirrja publike mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera që janë me rëndësi për lëshimin dhe shitjen e aksioneve.

(4) Thirrja publike është e pavlefshme nëse, nuk i përmban të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni ose, nëse përmban të dhëna me të cilat kufizohen të drejtat e regjistruesit të aksioneve. Regjistruesi i aksioneve, nuk mund të thirret në atë se, regjistrimi i aksioneve nuk e obligon ose, se thirrja

publike është e pavlefshme nëse shoqëria është regjistruar në regjistrin tregtar, ndërsa ai ka votuar në kuvendin themelues ose më vonë, si aksionar, ka realizuar të drejtë në shoqërinë ose ka përmbushur ndonjë obligim ndaj shoqërisë. Ndaj shoqërisë, nuk ka ndikim juridik kufizimi që nuk është i përmbajtur në thirrjen publike.

(5) Të dhënat për themelimin dhe informata tjera për shoqërinë, përcaktohen në prospektin që është bashkëngjitur e thirrjes publike.

(6) Emisioni themelues i aksioneve, konsiderohet i suksesshëm nëse është regjistruar përqindja e aksioneve të lëshuara të përcaktuara në thirrjen publike, por jo më pak se shumata më e vogël e kryegjësë bazë, e përcaktuar me këtë ligj, si kusht për themelimin suksessiv të shoqërisë aksionare.

Fletëregjistrim

Neni 305

(1) Çdo regjistrues nënshkruan tre kopje të deklaratës për regjistrim të aksioneve (fletëregjistrimin), një për vete dhe, dy për shoqërinë. Nëse regjistrimi kryhet përmes prokuristit, fletëregjistrimeve që mbasin në shoqëri u bashkëngjitet edhe prokurë.

(2) Fletëregjistrimi përmban:

- 1) numër, gjini dhe klasë të aksioneve të regjistruara, shumata e tyre nominale dhe, nëse ajo është e nevojshme, edhe vlera emetuese;
- 2) deklaratë të regjistruesit se, obligohet ta paguajë aksionin sipas kushteve të përcaktuara në thirrjen publike;
- 3) shumata monetare që regjistruesi e paguan gjatë regjistrimit;
- 4) deklaratë e regjistruesit se është i njohur me statutin dhe me thirrjen publike, respektivisht me prospektin, me raportin themelues dhe me raportin për revizionin e themelimit, në qoftë se raport i tillë ekziston, pas kërkesës së themeluesve, gjegjësisht të personave tjerë, në pajtim me këtë ligj është përgatitur dhe, se dakordohet me statutin dhe me mënyrën në të cilën është themeluar shoqëria.
- 5) nënshkrimi i regjistruesit me shënimin e emrit dhe mbiemrit, respektivisht emrit dhe mbiemrit të prokuristit të tij, NUAQ, numri i pasaportës, gjegjësisht numri i letërnjoftimit, nëse regjistruesi është person i huaj fizik, ose të dokumentit tjetër për verifikimin e identitetit, valid në vendin e tij dhe shtetësia e tij, si edhe vendi i banimit, gjegjësisht firma, selia, NUAS, nëse regjistruesi është person juridik;
- 6) dëshmi nga banka tek e cila janë kryer, gjegjësisht do të kryhen regjistrimi dhe pagimi, si edhe vërtetimi i lëshuar për pagesën e pranuar.

(3) Fletëregjistrimi e obligon regjistruesin, vetëm nëse shoqëria themelohet.

(4) Fletëregjistrimi është i pavlefshëm nëse nuk i përmban të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni me të cilin, përkundërt ligjit, kufizohet përgjegjësia për obligimet që i ka ndërmarrë regjistruesi.

Afati për regjistrim dhe regjistrimi i pasuksesshëm i aksioneve

Neni 306

(1) Afati për regjistrimin e aksioneve nuk mund të jetë më i gjatë se nëntëdhjetë ditë, llogaritur nga dita e fillimit të regjistrimit.

(2) Nëse, në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni nuk janë të regjistruar dhe në pajtim me thirrjen publike rregullisht të paguara të gjitha aksionet që janë ofruar për regjistrim, themeluesit munden, në afat prej pesëmbëdhjetë ditë pas skadimit të afatit për regjistrim, aksionet e paregjistruara dhe të papaguara, t'i regjistrojnë ose t'i ndërmarrin vetë. Në këtë rast, afati për shpërndarje të aksioneve është pesëmbëdhjetë ditë nga skadimi i afatit paraprak.

(3) Nëse themeluesit, në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk i ndërmarrin ose nuk i regjistrojnë dhe nuk i paguajnë aksionet e ofruara për regjistrim, në pajtim me kushtet e përcaktuara në thirrjen publike, themelimi konsiderohet i pasuksesshëm, ndërsa themeluesit janë të obliguar në pesëmbëdhjetë ditët e ardhshme, me shpallje, t'i thërrasin regjistruesit t'i tërheqin shumat e paguara. Shpallja publikohet në mënyrën e njëjtë, në të cilën është shpallur thirrja publike.

Shpërndarja e aksioneve të regjistruara

Neni 307

(1) Nëse janë regjistruar aksione në sasi me të cilën konsiderohet se regjistrimi i aksioneve është i suksesshëm, themeluesit, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh pas skadimit të afatit për regjistrim të aksioneve, që është përcaktuar në thirrjen publike, i shpërndajnë aksionet ndërmjet regjistruesve.

(2) Në çdo vend ku bëhet regjistrimi, regjistruesve domosdo t'u jepet në shqyrtim listë e plotë nga e cila mund të shihet, sa aksione janë regjistruar nga çdo gjini dhe sa aksione nga çdo gjini i janë shpërndarë çdo regjistruesi. Lista përmban edhe ftesë për regjistruesit të cilëve nuk u është dhënë asnjë aksion ose nuk u janë shpërndarë të gjitha aksionet e regjistruara, t'i tërheqin shumat e paguara për të cilat nuk u janë shpërndarë aksione.

Pagesa jo në kohë

Neni 308

(1) Nëse ndonjëra nga obligimet për pagesë, që ka arritur para regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, nuk kryhet në kohë, themeluesit munden ndërmarrjen, gjegjësisht regjistrimin e mëtejshëm të aksioneve ta shpallin të pavlefshëm, ndërsa aksionet mund t'i regjistrojnë, respektivisht ndërmarrin, respektivisht t'i regjistrojnë ato vetë ose ndonjë person i tretë.

(2) Pagesat që i ka kryer regjistruesi i mëparshëm ose ndërmarrësi i aksioneve, i kthehen të zvogëluara për shpenzimet që i ka pasur shoqëria nga regjistrimi i pasuksesshëm i aksioneve nga paragrafi 1 i këtij neni, në mënyrën e përcaktuar në thirrjen publike.

Disponimi me pagesat

Neni 309

(1) Themeluesit, nuk munden të disponojnë me pagesat për aksione. Organi administrues, mundet me pagesat të disponojë pas regjistrimit të themelimit të shoqërisë në regjistrin tregtar.

(2) Kompensime të posaçme, kthimi i pagesës dhe shpërblime, nuk mund të paguhen në llogari të kryegjësë bazë.

Konvokimi i kuvendit themelues

Neni 310

(1) Kuvendi themelues, mbahet më së voni për gjashtëdhjetë ditë pas skadimit të afatit për regjistrim të aksioneve, të përcaktuar me thirrjen publike, nëse aksionet nuk regjistrohen në afat më të shkurtër nga afati i përcaktuar për regjistrim të aksioneve. Themeluesit e konvokojnë Kuvendin themelues me thirrje, që patjetër të publikohet në mënyrë të njëjtë si edhe thirrja publike për regjistrim të aksioneve. Nga dita e shpalljes së fundit të thirrjes për konvokim të kuvendit themelues dhe ditës së mbajtjes të kuvendit themelues, domosdo të kalojnë së paku pesëmbëdhjetë ditë.

(2) Themeluesit janë të obliguar, në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, regjistruesve të cilëve u janë shpërndarë aksione në bankën në të cilën janë të regjistruar, tua japin në shqyrtim statutin, raportin themelues, thirrjen publike, listën e fletëregjistrimeve, raportin e themeluesve për shpenzimet e themelimit, listën për shpërndarjen e aksioneve dhe listën e personave që kanë ndërmarrë aksione pa regjistrim, në bazë të thirrjes publike, me shënimin e numrit dhe gjinisë të aksioneve të cilat secili nga ato i ka ndërmarrë dhe raporti për revizionin e themelimit, nëse raport i tillë, sipas kërkesës së themeluesve, gjegjësisht të personave të tjerë, ka qenë i përgatitur.

(3) Gjyqi, në rajonin e të cilit ndodhet selia e shoqërisë, mundet, në propozim të themeluesve, nëse për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, afatin për mbajtjen e kuvendit themelues ta vazhdojë për tridhjetë ditë,

(4) Për mbajtjen e kuvendit themelues, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji për kuvendin, nëse kjo nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Pasojat nga mosmbajtja e kuvendit themelues

Neni 311

(1) Nëse kuvendi themelues, nuk mbahet në afatin e përcaktuar, konsiderohet se themelimi i shoqërisë nuk ka pasur sukses.

(2) Themeluesit, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh pas skadimit të afatit për mbajtje të kuvendit themelues, me shpallje, të publikuar në mënyrë të njëjtë si edhe thirrja publike, i thirrën regjistruesit e aksioneve t'i tërheqin pagesat.

(3) Nëse themeluesit nuk veprojnë konform paragrafit 2 të këtij neni, shpalljen do ta publikojë gjyqi, në propozim të cilitdo regjistrues të aksioneve, në llogari të themeluesve.

Kushtet për vendosje të plotfuqishme të kuvendit themelues

Neni 312

(1) Kuvendi themelues mbahet në selinë e shoqërisë, nëse me thirrjen nuk përcaktohet ndonjë vend tjetër.

(2) Në kuvendin themelues, domosdo të jenë prezent themeluesit dhe regjistruesit e aksioneve të cilët kanë në pronësi shumicë nga të gjitha aksionet, ndërsa nëse shoqëria ka lëshuar aksione nga më shumë gjini, atëherë edhe shumica e aksioneve nga çdo gjini e aksioneve.

(3) Kuvendin themelues e hap noteri, paraprakisht i përcaktuar nga themeluesit. Noteri, domosdo të përpilojë listë të themeluesve dhe regjistruesve prezentë, respektivisht të prokuristëve të tyre dhe të konstatojë a janë përmbushur kushtet për mbajtjen e kuvendit themelues.

(4) Nëse në kuvendin themelues, nuk janë përmbushur kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni dhe nëse gjyqi nuk e ka vazhduar afatin për mbajtje të kuvendit themelues, në pajtim me nenin 310 paragrafi 3 i këtij ligji, themeluesit mundën përsëri ta konvokojnë kuvendin dhe atë më së voni në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita në të cilën është duhur të mbahet kuvendi themelues i pa mbajtur. Nga dita e rikonvokimit të kuvendit deri në ditën e mbajtjes së tij, domosdo të kalojnë më së paku tetë, e më së shumë pesëmbëdhjetë ditë. Kuvendi i rikonvokuar punon dhe vendos me kuorumin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Rrjedha e kuvendit themelues

Neni 313

(1) Pas hapjes së kuvendit themelues, zgjidhet kryesues i kuvendit themelues dhe dy numërues të votave. Pastaj, lexohet raporti themelues dhe raporti për revizionin e themelimit, nëse raport i tillë, pas kërkesës së themeluesve, gjegjësisht personave tjerë, konform këtij ligji, ka qenë i përgatitur. Bashkëngjitjet e raporteve të përmendura, lexohen vetëm nëse atë e kërkojë të pranishmit dhe themeluesit e përfaqësuar dhe regjistruesit e aksioneve, të cilët kanë së paku një të dhjetat e numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote.

(2) Procesverbalin për punën e kuvendit themelues e mban noteri. Procesverbalin, përveç noterit, e nënshkruan kryesuesi i kuvendit themelues dhe numëruesit e votave.

Kompetencat e kuvendit themelues

Neni 314

Kuvendi themelues:

- 1) e miraton raportin themelues dhe raportin e revizionit të themelimit, nëse i tillë ka qenë i përgatitur;
- 2) konstaton nëse janë të regjistruara, gjegjësisht të ndërmarra dhe të shpërndara të gjitha aksionet, a janë deponuar të gjithë depozitet që sipas ligjit dhe statutit, domosdo është dashur të deponohen deri në mbajtjen e kuvendit themelues dhe a do të mundet shoqëria lirisht të disponojë me atë që është deponuar pas regjistrimit në regjistrin tregtar;
- 3) e konstaton shumën më të lartë të shpenzimeve të themelimit, që janë në barrë të shoqërisë; dhe
- 4) i zgjedh ato organe të shoqërisë që sipas ligjit dhe statutit i zgjedh kuvendi, përveç nëse, konform ligjit, nuk janë emëruar me statutin.

Votimi në kuvendin themelues

Neni 315

(1) Në kuvendin themelues çdo aksion jep të drejtë vote, përveç për zgjedhjen e këshillit të drejtorëve, respektivisht këshillit mbikëqyrës për të cilin të drejtë vote japin vetëm aksionet me të drejtë vote.

(2) Për çështjet nga neni 314, pika 2 të këtij ligji, që janë në lidhje me depozitimet jomonetare, domosdo të votohet veçmas për çdo depozitim jomonetar. Themeluesit dhe regjistruarit e aksioneve, në bazë të depozitave jomonetare, nuk kanë të drejtë vote. Themeluesit nuk kanë të drejtë vote as kur votohet për çështjet nga neni 314 pikat 1 dhe 3 të këtij ligji.

(3) Në kuvendin themelues, vendoset me shumicë votash nga kuorumi i përcaktuar në nenin 312, paragrafi 2 i këtij ligji, pa aksionet e përfaqësuar në kuvend që janë të anashkaluar nga votimi, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

(4) Me përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, zgjedhja e këshillit të drejtorëve, respektivisht këshillit mbikëqyrës, kryhet me shumicë të themeluesve dhe të regjistruarit të aksioneve të pranishëm me të drejtë vote, nëse në kuvendin themelues janë prezent shumica e themeluesve dhe regjistruarit të aksioneve me të drejtë vote.

(5) Për ndryshimet e dispozitave të statutit nga neni 287, paragrafi 1 i këtij ligji, është e nevojshme pajtueshmëria e të gjithë themeluesve dhe regjistruarit të aksioneve.

Fletëparaqitje dhe të dhëna për regjistrim

Neni 316

(1) Fletëparaqitje për regjistrim të themelimit suksesiv të shoqërisë në regjistrin tregtar, dorëzohet në mënyrën dhe sipas kushteve nga neni 297 i këtij ligji.

(2) Në regjistrin tregtar, shënohen të dhënat e përcaktuara në nenin 298, paragrafi 1 i këtij ligji. Çdo ndryshim i të dhënave të shënuara, përveç të dhënave nga neni 298, paragrafi 1, pika 5 shënohet në regjistrin tregtar.

(3) Fletëparaqitjes për regjistrim i bashkëngjiten:

1) statuti;

2) kopje e pasaportës ose e letërnjoftimit për personat e huaj fizik ose të ndonjë dokumenti tjetër për përcaktimin e identitetit, valid në vendin e tyre, gjegjësisht dëshmi për regjistrim, nëse themelues është person juridik;

3) dëshmi për shumën e paguar, nga banka në të cilën është kryer pagesa e aksioneve, e nëse është deponuar depozit jomonetar në send të patundshëm me raportin e vlerësuesit dhe dëshmi për pronësi në të cilën është evidentuar në libër publik për evidentim të sendeve të patundshme, ndërsa nëse deponohet send i tundshëm, për të cilën me ligj është përcaktuar obligim për evidentim (regjistër) dëshmi për pronësi mbi sendin e tundshëm dhe nga një kopje nga prospekti në bazë të së cilës është regjistruar e tëra ose pjesë e kryegjësë bazë e nëse depozitohen letra me vlerë në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronësi të letrave të tilla me vlerë me shënim se të njëjtat depozitohen në shoqërinë tregtare dhe se pronari nuk mund të disponojë me të njëjtat. Për këtë qëllim, pronari i letrave me vlerë te Depozitari qendror për letra me vlerë dorëzon deklaratë të verifikuar te noteri se letrat me vlerë janë depozituar në shoqërinë tregtare dhe se pajtohet që ndaj të njëjtave të bëhet kufizim i evidentuar për disponim deri në bartjen e të njëjtave në shoqërinë tregtare.

- 4) procesverbalin e kuvendit themelues, me ftesën për të dhe me listën e pjesëmarrësve;
- 5) vendimet për zgjedhje të anëtarëve të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, nëse ato nuk janë emëruar me statutin.
- 6) raporti themelues dhe raporti për revizionin e themelimit, nëse raport i tillë, pas kërkesës së themeluesve, gjegjësisht personave tjerë, konform këtij ligji, ka qenë i përgatitur.
- 7) kontratat me të cilat janë konstatuar ose me të cilat janë deponuar depozite jomonetare, nëse në themelimin deponohen depozite jomonetare;
- 8) leja ose akt tjetër i organit shtetëror ose i organit tjetër kompetent nëse ai obligim është përcaktuar me ligjin për regjistrim të shoqërisë në regjistrin tregtar;
- 9) deklarata nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik, përkatësisht deklarata nga personi fizik, se nuk ekziston pengesë që të bëhet themelues i shoqërisë, në pajtim me nenin 29 të këtij ligji; dhe
- 10) deklarata, në pajtim me nenin 32 të këtij ligji.

(4) Anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, gjegjësisht anëtarët e këshillit administrues si edhe personat tjerë të cilët, sipas statutit, janë të autorizuar për përfaqësim, dorëzojnë nënshkrime të verifikuara, të bashkëngjitura dhe të dhëna në pajtim me nenin 65, paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji.

(5) Themeluesit e shoqërisë, përgjigjen për autenticitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave, të përmbajtura në fletëparaqitjen dhe për bashkëngjitjet për të cilat me këtë ligj është përcaktuar se i bashkëngjiten fletëparaqitjes për regjistrim të themelimit të shoqërisë.

Zbatimi përkatës i dispozitave të tjera gjatë themelimit suksesiv

Neni 317

(1) Në përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar në procedurën për themelim të shoqërisë, respektivisht në përgjegjësinë e themeluesve dhe të anëtarëve të organit administrues dhe të këshillit mbikëqyrës, në përgjegjësinë e personave të tjerë dhe në përgjegjësinë për deklaratat e rrejshme, zbatohen përkatësisht dispozitat e nenit 296, paragrafi 4, 299, 300 dhe 301 të këtij ligji.

(2) Në veprimin në emër të shoqërisë, para regjistrimit të saj në regjistrin tregtar, zbatohen dispozitat e nenit 23 të këtij ligji.

SEKSIONI 4

AKTE, DOKUMENTE DHE INFORMIMI I AKSIONARËVE

Mënyra e shpalljes të të dhënave dhe raporteve

Neni 318

Organi administrues, e përcakton mënyrën e shpalljes të të dhënave dhe raporteve për të cilat me statutin është përcaktuar obligimi për shpalljen e tyre në gazetë të shoqërisë, në gazetë ditore, internet ose në mënyrë

tjetër dhe i përcakton të dhënat dhe raportet të cilat shpallen, e për të cilat konsiderohet se janë të rëndësishme për aksionarët dhe shoqërinë, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Aktet dhe dokumente të cilat domosdo të ruhen

Neni 319

Shoqëria, në selinë e vetë, domosdo t'i ruajë aktet dhe dokumentet vijuese:

- 1) statutin dhe aktet tjera si edhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tyre, bashkë me tekstet e pastruara;
- 2) procesverbalet dhe të gjitha dokumentet tjera nga të gjitha kuvendet e aksionarëve;
- 3) procesverbalet dhe vendimet nga seancat e organit administrues, respektivisht të këshillit mbikëqyrës;
- 4) llogaritë vjetore dhe raportet financiare të cilat duhet të ruhen sipas ligjit;
- 5) bashkëngjitje (dokumente dhe dëshmi) të cilat janë paraqitur tek regjistri tregtar;
- 6) të gjitha thirrjet publike dhe prospekte për lëshimin e aksioneve dhe letrave tjera me vlerë të shoqërisë;
- 7) e tërë korrespondenca me shkrim e shoqërisë me aksionarët e saj;
- 8) lista e azhurnuar me emra dhe mbiemra dhe adresa të të gjithë anëtarëve të zgjedhur të organit administrues, respektivisht edhe të këshillit mbikëqyrës;
- 9) dokumentet për peng dhe hipotekë;
- 10) raporti i revizorit të autorizuar dhe raporti i vlerësuesit të autorizuar;
- 11) fletëvotimet dhe prokurat për pjesëmarrje në kuvendin, në origjinal ose kopje;
- 12) marrëveshja kolektive në nivel të shoqërisë;
- 13) dokumentacionin e plotë lidhur me miratimit e transaksionit me palën e interesuar;
- 14) akte tjera dhe dokumente të parapara me ligjin dhe statutin.

E drejta e informimit

Neni 320

(1) Çdo aksionari, domosdo t'i sigurohet e drejtë shqyrtimi në aktet dhe dokumentet tjera të shoqërisë, nga neni 319 i këtij ligji, në selinë e shoqërisë, në mënyrën e përcaktuar në statut.

(2) E drejta për informim për procesverbalet dhe vendimet nga seancat e organeve administrues, aksionarët e realizojnë nëpërmjet anëtarëve joekzekutivë të këshillit të drejtorëve ose përmes këshillit mbikëqyrës.

(3) Shoqëria, mundet të kërkojë nga aksionari i cili kërkon shqyrtim, paraprakisht ta informojë shoqërinë për shqyrtimin, në afat jo më të gjatë se tri ditë para ditës së shqyrtimit të kërkuar. Shoqëria, mundet të kërkojë aksionari t'i paguajë shpenzimet për kopjet e kërkuara, të cilat nuk mund të jenë më të larta se shpenzimet reale.

(4) Nëse, shoqëria nuk i lejon aksionarit të realizojë shikim dhe kopjim të akteve dhe dokumenteve, aksionari mund të paraqesë propozim të gjyqi t'i mundësojë shikim në aktet dhe dokumentet. Në propozim, aksionari i shënon aktet dhe dokumentet të cilat dëshiron t'i shqyrtojë ose t'i marrë si edhe formën në të cilën dëshiron t'i dërgohen.

(5) Gjyqi, në afat prej tre ditë nga paraqitja e propozimit, merr vendim me të cilin ngarkohet shoqëria, t'i lejojë aksionarit-paraqitës i propozimit, të kryen kontrole në aktet dhe dokumentet që i ka shënuar në propozimin ose, t'i japë kopje të akteve dhe dokumenteve në llogari të shoqërisë.

(6) Aksionari, nuk mundet publikisht t'i shpallë ose t'i prezantojë informatat, përveç aksionarëve, nëse realizon para organit kompetent ndonjë të drejtë të përcaktuar me statutin dhe akt tjetër të shoqërisë, ose, nëse ato nuk janë më publikisht të shpallura.

SEKSIONI 5

MARRËDHËNIET JURIDIKE MIDIS SHOQËRISË DHE AKSIONARËVE

Parimi i pozitës së njëjtë të aksionarëve

Neni 321

(1) Aksionarët, nën kushtet e barabarta kanë pozitë të njëjtë në shoqërinë.

(2) Çdo marrëveshje e kontraktuar ose, punë juridike tjetër e ndërmarrë nga disa nga aksionarët, me të cilën cenohen të drejtat dhe interesat e aksionarëve të tjerë është e pavlefshme, përveç nëse me atë marrëveshje, gjegjësisht me punën juridike nuk pajtohen të gjithë aksionarët.

Detyra themelore e aksionarit

Neni 322

(1) Aksionari, është i obliguar shoqërisë t'ia paguajë shumën nominale të aksionit, respektivisht shumën më të madhe nëse, aksioni është lëshuar me shumë më të lartë se shuma nominale, si edhe t'ia bartë depozitin jomonetar nëse aksionin e fiton në bazë të deponimit të depozitit jomonetar.

(2) Kushtet për pagim të aksioneve të cilat aksionarët i kanë regjistruar, e nuk i kanë paguar, janë të njëjta për të gjithë aksionarët sipas gjinisë dhe klasës së aksioneve.

(3) Aksionari, nuk mundet kërkesat ndaj shoqërisë t'i mbulojë me pagesat e aksioneve, as që mundet mbi depozitet jomonetare ta realizojë të drejtën e ndalesës.

(4) Shoqëria, nuk mundet aksionarëve të veçuar tua shtyjë pagesën, as t'i lirojë nga pagesa, as që mundet në emër të pagesës të pranojë diçka tjetër, nga ajo që është paraparë në statutin. Depoziti jomonetar, që përbëhet nga kërkesa, konsiderohet i deponuar pasi që shoqëria do ta arkëtojë, gjegjësisht ndërmarrë. Shoqëria, i përgjigjet aksionarit nëse, për arkëtimin nuk kujdeset me vëmendje të tregtarit të rregullt dhe të ndërgjegjshëm.

Pasojat nga pagesa jo në kohë

Neni 323

(1) Aksionari, domosdo t'i paguajë aksionet në thirrje të organit administrues, sipas kushteve nën të cilat i ka regjistruar. Thirrja bëhet me njoftimin personal të aksionarëve, përveç nëse me statutin nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Aksionari, i cili në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk e kryen pagesën në kohë, nuk ka të drejtë vote derisa nuk e paguan tërë pagesën e mbetur, duke përfshirë edhe kamatë ligjore me vonesë. Aksionari, i cili nuk i ka paguar aksionet në afatin e përcaktuar, është i obliguar të paguajë kamatë ligjore me vonesë.

(3) Nëse aksionari është në vonesë me deponimin e depozitit jomonetar, ai është i obliguar të paguajë dënim kontraktues, nën kushtet e përcaktuara me marrëveshjen për ndërmarrjen e depozitit jomonetar në pajtim me statutin.

Përrjashtimi i aksionarit

Neni 324

(1) Aksionarit, i cili nuk do t'i paguajë aksionet e regjistruara në afatin dhe, sipas kushteve nën të cilat i ka regjistruar, mundet me letër të rekomanduar, t'i jepet afat plotësues, me paralajmërim se, nëse në afatin e dhënë nuk e përmbush obligimin për pagim, do t'i merren të gjitha aksionet e paguara pjesërisht, për të cilat ka qenë i paralajmëruar t'i paguajë. Dhënia e afatit plotësues, shpallet në gazetë ditore.

(2) Aksionarit, i cili edhe përkrah paralajmërimit nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk do ta paguajë shumën e cila prej tij kërkohet në favor të shoqërisë, i merren aksionet dhe përjashtohet nga shoqëria. Në publikimin nga paragrafi 1 i këtij neni, shënohen aksionet që i merren në favor të shoqërisë.

(3) Për përjashtimin nga shoqëria, aksionari lajmërohet në formë të shkruar, me letër të rekomanduar ose, me letër të dorëzuar personalisht në dorë.

Të drejtat dhe obligimet e aksionarit të përjashtuar

Neni 325

(1) Nëse, shoqëria i shet aksionet që i ka marrë nga aksionari i përjashtuar:

1) nën shumën e tyre nominale, ndërsa mjetet nuk janë të mjaftueshme të paguhen pjesa e papaguar e depozitit si edhe shpenzimet dhe kamata ligjore me vonesë, aksionari i përjashtuar është i obliguar shoqërisë t'ia plotësojë pagesën e dallimit;

2) sipas shumës së tyre nominale, pas pagesës së shpenzimeve dhe kamatës ligjore me vonesë, shoqëria, ia kthen shumën paraprakisht të paguar, të zvogëluar për shpenzimet dhe kamatën ligjore me vonesë; dhe

3) mbi shumën e tyre nominale, pas pagesës së shpenzimeve dhe kamatës ligjore me vonesë, shoqëria, ia kthen shumën paraprakisht të paguar, të zvogëluar për shpenzimet dhe kamatën ligjore me vonesë deri në shumën nominale të aksionit, ndërsa dallimin e mban shoqëria.

(2) Aksionari i përjashtuar, ka obligim të paguajë edhe dënim kontraktues, nëse është përcaktuar në thirrjen publike, për mosdeponimin në kohë të depozitit jomonetar. Me pagesat nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk përjashtohet edhe përgjegjësia e aksionarit të përjashtuar, për dëmin e shkaktuar ndaj shoqërisë, për lëshimin e pagesës.

Shitja e aksioneve të aksionarit të përjashtuar

Neni 326

(1) Aksionet e aksionarit të përjashtuar, shoqëria i shet nëpërmjet bursës ose në treg tjetër të organizuar. Aksionet, mund të shiten dhe shndërrohen në para edhe në mënyrë tjetër, vetëm me dakordim të aksionarit të përjashtuar.

(2) Dispozitat nga statuti, si edhe punët dhe veprimet tjera juridike, që janë në kundërshtim me dispozitat nga neni 324 dhe 325 të këtij ligji dhe, paragrafi 1 i këtij neni, janë të pavlefshme.

Përgjegjësia e poseduesit të aksioneve pjesërisht të paguara

Neni 327

(1) Çdo pronar i aksioneve pjesërisht të paguara, është personalisht përgjegjës, për pjesën e papaguar nga shuma për të cilën kanë qenë të lëshuara aksionet. Shoqëria, nuk mundet ta lirojë poseduesin e aksioneve pjesërisht të paguara, nga obligimi ta paguajë pjesën e papaguar nga çmimi i aksioneve të regjistruara.

(2) Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, shoqëria mund ta lirojë aksionarin nga obligimi i pagesës së aksioneve të regjistruara, vetëm në rast të zvogëlimit të kryegjësë bazë, me tërheqje të aksioneve deri në shumën për të cilën është zvogëluar kryegjësja bazë, në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Ndalesa për kthimin e borxhit dhe pagesës së kamatës

Neni 328

(1) Përveç në rastet e parapara me këtë ligj, aksionarëve nuk u kthehet depoziti i paguar. Si kthim borxhi, nuk konsiderohet pagesa e çmimit blerës gjatë fitimit të lejuar të aksioneve personale, nga ana e shoqërisë.

(2) Aksionarëve, nuk guxon t'u premtohet as t'u paguhet kamatë për depozitin e deponuar në shoqëri.

Pjesëmarrja e aksionarëve në fitimin

Neni 329

(1) Aksionarët, kanë të drejtë pjesëmarrjeje në fitim, përveç nëse, sipas vendimit të kuvendit për përdorim të fitimit, të marrë në bazë të ligjit ose të statutit, fitimi është lënë mënjanë nga shpërndarja ndërmjet aksionarëve.

(2) Pjesëmarrja e aksionarëve në fitim, përcaktohet sipas gjinisë dhe klasës së aksioneve.

(3) Dividenda për çdo gjini ose klasë të aksioneve, u paguhet proporcionalisht pronarëve të asaj gjinie ose klase të aksioneve. Nëse depozitet në kryegjënë bazë, nuk janë paguar tërësisht ose, nuk janë paguar të gjitha aksionet në raport të njëjtë, aksionarët të cilët i kryejnë në kohë obligimet e tyre, marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit

proporcionalisht me pjesën e paguar të aksioneve. Pagesat e kryera gjatë vitit afarist, merren parasysh sipas kohës të pagesës.

(4) Para pushimit të shoqërisë, aksionarëve mund t'u ndahet vetëm fitim i cili rrjedh nga bilanci i suksesit.

Përgjegjësia e aksionarit i cili ka pranuar pagesë të ndaluar

Neni 330

(1) Aksionari i cili ka pranuar nga shoqëria avans nga dividenda, dividendë ose mjete tjera, në cilën çdo bazë, ka obligim t'ua kthejë shoqërisë, nëse shoqëria dëshmon se aksionari ka ditur ose, duke marrë parasysh rrethanat, patjetër është dashur të dijë se, shpërndarja e mjeteve është në kundërshtim me ligj.

(2) Kthimi e mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni, të pranuar në kundërshtim me ligjin, mund ta kërkojnë edhe kreditorët nëse, ato nuk mund t'i arkëtojnë kërkesat e tyre nga shoqëria. Nëse mbi shoqërinë është hapur procedurë falimentuese, gjatë kohëzgjatjes së procedurës falimentuese, administruesi falimentues e realizon të drejtën e kreditorit në raport me aksionarët.

(3) E drejta për paraqitje të ankesës, në rastet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, parashkruhet për pesë vite nga pranimi i pagesës së ndaluar.

Posedues të aksionit

Neni 331

(1) Poseduesit e aksionit, i realizojnë të drejtat e tyre nëpërmjet përfaqësuesit të përbashkët.

(2) Veprimet juridike, që shoqëria i ndërmerr ndaj bashkëpronarëve, i kryen ndaj përfaqësuesit të përbashkët, nëse shoqërisë i është paraqitur përfaqësues i përbashkët. Nëse shoqërisë, nuk i është paraqitur përfaqësues i përbashkët, shoqëria mund të ndërmerr ndonjë veprim juridik, gjegjësisht ta shpreh vullnetin ndaj cilit çdo bashkëpronarë, me çka konsiderohet se veprimi juridik është ndërmarrë, respektivisht se shoqëria e ka shprehur vullnetin e saj ndaj të gjithëve.

(3) Përfaqësuesi regjistrohet në librin aksionar, në Depozituesin Qendrorë për letra me vlerë.

(4) Për obligimet nga aksionet, të gjithë bashkëpronarët përgjigjen si debitorë solidarë.

Ndalesa për regjistrimin e aksioneve personale

Neni 332

(1) Shoqëria, nuk mundet të regjistrojë aksione të veta.

(2) Secili, i cili në llogari të shoqërisë ka ndërmarrë aksione, nuk mund të thirret në atë se nuk i ka ndërmarrë në llogari të vetë. Atij, që i ka ndërmarrë aksionet në llogari të shoqërisë, nuk i takojnë kurrfarë të drejta nga aksionet, derisa nuk i ndërmerr në emër të vetë.

(3) Nëse regjistrohen aksione, në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni, themeluesit ose anëtarët e organit administrues kanë obligim që personalisht t'i paguajnë ato aksione, nëse nuk kanë vepruar me vëmendje të tregtarit të rregullt dhe të ndërgjegjshëm, përveç nëse bëhet fjalë për hua e cila transformohet në depozitë në shoqëri.

Blerja e aksioneve të veta

Neni 333

(1) Shoqëria mund të fitojë aksione vetjake me blerje, ose përmes personit i cili vepron në emër të vet, por në llogari të shoqërisë. Blerja e aksioneve vetjake është e plotfuqishme nën këto kushte:

1) kuvendi të marrë Vendim për fitimin e aksioneve vetjake me blerje në të cilin është përcaktuar mënyra e blerjes, numri maksimal i aksioneve që duhet të fitohet, koha gjatë të cilës duhet të realizohet blerja dhe e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë muaj nga dita e miratimit të Vendimit për fitimin e aksioneve vetjake, dhe kundërvlerën minimale dhe maksimale që mund të paguhet për ato.

2) shuma nominale e aksioneve të fituara, bashkë me aksionet që shoqëria i ka fituar paraprakisht, përkatësisht të cilat shoqëria i posedon, të mos e kapërcejë një të dhjetën nga kryegjësja bazë;

3) me fitimin e aksioneve vetjake, të mos zvogëlohet prona e shoqërisë nën shumën e kryegjësë bazë dhe rezervave, të cilat sipas ligjit ose sipas statutit, patjetër duhet t'i ketë dhe të cilat nuk guxon të përdoren për t'i paguar aksionarët; dhe

4) me blerjen të fitohen vetëm ato aksione që janë të paguara në tërësi.

(2) Me përjashtim, shoqëria mund të fitojë aksione vetjake në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, pika 1 e këtij neni, në rastet kur fitimi i aksioneve vetjake është i domosdoshëm që të pengohet dëmi serioz dhe i drejtpërdrejtë që do ta pësonte shoqëria. Vendimin e miraton këshilli i drejtorëve, gjegjësisht këshilli administrues sipas pëlqimit paraprak të këshillit mbikëqyrës. Në këtë rast, këshilli i drejtorëve, përkatësisht këshilli administrues obligohet që në kuvendin e parë të radhës ta lajmërojë kuvendin për shkaqet dhe qëllimin e realizimit të fitimit të aksioneve vetjake, për numrin dhe shumën nominale të aksioneve të fituara, për pjesën nga kryegjësja bazë që e përfaqësojnë aksionet e fituara, për çmimin për të cilin janë fituar si edhe për burimin e mjeteve që janë shfrytëzuar për fitimin e tyre.

(3) Nëse anëtarët e Këshillit të Drejtorëve, përkatësisht anëtarët e Këshillit Udhëheqës dhe të Këshillit Mbikëqyrës, me vendim për fitimin e aksioneve personale nga paragrafi (2) i këtij neni, i kanë shkaktuar dëm shoqërisë ose aksionarëve, ata kanë obligim që ta kompensojnë dëmin si debitorë solidarë nga tërë pasuria e tij.

(4) Dispozita nga paragrafi 1, pika 1 e këtij neni, zbatohet në aksionet e fituara vetjake, qoftë nga ana e vetë shoqërisë, qoftë nga personi i cili vepron në emër të vet, por në llogari të shoqërisë, me qëllim që t'u shpërndahen të punësuarve në shoqërinë ose të punësuarve në shoqërinë e ndërlidhur me atë. Shpërndarja e këtyre aksioneve patjetër duhet të realizohet brenda një afati njëvjeçar, llogaritur nga dita e fitimit të këtyre aksioneve.

Procedura për fitim proporcional të aksioneve vetjake nga aksionarët

Neni 334

(1) Kur shoqëria fiton aksione vetjake në mënyrë proporcionale nga të gjithë aksionarët, shoqëria në bazë të Vendimit për fitim të aksioneve vetjake dërgon thirrje publike deri te të gjithë aksionarët, në të cilën përfshihet përmbajtja e ofertës për fitimin e aksioneve. Në thirrje ceket numri i aksioneve të cilat shoqëria ka për qëllim t'i fitojë, gjithashtu ceket edhe gjinia dhe klasa e aksioneve, numri proporcional i aksioneve që çdo aksionar mund t'i ofrojë në shitje në raport me numrin e aksioneve që i posedon, çmimin e blerjes ose mënyrën e përlogaritjes të çmimit blerës, procedurën e pagimit dhe data e pagimit si edhe procedura për afatin e fundit në të cilin të gjithë aksionarët duhet t'i ofrojnë aksionet e tyre për shitjen e shoqërisë. Shpallja e thirrjes publike zgjat më së paku 30 ditë nga dita e shpalljes.

(2) Nëse numri i përgjithshëm i aksioneve të ofruara nga aksionarët për shitjen e shoqërisë e tejkalon numrin e aksioneve që shoqëria mund t'i fitojë, konform këtij ligji, shoqëria do të blejë aksione nga çdo aksionar proporcionalisht me numrin e aksioneve që çdo aksionar i ka ofruar për shitje në raport me numrin e aksioneve që i posedon, përveç në rastin kur është e nevojshme t'i shmanget blerjes të pjesëve nga aksioni.

Mënyra të veçanta të fitimit të aksioneve vetjake

Neni 335

(1) Fitimi i aksioneve vetjake bëhet pa zbatimin e kushteve nga neni 333, paragrafi 1 i këtij ligji, nëse:

- 1) sipas vendimit të kuvendit, tërheqja e aksioneve bëhet sipas dispozitave të këtij ligji, për zvogëlimin e kryegjësë bazë;
- 2) pa pagesë ose kur nga provizioni i fituar me blerjen e aksioneve, banka, fondi për investime dhe institucion tjetër financiar blen aksione në emër të vet;
- 3) si pasojë universale e suksesionit të pronës;
- 4) në procedurë për ekzekutim të detyrueshëm me qëllim të përmbushjes të kërkesës së shoqërisë sipas aktvendimit të gjykatës;
- 5) në rast të bashkimit, bashkëngjijtes dhe ndarjes dhe gjatë transformimit të shoqërisë nga njëra në formë tjetër, kur në harmoni me këtë ligj, shoqëria ka obligim t'i blejë aksionet e aksionarëve të cilët nuk e kanë pranuar ofertën të pranojnë aksione;
- 6) gjatë përjashtimit të aksionarit, konform nenit 324 të këtij ligji;
- 7) aksione të fituara sipas fuqisë të obligimit ligjor ose në bazë të aktvendimit të gjykatës; dhe
- 8) si kompensim për huan ose në procedurë të riorganizimit të debitorit, konform Ligjit për falimentim.

(2) Aksionet e fituara në rastet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, patjetër të jenë në tërësi të paguara dhe patjetër duhet të tjetërsohen brenda afatit trevjeçar nga dita e fitimit të tyre, vetëm nëse shuma nominale e aksioneve të fituara, duke i përfshirë edhe aksionet e fituara vetjake, sipas nenit 333 të këtij ligji, nuk e tejkalon një të dhjetën e kryegjësë bazë.

(3) Nëse aksionet të cilat janë fituar sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk tjetërsohen dhe të njëjtat paraprakisht janë ofruar për shitje nëpërmjet ofertës publike në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, por shitja nuk ka qenë e suksesshme, atëherë aksionet të cilat janë fituar sipas paragrafit (1) të këtij neni, pa prolongim duhet të zhvleftësohen. Kur asgjësimi i aksioneve vetjake sjell deri te zvogëlimi i pronës së shoqërisë nën vlerën nominale të kryegjësë bazë, patjetër duhet të zbatohet procedura për zvogëlimin e kryegjësë bazë.

Tjetërsimi i aksioneve vetjake

Neni 336

Prej ditës së fitimit të tyre, aksionet e fituara në kundërshtim me nenet 333, 334 dhe 335 tjetërsohen brenda afatit njëvjeçar. Nëse aksionet nuk tjetërsohen brenda këtij afati, do të aplikohen dispozitat nga paragrafi 3 të nenit 335 të këtij ligji.

(2) Pa dallim se si janë fituar aksionet personale, respektivisht në pajtim ose në kundërshtim me dispozitat e neneve 333, 334 dhe 335 të këtij ligji dhe pa dallim të afateve të tjetërsimit të tyre, para se të anulohen, aksionet personale doemos duhet paraprakisht të ofrohen për shitje me anë të ofertës publike.

Njoftimi për aksionet e fituara vetjake

Neni 337

Në raportin vjetor për punën e shoqërisë detyrimisht theksohen:

- 1) shkaqet për të cilat gjatë vitit është kryer fitimi i aksioneve vetjake;
- 2) numri, shuma nominale e aksioneve vetjake të fituara dhe të tjetërsuara sipas çdo baze të vitit paraprak financiar, pjesëmarrja e tyre në kryegjënë bazë dhe kundërvlera e paguar për ato;
- 3) numri i përgjithshëm dhe çmimi sipas të cilit në vitet paraprake, janë fituar dhe tjetërsuar aksionet vetjake paraprakisht të fituara dhe pjesëmarrja e tyre në kryegjënë bazë; dhe
- 4) numri, shuma nominale e aksioneve të fituara vetjake të cilat u janë shpërndarë të punësuarve dhe pjesëmarrja e tyre në kryegjënë bazë.

Të drejtat nga aksionet vetjake

Neni 338

Të drejtat nga aksionet e fituara vetjake pushojnë.

Aksione me të drejtë për blerje nga ana e shoqërisë

Neni 339

(1) Me statutin, shoqëria mund të autorizohet të lëshojë aksione në të cilat është përmbajtur e drejta e shoqërisë që në afat të caktuar t'i blejë aksionet e lëshuara. Blerja është e plotfuqishme nëse përmbushen kushtet si vijon:

- 1) kushtet dhe mënyra e blerjes të përcaktohen me statutin;
- 2) para se të evidentohen, kuvendi të marrë vendim për blerjen e aksioneve të atilla;
- 3) aksionet duhet të jenë të paguara në tërësi;
- 4) blerja patjetër të kryhet vetëm me mjete që e tejkalojnë kryegjënë bazë dhe rezervat, që sipas këtij ligji dhe statutit, nuk guxon t'u shpërndahen aksionarëve; dhe
- 5) shuma e cila nuk është më e vogël se shuma nominale e aksioneve të lëshuara patjetër të vendoset në rezervat, të cilat sipas këtij ligji dhe statutit, nuk mund të shpërndahen, përveç në rastin e zvogëlimit të kryegjësë bazë.

(2) Dispozita nga paragrafi 1, pika 2 e këtij neni, nuk do të aplikohet në blerjet në të cilat shfrytëzohen mjetet për lëshimin e aksioneve të reja me

të cilat blihen aksionet ekzistuese, dhe në të cilat përfshihet e drejta për blerje nga ana e shoqërisë.

(3) Në qoftë se gjatë blerjes, ekziston dispozitë për pagimin e premisë së aksionarëve, premia mund të paguhet vetëm nga rezervat të cilat mund t'u shpërndahen aksionarëve.

(4) Në statut patjetër të përcaktohet afati i blerjes të aksioneve, në të cilat përfshihet e drejta për blerje nga ana e shoqërisë.

(5) Njoftimi për blerjen e aksioneve nga paragrafi 1 i këtij neni, shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Punë juridike të pavlefshme

Neni 340

(1) E pavlefshme është puna juridike me të cilën shoqëria dikujt i jep avans, hua, kredi ose sigurim me qëllim të fitimit të aksioneve në atë shoqëri. Kjo nuk ka të bëjë me punët juridike rrjedhëse të bankave si edhe me institucione tjera financiare, nëse me ndonjë ligj të veçantë ndryshe nuk është përcaktuar, ose në rastet kur shoqëria fiton aksione vetjake që tua shpërndajë të punësuarve nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(2) E pavlefshme është puna juridike në rastet kur shoqëria ka fituar aksione vetjake nga rezervat e nevojshme për t'u ruajt shuma nominale e kryegjësë bazë ose rezervave që sipas ligjit dhe statutit, nuk kanë mund të shfrytëzohen për dedikime tjera.

(3) E pavlefshme është puna juridike ndërmjet shoqërisë dhe personit tjetër me të cilën personi tjetër autorizohet ose obligohet të fitojë aksione në shoqëri tjetër për llogari të shoqërisë, për llogari të shoqërisë të varur nga ajo, ose për llogarinë e shoqërisë në të cilën shoqëria ka shumicën e pjesës, nëse fitimi i aksioneve nga ana e shoqërisë është në kundërshtim me nenin 333 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji.

(4) I pavlefshëm është fitimi i aksioneve vetjake, sipas çdo baze, nëse në tërësi nuk është paguar shuma nominale e aksioneve, atij të cilit i janë lëshuar.

Marrja në peng e aksioneve vetjake

Neni 341

(1) Marrja në peng e aksioneve vetjake dhe mënyra tjera të sigurimit nga shoqëria apo nga personi i cili vepron në emër të vet, por për llogari të shoqërisë, do të llogaritet si fitim i aksioneve vetjake për qëllimet e përcaktuara në nenet 333, 335, 337 dhe 339 të këtij ligji.

(2) Paragrafi 1 i këtij neni, nuk aplikohet në punët rrjedhëse juridike të bankave si edhe në institucione tjera financiare, nëse me ndonjë ligj të veçantë ndryshe nuk është përcaktuar.

Seksioni 6

ORGANET E SHOQËRISË

Nënseksioni 1

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Sistemet e administrimit

Neni 342

(1) Administrimi me shoqërinë mund të organizohet sipas sistemit njëshkallësh (këshilli i drejtorëve) ose sipas sistemit dyshkallësh (këshilli administrues apo administratori dhe këshilli mbikëqyrës).

(2) Shoqëria e zgjedh sistemin e administrimit. Me ndryshimet e statutit, sistemi i administrimit njëshkallësh të zëvendësohet me sistem dyshkallësh dhe anasjelltas.

(3) Dispozitat për kuvendin në mënyrë përkatëse aplikohen si në shoqëritë me sistem njëshkallësh ashtu edhe në shoqëritë me sistem dyshkallësh të organizimit të administrimit.

(4) Pjesëmarrja e të punësuarve në administrimin me shoqërinë rregullohet me ligj.

Kushtet për zgjedhje

Neni 343

(1) Për anëtar të organit administrues, përkatësisht të organit mbikëqyrës mund të zgjedhen vetëm persona fizik që janë të aftë për punë.

(2) Për anëtar të organit administrues, përkatësisht të organit mbikëqyrës nuk mund të zgjedhet personi kundër të cilit është shqiptuar dënimi, përkatësisht sanksioni për kundërvajtje ndalim i kryerjes së detyrës së profesionit të caktuar i cili pjesërisht apo në tërësi është inkorporuar në lëndën e punës të shoqërisë përderisa zgjat ky ndalim.

Organe që kryejnë zgjedhje

Neni 344

(1) Anëtarët e këshillit të drejtorëve dhe anëtarët e organit mbikëqyrës me shumicën e votave të aksioneve me të drejtë vote, me këtë ligj, i zgjedh kuvendi nga kuorumi i caktuar për punën e kuvendit, vetëm nëse me statut nuk është caktuar shumicë më e madhe, me mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara në statut.

(2) Nëse kjo është e përcaktuar në statut, zgjedhja e anëtarëve të këshillit të drejtorëve ose e këshillit mbikëqyrës mund të bëhet me votim kumulativ. Aksionari me të drejtë vote ka të drejtë votat që i ka në bazë të aksioneve t'i japë, të shumëzuara me numrin e anëtarëve që zgjedhën në dobi të njërit kandidat ose në cilëndo qoftë mënyrë t'i shpërndajë ndërmjet kandidatëve. Zgjedhja e kandidatëve bëhet në kohë të njëjtë. Votat e dhëna për secilin nga kandidatët llogariten veç e veç. Për kandidatë të zgjedhur llogariten kandidatët që do ta marrin numrin më të madh të votave.

(3) Para se t'i qaset zgjedhjes të anëtarit të këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtarit të këshillit mbikëqyrës, konform paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, për çdo kandidat, në formë të shkruar publikohen të dhënat për moshën, gjininë, arsimimin dhe kualifikimet tjera profesionale, përvoja e punës dhe si ka ardhë deri te ajo, në cilat shoqëri është apo ka qenë

anëtar i organit administrues, numrin e aksioneve që e posedon në shoqërinë dhe në shoqëri tjera si edhe huat dhe obligimet tjera që i ka ndaj shoqërisë.

(4) Të dhënat e verifikuara në paragrafin 3 të këtij neni, iu dërgohen aksionarëve më së voni shtatë ditë para se kuvendi të qaset në zgjedhje. Në të dhënat ka qasje çdo aksionar.

(5) Vendimi i kuvendit për zgjedhjen e këshillit të drejtorëve ose këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht të anëtarit të tyre, hyn në fuqi prej ditës së miratimit. Fletëparaqitjen për regjistrimin në regjistrin tregtar të këshillit të zgjedhur të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht të anëtarit të tyre e paraqet personi i caktuar me Vendim të kuvendit. Vendim për regjistrim në regjistrin tregtar, në harmonizim me vendimin e kuvendit, patjetër të nxirret brenda afatit prej 48 orësh nga paraqitja e fletëparaqitjes.

Mandati

Neni 345

(1) Anëtarët e organit administrues, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës, zgjedhën për një periudhë që përcaktohet me statut, por e cila nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë vjet. Nëse në statut nuk është përcaktuar kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të organit administrues, gjegjësisht të organit mbikëqyrës, mandati i tyre zgjat katër vjet.

(2) Anëtarët e organit administrues, përkatësisht të organit mbikëqyrës mund të rizgjidhen pa marrë parasysh faktin se në sa mandate paraprakisht janë zgjedh, përveç nëse me statut ndryshe nuk është përcaktuar.

Kufizimet për zgjedhje

Neni 346

(1) Anëtari jo ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtari i këshillit mbikëqyrës, njëkohësisht, si anëtar jo ekzekutiv nuk mund të zgjedhet në më shumë se pesë këshilla të drejtorëve, e as në më shumë se pesë këshilla mbikëqyrës të shoqërive aksionare me seli në Republikën e Maqedonisë.

(2) Anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve dhe anëtari i këshillit administrues nuk mund të zgjedhet për anëtar ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtari i këshillit administrues në shoqëri tjera aksionare me seli në Republikën e Maqedonisë, përveç nëpër banka, nëpër shoqëri sigurimi dhe nëpër shoqëri tjera nëse kjo është e përcaktuar me ligj.

(3) Anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve dhe anëtari i këshillit administrues mund të zgjedhet për anëtar joekzekutiv si edhe për anëtar të këshillit mbikëqyrës në më së shumti pesë shoqëri tjera aksionare me seli në Republikën e Maqedonisë.

(4) Kufizimi nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk aplikohet mbi personat juridik.

Përbërje jo e plotë

Neni 347

(1) Nëse disa anëtarë të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës gjatë mandatit pushojnë t'i kryejnë funksionet e tyre ose nëse janë të penguar t'i kryejnë, në këtë rast anëtarët tjerë të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës e vazhdojnë punën deri në përmbushjen e vendeve të lira.

(2) Nëse numri i anëtarëve të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës zvogëlohet nën numrin e përcaktuar me statut, por jo më pak se numri minimal i caktuar me ligj, këshilli i drejtorëve, përkatësisht këshilli mbikëqyrës mundet brenda afatit prej nëntëdhjetë ditësh nga dita kur anëtarit i ka pushuar funksioni, ta plotësojë përbërjen e tij me zgjedhjen e ushtruesit të detyrës anëtar i këshillit të drejtorëve, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës të kuvendit të ardhshëm. Vendimet e miratuara dhe çështjet dhe veprimet juridike të ndërmarra nga ana e këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës ngelin të plotfuqishme.

(3) Nëse numri i anëtarëve i këshillit të drejtorëve, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës zvogëlohet nën numrin e caktuar me ligj, anëtarët tjerë të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës duhet patjetër brenda afatit prej tre ditësh të konvokojnë kuvend që të plotësohet përbërja e këshillit të drejtorëve, përkatësisht e këshillit mbikëqyrës. Nëse kuvendi nuk konvokohet brenda këtij afati, kuvendin, brenda afatit prej tre ditësh pas skadimit të afatit paraprak do ta konvokojnë anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit administrues.

(4) Nëse këshilli i drejtorëve, përkatësisht këshilli mbikëqyrës nuk e kryen zgjedhjen e ushtruesit të detyrës anëtar i këshillit të drejtorëve, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës, nëse anëtarët tjerë të këshillit të drejtorëve ose të këshillit mbikëqyrës nuk e konvokojnë kuvendin, përkatësisht nëse anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve ose të këshillit administrues nuk e konvokojnë kuvendin brenda afateve nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, çdo person i cili ka interes juridik, mundet me propozim, të kërkojë nga gjykata të caktojë person fizik që do ta konvokojë kuvendin.

Ndalimi i konkurrencës

Neni 348

(1) Anëtarët e organit të administrimit, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, si dhe anëtarët e familjeve të tyre (bashkëshortë/e, prindër dhe fëmijë) pa lejen e këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës nuk guxojnë:

- 1) për llogari të vetë ose të huaj, të kryejnë punë që bëjnë pjesë në lëndën e veprimtarisë së shoqërisë;
- 2) të kryejnë veprimtari ose aktivitet tjetër në shoqëri tjetër, me lëndë të njëjtë ose të ngjashëm të veprimtarisë, të paguar ose të papaguar, për llogari të vetë ose për llogari të personit tjetër.
- 3) të jetë anëtar i organit administrues ose anëtar i këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrollor në shoqëri tjetër, që ka lëndë të njëjtë ose të ngjashme të punës si edhe shoqëria;
- 4) në zyrat e shoqërisë të kryej punë për llogari të vet ose të huaj.

(2) Personi fizik, para se të zgjedhet për anëtar të organit administrues, kandidati me shkrim, e njofton organin e shoqërisë të autorizuar për zgjedhjen e tij për të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet e tij në shoqëri

tjetër, të paguara apo të papaguara, të cilat i kryen për llogari personale ose për llogari të çdo personi tjetër.

(3) Kuvendi patjetër të njoftohet në seancën e parë të radhës për lejen e lëshuar nga paragrafi 1 i këtij neni.

(4) Nëse anëtari i organit të administrimit, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës vepron në kundërshtim me ndalimet nga paragrafi 1 të këtij neni, përkatësisht nëse e hesht një fakt relevant në njoftimin nga paragrafi 2 i këtij neni, shoqëria mundet:

1) të kërkojë kompensim të dëmit; ose

2) të kërkojë që shoqërisë t'ia lë punën juridike që e ka kontraktuar për llogari të vet dhe, t'ia japë dobinë e cila buron nga puna juridike, e kontraktuar për llogari të vet ose të huaj.

(5) Nëse, anëtari i organit të administrimit, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës nuk e kompenson dëmin ose nëse në dobi të shoqërisë nuk heq dorë nga puna juridike e kontraktuar për llogari të vet ose nëse dobinë që del nga puna juridike e kontraktuar për llogari të vet ose të huaj, nuk ia jep shoqërisë ose nëse shoqërisë nuk ia bart kërkesën që del nga ajo, nga anëtarët tjerë të këshillit të drejtorëve, të këshillit administrues, përkatësisht këshillit mbikëqyrës dhe secilit aksionar, mund të ngrenë aktpadi për realizimin e kërkesave nga paragrafi 4 i këtij neni.

(6) E drejta për realizim të kërkesave nga paragrafi 4 të këtij neni, parashkruhet brenda afatit prej nëntëdhjetë ditësh nga dita kur anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarët e këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht aksionari, kanë kuptuar për veprimin sipas të cilit ekziston e drejta për kompensim të dëmit, përkatësisht e drejta që shoqëria të kërkojë t'ia lë punën juridike që e ka kontraktuar për llogari të vet dhe t'ia japë dobinë që del nga puna juridike e kontraktuar për llogari të vet ose të huaj. Pas skadimit të afatit prej pesë vitesh, nga dita e shfaqjes së cenimit për ndalim, kërkesat nga paragrafi 4 të këtij neni, nuk mund të realizohen.

Kolizion interesash

Neni 349

(1) Për çdo marrëveshje ose, aktivitet tjetër afarist të shoqërisë, në të cilin shoqëria është palë dhe në të cilin anëtari i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës ka interes, bile edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, patjetër të veprohet sipas neneve 457, 459 dhe 460 të këtij ligji.

(2) Çdo anëtar i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës që ka interes, obligohet menjëherë ta denoncojë këtë.

(3) Nëse anëtari ose anëtari i interesuar i organit administrues, përkatësisht këshillit mbikëqyrës, e kupton se është përmbushur ndonjëri nga kushtet e paragrafit 1 të këtij neni, për këtë menjëherë e lajmëron këshillin e drejtorëve, përkatësisht këshillin mbikëqyrës. Anëtari i interesuar ka të drejtë të dëgjohet, por nuk mund të marrë pjesë në debat ose në vendimmarrjen në lidhje me marrëveshjen ose me punën tjetër juridike e as edhe në miratimin e vendimit për lëshimin e lejes nga neni 460, paragrafi 1 i këtij ligji.

(4) Nëse, këshilli i drejtorëve, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kuvendi nuk kanë dhënë leje ose nëse Vendimi me të cilin është dhënë leja është i paligjshëm, nuk mund të ketë kërkesa drejt personave të tretë, përveç nëse shoqëria dëshmon se personi i tretë e ka ditë mosekzistimin e lejes

ose për paligjshmërinë e Vendimit ose duke i pas parasysh të gjitha rrethanat, patjetër është dashur ta dijë këtë.

Të drejtat dhe obligimet

Neni 350

Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit administrues, përkatësisht administruesit, krahas të drejtave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj, mund të përcaktohen me marrëveshje për rregullimin e raporteve ndërmjet shoqërisë dhe anëtarit ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarit të këshillit administrues, përkatësisht administruesit. Në emër të shoqërisë, marrëveshjen me anëtarin ekzekutiv të këshillit të drejtorëve e lidhin anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, ndërkaq e firmos kryetari i këshillit të drejtorëve, ndërsa marrëveshjen ndërmjet anëtarit të këshillit administrues apo administruesit dhe shoqërisë e lidh këshilli mbikëqyrës, dhe e firmos kryetari i këshillit mbikëqyrës.

Pozita e barabartë

Neni 351

(1) Anëtarët e organit administrues, të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht administruesit, konform pozitës së tyre të përcaktuar me këtë ligj, kanë të drejta dhe obligime të njëjta, pa marrë parasysh faktin se si janë shpërndarë të drejtat dhe obligimet ndërmjet tyre në organin. Punët i kryejnë bashkërisht sipas autorizimeve të përcaktuara me këtë ligj, dhe sipas punëve që u janë besuar konform këtij ligji dhe statuti. Me statutin, mund të përcaktohet edhe mënyrë tjetër e drejtimit dhe kryerjes të këtyre punëve, por vetëm sipas autorizimeve të anëtarëve të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Aktet, përkatësisht vendimet e organit administrues, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës që janë marrë jashtë nga autorizimet e tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe sipas statutit, e obligojnë shoqërinë në raportet me persona të tretë, përveç kur personi i tretë e ka ditur ose duke i marrë parasysh rrethanat, është dashur patjetër ta dijë këtë.

(3) Organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës punon dhe vendos sipas mënyrës së përcaktuar me këtë ligj, statutin dhe sipas rregullores të tij të punës. Rregullorja e punës miratohet sipas mënyrës së përcaktuar me statutin.

Raporti për punën e shoqërisë

Neni 352

(1) Anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarët e këshillit administrues, përkatësisht administruesi, së paku një herë në tre muaj, këshillit të drejtorëve, përkatësisht këshillit mbikëqyrës i paraqesin raport në formë të shkruar për punën e shoqërisë, ndërsa, pas skadimit të vitit afarist paraqesin edhe llogari vjetore, raporte financiare vjetore dhe raport vjetor për punën e shoqërisë.

(2) Me kërkesë të anëtarëve jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarët e këshillit administrues, përkatësisht administruesi,

hartojnë raport të veçantë për gjendjen e shoqërisë apo për ndonjë çështje nga veprimtaria e tij.

(3) Anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht këshillit mbikëqyrës munden vetë ose përmes personave tjerë të ndërmarrin veprime me qëllim të këqyrjes në punën e shoqërisë dhe administrimin me të njëjtën nga ana e anëtarëve ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarëve të këshillit administrues, përkatësisht administruesit. Me kërkesën e më së paku një të tretës nga anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtarët e këshillit administrues apo administruesi, obligohen t'i përgatisin të gjitha dokumentet dhe njoftimet e nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën e tij.

(4) Secili anëtar jo ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës, për shkak të kryerjes së funksionit të vet, ka të drejtë t'i shqyrtojë të gjitha raportet, aktet dhe dokumentet të cilat anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarët e këshillit administrues, përkatësisht administruesi ua dërgojnë anëtarëve jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht këshillit mbikëqyrës.

Hartimi dhe zbatimi i vendimeve të kuvendit

Neni 353

Organi administrues, gjatë hartimit dhe zbatimit të vendimeve të kuvendit, veçanërisht e ka për obligim:

- 1) sipas kërkesës së kuvendit t'i hartojë aktet dhe vendimet e përgjithshme, miratimi i të cilave është në kompetencat e kuvendit,
- 2) t'i hartojë marrëveshjet që mund të kontraktohen vetëm me pëlqimin e kuvendit,
- 3) t'i realizojë vendimet të cilat kuvendi i miraton në kuadër të kompetencave të tij, dhe
- 4) të kryejë punë tjera të cilat me këtë ligj, i ka ndaj kuvendit dhe të cilat janë në kornizat e kompetencave të tij.

Obligimi në rast të humbjes, stërngarkimit dhe të paaftësisë për pagim

Neni 354

(1) Nëse, shoqëria gjatë punës, dhe veçanërisht nëse sipas përllogarisë tremujore apo gjysmëvjetore, përkatësisht nëse llogaria vjetore tregon humbje të re, më të madhe se 30% nga vlera e pronës së shoqërisë, respektivisht 50% nga kryegjëja bazë, anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht këshilli administrues patjetër duhet të hartojnë raport në formë të shkruar në të cilin do t'i shpjegojnë arsyet për humbjen dhe do të propozojnë masa me të cilat humbja do të mbulohet. Raporti, merr pëlqim nga këshilli i drejtorëve, përkatësisht nga këshilli mbikëqyrës. Brenda afatit prej 48 orësh, nga të kuptuarit se shoqëria ka treguar humbje, organi administrues konvokon kuvend në të cilin do t'i njoftojë aksionarët për gjendjen dhe masat e ndërmarra.

(2) Nëse shfaqet rrethanë e cila me ligj është e përcaktuar si kusht për hapjen e procedurës falimentuese, organi administrues, më së voni në afat prej 21 ditësh, nga dita e shfaqjes së kushtit për hapjen e procedurës falimentuese, konvokon kuvend në të cilin do t'i njoftojë aksionarët për

gjendjen dhe për masat e ndërmarra si edhe për masat që duhet të ndërmerren dhe të lejohen nga aksionarët e kuvendit.

(3) Pas shfaqjes së paaftësisë për pagim të shoqërisë apo stërngarkimit të saj, organi administrues nuk guxon të propozojë ose të bëjë pagesa, përveç pagesave që janë të domosdoshme për punë të rregullt të shoqërisë dhe të cilat kryhen me kujdesin e tregtarit koshient dhe të rregullt.

(4) Për dëmin e shkaktuar, anëtarët e organit administrues në mënyrë solidare u përgjigjen kreditorëve dhe aksionarëve, nëse kanë vepruar në kundërshtim me paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij ligji.

Kuorum për punë dhe për vendimmarrje

Neni 355

(1) Këshilli i drejtorëve mund të punojë dhe vendosë nëse në mbledhje janë prezent së paku gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, prej të cilëve numri i anëtarëve jo ekzekutiv prezent të këshillit të drejtorëve, patjetër duhet të jetë më i madh se numri i anëtarëve ekzekutiv prezent të këshillit të drejtorëve.

(2) Këshilli administrues ose këshilli mbikëqyrës mund të punojë dhe vendosë nëse në mbledhje janë prezent së paku gjysma e të gjithë anëtarëve të tij.

(3) Dispozita në statut që është në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, është e pavlefshme.

(4) Organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës i miraton vendimet me shumicë votash nga kuorumi i caktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, nëse me këtë ligj dhe me statutin nuk është caktuar shumicë më e madhe.

(5) Vota e kryetarit të organit administrues, përkatësisht e këshillit mbikëqyrës, por në mungesë të tij vota e kryesuesit i cili është i autorizuar nga ana e kryetarit që ta zëvendësojë, është vendimtare në rast të ndarjes së votave, përveç nëse me statut ndryshe nuk është përcaktuar.

(6) Vendimet e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre, përveç nëse me këtë ligj ndryshe nuk është përcaktuar.

Mbledhjet dhe njoftimet

Neni 356

(1) Organi administrues mban mbledhje kur këtë e imponon realizimi i punëve në kuadër të kompetencave të tij.

(2) Secili anëtar i organit administrues, me kërkesë të dorëzuar në formë të shkruar, mundet me theksimin e shkaqeve dhe qëllimit, të kërkojë nga kryetari të konvokojë mbledhje të organit administrues.

(3) Nëse anëtari i cili ka kërkuar konvokimin e mbledhjes, e ka përkrahjen e më së paku një të tretës së anëtarëve të organit administrues për konvokimin e mbledhjes, kryetari i organit administrues patjetër duhet të konvokojë mbledhje brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(4) Konvokimi i mbledhjes nga paragrafi 3 i këtij neni, bëhet me njoftimin e të gjithë anëtarëve të organit administrues, gjë që është e zakonshme për konvokimin e mbledhjeve të organit administrues, në të cilin theksohen shkaqet, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes.

Mbledhjet përmes lidhjes telefonike konferenciale

Neni 357

(1) Anëtarët e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, në mbledhje të organizuar me shfrytëzimin e lidhjes telefonike konferenciale ose me shfrytëzimin e pajisjes së komunikimit tjetër audio dhe vizuale, mund të marrin pjesë dhe të vendosin, me atë që të gjithë pjesëmarrësit që marrin pjesë në një mbledhje të organizuar në këtë mënyrë kanë mundësi të dëgjohen, të shikohen dhe të bisedojnë njëri me tjetrin, përveç nëse kjo nuk është e ndaluar me statut. Pjesëmarrja në këso mbledhje llogaritet si prezencë dhe pjesëmarrje personale e personave që janë të inkuadruar në këtë mënyrë.

(2) Pjesëmarrja në mbledhje evidentohet në procesverbalin e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, të cilin e firmosin të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhjen e organizuar sipas mënyrës nga paragrafi 1 i këtij neni.

Vendimmarrja pa mbajtjen e mbledhjes

Neni 358

(1) Me statutin, mund të parashikohet që organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës të vendosë edhe pa u mbajtur mbledhja, nëse të gjithë anëtarët e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës japin pëlqim për vendimin që miratohet pa u mbajtur mbledhja.

(2) Për të gjitha vendimet e miratuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryetari i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës apo personi fizik të cilin ai vetë do ta autorizojë, harton procesverbalin në të cilin evidentohen vendimet. Procesverbalin e firmos kryetari i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës, më së voni brenda afatit prej tridhjetë ditësh nga dita e dhënies së pëlqimit për vendimin, të cilin e kanë miratuar pa u mbajtur mbledhja.

(3) Vendimet e miratuara sipas mënyrës nga paragrafi 1 i këtij neni, hyjnë në fuqi në ditën e dhënies së pëlqimit nga paragrafi 1 i këtij neni, nga ana e të gjithë anëtarëve të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, përveç nëse në vendimin nuk është përcaktuar ndonjë moment tjetër i hyrjes në fuqi. Dhënia e pëlqimit, për propozim-vendimin, mund të realizohet me firmosje dora vetë, apo me firmosje të dërguar me faks apo përmes rrugës elektronike.

Komisione

Neni 359

(1) Organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës, mund të formojë një apo më shumë komisione nga radhët e anëtarëve të vet dhe nga persona tjerë.

(2) Komisionet nuk mund të vendosin për çështje që janë nën kompetencat e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, dhe nuk mund t'u barten të drejtat dhe obligimet e tyre.

(3) Përbërja, kushtet, përmbajtja e punës dhe mënyra e punës e këtyre komisioneve, më për së afërmi rregullohen me statut dhe me akte tjera të shoqërisë të miratuara konform statutit.

(4) Të gjitha aktivitetet e komisioneve i nënshtrohen pëlqimit nga ana e organit administrues, përkatësisht këshillit mbikëqyrës.

Procesverbali nga mbledhjet

Neni 360

(1) Për punën e secilës mbledhje të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës dhe të komisioneve, pa dallim të faktit se si është mbajtur mbledhja, hartohet procesverbal.

(2) Procesverbali patjetër duhet të hartohet brenda afatit prej tre ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes, përveç nëse me këtë ligj, ndryshe nuk është përcaktuar.

(3) Procesverbali duhet t'i përfshijë të dhënat për mënyrën se si ka punuar organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës (me mbledhje apo në mënyrë tjetër), kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, personat pjesëmarrës dhe rendi i ditës së mbledhjes, çështjet që janë objekt i votimit dhe rezultatet e çdo votimi, duke i përfshirë edhe emrat e anëtarëve të cilët kanë votuar "Për" dhe "Kundër" vendimeve të miratuara në mbledhje. Në procesverbalin mundet, sipas kërkesës të anëtarit që ka votuar "Për" dhe "Kundër" të përfshihet edhe shkaku pse ka votuar ashtu. Nëse ndonjë anëtar ka konflikt interesash, anëtari ka obligim që këtë ta paralajmërojë në fillim të mbledhjes dhe kjo të evidentohet në procesverbalin.

(4) Procesverbalin e firmosin të gjithë anëtarët e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës prezent në mbledhje. Procesverbalin e firmos edhe kryetari i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës, ndërkaq në mungesë të tij anëtari i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës i cili sipas autorizimit të kryetarit ka kryesuar me mbledhjen.

Obligimet gjatë kryerjes së autorizimeve

Neni 361

(1) Anëtari i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës, obligohet autorizimet që i janë dhënë me këtë ligj, dhe me statutin t'i kryejë në interes të shoqërisë dhe në interes të të gjithë aksionarëve me kujdesin e tregtarit të rregullt dhe koshient, dhe autorizimet e tij nuk mund t'ia bartë anëtarit tjetër të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës.

(2) Anëtarët e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës obligohen që si fshehtësi afariste t'i ruajnë të gjitha njoftimet dhe të dhënat të cilat në cilëndo qoftë mënyrë kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë, dhe të cilat i kanë pranuar si të besueshme.

(3) Obligimi nga paragrafi 2 i këtij neni, vlen edhe pas pushimit të mandatit në organin administrues, përkatësisht në këshillin mbikëqyrës,

konform obligimeve të ndërmarra nga marrëveshja për rregullimin e raporteve ndërmjet shoqërisë dhe anëtarit ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarit të këshillit administrues, përkatësisht administruesit.

(4) Obligimi nga paragrafi 2 i këtij neni, vlen edhe pas pushimit të mandatit të anëtarit të organit administrues, përkatësisht të anëtarit të këshillit mbikëqyrës.

(5) Gjatë kryerjes të obligimeve të veta, konform paragrafit 1 të këtij neni, anëtari i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës mund të mbështetet në informata, sugjerime apo në raporte të hartuara nga këshilltarë juristë të pavarur, nga kontabilistë të autorizuar të pavarur dhe nga revizorë të autorizuar dhe nga persona tjerë, për të cilët besohet se janë të besueshëm dhe kompetent për punët që i kryejnë, me çka nuk llogaritet se me këtë është i liruar nga obligimi i tij të veprojë me kujdesin e tregtarit të rregullt dhe koshient.

(6) Kufizimet e autorizimeve për përfaqësimin e anëtarëve ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të anëtarëve të këshillit administrues janë pa ndikim juridik ndaj personave të tretë edhe në rast se kufizimet janë publikuar.

Përgjegjësia për dëmin

Neni 362

(1) Nëse anëtarët e organit administrues i cenojnë obligimet e veta, përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar e japin para shoqërisë si debitorë solidar, nëse nuk kanë punuar dhe vepruar me kujdesin e tregtarit të rregullt dhe koshient. Nuk llogaritet për anëtar me përgjegjësi të organit administrues, i cili ka punuar në bazë të vendimit të kuvendit, të cilin kuvendi e ka miratuar edhe përkundër faktit se ai ua ka bërë me dije se është në kolizion me këtë ligj, si edhe anëtari i organit administrues i cili i është kundërvënë miratimit të vendimit, kështu që në procesverbalin e mbledhjes të organit administrues e ka veçuar mendimin e vetë, dhe ka votuar "kundër" vendimit.

(2) Anëtarët e organit administrues në veçanti do të llogariten si përgjegjës për dëmin nëse në kundërshtim me këtë ligj:

- 1) aksionarëve ua kthejnë atë që ata e kanë investuar në shoqërinë;
- 2) aksionarëve ua paguajnë kamatën apo dividendën;
- 3) regjistrojnë, fitojnë, marrin në peng apo nëse i tërheqin aksionet e shoqërisë;
- 4) e shpërndajnë pronën e shoqërisë;
- 5) bëjnë pagesa pas shfaqjes së paaftësisë së shoqërisë për pagim, përkatësisht pas shfaqjes së stërngarkimit të shoqërisë;
- 6) paraqesin llogari vjetore dhe raporte financiare të pavërteta;
- 7) i keqpërdorin dhe pa autorizim i përdorin mjetet e shoqërisë; dhe
- 8) gjatë zmadhimit të kushtëzuar të kryegjësë bazë lëshojnë aksione, në kundërshtim me qëllimin, ose lëshojnë aksione, para pagimit të tërësishëm të aksioneve nga misioni paraprak.

(3) Nëse anëtarët e organit administrues nuk i mënjanojnë parregullsitë nga veprimet sipas paragrafit 2 të këtij neni, aksionarët, kanë të drejtë nga anëtarët e organit administrues të kërkojnë kompensim dëmi.

(4) Nëse anëtari i organit administrues, në mënyrë të vrazhdë e cenon detyrën e vet, të veprojë me kujdesin e tregtarit të rregullt dhe koshient, kërkesë për kompensim dëmi mund të paraqesin edhe kreditorët e shoqërisë nëse nga shoqëria, kërkesat e veta nuk mund t'i përmbushin.

(5) Për dëmin e shfaqur të shoqërisë, anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen në mënyrë solidare me anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht me anëtarët e këshillit administrues, nëse gjatë dhënies së lejes paraprake nuk kanë vepruar me kujdesin e tregtarit të rregullt dhe koshient.

(6) E drejta për realizimin e kërkesës për kompensim dëmi, që është përfshirë në këtë nen, parashkruhet për pesë vite.

Revokimi i anëtarëve të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës

Neni 363

(1) Kuvendi mund t'i revokojë të gjithë anëtarët e këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht anëtarin e këtyre organeve edhe para skadimit të kohës për të cilën janë zgjedh. Për Vendimin e revokimit nevojitet shumicë votash nga aksionet me të drejtë vote, të prezantuara para kuvendit, përveç nëse me këtë ligj, ndryshe nuk është përcaktuar, përkatësisht nëse me statutin nuk është caktuar shumicë më e madhe. Me statut mund të caktohen edhe kushte tjera për miratimin e Vendimit.

(2) Anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, në çdo kohë, me ose pa arsyetim, mund të revokohet nga ana e këshillit të drejtorëve. Anëtarit ekzekutiv të revokuar i pushon cilësia e anëtarit në këshillin e drejtorëve, deri në kuvendin e radhës në të cilin do të vendoset a do të revokohet para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedh.

(3) Nëse kuvendi ka marrë Vendim për revokimin e të gjithë anëtarëve të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të organit mbikëqyrës, gjegjësisht të anëtarit të tyre, në seancën e njëjtë zgjedh anëtarë të rinj të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht anëtarin e ri në vendin e anëtarit të revokuar nëse kuvendi vendos kështu dhe nëse në kuvendin e aksionarëve, në formë të shkruar, ju dorëzohen të dhënat për kandidatët që duhet të zgjedhën.

(4) Këshilli mbikëqyrës mundet në çdo kohë, me apo pa arsyetim, t'i revokojë të gjithë anëtarët e këshillit administrues, përkatësisht anëtarin e tij. Këshilli mbikëqyrës në seancën e njëjtë zgjedh anëtarë të rinj të këshillit administrues, përkatësisht anëtar të ri në vendin e anëtarëve të revokuar, gjegjësisht të anëtarit të revokuar. Vendimi për revokim hyn në fuqi në ditën e miratimit.

(5) Anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, anëtari i këshillit administrues, përkatësisht administruesi i revokuar ka të drejtë të kërkojë kompensim dëmi nëse kështu është caktuar në marrëveshjen e nenit 350 të këtij ligji.

(6) Anëtarit të organit administrues, përkatësisht këshillit mbikëqyrës i pushon mandati edhe atëherë kur do të përmbushet kushti i përcaktuar në nenin 384, paragrafi 8 i këtij ligj.

(7) Nëse revokohet një anëtar i këshillit të drejtorëve, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës, i cili është zgjedh me votim kumulativ, anëtari llogaritet si i revokuar nëse për revokimin kanë votuar aksionarë me shumicë votash që nuk mund të jetë më pak se 90% nga aksionet me të drejtë vote të prezantuara në kuvend.

(8) Nëse kuvendi revokon më shumë se një anëtar të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, votohet për revokimin e të gjithë anëtarëve të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës. Llogaritet se anëtarët e këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës janë të revokuar, nëse për revokimin aksionarët janë deklaruar me shumicën e votave nga aksionet e prezantuara në kuvend me të drejtë vote, përveç nëse me statutin nuk është përcaktuar shumicë më e madhe. Zgjedhja e anëtarëve të rinj të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës bëhet me votim kumulativ.

(9) Vendimi i kuvendit për revokimin e këshillit të drejtorëve ose të këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht të anëtarit të tyre, hyn në fuqi në ditën e miratimit.

(10) Fletëparaqitjen për regjistrim në regjistrin tregtar të anëtarëve të zgjedhur, përkatësisht të revokuar nga organet e këtij neni, e paraqet personi i autorizuar me Vendimin për zgjedhje, përkatësisht revokim. Vendimi për regjistrim në regjistrin tregtar, në harmonizim me Vendimin e kuvendit, patjetër të nxirret brenda afatit prej 48 orësh nga paraqitja e fletëparaqitjes.

Dorëheqja

Neni 364

(1) Anëtar i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës, në çdo kohë, mund të paraqesë dorëheqje përmes parashtrimit të njoftimit në formë të shkruar pranë organit i cili e ka zgjedhur, përveç kur interesat e shoqërisë nuk imponojnë diçka tjetër.

(2) Nënshkrimi i anëtarit të organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës i kumtimit për dorëheqjen, vërtetohet te noteri.

(3) Pas dorëheqjes të paraqitur, nuk vendoset për pranimin e saj. Nëse interesat e shoqërisë e imponojnë këtë, organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës mund ta obligojë anëtarin që ka dhënë dorëheqje që të vazhdojë ta kryejë funksionin, deri në zgjedhjen e anëtarit të ri të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, por jo më gjatë se gjashtëdhjetë ditë. Llogaritet se anëtarit të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës i ka pushuar mandati në ditën e paraqitjes së njoftimit për dorëheqje, në formë të shkruar, përveç nëse në njoftimin nuk është theksuar ndonjë datë tjetër. Në bazë të njoftimit për dorëheqjen, paraqitet fletëparaqitje për shlyerjen e regjistrimit nga regjistri tregtar të anëtarit të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës i cili ka dhënë dorëheqje.

Shpërblimi i anëtarëve të organit administrues dhe të këshillit mbikëqyrës

Neni 365

(1) Kuvendi, me Vendim, e cakton paushallin mujor ose paushallin pas mbledhjes së anëtarëve joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtarët e këshillit mbikëqyrës, kanë të drejtë kompensimi edhe në të gjitha shpenzimet tjera (shpenzimet e udhëtimit dhe në shpenzime tjera), të drejtën e sigurimit të jetës dhe llojeve tjera të sigurimit si edhe të drejta tjera që janë të ndërlidhura me kryerjen e

funksionit të tyre (shfrytëzimin e zyrave të punës, mjetet e nevojshme për punë e tjerë).

(2) Anëtarët ekzekutiv dhe këshilli i drejtorëve, anëtarët e këshillit administrues, përkatësisht administruesi kanë të drejtë në rrogë, përkatësisht në kompensim mujor, të drejtë sigurimi të jetës dhe llojeve tjera sigurimi, në kompensim të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera dhe të drejta tjera.

(3) Për punën e anëtarëve ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit administrues, përkatësisht administruesit, kuvendi mundet me Vendim, t'u lejojë pjesëmarrje në fitim. Pjesëmarrja, sipas rregullës, përbëhet nga pjesëmarrja e një pjese nga fitimi vjetor i shoqërisë (pagimi në para, aksione, tantiema, bonus ose mënyra tjera). Pjesëmarrja e lejuar në fitimin vjetor të shoqërisë llogaritet në pjesën e fitimit vjetor që ngel pas zvogëlimit të fitimit të realizuar për shumën nga humbjet e përgjithshme të bartura nga vitet paraprak dhe për shumën që ndahen për rezerva ligjore dhe statusore. Vendimi që është në kundërshtim me këtë dispozitë është i pavlefshëm.

(4) Të drejtat e anëtarëve ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit administrues, përkatësisht të administruesit nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, rregullohen me marrëveshjen nga neni 350 të këtij ligji, në mënyrë përkatëse me llojin dhe vëllimin e detyrave të besuara, statusin juridik të punës dhe kontributin e tyre personal në suksesin e punës së shoqërisë.

(5) Në marrëveshjen nga neni 350 të këtij ligji, përcaktohen edhe situatat kur llogaritet se në mënyrë të dukshme është keqësuar gjendja financiare e shoqërisë, për këtë shkak të ardhurat e anëtarit të organit administrues paraqesin ngarkesë të madhe për shoqërinë, dhe për këtë kuvendi, anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht këshilli mbikëqyrës mund t'i zvogëlojnë të ardhurat e përgjithshme dhe të drejtat e tjera të anëtarit të organit administrues nga paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni. Me këtë zvogëlim të të ardhurave, raportet ndërmjet anëtarit të organit administrues dhe shoqërisë, mbesin të pandryshueshme, ndërsa anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtari i këshillit administrues mund të heq dorë nga marrëveshja dhe të japë dorëheqje edhe atë deri në fund të tremujorit të ardhshëm, me afat përjashtimi i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë ditë, përveç nëse kuvendi, anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht këshilli mbikëqyrës nuk pranon afat më të shkurtër.

(6) Mjetet që u paguhen anëtarëve të organit administrues, administruesit, përkatësisht këshillit mbikëqyrës janë shpenzime të punës së shoqërisë. Për punë veçanërisht të besuara, që për shoqërinë i ka kryer anëtari i organit administrues, përkatësisht administruesi ose anëtari i këshillit mbikëqyrës mund t'i jepet shpërblim plotësues, i cili gjithashtu paguhet në barë të shpenzimeve të punës.

(7) Shoqëria nuk mund t'i japë kredi anëtarit të organit administrues, anëtarit të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht administruesit dhe anëtarëve të familjeve të tyre më të ngushta e as anëtarit të organit administrues, këshillit mbikëqyrës, përkatësisht administruesit të shoqërisë së varur ose anëtarit të familjes të tij më të ngushtë. Me ndalimin, nuk janë përfshirë obligimet të cilat shoqëria i ka ndërmarrë me marrëveshjen nga neni 350 i këtij ligji, nëse Vendimin e konfirmon kuvendi me dy të tretat e aksioneve me të drejtë vote, të prezantuara para kuvendit.

Statusi i anëtarëve të organit administrues dhe i personave udhëheqës

Neni 366

(1) Të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës që i ka fituar anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, anëtari i këshillit administrues, përkatësisht administruesi i cili para zgjedhjes është në marrëdhënie pune me shoqërinë, të caktuara me marrëveshje pune, i pushojnë. Pushimi fillon nga dita e zgjedhjes së atij personi.

(2) Anëtari ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, anëtari i këshillit administrues, përkatësisht administruesi për kohën për të cilën është zgjedhur, përveç në rast se funksionin e kryen pa themelim të marrëdhënies së punës, të drejtat nga marrëdhënia e punës i realizon sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen për rregullimin e raporteve ndërmjet anëtarit ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarit të këshillit administrues, përkatësisht administruesit dhe shoqërisë, konform këtij ligji.

(3) Personat të cilët me Vendim të organit administrues janë cekur si persona me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta (në tekstin e mëtejme: persona udhëheqës) ndaj tyre në mënyrë përkatëse zbatohet paragrafi 1 i këtij neni. Personat udhëheqës të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës i realizojnë sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen për rregullimin e raportit ndërmjet organit administrues dhe personit udhëheqës (në tekstin e mëtejme: marrëveshje për rregullimin e raporteve me personin udhëheqës). Me marrëveshjen për rregullimin e raporteve me personin udhëheqës rregullohen: rroga, kompensimet, pjesëmarrja në fitim, kompensimi i shpenzimeve, kompensimi i sigurimit të jetës dhe llojeve tjera të sigurimit dhe të drejtave tjera nga marrëdhënia e punës. Përcaktimi i llojit dhe sasisë së të ardhurave të përgjithshme dhe të drejtave dhe obligimeve tjera nga marrëdhënia e punës të personit udhëheqës është adekuate me llojin dhe vëllimin e detyrave të besuara edhe me përgjegjësinë e personit udhëheqës si edhe me kontributin e tij personal në suksesin e punës të shoqërisë. Në emër të organit administrues, marrëveshjen me personin udhëheqës e firmos kryetari i organit administrues.

(4) Mbi anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, mbi anëtarët e këshillit administrues, përkatësisht mbi administruesit dhe personat udhëheqës nuk aplikohen dispozitat nga marrëveshjet kolektive si edhe dispozitat nga Ligji për marrëdhënie pune që kanë të bëjnë me themelimin dhe pushimin e marrëdhënies së punës, me përgjegjësinë disiplinore, me rrogën, me kompensimet dhe me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Të drejtat nga dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune, këto persona i realizojnë sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjen nga neni 350 i këtij ligji, dhe nga marrëveshja nga paragrafi 3 i këtij neni.

(5) Dispozitat nga ky nen dhe nga neni 365 i këtij ligji, në mënyrë përkatëse aplikohen edhe mbi administruesin në format tjera të shoqërive tregtare, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me marrëveshjen për shoqërinë, përveç nëse funksionin e kryejnë pa themelimin e marrëdhënies së punës.

Nënseksioni 2

SISTEMI NJË SHKALLËSH I ADMINISTRIMIT (KËSHILLI I DREJTORËVE)

Përbërja

Neni 367

(1) Këshilli i drejtorëve ka së paku tre dhe më së shumti pesëmbëdhjetë anëtarë.

(2) Kuvendi i zgjedh anëtarët e këshillit të drejtorëve.

(3) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të këshillit të drejtorëve caktohen anëtarët e zgjedhur si anëtarë të pavarur të këshillit të drejtorëve. Anëtarët e pavarur të këshillit të drejtorëve, zgjedhën nga radhët e anëtarëve joekzekutiv të këshillit të drejtorëve.

(4) Nga anëtarët e zgjedhur në këshillin e drejtorëve, këshilli i drejtorëve cakton një apo më shumë anëtarë ekzekutiv të këshillit të drejtorëve (në tekstin e mëtejme: anëtarë ekzekutiv). Për anëtar ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, nuk mund të zgjedhet anëtari nga këshilli i drejtorëve i cili është zgjedhur si anëtar i pavarur i këshillit të drejtorëve. Numri i anëtarëve ekzekutiv patjetër duhet të jetë më i vogël nga numri i anëtarëve jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve (në tekstin e mëtejme: anëtarë jo ekzekutiv).

(5) Nëse këshilli i drejtorëve ka deri më katër anëtarë jo ekzekutiv, atëherë më së paku njëri nga anëtarët jo ekzekutiv i këshillit të drejtorëve është anëtar i pavarur. Nëse këshilli i drejtorëve ka më shumë se katër anëtarë jo ekzekutiv, atëherë më së paku një e katërta nga anëtarët joekzekutiv janë anëtarë të pavarur të këshillit të drejtorëve.

Neni 367-a

(1) Anëtar i bordit të drejtorëve në shoqëri me pronësi dominante ose të tërësishme shtetërore mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën e arsimit VII/1;
- 3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon certifikatë ose dëshmi të pranuar ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, si vijon: TOEFEL IBT-së paku 30 pikë, IELTS (IELTS)-së paku 3 pikë, KET (Cambridge English)-të dhënë, BULATS (BULATS)-së paku 20 pikë, dhe
- 6) ka kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet.

(2) Anëtar ekzekutiv i bordit të drejtorëve nga paragrafi (1) të këtij neni mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën e arsimit VII/1;
- 3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, edhe atë: TOEFEL IBT-së paku 74 pikë, IELTS (IELTS)-së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal)-së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE) (Cambridge English: First)-të dhënë, BULATS (BULATS)-së paku 60 pikë ose, APTIS (APTIS)-së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka kaluar testin psikologjik dhe test për integritet.

Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve ekzekutiv

Neni 368

(1) Mënyra e zgjedhjes së anëtarit ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përcaktohet me statut. Në statut mund të përcaktohet që zgjedhja e anëtarit ekzekutiv të bëhet edhe me Vendim të njëzëshëm të të gjithë anëtarëve të këshillit të drejtorëve.

(2) Njëri nga anëtarët e këshillit të drejtorëve, i zgjedhur për anëtar ekzekutiv, mund ta mbajë titullin e zakonshëm për ushtrimin e funksionit (drejtor i përgjithshëm, gjegjësisht drejtor kryesor dhe ekzekutiv dhe titull tjetër) ndërsa anëtarët tjerë ekzekutiv mund ta mbajnë titullin e zakonshëm për ushtrimin e funksionit që i është besuar si anëtar ekzekutiv i këshillit të drejtorëve.

(3) Nëse këshilli i drejtorëve ka më shumë se një anëtar ekzekutiv, anëtarët e këshillit të drejtorëve me shumicë votash e caktojnë anëtarin ekzekutiv i cili mban përgjegjësi të veçantë për çështjet e të punësuarve dhe për raportet me ata.

Kryetari i këshillit të drejtorëve

Neni 369

(1) Këshilli i drejtorëve, nga radhët e anëtarëve jo ekzekutiv të vet, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të drejtorëve, e zgjedh kryetarin e këshillit.

(2) Këshilli i drejtorëve, në çdo kohë, mund ta shkarkojë kryetarin dhe të zgjedhë kryetar të ri.

(3) Kryetari i këshillit të drejtorëve, i konvokon dhe kryeson me mbledhjet, mban përgjegjësi për mbajtjen e evidencës të mbledhjeve dhe organizimit të mënyrave (formave) tjera të punës dhe vendimmarrjes të këshillit të drejtorëve.

(4) Nëse kryetari nga cilado qoftë shkaqe nuk është në gjendje ta ushtrojë funksionin e kryetarit ose nëse mungon, me mbledhjet e këshillit të drejtorëve kryeson anëtar tjetër jo ekzekutiv, me shumicën e votave të anëtarëve prezent të këshillit të drejtorëve.

Autorizimet e këshillit të drejtorëve

Neni 370

Këshilli i drejtorëve, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me ligj dhe statut dhe autorizimeve që në mënyrë të prerë i janë dhënë nga kuvendi, administron me shoqërinë. Këshilli i drejtorëve, ka autorizime nga më të mëdhatë në administrimin me shoqërinë, në kuadër të lëndës së punës së

shoqërisë dhe në kuadër të veprimit në të gjitha rrethanat në emër të shoqërisë, me përjashtim të autorizimeve që prerazi u janë dhënë anëtarëve jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve.

Autorizimet e anëtarëve ekzekutiv

Neni 371

(1) Me përjashtim të autorizimeve për të cilat prerazi me ligj, është caktuar se i kryen këshilli i drejtorëve, anëtarët ekzekutiv udhëheqin me punën e shoqërisë dhe kanë autorizime nga më të mëdhatë për t'i kryer të gjitha punët që kanë të bëjnë me udhëheqjen, zbatimin e vendimeve të këshillit të drejtorëve dhe kryerjen e aktiviteteve rrjedhëse të shoqërisë dhe në të gjitha rrethanat të veprojnë në emër të shoqërisë.

(2) Këshilli i drejtorëve, anëtarëve ekzekutiv ua beson përfaqësimin e shoqërisë në raportet me persona të tretë.

(3) Nëse këshilli i drejtorëve, zgjedh më shumë se një anëtar ekzekutiv, e cakton anëtarin i cili udhëheq me punën e anëtarëve ekzekutiv dhe sipas propozimit të tij këshilli i drejtorëve e përcakton organizimin e brendshëm dhe mënyrën me të cilën bëhet koordinimi i udhëheqjes së punës në shoqërinë.

(4) Këshilli i drejtorëve paraqet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të anëtarëve ekzekutiv të autorizuar për përfaqësimin e shoqërisë. Fletëparaqitjen e firmosin të gjithë anëtarët e këshillit të drejtorëve, përveç nëse anëtarët nuk i kanë dhënë autorizim në formë të shkruar, anëtarit ekzekutiv të këshillit të drejtorëve që ta firmos fletëparaqitjen. Gjatë regjistrimit në regjistrin tregtar, anëtarët ekzekutiv paraqesin nënshkrime të vërtetuara, të bashkangjitura dhe të dhëna konform nenit 65, paragrafit 2 dhe 3 të këtij ligji.

(5) Anëtarët ekzekutiv, për shkak të realizimit të autorizimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të caktojnë persona udhëheqës të cilët e bëjnë udhëheqjen e përditshme të punës së shoqërisë, konform me vendimet, kahjet dhe urdhërat e anëtarëve ekzekutiv të këshillit të drejtorëve.

Autorizimet e anëtarëve joekzekutiv gjatë kryerjes së mbikëqyrjes

Neni 372

(1) Anëtarët jo ekzekutiv, krahas autorizimeve që me këtë ligj, u janë përcaktuar në kryerjen e të drejtës për mbikëqyrje mbi udhëheqjen e punës nga ana e anëtarëve ekzekutiv, kanë të drejtë në këqyrje dhe t'i kontrollojnë librat dhe dokumentet e shoqërisë si edhe pronën, veçanërisht arkën e shoqërisë dhe letrat me vlerë dhe mallin. Anëtarët jo ekzekutiv, për kryerjen e punëve të caktuara profesionale, nga mbikëqyrja mund ta obligojnë secilin person të punësuar në shoqërinë ose person tjetër profesional.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, kryetari i këshillit të drejtorëve ose cilido qoftë anëtar jo ekzekutiv, revizori i autorizuar apo person tjetër i caktuar me statutin apo aksionarë që paraqesin më së paku një të dhjetën e aksioneve me të drejtë vote, mund të kërkojnë të konvokohet mbledhje e këshillit të drejtorëve. Kërkesa i dërgohet kryetarit të këshillit të drejtorëve.

Autorizime të cilat nuk mund të barten mbi anëtarët ekzekutivë

Neni 373

(1) Këshilli i drejtorëve nuk mund t'i bartë autorizimet mbi anëtarët ekzekutivë kur vendoset për:

- 1) mbylljen (pushimin) ose bartjen e ndërmarrjes ose së një pjese të saj që merr pjesë me mbi 10 % në të hyrat e shoqërisë;
- 2) zvogëlimin ose zgjerimin e lëndës së punës së shoqërisë;
- 3) ndryshimet esenciale organizative të brendshme të shoqërisë që përcaktohen me akt të shoqërisë;
- 4) vënien e bashkëpunimit afatgjatë me shoqëri tjera me rëndësi të veçantë për shoqërinë ose pushimin e saj;
- 5) themelimin dhe pushimin e shoqërisë tregtare, e cila merr pjesë me mbi një të dhjetën e kryegjësë bazë të shoqërisë; dhe
- 6) themelimin dhe pushimin e filialeve të shoqërisë.

(2) Me statutin mund të ndalohet bartja e autorizimeve mbi anëtarët ekzekutivë dhe për vendosjen për çështje tjera nga kompetencat e këshillit.

(3) Ndalimet e parapara me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, nuk mund të ndikojnë ndaj personave të tretë, përveç nëse shoqëria dëshmon se personi i tretë e ka ditur këtë ose duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat, doemos është dashur ta dijë këtë.

Neni 373-a

Konvokimi i mbledhjes

Këshilli i drejtorëve, gjatë vitit detyrimisht mban së paku katër mbledhje të rregullta edhe në çdo tre muaj, me atë që njëra nga ato detyrimisht duhet të mbahet në afat prej një muaji para mbajtjes së kuvendit vjetor.

Nënseksioni 3

SISTEMI DYSHKALLËSH I ADMINISTRIMIT (KËSHILLI ADMINISTRUES DHE KËSHILLI MBIKËQYRËS)

Spektori i parë

KËSHILLI ADMINISTRUES

Përbërja dhe zgjedhja

Neni 374

(1) Këshilli administrues, më së paku ka tre dhe më së shumti njëmbëdhjetë anëtarë.

(2) Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, shoqëritë që e kanë kryegjësë bazë më të vogël se 150.000 euro në kundërvlerë me denarë,

në vend të këshillit administrues mund të zgjedhin administrues, me të gjitha të drejtat dhe obligimet që i ka këshilli administrues.

(3) Këshilli mbikëqyrës i zgjedh anëtarë e këshillit administrues, përkatësisht administruesin. Me vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit administrues, njëri nga anëtarët e këshillit administrues emërohet për kryetar të këshillit administrues.

(4) Këshilli mbikëqyrës në çdo kohë mund ta shkarkojë kryetarin e këshillit administrues dhe të emërojë kryetar të ri.

(5) Asnjë person në të njëjtën kohë nuk mund të jetë anëtar i këshillit administrues, përkatësisht administrues dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës.

(6) Kryetari i këshillit administrues i konvokon mbledhjet dhe kryeson me të njëjtat dhe është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit nga mbledhjet edhe për organizimin e formave tjera, përmes së cilave këshilli administrues punon dhe vendos.

(7) Nëse kryetari, nga cilado qoftë shkaqe, nuk ka mundësi ta ushtrojë funksionin apo nëse mungon, me mbledhjet e këshillit administrues kryeson anëtar i këshillit administrues, i emëruar nga këshilli mbikëqyrës.

Neni 374-a

(1) Anëtar i këshillit drejtues të shoqërisë aksionare me pronësi dominante ose të tërësishme shtetërore mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën e arsimit VII/1;
- 3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon certifikatë ose dëshmi të pranuar ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, si vijon: TOEFEL IBT-së paku 30 pikë, IELTS (IELTS)-së paku 3 pikë, KET(KET) (Cambridge English) të dhënë, BULATS (BULATS)-së paku 20 pikë, dhe
- 6) ka kaluar testin psikologjik dhe test për integritet.

(2) Kryetar i këshillit drejtues të shoqërisë nga paragrafi (1) i këtij neni mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën e arsimit VII/1;
- 3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, si vijon: TOEFEL IBT-së paku 74 pikë, IELTS (IELTS)-së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE) (Cambridge English: First)-të dhënë, BULATS (BULATS)-së paku 60 pikë, ose APTIS (APTIS)-së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Autorizime

Neni 375

(1) Këshilli administrues, administron me shoqërinë dhe në këto suaza, e drejton punën e shoqërisë nën përgjegjësinë e vet. Këshilli administrues ka autorizime më të gjera në administrimin e shoqërisë, përkatësisht në kryerjen e të gjitha punëve që kanë të bëjnë me drejtimin e punëve dhe aktivitetëve rrjedhëse të shoqërisë dhe në emër të shoqërisë, të veprojë në të gjitha rrethanat në kuadër të lëndës së punës së shoqërisë, me përjashtim të autorizimeve, të cilat në mënyrë të prerë i janë dhënë kuvendit dhe këshillit mbikëqyrës.

(2) Të gjithë anëtarët e këshillit administrues i drejtojnë dhe i kryejnë bashkërisht punët nga paragrafi 1 të këtij neni. Me statut mund të përcaktohet edhe mënyra tjetër fare e drejtimit dhe kryerjes së këtyre punëve.

(3) Këshilli administrues, për shkak të realizimit të autorizimeve, nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të caktojë persona udhëheqës, të cilët e kryejnë udhëheqjen e përditshme të punës së shoqërisë, konform vendimeve, orientimeve dhe urdhrave të këshillit administrues.

Vendimmarrje me leje paraprake të këshillit mbikëqyrës

Neni 376

(1) Këshilli administrues, me leje paraprake të këshillit mbikëqyrës, vendos për çështjet e përcaktuara në nenin 373, paragrafi 1 të këtij ligji.

(2) Me statutin mund të përcaktohen edhe raste tjera kur për vendimet e këshillit administrues është e nevojshme leje paraprake e këshillit mbikëqyrës.

(3) Mospasja e lejes paraprake nga këshilli mbikëqyrës, nuk mund të ndikojë mbi persona të tretë.

Përfaqësimi i shoqërisë

Neni 377

(1) Anëtarët e këshillit administrues në raportet me persona të tretë e përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë, përveç nëse me statutin ndryshe nuk është përcaktuar.

(2) Këshilli administrues, me pëlqimin e këshillit mbikëqyrës, mund të autorizojë një apo më shumë anëtarë të këshillit administrues për ta përfaqësuar shoqërinë. Në këtë rast, anëtarët tjerë të këshillit administrues përjashtohen nga përfaqësimi. Autorizimi për përfaqësim në çdo kohë mund të tërhiqet nga ana e këshillit mbikëqyrës.

(3) Këshilli administrues, për anëtarët e autorizuar të këshillit administrues për përfaqësimin e shoqërisë, paraqet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar. Fletëparaqitjen e firmosin të gjithë anëtarët e këshillit administrues, përveç nëse anëtarët nuk kanë dhënë autorizim me shkrim që anëtar i këshillit administrues që ta firmosë fletëparaqitjen. Gjatë regjistrimit në regjistrin tregtar, anëtarët e këshillit administrues, të autorizuar për përfaqësim, deponojnë nënshkrime të vërtetuara, të dorëzuara dhe të paraqitura konform nenit 65, paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji.

(4) Kufizimet e autorizimeve për përfaqësimin e anëtarëve të këshillit administrues, nuk kanë veprim juridik ndaj personave të tretë.

(5) Anëtarët e këshillit administrues, të cilët e përfaqësojnë shoqërinë, mund ta mbajnë edhe titullin drejtor i përgjithshëm apo titull tjetër.

Sektori i dytë

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

Neni 378

(1) Këshilli mbikëqyrës ka më së paku tre dhe më së shumti njëmbëdhjetë anëtarë.

(2) Kuvendi i zgjedh anëtarët e këshillit mbikëqyrës. Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, caktohet se cilët anëtarët zgjedhën si anëtarë të pavarur të këshillit mbikëqyrës.

(3) Nëse këshilli mbikëqyrës ka deri katër anëtarë, më së paku njëri nga anëtarët është anëtar i pavarur. Nëse këshilli mbikëqyrës ka më shumë se katër anëtarë, më së paku një e katërta e anëtarëve të tij janë anëtarë të pavarur të këshillit mbikëqyrës.

Neni 378-a

Anëtar i këshillit mbikëqyrës në shoqëri aksionare me pronësi dominante ose të tërësishme shtetërore mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën e arsimit VII/1;
- 3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon certifikatë ose dëshmi të pranuar ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, si vijon: TOEFEL IBT-së paku 30 pikë, IELTS (IELTS)-së paku 3 pikë, KET (KET) (Cambridge English Legal)-të dhënë, BULATS (BULATS)-së paku 20 pikë, dhe
- 6) ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Kryetari i këshillit mbikëqyrës

Neni 379

(1) Këshilli mbikëqyrës, nga radhët e anëtarëve të vet, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, e zgjedh kryetarin e këshillit mbikëqyrës.

(2) Këshilli mbikëqyrës, në çdo kohë, mund ta shkarkojë kryetarin dhe të zgjedhë kryetar të ri.

(3) Kryetari i këshillit mbikëqyrës i konvokon seancat dhe kryeson me të njëjtat, mban përgjegjësinë për mbajtjen e evidencës për mbledhjet dhe

organizimin e mënyrave (formave) tjera të punës dhe të vendimmarrjen e këshillit mbikëqyrës.

(4) Nëse kryetari i këshillit mbikëqyrës, nga cilitdo qoftë shkaqe, nuk është në gjendje ta ushtrojë funksionin ose mungon, me mbledhjet e këshillit mbikëqyrës kryeson anëtar i këshillit mbikëqyrës i zgjedhur me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të këshillit mbikëqyrës.

Neni 379-a

Kryetar i këshillit mbikëqyrës në shoqëri aksionare me pronësi dominante ose të tërësishme shtetërore mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën e arsimit VII/1;
- 3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: TOEFEL IBT (TOEFL IBT)-së paku 74 pikë, IELTS (IELTS)-së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal)-së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE) (Cambridge English: First)-të dhënë, BULATS (BULATS)-së paku 60 pikë, dhe
- 6) ka të dhënë testin psikologjik dhe test për integritet.

Autorizimet e këshillit mbikëqyrës

Neni 380

(1) Këshilli mbikëqyrës ushtron mbikëqyrje mbi administrimin me shoqërinë të cilën e realizon këshilli administrues.

(2) Këshilli mbikëqyrës mund të bëjë inspektim dhe t'i kontrollojë librat dhe dokumentet e shoqërisë si edhe pronën, veçanërisht arkën e shoqërisë, letrat me vlerë dhe mallin. Këshilli mbikëqyrës, për kryerjen e punëve të caktuara profesionale, nga mbikëqyrja, mund të obligojë disa anëtarë të këshillit, revizorin e autorizuar apo persona profesionalë.

(3) Këshillit mbikëqyrës nuk mund t'i barten autorizimet që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë, përveç nëse me këtë ligj ndryshe nuk është përcaktuar. Me përjashtim, me statutin mund të përcaktohet se për disa lloje të caktuara të punëve, këshilli administrues mund të vendosë vetëm sipas pëlqimit paraprak të këshillit mbikëqyrës. Nëse këshilli mbikëqyrës refuzon të japë pëlqim, këshilli administrues, me justifikim të dorëzuar në formë të shkruar, pëlqim mund të kërkojë nga kuvendi. Vendimi, me të cilin kuvendi e jep pëlqimin, miratohet me shumicë votash, e cila nuk mund të jetë nën dy të tretat e aksioneve, me të drejtë vote, të përfaqësuara në kuvend, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe. Me statutin, mund të përcaktohen edhe kushte tjera për miratimin e vendimit.

(4) Këshilli mbikëqyrës e përfaqëson shoqërinë kundrejt anëtarëve të këshillit administrues.

Konvokimi i mbledhjeve

Neni 381

(1) Këshilli mbikëqyrës mban mbledhje nëse këtë e imponon realizimi i punëve në kuadër të kompetencave të tij.

(2) Çdo anëtar i këshillit mbikëqyrës ose i këshillit administrues, me kërkesë të parashtruar në formë të shkruar, mundet me potencimin e shkaqeve dhe qëllimit, të kërkojë nga kryetari i këshillit mbikëqyrës të konvokojë mbledhje të këshillit mbikëqyrës. Mbledhja patjetër duhet të mbahet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(3) Këshilli mbikëqyrës, përgjatë vitit, detyrimisht mban më së paku katër mbledhje të rregullta edhe atë në çdo tre muaj dhe njëra nga këto, detyrimisht duhet të mbahet brenda afatit prej një muaji, para mbajtjes së kuvendit vjetor.

(4) Përkrah obligimit për mbajtje të mbledhjeve, i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, këshilli mbikëqyrës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, të cilat i konvokon kryetari i këshillit mbikëqyrës ose të konvokohen përmes kërkesës me shkrim të ndonjërit nga anëtarët e këshillit, revizorit të autorizuar apo personit tjetër të përcaktuar në statut, aksionarët të cilët paraqesin më së paku një të dhjetën e aksioneve me të drejtë vote. Kërkesa i parashtrohet kryetarit të këshillit mbikëqyrës. Nëse kryetari nuk e konvokon mbledhjen pas kërkesës së parashtruar me shkrim, brenda afatit nga paragrafi 1 të këtij neni, anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund ta konvokojnë mbledhjen me mënyrën e përcaktuar në nenin 356, paragrafi 3 të këtij ligji.

Nënseksioni 4

KUVENDI I SHOQËRISË

Spektori i parë

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR KUVENDIN

Kuvendi

Neni 382

(1) Aksionarët të drejtat e tyre në shoqërinë i realizojnë në kuvend, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Çdo aksionari të regjistruar në librin e aksionarëve, nga dita e regjistrimit, i takon e drejta në pjesëmarrje në punën e kuvendit dhe e drejta e votës, përveç nëse me këtë ligj ndryshe nuk është përcaktuar.

(3) Anëtarët e organit administrues dhe këshillit mbikëqyrës, pa të drejtë vote marrin pjesë në punën e kuvendit, përveç nëse nuk janë aksionarë.

Kompetencat e kuvendit

Neni 383

(1) Kuvendi vendos vetëm për çështje të përcaktuara me këtë ligj dhe statutin në mënyrë të prerë, e veçanërisht për:

1) ndryshimin e statutit;

- 2) miratimin e llogarisë vjetore, raporteve financiare dhe raporteve vjetore për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist dhe vendimmarrjen për shpërndarjen e fitimit;
- 3) zgjedhjen dhe konvokimin e anëtarëve të këshillit të drejtorëve dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;
- 4) pëlqimin e punës dhe udhëheqjen e punës me shoqërinë të anëtarëve të organit administrues dhe të këshillit mbikëqyrës;
- 5) ndryshimin e të drejtave që kanë të bëjnë me gjini të caktuara dhe aksioneve me klasë;
- 6) zmadhimin dhe zvogëlimin e kryegjësë bazë të shoqërisë;
- 7) lëshimin e aksioneve dhe letrave tjera me vlerë;
- 8) caktimin e revizorit të autorizuar për revizion të llogarisë vjetore dhe raporteve financiare nëse shoqëria e ka për obligim t'i përpilojë;
- 9) transformimin e shoqërisë në shoqëri me formë tjetër si edhe për ndryshimet statusore të shoqërisë; dhe
- 10) pushimin e shoqërisë.

(2) Kuvendi, në rast kur Qeveria e Republikës së Maqedonisë është themelues i shoqërisë, krahas çështjeve nga paragrafi (1) i këtij neni jep pëlqim për aktin për përcaktim të lartësisë së pikës për përlogaritje të rrogave të të punësuarve në shoqërinë aksionare.

(3) Kuvendi zgjedh kryesuesin që do të kryesojë me seancën e kuvendit, personin që do ta mbajë procesverbalin dhe dy aksionarë që do ta verifikojnë procesverbalin, përveç nëse procesverbalin nuk e mban noter. Kuvendi zgjedh edhe komisionin për zbatimin e votimit të fshehtë dhe persona tjerë fizikë (numëruar të votave dhe të tjerë), nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e punëve tjera, të cilat e mundësojnë zhvillimin pa pengesë të punës së kuvendit, në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe statutin.

(4) Nëse kuvendi vendos për ndryshimin e të dhënës, e cila konform nenit 298 të këtij ligji, evidentohet në regjistrin tregtar, procesverbalin e mban noter.

(5) Kuvendi nuk mund të vendosë për çështje nga sfera e administrimit, përkatësisht nga sfera e udhëheqjes me punën e shoqërisë, që janë nën kompetencat e organit administrues, përveç nëse me këtë ligj ndryshe nuk është përcaktuar.

Kuvendi vjetor

Neni 384

(1) Kuvendin vjetor e konvokon organi administrues më së voni tre muaj pas përpilimit të llogarisë vjetore, raporteve financiare dhe raportit vjetor për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist dhe jo më vonë se gjashtë muaj nga mbarimi i vitit kalendarik ose 14 muaj nga mbajtja e kuvendit të fundit vjetor.

(2) Në kuvendin vjetor:

- 1) shqyrtohet dhe miratohet llogaria vjetore, raportet financiare dhe raporti vjetor për punën e shoqërisë në vitin afarist paraprak;
- 2) vendoset për përdorimin e fitimit të pastër apo për mbulimin e humbjes; dhe
- 3) lejohet puna e anëtarëve të organit administrues dhe këshillit mbikëqyrës.

(3) Nëse organi administrues në kohë nuk e konvokon kuvendin vjetor, kuvendin, pa prolongim, e konvokojnë anëtarët jo ekzekutivë të këshillit të

drejtorëve, përkatësisht këshilli mbikëqyrës.

(4) Nëse kuvendin vjetor nuk e konvokojnë anëtarët jo ekzekutivë të këshillit të drejtorëve, përkatësisht, këshilli mbikëqyrës ose nëse nga cilado qoftë shkaqe tjera, nuk mbahet në afatin e përcaktuar të paragrafit 1, të këtij neni, vendim për konvokim të kuvendit vjetor, mund të miratojë gjykata sipas propozimit të cilitdo qoftë aksionari.

(5) Kuvendi vjetor, pas mbarimit të vitit afarist, detyrimisht vendos për pëlqimin e punës dhe për udhëheqjen e punës së shoqërisë nga ana e anëtarëve të organit administrues dhe për punën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Për pëlqimin e punës së anëtarëve të organeve të shoqërisë votohet veç e veç, për çdo anëtar të organit.

(6) Debati dhe pëlqimi për punën e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht për mënyrën e udhëheqjes së punës së shoqërisë, patjetër duhet të jetë e lidhur me debatin për llogarinë vjetore, raportet vjetore dhe raportin vjetor për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist.

(7) Në raportin vjetor për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist, organi i administrimit ka për obligim që objektivisht t'i prezantojë dhe t'i sqarojë faktorët kryesorë dhe rrethanat që kanë ndikuar në përcaktimin e punës, duke i përfshirë edhe ndryshimet në mjedisin në kuadër të të cilit shoqëria vepron, veprimi i shoqërisë në ato ndryshime dhe ndikimi i tyre, politika e investimeve për mbajtje dhe për përkrahje të suksesit në punën e shoqërisë, duke e përfshirë edhe politikën e dividendave, burimet e mjeteve të shoqërisë, politika e raportit ndaj borxhit afatgjatë ndaj kryegjësë bazë dhe politika e menaxhimit me rrezikun, transaksionet e mëdha dhe transaksionet me palën e interesuar me të dhëna të paraqitura për lartësinë e shumës së transaksioneve, që janë kryer në bazë të transaksionit me palën e interesuar dhe mënyra dhe procedura në të cilën është lejuar transaksioni me palën e interesuar, emri, mbiemri dhe adresa me palën e interesuar nëse është person fizik, ose emri dhe selia nëse pala e interesuar nëse është person juridik, si dhe mjetet e shoqërisë vlere të cilave nuk është e shprehur në bilancin e gjendjes sipas standardeve ndërkombëtare për njoftim financiar, gjasat për zhvillimin e ardhshëm të shoqërisë dhe punës së saj afariste, aktivitetet në sferën e hulumtimit dhe zhvillimit, si dhe informatat lidhur me fitimin e pjesëve dhe aksioneve të veta, varësisht nga rrethanat relevante. Në raportin vjetor të shoqërisë publikohen edhe të ardhurat e secilit anëtar ekzekutiv të këshillit të drejtorëve dhe të anëtarit të këshillit drejtues (rroga, kompensimet e rrogës, bonusi, sigurimet dhe të drejtat e tjera), përkatësisht kompensimi e anëtarëve jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve dhe të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Në Raportin vjetor të shoqërisë në mënyrë të obligueshme shpallen edhe të dhënat e hollësishme për të ardhurat në shoqëri tjera (rrogë, kompensime të rrogave, kompensime për anëtarësim, bonus, sigurime dhe të drejta tjera) për anëtarët ekzekutivë të këshillit të drejtorëve, anëtarët e këshillit drejtues, anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nëse të njëjtit janë anëtarë në organet drejtuese të shoqërive tjera. Në raportin vjetor të shoqërisë në mënyrë të obligueshme shpallen edhe të dhëna të hollësishme për punësim (emri i punëdhënësit, veprimtaria, lartësia e rrogës, kompensimet e rrogës, bonus, sigurime dhe të drejta tjera) për anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, anëtarëve të këshillit drejtues, anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nëse të njëjtit kanë themeluar marrëdhënie pune të punëdhënësit tjerë.

(8) Nëse kuvendi vjetor nuk jep pëlqim për punën e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës apo të disa nga anëtarët e këtyre organeve, në seancën e njëjtë, kuvendi mund të vendosë t'i qaset zgjedhjes të të gjithë anëtarëve të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës apo drejt zgjedhjes së anëtarëve të rinj të këtyre organeve, në vendin e atyre të cilëve kuvendi nuk u ka dhënë pëlqim për punë. Kuvendi mund të vendosë që anëtarët e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, të cilëve ua ka dhënë pëlqimin për punë, të vazhdojnë t'i kryejnë punët e shoqërisë që nuk mund të shtyhen deri në zgjedhjen e përbërjes së plotë të këtyre organeve e që bëhet në seancë të vazhduar, e cila mbahet në afat jo më të shkurtër se tetë ditë dhe jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë ditë nga dita e shpalljes së datës, në të cilën do të vazhdojë seanca e kuvendit vjetor. Dita e mbajtjes së seancës së vazhduar, shpallet në gazetë ditore.

(9) Vendimi për dhënien e pëlqimit të punës, për të gjithë anëtarët e organit administrues, përkatësisht të organit mbikëqyrës, nuk e përjashton të drejtën të kërkohej kompensim në dëm.

(10) Dispozitat nga ky ligj, me të cilat rregullohet kuvendi, aplikohen edhe në kuvendin vjetor, përveç nëse me këtë ligj, ndryshe nuk është përcaktuar.

Sektori i dytë

KONVOKIMI DHE MBAJTJA E KUVENDIT

Konvokimi i kuvendit

Neni 385

(1) Kur këtë e kërkon interesi i shoqërisë dhe i aksionarit, në kohën ndërmjet dy kuvendeve vjetore, mund të konvohet kuvendi.

(2) Organi administrues, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht anëtarët jo ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, me shumicën e votave të anëtarëve të vet, kur kjo është e paraparë me këtë ligj, me iniciativë të vet ose me kërkesë të aksionarit mund të marrin vendim për konvokimin e kuvendit.

(3) Kërkesë për konvokimin e kuvendit mund të parashtrojnë aksionarë që kanë më së paku një të dhjetën e të gjitha aksioneve me të drejtë vote. Në kërkesën që e parashtrojnë në formë të shkruar, aksionarët që kërkojnë konvokimin e kuvendit, doemos duhet ta potencojnë qëllimin dhe shkaqet për konvokimin e kuvendit, emrin dhe mbiemrin e vet, vendin e banimit dhe NUAQ-në, përkatësisht firmën dhe selinë e NUAS nëse aksionari është person juridik. Me kërkesën aksionarët paraqesin edhe certifikatë nga libri i aksionarëve të lëshuar nga Depozitari qendror për letra me vlerë, në të cilën është theksuar numri i aksioneve me të drejtë vote, të cilat i posedojnë në shoqërinë.

(4) Kërkesa i parashtrohet organit administrues në selinë e shoqërisë. Kërkesa mund të përfshihet në një dokument ose në dy apo më shumë dokumente të firmosura nga aksionarët, të cilët kanë më së paku një të dhjetën e numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote.

(5) Organi administrues, brenda afatit prej tetë ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës së aksionarëve për konvokimin e kuvendit, merr vendim për pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në vendimin për refuzimin e kërkesës,

patjetër duhet të theksohen arsyet për shkak të të cilave është vendosur kështu.

(6) Nëse kërkesa e aksionarëve, të cilët e kanë shumicën nga të gjitha aksionet me të drejtë vote, organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës, nuk konvokon kuvend brenda afatit prej 24 orësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, aksionarët pranë gjykatës, mund të paraqesin propozim për konvokim të kuvendit.

Konvokimi i kuvendit në bazë të vendimit të gjykatës

Neni 386

(1) Nëse organi administrues, këshilli mbikëqyrës, përkatësisht anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, nuk marrin vendim në afatin nga paragrafët 5 dhe 6 të nenit 385 ose nuk e pranojnë kërkesën për konvokimin e kuvendit, gjykata, sipas propozimit, mund të marrë vendim që të konvokohet kuvendi.

(2) Gjykata, brenda afatit prej tetë ditësh, nga dita e paraqitjes së propozimit nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse janë plotësuar kushtet, mënyra dhe procedimi për konvokimin e kuvendit të përcaktuara me këtë ligj, merr vendim për konvokimin e kuvendit dhe nëse çështjet e propozuara të rendit të ditës, janë në kompetenca të kuvendit sipas këtij ligji ose sipas statutit.

(3) Në vendimin për thirrjen e kuvendit nga paragrafi (2) të këtij neni, gjykata urdhëron thirrjen e kuvendit dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete, që janë të domosdoshme për realizimin e qëllimeve për të cilat thirret kuvendi, duke përfshirë edhe përcaktimin e personit i cili do ta thirr kuvendin. Personi i përcaktuar nga gjykata e cakton kohën dhe vendin e mbajtjes së kuvendit, datën për evidencën e aksionarëve të cilët kanë të drejtë vote dhe parashtron kërkesa të shoqëria aksionare e cila kuoton në bursë, përkatësisht shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë, ka obligime të veçanta për njoftim për shpalljen e thirrjes së kuvendit, në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë dhe në faqen zyrtare të internetit të bursës në të cilën kuotojnë aksionet e shoqërisë, si dhe veprimet tjera të nevojshme për thirrje dhe mbajtje të suksesshme të mbledhjes së kuvendit të shoqërisë. Shoqëria aksionare dhe bursa janë të obliguara që pa prolongim dhe në kohë t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e nevojshme, në pajtim me dispozitat e këtij ligji për thirrjen e mbledhjes së kuvendit dhe shpalljen e saj në internet, drejtuar atyre nga personi i cili e thirr kuvendin. Personi për ndërmarrjen e veprimeve për thirrjen e kuvendit, mundet të shfrytëzojë edhe shërbime të avokatit.

(4) Kuvendi konvokimi i të cilit do të urdhërohet me vendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, konvokohet më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të miratuar gjyqësor me të cilin urdhërohet konvokimi i kuvendit, te personi i caktuar nga ana e gjyqit që do ta konvokojë kuvendin.

(5) Shpenzimet rreth mbajtjes së kuvendit si edhe shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet për shërbimet e avokatit nga paragrafi (3) i këtij neni, nëse gjykata e lejon kërkesën, bien mbi barrë të shoqërisë. Nëse gjykata e refuzon kërkesën, të gjitha shpenzimet bien mbi barrë të propozuesit.

Ftesë dhe thirrje publike për konvokimin e kuvendit

Neni 387

(1) Kuvendi mund të konvokohet me ftesë ose me thirrje përmes shpalljes publike ose me ftesë dhe me thirrje përmes shpalljes publike deri te aksionarët.

(2) Kuvendi konvokohet me dërgimin e ftesës deri te të gjithë aksionarët, aksionet e të cilëve u japin të drejtë pjesëmarrjeje në punën e kuvendit që konvokohet. Ftesa dërgohet sipas certifikatës nga libri i aksionarëve, e cila nuk është më e vjetër se tri ditë nga dita e dërgimit të ftesës.

(3) Thirrja publike për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit, shpallet në gjysmë faqe në më së paku një gazetë ditore, që del në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me obligime të veçanta, për njoftim duhet ta shpallin përmbajtjen e thirrjes publike edhe në faqen e parë të internet-faqes së tyre zyrtare, ndërsa kur aksionet e tyre kuotojnë në bursë, ta parashtrojnë për shpallje edhe në faqen e internetit të bursës.

(4) Dërgimi i ftesës bëhet në atë mënyrë, që mundëson verifikimin e datës së dërgimit dhe datë së pranimit nga secili aksionar.

(5) Afati që rrjedh nga dita e shpalljes së thirrjes publike, përkatësisht nga dita e dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në kuvend, deri në ditën e mbajtjes së kuvendit, nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë deri në ditën e mbajtjes së kuvendit.

(6) Organi administrues e cakton ditën (datën e evidentimit) që do ta shfrytëzojë për dërgimin e ftesave, sipas certifikatës nga libri i aksionarëve, që nuk mund të jetë më i gjatë se tri ditë.

(7) Kuvendi mund të miratojë vendim për thirrjen e mbledhjes së kuvendit e cila nuk është mbledhje e rregullt vjetore, në një nga mënyrat e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, në afat i cili nuk mund të jetë më vonë nga dita e katërmëdhjetë para ditës në të cilën duhet të mbahet mbledhja e kuvendit, nëse shoqëria ka vendosur ose shfrytëzon sistem elektronik me të cilin i mundësohet çdo aksionari që të votojë në mënyrë elektronike. Vendimin për thirrjen e mbledhjes së kuvendit, kuvendi i shoqërisë e miraton me shumicë votash të cilat nuk mund të jenë më pak se dy të tretat nga aksionet me të drejtë vote, të paraqitura në kuvend dhe afati për vlefshmërinë e tyre nuk mund të jetë më vonë nga mbajtja e mbledhjes së parë të ardhshme vjetore të kuvendit të shoqërisë.

(8) Nëse mbledhja e kuvendit e cila është thirrur në mënyrë siç është përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni, nuk mbahet për shkak të mospasjes së kuorumit, në afat i cili nuk është më i gjatë se 15 ditë nga dita në të cilën duhej të mbahej mbledhja e rregullt e thirrur e kuvendit, caktohet datë e re për mbajtjen e kuvendit (mbledhje e prolonguar e kuvendit). Thirrja e mbledhjes së prolonguar të kuvendit si dhe çdo thirrje e ardhshme, mund të jetë në afat i cili është i ndryshëm nga afati i përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni, me kusht që të mos jetë vënë pikë e re në rendin e ditës dhe nëse kanë kaluar së paku dhjetë ditë, nga data kur është bërë thirrja e fundit dhe data kur duhej të mbahej mbledhja e kuvendit.

(9) Shpenzimet për shpalljen e thirrjes publike, gjegjësisht për dërgimin e ftesave për thirrjen e mbledhjes së kuvendit të shoqërisë, bien në llogari të shoqërisë.

Përmbajtja e ftesës, përkatësisht e thirrjes publike

Neni 388

(1) Ftesa, përkatësisht thirrja publike për konvokimin e kuvendit i përmban të dhënat si vijojnë:

- 1) firmën dhe selinë e shoqërisë;
- 2) vendin dhe datën e mbajtjes së kuvendit;
- 3) formalitetet tjera të procedimit; të përcaktuara me statut, që kanë rëndësi për praninë në kuvend dhe për mënyrën e votimit;
- 4) rendin e ditës, sipas të cilit do të punojë kuvendi; dhe
- 5) mënyrën, me të cilën kanë qasje materialet që janë të përgatitura për kuvendin e konvokuar.

(2) Me statut mund të përcaktohen edhe të dhënat tjera, të cilat duhet t'i përmbajë ftesa, përkatësisht thirrja publike, që kanë rëndësi për realizimin e të drejtave të aksionarëve në lidhje me konvokimin dhe mbajtjen e kuvendit.

(3) Nga dita e dërgimit të ftesës, përkatësisht shpalljes së thirrjes publike aksionarët, doemos duhet të kenë qasje deri te materialet.

Përmbajtja e ftesës përkatësisht e thirrjes publike të shoqërisë aksionet e së cilës kuotojnë në bursë përkatësisht të shoqërisë, e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me obligime të veçanta për njoftim

Neni 388-a

(1) Në thirrjen publike përkatësisht në ftesën për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit të shoqërisë, aksionet e së cilës kuotojnë në bursë përkatësisht mbledhjes së kuvendit të shoqërisë e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me obligime të veçanta për njoftim, shënohet data dhe ora e mbajtjes së mbledhjes, shënohet vendi i mbajtjes së mbledhjes dhe paraqitet rendi i propozuar i ditës së mbledhjes së kuvendit.

(2) Thirrja publike përkatësisht ftesa për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit të shoqëritë nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban përshkrim të procedurave sipas së cilave aksionarët marrin pjesë dhe votojnë në seancën e kuvendit, ndërsa veçanërisht për atë se si:

- 1) aksionarët mundet të përfshijnë pika në rendin e ditës së kuvendit dhe të propozojnë vendime me informatën për atë se si të njëjtën mund ta bëjnë, pasi që do t'u dorëzohet ftesa përkatësisht pasi që të shpallet thirrja, si aksionarët mund t'i parashtrojnë pyetje shoqërisë për pikat e rendit të ditës në mbledhjen e kuvendit dhe me informatën për afatin deri kur atë mund ta bëjnë. Me përjashtim, thirrja publike përkatësisht ftesa mund t'i përmbajë vetëm afatet e fundit deri kur mund të propozohen pikat e rendit të ditës, parashtrojnë pyetje përkatësisht të propozohen vendime nëse në ftesë përkatësisht në thirrjen publike, është e shënuar faja zyrtare e internetit të shoqërisë, me udhëzim se në të njëjtën mund të gjenden informata detajore për mënyrën e propozimit të pikave të rendit të ditës, parashtrimi të pyetjeve dhe propozimit të vendimeve nga ana e aksionarëve;
- 2) zhvillohet procedura për votim nëpërmjet të autorizuarit, si do t'u bëhen të arritshëm formularët për votim nëpërmjet të autorizuarit të aksionarëve, kur shoqëria ka përgatitur formularë të atillë, informata për atë sesi shoqëria është e përgatitur që t'i pranojë njoftimet-elektronike nga ana e aksionarëve, për autorizimet e dhëna të autorizuarve dhe
- 3) zhvillohet procedura për votim me korrespondencë ose elektronik, kur shoqëria mundëson votim të atillë.

(3) Në thirrjen publike përkatësisht në ftesën për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit të shoqërisë nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të jetë e shënuar adresa e faqes zyrtare të internetit të shoqërisë, në të cilën do të jenë të kapshme informatat nga neni 388-b nga ky ligj.

Informatat të cilat duhet të shpallen në faqen e internetit të shoqërisë aksionet e së cilës kuotojnë në bursë, përkatësisht të shoqërisë e cila në pajtim me Ligjin e letrave me vlerë është me obligime të veçanta për njoftim për kohën e thirrjes së mbledhjes së kuvendit të shoqërisë

Neni 388-b

(1) Në periudhën e cila nuk mund të fillojë më vonë nga dita e 21-të para ditës së mbajtjes së mbledhjes së kuvendit të shoqërisë, si dhe në ditën e mbajtjes së mbledhjes së kuvendit, shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë, përkatësisht shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me obligime të veçanta për njoftim në faqen e vet të internetit, i shpall së paku informatat në vijim:

- 1) përmbajtjen e thirrjes publike përkatësisht ftesës, për thirrjen e mbledhjes së kuvendit të shoqërisë;
- 2) numrin e përgjithshëm të aksioneve dhe numrin e përgjithshëm të të drejtave votuese të cilat dalin nga aksionet me të drejtë vote, në ditën e shpalljes së thirrjes publike përkatësisht në ditën e dërgimit të ftesës, duke e përfshirë edhe numrin e përgjithshëm të aksioneve nga secili lloj dhe klasë;
- 3) dokumentet dhe materialet të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë;
- 4) vendimet e propozuara për miratim ose ku të atilla nuk janë propozuar, mendimet e organit të autorizuar ose trupit të shoqërisë për çdo pikë nga rendi i propozuar i ditës, i mbledhjes së kuvendit të shoqërisë;
- 5) vendimet e propozuara nga aksionarët, të cilat shoqëria menjëherë pasi që t'i pranojë duhet t'i shpallë dhe
- 6) formularët për votim nëpërmjet të autorizuarit dhe formularët për votim me korrespondencë, të përgatitura për marrje elektronike nga ana e aksionarëve. Në rast se shoqëria e aksionarëve nuk i bën formularët të arritshëm për marrje elektronike nga faqja e saj e internetit, atëherë në të njëjtën faqe shoqëria shpall sesi formularët mund të merren në formën e shkruar dhe me shpenzimin e vet, e me kërkesë të aksionarit i dorëzon formularët.

(2) Në rast se thirrjet mbledhje e kuvendit të shoqërisë në bazë të nenit 387 paragrafit (7) të këtij ligji, ndërsa thirrja publike është shpallur gjegjësisht ftesa është dërguar më vonë nga dita e njëzetënjëtë para ditës të mbajtjes së mbledhjes, afati nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet në pajtim me nenin 387 paragrafi (7) të këtij ligji.

Mënyrat e njoftimit, dërgimit dhe pranimit të materialeve dhe informatave tjera

Neni 389

(1) Nëse më këtë ligj dhe me statut është përcaktuar të kryhet njoftimi, përkatësisht dërgimi i materialeve dhe informatave tjera prej shoqërisë deri te aksionarët dhe shoqëria, kjo doemos duhet të bëhet përmes

dërgesës së rekomanduar, telegramit, faksit, postës elektronike apo përmes gazetës ditore.

(2) Njoftimi, përkatësisht dërgesa e materialeve dhe informatave tjera nga paragrafi 1 i këtij neni, prej shoqërisë deri te aksionarët llogaritet se është realizuar nëse:

- 1) është dërguar me dërgesë të rekomanduar apo me telegram, përmes postës, në vendin e banimit të paraqitur nga ana e aksionarit në Depozitarin qendror të letrave me vlerë; ose
- 2) është dërguar përmes faksit, postës elektronike, apo në postë elektronike, e paraqitur nga ana e aksionarit; ose
- 3) është shpallur në gazetë ditore.

(3) Njoftimi, përkatësisht dërgimi i materialit dhe informatave tjera, nga paragrafi 1 i këtij neni, nga shoqëria deri te aksionarët, llogaritet se është pranuar:

- 1) kur ka arritur në vendin e banimit të aksionarit dhe kur është regjistruar në librin e aksionarëve;
- 2) kur personalisht ka qasje, përkatësisht është pranuar nga personi i autorizuar i shoqërisë, anëtarit të organit administrues, përkatësisht nga aksionari që është person fizik;
- 3) kur është pranuar përmes rrugës elektronike, në të cilën mund të konfirmohet dërgesa dhe pranimi; dhe
- 4) në ditën e cekur në vërtetimin për dorëzimin e dërgesës së rekomanduar apo dërgesës së telegramit, përfshirë edhe rastet e dërgesës respektivisht telegramit, të dërguar, por të papranuar dhe të pa ngritur.

(4) Njoftimi, përkatësisht dërgesa e materialit dhe informatave tjera nga aksionari deri te shoqëria llogaritet se është pranuar:

- 1) kur ka arritur në selinë e shoqërisë, e cila është regjistruar në regjistrin tregtar;
- 2) kur personalisht është pranuar nga personi i autorizuar i shoqërisë, përkatësisht nga anëtar i organit administrues;
- 3) kur është pranuar përmes rrugës elektronike, ku mund të konfirmohet dërgesa dhe pranimi; dhe
- 4) në ditën e cekur në vërtetimin për dorëzimin e dërgesës së rekomanduar apo për dërgimin e telegramit, përfshirë edhe rastet e dërgesës së rekomanduar, përkatësisht telegramit të dërguar, por të papranuar dhe të pa ngritur.

Rendi i ditës dhe inkuadrimi i pikave të reja në rendin e ditës

Neni 390

(1) Kuvendi mund të vendosë vetëm për çështje, të cilat në mënyrë të rregullt janë vënë në rend dite.

(2) Kuvendi mund të debatojë pa të drejtë për vendosje, edhe për çështje të cilat në mënyrë të rregullt nuk janë vënë në rend dite.

(3) Çdo aksionar në çdo kohë ka të drejtë të paraqesë iniciativë për inkuadrimin e pikave në rendin e ditës në kuvendin, i cili do të konvokohet.

(4) Aksionarët të cilët individualisht ose bashkërisht posedojnë së paku 5% nga numri i përgjithshëm i aksioneve më të drejtë vote, mund të propozojnë plotësim të rendit të ditës me kërkesë për futjen e pikave të reja, nëse në të njëjtën kohë parashtrojnë edhe arsyetim për pikën e propozuar për plotësimin e rendit të ditës, ose nëse propozojnë vendim

për pikën e propozuar. Propozimin e pikave në rendin e ditës, shoqëritë mund ta mundësojnë që të kryhet me mjete elektronike.

(5) Aksionarët të cilët individualisht ose bashkërisht posedojnë 5% nga numri i përgjithshëm të aksioneve më të drejtë vote, kanë të drejtë që me shkrim të propozojnë për miratim vendime për secilën nga pikat, të cilat janë të përfshira ose do të përfshihen në rendin e ditës të mbledhjes së kuvendit të shoqërive. Propozimin e vendimeve shoqëritë mund ta mundësojnë që të kryhet edhe me mjete elektronike.

(6) Kërkesa për futjen të një ose më shumë pikave në rendin e ditës të kuvendit që është thirrur dhe/ose propozimi i vendimeve për miratim, dorëzohet te organi për udhëheqjen e shoqërisë, gjegjësisht te thirrësi i kuvendit i përcaktuar nga gjyqi, në pajtim me këtë ligj në afat prej tetë ditësh nga dita kur është dorëzuar ftesa gjegjësisht nga dita kur është shpallur thirrja publike për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit të shoqërisë.

(7) Kërkesa për inkuadrimin e një apo më shumë pikave në rendin e ditës të kuvendit, i cili është konvokuar, nuk mund të refuzohet përveç në rastet:

- 1) nëse aksionari, përkatësisht nëse aksionarët e kanë lëshuar afatin nga paragrafi (6) i këtij neni,
- 2) nëse aksionari, përkatësisht aksionarët nuk posedojnë numër të mjaftueshëm të aksioneve me të drejtë vote në shoqëri, konform paragrafit 4 nga ky nen;
- 3) nëse propozimi nuk i përmbushë kushtet tjera të parapara me këtë ligj; dhe
- 4) nëse pika, përkatësisht pikat të cilat kërkohen të inkuadrohen në rendin e ditës së kuvendit, nuk janë në kompetencat e kuvendit ose nuk janë në harmoni me ligjin dhe statutin.

(8) Nëse kërkesa nga paragrafi 6 i këtij neni nuk është vënë në rendin e ditës, përveç në rastet nga paragrafi 7 i këtij neni, vendim përfundimtar lidhur me kërkesën merr kuvendi gjatë miratimit të rendit të ditës.

(9) Kërkesën për inkuadrimin e një apo më shumë pikave në rendin e ditës të kuvendit të konvokuar organi që e ka konvokuar kuvendin, përkatësisht personi i përcaktuar nga gjykata që ta konvokojë kuvendin, e dërgon deri te të gjithë aksionarët, përkatësisht e publikon në mënyrë të njëjtë siç i ka dërguar ftesat, përkatësisht thirrjen publike për pjesëmarrje në kuvendin e konvokuar, më së voni tetë ditë para ditës së mbajtjes së tij.

(10) Atje ku realizimi i së drejtës së aksionarëve nga paragrafi (4) dhe paragrafi (5) të këtij neni, tërheq ndryshime të rendit të ditës në mbledhjen e kuvendit që tanimë u është dorëzuar/shpallur aksionarëve, shoqëria e vë në disponim rendin e ditës të reviduar, në të njëjtën mënyrë si rendin paraprak të ditës, para datës së mbajtjes të mbledhjes së kuvendit të shoqërisë. Rendi i ditës i reviduar është vendosur në mënyrë të rregullt në disponim, nëse aksionarët me kohë do të mund të autorizojnë përfaqësues ose të votojnë me korrespondencë.

Paraqitja dhe evidenca për pjesëmarrje në kuvend

Neni 391

(1) Çdo aksionar, i cili ka qëllim të marrë pjesë në kuvend të konvokuar, obligohet ta paraqesë pjesëmarrjen e tij në kuvend (fletëparaqitje për pjesëmarrje në kuvend) më së voni para fillimit të seancës në kuvendin e

konvokuar. Listën e aksionarëve të paraqitur e përgatit organi administrues, përkatësisht personi i autorizuar për konvokimin e kuvendit.

(2) Lista e aksionarëve të paraqitur nga paragrafi 1 i këtij neni, në selinë e shoqërisë vihet në këqyrje.

(3) Para fillimit të mbajtjes së kuvendit, organi administrues, përkatësisht personi i autorizuar për konvokimin e kuvendit e krahason listën e aksionarëve të paraqitur sipas gjendjes në librin e aksionarëve të pranuar nga Depozitari qendror të letrave me vlerë dyzetë e tetë orë para mbajtjes së seancës kuvendore.

(4) Para fillimit të mbajtjes së kuvendit, listën nga paragrafi 3 të këtij neni, e firmos secili nga aksionarët e pranishëm, përkatësisht i autorizuari nga aksionari, me çka e verifikon praninë e tij në kuvend (pjesëmarrës i verifikuar në kuvend). Listën e firmosur, me nënshkrimin e vet e vërtetojnë kryesuesi i kuvendit dhe mbajtësi i procesverbalit. Pas vërtetimit të listës, kryesuesi i kuvendit e konstaton kuorumin e punës.

(5) Lista, e vërtetuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, para votimit të parë u jepet në këqyrje të gjithë pjesëmarrësve në kuvend. Çdo pjesëmarrës i verifikuar i kuvendit mund të kërkojë ekzemplar të listës së firmosur, me shpenzime të veta, të cilat mund të jenë më të mëdha nga shpenzimet reale.

Pjesëmarrja e aksionarëve në mbledhje të kuvendit me mjete elektronike të shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë, gjegjësisht shoqëria e cila në përputhshmëri me Ligjin për letra me vlerë është me obligim të veçantë për të njoftim

Neni 391-a

(1) Shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me obligim të posaçëm për njoftim, mund t'u mundësojnë aksionarëve së paku një nga mënyrat vijuese, për pjesëmarrje në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë me mjete elektronike:

- 1) transmetim të drejtpërdrejtë të kuvendit;
- 2) komunikim dykatësh audiovizuel të drejtpërdrejtë, i cili aksionarëve u mundëson që t'i drejtohen kuvendit nga cilido vend i largët dhe
- 3) mjetet elektronike për votim, para ose gjatë kohëzgjatjes së kuvendit edhe pa nevojë autorizimi të përfaqësuesit, i cili fizikisht do të merrte pjesë në mbledhje.

(2) Shoqëritë nga paragrafi (1) i këtij neni që aksionarëve u mundësojnë që të marrin pjesë në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë në mënyrë siç është e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, doemos duhet të kenë vendosur sistem për regjistrim dhe evidencë elektronike të aksionarëve për identifikimin e tyre dhe ruajtjen e sigurisë së lidhjes elektronike, gjatë pjesëmarrjes së aksionarëve në kuvend në njërin nga mënyrat të përcaktuara me paragrafin (1) të këtij neni, dhe me atë rast nuk guxojnë të kërkojnë nga aksionarët që të dorëzojnë dokumente të verifikuara te noteri ose të vërtetuara nga organi tjetër kompetent i vendit ose i huaj.

(3) Shoqëritë nga paragrafi (1) i këtij neni në shpenzim të vet, janë të detyruar që të sigurojnë përkthyes gjyqësor të autorizuar nga gjuha maqedonase në gjuhën angleze dhe nga anglishtja në gjuhën maqedonase, atje ku në mbledhjen e kuvendit pjesëmarrje kanë

paralajmëruar aksionarët të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë.

E drejta për të parashtruar pyetje

Neni 391-b

(1) Secili aksionar ka të drejtë që të parashtrojë pyetje për secilën nga pikat e rendit të ditës, të mbledhjes së kuvendit të shoqërisë.

(2) Shoqëria nëpërmjet organit të tij të autorizuar ose përfaqësuesit, është e detyruar që të përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga aksionarët.

(3) E drejta për të parashtruar pyetje nga aksionarët dhe obligimi i shoqërisë që të përgjigjet në pyetjet e parashtruara, mundet paraprakisht të kushtëzohet nga nevoja e vërtetimit të identitetit personal të aksionarëve që kanë parashtruar pyetje, mbajtja e rendit gjatë kryesimit dhe punës së kuvendit, ose ndërmarrja e aktiviteteve për ruajtjen e fshehtësisë së punës dhe interesave afariste të shoqërisë.

(4) Shoqëria mund të japë një përgjigje përmbledhëse të pyetjeve me përmbajtje të njëjtë.

(5) Pyetjet e parashtruara nga aksionarët, konsiderohen se janë të përgjigjura nëse pyetjet janë të arritshme në faqen e internetit të shoqërisë, në formë të pyetjes dhe përgjigjes.

(6) Shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me detyrë të veçantë për njoftim, është e detyruar që përgjigjet e pyetjeve të parashtruara në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë, t'i shpallë në faqen e saj të internetit në formë të pyetjes dhe përgjigjes.

I autorizuari i aksionarit të kuvendit

Neni 392

(1) Aksionari mund të autorizojë me autorizim person tjetër fizik ose juridik si autorizues të tij në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë (në tekstin e mëtutjeshëm: i autorizuari), i cili do të marrë pjesë dhe do të votojë në mbledhjen e kuvendit në emër të tij. I autorizuari i gëzon të drejtat e njëjta si aksionari nga i cili është i autorizuar me autorizim, duke e përfshirë që të paraqitet për fjalë, të diskutojë dhe të parashtrojë pyetje në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë.

(2) Aksionari doemos duhet që ta informojë shoqërinë aksionare me shkrim, për përcaktimin e autorizuesit të tij në mbledhje të kuvendit të shoqërisë.

(3) Atje ku autorizimi nuk përmban kufizime ose instruksione për votim, i autorizuari mund të votojë sipas përcaktimit të tij, por çdo herë duke i marrë parasysh interesat e aksionarit i cili e ka autorizuar.

(4) Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, autorizimi për të autorizuarin në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë, jepet në formë të shkruar dhe të verifikuar te noteri.

(5) Te shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë gjegjësisht shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me detyrë të veçantë për njoftim, autorizimi për të autorizuarin në mbledhjen e kuvendit të

shoqërisë, jepet në mënyrë siç është e përcaktuar në nenet 392-b dhe 392-v të këtij ligji.

(6) Autorizimi ka vlefshmëri deri në revokimin e tij, por jo më gjatë se dy vjet nga dita e dhënies së tij.

(7) I autorizuari mund të marrë autorizim nga një ose më shumë aksionarë dhe numri i aksionarëve të cilët mund të autorizojnë person të njëjtë për autorizues, nuk është i kufizuar.

(8) I autorizuari doemos duhet të mbajë shënime për instruksionet e marra për votim nëse ka pasur të atilla dhe t'i ruajë së paku një vit nga dita e mbajtjes së mbledhjes së kuvendit të shoqërisë, në të cilin ai ka marrë pjesë dhe ka votuar, si dhe të dëshmojë se i ka zbatuar ato instruksione nëse atë ia kërkon shoqëria ose aksionari nga i cili ka marrë autorizim;

(9) Kur i autorizuari është i autorizuar nga disa aksionarë, ai mund të veprojë dhe të votojë për një aksionar të caktuar më ndryshe, se për aksionarin tjetër.

(10) Autorizimi mund të anulohet njëanshëm, pa i paraqitur arsyet nga aksionari ose nga i autorizuari, me dorëzim të njoftimit me shkrim nga pala tjetër. Nëse aksionari personalisht e evidenton pjesëmarrjen e tij në mbledhjen e kuvendit me të gjitha aksionet që i posedon dhe deklaron se do të debatojë vet, vendos dhe voton me të gjitha aksionet të cilat i posedon, konsiderohet se autorizimi për atë mbledhje të kuvendit të autorizuarit i është anuluar dhe aksionari mund të drejtën e tij të votës ta realizojë personalisht dhe pa kufizim.

Konflikt i interesave tek i autorizuari

Neni 392-a

(1) Shoqëria nuk guxon që t'i kufizojë personat të jenë të autorizuar në kuvend, vetëm kur te ata ekziston gjendje e konfliktit të interesave, sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(2) Gjendja e konfliktit të interesit, ekziston kur ka rrezik që personi të ketë interes të ndryshëm nga interesi i aksionarit nga i cili e ka marrë autorizimin që të jetë i autorizuari i tij, sidomos në rast kur personi është:

1) anëtar i organit udhëheqës, gjegjësisht anëtar i organit të mbikëqyrjes të shoqërisë, duke i përfshirë edhe anëtarët nga familja e tij më e ngushtë;

2) anëtar udhëheqës në shoqëri ose anëtar i familjes së tij më të ngushtë;

3) anëtar i organit drejtues, gjegjësisht i organit mbikëqyrës, i punësuar ose revizor i autorizuar i shoqërive të lidhura ose të varura me shoqërinë, duke i përfshirë edhe anëtarët e familjes së tij më të ngushtë;

4) përfaqësues në bazë të ligjit ose person tjetër fizik i autorizuar nga shoqëria, ose nga personi tjetër juridik që është në pronësi të shoqërisë dhe

5) i punësuar ose revizor i autorizuar në shoqëri.

(3) Në rastin kur ekziston konflikt i interesit sipas dispozitave nga paragrafi (2) i këtij neni, personi nuk mund të jetë i autorizuar.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, për të autorizuar të kuvendit të shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe të shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me detyrime të veçanta për njoftim, mund të jenë të autorizuar personat të cilët kanë konflikt të

interesit sipas paragrafi (2) të këtij neni, vetëm me kusht nëse ata:

1) paraprakisht ua kanë bërë të njohur aksionarëve se te ata ka konflikt të interesit dhe

2) kanë marrë instruksione konkrete për votim në formë të shkruar nga aksionarët nga të cilët janë autorizuar që të jenë të autorizuar të tyre për secilin vendim të propozuar për votim për pikat e rendit të ditës, në mbledhjen e kuvendit për të cilën u vlen autorizimi.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, personat juridikë mund të autorizojnë me autorizim personin i cili është i anëtar i organit të tyre udhëheqës ose është i punësuar te ata, që të marrë pjesë dhe të votojë në mbledhjen e kuvendit.

(6) Secili mund ta njoftojë shoqërinë nga paragrafi (4) i këtij neni, për ekzistimin e konfliktit të interesit te cilido person i cili ka marrë autorizim nga aksionari. Organi udhëheqës ose këshilli mbikëqyrës i shoqërisë pas marrjes së informatës për ekzistimin e konfliktit të interesit te një person, detyrimisht doemos duhet ta provojë atë informatë dhe të kërkojë nga personi për të cilin shoqëria është njoftuar se te ai ekziston konflikt i interesit, që t'i bëjë të njohura të gjitha informatat në lidhje me ekzistimin e mundshëm të gjendjes së atillë.

(7) Shoqëria nga paragrafi (4) i këtij neni, pa prolongim në faqen e vet të internetit i shpall identitetin dhe arsyet për ekzistimin e konfliktit të interesit te të autorizuarit.

(8) Autorizimi i dhënë në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, personit te i cili ekziston konflikt i interesit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, vlen nga dita kur do të shpallet identiteti i personit me arsyen për ekzistimin e konfliktit të interesit, në faqen e internetit të shoqërisë.

(9) Veprimet e realizuara nga të autorizuarit te të cilët ka ekzistuar konflikti i interesit, por i njëjti paraprakisht nuk u është bërë i ditur aksionarëve nga të cilët kanë qenë të autorizuar si të autorizuar, si dhe shoqërisë, do të konsiderohen si persona të cilëve nuk i është dhënë autorizimi.

Autorizimi i të autorizuarve me shkrim te shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe te shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë, është me obligime të veçanta për njoftim.

Neni 392-b

(1) Aksionarët mund të autorizojnë përfaqësues në mbledhje të kuvendit të shoqërisë, me dhënie të autorizimit në formë të shkruar pa obligim për ta verifikuar autorizimin te noteri, në shoqërinë aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe në shoqërinë e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me obligime të veçanta për njoftim. Aksionarët duhet menjëherë ta njoftojnë shoqërinë për secilin autorizim të dhënë në formë të shkruar. Aksionari i cili nuk do ta njoftojë shoqërinë për autorizimin e dhënë, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë autorizimin.

(2) Nëse shoqëria nga paragrafi (1) i këtij neni, ka përcaktuar formular për dhënie të autorizimit në formë të shkruar, atëherë formulari duhet të dërgohet me shpenzim të shoqërisë personalisht te secili aksionar, ose të bëhet e arritshme për marrje nga faqja e internetit e shoqërisë, në mënyrë që aksionarët të kenë mundësi ta marrin në mënyrë elektronike që ta shtypin, plotësojnë dhe nënshkruajnë. Kur aksionarët nga cilado arsye,

teknikisht nuk mund ta marrë formularin për dhënie të autorizimit, nga faqja e internetit e shoqërisë ose nëse i është dërguar personalisht me postë ndërsa formularin nuk e ka pranuar, ai mund të shfrytëzojë edhe lloje tjera të formularëve për dhënie të autorizimit në formë të shkruar.

(3) Shoqëria nga paragrafi (1) i këtij neni, është e detyruar që ta pranojë autorizimin e dhënë në formë të shkruar, nëse ka qenë i njoftuar me shkrim nga aksionari dhënës i autorizimit. Shoqëria mund të kërkojë vërtetimin e identitetit personal të aksionarit, si kusht për pranimin e autorizimit gjegjësisht për verifikimin e instruksioneve për votim nëse të atilla i janë dhënë të autorizuarit, mirëpo nuk guxon të kërkojë që autorizimi të verifikohet te noterit, ose të vërtetohet nga organi kompetent i vendit ose i huaj, si kusht për pranimin e autorizimit gjegjësisht instruksioneve për votim.

(4) Dispozitat e këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për heqjen e autorizimit me shkrim.

Autorizimi i të autorizuarve në formë elektronike të shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe të shoqëria e cila në bazë të Ligjit për letra me vlerë është me detyra të veçanta për njoftim

Neni 392-v

(1) Aksionarët në shoqërinë aksionet e së cilës kuotojnë në bursë dhe shoqërinë e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me detyra të veçanta për njoftim, mund të autorizojnë përfaqësues dhe/ose të njëjtëve t'u japin instruksione për votim në mënyrë elektronike.

(2) Shoqëritë nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të detyruar që aksionarëve t'ua sigurojnë shfrytëzimin e sistemit elektronik nëpërmjet të cilit aksionarët do të mund të regjistrohen, të autorizojnë përfaqësues të vet dhe të njëjtëve t'u japin instruksione për votim në mbledhjen e kuvendit të shoqërisë.

(3) Dispozitat e këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në heqjen e autorizimit në mënyrë elektronike.

Kuorumi i punës së kuvendit

Neni 393

(1) Kuvendi mund të punojë (kuorumi i punës) nëse në seancë marrin pjesë pjesëmarrës të verifikuar të kuvendit, të cilët posedojnë më së paku shumicën e numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe.

(2) Nëse në kuvend nuk sigurohet kuorumi nga paragrafi 1 i këtij neni, kuvendi nuk mund të fillojë me punë. Koha që nuk është më e gjatë se pesëmbëdhjetë ditë nga dita e konvokimit të mbajtjes së kuvendit, i cili nuk ka pasur kuorum për punë, konvokohet termin i ri për mbajtjen e kuvendit (kuvend i rikonvokuar), i cili mbahet brenda këtij afati. Termini i ri për mbajtjen e kuvendit të rikonvokuar, publikohet në mënyrë, në të cilën është publikuar konvokimi i kuvendit, i cili nuk ka pasur kuorum për punë.

(3) Pjesëmarrja në kuvendin e rikonvokuar, nuk paraqitet rishtas. Para se të fillohet me punë, në kuvendin e rikonvokuar i qasen nënshkrimet të

listës, me çka secili pjesëmarrës e verifikon praninë e tij në kuvendin e rikonvokuar. Listën e firmosur me nënshkrimin e vet, e vërteton kryesuesi i kuvendit dhe mbajtësi i procesverbalit. Pas vërtetimit të listës, kryesuesi bashkë me kuvendin e konstaton praninë e aksionarëve të paraqitur, përkatësisht të autorizuarve të tyre, përkatësisht kuorumin për punë të kuvendit.

(4) Çdo pjesëmarrës i verifikuar në kuvendin e rikonvokuar mund të kërkojë ekzemplar nga lista e firmosur në shpenzim të vetë.

(5) Në kuvendin e rikonvokuar mund të vendoset vetëm për çështje të caktuara me rendin e ditës për konvokimin e parë të kuvendit, pa marrë parasysh numrin e aksionarëve të pranishëm dhe numrin e aksioneve që i kanë. Në kuvendin e rikonvokuar nuk mund të vendoset për çështje të cilat, sipas këtij ligji, vendoset me shumicë më të madhe nga shumica e kuorunit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Shumica me të cilën vendoset në kuvend

Neni 394

Vendimet e kuvendit, miratohen me shumicë të aksionarëve me të drejtë vote të përfaqësuar në kuvend, përveç nëse me këtë ligj dhe statutin nuk është përcaktuar shumicë më e madhe apo nuk janë caktuar kushte tjera në aspektin e shumicës, me të cilën miratohen vendimet e kuvendit.

Udhëheqja me kuvendin

Neni 395

(1) Me seancën e kuvendit kryeson kryesuesi (në tekstin e mëtejme: kryesues i kuvendit). Kryesuesi i kuvendit e përcakton radhitjen e punëve dhe e mban rendin e seancës së kuvendit, ndërkaq mund të caktojë rregulla për udhëheqjen e seancave të kuvendit.

(2) Kryesuesi i kuvendit zgjedhet për secilin kuvend të radhës.

(3) Mandati i kryesuesit me kuvendin zgjat deri në zgjedhjen e kryesuesit në kuvendin e radhës, i cili duhet të mbahet.

(4) Për kryesues të kuvendit mund të zgjedhet çdo aksionar apo person, i cili përfaqëson aksionarin. Për kryesues të kuvendit nuk mund të zgjedhet personi i organit administrues apo anëtar i këshillit mbikëqyrës.

Vazhdimi i seancës së ndërprerë të kuvendit

Neni 396

(1) Nëse vjen deri te ndërprerja e seancës së kuvendit, e cila ka filluar me punë, aksionarët e pranishëm në seancën e kuvendit mund të vendosin që kuvendi të vazhdojë me punë në kohën dhe vendin që përcaktohet me shumicën e votave nga kuorumi për punë i kuvendit, përveç nëse me statutin nuk është paraparë shumicë më e madhe (vazhdimi i seancës së ndërprerë të kuvendit). Prolongimi nuk mund të jetë më i gjatë se tetë ditë nga dita e ndërprerjes.

(2) Nëse vjen deri te ndërprerja e seancës së kuvendit, e cila ka filluar me punë, ndërkaq kuvendi nuk ka marrë vendim për vazhdimin e punës, konform paragrafit 1 të këtij neni, kryesuesi i kuvendit e cakton kohën dhe

vendin e vazhdimin të seancës kuvendore të ndërprerë, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Pjesëmarrja në vazhdimin e seancës së ndërprerë të kuvendit nuk paraqitet rishtazi. Aksionari, i cili nuk e ka paraqitur pjesëmarrjen në kuvend, seanca e të cilit është ndërprerë, ka të drejtë ta paraqesë praninë e vet para fillimit të seancës së vazhduar, sipas gjendjes në librin e aksionarëve. Në fillimin e punës së seancës së vazhduar të kuvendit, fillohet rishtas me firmosjen e listës të aksionarëve të paraqitur, përkatësisht të të autorizuarve me çka çdo pjesëmarrës e verifikon praninë e vet në vazhdimin e seancës së ndërprerë të kuvendit. Listën e firmosur, me nënshkrimin e vet, përsëri e vërteton kryesuesi i kuvendit dhe mbajtësi i procesverbalit. Pas vërtetimit të listës, kryesuesi i kuvendit e konstaton kuorumin e punës të vazhdimin të seancës së ndërprerë të kuvendit.

(4) Lista e vërtetuar nga paragrafi 3 i këtij neni, para votimit të parë u jepet në shikim të gjithë pjesëmarrësve në vazhdimin e seancës së ndërprerë të kuvendit. Çdo pjesëmarrës i verifikuar i kuvendit mund të kërkojë ekzemplar të listës së firmosur në shpenzimin e vet.

(5) Nëse në seancën e vazhduar të kuvendit nuk ka kuorum për punë apo ajo nuk mbahet brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, konvokohet kuvend i ri sipas kushteve, mënyrës dhe procedurës të përcaktuara me këtë ligj dhe statutin.

(6) Vendimet e marra në kuvend, i cili pas fillimit të punës e ka ndërprerë punën, pa marrë parasysh se a do të fillojë me punë, llogariten si të plotfuqishme. Në seancën, në të cilën kuvendi ka vazhduar me punë, kuvendi debaton dhe vendos vetëm për pikat që nuk janë shqyrtuar dhe për të cilat nuk është vendosur.

Kushtet për realizimin e të drejtës së votës

Neni 397

(1) E drejta e votës fitohet me pagimin e plotë të depozitit monetar, përkatësisht me futjen e plotë të depozitit jomeonetar.

(2) Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, me statutin mund të përcaktohet që e drejta e votës të fitohet edhe kur për aksionet do të paguhet shuma më e vogël e depozitit të përcaktuar me ligj ose me statut. Për aksionin, për të cilin do të paguhet shuma më e vogël e depozitit të përcaktuar me ligj dhe statut, fitohet e drejta në një votë. Për depozitimet më të mëdha raporti i të drejtave të fituara përcaktohet proporcionalisht në shumën e asaj që është paguar. Në këto raste, pjesët e votave grupohen vetëm në vota të plota.

(3) Nëse me statut nuk është përcaktuar se e drejta e votës fitohet para pagimit të plotë të depozitit, ndërsa asnjë aksion nuk është paguar në tërësi, e drejta e votës përcaktohet proporcionalisht në shumën e depozitimeve të paguara. Gjatë kësaj pagese e shumës më të vogël të depozitit e jep të drejtën e një vote. Në këto raste, pjesët e votave merren parasysh vetëm atëherë nëse aksionarit, i cili ka të drejtë vote i japin vota të plota.

(4) Dispozitat në statutin e shoqërisë nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, që aplikohen vetëm në aksionarë të caktuar apo në aksione në gjini aksionesh të caktuara janë të pavlefshme.

Realizimi i të drejtës në votë në raste të caktuara

Neni 398

(1) Me dhënien peng të aksioneve, aksionari nuk e humb të drejtën e votës.

(2) Për aksionet në pronë të të miturit ose të personit tjetër të paaftë për punë, të drejtën e votës e realizon përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht tutori, personalisht ose përmes të autorizuarit, i përcaktuar me autorizim në formë të shkruar, i vërtetuar te noteri.

(3) Për aksionet, në pronë të personit të vdekur, deri në përfundimin e procedurës së trashëgimisë, të drejtën e votës e realizon përfaqësuesi i përbashkët i caktuar nga trashëgimtarët e të vdekurit me autorizim në formë të shkruar i vërtetuar te noteri.

(4) Për shoqërinë në likuidim apo falimentim, e cila ka aksione në person tjetër juridik, voton likuiduesi, përkatësisht administruesi për falimentim ose nga ato i autorizuari i caktuar me autorizim në formë të shkruar i vërtetuar te noteri.

Kufizime gjatë realizimit të së drejtës së votës

Neni 399

(1) Në kuvend, aksionari nuk mund të votojë për vendim që personalisht atë e liron nga obligimi, nga ndonjë kërkesë që shoqëria e ka ndaj atij, apo nga përgjegjësia ose kur i pranohet ndonjë përparësi ose privilegj në llogari të shoqërisë, përkatësisht kur votohet për vendim që të ngritët procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër kundër tij, përveç nëse me këtë ligj ndryshe nuk është përcaktuar. Në këto raste, aksionari nuk mund ta realizojë të drejtën e votës as ai vetë personalisht e as përmes personit të autorizuar.

(2) Dispozitat në statut që janë në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, llogariten si të pavlefshme.

(3) Nëse aksionari vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, përgjigjet për dëm, të cilin do ta pësojë shoqëria, përveç nëse dëshmon se mazhoranca do të arrihet edhe pa votën e tij.

(4) E pavlefshme është marrëveshja me të cilën aksionari obligohet ta realizojë të drejtën e votës sipas udhëzimit të organit administrues ose të këshillit mbikëqyrës. E pavlefshme është edhe marrëveshja, me të cilën aksionari obligohet të votojë për secilin propozim të organit administrues ose të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë.

Mënyra e votimit të kuvendit

Neni 400

(1) Nëse me ligj dhe me statut ndryshe nuk është përcaktuar, ndërsa vetë kuvendi nuk përcakton mënyrë të veçantë të votimit ose votim të fshehtë, mënyrën e votimit e përcakton kryesuesi i kuvendit. Për numërimin e votave, kuvendi zgjedh më së paku një numërues votash.

(2) Për të gjitha zgjedhjet të anëtarit të organit administrues të shoqërisë, përkatësisht për anëtarët e këshillit mbikëqyrës ose për revokimin e

anëtarëve të këtyre organeve, votimi është i fshehtë, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar që votimi të jetë publik.

(3) Nëse me statutin është përcaktuar që në kuvend aksionarët të votojnë publikisht, sipas kërkesës të njërit ose më shumë aksionarëve, të cilët kanë më së paku një të dhjetën nga numri i përgjithshëm i aksioneve me të drejtë vote në këtë rast i qaset votimit të fshehtë.

(4) Me statut, mund të përcaktohet mënyra, me të cilën aksionarët mund të votojnë në kuvend të konvokuar përmes telefonit ose përmes mjetit tjetër përkatës elektronik, që është pjesë e rrjetit të komunikimit publik dhe përmes të cilit në mënyrë të sigurt mund të verifikohet identiteti i çdo aksionari, e drejta e votës, mënyra e vendosjes së lidhjes së komunikimit ndërmjet shoqërisë dhe aksionarëve edhe atë në mënyrën që në votim do të ketë qasje çdo aksionar dhe do të me siguri do të mund të evidentohet votimi i realizuar. Aksionari, i cili voton përmes telefonit ose përmes mjetit tjetër elektronik, llogaritet si pranishëm në kuvend, përkatësisht e përbënë kuorimin e punës dhe kuorumin e vendimmarrjes në kuvend.

(5) Nëse në mënyrë të sigurt nuk mund të caktohet identiteti i çdo aksionari, mënyra e vendosjes së linjës së komunikimit ndërmjet shoqërisë dhe aksionarit dhe nëse në votim nuk ka qasje çdo aksionar dhe nëse me siguri nuk mund të evidentohet kuorumi dhe votimi i realizuar, votimi është i pavlefshëm.

Votimi me korrespondencë

Neni 400-a

(1) Shoqëria mund t'u mundësojë aksionarëve që të votojnë me korrespondencë para ditës së mbajtjes së kuvendit.

(2) Shoqëria, para se t'u mundësojë aksionarëve që të votojnë me korrespondencë, mund të kërkojë që paraprakisht ata ta vërtetojnë identitetin e tyre personal, duke parashtruar dokumente për identifikim personal në origjinal ose përkopim nga origjinali, sipas zgjedhjes së aksionarëve dhe pa obligim të aksionarëve që ta verifikojnë te noteri, ose të vërtetohet nga organi kompetent i vendit ose i huaj. Shoqëria e cila ka vendosur sistem të evidencës dhe regjistrimit të brendshëm të aksionarëve, i cili të njëjtëve u është i arritshëm, mund ta zbatojë atë sistem si mjet për identifikimin e aksionarëve.

(3) Votimi me korrespondencë që është realizuar në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni, është i pavlefshëm.

Mënjanimi i pengesave të caktuara për realizimin efektiv të të drejtave të votës

Neni 400-b

(1) Personi juridik ose fizik i cili është aksionar në përputhshmëri me dispozitat të këtij, ligji mund të ndërmarrë veprime gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij për llogari të personit tjetër fizik apo juridik (në tekstin e mëtutjeshëm: klienti). Personi i cili ndërmerr veprime në emër të një ose më shumë klientëve, ia bën të ditur shoqërisë identitetin e secilit klient të vet dhe numrin e aksioneve të drejtën e votës të së cilave e realizon për llogari të secilit klient, si dhe përmbajtjen e autorizimit dhe instruksionet për votim, nëse instruksione të atilla ka pranuar nga klienti. Shoqëria nuk

mund të kërkojë verifikim te noteri ose vërtetim nga organi i vendit ose i huaj, të dokumenteve me të cilat do të kryhet njoftimi.

(2) Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni kanë të bëjnë edhe me bankat, shtëpitë brokere dhe personat tjerë fizikë dhe juridikë të cilët në pajtim me ligjin mund të jenë pronarë të llogarive të letrave me vlerë dhe të kryejnë shërbime të ruajtjes së letrave me vlerë dhe menaxhimit me portofolin e letrave me vlerë, nëse klienti ua ka besuar në menaxhim dhe disponim letrat e tij me vlerë dhe realizimin e të drejtave nga ato letra me vlerë.

(3) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të votojë ndryshe për disa aksione me të drejtë vote nga aksionet tjera me të drejtë vote, për llogari të klientit të njëjtë.

Mënyra e zbatimit të votimit të fshehtë

Neni 401

(1) Votimin e fshehtë e zbaton komisioni për zbatimin e votimit të fshehtë, i zgjedhur me vendim të kuvendit, përveç nëse me stautin ndryshe nuk është përcaktuar. Komisioni patjetër duhet të përbëhet prej më së paku tre anëtarëve nga radhët e aksionarëve. Në komisionin nuk mund të zgjedhet aksionar, përkatësisht person tjetër, i cili është anëtar i organit administrues i shoqërisë, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës e as kryesuesi i kuvendit, në të cilin realizohet votimi i fshehtë. Komisioni për zbatimin e votimit të fshehtë obligohet të punojë në mënyrë të paanshme dhe të drejtë.

(2) Komisioni e përcakton përmbajtjen e fletëvotimeve, kujdeset për shumimin e fletëvotimeve, i shënon numra fletëvotimeve, i numëron votat dhe dërgon raport të shkruar për votimin e zbatuar të fshehtë, me të cilin konfirmon se sa fletë janë përdorur për votimin e zbatuar të fshehtë, sa fletëvotime mbeten të pashfrytëzuara dhe i verifikon rezultatet e votimit. Raporti për votimin e zbatuar të fshehtë e firmosin të gjithë anëtarët e komisionit.

(3) Fletëvotimi doemos duhet t'i përmbajë emrat dhe mbiemrat e të gjithë kandidatëve që zgjedhën me votim të fshehtë.

(4) Kur realizohet votimi i fshehtë, fletëvotimi doemos duhet t'i përmbajë çështjet për të cilat do të votohet, opsionin e votimit "Për", "Kundër", "I përmbajtur", për secilin çështje ose grup çështjesh ose opsion tjetër i qartë si edhe sqarimi për mënyrën, me të cilën realizohet votimi i fshehtë.

(5) Fletëvotimet (të përdorura dhe të papërdorura), raporti për votimin e zbatuar dhe materiali tjetër zgjedhor ruhen në mënyrë të njëjtë si edhe procesverbalet e kuvendit.

Përcaktimi i rezultateve nga votimi

Neni 401-a

(1) Shoqëria është e detyruar që për secilin vendim për të cilin është votuar në mbledhje të kuvendit të shoqërisë, ta përcaktojë numrin e përgjithshëm të aksioneve për të cilat janë dhënë vota të vlefshme, numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme dhe pjesën nga kryegjësja themelore të cilën e përfaqësojnë ato dhe numrin e votave të dhëna "për", "kundër" dhe "të përmbajtur" për secilin vendim që është lëndë e votimit në kuvend.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) të këtij neni, nëse asnjë nga aksionarët nuk jep vërejtje në votim, gjegjësisht nuk kërkon raport të tërësishëm për rezultatet e votimit, shoqëria mund t'i përcaktojë rezultatet nga votimi vetëm deri në shkallën e nevojshme që të tregohet se shumica e nevojshme për secilin vendim është arritur.

(3) Në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes së kuvendit, shoqëria aksionet e së cilës kuotojnë në bursë, gjegjësisht shoqëria e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me detyra të veçanta për njoftim, është e detyruar që në faqen e saj të internetit t'i shpallë rezultatet nga votimi, në mënyrë siç është përcaktuar me paragrafin (1) të këtij neni.

Hyrja në fuqi e vendimeve të kuvendit

Neni 402

Vendimet e kuvendit hyjnë në fuqi në ditën e miratimit, përveç nëse në vendimet nuk është caktuar datë tjetër e hyrjes në fuqi.

Kuvendi i veçantë dhe votimi i ndarë

Neni 403

(1) Kur me vendim të kuvendit, përkatësisht me vendim për ndryshimin e statutit, ndryshohet, përkatësisht kufizohet cilado qoftë e drejtë e lidhur për ndonjë gjini aksionesh, ai vendim llogaritet si i plotfuqishëm nëse aksionarët që e përfaqësojnë gjininë përkatëse të aksioneve mbështesin miratimin e vendimit për pajtueshmëri me shumicën e përcaktuar në këtë ligj dhe në statutin.

(2) Aksionarët nga paragrafi 1 i këtij neni, marrin vendim për pajtueshmëri të seancës së ndarë të këtyre aksionarëve (kuvend i veçantë) ose në kuvend të njëjtë me aksionarët e tjerë, por me votim të ndarë (votim i ndarë), përveç nëse me ligj, ndryshe nuk është përcaktuar. Për konvokimin e seancës së ndarë në kuvend të veçantë dhe për pjesëmarrjen në të, për të drejtën e kumtimit si edhe për miratimin e vendimeve të veçanta, vlejné dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e kuvendit. Konvokim të kuvendit të veçantë apo votimit të ndarë mund të kërkojnë aksionarë, të cilët kanë më së paku një të dhjetën nga numri i përgjithshëm i aksioneve të cilët mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e vendimit për pajtueshmëri.

Të drejtat e aksioneve me prioritet pa të drejtë vote

Neni 404

Nëse shuma që duhet të paguhet nga dividendat për aksionet me prioritet, pa të drejtë vote, nuk është paguar ose tërësisht nuk është paguar për një vjet dhe nëse kjo nuk paguhet në mënyrë plotësuese në vitin e ardhshëm, përkrah shumës së plotë të dividendës për atë vit, aksionet me prioritet, pa të drejtë vote, japin të drejtë vote përderisa nuk paguhet këto shuma. Në këtë rast, aksionet me prioritet marrin pjesë edhe gjatë përlogaritjes së kuorumit të punës edhe për vendimmarrjen si edhe aksionet me të drejtë vote.

Vendimi me të cilin abrogohet e drejta me përparësi

Neni 405

(1) Për vendimin, me të cilin abrogohet e drejta e autorizuar, është i nevojshëm pëlqimi i pronarëve të aksioneve me prioritet.

(2) Për lëshimin e aksioneve me prioritet, të cilat gjatë shpërndarjes së fitimit ose gjatë pagesës të një pjese të mbetur nga masa e likuiduar, gjegjësisht nga masa falimentuese e shoqërisë, kanë përparësi dhe është i nevojshëm pëlqimi i pronarëve të aksioneve me prioritet.

(3) Pronarët e aksioneve me prioritet pëlqimin e japin me vendim të veçantë. Vendimi miratohet me shumicën e votave, e cila nuk mund të jetë nën dy të tretat e aksioneve të përfaqësuara me prioritet, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe. Me statutin mund të përcaktohen edhe kushte tjera për miratimin e vendimit.

(4) Nëse të drejtat e autorizuar abrogohen, aksionet me prioritet pa të drejtë vote fitojnë të drejtën e votës.

E drejta e njoftimit

Neni 406

(1) Çdo aksionar në kuvend mund të kërkojë njoftim për gjendjen e shoqërisë dhe për raportet e saj me shoqëri tjera, nëse njoftimi ndërlidhet me pikat e rendit të ditës të kuvendit.

(2) Aksionarit, të cilit i është pamundësuar njoftimi, mund të kërkojë, në formë të shkruar, që çështja e tij, kërkesa dhe shkaqet, për shkak të të cilave i pamundësohet njoftimi të evidentohen në procesverbalin e debatit.

(3) Aksionari, i cili nuk ka pranuar njoftim, nga gjykata mund të kërkojë mbrojtje të së drejtës së tij për njoftim. Propozimi dorëzohet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e mbajtjes së kuvendit.

Procesverbali nga kuvendi

Neni 407

(1) Për punën e kuvendit mbahet procesverbal, i cili i përmban të dhënat për:

- 1) firmën dhe selinë e shoqërisë;
- 2) datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së kuvendit;
- 3) emrin e kryesuesit të kuvendit, përkatësisht emrin e mbajtësit të procesverbalit dhe emrat e anëtarëve të komisionit për votim, nëse zgjedhën;
- 4) rendin e ditës të kuvendit;
- 5) numrin e aksionarëve të pranishëm, përkatësisht të autorizuarit e aksionarëve dhe kuorumin e punës;
- 6) debatin e mbajtur në kuvend;
- 7) ngjarjet e rëndësishme në kuvend si edhe për propozimet e paraqitura;
- 8) vendimet, numrin e votave "Për" dhe "Kundër" dhe numri i votave të përmbajtura; dhe
- 9) mospajtimet, përkatësisht kundërshtimet e aksionarit, anëtarit të organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës kundër ndonjë vendimi, nëse është deklaruar mospajtim, përkatësisht kundërshtim.

(2) Për mbajtës të procesverbalit dhe për persona që e vërtetojnë procesverbalin, nuk mund të zgjedhet anëtari i organit administrues i shoqërisë, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës e as kryesuesi i kuvendit.

(3) Procesverbali hartohet, më së voni, brenda afatit prej tetë ditësh nga dita e mbajtjes së kuvendit dhe atë e firmosin mbajtësi i procesverbalit dhe kryesuesi i kuvendit, ndërsa e vërtetojnë vërtetuesit e procesverbalit.

(4) Çdo aksionar, nga anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht nga këshilli administrues mund të kërkojë ekzemplar nga procesverbali i kuvendit, në shpenzim të tij. Shpenzimi nuk mundet të jetë më i madh nga shpenzimi real.

(5) Kur procesverbalin e mban noteri, procesverbali hartohet më së voni brenda afatit prej tre ditësh, nga dita e mbajtjes së kuvendit dhe atë e firmos noteri dhe kryesuesi i kuvendit. Ekzemplarin, nga paragrafi 4 të këtij neni, e jep noteri që e ka mbajtur procesverbalin.

(6) Procesverbalet bashkë me shtojcat ruhen më së paku dhjetë vjet.

Sektori i tretë

PAVLEFSHMËRIA DHE PËRGËNJESHTRIMI I VENDIMIT TË KUVENDIT

Shkaqet për pavlefshmëri

Neni 408

Përkrah rasteve prerazi të përcaktuara në këtë ligj, vendimi i kuvendit është i pavlefshëm nëse:

- 1) Vendimi është marrë në kuvend që nuk është konvokuar konform ligjit dhe statutit, përveç nëse në kuvend marrin pjesë të gjithë aksionarët;
- 2) kuvendi nuk e ka marrë vendimin në mënyrë dhe formë të përcaktuar me këtë ligj dhe me statutin;
- 3) është në kundërshtim me esencën e shoqërisë ose nëse përmbajtja e tij është në kundërshtim me ligjin, me moralin ose me dispozitat e statutit;
- 4) kuvendi vendos për çështje që nuk janë në kompetencat e tij;
- 5) Vendimi nuk është përfshirë në procesverbalin, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj;
- 6) është zgjedhur organ administrues, përkatësisht këshill mbikëqyrës i përbërë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose statuti;
- 7) me vendim, kuvendi e ka zgjedhur anëtarin e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës personin fizik, të cilin nuk e ka propozuar konform këtij ligji ose statuti;
- 8) me vendim, në organin administrues kuvendi ka zgjedhur, përkatësisht në këshillin mbikëqyrës më shumë persona fizik nga ajo që është e përcaktuar në këtë ligj përkatësisht në statutin;
- 9) me vendim kuvendi ka zgjedhur person, i cili në kohën kur është zgjedhur nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë ligj, për zgjedhje në organin administrues, përkatësisht këshillin mbikëqyrës;
- 10) kuvendi ka vendosur t'i japë pëlqim llogarisë vjetore dhe raporteve financiare në të cilat nuk është kryer revizioni ose nëse revizioni nuk është kryer në tërësi sipas ligjit ose revizionin nuk e ka kryer revizor i autorizuar;
- 11) kuvendi ka vendos t'i japë pëlqim llogarisë vjetore, raporteve financiare dhe raportit vjetor për punën e shoqërisë në vitin paraprak afarist pa miratimin e tyre paraprak nga organi administrues dhe nga këshilli mbikëqyrës;
- 12) gjatë hartimit të llogarisë vjetore nuk janë respektuar dispozitat e këtij ligji dhe statuti, me të cilat janë përcaktuar obligimet për ndarjen dhe shfrytëzimin e mjeteve për rezervat; dhe

13) me vendim të plotfuqishëm të gjykatës konfirmohet se vendimi i kuvendit është i pavlefshëm.

Thirrja në pavlefshmëri

Neni 409

(1) Pas regjistrimit të vendimit të kuvendit në regjistrin tregtar nuk mund të thirret në pavlefshmërinë e tij nga shkaqet e cekura në nenin 408, pika 5 e këtij ligji.

(2) Nëse vendimi i kuvendit është i pavlefshëm nga shkaqet e cekura në nenin 408 pika 1 ose pika 3 e këtij ligji, nuk mund të thirret në pavlefshmërinë e tij pas skadimit të tre viteve nga regjistrimi i tij në regjistrin tregtar. Nëse brenda këtij afati është ngritur procedurë sipas ankesës për verifikimin e pavlefshmërisë së vendimit, afati prej tre vitesh zgjatet derisa nuk vendoset në mënyrë të plotfuqishme sipas ankesës ose derisa kontesti nuk zgjidhet në mënyrë tjetër. Nëse vendimi i kuvendit është i pavlefshëm sipas nenit 408 pika 1 e këtij ligji, nuk mund të kërkohej pavlefshmëria e tij nëse me vendimin pajtohen të gjithë aksionarët, të cilët nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt në kuvend.

Padi për verifikimin e pavlefshmërisë

Neni 410

(1) Pavlefshmëri mund të ceket me padi dhe në çdo mënyrë tjetër.

(2) Padi kundër shoqërisë, me të cilën kërkohej verifikimi i pavlefshmërisë së vendimit të kuvendit mund të paraqesë çdo aksionar, organi administrues ose anëtar i organit administrues apo i këshillit mbikëqyrës.

(3) Padia paraqitet brenda afatit prej tridhjetë ditësh nga dita e miratimit të vendimit. Nëse paditësi ka marrë pjesë në kuvend, në të cilin është miratuar vendimi, afati fillon të rrjedhë nga dita e parë e ardhshme prej ditës së mbarimit të kuvendit me punë, në të cilin është miratuar vendimi. Nëse paditësi nuk ka marrë pjesë në kuvend, në të cilin është miratuar vendimi, afati fillon të rrjedhë prej ditës së parë të ardhshme nga dita kur ka mundur të kuptjë për vendimin, por jo më vonë se një vit nga miratimi i vendimit.

(4) Padia paraqitet kundër shoqërisë. Shoqëria përfaqësohet nga anëtari i autorizuar i organit administrues, përkatësisht i këshillit mbikëqyrës. Nëse padi paraqesin anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, shoqëria përfaqësohet nga anëtarët jo ekzekutiv, nëse padi paraqet këshilli administrues ose ndonjë anëtar i tij, shoqërinë e përfaqëson anëtari i autorizuar i këshillit mbikëqyrës, ndërsa nëse padi paraqet këshilli mbikëqyrës, shoqëria përfaqësohet nga anëtari i autorizuar i këshillit administrues.

(5) Gjykata me masë të përkohshme mund ta ndalojë zbatimin e vendimit, për të cilin me padi kërkohej të verifikohet pavlefshmëria e tij, nëse është e besueshme se me ekzekutimin e tij shoqërisë, përkatësisht aksionarit mund t'i shkaktohet dëm i pakompensueshëm.

(6) Nëse anëtarët e organit administrues, të këshillit mbikëqyrës ose administruesi paraqesin padi për verifikimin e pavlefshmërisë, në këtë rast në mënyrë përkatëse zbatohet dispozita nga paragrafi 4 i këtij neni.

Pasojat juridike nga pavlefshmëria

Neni 411

(1) Vendimi, për të cilin është verifikuar se është i pavlefshëm nuk ka veprim juridik përveç në rastet e nenit 409 të këtij ligji.

(2) Çdo gjë e fituar në shoqërinë në bazë të vendimit të pavlefshëm, doemos duhet t'i kthehet shoqërisë dhe t'i kompensohen shpenzimet në lidhje me këtë.

(3) Pavlefshmëria e vendimeve nga neni 408, paragrafi 1, pikat 10, 11 dhe 13, si pasojë e ka pavlefshmërinë e vendimeve të kuvendit të marra në bazë të këtyre vendimeve. Të pavlefshme janë vendimet e organit administrues, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës, me të cilat janë lejuar njoftimet financiare.

Përgënjeshtrimi i Vendimit

Neni 412

(1) Vendimi i kuvendit mund të përgënjeshtrohet edhe nëse aksionari ka votuar për vendimin, me qëllim që për vetvete apo por dikë tjetër të përfitojë në dëm të shoqërisë ose në dëm të aksionarëve tjerë, ndërsa me vendimin përgënjeshtrohet kjo gjë arrihet. Kjo dispozitë nuk aplikohet kur aksionarëve tjerë, në mënyrë përkatëse do tju kompensohet dëmi.

(2) Mund të përgënjeshtrohet vendimi i kuvendit, i bazuar në mosdhënien e njoftimit, i cili ndikon në marrjen e vendimit.

(3) Nuk mund të përgënjeshtrohet vendimi i kuvendit nëse vendimi verifikohet me vendim të ri të kuvendit, ndërkaq vendimi i ri nuk përgënjeshtrohet brenda afatit nga neni 410 paragrafi 3 i këtij ligji.

Subjektet që mund të përgënjeshtrojnë Vendim

Neni 413

Vendimin e kuvendit mund ta përgënjeshtrojë:

- 1) aksionari i cili ka marrë pjesë në punën e kuvendit dhe kundërshtimin e tij ndaj Vendimit e ka deklaruar në procesverbalin;
- 2) aksionari i cili nuk ka marrë pjesë në punën e kuvendit, sepse në kundërshtim me ligjin dhe statutin, nuk i është lejuar të marrë pjesë në punën e tij, nëse kuvendi nuk është konvokuar sipas rregullës ose nëse çështja për të cilën është vendos në kuvend nuk është shpallur në mënyrë të rregullt;
- 3) çdo aksionar kur kuvendi ka miratuar vendim me qëllim që aksionari i cili ka votuar për vendimin të realizojë dobi për veten ose për ndonjë person tjetër, në dëm të shoqërisë ose në dëm të aksionarëve tjerë;
- 4) organi administrues dhe këshilli mbikëqyrës;
- 5) çdo anëtar i organit administrues dhe këshillit mbikëqyrës, nëse me zbatimin e Vendimit do të kishte bërë veprim ndëshkues, të paligjshëm ose për të cilin mund të përgjigjet për dëm; dhe
- 6) kreditori i shoqërisë i cili ka interes juridik.

Padi për përgënjeshttrim dhe pasojat juridike nga përgënjeshtrimi

Neni 414

(1) Në padinë për përgënjeshttrim në mënyrë përkatëse zbatohen paragrafët 2, 3, 4 dhe 6 nga neni 410 të këtij ligji.

(2) Nëse gjykata me aktvendim të plotfuqishëm e zhvleftëson vendimin e kuvendit, ai ka veprim mbi të gjithë aksionarët, anëtarët e organit administrues, përkatësisht mbi këshillin mbikëqyrës, edhe atëherë kur ato nuk kanë qenë palë në procedurën.

Obligimi për dërgimin dhe regjistrimin e aktvendimit gjyqësor

Neni 415

(1) Organi administrues doemos duhet që brenda afatit prej tri ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të plotfuqishëm t'ia dërgojë regjistrin tregtar, nëse sipas këtij aktvendimi është bërë regjistrimi në regjistrin tregtar. Regjistrimi i aktvendimit gjyqësor në regjistrin tregtar doemos duhet të shpallet në mënyrën e njëjtë ashtu siç është shpallur paraprakisht regjistrimi.

(2) Nëse sipas aktvendimit gjyqësor është harmonizuar statuti së bashku me aktvendimin, regjistrin tregtar i dërgohet edhe teksti i spastruar i statutit.

SEKSIONI 6-a

Shërbimi i revizionit të brendshëm

Neni 415-a

(1) Organi mbikëqyrës i shoqërisë aksionare obligohet që të organizojë shërbim për revizion të brendshëm, si njësi e pavarur organizative në shoqëri. Shoqëritë aksionare obligohen të emërojnë revizor të brendshëm.

(2) Vendosjen organizative, të drejtat, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet me njësitë e tjera organizative të shoqërisë, si dhe përgjegjësitë dhe kushtet për emërimin e udhëheqësit të shërbimit për revizion të brendshëm, i rregullon organi mbikëqyrës.

(3) Shërbimi për revizion të brendshëm bën revizion të vazhdueshëm dhe të plotë të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe azhurnitetit të punës së shoqërisë përmes:

- 1) vlerësimit të përputhshmërisë dhe efikasitetit të sistemeve për kontroll të brendshëm;
- 2) vlerësimit të zbatimit të politikave për menaxhim me rreziqet;
- 3) vlerësimit të strukturës të sistemit informativ;
- 4) vlerësimit të saktësisë dhe besueshmërisë së librave tregtarë dhe raporteve financiare;
- 5) kontrollit të saktësisë, besueshmërisë dhe informimit me kohë në pajtim me rregullat dhe
- 6) ndjekjes së respektimit të rregullave, politikave dhe procedurave të shoqërisë.

(4) Shërbimi për revizion të brendshëm i zbaton aktivitetet e veta, në pajtim me parimet dhe standardet për revizion të brendshëm dhe politikën dhe procedurat për punën e shërbimit.

(5) Personat e punësuar në shërbimin për revizion të brendshëm i kryejnë vetëm punët e shërbimit.

(6) Të punësuarit në shoqëri obligohen që personave të cilët janë të punësuar në shërbimin për revizion të brendshëm, t'u mundësojnë kontroll mbi dokumentacionin me të cilin disponojnë dhe t'ua japin të gjitha informatat e nevojshme.

Neni 415-b

(1) Shërbimi për revizion të brendshëm përgatit planin vjetor të punës, të cilin e miraton organi mbikëqyrës.

(2) Në planin nga paragrafi (1) i këtij neni, detyrimisht shënohet lënda e revizionit me përshkrim të përmbajtjes së revizionit të planifikuar në sfera të veçanta dhe orari i kontrolleve gjatë vitit, me kohëzgjatje të planifikuar për realizimin e kontrolleve.

Neni 415-v

(1) Shërbimi për revizion të brendshëm obligohet që për punën e vet të hartojë raport gjashtëmuor dhe vjetor dhe t'ia dorëzojë organit mbikëqyrës dhe organit udhëheqës.

(2) Raporti gjashtëmuor dhe vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, përmbajnë:

- 1) përshkrim të revizioneve të kryera për punën e shoqërisë;
- 2) vlerësim përputhshmërie dhe efikasiteti të sistemeve për kontroll të brendshëm;
- 3) konstatime dhe masa të propozuara të shërbimit për revizion të brendshëm dhe
- 4) vlerësim për zbatimin e masave të propozuara nga ana e shërbimit për revizion të brendshëm.

(3) Raporti vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, i përmban edhe:

- 1) vlerësimin e realizimit të qëllimeve të parashtruara me planin vjetor të punës;
- 2) vlerësimin e kohës së planifikuar për kontroll dhe devijimi eventual dhe
- 3) informacionet për aktivitetet e tjera të realizuara.

(4) Organi mbikëqyrës obligohet që t'ia dorëzojë raportin vjetor të shërbimit për revizion të brendshëm, kuvendit të shoqërisë.

Neni 415-g

Shërbimi për revizion të brendshëm obligohet që menjëherë t'i informojë organin mbikëqyrës dhe organin udhëheqës nëse gjatë kontrollit konstaton:

- 1) mosrespektim të standardeve për menaxhim me rreziqet pasi që ekziston mundësia për çrregullimin e likuiditetit ose solvencionit të shoqërisë dhe
- 2) se organi mbikëqyrës nuk i respekton rregullat dhe aktet e përgjithshme dhe procedurat e brendshme të shoqërisë.

SEKSIONI 7

SHOQËRI AKSIONARE ME NJË AKSIONAR

Aplikimi përkatës i dispozitave për shoqërinë me një aksionar

Neni 416

(1) Mbi shoqërinë me një aksionar, në mënyrë përkatëse aplikohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me shoqërinë me dy ose më shumë aksionarë, me atë që të drejtat dhe obligimet e kuvendit të shoqërisë aksionare i kryen organi i përcaktuar nga themeluesi, përkatësisht aksionari i vetëm në mënyrën e përcaktuar me statutin e shoqërisë aksionare me një aksionar.

(2) Marrëveshjet ndërmjet aksionarit të vetëm dhe shoqërisë kur aksionari i vetëm, njëkohësisht është edhe përfaqësues i vetëm, sipas ligjit të shoqërisë patjetër duhet të regjistrohen në procesverbal ose të jenë të kontraktuara në formë të shkruar.

SEKSIONI 8

NDRYSHIMI I STATUTIT

Mënyra e procedurës

Neni 417

(1) Statuti ndryshohet me vendim për ndryshimin e statudit.

(2) Procedurën për ndryshimin e statudit mund ta ngrejë organi administrues, përkatësisht këshilli mbikëqyrës si edhe aksionarët që kanë më së paku një të dhjetën e numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote. Iniciativa në formë të amandamenteve, dërgohet pranë organit administrues, ndërsa kur për këtë me këtë ligj është i autorizuar, dërgohet edhe pranë këshillit mbikëqyrës.

(3) Propozimvendimi për ndryshimin e statudit, në të cilin janë cekur ndryshimet e propozuara, pa dallim të faktit se kush e ka dhënë iniciativën, e verifikon organi administrues, ndërkaq kur për këtë është i autorizuar, me këtë ligj, edhe këshilli mbikëqyrës. Propozimvendimi i verifikuar, për ndryshimin e statudit, patjetër duhet të justifikohet.

Vendimi për ndryshim

Neni 418

(1) Vendimin për ndryshimin e statudit e merr kuvendi.

(2) Vendimi për ndryshimin e statudit miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i aksioneve me të drejtë vote, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe.

(3) Kuvendi, me vendimin për ndryshimin e statudit, e autorizon këshillin e drejtorëve, përkatësisht këshillin mbikëqyrës të hartojë tekst të spastruar të statudit, në të cilin përfshihen ndryshimet e bëra me vendimin për ndryshimin e statudit si edhe dispozitat nga vendimet që kanë karakter të vendimit për ndryshimin e statudit të verifikuara me këtë ligj.

Hyrja në fuqi e ndryshimit

Neni 419

Ndryshimi i statutit hyn në fuqi në ditën e miratimit të vendimit për ndryshimin e statutit, përveç nëse me vendimin për ndryshimin e statutit nuk është caktuar datë tjetër e hyrjes në fuqi.

Seksioni i 9

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KRYEGJËSË BAZË

Nënseksioni 1

ZMADHIMI I KRYEGJËSË BAZË

Seksioni i parë

Dispozitat e përbashkëta

Mënyrat e zmadhimit

Neni 420

Zmadhimi i kryegjësë së madhe e shoqërisë mund të kryhet:

- 1) me depozitime;
- 2) me zmadhimin e kushtëzuar të kryegjësë themlore;
- 3) me kapital të miratuar; dhe
- 4) nga mjetet e shoqërisë.

Vendimi për zmadhim

Neni 421

(1) Zmadhimi i kryegjësë bazë kryhet me vendimin e kuvendit për zmadhimin e kryegjësë bazë. Vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë ka karakter të vendimit për ndryshimin e statutit, përveç vendimit për zmadhimin e kryegjësë bazë, të cilin e ka marrë organi i udhëheqësit sipas dispozitës së statutit për kapitalin e miratuar.

(2) Nëse aksionet e reja jipen me vlerë më të lartë nga vlera nominale e aksioneve, në venimin për zmadhimin e kryegjësë bazë doemos duhet të caktohet shuma nën të cilën aksionet nuk mund të jipen.

(3) Vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë përmban të dhëna për shumën, mënyrën dhe datën e zmadhimit të kryegjësë bazë, numrin, llojin dhe klasat e aksioneve, depozitimet monetare dhe jomonetare në bazë të cilave ndërmerren aksionet e posadhëna dhe të dhëna tjera të caktuara me ligj dhe me dispozitat tjera të caktuara me ligj dhe me dispozitat e këtij seksioni nga ky ligj, sipas mënyrës përkatëse të zmadhimit të kryegjësë bazë.

(4) Vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë merret me shumicë votash që nuk mund të jetë nën dy të tretat e aksioneve me të drejtë vote të prezentuara në kuvend, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe.

(5) Nëse ekzistojnë shumë lloje të aksioneve, vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni është me fuqiplotë nëse me atë pajtohen aksionarët e të gjithë

llojeve të aksioneve. Vendimin për pajtueshmëri aksionarët e çdo lloji të aksioneve e marrin me të njëjtën shumicë me të cilën është marrë vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni.

(6) Vendim i ri për rritjen e kryegjësë themelore mund të miratohet vetëm nëse rritja paraprake e kryegjësë themelore është bërë dhe është regjistruar në regjistrin tregtar dhe te depozitari i letrave me vlerë.

E drejta e përparësisë për regjistrim të aksioneve të reja të emetuara dhe letrave të tjera me vlerë

Neni 421-a 15

(1) Gjatë rritjes së kryegjësë bazë, aksionarët kanë të drejtë përparësie për regjistrimin e aksioneve të reja të emetuara, në përpjesëtim të pjesëmarrjes së aksioneve të tyre në kryegjënë bazë të shoqërisë, pa dallim nëse aksionet e reja të emetuara shiten përmes bankës, ose përmes organizatës tjetër financiare.

(2) Në rastin kur shoqëria ka emetuar më shumë lloje dhe klasa të aksioneve dhe e zmadhon kryegjënë themelore nëpërmjet emetimit vetëm të njërit nga llojet dhe klasat e aksioneve, aksionarët të cilët janë pronar të aksioneve nga lloji dhe klasa tjetër, kanë të drejtë përparësie vetëm pasi që aksionarët që janë pronar të aksioneve të llojit dhe klasës së njëjtë si dhe aksioneve të reja, ta realizojnë të drejtën e përparësisë.

(3) Të drejtat e përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja të emetuara, zbatohen edhe në emetimin e llojeve të tjera të letrave me vlerë, të cilat mund të konvertohen në aksione, ose në të cilat përmbahet e drejta për regjistrimin e aksioneve, por nuk zbatohet edhe në konvertimin e atyre letrave me vlerë, as në realizimin e të drejtës së regjistrimit.

Përfundimi dhe kufizimi i të drejtës së përparësisë gjatë regjistrimit të aksioneve të reja të emetuara

Neni 421-b

(1) E drejta e përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja të emetuara nga lloji dhe klasa e njëjtë e aksioneve, mundet para regjistrimit të aksioneve, të përjashtohet tërësisht apo pjesërisht vetëm me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë në pajtim me statutin, e cila doemos duhet të publikohet në mënyrën në të cilën publikohet konvokimi i kuvendit.

(2) Kuvendi mund të vendosë për përjashtimin e të drejtës së përparësisë gjatë regjistrimit të aksioneve të reja të emetuara vetëm në bazë të raportit me shkrim, të organit të administrimit në të cilin shënohen shkaqet për kufizimin apo përjashtimin e së drejtës së përparësisë për regjistrim, dhe në të cilin doemos duhet të arsyetohet çmimi i emetimit të aksioneve. Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet me shumicë votash, që nuk mund të jetë nën se tri të katërtat e aksioneve të prezantuara në kuvend me të drejtë vote, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe. Me statut mund të përcaktohen edhe kushte të tjera për miratimin e vendimit.

E drejta për përparësi në regjistrimin e aksioneve të reja

Neni 422

I fshirë 16

Zëvendësimi i aksioneve për shkak të zmadhimit të shumës nominale të aksioneve

Neni 423

(1) Aksionet të cilat plotësisht janë paguar marrin pjesë në zmadhimin e kryegjësë bazë sipas vlerës së tyre nominale.

(2) Aksionet të cilat pjesërisht janë paguar marrin pjesë në zmadhimin e kryegjësë bazë sipas vlerës së tyre nominale që është paguar.

Pjesëmarrja e aksioneve te reja ne përfitim

Neni 424

(1) Me vendimin për zmadhimin e kryegjësë bazë mund të caktohet që aksionet e reja të marrin pjesë në përfitimin e shoqërisë në vitin afarist që i ka paraprirë vitit në të cilin është marrë vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë. Në këtë rast, vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë doemos duhet të merret para marrjes së vendimit për ndarje, përkatësisht për përdorimin e përfitimit për vitin afarist që i ka paraprirë vitit në të cilin është marrë vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë. Vendimin për ndarje, përkatësisht për përdorimin e përfitimit nga viti paraprak, ka veprim juridik pas zmadhimit të kryegjësë bazë.

(2) Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni është i pavlefshëm nëse vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë nuk është regjistruar në regjistrin tregtar në afat prej tre muajsh nga dita e marrjes së tij. Ky afat nuk rrjedh gjatë kohës sa zgjat procedura e padisë me të cilën mohohet vendimi apo me të cilën kërkohet vërtetimi i pavlefshmërisë së saj apo gjatë kohës derisa nuk merret leja nga organi kompetent për zmadhimin e kryegjësë bazë nëse kjo është caktuar me ligj.

Përjashtimi i të drejtës së përparësisë gjatë regjistrimit të aksioneve të posadhëna

Neni 425

I fshirë 17

Mbrojtja e të drejtave të aksionarëve dhe perosnave të tretë

Neni 426

(1) Nëse të drejtat e caktuara të aksioneve që janë paguar pjesërisht, siç janë e drejta e pjesëmarrjes në përfitim ose e drejta e votës, caktohen sipas shumës që është paguar dhe deri në pagesën e tërësishme të aksioneve, aksionarët i kanë të drejtat që janë përcaktuar deri në shumën që e kanë paguar.

(2) Zmadhimi i kryegjësë bazë nuk ndikon në përmbajtjen e marrëdhënieve të kontraktuara ndërmjet shoqërisë dhe personave të tretë

që varen nga përfitimi i realizuar, vlera e aksioneve ose vlera e kryegjësë bazë para zmadhimit të kryegjësë bazë.

(3) Dispozita nga paragrafi 2 i këtij neni i përket edhe obligimeve plotësuese të aksionarëve.

Seksioni i dytë

ZMADHIMI I KRYEGJËSË BAZË ME DEPOZITIME

Supozimet për zmadhim

Neni 427

(1) Zmadhimi i kryegjësë bazë me depozitime mund të bëhet vetëm me dhënien e aksioneve të posadhëna. Aksionet e reja të emetuara mund të paguhen me para, me futje të depozitave jomonetare dhe me hua që transformohet në borxh në shoqëri në procedurë të zmadhimit të kryegjësë themelore të shoqërisë.

Zmadhimi i kryegjësë bazë me depozitim jomonetar

Neni 428

(1) Nëse zmadhimi i kryegjësë themelore kryhet me depozitime pa para, në vendimin për zmadhimin e kryegjësë bazë me depozitime doemos duhet të theksohen depozitimet jomonetare, personat prej të cilëve shoqëria i ndërmerr depozitimet pa para dhe shuma nominale e aksioneve që përfitohen si kundërvlerë për depozitimet e emetuara jomonetare.

(2) Nëse në vendimin për zmadhimin e kryegjësë bazë me depozitime pa para nuk përcaktohen të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni, emetimi i depozitimeve pa para, marrëveshjet për emetimin e depozitimeve jomonetare dhe veprimet juridike për realizimin e tyre ndaj shoqërisë janë të pavlefshme.

(3) Në zmadhimin e kryegjësë bazë me depozitime pa para, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e nenit 35 të këtij ligji.

Shpallja publike për regjistrimin e aksioneve

Neni 429

18

(1) Organi i administrimit, pas marrjes së lejes nga Komisioni i letrave me vlerë për emetimin e aksioneve, sipas vendimit për rritjen e kryegjësë bazë me depozitime, publikon thirrje për aksionarët. Thirrja botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", së paku në dy gazeta ditore që dalin në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në ueb faqen e shoqërisë. Në thirrje aksionarët njoftohen në afat jo më të shkurtër se 15 ditë nga dita e publikimit të thirrjes, që ta regjistrojnë atë pjesë të aksioneve të reja të emetuara që i përgjigjet pjesëmarrjes së aksioneve të tyre në kryegjënë bazë para rritjes së saj, përkatësisht ta shfrytëzojnë të drejtën e përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja të emetuara, përveç nëse me vendimin për rritjen e kryegjësë bazë me depozitime, aksionarët nuk kanë hequr dorë nga kjo e drejtë.

(2) Organi i administrimit, njëkohësisht me shkrim e informon secilin aksionar për shumën e aksioneve të emetuara, për numrin e aksioneve që i përgjigjet pjesëmarrjes së aksioneve të tij në kryegjënë bazë, dhe për afatin nga paragrafi (1) i këtij neni në të cilin aksionari mund t'i regjistrojë aksionet e reja.

(3) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, në të cilin aksionarët mund ta shfrytëzojnë të drejtën e përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja të emetuara, të drejtë për regjistrimin e aksioneve të reja të emetuara kanë edhe personat e tjerë, në afatin që nuk është më i shkurtër se 15 ditë nga dita e kalimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe atë në kushte të njëjta që kanë vlejtur për aksionarët që kanë pasur të drejtë përparësie për regjistrimin e aksioneve të reja të emetuara, në aspektin e çmimit me të cilin aksionet u janë ofruar dhe mënyrën e pagesës së aksioneve të reja të emetuara.

E drejta e përparësisë për regjistrimin e aksioneve të aksionarit ekzistues

Neni 429-a 19

Në afatin që nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë, secili aksionar ka të drejtë që me deklaratë me shkrim ta regjistrojë atë pjesë të aksioneve të reja që i përgjigjet pjesëmarrjes së aksioneve të tij në kryegjënë bazë, para rritjes së saj.

E drejta për përparësi

Neni 430

I fshirë 20

Regjistrimi i aksioneve të posadhëna

Neni 431

(1) Aksionet e posadhëna regjistrohen me deklaratë me shkrim (fletëregjistrim) nga e cila në mënyrë të qartë mund të vërtetohet se kush është regjistruesi, numri i aksioneve që i regjistron, shuma nominale e aksioneve, por nëse janë në pyetje aksionet e më shumë llojeve dhe klasave, edhe lloji dhe klasa e aksioneve. Fletëregjistrimi doemos duhet t'i përmbajë:

- 1) ditën kur është marrë vendimi për zmadhimin e kryegjësë themelore me depozitime;
- 2) vlerën për të cilën zmadhohet kryegjëja bazë, llojin dhe numrin e aksioneve, mënyrën e pagesës dhe obligimet plotësuese nëse të tilla janë përcaktuar me vendimin për zmadhimin e kryegjësë bazë me depozitime;
- 3) të dhënat për zmadhimin e kryegjësë bazë me emetimin e depozitimeve jomonetare, por nëse jepen aksione të më shumë llojeve, edhe shuma e përgjithshme nominale e aksioneve të çdo lloji; dhe
- 4) afati deri në të cilin obligimi i marrë me nënshkrimin e fletëregjistrimit pushon nëse deri në atë afat nuk bëhet regjistrimi i zmadhimit të kryegjësë bazë në regjistrin tregtar.

(2) Fletëregjistrimet që nuk i përmbajnë të dhënat apo përmbajnë përkufizime, përveç atyre nga paragrafi 1, pika 4 e këtij neni janë të pavlefshme.

(3) Personi i cili në bazë të fletëregjistrimit ka regjistruar aksione dhe si aksionar ka realizuar të drejta dhe ka plotësuar obligimin nuk mund të thirret në pavlefshmëri ose të lirohet nga obligimet që i ka marrë nga fletëregjistrimi nëse në regjistrin tregtar është kryer regjistrimi i vendimit për zmadhimin e kryegjësë bazë.

(4) Kufizimi që nuk është përmbajtur në fletëregjistrim, nuk ka veprim juridik ndaj shoqërisë.

Pagesa dhe emetimi i depozitimeve

Neni 432

(1) Depozitimet monetare paguhen në tërësi deri në ditën e regjistrimit të zmadhimit të kryer të kryegjësë bazë në regjistrin tregtar.

(2) Depozitimet jomonetare emetohen në shoqërinë në tërësi deri në ditën e regjistrimit të zmadhimit të kryer të kryegjësë bazë në regjistrin tregtar. Shoqëria nënshkruan marrëveshje për emetimin e depozitimit jomonetar me personin që e emeton depozitimin jomonetar. Marrëveshjen e nënshkruan anëtari ekzekutiv i këshilli të drejtorëve, kryetari i këshillit drejtues, përkatësisht personi të cilin do ta autorizojë dhe personi që emeton depozitimin jomonetar.

(3) Nëse personi nga paragrafi 2 i këtij neni nuk e emeton depozitimin jomonetar sipas kushteve të caktuara me marrëveshje në paragrafin 2 të këtij neni, është i obliguar ta paguajë shumën nominale të aksioneve që i ka marrë si dhe t'i kryejë obligimet tjera të caktuar me marrëveshje.

(4) Huaja e cila transformohet në depozitë në shoqëri gjatë procedurës së zmadhimit të kryegjësë themelore të shoqërisë futet në bazë të marrëveshjes për hua që transformohet në depozitë në shoqëri gjatë procedurës së zmadhimit të kryegjësë themelore të shoqërisë dhe vendimit për transformim në depozitë të shoqërisë gjatë procedurës për zmadhimin e kryegjësë themelore të shoqërisë.

Regjistrimi i zmadhimit të kryegjësë themelore me depozitime

Neni 433

(1) Pas zmadhimit të kryer të kryegjësë bazë me depozitime, në afat prej tetë ditësh nga zmadhimi i kryer i kryegjësë themelore, parashtrohet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të zmadhimit të kryegjësë themelore.

(2) Fletëparaqitjes për regjistrimin e zmadhimit të kryegjësë bazë me depozitime i bashkangjiten:

1) vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë me depozitime, por nëse ekzistojnë lloje më të mëdha të aksioneve, edhe vendimi për pajtueshmërinë e aksionarëve të çdo lloji të aksioneve;

2) ekstrakti nga procesverbali i mbledhjes së kuvendit ku është marrë vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë me depozitime, i verifikuar në noter;

3) leja nga Komisioni i letrave me vlerë për vlerën e aksioneve;

4) raporti për vlerësim nëse zmadhimi i kryegjësë bazë i shoqërisë bëhet me bartjen e depozitimeve jomonetare dhe dëshmia për pronësi, në të cilën është bërë shënimi në librin publik për evidentimin e sendeve të patundshme, por nëse depozitohet lëndë e tundshme për të cilën me ligj

është paraparë obligimi për videncë (regjistër) dëshmi për pronësinë e sendeve të tundshme;

5) marrëveshja për emetimin e çdo depozitimi jomonetarë e nëse depozitohen letra me vlerë në regjistrin tregtar dorëzohet dëshmi për pronësi të atyre letrave me vlerë me shënim se të njëjtat depozitohen në shoqërinë tregtare dhe se pronari nuk mund të disponojë me të njëjtat. Për atë qellim, pronari i letrave me vlerë te Depozitari qendror për letra me vlerë dorëzon deklaratë të verifikuar te noteri se letrat me vlerë janë investuar në shoqëri tregtare dhe se pajtohet që mbi të njëjtat të evidentohet kufizim për disponimin deri në bartjen e të njëjtave në shoqërinë tregtare.

6) llogaria e shpenzimeve nga dhënia e aksioneve të reja;

7) teksti i spastruar i statutit;

8) dëshmia për të drejtën e realizuar të përparësisë për regjistrimin e aksioneve të dhëna si dhe lista e personave që e kanë realizuar atë të drejtë, me theksimin e numrit të aksioneve që i kanë përfituar dhe depozitimet që i kanë paguar, përkatësisht që i kanë inkorporuar për përfitimin e tyre, të nënshkruar nga kryetari i organit të administrimit, nëse e drejta e përparësisë për regjistrim nuk përjashtohet;

9) lejen nga organi kompetent nëse për zmadhimin e kryegjësë bazë kjo është përcaktuar me ligj.

10) marrëveshje për hua e cila transformohet në depozitë në shoqërinë gjatë procedurës së zmadhimit të kryegjësë themelore të shoqërisë dhe

11) vendim për transformimin e huas e cila transformohet në depozitë të shoqërisë gjatë procedurës së zmadhimit të kryegjësë themelore të shoqërisë.

(3) Lajmërimi për regjistrimin e zmadhimit të kryegjësë bazë në regjistrin tregtar shpallet.

Seksioni i tretë

ZMADHIMI ME KUSHT I KRYEGJËSË THEMELORE

Supozime

Neni 434 **21**

(1) Vendim për zmadhimin me kusht të kryegjësë bazë mund të merret vetëm përshkak të realizimit të qëllimeve vijuese:

1) kreditorët e shoqërisë të mund ta realizojnë të drejtën e zëvendësimit të kreditorëve konvertibilë me aksionet e shoqërisë, dhe të drejtën për përparësi në regjistrimin e aksioneve që do t'i japë shoqëria;

2) përgatitja për bashkangjitjen dhe për ndarjen me shkëputjen ose me ndarjen me marrje; dhe

3) realizimi i të drejtës me aksionet e të punësuarve, të anëtarëve ekzekutivë të këshillit të drejtorëve, të këshillit drejtues, përkatësisht të drejtuesit të shoqërisë dhe të anëtarëve të këtyre organeve të shoqërisë të lidhura me të.

(2) Në vendimin për zmadhimin me kusht të kryegjësë bazë caktohen qëllimet e zmadhimit me kusht të kryegjësë bazë, personat që mund ta shfrytëzojnë të drejtën për përparësi në regjistrimin e aksioneve të posadhëna, afati në të cilin doemos duhet të kryhet zmadhimi me kusht i kryegjësë bazë, kushtet nën të cilat mund të shfrytëzohen këto të drejta, shuma në të cilën jepen akisonet dhe masat dhe kriteret me të cilat kjo shumë mund të llogaritet.

(3) Shuma nominale e kryegjësë bazë të zmadhuar me kusht nuk mund ta kalojë gjysmën e kryegjësë bazë në ditën e marrjes së vendimit për zmadhimin me kusht të kryegjësë bazë.

(4) Vendimi i kuvendit për zmadhimin e kryegjësë bazë me kusht të marrë në kundërshtim me dispozitat e këtij neni është i pavlefshëm.

(5) E drejta e zëvendësimit të kreditorëve, përkatësisht e drejta e përparësisë për regjistrimin e aksioneve nga paragrafi 1, pika 1 e këtij neni realizohen me deklaratë me shkrim për shndërrimin e fletëobligacionit në aksione, përkatësisht për regjistrimin e aksioneve. Në deklaratën me shkrim, në mënyrë përkatëse zbatohet neni 429 të këtij ligji.

(6) Dispozitat e neneve 35 dhe 428 të këtij ligji që i përkasin depozitimit jomonetar, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe gjatë zmadhimit me kusht të kryegjësë themelore.

(7) Dispozitat e neneve 429 dhe 429-a të këtij ligji që i përkasin të drejtës së përparësisë për regjistrimin e aksioneve të posadhëna, në mënyrë përkatëse, zbatohen edhe për realizimin e të drejtës së përparësisë për regjistrimin e aksioneve të posadhëna sipas vendimit për zmadhimin me kusht të kryegjësë bazë.

22

Regjistrimi i zmadhimit të kryegjësë bazë

Neni 435

(1) Konsiderohet se zmadhimi i kryegjësë bazë është kryer me dhënien e aksioneve dhe nëse është realizuar ndonjëri prej qëllimeve nga neni 434, paragrafi 1 i këtij neni.

(2) Pas zmadhimit të kryegjësë bazë, në afat prej tetë ditësh, dërgohet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar për shumën e përgjithshme për të cilën është zmadhuar kryegjësja bazë.

(3) Me fletëparaqitjen nga paragrafi 2 i këtij neni, përveç shtojcave nga neni 433, paragrafi 2, pikat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9 bashkangjiten dhe:

1) vendimi për zmadhim me kusht të kryegjësë bazë;

2) ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së kuvendit në të cilin është marrë vendimi për zmadhimin me kusht të kryegjësë bazë me depozitime, i verifikuar në noter; dhe

3) deklaratë me të cilën organi drejtues vërteton se fletëobligacionet dhe aksionet kanë janë dhënë vetëm për shkak të realizimit të qëllimit të caktuar në vendimin për zmadhimin me kusht të kryegjësë bazë.

Seksioni i katërt

MËNYRAT E MIRATIMIT

Neni 436

(1) Organi i administrimit mund të autorizohet me statut më së shumti pesë vjet pas regjistrimit të shoqërisë, përkatësisht për pesë vjet pas vendimit për ndryshimin e statutit në regjistrin tregtar, nëse kjo mundësi është përcaktuar me statut, që me dhënien e aksioneve të reja në bazë të depozitimeve, ta zmadhojë kryegjënë bazë deri në një shumë të caktuar nominale (kapital i miratuar).

(2) Shuma nominale e kapitalit të miratuar nuk mund ta tejkalojë gjysmën e kryegjësë bazë gjatë kohës kur është dhënë autorizimi për zmadhimin me kusht të kryegjësë bazë.

(3) Aksionet e reja mund të jepen vetëm në pajtim me shumicën e drejtorëve joekzekutivë të këshillit të drejtorëve, përkatësisht me shumicën nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës.

Dhënia e aksioneve të reja

Neni 437

(1) Dispozita me të cilën jipet autorizimi nga neni 436, parafi 1 i këtij ligji konsiderohet si vendim për zmadhimin e kryegjësë bazë me kapital të miratuar.

(2) Dhënia e aksioneve të reja bëhet sipas dispozitave të këtij ligji me të cilat rregullohet zmadhimi i kryegjësë bazë nëpërmjet depozitimeve, nëse me këtë nënseksion nga ky ligj dhe me ligj tjetër num është caktuar ndryshe.

(3) *I fshirë* **23**

(4) Dispozitat e neneve 35 dhe 428 të këtij ligji që i përkasin depozitimit jomonetar, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe gjatë zmadhimit të kryegjësë bazë me kapital të miratuar.

(5) Dispozitat e neneve 429 dhe 429-a që i përkasin të drejtës për përparësi në regjistrimin e aksioneve të posadhëna në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për realizimin e të drejtës për përparësi në regjistrimin e aksioneve të posadhëna sipas vendimit për zmadhimin e kryegjësë bazë me kapital të miratuar. **24**

Autorizimi për vendimmarrje për përjashtimin e së drejtës së përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja

Neni 437-a **25**

Me autorizimin nga neni 436 paragrafi (1) i këtij ligji, këshilli i drejtorëve, përkatësisht këshilli mbikëqyrës, mund të autorizohet që të vendosë për përjashtimin e përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja, e cila doemos duhet të jepet me shumicë votash e cila nuk mund të jetë nën tri të katërtat nga aksionet e prezantuara në kuvend me të drejtë vote, përveç nëse me statut nuk është e përcaktuar shumicë më e madhe.

Vendimi për përjashtimin e të drejtës së përparësisë, miratohet me pajtimin e shumicës së anëtarëve joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, përkatësisht shumicës së anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Këta anëtarë janë të obliguar që në kuvendin e ardhshëm vjetor, të paraqesin raport me shkrim, në të cilin do t'i shënojnë shkaqet për përjashtimin e së drejtës së përparësisë për regjistrimin e aksioneve të reja.

Regjistrimi i rritjes së kryer në regjistrin tregtar të kryegjësë bazë

Neni 438

(1) Në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së aksioneve, dorëzohet fletëparaqitje për regjistrimin e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar në mënyrë përkatëse me shumën e përgjithsme të aksioneve të ndërmarra.

(2) Me fletëparaqitjen nga paragrafit 1 të këtij neni, përveç shtojcave nga neni 433, paragrafi 2, prej pikave 2, 3, 4, 5, 6, dhe 9 bashkangjiten edhe:

1) statuti në të cilin është përmbajtur dispozita për zmadhim me kusht të kryegjësë bazë;

2) ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së organit drejtues, në të cilin është marrë vendimi për dhënien e aksioneve;

3) pajtueshmëria e shumicës së anëtarëve joekzekutivë të këshillit të drejtorëve, përkatësisht shumicës së anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, nëse me autoritim nga neni 436, paragrafi 1 i këtij ligji, këshilli i drejtorëve përjashtimin e të drejtës për përparësi në regjistrim mund ta kryejë vetëm me pajtimin e tyre; dhe

4) deklaratën me të cilën organi drejtues dëshmon se aksionet janë dhënë në kuadër të autorizimit për dhënien e aksioneve të reja dhe vetëm për shkak të realizimit të qëllimit të caktuar në autorizim nëse është përcaktuar me statut.

Seksioni i pestë

ZMADHIMI I KRYEGJËSË BAZË NGA MJETET E SHOQËRISË

Vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë me mjetet e shoqërisë

Neni 439

(1) Kuvendi mund ta zmadhojë kryegjënë bazë me vendimin për zmadhimin e kryegjësë bazë me transformimin e fitimit, rezervat dhe fitimet e papërcaktuara (të mbajtura) që nuk janë ndarë për dividendë ose për të cilat nuk është caktuar ndonjë synim tjetër (në tekstin e mëtejshëm: vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë me mjetet e shoqërisë).

(2) Vendimi për rritjen e kryegjësë themelore me mjete të shoqërisë, doemos duhet të bazohet në llogarinë e fundit vjetore të reviduar nga revizor i autorizuar për të cilën revizioni ka shprehur mendim pa rezervë ose mendim me rezervë i cili nuk e vë në pikëpyetje objektivitetin e llogarisë vjetore si dhe të raportit vjetor për punën e shoqërisë në vitin afarist paraprak, të miratuara nga kuvendi.

(3) Nëse në kuvendin e fundit të rregullt nuk është caktuar revizor i autorizuar, konsiderohet se është caktuar ai revizor i autorizuar që është caktuar nga kuvendi për revizionin e llogarisë së fundit vjetore ose revizori i autorizuar, i cili me propozimin e shoqërisë do të caktohet nga gjykata.

(4) Zmadhimi i kryegjësë bazë me mjetet e shoqërisë mund të kryhet me dhënien e aksioneve të reja. Në vendimin për zmadhimin e kryegjësë bazë doemos duhet të theksohet se në çfarë mënyre do të bëhet zmadhimi i kryegjësë bazë.

(5) Aksionarët kanë të drejtë për aksionet e posadhëna, në proporcion me aksionet e tyre në kryegjënë e deriatëhershme bazë.

(6) Dispozita e statutit, përkatësisht vendimi i kuvendit që është në kundërshtim me paragrafin 5 të këtij neni është i pavlefshëm.

Përshtatshmëria e dobisë dhe rezervave të zmadhimit të kryegjësë bazë

Neni 440

(1) Rezervat statutare mund të shndërrohen në kryegjënë bazë në shumën e plotë, nëse rezerva ligjore mund të shndërrohet në kryegjësë bazë vetëm nëse e tejkalon shumën e caktuar me këtë ligj.

(2) Fitimi dhe rezervat nuk mund të shndërrohen në kryegjënë bazë nëse në bilancin e gjendjes paraqitet humbje, duke përfshirë edhe humbjen e bartur nga vitet e mëparshme.

(3) Rezervat statutare të cilat janë caktuar për realizimin e dedikimit të caktuar mund të shndërrohen në kryegjënë bazë vetëm nëse kjo është në pajtim me atë dedikim.

(4) Përfitimi mund të shndërrohet në kryegjë themelore vetëm pasi që shoqëria të ndajë rezervë të përgjithshme të detyrueshme, në pajtim me nenin 485 të këtij neni.

Fletëparaqitja për regjistrimin e zmadhimit të kryegjësë bazë me mjetet e shoqërisë

Neni 441

(1) Në afat prej tetë ditësh nga dita e dhënies së aksioneve, sipas vendimit për zmadhimin e kryegjësë bazë me mjetet e shoqërisë, dërgohet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të zmadhimit të kryegjësë bazë.

(2) Me fletëparaqitjen nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç shtojcave nga neni 433, paragrafi 2, nga pikat 6, 7 dhe 9 bashkangjiten edhe:

1) llogari vjetore, e reviduar nga ana e revizorit të autorizuar për të cilën revizori ka shprehur mendim pa rezervë ose mendim me rezervë i cili nuk e vë në pyetje objektivitetin e llogarisë vjetore;

2) vendimin për zmadhimin e kryegjësë bazë me mjetet e shoqërisë;

3) ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së kuvendit në të cilën është marrë vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë me mjetet e shoqërisë të verifikuara në noter;

4) deklaratë të nënshkruar nga kryetari i Këshillit të Drejtorëve, përkatësisht nga kryetari i Këshillit Udhëheqës me të cilën garanton se sipas llogarisë vjetore ose raportit financiar që është marrë si bazë për rritjen e kryegjësë themelore, për të cilën revizori i autorizuar ka shprehur mendim pa rezervë ose mendim me rezervë i cili nuk e vë në pikëpyetje objektivitetin e llogarisë vjetore, deri në ditën e dorëzimit të fletëparaqitjes për regjistrim në regjistrin tregtar të rritjes së kryegjësë themelore, nuk ka arrdhur deri të zvogëlimi i pronës së shoqërisë, e cila do të ishte pengesë për rritjen e kryegjësë themelore me mjetet e shoqërisë, nëse për rritjen do të vendosej në ditën e dorëzimit të fletëparaqitjes.

Nënseksioni i dytë

ZVOGËLIMI I KRYEGJËSË BAZË

Sektori i parë

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Mënyra e zvogëlimit të kryegjësë bazë

Neni 442

(1) Kryegjëja bazë mund të zvogëlohet me:

- 1) zvogëlimin e shumës nominale të një ose më shumë llojeve dhe aksioneve të klasave;
- 2) bashkangjtitjen e një ose më shumë llojeve të aksioneve, me atë që shuma më e vogël nominale e aksionit të bashkangjitur nuk mund të jetë më e vogël se një euro;
- 3) tërheqjen e aksioneve personale dhe aksioneve të tjera, nëse me tërheqjen bëhet zvogëlimi i kryegjësë bazë.

(2) Pas zvogëlimit të shumës nominale dhe numrit të aksioneve, përkatësisht pas tërheqjes së aksioneve personale dhe aksioneve tjera, nëse me tërheqjen bëhet zvogëlimi i kryegjësë bazë, dhe pas regjistrimit dhe pas shpalljes së regjistrimit të zvogëlimit të kryegjësë bazë në regjistrin tregtar, aksionet anulohen.

(3) Kryegjëja bazë nuk mund të zvogëlohet më shumë nga shuma më e vogël nominale e përcaktuar me kryegjënë bazë me këtë ligj.

(4) Nëse shoqëria e zvogëlon kryegjënë bazë, në kundërshtim me dispozitën nga paragrafi 3 i këtij neni, vendimi për zvogëlimin e kryegjësë bazë është i pavlefshëm, përveç nëse së bashku me vendimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë nuk është marrë edhe vendimi për zmadhimin e kryegjësë bazë së paku deri në shumën më të vogël të caktuar për kryegjënë bazë me këtë ligj.

Sektori i dytë

ZVOGËLIMI I RREGULLT I KRYEGJËSË BAZË

Vendimi për zvogëlimin e rregullt të kryegjësë bazë

Neni 443

(1) Zvogëlimi i kryegjësë bazë bëhet me vendimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë, të cilin e merr kuvendi me shumicën e votave që nuk mund të jetë nën dy të tretat e aksioneve me të drejtë vote të përfaqësuesve në kuvend, përveç nëse me statut nuk është caktuar shumicë më e madhe.

(2) Nëse ekzistojnë më shumë lloje të aksioneve, për plotfuqishmërinë e vendimit nevojitet pajtueshmëria e aksionarëve të çdo lloji të aksioneve, me shumicë që nuk mund të jetë më e vogël se shumica e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni. Për dhënien e pajtueshmërisë, aksionarët e çdo lloji të aksioneve marrin vendim të veçantë për pajtueshmëri. Vendimi për pajtueshmëri merret në mënyrën dhe sipas kushteve të caktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

(3) Me vendimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë përcaktohen shuma, qëllimi si dhe mënyra për zbatimin e zvogëlimit të kryegjësë bazë. Nëse zvogëlimi i kryegjësë bazë bëhet me qëllim që t'u kthehet një pjesë nga baza e zvogëluar e kryegjësë bazë të aksionarëve, kjo doemos duhet të theksohet në vendim.

(4) Me ftesën, me të cilën konvokohet kuvendi në të cilin vendoset për zvogëlimin e kryegjësë bazë shënohen shkaku, qëllimi dhe mënyra me të cilën do të kryhet zvogëlimi i kryegjësë bazë.

Regjistrimi i vendimit

Neni 444

(1) Në endimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë, kryhet parashënimi në regjistrin tregtar. Për parashënimin dërgohet fletëparaqitje për regjistrim.

(2) Në fletëparaqitje bashkangjiten:

- 1) vendimi i kuvendit për zvogëlimin e kryegjësë bazë;
- 2) ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së kuvendit në të cilin është marrë vendimi për zvogëlimin e kryegjësë bazë, i verifikuar në noter;

(3) Kryetari i këshillit të drejtorëve, përkatësisht kryetari i këshillit drejtues, ditën vijuese të punës pas regjistrimit të parashënit të vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar, shpall qëllimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" dhe së paku në një gazetë ditore. Në shpallje, shoqëria proklamon se është në pajtim të çdo kreditori i cili do të paraqesë kërkesë që t'i paguhet kërkesa e arritur ose t'i jepet siguri për kërkesën. Nëse pas kalimit të nëntëdhjetë ditëve nga dita e publikimit të shpalljes nuk paraqitet kërkesë për pagesën e kërkesës, llogaritet se të gjithë kreditorët pajtohen me venimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë.

(4) Kreditorët e njohur, kërkesat e të cilëve tejkalojnë 10.000 euro në kundërvlerën me denarë, lajmërohen me shkrim, individualisht, në vendbanim, përkatësisht selinë e kreditorit të regjistruara në regjistrin tregtar.

Sigurimi i kreditorëve

Neni 445

(1) Shoqëria, për kërkesën e bërë parashënit të vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë të shoqërisë në regjistrin tregtar, doemos duhet t'i japë çdo kreditori siguri përkatës, nëse:

- 1) kreditori ka paraqitur kërkesë para marrjes së vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë, pa dallim se kërkesa është dërguar, në afat prej nëntëdhjetë ditësh nga dita e publikimit të shpalljes për qëllimin e zvogëlimin të kryegjësë bazë;
- 2) kreditori, me paraqitjen e kërkesës që nuk ka arritur, ka kërkuar sigurimin e tij; dhe
- 3) ka mjaft shkaqe që të llogaritet se zvogëlimi i kryegjësë bazë do ta zvogëlojë aftësinë e shoqërisë që ta paguajë kërkesën e kreditorit.

(2) Kreditori i cili ka të drejtë përparësie në përmbushjen e masës falimentuese të debitorit, përkatësisht që ka realizuar sigurim, nuk ka të drejtë të kërkojë sigurim të ri për shkak të zvogëlimin të kryegjësë bazë.

(3) Nëse zvogëlimi i kryegjësë bazë të shoqërisë është bërë në kundërshtim me paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni, vendimi për zvogëlimin e kryegjësë bazë është i pavlefshëm.

Bashkangjitja e aksioneve

Neni 446

(1) Nëse zvogëlimi i kryegjësë bazë bëhet me zvogëlimin e shumë nominale të aksioneve ose me bashkangjtitjen e një ose të më shumë llojeve dhe klasave të aksioneve me zvogëlimin e shumë të tyre nominale, aksionarëve u jepen aksione të reja me shumë të re nominale, proporcionalisht me atë sa kanë marrë pjesë aksionet e tyre në kryegjënë bazë para zvogëlimit të kryegjësë bazë. Aksionet e reja janë të llojit dhe klasit të njëjtë si aksionet për të cilat zëvendësohen.

(2) Këshilli i drejtorëve, përkatësisht këshilli drejtues i paraqet kërkesë Depozitorit qendror të letrave me vlerë që të bëhen ndryshime në librin e aksionarëve të shoqërisë, në mënyrë përkatëse me zvogëlimin e bërë të kryegjësë bazë, ashtu që të shënohet shuma e re nominale e aksioneve ose zvogëlimi i numrit të aksioneve për shkak të bashkimit ose tërheqjes së aksioneve.

(3) Para se të bëhet dhënia e aksioneve të reja përshkak të zvogëlimit të shumë nominale të aksionarëve ose përshkak të bashkimit të aksioneve, nuk guxon të jepen aksione të reja.

Pagesat e aksionarëve

Neni 447

(1) Aksionarëve duhet t'u paguhet një pjesë e kryegjësë së zvogëluar bazë edhe pas pagesës së bërë të kërkesës së kreditorëve ose pas dhënies së sigurisë së kërkesave të tyre, në pajtim me këtë nënseksion.

(2) Pagesat në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni mund të bëhen nëse është bërë zvogëlimi i kryegjësë bazë dhe nëse është kryer regjistrimi i zvogëlimit të bërë në regjistrin tregtar. Aksionarët nuk mund të lirohen nga obligimi që t'i paguajnë pagesat e papaguara për aksionet, përkatësisht nëse nuk e kanë paguar depozitimin që e kanë marrë për obligim ta paguajnë përderisa nuk i paguajnë kërkesat e kreditorëve që janë paraqitur, përkatësisht nëse shoqëria nuk jep siguri përkatëse për kërkesat e tyre.

(3) Nëse është bërë padi për anulimin e vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë, pagesat nuk mund të bëhen, përkatësisht lirimi nga pagesa e mëtejme e aksioneve nuk arrin para plotfuqishmërisë së vendimit të gjykatës.

Pagesa e dividendës

Neni 448

(1) Shoqëria nuk mund të paguajë dividendë më të lartë se 4% nga kryegjësja bazë e shoqërisë para se të kalojnë dy vjet nga viti në të cilin është marrë vendimi për zvogëlimin e kryegjësë bazë.

(2) Përkufizimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk u përket shoqërive të cilat deri në regjistrimin e vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar i kanë paguar kërkesat e kreditorëve ose kanë dhënë siguri përkatëse për kërkesat e tyre.

(3) Shoqëria nga paragrafi 1 i këtij neni që ka për qëllim të paguajë dividendë, doemos duhet të shpallë raportin financiar vjetor. Në shpallje duhet t'i lajmërojë kreditorët për qëllimin që ta bëjë pagesën për dividendë dhe për të drejtën e tyre të kërkojnë pagesën e kërkesave të tyre ose të kërkojnë t'u jepet për atë siguri përkatëse. Siguri nuk mund të

kërkojnë kreditorët që kanë të drejtën për përparësi në pagesën e kërkesave në rast falimentimi.

Seksioni i tretë

ZVOGËLIMI MË I THJESHTË I KRYEGJËSË BAZË

Neni 449

(1) Zvogëlimi më i thjeshtë i kryegjësë bazë mund të bëhet vetëm përshkak të pagesës së shumës nominale të kryegjësë bazë me shumën më të ulët nominale të kryegjësë bazë, që do të bëhet si pasojë e mbulimit të humbjes së shoqërisë në ngarkesë të kryegjësë bazë. Nëse zvogëlimi i kryegjësë bazë bëhet në mënyrën më të thjeshtë, nuk zbatohen dispozitat e neneve 445 dhe 447 të këtij viti.

(2) Zvogëlimi më i thjeshtë i kryegjësë bazë kryhet me vendimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë. Në vendimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë doemos duhet të theksohet se qëllimi për zvogëlimin e kryegjësë bazë është mbulimi i humbjes dhe plotësimi i rezervave ligjore.

(3) Kryegjëja bazë mund të zvogëlohet në mënyrën më të thjeshtë vetëm pasi të harxhohet dobia e pandarë dhe rezervat e shoqërisë.

(4) Shuma e fituar me zvogëlimin e kryegjësë bazë nuk guxon t'u paguhet aksionarëve dhe nuk guxon të përdoret për t'u liruar aksionarët nga pagesat e mëtejshme të depozitimit në bazën mbi të cilën i kanë marrë aksionet.

Seksioni i katërt

ZVOGËLIMI I KRYEGJËSË BAZË

Supozime

Neni 450

(1) Zvogëlimi i kryegjësë bazë me tërheqjen e aksioneve mund të bëhet vetëm nëse me ligj dhe me statut është theksuar e lejueshme.

(2) Tërheqja e akaioneve bëhet sipas dispozitave të këtij ligji me të cilat bëhet zvogëlimi i rregullt i kryegjësë bazë.

(3) Kuvendi, në vendimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë, përcakton mënyrën se si do të zbatohet tërheqja e aksioneve, afati si dhe hollësitë si duhet të zbatohet ajo.

(4) Për pagesën e kompensimit, aksionarëve që u përket në rast të tërheqjes së dhunshme të aksioneve ose nëse aksionet fitohen që të tërhiqen, si dhe për lirimin e aksionarëve nga obligimi për pagesën e depozitimit të ndërmarre, në mënyrë përkatëse, zbatohen dispozitat e nenit 445 të këtij ligji.

(5) Nuk veprohet sipas paragrafit 2 të këtij neni nëse aksionet për të cilat në përgjithësi është paguar shuma nominale ose më e madhe për të cilën janë dhënë:

1) falas i janë dhënë në disponim shoqërisë;

2) janë tërhequr në ngarkesë të fitimit ose rezervave të mbetura nëse ato mund të shfrytëzohen për atë.

(6) Në rastet nga paragrafi 5 i këtij neni në fitimin kapital bartet shuma që i përgjigjet shumës së kryegjësë bazë, e cila u përket aksioneve të tërhequra. Ato mjete, përveç në rastet e zvogëlimit të kryegjësë bazë, nuk guxojnë t'u paguhen aksionarëve.

(7) Zvogëlimi i kryegjësë bazë, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, bëhet me vendimin për zvogëlimin e kryegjësë bazë që e merr kuvendi me shumicën e aksioneve me të drejtë vote të përfaqësuar në kuvend, përveç nëse me statut nuk është caktuar shumicë më e madhe ose nuk kërkohet plotësimi i kushteve të tjera. Në vendim përcaktohet qëllimi i zvogëlimit të kryegjësë bazë.

(8) Nëse tërheqja e dhunshme e aksioneve është caktuar me statut, nuk është nevojitet që kuvendi të marrë vendim për zvogëlimin e kryegjësë bazë me tërheqjen e aksioneve. Në atë rast, organi drejtues është i autorizuar ta marrë vendim për tërheqjen e aksioneve.

(9) Vendimi për zvogëlimin e kryegjësë bazë me tërheqjen e aksioneve, regjistrohet në regjistrin tregtar.

Seksioni i pestë

REGJISTRIMI I ZVOGËLIMIT TË REALIZUAR I KRYEGJËSË BAZË

Regjistrimi

Neni 451

(1) Në afat prej tetë ditësh nga dita pas zvogëlimit kryer të kryegjësë bazë, dorëzohet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar.

(2) Kryegjëja bazë zvogëlohet për zvogëlimin e përgjithshëm të shumës nominale të një ose më shumë llojeve të aksioneve, përkatësisht për shumën e plotë të zvogëluar nominale të aksioneve të bashkuara të një ose më shumë llojeve të aksioneve ose për shumën e përgjithshme nominale të aksioneve të tërhequra.

(3) Kryegjëja bazë është zvogëluar me regjistrimin e vendimit për zvogëlimin e kryegjësë bazë në regjistrin tregtar.

Seksioni 10

PUSHIMI I SHOQËRISË

Bazat e ndërprerjes

Neni 452

(1) Shoqëria pushon me:

1) kalimin e kohës së caktuar me statut, nëse shoqëria është themeluar për kohë të caktuar;

2) vendimin e kuvendit për pushimin e shoqërisë të marrë me shumicë votash, që nuk mund të jetë nën dy të tretat e aksioneve me të drejtë

vote të përfaqësuar në kuvend, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe dhe nuk janë caktuar kushte të tjera për marrjen e vendimit.

3) vendimin e plotfuqishëm të gjykatës vërtetohet si i pavlefshëm për shoqërinë dhe regjistrimi i shoqërisë në regjistrin tregtar;

4) bashkangjitet, me bashkimin ose me ndarjen e shoqërisë me me shkëputje me themelim dhe me shkëputje me ndërmarrje; dhe

5) falimentim.

(2) Qëllimi për shlyerjen e shoqërisë nga regjistri tregtar, shpallet. Çdo person që ka interes juridik mund të dërgojë kundërshtim, më së voni në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e shpalljes së qëllimit për shlyerjen e shoqërisë.

(3) Shoqëria pushon pa zbatimin e likuidimit, përveç nëse në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni tregohet se shoqëria ka pronë që duhet të ndahet dhe kërkesa që duhet të paguhet. Në atë rast, zbatohet likuidimi, përkatësisht procedura falimentuese. Likuidatorët, me propozimin e personave të interesuar, i cakton gjykata.

(4) Me statut mund të caktohen edhe kushte të tjera për pushimit të shoqërisë.

Regjistrimi i vendimit për ndërprerje

Neni 453

(1) Organi drejtues, përkatësisht personi tjetër fizik i autorizuar nga kuvendi që e ka marrë vendimin për pushimin e shoqërisë, dërgon fletëparaqitje përshkak të regjistrimit në regjistrin tregtar të vendimit për ndërprerjen e shoqërisë.

(2) Nëse vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk paraqitet dhe nuk regjistrohet në mënyrën e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, me propozim të çdo personi që ka interes juridik, gjykata i bën apel organit drejtues, përkatësisht personit fizik nga paragrafi 1 i këtij neni që në afat jo më shumë se tetë ditë nga dita e pranimit të lajmërimit, të dërgojë fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të vendimit për ndërprerjen e shoqërisë. Nëse në këtë afat nuk është dërguar fletëparaqitja, gjykata bënë serish apel me të cilin e paralajmëron organin drejtues, përkatësisht personin fizik nga paragrafi 1 i këtij neni se pas skadimit të afatit plotësues, i cili nuk është më i gjatë se 8 ditë nga dita e pranimit të paralajmërimit të dytë, me obligim zyrtar, do të kërkojë nga Regjistri qendror që të shënojë në regjistrin tregtar vendimin për pushimin e shoqërisë dhe do të caktojë likuidatorë në pajtim me këtë ligj.

(3) Nëse organi drejtues nuk vepron sipas paragrafit 2 të këtij neni, anëtarët e organit drejtues, përkatësisht personi fizik nga paragrafi 1 i këtij neni, personalisht dhe në mënyrë solidare janë përgjegjës me gjithë pronën e vet për dëmin që do të shkaktohet nga mosplotësimi i obligimit të tyre të caktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

(4) Nëse vendimin për pushimin e shoqërisë e ka marrë gjykata, gjykata, sipas obligimit zyrtar e dërgon në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë që e regjistron në regjistrin tregtar.

Baza për pushimin e shoqërisë prej një personi

Neni 454

(1) Shoqëria nga një person, në të cilën pronar i aksioneve është person fizik, pushon me vdekjen e atij personi, nëse pas procedurës së zbatuar trashëgimore, trashëgimtarët nuk kërkojnë që shoqëria të vazhdojë me punë.

(2) Për aksionet në pronën e bashkëpronarit të vdekur, deri në mbarimin e procedurës trashëgimore, të drejtën e votës e realizon përfaqësuesi i përbashkët, i caktuar nga trashëgimtarët e bashkëpronarit të vdekur, me autorizim me shkrim, të verifikuar në noter.

(3) Nëse pronari i aksioneve të shoqërisë nga një person, është personi juridik, shoqëria prej një personi pushon me pushimin e personit juridik, përveç nëse në procedurën për falimentim, aksionet i merr personi tjetër.

KAPITULLI I PESTË

TRANSAKSIONE TË MËDHA DHE TRANSAKSIONE ME PALË TË INTERESUARA

Seksioni 1

TRANSAKSIONET E MËDHA

Nocioni për transaksionin vëllimor

Neni 455

(1) Si transaksion i madh konsiderohet transaksioni (duke përfshirë pa kufizim, hua, kredi, peng, garanci) ose transaksione të lidhura të ndërsjella, nëse transaksioni përkatësisht transaksionet e atilla kanë të bëjnë me përfitim apo tjetërsim apo me tjetërsim të mundshëm të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të pronës së shoqërisë, vlera e së cilës është mbi 20% të vlerës së përllëguaritur të pronës së shoqërisë, e përcaktuar në bazë të raporteve të fundit financiare të shoqërisë, me përjashtimin e transaksioneve të lidhura me përfitimin përmes regjistrimit të aksioneve të rëndomta të shoqërisë dhe transaksioneve të lidhura me përfitimin e obligacioneve konvertibile. Në statut mund të përcaktohen edhe transaksione të tjera, në të cilat do të zbatohet procedura e miratimit të transaksioneve të mëdha, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj. ²⁶

(2) Në rast të tjetërsimit ose të krijimit të mundësisë për tjetërsimin e pronës, vlera e kësaj prone e cila është vërtetuar në bazë të raporteve të reviduara të fundit financiare të shoqërisë dhe në rast të fitimit të pronës, çmimi i pronës që blihet krahasohet me vlerën e llogarisë së kontabiluar të pronës së shoqërisë.

(3) Atëherë kur, në pajtim me këtë ligj, kuvendi merr vendim për miratimin e transaksionit të madh, vendimin e merr në bazë të vlerës së llogaritur të pronës që fitohet ose tjetërsohet, të caktuar nga këshilli i drejtorëve, përkatësisht këshilli mbikëqyrës.

Procedura për miratimin e transaksionit të madh

Neni 456

(1) Sipas madhësisë, çdo transaksion i madh doemos duhet të miratohet nga këshilli i drejtorëve, këshilli mbikëqyrës ose kuvendi.

(2) Vendimin për lejimin e transaksionit të madh që ka të bëjë me pronën, vlera e së cilës është çmuar mbi 20% deri 50% të vlerës së kontabilitetit të pronës së shoqërisë merret në pajtim me të gjithë anëtarëve të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës.

(3) Nëse nuk arrihet pajtueshmëri nga paragrafi 2 i këtij neni për miratimin e transaksionit të madh, këshilli i drejtorëve, gjegjësisht këshilli mbikëqyrës mund të vendosë që transaksioni i madh për të cilën duhet të merret Vendimi ta dorëzojë në miratim të kuvendit. Vendimin, kuvendi e miraton me shumicë votash që nuk mund të jetë më pak se shumica e aksioneve të përfaqësuara të kuvendit me të drejtë vote, përveç nëse me statut nuk është caktuar shumicë më e madhe.

(4) Vendimin për miratimin e transaksionit të madh lënda e së cilës është prona vlera e të cilës është vlerësuar mbi 50 % nga vlera e kontabilitetit të pronës së shoqërisë, merret me shumicë votash që nuk mund të jetë nën dy të tretat e aksioneve me të drejtë vote të përfaqësuara në kuvend, përveç nëse me statut nuk është caktuar shumicë më e madhe.

(5) Këshilli i drejtorëve, gjegjësisht këshilli mbikëqyrës i kuvendit i dorëzojnë lajmërim me shkrim për transaksionin e madh ku shënojnë se kuvendi duhet ta shqyrtojë propozimin për transaksionin e madh dhe rekomandimin e tyre duke përfshirë edhe deklaratën për të drejtën e aksionarëve të mos pajtohen në transaksionin e madh. Në deklaratën me shkrim theksohet pala, gjegjësisht palët e transaksionit, shfrytëzuesi gjegjësisht shfrytëzuesit e transaksionit, vlera lënda, sasia dhe kushtet tjera materiale të transaksionit.

(6) Në rast se për largimin e transaksionit të madh anëtarë i organit drejtues, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës ka interes personal, gjegjësisht pala e interesuar për miratimin e saj, zbatohen dispozitat e këtij ligji a i përket transaksionit të palës së interesuar.

(7) Transaksioni i madh, i kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij neni është i pavlefshëm.

(8) Dispozitat e këtij neni nuk vlejnë për shoqëritë me një aksionar, i cili njëkohësisht është edhe administrues.

Neni 456-a

(1) Dispozitat nga nenet 455 dhe 456 nga ky ligj në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, me përjashtim të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të themeluar nga një person, në të cilën bashkëpronari njëkohësisht është edhe drejtor.

(2) Vendimin nga neni 456 paragrafi (3) nga ky ligj, mbledhja e bashkëpronarëve e miraton me shumicë e cila nuk mund të jetë më e vogël se shumica e votave të cilat i japin investimet në pajtim me nenin 218 nga ky ligj, nëse me marrëveshjen për shoqërinë nuk është caktuar shumicë më e madhe.

(3) Vendimin nga neni 456 paragrafi (4) nga ky ligj, mbledhja e bashkëpronarëve e miraton me shumicë e cila nuk mund të jete nën dy të tretat nga shumica e votave të cilat i japin investimet në pajtim me nenin 218 nga ky ligj, nëse me marrëveshjen për shoqërinë nuk është caktuar shumicë më e madhe.

(4) Vendimet e miratuara në kundërshtim me dispozitat nga ky nen janë të pavlefshme.

SEKSIONI 2**TRANSAKSIONE ME PALË TË INTERESUARA****Transaksionet e shoqërisë me palë të interesuara****Neni 457**

(1) Çdo transaksion (duke përfshirë, hua, kredi, peng ose garanci pa kufizime) në të cilën pala e interesuar është anëtar i organit administrues, gjegjësisht këshilli mbikëqyrës apo administrues duke përfshirë edhe personat udhëheqës ose aksionarët e shoqërisë të cilët së bashku me personat e lidhur posedojnë 20 % ose më shumë përqindje të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë ose person që ka autorizim të japë instruksione shoqërisë që janë të obliguara, konsiderohet si transaksion me palën e interesuar dhe zbatohet nga ana e shoqërisë në procedurë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Konsiderohet se personi nga paragrafi 1 i këtij neni është palë e interesuar dhe ka interes në kryerjen e transaksionit nga ana e shoqërisë nëse ai person, përfaqësuesi i tij, bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit/motrat nga të dy prindërit ose vetëm nga njëri prind, prindër-adoptues, fëmijë të adoptuar, dhe/ose ndonjë person i lidhur me ata (në tekstin e mëtejshëm pala e interesuar):

- 1) është palë në atë transaksion, shfrytëzues i tij, prezentues ose përfaqësues në atë transaksion, ose
- 2) individualisht ose së bashku kanë 20 % ose më shumë përqindje të aksioneve të personit juridik që është palë në transaksion shfrytëzues i tij përfaqësues apo ndërmjetësuesi në atë transaksion, ose
- 3) është anëtarë në organin e udhëheqjes, gjegjësisht në këshillin e personit juridik që është palë në transaksion, shfrytëzues i tij, përfaqësues apo ndërmjetësuesi në atë transaksion ose është udhëheqës i personit juridik, ose
- 4) nëse është caktuar ashtu me statut.

(3) Dispozitat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen:

- 1) nëse shoqëria ka aksionar të vetëm i cili njëkohësisht është edhe drejtor,
- 2) nëse të gjithë aksionarët e shoqërisë kanë interes në transaksion;
- 3) në rast të realizimit të së drejtës me përparsi në blerje të aksioneve të dhëna nga shoqëria; dhe
- 4) gjatë përfitimit apo blerjes së aksioneve vetanake.

Lajmërimi për pronën e ekzistuar**Neni 458**

Nëse shoqëria në afat prej dy viteve nga themelimi i shoqërisë ka përfituar çfarëdo lloj prone që është në pronësi të themeluesve që është më e madhe se një e dhjeta e kryegjësë bazë të shoqërisë, është patjetër në imtësira të analizohet përfitimi i pronës dhe të shpallet raporti në mbledhjen e ardhshme që të kërkohet miratimi.

Lajmërimi për palën e interesuar në transaksionet e shoqërisë**Neni 459**

Personat e theksuar në nenin 457 të këtij ligji janë të obliguar ta lajmërojnë këshillin e drejtorëve, gjegjësisht këshillin mbikëqyrës:

- 1) për shoqëritë të cilat ato vet apo sëbashku me persona të lidhur kanë 20% apo më shumë përqindje të kontributit, gjegjësisht aksionet me të drejtë vote,
- 2) për shoqëritë në organet e të cilave ka funksione të drejtorëve; dhe
- 3) për ta transaksione të njohura rrjedhëse apo të mundshme ku është pala e interesuar.

Procedura për miratimin e transaksionit për palën e interesuar

Neni 460

(1) Çdo transaksion me palë të interesuar është lëndë e miratimit të mëparmë nga ana e këshillit të drejtorëve, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës ose të kuvendit në mënyrë dhe sipas procedurës së caktuar në këtë nen.

(2) Vendimi për lejimin e çdo transaksioni me palën e interesuar merret me shumicën e votave të anëtarëve të këshillit të drejtorëve, përkatësisht të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të cilët nuk kanë interes në transaksion. Nëse të gjithë anëtarët e këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës janë palë të interesuara ose nëse numri i anëtarëve të këshillit të drejtorëve, përkatësisht anëtarët e këshillit mbikëqyrës të cilët nuk kanë interes është më i vogël nga numri që është i nevojshëm për kuorum për seancën e këshillit të drejtorëve, përkatësisht të këshillit mbikëqyrës të përcaktuar në statutin, transaksionin e këtillë e lejon kuvendi.

(3) Kuvendi e lejon transaksionin me palën e interesuar me shumicën e votave të të gjithë aksionarëve të cilët nuk kanë interes, ndërsa posedojnë aksione me të drejtë vote edhe atë, nëse: 27

1) nëse vlera e pronës për të cilën bëhet fjalë ky transaksion ose seri e transaksioneve të lidhura është vërtetuar me vlerë prej 2% ose më shumë përqind nga vlera e kontabilitetit të pronës së shoqërisë, sipas raporteve të fundit të reviduara financiare në bazë të raporteve të fundit financiare të shoqërisë të vërtetuara në bazë të vlerës së pronës caktohet në bazë të raporteve të shoqërisë ose çmimi i ofruar kur prona duhet të blihet;

2) nëse transaksioni apo transaksioneve të lidhura i përket dhënies përmes regjistrimit ose shitjes së aksioneve që janë më shumë se 2 % përqind nga aksionet e thejshta të shoqërisë të mbetura në atë periudhë dhe aksionet e thjeshta në të cilat mund të konvertohen letra me vlerë të dhëna paraprakisht në seri dhe që janë konvertibile në aksione; ose

3) nëse transaksioni ose transaksionet e lidhura i përket dhënies përmes regjistrimit të kreditorëve konvertabil që mund të konvertohen në aksione të thjeshta dhe që kanë shumë më të madhe se 2 % përqind nga aksionet e rëndomta të dhëna të shoqërisë, dhe njëkohësisht paraprakisht aksionet e rëndomta të dhëna në seri janë konvertibile në aksione.

(4) Në vendimin ku miratohet transaksioni për palë të interesuara caktohet personi që është palë e transaksionit ose shfrytëzues, si dhe vlera, lënda dhe kushtet tjera materiale të transaksionit.

(5) Në procedurën e miratimit të transaksionit për palën e interesuar çmimi i pronës ose shërbimet që shiten ose blehen me atë i cakton këshilli i drejtorëve, gjegjësisht këshilli mbikëqyrës.

(6) Transaksioni me palë të interesuar i kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij seksioni të këtij ligji është i pavlefshëm.

(7) Çdo palë e interesuar është përgjegjëse ndaj shoqërisë, aksionarëve dhe ndaj anëtarëve të tjerë të organit për menaxhim, përkatësisht këshillit mbikëqyrës ose drejtuesit, për dëmet që i ka shkaktuar nëse në afat prej tre vjetësh nga dita kur është e lejuar transaksioni me palën e interesuar vërtetohet se është e dëmshme për shoqërinë tregtare, aksionarët ose për anëtarët e organit për menaxhim, përkatësisht këshillit mbikëqyrës të cilët nuk kanë interes në transaksionin. Nëse më tepër palë të interesuara janë përgjegjëse, përgjegjësia e tyre është solidare.

Procedura për miratimin e transaksionit me palën e interesuar të shoqëria aksionare letrat me vlerë të së cilës kuotojnë në bursën e autorizuar

Neni 460-a

(1) Para miratimit të vendimit për miratimin e transaksionit me palën e interesuar, të miratuar nga organi kompetent i shoqërisë aksionare letrat me vlerë të së cilës kuotojnë në bursë të autorizuar, krahas dispozitave të nenit 460 të këtij ligji, nëse vlera e transaksionit që është lëndë e miratimit ose vlera kumulative e transaksioneve të lidhura ndërmjet veti gjatë 12 muajve të kaluar nga dita e miratimit të transaksionit është 10% e më shumë të vlerës së aktivitetit të shoqërisë të përcaktuar në bazë të raporteve të fundit të reviduara financiare vjetore, nevojitet mendim nga revizor i autorizuar që i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për revizion dhe Ligjin për letra me vlerë.

(2) Mendimi i revizorit të autorizuar ka të bëjë me atë nëse transaksioni me palën e interesuar është në përputhje me rregullat e vendit në fuqi, nëse transaksioni me palën e interesuar është i drejtë, përkatësisht nëse vlera e transaksionit është përcaktuar sipas kushteve të tregut, nëse ekziston disproporcion në detyrimet e përbashkëta të palëve, nëse ekzistojnë edhe çfarëdo qoftë fakte dhe rrethana tjera që do të mund të paraqesin bazë për shkaktim të dëmit me rekomandim të aksionarët pakicë nëse duhet ta mbështesin transaksionin me palën e interesuar.

(3) Shoqëria aksionare nga paragrafi (1) i këtij neni, mund ta realizojë transaksionin me palën e interesuar vetëm nëse para miratimit të transaksionit është marrë mendim nga revizori i autorizuar.

(4) Dispozitat e këtij neni nuk do të zbatohen kur shoqëria:

- kryen pagesë të dividendit,
- lëshon letra me vlerë dhe
- ofron shërbime financiare që bëjnë pjesë në domenin e punës së rregullt të shoqërisë aksionare (shërbime bankare, shërbime në punën me letra me vlerë, shërbime të lidhura me sigurimin e ngjashëm) kur të njëjtat janë të rregulluara me ligje të veçanta dhe janë nën supervizion të organit kompetent.

Shfuqizimi i marrëveshjes me palën e interesuar

Neni 460-b

(1) Aksionari i shoqërisë tregtare me të drejtë vote, nëse konsideron se shoqëria është dëmtuar për shkak të ekzistimit të disproporcionit evident ndërmjet detyrimeve të përbashkëta dhe kostove që dalin nga marrëveshja e lidhur ndërmjet palëve të interesuara, marrëveshje e cila njëkohësisht nuk është e drejtë, përkatësisht vlera e transaksionit nuk është përcaktuar sipas kushteve të tregut, mund të ngrejë padi te gjykata kompetente për shfuqizimin e marrëveshjes.

(2) Padia nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashtrohet në afat prej një viti nga dita njoftimit për ekzistimin e marrëveshjes së tillë, por jo më tepër se tre vjet nga dita e miratimit të saj në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Nëse gjykata e shfuqizon marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni, pala e interesuar që ka përfituar nga marrëveshja e këtillë, detyrohet që shoqërisë t'ia kompensojë dëmin e thjeshtë dhe dobinë e lëshuar (që e përfshin edhe fitimin e realizuar nga transaksioni i realizuar).

(4) Lartësia e kompensimit të dëmit përcaktohet sipas çmimeve në kohën e miratimit të vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(5) Gjatë përcaktimit të lartësisë së dëmit nga paragrafi (3) i këtij neni merret parasysh edhe vlera e dobisë së fituar nga realizimi i marrëveshjes së shfuqizuar.

(6) Kompensimi i dëmit është në dobi të shoqërisë.

(7) Dispozitat e këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për bashkëpronarin, përkatësisht bashkëpronarët investimet e të cilëve bashkërisht e përbëjnë së paku një të dhjetën e kryegjësë themelore të shoqërisë.

(8) Për tërë çështjet tjera që nuk janë të rregulluara me dispozitat e këtij neni, në mënyrë përkatëse zbatohen rregullat nga sfera e marrëdhënieve obliguese me të cilat rregullohen dëmi tejmasë dhe prishja e marrëveshjeve, në përgjithësi.

Procedura për inspektim dhe hulumtim/kontroll të librave tregtare dhe aktiviteteve në shoqëri

Neni 460-v

(1) Aksionari ose grupi i aksionarëve që kanë së paku 10% nga kryegjësja themelore e shoqërisë tregtare, në bazë të ekzistimit të dyshimit për parregullsi të mundshme në mbajtjen e librave tregtarë dhe aktiviteteve të shoqërisë tregtare, përkatësisht se shoqëria tregtare vepron në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare, kanë të drejtë të kërkojnë nga organi i menaxhimit që të konvokojë Kuvend të shoqërisë tregtare në të cilin do të emërohet revizori i autorizuar që do të kryejë inspektim, revizion, kontroll, vërtetim ose shërbime të lidhura në fushëveprimin e aktiviteteve të shoqërisë tregtare, për të cilat në kërkesë është shprehur dyshim për ekzistimin e parregullsive të mundshme.

(2) Aksionarët mund të kërkojnë nga gjykata kompetente që të miratojë aktvendim për emërimin e revizorit të autorizuar në pajtim me paragrafin

(1) të këtij neni, nëse:

- 1) Kuvendi nuk konvokohet në afat prej tetë ditësh nga parashtrimi i kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni;
- 2) Kuvendi refuzon të emërojë revizor të autorizuar ose
- 3) Kuvendi në afat prej 60 ditësh nga parashtrimi i kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk miraton vendim për emërim të revizorit të autorizuar.

(3) Kërkesa në gjykatë mund të parashtrohet në afat prej 30 ditësh nga kalimi i afateve nga paragrafi (2) pikat 1 dhe 3 të këtij ligji, përkatësisht në afat prej 30 ditësh nga dita kur Kuvendi ka refuzuar të emërojë revizor të autorizuar.

(4) Kuvendi përkatësisht gjykata, për qëllimet nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të emërojë revizor të autorizuar, i cili:

1) me shoqërinë tregtare ose aksionarët nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ka konflikt të interesave sipas Ligjit për revizion dhe

2) në tre vitet e fundit nuk i ka dhënë shërbime konsultuese shoqërisë tregtare ose aksionarëve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Shpenzimet për emërim dhe kompensim për revizorin e autorizuar janë në ngarkim të aksionarëve që e kanë kërkuar emërimin. Nëse pas përfundimit të inspektimit, revizori i autorizuar konstaton se ekzistojnë parregullsi në udhëheqjen e aktiviteteve (punës) të shoqërisë tregtare, shpenzimet për emërim dhe kompensim për revizorin e autorizuar janë në ngarkim të shoqërisë tregtare.

(6) Revizori i autorizuar i emëruar në pajtim me dispozitat e këtij neni përpilon raport në pajtim me standardet ndërkombëtare për revizion të publikuara në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", të njëjtin ua dorëzon parashtruesve të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe shoqërisë tregtare me të cilën ka të bëjë kërkesa. Shoqëria tregtare detyrohet që t'i mundësojë shikim në raportin e revizorit të autorizuar secilit aksionar dhe personit tjetër që ka interes juridik, në selinë e shoqërisë në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me nenin 320 të këtij ligji.

(7) E drejta për parashtrimin e kërkesës për emërim të revizorit të autorizuar në pajtim me paragrafi (1) të këtij neni, mund të realizohet në afat prej një viti nga dita e njoftimit për ekzistimin e parregullsive të mundshme në udhëheqjen e aktiviteteve të shoqërisë tregtare.

(8) Revizori nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ka të drejtë për qasje në të dhënat dhe informatat që kanë të bëjnë me patenta, të drejta të autorit, pronësi intelektuale etj.

Njoftimi për transaksion të realizuar me palën e interesuar

Neni 460-g

(1) Shoqëria aksionare letrat me vlerë të së cilës kuotojnë në bursën e autorizuar është e obliguar, pas realizimit të plotë të transaksionit me palën e interesuar, menjëherë e më së voni ditën e radhës të punës, së paku në një gazetë ditore, në ueb faqen e shoqërisë dhe në ueb faqen e bursës së autorizuar të shpallë njoftim për transaksionin e realizuar me palët e interesuara.

(2) Njoftimi nga paragrafi (1) i këtij neni përmban të dhëna për lëndën dhe vlerën e transaksionit të realizuar, fitimin nga transaksioni i realizuar, personat të cilët në transaksion janë palë e interesuar, natyrën e marrëdhënieve me palët e lidhura, si dhe informata tjera lidhur me interesin e personit, përkatësisht palëve të lidhura në transaksion.

KAPITULLI I GJASHTË

SHOQËRIA KOMANDITORE ME AKSIONE

Nocioni

Neni 461

(1) Shoqëria komanditore me aksione është shoqëri tregtare e cila e ka të ndarë kryegjënë bazë në aksione dhe në të cilën një apo më shumë bashkëpunar përgjigjen pakufi dhe në mënyrë solidare për obligimet e shoqërisë, me gjithë pronën që e kanë (në tekstin e mëtejshëm: komplementues) dhe disa bashkëpunar që kanë ndikim të aksionarëve dhe që i përgjigjen shumës së depozitimeve të tyre dhe që nuk përgjigjen për obligimet e shoqërisë (në tekstin e mëtejshëm: komplementues). **28**

(2) Numri i komanditorëve nuk mund të jetë më i vogël se tre.

(3) Marrëdhëniet juridike të komplementarëve në mes veti dhe ndaj komanditorëve si dhe ndaj personave të tretë dhe ndaj të drejtës komplementare të drejtuesve dhe përfaqësimit të shoqërisë komanditore me aksione rregullohen në mënyrë përkatëse me dispozitat e shoqërisë komanditore të caktuara me këtë ligj.

(4) Nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe për shoqërinë komanditore me aksione zbatohen dispozitat në mënyrë përkatëse të këtij ligji për shoqëritë aksionare, përveç dispozitave me të cilat rregullohet administrimi i shoqërisë aksionare.

(5) Firma e shoqërisë komanditore me aksione i përmban edhe fjalët shoqëria komanditore me aksione. apo shenja "SHKA".

Marrëveshja për shoqërinë komanditore me aksione

Neni 462

(1) Marrëveshja për shoqërinë komanditore me aksione (në tekstin e mëtejshëm: marrëveshjen për shoqërinë) e lidhin të gjithë themeluesit me verifikimin e nënshkrimeve të kontratës në noter.

(2) Komplementarët doemos duhet të marrin pjesë në lidhjen e kontratës për shoqërinë. Në lidhjen e kontratës marrin pjesë edhe personat që i ndërmarrin aksionet për depozitimet ekzekutive në gjendje të aksionarëve.

Të dhënat që i përmban marrëveshja e shoqërisë

Neni 463

(1) Përveç të dhënave të nenit 151 të këtij ligji, marrëveshja për shoqëri doemos duhet t'i përmbajë emrin, mbiemrin, NUAQ, numrin e pasaportës, gjegjësisht numrin e letërnjoftimit apo të ndonjë dokumenti tjetër për vërtetimin e identitetit që ka vlerë në vendin e tij nëse komplementuesi është person i jashtëm fizik dhe shtetësia e tij si dhe vendbanimi, gjegjësisht firma selija NUAS nëse komplementuesi është person juridik.

(2) Investimet e depozitimeve pa para të komplementarëve në marrëveshjen për shoqërinë janë përcaktuar sipas llojit dhe lartësisë.

(3) Depozitimet e komplementarëve së bashku nuk mund të jenë më të vogla se 10% të kryegjësë bazë.

Regjistrimi i shoqërisë komanditore me aksione

Neni 464

Gjatë regjistrimit të shoqërisë komanditore me aksione në regjistrin tregtar shënohen komplementarët. Nëse marrëveshja përmban dispozita

të veçanta për autorizimin e komplementarëve për përfaqësimin e shoqërisë komanditore me aksione, ato regjistrohen në regjistrin tregtar.

Kufizimi i komplementarëve në vendosje

Neni 465

(1) Në kuvendin e shoqërisë komanditore me aksione komplementarët kanë të drejtë vote në mënyrë të barabartë me pjesëmarrjen e tyre në kryegjënë bazë.

(2) Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, komplementarët nuk mund ta realizojnë të drejtën e tyre për votim as për vehte as për personin tjetër për vendosjen e lidhjes me:

- 1) Zgjidhja dhe thirja e këshillit mbikëqyrës;
- 2) Miratimi i punës së komplementarëve dhe këshillit mbikëqyrës;
- 3) Zgjidhja e kontrolluesve të posaçëm;
- 4) Theksimi i kërkesës për kompensim apo dorëzimi i të drejtës së kompensimit; dhe
- 5) Emëritmi i revizorit të autorizuar të llogarisë vjetore dhe të raporteve financiare.

(3) Për vendimet e kuvendit është e nevojshme pajtueshmëri e komplementarëve përderisa ato vendime janë për punët për të cilat në shoqërinë komanditore është e nevojshme pajtueshmëri e komplementarëve dhe komanditorëve. Vendimet e kuvendit të shoqërisë komanditore me aksione për të cilat është e nevojshme pajtueshmëri e komplementarëve dërgohen për regjistrim në regjistrin tregtar pasi të arrihet pajtueshmëria.

Administrimi me shoqërinë komanditore me aksione

Neni 466

(1) Me shoqërinë komanditore me aksione administrojnë komplementarët.

(2) Komplementarët mund tua besojnë administrimin me shoqërinë një apo më shumë drejtorëve.

Këshilli mbikëqyrës

Neni 467

(1) Kuvendi i shoqërisë komanditore me aksione zgjedh, në kushte dhe në mënyrë të caktuar me marrëveshjen për shoqërinë me aksione, anëtarët të këshillit mbikëqyrës, të përbërë së paku prej tre aksionarëve. Në këshillin mbikëqyrës nuk mund të zgjidhet aksionar nga radha e komplementarëve. Komplementarët nuk mund të marrin pjesë në zgjedhjen e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

(2) Këshilli mbikëqyrës bën kontroll të përhershëm mbi administrimin me shoqërinë komanditore me aksione. Në kuvendin e shoqërisë komanditore me aksione këshilli mbikëqyrës i dërgon raport të rregullt vjetor në të cilin shënon parregullsitë dhe pasaktësitë posaçërisht në llogaritë vjetore. Këshilli mbikëqyrës mund ta konvokojë mbledhjen e shoqërisë komanditore me aksione.

(3) Në paditë juridike që i udhëheqin të gjithë komanditorët kundër komplementarëve apo që i udhëheqin komplementarët kundër të gjithë

komanditorëve, komanditorët i përfaqësojnë anëtarët e këshillit mbikëqyrës në mënyrë të caktuar me statut, përveç nëse kuvendi nuk ka zgjedhur përfaqësues të posaçëm. Për shpenzimet e padisë që janë barë e komanditorëve përgjigjet shoqëria komanditore me aksione, pavarësisht nga e drejta e tij në regres ndaj komanditorëve.

Përgjegjësia e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

Neni 468

(1) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk përgjigjen në mënyrën se si administron me shoqërinë komanditore me aksione dhe për rezultatet e tyre.

(2) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk janë përgjegjës për lëshimet e komplementarëve apo të drejtorëve gjatë kryerjes së obligimeve të tyre apo për çfarëdo lëshimi me qëllim, përveç nëse kanë qenë të vetëdijshëm për lëshim të atillë, moskujdesja apo gabimi, dhe për atë nuk e kanë lajmëruar kuvendin e shoqërisë komanditore me aksione.

KAPITULLI I SHTATË

LIBRAT TREGTAR, LLOGARITË VJETORE DHE RAPORTET FINANCIARE

SEKSIONI 1

UDHËHEQJA E KONTABILITETIT

Obligimi për udhëheqjen e kontabilitetit

Neni 469

(1) Secili tregtar obligohet që të mbajë kontabilitet, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe me rregullat për kontabilitet dhe:

1) çdo tregtar i madh dhe i mesëm, tregtarët e përcaktuar me ligj si dhe tregtarët të cilët kryejnë veprimtari bankare, veprimtari të sigurimit, tregtarët të cilët kuotojnë në bursë si dhe tregtarët raportet financiare të të cilëve hyjnë në raportet e konsoliduara financiare të tregtarëve të përmendur paraprakisht, obligohen që të mbajnë kontabilitet në pajtim me standardet e miratuara ndërkombëtare për njoftim financiar, të botuara në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe

2) tregtarët tjerë obligohen që të mbajnë kontabilitet në pajtim me standardet ndërkombëtare për njoftim financiar, të subjekteve të vogla dhe të mesme.

(2) Standardet ndërkombëtare për njoftim financiar dhe standardet ndërkombëtare për njoftim financiar të subjekteve të vogla dhe të mesme, azhurnohen në bazë vjetore që të harmonizohen me standardet rrjedhëse, ashtu që plotësohen, ndryshohen ose miratohen nga ana e Këshillit për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

(3) Dispozitat e këtij ligji në lidhje me udhëheqjen e kontabilitetit, klasifikimit të tregtarëve, librave tregtarë, llogaritë vjetore dhe raportet financiare në mënyrë adekuate zbatohen edhe për personat juridikë me seli në Republikën e Maqedonisë, që kryejnë veprimtari të përcaktuar me

Klasifikimin Nacional të Veprimtarisë, të cilët nuk llogariten si tregtarë në pajtim me këtë ligj dhe me rregulla të tjera, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Dispozitat e këtij ligji me të cilat është rregulluar udhëheqja e kontabilitetit, librave tregtarë dhe llogarive vjetor, zbatohen edhe për tregtarin individ dhe për personat tjerë fizikë të cilët kryejnë veprimtari, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(5) Ministri i Financave do ta përcaktojë mënyrën e udhëheqjes të kontabilitetit nga paragrafi (1) i këtij neni, me rregulla të veçanta.

(6) Ministri i financave më për së afërmi i përcakton mënyrën dhe kushtet e dorëzimit të llogarisë vjetore në formë elektronike.

Klasifikimi i tregtarëve

Neni 470

(1) Tregtarët klasifikohen në tregtarë të mëdhenj, të mesëm, të vegjël dhe mikrotregtarë, varësisht nga numri i të punësuarve, të ardhurave vjetore dhe vlerës mesatare të mjeteve të përgjithshme pas llogarive vjetore në dy vitet e fundit (viteve llogaritëse).

(2) Në vitin e parë të punës tregtari rradhitet sipas vëllimit të vlerësuar të punës së tij, ndërsa në të dytin sipas të dhënave të punës të vitit të kaluar.

(3) Radhitja e tregtarit prej klasifikimit të parë në të dytë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni nuk mund të bëhet gjatë vitit.

(4) Si mirkotregtarë llogaritet tregtari i cili në çdo dy vitet të fundit llogaritëse gjegjësisht në vitin e parë të punës i ka plotësuar kriteret vijuese:

- 1) numrin mesatar të punësuarve, në bazë të orëve të punës të jetë deri në dhjetë punëtorë; dhe
- 2) të ardhura bruto të realizuara nga tregtari që ka qenë burim të mos tejkalojë 50.000 euro në kundërvlerë me denarë, dhe

(5) Tregtari i vogël është tregtarë i cili në çdo dy vitet e fundit llogaritëse gjegjësisht në vitin e parë të i ka përmbushur së paku dy nga tre kriteret e mundshme vijuese dhe atë:

- 1) numrin mesatar të punësuarve, në bazë të orëve të punës të jetë deri në pesëdhjetë punëtorë; dhe
- 2) të hyrat vjetore të jenë më të ulta se 2.000.000 euro në kundërvlerë me denarë, ose
- 3) vlera mesatare (në fillim dhe në fund të vitit llogaritës) të mjeteve të përgjithshme (në aktivë) të jetë më e vogël se 2.000.000 euro në kundërvlerë me denarë.

(6) Për tregtarë të mesëm llogaritet tregtari i cili në çdo dy vitet të fundit llogaritës, gjegjësisht në vitin e parë të punës i ka përmbushur së paku dy nga tre kriteret e mundshme vijuese dhe atë:

- 1) numrin mesatar të punësuarve, në bazë të orëve të punës të jetë deri në 250 punëtorë; dhe
- 2) të ardhurat vjetore të jenë më të vogla se 10.000.000 euro në kundërvlerë me denarë, ose
- 3) vlera mesatare (në fillim dhe në fund të vitit llogaritës) të mjeteve të përgjithshme (në aktivë) të jetë më e vogël se 11.000.000 euro në kundërvlerë me denarë.

(7) Tregtarët që nuk radhiten në tregtarë të vegjël apo të mesëm fitojnë statusin e tregtarëve të mëdhenj. Në rast të pamundësisë së klasifikimit të tregtarëve të paragrafëve (5) dhe (6) të këtij neni, përkatësisht kur tre kriteret janë të ndryshëm, tregtari radhitet si tregtar i mesëm. Në rast të pamundësisë së klasifikimit të tregtarëve nga paragrafi (4) i këtij neni, përkatësisht kur të dy kriteret janë të ndryshëm, tregtari radhitet si tregtar i vogël.

(8) Nëse për tregtarin në dy vitet e fundit llogaritëse janë vërtetuar të dhëna të ndryshme të rradhitjes, tregtari mban rradhitjen e vitit të fundit.

(9) Regjistri i llogarive vjetore ndaj regjistrit qendror ku dërgohen llogarit vjetore dhe raportet financiare që bën mbikëqyrje, në afat prej gjashtëdhjetë ditëve nga afati i rregullt për dorëzimin e llogarisë së fundit vjetore në bazë të asaj se si rradhitet tregtari sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni e lajmëron tregtarin për rradhitje.

(10) Bankat shoqëritë për sigurim dhe institucionet tjera financiare dhe tregtarët që përbëjnë llogari konsoliduese vjetore dhe raporte konsoliduese financiare rradhitën në pajtim me dispozitat e këtij neni që i përkasin tregtarëve të mëdhenj.

SEKSIONI 2

LIBRAT TREGTAR

Përgjegjësia për udhëheqjen e librave tregtar

Neni 471

(1) Çdo tregtar, në pajtim me parimet e udhëheqjes së drejtë të kontabilitetit, udhëheq libra tregtar në mënyrë që të shqyrtohen të gjitha punët e ndërmarrura tregtare juridike, gjendje e mjeteve, obligimet, kryegjëja, të ardhurat dhe të dalat. Librat tregtarë udhëhiqen kështu që çdo person i tretë-ekspert gjatë shqyrtimit të librave mund të përfitojë shqyrtim të përgjithshëm në lidhje me punën e tregtarit dhe në lidhje me gjendjen financiare si dhe me rezultatin financiar të shoqërisë së tij. Librat tregtar është patjetër në mënyrë të qartë të tregojnë se në çfarë mënyre kanë filluar janë udhëhequr dhe komplementuar të gjitha transaksionet tregtare të tregtarit.

(2) Tregtari është i obliguar ta ruajë çdo ekzemplar të çdo letre të dërguar afariste. Ekzemplari i ruajtur doemos duhet të jetë identik me origjinalin e dërguar.

(3) Librat tregtar udhëhiqen me sistemin e kontabilitetit të dyfishtë.

(4) Librat tregtar që udhëhiqen me sistemin e kontabilitetit të dyfishtë janë ditari, libri kryesor dhe evidencat analitike.

Udhëheqja e librave tregtar

Neni 472

(1) Tregtari i udhëheq librat tregtar në gjuhën maqedonase me shifra arabe dhe me vlera të theksuara në denarë. Nëse shfrytëzon shkurtesa, kode, shenja dhe simbole, ai doemos duhet qartë ta shpjegojë domethënien e tyre.

(2) Tregtari me seli në njësi të vetë administrimit lokal në të cilën së paku 20% i qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja librat tregtar i udhëheq në gjuhën maqedonase, por mund ta udhëheqë edhe në atë gjuhë.

(3) Të gjitha të dhënat e regjistruara në librat tregtar doemos duhet të jenë plotësisht komplete me kohë të azhuruara dhe të prezentohen kronologjikisht gjegjësisht në mënyrë të qartë ta pasqyrojë radhitjen kohore të themelimit të tyre.

(4) Librat tregtarë udhëhiqen në bazë të dokumenteve të besueshme kontabiliste.

(5) Të dhënat e regjistruara në librat tregtar nuk guxon të ndërrohen në mënyrë që më vonë do ta pamundësojë vërtetimin e përmbajtjes së regjistruara me vlerë. Në kundërshtim me këtë ligj është bërja e ndryshimit apo plotësimet e kryera në mënyrë që nga natyra e tyre nuk mund të vërtetohet ç'është regjistrim burimor dhe bartja e përmbajtjes me vlerë, dhe ç'është plotësim apo ndryshim i mëvonshëm.

(6) Librat tregtar mund të udhëhiqen në mënyrë klasike (në lista të lira apo të lidhura) apo në mënyrë elektronike, por pastaj të ruhen parimet e kontabilitetit të udhëhequr në mënyrë të drejtë. Tregtari është i obligueshëm pavarësisht nga mënyra e udhëheqjes dhe ruajtjes së librave tregtar në çdo kohë dhe afat të siguroj qasje në libra, t'i ruajë dhe t'i mbrojë në afat të caktuar për të dhe doemos të garantoj se ato mund të prezentohen në çdo kohë.

(7) Librat tregtar sipas sistemit të kontabilitetit të dyfishtë udhëhiqen me zbatimin e llogarive të vetme të rregulluara me plan llogaritës. Me planet llogaritës vërtetohen llogaritë që janë të obligueshme për të gjitha shoqëritë nëse nuk është e caktuar ndryshe me ligj.

(8) Tregtari, sipas nevojave të tij i rradhit llogarit nga plani kontabilist në sistem analitik (në planin e tij analitik kontabilist).

(9) Minsitri i Financave i rregullon planet kontabiliste.

Regjistrimi dhe pajtueshmëria e gjendjeve

Neni 473

(1) Tregtarët sipas formës së vet, si dhe tregtari - individ detyrohen që së paku një herë në vjet në vitin afarist të kryejnë regjistrimin e mjeteve dhe obligimeve dhe ta harmonizojnë gjendjen e kontabilitetit të mjeteve dhe obligimeve me gjendjen faktike të përcaktuar me regjistrimin.

(2) Tregtarët sipas formës së vet detyrohen ta kryejnë regjistrimin edhe në rast të ndryshimeve statusore edhe në raste tjera të caktuara me këtë ligj.

(3) Mënyrën për kryerjen e regjistrimit të mjeteve dhe obligimeve dhe harmonizimin e gjendjes së kontabilitetit të mjeteve dhe obligimeve me gjendjen faktike të përcaktuar me regjistrim i përcakton ministri i Financave.

Ruajtja e librave tregtare, të dokumenteve kontabiliste, të llogarive vjetore dhe të raporteve financiare

Neni 474

- (1) Tregtari përgjithmonë i ruan llogarit vjetore dhe llogarit financiare.
- (2) Librat tregtar ruhen së paku dhjetë vite pas kalimit të vitit që i përkasin.
- (3) Dokumentet kontabiliste ruhen së paku pesë vite nga kalimi i vitit që janë shfrytëzuar për përbërjen e librave tregtare, përveç dokumenteve për llogaritjen e rrogave, të cilat ruhen përgjithmonë.
- (4) Llogaritë vjetore dhe raportet financiare, librat tregtarë dhe dokumentet kontabiliste ruhen në formë burimore apo transferim në ndonjërin prej medijave për përpunim automatik apo mikrografik të të dhënave.

Prezentimi në procedurat gjyqësore

Neni 475

- (1) Gajtë procedurës gjyqësore gjyqi ka mundësi me propozim apo obligim zyrtar, të urdhërojë e para ose e dyta ose të dy palët t'ia dërgojnë në shqyrtim librat tregtarë.
- (2) Nëse librat tregtarë janë dërguar në shqyrtim me padi gjuqësore, përmbajtja e tyre shqyrtohet në prezencë të palëve deri në atë masë kur shihet kundërshtimi konkret, e nëse është e nevojshme do të bëhet edhe rregull. Përmbajtja tjetër e librave tregtar do t'i dorëzohet në shqyrtim gjyqit deri në atë masë sa duhet të vlerësohet a kanë qenë të udhëhequra në mënyrë të rregullt, të drejtë, të ligjshme.

SEKSIONI 3

LLOGARIA VJETORE DHE RAPORTET FINANCIARE

Obligimi për përbërjen e llogarisë vjetore dhe raporteve financiare

Neni 476

- (1) Çdo tregtar nga paragrafi 1 i nenit 469 të këtij ligji është bashkëpronar i shoqërisë së jashtme, pas kalimit të vitit afarist përbën llogari vjetore.
- (2) Tregtarët nga paragrafi (1) pika 1 të nenit 469 të këtij ligji, pas kalimit të vitit afarist përgatisin edhe raporte financiare.
- (3) Për qëllimet e përgatitjes së llogarisë financiare dhe raporteve financiare nën vitin afarist nënkuptojmë vit kalendarik.
- (4) Llogaria vjetore përfshin bilanc të gjendjes dhe bilanc të suksesit dhe shënime sqaruese. Raportet financiare e përfshijnë bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit, raportin për ndryshimet në kryegjë, raportin për qarkullim parash, politikat e zbatuara të kontabilitetit dhe shënime të tjera sqaruese të përgatitura në pajtim me Standardet ndërkombëtare për njoftim financiar nga neni 469, paragrafi (1), pika 1 të këtij ligji.
- (5) Tregtari në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përgatit llogari vjetore dhe raporte financiare dhe në periudhë më të shkurtë nga ai i theksuar në paragrafin 3 të këtij neni, në rast të ndryshimeve statutare

(bashkangjitja, bashkim, ndarje), likuidim, falimentim dhe në raste të tjera të caktuara me ligj.

(6) Llogaria vjetore dhe raporti financiar të cilat kanë të bëjnë me vitin e njëjtë afarist dhe të cilat janë përgatitur në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e kontabilitetit, duhet të përmbajnë të dhëna identike për gjendjen e mjeteve, obligimeve, të ardhurave, shpenzimeve, kryegjësë dhe fitimit të realizuar përkatësisht humbjes së shoqërisë për vitin afarist.

(7) Llogarinë vjetore dhe raportet financiare i nënshkruan kontabilisti, përkatësisht kontabilisti që i ka përpiluar, me ç'rast e shënon datën e përpilimit të tyre dhe nënshkrimin dhe numrin e regjistrimit me të cilin është evidentuar në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë.

(8) Pas nënshkrimit të llogarisë vjetore dhe raporteve financiare nga personi nga paragrafi (7) i këtij neni, ato i nënshkruan përfaqësuesi ligjor i tregtarit.

(9) Ministri i Financave rregullon formën dhe përmbajtjen e llogarisë vjetore dhe nuk mund ta ndërrojë gjatë një viti fiskal.

Përgatitja dhe dorëzimi i llogarive vjetore dhe i raporteve financiare

Neni 477

(1) Afati për përgatitjen e llogarisë financiare nga paragrafi 1 i nenit 476 të këtij ligji dhe i raporteve financiare të paragrafit 2 të nenit 476 të këtij ligji nuk mund të jetë më i gjatë se dy muaj pas kalimit të muajit afarist, përveç nëse organi kompetent shtetëror nuk e vazhdon në tre muaj.

(2) Me përjashtim të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni tregtarët me karakter sezonal të veprimtarisë kanë mundësi llogarinë vjetore dhe raportet financiare t'i përgatisin për vitin afarist që është e ndryshme nga viti kalendarik, për të cilën ministri i Financave merr Vendim në bazë të kërkesës të posaçme të tregtarit.

(3) Me marrëveshjen për shoqërinë dhe me statutin mund të rregullohet përveç llogarisë vjetore dhe raporteve financiare të parapara me paragrafin 1 të këtij neni të përgatiten edhe raporte financiare për periudha më të shkurta të vitit afarist.

(4) Llogarija vjetore dorëzohet në regjistrin qendror deri në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, gjegjësisht në afat prej 60 ditëve nga dita e hapjes së procedurës për likuidim apo procedurës për falimentim apo të themelimit të ndryshimit statutar, ndërsa llogarit e përgatitura për periudha më të shkurta të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni dorëzohen deri në fund të muajit të ardhshëm pas kalimit të muajit të fundit nga periudha e llogarit. Regjistri qendror ka për obligim t'i përpunoj llogaritë vjetore për nevojat e Ministrisë së Financave.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, llogaria vjetore në formë elektronike mund të dorëzohet te Regjistri Qendror edhe deri më 15 mars vitin e ardhshëm.

(6) Kompensimi për parashtrim të llogarisë vjetore në afatet nga paragrafet (4) dhe (5) të këtij neni, përcaktohet me tarifen e Regjistrimit Qendror.

(7) Tregtarët që nuk do t'i dorëzojnë të dhënat e llogarisë vjetore në afatet nga paragrafet (4) dhe (5) të këtij neni, paguajnë kompensim të veçantë të përcaktuar me tarifen e Regjistrit Qendror.

(8) Të dhënat nga llogaria vjetore e përpiluar dhe nënshkruar në pajtim me nenin 476 paragrafet (7) dhe (8) të këtij ligji, që në Regjistrin Qendror dorëzohen në formë elektronike, nënshkruhen me nënshkrim elektronik të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar që e ka përpiluar llogarinë vjetore ose të përfaqësuesit ligjor të tregtarit.

(9) Çdo tregtar i madh dhe i mesëm, detyrohet që ta dorëzojë llogarinë vjetore në Regjistrin Qendror vetëm në formë elektronike.

(10) Tregtarët individë dhe shoqëritë tregtare të cilat nuk kanë kryer asnjë veprimtari tregtare respektivisht veprimtari e cila sipas natyrës dhe vëllimit të veprimit mund të konsiderohet si tregtare në vitin paraprak detyrohen te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë krahas njoftimit me shkrim se nuk kanë qenë aktivë, të dorëzojnë edhe llogari vjetore me të dhëna në formularë të përcaktuar më së voni deri në ditën e fundit nga skadimi i afatit ligjor për të cilin parashtrohen llogaritë vjetore në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(11) Mbi subjektet nga paragrafi (10) i këtij neni zbatohet procedurë për përcaktimin e subjektit joaktiv në pajtim me nenin 477-a të këtij ligji.

(12) Tregtarë individë dhe shoqëritë tregtare të cilat nuk kanë dorëzuar llogari vjetore dhe njoftim me shkrim se nuk kanë qenë aktivë në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni për vitin e fundit afarist deri në ditën e fundit të punës të vitit rrjedhës, shlyhen nga regjistri unik tregtar në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

(13) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë i shlyen nga regjistri unik tregtar subjektet nga paragrafi (11) i këtij neni për të cilat është përcaktuar se tre vite me radhë janë subjekte joaktive në pajtim me nenin 477-a të këtij ligji.

(14) Organi i udhëheqjes, përveç llogarisë vjetore për tregtarët nga paragrafi 1 i nenit 469 të këtij ligji gjegjësisht raportet financiare për tregtarët nga paragrafi (1), pika 1 të nenit 469 të këtij ligji, është i obliguar pas mbarimit të çdo viti afarist, të përgatis edhe raport për punën e shoqërisë për vitin e kaluar afarist me përmbajtje të caktuar në nenin 384, paragrafi 7 i këtij ligji.

(15) Tregtarët individë ose shoqëritë tregtare të cilat nuk do të parashtrojnë llogari vjetore dhe raporte financiare në afatin e përcaktuar me ligj, janë të obliguar te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë të dorëzojnë llogari vjetore dhe raporte financiare me revizion të kryer paraprakisht nga revizori i autorizuar, më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës.

Procedura e përcaktimit të statusit të subjektit joaktiv

Neni 477-a

(1) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë shënon në evidencën e vet se ndaj subjektit udhëhiqet procedurë e përcaktimit të statusit të subjektit joaktiv dhe në mënyrë elektronike e njofton Drejtorinë e të Hyrave Publike për çdo subjekt për të cilin ka konstatuar se i plotëson kushtet nga neni 477 paragrafi (10) i këtij ligji.

(2) Drejtoria e të Hyrave Publike ngre procedurë për përcaktimin e statusit të subjektit joaktiv për subjektet nga neni 477 paragrafët (9) dhe (10) të këtij ligji, për të cilat është njoftuar në mënyrë elektronike në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni. Në procedurë, Drejtoria e të Hyrave Publike përcakton nëse në periudhën për të cilën nuk është parashtruar llogari vjetore dhe raporte financiare, subjekti:

- ka realizuar transaksione në çfarëdo baze përmes llogarisë së transaksionit të hapur te bartësi i qarkullimit pagesor (duke përfshirë edhe nëse janë realizuar vetëm hyrje të mjeteve) ose
- në mënyrë tjetër ka disponuar me mjetet dhe pronën e vet që Drejtoria e të Hyrave Publike e ka konstatuar gjatë kryerjes së punëve të fushëveprimit të kompetencave të veta.

(3) Në rast kur te subjekti si debitor ekziston derdhje e mjeteve ose transfer i pronës në bazë të arkëtimit të detyrueshëm, përkatësisht përmbarimit, kjo nuk mund të trajtohet si aktivitet i subjektit në procedurën e përcaktimit të statusit të subjektit joaktiv.

(4) Drejtoria e të Hyrave Publike miraton aktvendim për përcaktimin e statusit të subjektit joaktiv, nëse te subjekti ndaj të cilit është zbatuar procedura në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, konstaton se nuk është plotësuar një nga kushtet e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni. Drejtoria e të Hyrave Publike në mënyrë elektronike menjëherë e njofton Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë se shoqërisë i është përcaktuar statusi i subjektit joaktiv, për evidentimin e saj.

(5) Nëse Drejtoria për të hyra publike në procedurën për përcaktimin e statusit të subjektit joaktiv konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për subjekt joaktiv, me Aktvendim e ngarkon subjektin që në afat prej 30 ditëve nga miratimi i aktvendimit, për vitin afarist sërish të dorëzojë te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë llogari vjetore dhe raporte financiare, me revizion të kryer paraprakisht nga revizori i autorizuar.

(6) Nëse Drejtoria për të hyra publike përcakton se ekzistojnë shmangie të caktuara të të dhënave në llogarinë vjetore dhe raportet financiare të dorëzuara te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë lidhur me të dhënat e dorëzuara te Drejtoria për të hyra publike, me Aktvendim e ngarkon subjektin që në afat prej 30 ditëve nga miratimi i aktvendimit, për vitin afarist sërish të dorëzojë te Regjistri Qendror llogari vjetore dhe raporte financiare, me revizion të kryer paraprakisht nga revizori i autorizuar.

(7) Drejtoria për të hyra publike për aktvendimet e miratuara në pajtim me paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni, në mënyrë elektronike e njofton Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

(8) Nëse subjekti nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni, nuk dorëzon në afatin e caktuar llogari vjetore dhe raporte financiare, shlyhet nga regjistri tregtar në pajtim me dispozitat nga nenet 552-a dhe 552-b të këtij ligji.

Revizioni i raporteve financiare

Neni 478

(1) Në revizion marrin pjesë tregtarët vijues:

- 1) tregtarë të mëdhenj dhe të mesëm të organizuar si shoqëri aksionare;
- 2) shoqëri, letrat me vlerë të të cilëve kotojnë në bursë; dhe
- 3) tregtarë të mëdhenj dhe të mesëm të organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

(2) Shoqëria obligohet që të ketë mendim revizori të raporteve financiare, më së voni një muaj para mbajtjes së tubimit të bashkëpronarëve, përkatësisht kuvendit.

Zgjedhja e revizionit të autorizuar

Neni 479

(1) Raportet financiare që janë në pajtim me nenit 478 të këtij ligji janë lëndë të revizionit dhe nuk mund të jenë të miratuara nëse nuk është bërë revizion nga shoqëria e autorizuar për revizion ose revizori i autorizuar tregtari individ (në tekstin e mëtejme: revizori i autorizuar).

(2) Revizori i autorizuar e zgjedh mbledhjen e bashkëpronarëve, gjegjësisht kuvendit.

(3) Revizori i autorizuar zgjidhet parakalimit të vitit afarist për të cilën bëhet revizioni.

(4) Anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve, gjegjësisht anëtarët e këshillit drejtues apo drejtori i shoqërisë janë të obliguar t'i mundësojnë revizorit të autorizuar shqyrtim të dokumentacionit të plotë duke përfshirë edhe atë që llogaritet si sekret afarist.

(5) Revizori autorizuar obligohet të kërkojë nga personat nga paragrafi 4 i këtij neni sqarim dhe dëshmi që janë të nevojshme për kryerjen e analizës së rregullt të raporteve financiare.

(6) Revizori i autorizuar i raporteve financiare dorëzon raport për kryerjen e revizionit, sipas standarteve revizore ndërkombëtare (SRN) të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", që azhurohen në bazën vjetore për arsye të pajtimit të standarteve rrjedhëse ashtu siç janë të përmbushura, të ndryshuara apo të miratuara nga federacioni ndërkombëtar kontabilist (FKN).

Obligimi për dorëzimin e raportit të revizionit

Neni 480

(1) Anëtarët ekzekutiv të këshillit të drejtorëve gjegjësisht këshilli drejtues apo drejtori menjëherë pas marrjes së raportit për revizionin e kryer, së bashku me llogarinë vjetore dhe raporteve financiare si dhe raportit financiar për punën e shoqërisë ia dorëzon këshillit të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrolluesit. Njëkohësisht këshillit të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrolluesit i dorëzohet edhe propozimi i Vendimit për ndarjen e dobisë së realizuar, e cila do të dorëzohet në mbledhjen e bashkëpronarëve, gjegjësisht në kuvendin për vendosje.

(2) Anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve të këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrolluesi është i obliguar t'i kontrolloj llogaritë vjetore, raportet financiare dhe propozimin e Vendimit për ndarjen e dobisë. Me kërkesë të anëtarëve joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës, revizori i autorizuar është i obliguar të merr pjesë në mbledhjen e këshillit të drejtorëve, gjegjësisht të këshillit mbikëqyrës.

(3) Anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrolluesit i dorëzon në mbledhjen e bashkëpronarëve, gjegjësisht kuvendit raport me shkrim për rezultatet nga kontrolli. Në raport anëtarët joekzekutiv të këshillit të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës gjegjësisht kontrolluesi e lajmërojnë mënyrën se si e kanë bërë kontrollin

dhe sasinë e kontrollit mbi administrimin me shoqërinë gjatë kohës së vitit të kaluar afarist. Në raport shpjegohet edhe për rezultatet e revizionit të kryer të zbatuara nga ana e revizorit të autorizuar për llogarin vjetore dhe për raportet financiare si dhe për ankesat e revizorit në llogarinë e përgatitur vjetore dhe në raportet financiare dhe propozon a të miratohen ato apo jo.

SEKSIONI 4

REZULTATI FINANCIAR DHE RADHITJA E DOBISË

Nënseksioni 1

REZULTATI FINANCIAR

Vërtetimi i rezultatit financiar

Neni 481

Për qëllimet e shpërndarjes të fitimit, tregtarët të cilët e udhëheqin kontabilitetin sipas nenit 469, paragrafi (1) i këtij ligji, e përcaktojnë rezultatit e tyre financiar në pajtim me standardet ndërkombëtare për njoftim financiar, standardet ndërkombëtare për njoftim financiar të subjekteve të vogla dhe të mesme, dhe në pajtim me këtë ligj.

Shpallja e llogarisë së miratuar vjetore dhe miratimi i raporteve financiare

Neni 482

(1) Llogaria vjetore e miratuar nga organi drejtues dorëzohet në regjistrin tregtarë më së voni deri në fund të shkurtit.

(2) Raportet e miratuara financiare me raportin vjetorë për punën e shoqërisë, organi drejtues me se voni tridhjetë ditë nga dita e miratimit të tyre, por jo më shumë se 30 korriku, me shkrim i dorëzon në regjistrin e llogarive vjetore në regjistrin Qendrorë dhe i vendosin në lokal afarist apo lokal tjetër për shqyrtim. Të drejtë për shqyrtim ka çdo bashkëpronar apo akcionar. Llogaria e reviduar vjetore, gjegjësisht raportet e reviduara financiare ku janë vërtetuar shmanget në të dhënat e llogarisë së dërguar vjetore, gjegjësisht të raporteve të dorëzuara financiare, regjistri tregtarë ka për obligim ti përpunojnë.

(3) Te dhënat e llogarive vjetore dhe të raporteve financiare janë publike dhe në qasje për të gjithë personat në mënyrë dhe në procedurë në pajtim me këtë apo ligj tjetër. Regjistri tregtarë jep informata, jep fotokopje nga dëshmitë e kontabilitetit dhe të dhëna të veçuara në bazë elektornike, në pajtim me Ligjin për regjistrin qendrorë.

(4) Shoqëria e cila lëndën për punë i ka punët bankare punët tjera kreditore si dhe punët e sigurimit, në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e mbajtjes së kuvendit, i shpall formularët e caktuar me këtë ligj, pa shënime për zbatimin e politikës së kontabilitetit dhe shënime të tjera për sqarim, në mënyrë të caktuar me ligj, dhe detyrimisht në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(5) Obligimin per shpalljen e paragrafit 3 të këtij neni e kanë edhe shoqëritë tjera të mëdha dhe shoqëritë që kotojnë në bursë.

(6) Kur shoqëria shpall ne gazetën zyrtare llogari vjetore dhe raporte financiare edhe atëherë kur nuk është i lidhir, doemos duhet t'i shpall siç janë të miratuara nga mbledhja e bashkëpronarëve, gjegjësisht kuvendit, pa ndryshime dhe plotësime, duke përfshirë edhe raportin e revizorit të autorizuar.

Nënseksioni 2

RADHITJA E DOBISË

Vendimi për radhitjen e dobisë

Neni 483

(1) Mbledhja e bashkëpronarëve, gjegjësisht kuvendi vendos për radhitjen e dobisë.

(2) Në Vendimin për radhitjen e dobisë tregohet çdo dedikim veç e veç për dobinë, e veçanërisht theksohen:

- 1) shuma e dobisë për mbulimin e humbjes nga vitet e kaluara (nëse ka të tilla);
- 2) shumat që barten në rezervat ligjore dhe statutare të shoqërisë;
- 3) shuma që paguhet në lloj të dividendës;
- 4) pagesat plotësuese në bazë të Vendimit;
- 5) bartje eventuale e dobisë në vitin e ardhshëm (dobia e akumuluar); dhe
- 6) shuma e dobisë me të cilën do të bëhet zmadhimi i kryegjësë bazë i shoqërisë dhe shuma e dobisë për investime.

(3) Me Vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund të kryhen ndryshime në dobi të realizuar të shoqërisë.

Mbulimi i humbjes

Neni 484

(1) Mbledhja e bashkëpronarëve, gjegjësisht kuvendi vendosin për mbulimin e humbjes.

(2) Mbulimi i humbjeve bëhet sipas renditjes nga burimet si vijon të cilat numërohen në vendimin për mbulimin e humbjes, edhe atë:

- 1) fitim i akumuluar;
- 2) në barrë rezervës së përgjithshme të obligueshme;
- 3) në barrë të rezervave të posaçme për mbulimin humbjeve;
- 4) premive, dhe
- 5) në barrë të kryegjësë themelore, me zvogëlimin e saj.

(3) Me Vendim nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund të kryhen ndryshime në humbjen e shoqërisë.

Rezerva të obligueshme dhe të përgjithshme (fondi i përgjithshëm rezerv)

Neni 485

(1) Shoqëria ka rezervë të obligueshme të përgjithshme si fond i përgjithshëm rezerv që është i formuar nëpërmjet përfshirjes së fitimit neto. Kjo rezervë llogaritet dhe ndahet si përqindje e caktuar në marrëveshje, gjegjësisht në statut, dhe nuk mund të jetë më e vogël se 5% nga dobia, përderisa rezervat e shoqërisë nuk arrijnë shumë që është e barabartë me një të dhjetën e kryegjësë bazë. Nëse rezerva e krijuar zvoglohet, doemos duhet të plotësohet në mënyrë të njëjtë.

(2) Përderisa rezerva e përgjithshme nuk e tejkalon me ligj, me marrëveshjen për shoqërinë, gjegjësisht të shumës më të vogël të caktuar me statut, mund të përdoret vetëm për mbulimin e humbjeve.

(3) Kur rezerva e përgjithshme do ta tejkalojë shumën më të vogël edhe pas mbulimit të të gjitha humbjeve, me Vendim të mbledhjes së bashkëpronarëve, gjegjësisht të kuvendit, teprica mund të përdoret për plotësimin e dividendës, nëse ajo për vitin afarist nuk e ka arritur shumën më të vogël të rregulluar me këtë ligj, me marrëveshjen për shoqërinë, gjegjësisht me statut.

(4) Ajo që në tepricë është bartur në bazë të pagesës plotësuese të bashkëpronarëve, gjegjësisht të akcionarëve, nuk mund të përdoret për plotësimin e dividendës.

(5) Shoqëritë të cilat kryejnë veprimtari bankare përkatësisht veprimtari siguruese nuk detyrohen të kenë rezervë të përgjithshme të detyrueshme nëse kështu është përcaktuar me ligj tjetër.

Rezerva të posaçme për arsye të mbulimit të humbjes apo pagese të tjera

Neni 486

(1) Me marrëveshjen për shoqërinë, gjegjësisht me statut mund të parashikohet formimi i rezervave të posaçme për arsye të mbulimit të humbjeve të caktuara apo për pagesa të tjera. Qëllimi, organizimi dhe mënyra e përdorimit të rezervave përcaktohen me marrëveshje për shoqërinë, gjegjësisht me statut, dhe mund të ndryshohen vetëm me ndryshimin e marrëveshjes për shoqërinë, gjegjësisht me statut.

(2) Nëse me marrëveshjen për shoqërinë, gjegjësisht me statut janë paraparë rezerva për pension, sigurim nga rreziku apo qëllime humanitare të të punësuarve në shoqëri, saktë caktohet qëllimi i tyre, mënyra e formimit të tyre dhe investimi, organizimi dhe mënyra e përdorimit të tyre.

(3) Rezervat nga paragrafi 2 i këtij neni janë të ndara nga prona e përgjithshme e shoqërisë, me ta veçmas administrohet dhe llogaritet për to udhëhiqen veçmas nga llogaritë tjera të shoqërisë. Në administrim marrin pjesë edhe përfaqësuesit e personave rezerve të cilëve u është dedikuar. Përderisa shoqëria ekziston, këto rezerva nuk mund të përdoren as për pagesën e borxheve as për çfarëdo lloji qëllimi tjetër, përveç asaj që është caktuar me marrëveshjen për shoqërinë, gjegjësisht me statut.

Nënseksioni 3

DIVIDENDA

Ndarja e dividendës

Neni 487

(1) Pas miratimit të llogarisë vjetore dhe të raporteve financiare dhe vendosjes së ekzistimit të dobisë për ndarje, kuvendi i bashkëpronarëve, gjegjësisht kuvendi e përcakton pjesën që duhet t'i ndahet bashkëpronarëve, gjegjësisht akcionarëve në formë të dividendës, sipas rregullave që i jep pjesëmarrja, gjegjësisht sipas llojit dhe klasave të akcioneve.

(2) Organi drejtues mund të paguajë dividendë shumë që nuk e tejkalon në përgjithësi dobinë e realizuar të treguar me llogarinë vjetore dhe me raportet financiare, të zmadhuar për dobinë e bartur dhe të pandarë nga vitet e kaluara, apo me rezervat që mund të ndahen, gjegjësisht që i tejkalojnë rezervat ligjore dhe rezervat e caktuara me marrëveshje për shoqërinë, gjegjësisht me statut dhe nëse janë të mbuluara humbjet nga vitet e kaluara, nëse ato për arsye të ndryshme nuk kanë qenë të mbuluara me llogarinë e fundit të miratuar dhe me raportet financiare.

(3) Nëse është e nevojshme, për arsye të sigurimit të shoqërisë apo për arsye të barabartë të dividendës, para se të caktohet lartësia e dividendës, bashkëpronarët, gjegjësisht akcionarët kanë mundësi me marrëveshje për shoqërinë, gjegjësisht me statut të vendosin të formohet rezervë e posaçme.

(4) Mënyrat e pagesës së dividendës i vërtetojnë bashkëpronarët në mbledhjen e bashkëpronarëve apo përmes sqarimit me letërkëmbim, gjegjësisht akcionarët e kuvendit.

(5) Dividenda paguhet më së voni në afat prej nëntë muajve pas mbarimit të vitit afarist. Bashkëpronarëve, gjegjësisht akcionarëve mund t'i paguhet avans në emër të dividendës gjatë vitit afarist nga pjesa e paraparë e dobisë.

(6) Nëse dividenda nuk paguhet në afatin nga paragrafi (5) i këtij neni, pas skadimit të këtij afati shumës së dividendës që duhet t'u paguhet akcionarëve llogaritet kamatëvonesa ligjore deri në ditën e pagimit të dividendës.

Dividendë në para, me pjesëmarrje gjegjësisht me akcione

Neni 488

(1) Në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, gjegjësisht në shoqërinë akcionare në marrëveshjen me shoqërinë, gjegjësisht me statut mund të parashikohet mundësia çdo bashkëpronarë gjegjësisht akcionarë, si pjesë të dividendës që është ndarë apo nga avanset e dividendës, ta fitojë dividendën, gjegjësisht avansin e dividendës në para apo në kontribute, gjegjësisht në akcione.

(2) Oferta për pagesë të dividendës apo për avanset e dividendës me pjesëmarrje, gjegjësisht në akcione doemos duhet të bëhet në të njejtën kohë për të gjithë bashkëpronarët, gjegjësisht akcionarëve sipas llojit dhe klasës së akcioneve.

Pagesa e avansit të dividendës

Neni 489

(1) Me marrëveshjen për shoqërnë, gjegjësisht me statut mund të autorizohet organi drjetues i shoqërisë gjatë vitit afarist në bazë të llogarisë periodike apo raporteve periodike financiare për tre gjashtë gjegjësisht nëntë muajt, të reviduara nga ana e revizorit të autorizuar, t'i paguajë bashkëpronarëve, gjegjësisht akcionarëve avans në emër të dividendës.

(2) Organi drejtues mund ta paguajë avansin e dividendës deri te shuma e dobisë që është realizuar në periudhën për të cilën paguhet afati i dividendës, dhe nuk mund ta tejkalojë dobinë e përgjithshme të realizuar në vitin e kaluar të miratuar me llogari vjetore, të zmadhuar për dobinë e bartur të pandarë nga vitet e kaluara, dhe me rezervat që mund të ndahen me këtë qëllim, të zbritura për shumat që ndahen për rezervat e ligjeve, ndërsa për rezervat e vërtetuara me marrëveshjen për shoqërinë, gjegjësisht me statut, për periudhën që llogaritet avansi i dividendës, nëse nuk janë mbuluar humbjet e viteve të kaluara, dhe ato për çfarëdo lloj arsye nuk kanë qenë të mbuluara me llogarinë e fundit të miratuar me raportet financiare.

(3) Për pagesën e avansit të dividendës është e nevojshme pajtueshmëri e anëtarëve të këshillit të drejtorëve dhe Vendim njëzëri i Këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrolluesit.

Përmbajtja e vendimit për pagesë të dividendës

Neni 490

(1) Me vendimin e kuvendit me të cilin miratohet pagesa e dividendës përcaktohet:

- 1) shuma e dividendës;
- 2) data e evidencës sipas së cilës përcaktohet lista e akcionarëve që kanë të drejtë të marrin dividendë, dhe
- 3) plani për pagesë të dividendës, si dhe dita kur paguhet dividenda (dita e pagesës) dhe mënyra se si i lajmëron shoqëria personat që kanë të drejtë në dividendë sipas Vendimit të marrur.

(2) Nëse data e evidentimit dhe para ditës së pagesës, bashkëpronari, gjegjësisht akcionari bën bartjen e pjesëmarrjes, gjegjësisht të akcioneve që i kanë sjellur të drejtë në dividendë, kjo e drejtë për marrjen e dividendës bartet te personi ku janë bartur kontributet gjegjësisht akcionet, përveç nëse bartësi dhe personi ku është bartur kontributi, gjegjësisht akcionet së bashku nuk kanë arritur marrëveshje për diçka tjetër.

KAPITULLI I TETË

PJESËMARRJA NË SHOQËRI TË TJERA TREGTARE (SHOQËRITË E LIDHURA)

Llojet e lidhjes dhe krijimit të marrëdhënieve ndërmjet shoqërive

Neni 491

Shoqëritë e lidhura janë shoqëri të pavarura juridike që lidhen dhe krijohen në mes veti si:

- 1) shoqëritë i cili në shoqëri tjetër ka marrë pjesë, pjesëmarrje të

rëndësishme, pjesëmarrje e shumicës, dhe e drejta e shumicës në vendosje apo pjesëmarrje të huazar; dhe

2) varësisht, shoqëria qeverisëse dhe shoqëritë që veprojnë së bashku.

SEKSIONI 1

SHOQËRIA ME PJESËMARRJE, ME PJESËMARRJE TË RËNDËSISHME, ME PJESËMARRJE NË SHUMICË, APO E DREJTA E SHUMICËS NË VENDOSJE

Nocioni i pjesëmarrjes së njërës shoqëri në tjetër

Neni 492

Shoqëria e cila në shoqëri tjetër ka përfituar kontribut apo akcione të cilat në kryegjënë bazë të shoqërisë tjetër janë përfaqësuar së paku 10 % por jo më shumë se 20% të kryegjësë bazë të shoqërisë llogaritet si shoqëri që ka pjesëmarrje në shoqëri tjetër.

Shoqëri me pjesëmarrje të rëndësishme

Neni 493

Shoqëria e cila në shoqëri tjetër ka përfituar kontribut apo akcione të cilat në kryegjënë bazë të shoqërisë tjetër janë paraqitur me më shumë se 20%, por jo më shumë se 50 % të kryegjësë bazë të shoqërisë, apo kur në mbledhjen e bashkëpronarëve, gjegjësisht të kuvendit i takojnë 20 % por jo më shumë se 50 % nga të gjithë votat, llogaritet si shoqëri me pjesëmarrje të rëndësishme.

Shoqëri me pjesëmarrje në shumicë apo me të drejtë në shumicë për vendosje në shoqëri tjetër

Neni 494

(1) Shoqëria e cila në shoqëri tjetër ka përfituar kontribute apo akcione të cilat në kryegjënë bazë të shoqërisë tjetër janë përfaqësuar më shumë se 50% apo kur në mbledhjen e bashkëpronarëve gjegjësisht të kuvendit të shoqërisë tjetër i takojnë më shumë se 50 % i të gjitha votave të shoqërisë, llogaritet si shoqëri që ka pjesëmarrje me shumicë.

(2) Shoqërisë që i takon pjesëmarrja në shumicë apo akcionet, gjegjësisht shumica e votave në shoqëri tjetër llogaritet, në kuptim të këtij ligji, për shoqëri me kontribut në shumicë, ndërsa shoqëria tjetër si shoqëri me pronë në shumicë.

(3) Sa kontribut i takon njërës shoqëri caktohet në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëria akcionare, dhe shoqëria komanditore e akcioneve sipas proporcionit të shumës nominale të kontributeve, gjegjësisht të akcioneve ndaj shumës nominale të përgjithshme të kryegjësë bazë që i takon shoqërisë tjetër. Kontributet vetanake, gjegjësisht akcionet e shoqërisë duhet të refuzohen nga kryegjësja bazë. Me kontributet vetanake, gjegjësisht akcionet e shoqërisë janë barazuar kontributet, gjegjësisht akcionet që i takojnë dikujt tjetër që i mban në llogari të asaj shoqërie.

(4) Çfarë numri të votave të mbledhjes së bashkëpronarëve, gjegjësisht të kuvendit i takojnë shoqërisë me pjesëmarrje në shumicë në shoqërinë tjetër caktohet ndaj marrëdhënies së numrit të votave që mund t'i përfitojë në bazë të kontributit, gjegjësisht akcioneve në marrëdhënie me numrin e përgjithshëm të gjithë votave. Nga numri i përgjithshëm refuzohen votat e kontributeve vetanake, gjegjësisht akcioneve si dhe kontributet gjegjësisht akcionet që i takojnë dikujt tjetër që i mban në llogari të asaj shoqërie.

(5) Për pjesëmarrje, gjegjësisht për akcione që i takojnë shoqërisë llogariten edhe pjesëmarrja, gjegjësisht akcionet që i takojnë shoqërisë që prej saj është e varur apo në llogari të saj apo në llogari të shoqërisë që prej saj është e varur i mban dikush tjetër, por nëse në shoqërinë tregtare - individ ka pjesëmarrje, gjegjësisht akcione të cilat hyjnë në pronën e tij.

SEKSIONI 2

SHOQËRI TË NËNSHTRUARA, MBISUNDUESE DHE SHOQËRI QË VEPROJNË BASHKË

Nocion për shoqëri të nënshtruara dhe mbisunduese

Neni 495

(1) Shoqëri e nënshtruar është shoqëri juridikisht e pavarur mbi të cilën një shoqëri tjetër (shoqëri mbisunduese) ka ndikesë mbisunduese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

(2) Shoqëri që ka ndikesë mbisunduese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në shoqëri që është e nënshtruar në atë është shoqëri mbisunduese.

Realizimi i ndikesës mbisunduese

Neni 496

(1) Konsiderohet se një shoqëri realizon ndikesë mbisunduese mbi shoqëri tjetër, kur:

- 1) drejtpërsëdrejti ose tërthorazi mban pjesë, përkatësisht aksione si pjesë të kapitalit themelor, që i siguron shumicën e votave në tubimin e bashkëpjesëmarrësve, përkatësisht në kuvendin;
- 2) vetë disponon shumicën e votave në shoqëri tjetër në sajë të marrëveshjes së kontraktuar me bashkëpjesëmarrësit, përkatësisht me aksionarët; ose
- 3) në fakt përcakton, përmes votave me të cilat disponon, cilat dhe çfarë vendimesh do të sjellin në kuvendin e bashkëpjesëmarrësit, përkatësisht në kuvendin në këtë shoqëri.

(2) Supozohet realizimi i ndikimit mbisundues nëse një shoqatë disponon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me numër votash që është më i madh se 40% nga numri i tërësishëm i votave që mund të jepen në tubimin e bashkëpjesëmarrësve, përkatësisht në kuvendin, ndërsa asnjë bashkëpjesëmarrës tjetër, përkatësisht aksionar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nuk posedon numër më të madh votash nga shoqata.

(3) Poqëse ekziston mospajtim nëse sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni për atë nëse një shoqatë realizon ndikesë mbisunduese mbi shoqatë

tjetër, Komisioni për letra me vlerë është i autorizuar t'i paraqesë gjykatës propozim për përcaktimin e ekzistimit të ndikesës mbisunduese mbi një ose më tepër shoqëri.

Shoqëri me pjesëmarrje të dyanshme

Neni 497

Shoqëritë që dyanshëm kanë fituar pjesë, përkatësisht aksione, kështuqë çdo shoqëri ka pjesë, përkatësisht aksione që marrin pjesë me më tepër se 20% në kapitalin themelor në shoqërinë tjetër ose nëse në kuvendin, përkatësisht tubimit të pjesëmarrësve të shoqërisë tjetër i takojnë më shumë se 20% të votave, konsiderohen për shoqëri që kanë pjesëmarrje të dyanshme. Për përcaktim nëse një shoqërie i takon pjesë, përkatësisht nëse i takojnë aksione që marrin pjesë me më shumë se 20% përqind në kapitalin themelor në shoqëri tjetër aplikohen dispozitat e nenit 494 paragrafi 3 nga ky ligj.

Kufizimi i kryqëzimit të shumicës midis shoqërive

Neni 498

(1) Shoqëria e varur nuk guxon të fitojë pjesëmarrje, përkatësisht aksione në shoqërinë e vet zotëruese.

(2) Nëse shoqëria e varur, para se të bëhet shoqëri e varur posedon pjesëmarrje, përkatësisht aksione në shoqërinë zotëruese, ka obligim ta tjetërsojë pjesëmarrjen, përkatësisht t'i tjetërsojë aksionet në shoqërinë zotëruese.

Shoqëri që veprojnë bashkarisht

Neni 499

(1) Konsiderohet se shoqëri veprojnë bashkë nëse kanë nënshkruar marrëveshje me qëllim të fitimit ose cedimit të të drejtës së votës ose për shkak të realizimit të të drejtës së votës me qëllim që të sigurohet udhëheqja e politikës së përbashkët ndaj shoqërisë.

(2) Shoqëritë që veprojnë bashkarisht janë përgjegjëse në mënyrë solidare për obligimet që dalin nga veprimi i tyre i përbashkët.

SEKSIONI 3

INFORMIM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRIVE TJERA

Informim për pjesë, përkatësisht aksione të fituara në shoqëri tjetër

Neni 500

(1) Kur një shoqëri fiton pjesë, respektivisht aksione të cilat në kapitalin themelor të shoqërisë tjetër të pavarur është e prezentuar me më shumë se 10% nga kapitali themelor të asaj shoqërie, llogaritur nga dita e tejkalimit të pragut të pjesëmarrjes prej 10%, për këtë, pa shtyerje, e informon atë shoqëri. Në informacionin me shkrim shoqëria që ka fituar

pjesë, respektivisht aksione informon për madhësinë e pjesës dhe për numrin, llojin dhe klasat e aksioneve që i ka fituar në shoqërinë.

(2) Pjesët, përkatësisht aksionet me të drejtë vote që i posedon shoqëria që ka për obligim informimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni janë të barazuara me pjesët, respektivisht aksionet me të drejtë vote që i kanë:

- 1) shoqëri tjera në llogari të kësaj shoqërie;
- 2) shoqëri që në pajtim me këtë ligj realizojnë ndikesë mbisunduese mbi këtë shoqëri;
- 3) shoqëri me të cilën kjo shoqëri vepron bashkarisht; dhe
- 4) shoqëritë nga pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi që shoqëria ka të drejtë t'i fitojë në sajë të marrëveshjes ose të bazës tjetër juridike.

(3) Nëse lartësia e pjesëmarrjes nga paragrafi 1 i këtij neni për të cilën ekziston obligimi i informimit, zvogëlohet, shoqëria nga paragrafi 1 I këtij neni, pa shtyerje, me shkrim e informon për këtë shoqërinë tjetër. Informacioni përmban të dhëna për madhësinë e pjesës, respektivisht numrin, llojin dhe klasat e aksioneve për të cilat është zvogëluar pjesëmarrja.

(4) Shoqëria që ka përfituar pjesëmarrje shumicë është e obliguar që këtë ta botojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(5) Nëse shoqëria bën lëshim që ta realizojë informimin në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk mund ta realizojë të drejtën e votës nga pjesa, respektivisht nga aksionet që i takojnë, dhe vendimet e sjellura me këto vota janë të pavlefshme. Mosvlerja e vendimeve nuk mund të theksohet ndaj personave të tretë që nuk kanë ditur ose, marrë parasysh të gjitha rrethanat, nuk kanë mund të dijnë për kufizimin e të drejtës së votës.

(6) Kur një shoqëri, sipas paragrafit 1 të këtij neni, fiton gjatë vitit afarist pjesë, respektivisht aksione me sëpaku 10% nga të gjitha votat në kuvendin, respektivisht tubimit të bashkëpjesëmarrësve në shoqëri tjetër, organi i administrimit është i obliguar për këtë t'i informojë bashkëpjesëmarrësit, respektivisht aksionarët në raportin vjetor mbi punën e shoqërisë si dhe për shoqëritë në të cilën ajo shoqëri ka pjesëmarrje të rëndësishme, shumicë ose të përbashkët.

(7) Në raportin vjetor për punën e shoqërisë nga paragrafi 5 të këtij neni theksohet identiteti i personave fizik dhe juridik që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kanë pjesëmarrje më shumë se 5% në kapitalin themelor ose kanë më tepër se 5% nga votat në tubimin e bashkëpjesëmarrësve, respektivisht kuvendit. Në raportin theksohen edhe ndryshimet nëse ato kanë ndodhur gjatë një viti.

SEKSIONI 4

UDHËHEQJE DHE PËRGJEGJËSI E SHOQËRISË ME PJESËMARRJE SHUMICË

Vëllimi i ndikesës së shoqërisë me pjesëmarrje shumicë

Neni 501

(1) Shoqëria me pjesëmarrje shumicë nuk mund ta shfrytëzojë ndikesën e saj që shoqërinë e nënshtruar ta detyrojë të ndërmerr punë të dëmshme

juridike ose të ndërmerr ose të lëshojë që të ndërmarrë veprim, vetëm nëse shoqëria me pjesëmarrje shumicë obligohet se do t'ia zhdëmtojë dëmin që ia ka shkaktuar shoqërisë së nënshtruar.

(2) Organi udhëheqës i shoqërisë së nënshtruar është i obliguar të përpilojë raport për marrëdhëniet me shoqërinë me pjesëmarrje shumicë për vitin paraprak afarist, të cilin e paraqet si pjesë përbërëse të raportit vjetor për punën e shoqërisë. Në raportin theksohen të gjitha punët juridike të cilat i ka ndërmarrë gjatë vitit paraprak shoqëria e nënshtruar e ndërlidhur me shoqërinë me pjesëmarrje shumicë ose me shoqëri e ndërlidhur me te në sajë të thirjes ose në interes të këtyre shoqërive si dhe të gjitha veprimet tjera të cilat në sajë të thirjes ose në interes të këtyre shoqërive i ka ndërmarrë ose ka lëshuar t'i ndërmerr në vitin e kaluar afarist. Në punët juridike theksohen pagesat dhe kundërpaguesat, ndërkaq tek veprimat tjera theksohen shkaqet për ndërmarrjen e tyre si dhe dobia dhe dëmet e krijuara për shoqërinë. Gjatë zhdëmtimit të dëmit veç e veç theksohet si është zhdëmtuar dëmi në vitin afarist dhe nëse shoqëria ka pasur të drejtë për lehtësime dhe cilat kanë qenë ato.

(3) Raporti përgatitet në pajtim me parimet për ndërgjegjësi dhe besueshmëri.

(4) Në raportin, organi i administrimit i shoqërisë së nënshtruar duhet të spjegojë nëse shoqëria në rrethanat që i ka pasur të njohura gjatë ndërmarrjes se punës juridike ose nëse dhe kur është lëshuar të ndërmerret, për të cilën është marrë zhdëmtim i caktuar dhe nëse me atë që është ndërmarrë ndonjë veprim ose është lëshuar të ndërmerret është shkaktuar dëm. Nëse shoqëria ka pësuar dëm, organi i administrimit i shoqërisë së nënshtruar është i detyruar të deklarojë nëse dëmi është zhdëmtuar. Sqarimi dhe deklarata shënohen në raportin e punës së shoqërisë së nënshtruar.

(5) Nëse revizionin e llogarisë vjetore dhe të raporteve financiare e kryen revizor i autorizuar, revizorit të autorizuar, njëkohësisht, me raportet i dorëzohet edhe raporti për marrëdhëniet e shoqërsë së nënshtruar me shoqërinë me pjesëmarrje shumicë.

(6) Me propozim të aksionarit, përkatësisht të bashkëpjesëmarrësit, gjykata mund të përcaktojë revizor të autorizuar që t'i hulumtojë marrëdhëniet afariste të shoqërisë me pjesëmarrje shumicë ose me ndonjë nga shoqëritë janë janë të varura nga ajo.

Përgjegjësi e organeve të shoqërisë së nënshtruar

Neni 502

(1) Anëtarët e organit të administrimit të shoqërisë së nënshtruar përgjigjen si debitorë solidarë, si dhe të gjitha personat tjera të obliguara me zhdëmtimin e dëmit sipas këtij ligji, nëse, me mospërmbushjen e obligimeve të tyre, në raportin për marrëdhëniet me shoqërinë e nënshtruar me shoqërinë me pjesëmarrje shumicë dhe me shoqëritë e varura nga ajo kanë bërë lëshim ta theksojnë punën e dëmshme juridike ose veprimin e dëmshëm ose nuk kanë theksuar se shoqëria me ato punë ose veprime juridike është dëmtuar, dhe ky dëm nuk i është zhdëmtuar. Në rast të kontestit, ata janë të obliguar të dëshmojnë se kanë vepruar me kujdes të tregëtarit të rregullt dhe të kujdesëshëm, gjë e cila pritet prej tyre.

(2) Nëse shoqëria e nënshtruar ka organin e mbikqyrjes, anëtarët e tij, respektivisht kontrollori përgjigjen si debitorë solidar, nëse sa i përket

punës juridike ose veprimit të dëmshëm nuk e kanë kryer obligimin e tyre ta kontrollojnë raportin nga paragrafi 2 të nenit 501 të këtij ligji dhe kanë bërë lëshim ta theksojnë punën e dëmshme juridike ose veprimin e dëmshëm me shoqërinë me pjesëmarrje shumicë dhe me shoqëritë e varura nga ajo dhe për rezultatin e shqyrtimit ta informojnë kuvendin, përkatësisht tubimin e bashkëpjesëmarrësve.

(3) Nuk ekziston obligimi për zhdëmtim të dëmit nëse veprimi i ndërmarrur mbështetet në vendim të sjellur nga kuvendi, përkatësisht nga tubimi i bashkëpjesëmarrësve, që është në pajtim me ligjin.

Përgjegjësi e shoqërisë me pjesëmarrje shumicë dhe përfaqësuesit e tij sipas ligji

Neni 503

(1) Nëse shoqëria me pjesëmarrje shumicë shtyn shoqëri të nënshtruar të ndërmerr punë ose veprim juridik, respektivisht të mos bëjë të ndërmarrë punë ose veprim të tillë me çka, i shkakton dëm shoqërisë së nënshtruar ose personit të tretë, dhe dëmin nuk e zhdëmton deri në fund të vitit afarist, shoqëria me pjesëmarrje shumicë patjetër duhet shoqërisë së nënshtruar t'ia zhdëmtojë dëmin e shkaktuar, ndërsa në raport me personin e tretë përgjigjet në mënyrë solidare me shoqërinë e nënshtruar. Aktpadinë për zhdëmtim të dëmit në emër ose në llogari të shoqërisë së nënshtruar ose individualisht mund ta paraqesin aksionarët, respektivisht bashkëpjesëmarrësit pa dallim të dëmit që u është shkaktuar me dëmin që i është bërë shoqërisë.

(2) Nëse shoqëri me pjesëmarrje shumicë, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk ia zhdëmton dëmin që ia ka shkaktuar shoqërisë së nënshtruar, patjetër duhet të përgatit raport në të cilin patjetër duhet të përcaktojë kur dhe në çfarë mënyrë dëmi do të zhdëmtohet. Raporti i dërgohet shoqërisë së nënshtruar në afat prej tredhiët ditësh pas kalimit të vitit afarist në të cilin është bërë dëmi.

(3) Nëse shoqëria me pjesëmarrje shumicë shtyn shoqëri të nënshtruar të ndërmarrë punë ose veprim juridik, respektivisht të bëjë lëshim të ndërmarrë punë ose veprim të tillë me çka i është shkaktuar dëm i pazhdëmtueshëm shoqërisë së nënshtruar ose e ka shtyrë të bëjë veprime, respektivisht ka lëshuar të ndërmarrë veprime e për këtë shkak është përmbushur njëri nga kushtet për falimentim mbi shoqërinë e nënshtruar, shoqëria me pjesëmarrje shumicë ka përgjegjësi solidare për lartësinë e kërkesave që nuk mund të përmbushen nga shoqëria e nënshtruar në falimentim e sipër.

(4) Nëse shoqëria me pjesëmarrje shumicë shtyn shoqëri të nënshtruar të ndërmerr punë ose veprim juridik, ose të mos ndërmarrë punë ose veprim të tillë juridik me çka u shkaktohet dëm aksionarët nga shoqëria e nënshtruar, shoqëria me pjesëmarrje shumicë dhe shoqëria e nënshtruar janë përgjegjëse në mënyrë solidare në raport me kërkesat e aksionarëve.

(5) Krahas shoqërisë me pjesëmarrje shumicë për dëmin në mënyrë solidare përgjigjen edhe përfaqësuesit me ligj të shoqërisë së nënshtruar për punët juridike, respektivisht për veprimet që është dashur t'i ndërmarrin, respektivisht që kanë lëshuar t'i ndërmarrin.

(6) Obligimi për zhdëmtim të dëmit nuk ekziston nëse tregëtari i përpiktë dhe i ndërgjegjshëm i shoqërisë së pavarur do të kishte ndërmarrë punën juridike ose do të kishte ndërmarrë ose do të kishte lëshuar të

ndërmarrë punë të njejtë juridike, respektivisht veprim pa shtyrje që ta bëjë këtë nga shoqëria me pjesëmarrje shumicë.

SEKSIONI 5

LLOGARIA E KONSOLIDUAR VJETORE DHE RAPORTE TË KONSOLIDUARA FINANCIARE

Llogaria e konsoliduar vjetore dhe raporte financiare

Neni 504

(1) Shoqëria tregëtare çdo vit përpilon dhe shpall llogari të konsoliduar vjetore dhe raporte të konsoliduara financiare, nëse ka ndikësë mbisunduese në një ose në më shumë shoqëri.

(2) Raportet e konsoliduara financiare përgatiten sipas standardeve ndërkombëtare për njoftim financiar. ^[29]

(4) Llogaria e konsoliduar vjetore dhe raportet e konsoliduara patjetër duhet të përpilohen në të njejtën datë në të cilën është përpiluar llogaria vjetore dhe raportet financiare e shoqërisë me ndikësë mbisunduese. ^[30]

Përmbajtja e llogarisë së konsoliduar vjetore dhe të raporteve të konsoliduara financiare

Neni 505

(1) Llogaria e konsoliduar vjetore permban bilanc të konsoliduar të gjendjes, bilanc të konsoliduar të suksesit dhe shenime sqaruese.

(2) Raportet e konsoliduara financiare përmbajnë bilancin e konsoliduar të gjendjes, bilancin e konsoliduar të suksesit, raportin e konsoliduar për rrjedhat e parave, raportin e konsoliduar për ndryshimet në kapitalin kryesor dhe shënime ndaj raporteve të konsoliduara, politika të aplikuara kontabiliste dhe shënime tjera sqarimi.

(3) Llogaritë e konsoliduara vjetore dhe raportet financiare përpilohen në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

Revizioni i llogarisë së konsoliduar vjetore raportet e konsoliduara financiare

Neni 506

(1) Llogaria e konsoliduar vjetore dhe raportet e konsoliduara nuk mund të miratohen pa u bërë revizioni.

(2) Llogarinë e konsoliduar vjetore dhe raportet e konsoliduara financiare shoqëria i dërgon deri te revizori i autorizuar.

(3) Shoqëria e autorizuar për revizion përcakton nëse raporti vjetor për punën e shoqërisë është në pajtim me llogarinë e konsoliduar vjetore, respektivisht me raportet e konsoliduara financiare për vitin e njejtë afarist.

(4) Llogarinë e konsoliduar vjetore, bashkë me raportin për punën për vitin vijues, shoqëria është e obliguar t'ua dërgojë organeve të

përcaktuara në nenin 477, paragrafi 4 të këtij ligji, më vonë deri më 31 Mars në vitin e ardhshëm.

(5) Llogaritë të miratuara të konsoliduara vjetore dhe raportet e miratuara të konsoliduara financiare, bashkë me raportin vjetor për punën e shoqërisë, organi i administrimit, më vonë tredhiët ditë nga dita e miratimit të tyre, në kopje, ia dërgojnë Regjistrin të llogarive vjetore pranë Regjistrin qendror dhe i vendosin për inspektim në lokal in afarist ose në lokal tjetër. Të drejtë inspektimi ka çdo bashkëpjesëmarrës, respektivisht aksionar.

(6) Llogaria e miratuar e konsoliduar dhe raportete miratuara të konsoliduara financiare bashkë me raportin vjetor, të punës dhe me raportin për revizionin të miartuar nga tubimi i bashkëpjesëmarrësve, respektivisht kuvendi, shpallen në të njejtën mënyrë dhe me të njejtat kushte si dhe llogaria vjetore dhe raportet financiare të shoqërive.

KAPITULLI I NËNTË

TRANSFORMIM I SHOQATËS PREJ NJËRËS NË FORMË TJETËR TË SHOQATËS

SEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Nocioni

Neni 507

(1) Secila shoqatë tregtare mundet që, në bazë të vendimit të bashkëpronarëve respektivisht aksionerëve, të marrë në mënyrë dhe në bazë të kushteve të caktuara me këtë ligj, kontratës për shoqatën, respektivisht statutin, ta transformojë formën e shoqatës dhe të vazhdojë të punojë në formën në të cilën është transformuar shoqata (në tekstin e mëtutjeshëm: transformim prej një forme në formë tjetër të shoqatës).

(2) Për transformimin prej një forme në formë tjetër të shoqatës zbatohen në mënyrë përkatëse edhe dispozitat e këtij ligji për themelimin e formës adekuate të shoqatës që ndodh me transformimin, nëse kjo kaptinë e ligjit nuk është caktuar ndryshe.

Përfjashtimi (moszbatimi) i likuidimit

Neni 508

(1) Gjatë transformimit të shoqatës prej një forme në formë tjetër të shoqatës, nuk zbatohet likuidimi.

(2) Shoqata mbi të cilën zbatohet likuidimi, mund të transformohet prej një forme në tjetër formë të shoqatës deri në fillim të ndarjes dhe pagesës së masës së mbetur të likuidimit që mbetet pas pagesës së kërkesave të kreditorëve të shoqatës.

(3) Shoqata mbi të cilën është hapur procedurë falimentuese, nuk mund të transformohet prej një forme në tjetër formë të shoqatës, përpos nëse në

pajtim me Ligjin për falimentim transformimi është përmbajtur në planin e miratuar për riorganizimin e borxhliut të falimentuar.

Kontinuitet i personit juridik

Neni 509

(1) Pas transformimit të kryer të shoqatës prej një forme në formë tjetër të shoqatës, shoqata vazhdon të punojë si person juridik në formën tjetër të shoqatës me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga forma e shoqatës prej së cilës është transformuar, përveç të drejtave dhe obligimeve të bashkëpronarëve, respektivisht aksionerëve të cilët janë ndryshuar me marrëveshjen e shoqatës, përkatësisht statutin e shoqatës në procedurën e transformimit.

(2) Për të gjitha obligimet e shoqatës që kanë ndodhur deri në transformimin e shoqatës, bashkëpronarët e shoqatës publike, përkatësisht komplementarët në shoqërinë komanditore ose shoqërinë komanditore me aksione nga shoqata e cila është transformuar, u përgjigjen kreditorëve pa kufi dhe në mënyrë solidare me gjithë pronën e tyre.

PJESA 2

PROCEDURA E TRANSFORMIMIT TË SHOQËRISË PREJ NJË FORME NË FORMË TJETËR TË SHOQËRISË

Vendimi për transformimin e shoqatës prej një forme në formë tjetër të shoqatës

Neni 510

(1) Transformim i shoqatës prej një forme në formë tjetër të shoqatës kryhet në bazë të vendimit për transformim të shoqatës prej një forme në formë tjetër të shoqatës (në tekstin e më tutjeshëm: vendimi për transformim) të cilin e merr tubimi i bashkëpronarëve, përkatësisht kuvendi.

(2) Vendimin për transformim nga paragrafi 1 i këtij neni e merr tubimi i bashkëpronarëve, përkatësisht kuvendi me shumicën e votave e cila nuk mund jenë nën dy të tretat nga të gjitha pjesët e paraqitura, përkatësisht aksionet me të drejtë vote, përpos nëse me kontartën për shoqërinë, përkatësisht statutin nuk kërkohet shumicë më e madhe.

(3) Vendimi për transformim të shoqërisë publike, përkatësisht të shoqërisë komanditore në formë tjetër të shoqërisë, kryhet në pajtim me të gjithë bashkëpronarët, përkatësisht komplementarët. Vendimi për transformimin e shoqërisë komanditore me aksione në formë tjetër të shoqërisë zbatohet në pajtim me kuvendin për të cilin vendim pëlqim japin të gjithë komplementarët.

(4) Vendimi për transformim e shoqërisë me përgjegjsi të kufizuar, përkatësisht të shoqërisë aksionare në shoqëri publike merret me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve.

(5) Në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht kuvend në të cilin vendoset për transformim, miratohet llogaria vjetore deri në ditën e vendosjes për transformimin e shoqërisë, së bashku me raportin e revizorit të autorizuar.

(6) Organi udhëheqës, përkatësisht bashkëpronarët, të autorizuar ta drejtojnë shoqërinë, duhet të doemos duhet të paraqesin informatë me shkrim, në të cilën arsyetohen shkaqet, çështjet juridike dhe afariste me rëndësi për transformimin, në mënyrë që të gjithë bashkëpronarët të kenë qasje, përkatësisht aksionerët. Informata me shkrim dërgohet si pjesë e materialeve të cilat u dërgohen bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve për mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht kuvendin në të cilin vendoset për transformimin.

Përmbajtja e vendimit për transformim

Neni 511

(1) Vendimi për transformim i përmban këto të dhëna:

- 1) firmën e shoqatës e cila transformohet dhe firmën e shoqatës në të cilën është transformuar;
- 2) emrin dhe mbiemrin e secilit bashkëpronar, përkatësisht aksionar, numrin amzë të qytetarit (NAQ), numrin e pasaportës, përkatësisht numrin e letërnjoftimit ose ndonjë dokumenti tjetër për dëshminë e identitetit që vlen në vendin e tij nëse bashkëpronari, përkatësisht aksionari është person i huaj fizik dhe nënshtetësia e tij, si dhe vendbanimi, përkatësisht firma, selia, NUAS nëse bashkëpronari, përkatësisht aksionari është person juridik;
- 3) udhëzimin e kontratës për shoqërinë, përkatësisht statutin i cili është shtesë e vendimit për transformim dhe pjesë përbërëse e saj;
- 4) udhëzimin e vendimit për zgjedhjen e organit udhëheqës, përkatësisht të organit mbikqyrës, nëse shoqëria ka organ mbikqyrës; dhe
- 5) udhëzimin e llogarisë së miratuar vjetore.

(2) Për përmbajtjen e kontratës për shoqatën, përkatësisht statutin në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji, me të cilat rregullohet përmbajtja e kontratës për shoqërinë, përkatësisht statutin gjatë themelimit të formës së shoqërisë që ndodh me transformimin.

(3) Nëse shmangia nga pjesët e shoqërisë që e ndryshon formën është e kushtëzuar me pëlqimin e bashkëpronarëve, të cilët krahas pagesave të depozitimeve kanë edhe obligime tjera ndaj shoqërisë, për vlefshmërinë e vendimit për transformim duhet edhe pëlqimi i tyre.

Kushtet me të cilat mund të kryhet transformimi

Neni 512

(1) Shoqëria mund të transformohet prej një forme në formë tjetër të shoqatës, në bazë të kushteve s vijojnë:

- 1) pas marrjes së vendimit për transformim t'u mundësohet të gjithë bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve të deklarohen se dëshirojnë që me pjesën e tyre, përkatësisht me aksionet e tyre të marrin pjesë me pjesën, përkatësisht me aksionet në formën e shoqatës që do të formohet me transformimin;
- 2) në formën e transformuar të shoqërisë, bashkëpronari, përkatësisht aksionari të marrë pjesë me pjesën, përkatësisht me aksionet proporcionalisht me vlerën nominale të pjesës së tij, përkatësisht aksioneve të tij me të cilat ka marrë pjesë si bashkëpronar, përkatësisht

aksionar në pjesën më të madhe të shoqërisë që është transformuar;

3) bashkëpronari, përkatësisht aksionari pavarësisht mund të vendosë për madhësinë e pjesës së pjesëmarrjes së tij, përkatësisht me numrin e aksioneve në formën e shoqërisë e cila do të formohet me transformimin; dhe

4) në shoqërinë e cila do të formohet me transformim të marrin pjesë bashkëpronarë, përkatësisht aksionarë ku pjesëmarja e pjesëve nominale të tyre, përkatësisht aksionet të përbëjnë më së paku dy të tretat e kryegjësë themelore të shoqërisë që ndodh me transformimin.

(2) Nëse kryegjësja themelore nuk mbulohet me participimin në bazë të paragrafit 1 pika 4 i këtij neni, kryegjësja themelore mund të plotësohet me depozitime që mund të merren edhe nga persona të cilët nuk janë bashkëpronarë, përkatësisht aksionarë, që mund të paguhen vetëm në para dhe atë plotësisht para regjistrimit të vendimit për transformim në regjistrin tregtar, ose bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët janë të obliguar ta paguajnë dallimin, proporcionalisht me pjesëmarrjen në depozitim të tyre, në kryegjësë themelore të shoqërisë që do të ndodhë me transformimin.

(3) Vlera e pjesës së posaçme, përkatësisht aksionit të posaçëm, llogaritet në bazë të bilancit të gjendjes, e cila themelohet për atë qëllim dhe që është pjesë përberëse e vendimit për transformim.

Marrja e pjesës, përkatësisht e aksionit

Neni 513

(1) Marrja e pjesës kryhet me deklaratë të vërtetuar te noteri, ndërsa marrja e aksioneve kryhet me fletëregjistrim.

(2) Nëse vendimi për transformim, pjesë përbërëse e të cilit është edhe kontrata për shoqërinë, përkatësisht statuti miratohet në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht kuvend, në të cilin vendoset për transformimin e saj në formë tjetër të shoqërisë, me kërkesën e shumicës së bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve të cilët marrin pjesë në punën e kuvendit të bashkëpronarëve, përkatësisht kuvend, në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht në vet mbledhjen mund të japin deklaratë për marrjen e pjesës, përkatësisht aksioneve të cilat hynë në procesverbalin e mbledhjes së bashkëpronarëve, përkatësisht të kuvendit, me kusht që procesverbalin ta mbajë noteri dhe përmbajtja e t'ij t'u përgjigjet dispozitave të këtij ligji.

(3) Bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht të kuvendit, në afat prej tri ditësh pas mbajtjes së mbledhjes së bashkëpronarëve, përkatësisht të kuvendit, ftohen me thirrje publike, që në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj, por jo edhe më i gjatë se dy muaj prej ditës së shpalljes së thirrjes publike të japin deklaratë se a pajtohen të marrin pjesë, përkatësisht aksione, të verifikuar te noteri, mund ta dorëzojnë në afat të caktuar në thirrjen publike.

(4) Të gjithë bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët të cilët janë pajtuar të jenë bashkëpronarë në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, bashkëpronarë si komanditorë, përkatësisht komplementarë në shoqërinë komanditore, shoqëri komanditore me aksione, përkatësisht bashkëpronarë në shoqëri publike, doemos duhet të japin deklaratë të hartuar me shkrim se e pranojnë kontratën për shoqërinë. Nënshkrimi i deklaratës vërtetohet te noteri.

(5) Të gjithë bashkëpronarët të cilët janë pajtuar të jenë aksionarë në shoqërinë e transformuar doemos duhet të nënshkruajnë fletëparaqitje për numrin e aksioneve që i marrin.

(6) Kur kryhet transformim i shoqërisë me përgjegjshi të kufizuar, përkatësisht të shoqërisë aksionare në shoqëri publike, bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht të kuvendit, deklaratën nga paragrafi 4 i këtij ligji mund ta japin në afat jo më të gjatë se tridhjet ditë prej ditës së mbajtjes së mbledhjes së bashkëpronarëve, përkatësisht të kuvendit.

(7) Dispozitat e këtij ligji për kryegjënë themelore, depozitimet në shoqëri, pjesët, përkatësisht aksionet aplikohen ngjashëm në rast të transformimit të shoqërisë prej një forme në formë tjetër të shoqërisë.

Regjistrimi i transformimit

Neni 514

(1) Transformimi prej një forme në formë tjetër të shoqërisë regjistrohet në regjistrin tregtar.

(2) Pas marrjes së vendimit për transformim dorëzohet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar. Fletëparaqitjen e nënshkruajnë antarët e organit udhëheqës, udhëheqësit, kryetari i këshillit mbikqyrës, përkatësisht kontrolluesi i shoqatës, të cilët janë caktuar me marrëveshjen e shoqatës, përkatësisht me statutin me verifikimin e nënshkrimeve të tyre me nënshkrim elektronik të agjentit regjistruar kur është në formë me shkrim, apo nënshkruar me nënshkrimet e tyre elektronike kur parashtrohet në formë elektronike përmes sistemit për e-regjistrim.

(3) Fletëparaqitjes për regjistrimin e transformimit në regjistrin tregtar i bashkangjiten në origjinal, duplikatë ose të verifikuar te noteri;

1) procesverbali nga mbledhja e bashkëpronarëve, përkatësisht nga kuvendi në të cilën është marrë vendimi për transformim, i vërtetuar te noteri;

2) deklarata nga të gjithë antarët e organit udhëheqës, përkatësisht të udhëheqësit, nëse shoqëria ka organ mbikqyrës edhe deklarata të antarëve të këshillit mbikqyrës, përkatësisht të kontrolluesit, përkatësisht të bashkëpronarëve në shoqërinë publike dhe komplementarët në shoqërinë komanditore dhe shoqërinë komanditore me aksione se janë plotësuar kushtet për transformimin e shoqërisë në formë tjetër të shoqërisë, të parapara me këtë ligj.

3) vendimi për transformim me pjesët e caktuara me këtë ligj;

4) lista me emrin dhe mbiemrin e secilit bashkëpronar, përkatësisht aksionar, numri amzë i qytetarit (NAQ), numri i pasaportës, përkatësisht numri i letërnjoftimit ose dokumentit tjetër për dëshmimin e identitetit që vlen në vendin e tij nëse bashkëpronari, përkatësisht aksionari është person i huaj fizik dhe nënshtetësia e tij si dhe vendbanimi, përkatësisht firma, selia, NUAS nëse bashkëpronari përkatësisht aksionari është person juridik, me të caktuarit e madhësisë së pjesës, përkatësisht të numrit të aksioneve që i ndërmerr secili bashkëpronar, përkatësisht aksionar proporcionalisht me vlerën nominale të pjesës së bashkëpronarit, përkatësisht vlera nominale e aksioneve të secilit aksionar që i posedojnë në kryegjënë themelore të shoqërisë që ndodh me transformimin;

5) lista e emëruar në të cilën përmenden bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët të cilët kanë votuar për marrjen e vendimit për transformim;

6) vendimi për zgjedhjen e organit udhëheqës, këshillit mbikqyrës ose kontrolluesit, nëse shoqëria ka organ mbikqyrës, përkatësisht vendimi për emërimin e bashkëpronarëve, përkatësisht personave të cilët sipas

marrëveshjes së shoqërisë janë të autorizuar për përfaqësim, që është shtesë e vendimit për transformim dhe është pjesë përbërëse e tij;

7) deklaratat e bashkëpronarëve për marrjen e pjesëve dhe për zbatimin e marrëveshjes për shoqërinë, pa dallim se a janë futur në procesverbalin ose janë dhënë në mënyrë tjetër, të caktuar me këtë ligj, përkatësisht fletëregjistrat për marrjen e aksioneve;

8) llogaria vjetore deri në ditën e vendosjes për transformim të shoqërisë, së bashku me raportin nga revizori i autorizuar; dhe

9) deklaratat në pajtim me nenin 32 të këtij ligji.

(4) Me regjistrimin e transformimit në regjistrin tregtar, shoqëria vazhdon të punojë si shoqëri në formën në të cilën është transformuar.

(5) Nëse fletëparaqitja nga paragrafi 2 i këtij neni nuk dorëzohet në afat prej nëntëdhjetë ditësh prej ditës kur në mbledhjen e bashkëpronarëve, përkatësisht të kuvendit është marrë vendimi për transformim, llogaritet se vendimi nuk është marrë.

Shndërrimi i pjesëve në aksione, përkatësisht aksione në pjesë

Neni 515

(1) Pas regjistrimit të transformimit në regjistrin tregtar, në bazë të deklaratave për marrjen e pjesëve, përkatësisht fletëregjistrave për marrjen e aksioneve dhe vërtetimit për fitimin e pjesëve, përkatësisht për fitimin e aksioneve në shoqërinë e transformuar, pjesët, përkatësisht aksionet regjistrohen në librin e pjesëve, përkatësisht në librin aksionar.

(2) Vërtetimin nga paragrafi 1 i këtij neni e jep organi udhëheqës i shoqërisë që transformohet.

(3) Nëse shoqëria transformohet në shoqëri aksionare, kryetari i këshillit të drejtorëve, përkatësisht kryetari i këshillit drejtues, më së voni në afat prej tetë ditësh prej ditës së regjistrimit të transformimit në regjistrin tregtar, i jep urdhër Depozitorit qendror për letra me vlerë të hapë libër aksionar.

(4) Nëse shoqëria aksionare transformohet në formë tjetër të shoqërisë, udhëheqësi më së voni në afat prej tetë ditësh prej ditës së regjistrimit të transformimit në regjistrin tregtar, i jep urdhër Depozitorit qendror për letra me vlerë ta mbyllë librin aksionar.

(5) Të drejtat e personave të tretë ndaj pjesëve, përkatësisht aksioneve nga shoqëria që është transformuar përcillen si të drejta të personave të tretë ndaj pjesëve, përkatësisht ndaj aksioneve në shoqërinë që ka ndodhur me transformimin.

Të drejtat e bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit pas transformimit të shoqërisë

Neni 516

(1) Bashkëpronarit, përkatësisht aksionarit i cili me deklaratë me shkrim nuk është pajtuar me transformimin e shoqërisë në formë tjetër të shoqërisë, shoqëria është e obliguar t'ia riblejë pjesën, përkatësisht aksionet sipas çmimit të përshtatshëm me bilancin e pranuar i vërtetuar në vendimin për transformimin e shoqërisë (çmim i ofruar).

(2) Nëse bashkëpronari, përkatësisht aksionari nuk e pranon çmimin e ofruar në paragrafi 1 i këtij neni më së voni në afat prej tridhjet ditësh nga dita e refuzimit të ofertës, mund të dorëzoj propozim deri te gjykata që ta konfirmojë vlerën e pjesës, përkatësisht të aksioneve bashkëpronari, përkatësisht aksionari i humb të drejtat e pjesës, përkatësisht të aksioneve, vetëm nëse të drejtën për kompensim të pjesës së tij, përkatësisht të aksioneve të tij.

(3) Bashkëpronari, përkatësisht aksionari i shoqërisë që është transformuar, mund ta dorëzojë propozimin nga paragrafi 2 i këtij neni vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të përkohshëm, të cilin ata e emërojnë. Përfaqësuesi i përkohshëm ka të drejtë për kompensim të harxhimeve si edhe në shpërblim të punës së tij nëse bashkëpronari, përkatësisht aksionari vetë nuk i cakton harxhimet dhe shpërblimin, ato i konfirmon gjykata në bazë të rrethanave të secilit rast dhe cakton në çfarë mase duhet t'ia kompenzojnë bashkëpronarët e mëparshëm, përkatësisht aksionarët që kanë të bëjnë me atë.

(4) Gjykata, në bazë të raportit për vlerësim, të përpiluar nga vlerësues i autorizuar i emëruar nga gjykata, cakton vlerën e pjesës, përkatësisht të aksioneve të bashkëpronarit, përkatësisht të aksionarit i cili kundërshtohet. Në këtë rast, harxhimet bien në barrë të shoqërisë, nëse vlerësuesi konfirmon se çmimi për pjesë, përkatësisht për aksionet që e ka caktuar shoqëria është e njëjtë ose më e vogël prej asaj që e ka konfirmuar shoqëria, harxhimet për vlerësimin bien mbi bashkëpronarin, përkatësisht aksionarin i cili e ka dorëzuar kërkesën, bashkëpronari, përkatësisht aksionari me propozim mund të kërkojë dhe kamatë.

(5) Pas plotfuqishmërisë juridike të vendimit të gjykatës nga paragrafi 4 të këtij neni, shoqëria që ka ndodhur me transformimin e cakton afatin për ngritjen e pagesës që nuk mund të jetë me pak se një muaj. Pas kalimit të këtij afati, paratë kalojnë te gjykata.

(6) Bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët e shoqërisë që transformohet nuk mund të kenë kërkesa të tjera nga pronësia e shoqërisë që ndodh me transformimin, në bazë të transformimit.

KAPTINA E DHJETË

BASHKIMI, BASHKANGJITJA DHE NDARJA E SHOQËRIVE (NDRYSHIME STATUTARE)

Bashkimi, bashkangjitja dhe ndarja e shoqërive

Neni 517

(1) Një ose më tepër shoqëri mund të bashkohen (shoqëri që bashkohet) në shoqër tjetër (shoqatë që merret) me bartje të gjithë pronës dhe të obligimeve të shoqatës që bashkohet pa kryerjen e likuidimit të tij, në zëvendësim për pjesë, respektivisht për aksione nga shoqata që merret.

(2) Dy ose më tepër shoqata mund të bashkohen, pa u kryer likuidimi, me themelimin e një shoqate të re shfrytëzuese në të cilën bartet gjithë pasuria dhe obligimet e shoqatave që bashkohen, për zëvendësim të pjesëve, respektivisht të aksioneve të shoqatës së re shfrytëzuese.

(3) Një shoqatë mund që, nëpërmjet ndarjes, njëkohësisht ta bartë tërë pasurinë dhe obligimet në dy ose më tepër shoqatave të reja të

themeluara (në tëkstin e mëtutjeshëm: ndarje me të themeluar) ose në dy ose më tepër shoqata ekzistuese (në tekstin e mëtutjeshëm: ndarje me marrje), gjatë së cilës shoqata që ndahet pushon pa kryerjen e likuidimit. Një shoqatë mund që gjatë ndarjes, pjesë të pasurisë së vet dhe të obligimeve t'i bartë në një ose më tepër shoqata të reja të themeluara (në tekstin e mëtutjeshëm: ndarje me themelim) ose në një ose më tepër shoqata ekzistuese (në tekstin e mëtutjeshëm: ndarje me marrje), gjatë së cilës shoqata nuk pushon.

(4) Ndarja mund të kryhet me bartje të njëkohësishme të të gjithë pasurisë ose të një pjese të pasurisë dhe të obligimeve të shoqatës që ndahet në shoqata të reja dhe në shoqata ekzistuese ndarje e kombinuar me ndarje të themeluar, ndarje me marrje, ndarje me themelim dhe me ndarje me marrje).

(5) Bashkëpronarët, respektivisht aksionarët të shoqatave në kuadër të veprimeve të cekura në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni pranojnë pjesë ose aksione nga shoqatat që i marrin respektivisht nga shoqatat e reja të themeluara shfrytëzues dhe sipas nevojës, dallim në të holla sasia e të cilit nuk kalon 10% nga sasia nominale të pjesëve të pranuar, respektivisht aksioneve.

(6) Bashkim, bashkangjijtja, respektivisht ndarja nga pragrafet 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni mund të kryhet edhe kur është marrë vendim për pushimin e shoqatës me likuidim, me kusht bashkëpronarët, respektivisht aksionarët të mos e kenë filluar ndarjen e pasurisë dhe bligimet e shoqatës, respektivisht kur ndalohet procedurë e hapur falimentuese për zbatimin e riorganizimit të borxhit të falimentuar, respektivisht kur ajo është e konfirmuar në planin për riorganizimin e borxhit të falimentuar.

(7) Veprimet të parapara me këtë nen mund të kryhen edhe midis shoqatave me forma të ndryshme.

Vendosja për ndryshimet statutare

Neni 518

(1) Për bashkimin vendosin shoqata që bashkohet dhe shoqata ndaj së cilës kryhet të bashkuarit (shoqata që merr);

(2) Për bashkangjijtjen vendosin shoqatat që bashkangjiten;

(3) Për ndarjen e shoqatës që kryhet me ndarje me themelim dhe me ndarje, me themelimin e shoqatave të reja, vendimin e merr shoqata e cila ndahet. Kur ndarja e shoqatës kryhet me ndarje me marrje dhe me ndarje me marrjen, vendimin e merr shoqata e cila ndahet dhe shoqata të cilës i bartet pjesë e pasurisë dhe obligimeve të shoqatës e cila ndahet (shoqata që merret).

(4) Vendimin për bashkimin, bashkangjijtjen dhe ndarjen e marrin bashkëpronarët, mbledhja e bashkëpronarëve, respektivisht kuvendi i secilës shoqatë e cila merr pjesë në bashkimin, bashkangjijtjen dhe në ndarjen, sipas kushteve dhe mënyrës, të parapara me këtë ligj për ndryshimin e marrëveshjes të shoqatës, respektivisht të statutit.

(5) Nëse me bashkim dhe ndarje themelohet shoqatë e re, themelimi kryhet në bazë të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me themelimin e formave përkatëse të shoqatës, vetëm nëse me dispozitat e kësaj kaptine nuk është ndryshe e caktuar.

(6) Nëse si pasojë e bashkimit, bashkangjities dhe ndarjes rriten obligimet e bashkëpronarëve ose të aksionarëve të një ose më tepër shoqatave, vendimi për bashkimin, bashkangjities dhe ndarjen merret në pajtim e të gjithë bashkëpronarëve, respektivisht aksionarë.

(7) Kryetari i këshillit të drejtorave, respektivisht kryetari i këshillit drejtues, më së voni në afat prej tetë ditëve prej ditës së regjistrimit të të bashkuarit në shoqatë tjetër kah shoqatë aksionare, respektivisht bashkangjities ose ndarjes të shoqatës aksionare e lajmëron Depozitori qendror për letra me vlerë për kryerjen e ndryshimit statutar i jep urdhër për ndryshimet të cilat duhet të kryhen në librin aksionar, respektivisht për hapjen e librit të ri aksionar.

Bartja universale e tërë pasurisë ose të një pjese të saj

Neni 519

(1) Me bashkimin, bashkangjities dhe ndarjen e shoqatës me ndarje me themelim dhe me ndarje me marrje, shoqata pushon pa likuidim dhe kryhet bartje universale e tërë pasurisë dhe obligimet ndaj shoqatave të reja të themeluara dhe ndaj shoqatave që marrin, me gjendjen e ditës të caktuar me marrëveshjen në të cilën i harmonizojnë kushtet me anë të të cilave do të kryhet bashkimi, bashkangjities, respektivisht ndarja (në tekstin e mëtutjeshëm: marrëveshje) ose me planin për ndarjen e shoqatës me ndarje me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar në tekstin e mëtutjeshëm: plan për ndarje).

(2) Shoqatat e reja të themeluara që kanë ndodhur me bashkangjities dhe me ndarjen me themim dhe me veçim me të themeluar dhe shoqatat që marrin me të bashkuar dhe me ndarje me të veçuar me marrje dhe me ndarje me marrje janë borxhlinj solidarë të kreditorëve të shoqatave të cilat janë bashkuar ose janë ndarë.

(3) Shoqatat e reja të themeluara dhe shoqatat që marrin me ndarjen mund të meren vesh që obligimet e shoqatës që ndahet (të cilat do t'i kenë përsipër) të jenë të rregulluara pa përgjegjësi solidarë, respektivisht t'i ndërmarrë shoqata e re e themeluar e cila ndërmerr. Edhe në këtë rast, shoqatat e reja të themeluara dhe shoqatat që ndërmarrin dhe shoqata që ndahet me të veçuar me të themeluar ose me të veçuar me të ndërmarrjet janë borxhlinj solidarë supsidierë të kreditorëve të shoqatës e cila ndahet.

(4) Dhënia, respektivisht tërheqja e aksioneve, respektivisht ndërmarrja dhe tërheqja e pjesëve kryhet në pajtim me marrëveshjen, respektivisht me planin për ndarje.

Përmbajtja e marrëveshjes

Neni 520

(1) Organi i udhëheqjes së shoqatës i cili bashkohet dhe organi i udhëheqjes së shoqatës i cili ndërmerr, organet e udhëheqjes së shoqatës që lidhen, respektivisht organi i udhëheqjes së shoqatës që ndahet me të ndërmarrë ose me të veçuarit me të ndërmarrë dhe organi i udhëheqjes së shoqatës që ndërmerr, lidhin marrëveshje në të cilën i harmonizojnë kushtet me anë të të cilave do të kryhet bashkimi, bashkangjities, respektivisht ndarja. Marrëveshja hartohet në formë të aktit noterik.

(2) Marrëveshja e paragrafit 1 të këtij neni i përmban këto të dhëna:

1) formën, firmën dhe selinë e shoqatës që bashkohet dhe të shoqatës e

cila ndërmerr, respektivisht të shoqatave që bashkohen, respektivisht të shoqatës që ndahet me të veçuar me ndërmarrje dhe me të veçuar me ndërmarrje dhe të shoqatave që ndërmarrin.

2) mënyrën me anë të së cilës do të kryhet bartja e pronës dhe obligimeve nga shoqata që bashkohet në shoqatën që ndërmerr, respektivisht të shoqatës që ndërmerr pjesë të pronës dhe të obligimeve të shoqatës që ndahet me të veçuar me të ndërmarrë dhe me ndarje me të ndërmarrë si edhe ndërrimi për pjesë, respektivisht aksione që fitohen nga shoqata e re shfrytëzues që ndodh me lidhjen.

3) qëllimin dhe kushtet në bazë të të cilave kryhet bashkimi, bashkangjitja ose ndarja me ndarje me të marrë dhe me të veçuar me të marrë;

4) vlera e të hyrave dhe të dalave që barten prej shoqatës që i bashkangjitet shoqatës që ndërmerr përkrahim detaj të ndarjes së pronës dhe obligimeve që barten, respektivisht ndërmeren (bilans ndarës), prej shoqatave që lidhen në shoqatën e re shfrytëzues, respektivisht prej shoqatës që ndahet me ndarje me ndërmarrje dhe me të veçuar me ndërmarrje të shoqatës e cila ndërmerr;

5) raporti sipas të cilit do të kryhet ndërrimi i pjesëve, respektivisht të aksioneve dhe, nese ka nevojë, edhe lartësia e te paguarit në të holla, respektivisht pjesët ose aksionet që duhet të arrihen me zmadhimin e kryegjës ë shoqatës e cila ndërmerr, respektivisht prej shoqatës së re shfrytëzues dhe obligimet që i japin ata;

6) të drejtat të cilat u pranohen bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve si edhe kushtet e posaçme që i kanë fituar, respektivisht të cilat ua japin pjesët, respektivisht aksionet;

7) mënyra e ndërmarrjes së pjesëve, respektivisht të aksioneve dhe data prej të cilëve pjesët e ndërmarrja, respektivisht aksioneve u jepet e drejta të marrin pjesë bashkëpronarët, respektivisht aksionarët e shoqatës për fitim të shoqatës e cila ndërmerr, respektivisht të shoqatës së re shfrytëzuese dhe të gjitha detajet të cilat janë me rëndësi për realizimin e asaj të drejte;

8) data kur do të ndërpriten aktivitetet afariste të shoqatës që bashkohet dhe shoqatat të cilat bashkangjiten;

9) data kur punët e shoqatës që bashkohet, shoqatave që bashkangjiten, respektivisht të shoqatës që ndahet me ndarje me të marrë ose me të veçuar me marrje nga pikëpamja kontabiliste do të llogariten si të jenë të kryera në llogari të shoqatës që ndërmeret, respektivisht të shoqatës së re shfrytëzuese që ndodh me bashkangjitet;

10) secili kusht i posaçëm nëse i jepet ndonjërit antar të organit udhëheqës ose të këshillit mbikqyrës, respektivisht kontrolluesit të shoqatave të cilët marrin pjesë në të bashkuarit, të bashkangjiturit, respektivisht ndarjen me të ndarë me të marrë dhe me të veçuar me të marrë, nëse shoqatat kanë organ mbikqyrës;

11) kushtet me të cilat të punësuarëve do t'u vazhdohet marrëdhënia e punës në shoqatat të cilat ndërmarrin, respektivisht shoqatat shfrytëzues;

12) afatet deri për kur do të përgariten llogaritë vjetore; dhe

13) çështje të tjera me interes të përbashkët për realizimin e të bashkuarit, të bashkangjitet, respektivisht ndarjes me ndërmarrje dhe të veçuarit me ndërmarrje.

(3) Pjesë përbërëse të marrëveshjes të paragrafit 2 të këtij neni janë:

1) te të bashkuarit, respektivisht te ndarja me të ndarët me ndërmarrje ose të veçuarit me ndërmarrje me propozim vendimet të ndryshimeve dhe plotësimeve të marrëveshjes të shoqatës, respektivisht te lidhja propozimi i marrëveshjes të shoqatës respektivisht propozimi i statutit i shoqatës së re shfrytëzues;

2) listë e bashkëpronarëve, respektivisht aksionarë të shoqatës që bashkohet, respektivisht të shoqatave të cilat lidhen, respektivisht ndarjen nga ndarja nga marrja ose përvetësimi duke marrë vlerën nominale të

pjesëve, respektivisht të aksioneve të cilët ekzistojnë në shoqatën që ndërmerr si edhe pjesët, respektivisht aksionet që ata duhet t'i fitojnë në shoqatën e cila ndërmerr, respektivisht në shoqatën e re shfrytëzues në të cilën bëhen bashkëpronarë, respektivisht aksionarë; dhe

3) listë e të punësuarve të cilët e vazhdojnë marrëdhënien e punës në shoqatën e cila ndërmerr, respektivisht në shoqatën e re shfrytëzues.

Plani për ndarje

Neni 521

(1) Nëse kryhet ndarje me të ndarë, me të themeluar ose të veçuar me të themeluar të shoqatave të reja, organi udhëheqës i shoqatës i cili ndahet sjell plan për ndarje. Plani për ndarje, me të gjitha shtojcat, duhet futet në formë të aktit noterik.

(2) Plani për ndarje nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'i përmbajë këto të dhëna:

1) formën, firmën dhe selinë e shoqatës që ndahet me ndarje me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar, respektivisht të shoqatave të reja të themeluar shfrytëzues;

2) mënyra me anë të së cilës do të kryhet bartja e pronës dhe obligimeve nga shoqata që ndahet në shoqatat të cilat themelohen, në zëvendësim për pjesët, respektivisht për aksione nga këto shoqata;

3) qëllimet dhe kushtet me anë të të cilave kryhet ndarja me të ndarë me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar;

4) vlera e të hyrave dhe të dalave që bartet (bilanci ndarës) nga shoqata që ndahet me ndarje me të themeluar dhe me të vetuar me të themeluar të shoqatave të krijuara dhe përshkrim detaj të ndarjes së pronës, të drejtat dhe detyrat;

5) raporti sipas të cilit do të bëhet ndërimi i pjesëve, respektivisht të aksioneve, nëse është e nevojshme edhe lartësia e të paguarit në të holla, respektivisht pjesëve ose aksioneve që duhet të ndërmerren, respektivisht të fitohen në shoqatën e re të krijuar dhe të drejtat dhe detyrat të cilat i japin ato;

6) të drejtat të cilat u janë pranuar bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve si edhe kushtet e posaçme të cilat i kanë fituar, respektivisht ua japin pjesëve, respektivisht aksionet;

7) mënyra e marrjes së pjesëve, respektivisht të aksioneve dhe data kur ata u japin të drejtë për pjesëmarrje në fitimin bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve në shoqatat e reja të krijuara dhe të gjitha hollësitë të cilat janë me rëndësi për fitimin e asaj të drejte;

8) data kur do të ndalohen të gjitha aktivitetet afariste të shoqatës e cila ndahet;

9) data prej kur punët e shoqatës që ndahet me ndarje me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar nga pikëpamja kontabiliste do të llogariten si të kryera në llogari të shoqatave të reja të themeluara;

10) secili kusht i posaçëm nëse i jepet ndonjërit antar të organit udhëheqës ose të këshillit mbikqyrës, respektivisht kontrolluesit të shoqatës që ndahet dhe të shoqatës së re të themeluar, nëse shoqatat kanë organ mbikqyrës;

11) kushtet me anë të të cilave të punësuarve do t'u vazhdohet mardhënia e punës në shoqatat e reja të themeluara.

12) afati deri kur do të pregaditet llogaria vjetore; dhe

13) çështje të tjera me interes të përbashkët për realizimin e ndarjes me ndarje me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar;

(3) Pjesë përbërëse e pjesës së planit për ndarje nga paragrafi 2 i këtij neni janë:

- 1) propozim marrëveshja për shoqatën, respektivisht statuti i shoqatave të reja të themeluara;
- 2) lista e bashkëpronarëve, respektivisht të aksionarëve të shoqatës e cila ndahet me ndarje me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar me vlerë nominale të pjesëve, respektivisht të aksioneve të cilat duhet t'i fitojnë në shoqatata e reja të krijuara ku bëhen bashkëpronarë, respektivisht aksionarë; dhe
- 3) listë e të punsuarve të cilët e vazhdojnë marrëdhënien e punës në shoqatat e reja të themeluara.

Obligimi për shpalljen e njoftimit për ndryshimin statutar

Neni 522

(1) Më së voni një muaj para vendosjes së bashkëpronarëve, respektivisht para mbajtjes së mbledhjes të bashkëpronarëve ose kuvendit ku sjellet vendim për pranimin e marrëveshjes, respektivisht të planit për ndarje, organet udhëheqëse të shoqatave të cilat e kanë lidh marrëveshjen ose organi udhëheqës i shoqatës që ndahet me ndarje me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar bashkarisht shpallin në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe më së paku në një gazetë ditore lajmërim për lidhjen e kontratës, respektivisht sjelljen e planit për ndarje. Në lajmerimin duhet t'i shpallin këto të dhëna:

- 1) forma, firma dhe selia e shoqatave që marrin pjesë në të bashkuarit, lidhjes ose ndarjes;
- 2) arsyet, qëllimet, dhe kushtet të të bashkuarit, lidhjes dhe ndarjes;
- 3) vlera e të hyrave dhe të dalave që bartet, respektivisht ndërmirë;
- 4) raportin sipas të cilit kryhet ndërrimi i pjesëve, respektivisht të aksioneve, nëse ka nevojë, edhe lartësia e të të paguarit në të holla, respektivisht të pjesëve ose aksioneve të cilët duhet të fitohen prej masës themelore të zmadhuar të shoqatës që ndërmer dhe të drejtat dhe detyrat që i japin ato;
- 5) të drejtat të cilat u janë pranuar bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve si edhe kushtet e posaçme të cilat i kanë fituar, respektivisht ua japin pjesët, respektivisht aksionet;
- 6) mënyra e ndërmarrjes së pjesëve, respektivisht të aksioneve dhe data prej ku ata u japin të drejtë pjesëmarrjeje në të fituarit e bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve në shoqatën e re të themeluar dhe të gjitha hollësitë të cilat janë me rëndësi për realizimin e asaj të drejte;
- 7) Data ku do të ndalohen të gjitha aktivitetet afariste të shoqatës e cila bashkohet, shoqatave të cilat lidhen, respektivisht shoqata e cila ndahet;
- 8) secili kusht i posaçëm nëse i jepet ndonjërit antar të organit udhëheqës ose të këshillit mbikqyrës, respektivisht kontrolluesit të shoqatave që marin pjesë në të bashkuarit, lidhjes, respektivisht ndarjes, nëse shoqatat kanë organ mbikqyrës; dhe
- 9) kushtet nën të cilat të punsuarve do t'u vazhdohet marrëdhënia e punës në shoqatën e cila ndërmer, në shoqatën e re shfrytëzues dhe në shoqatën e re të themeluar; dhe

(2) Marrëveshja, respektivisht plani për ndarje dhe shtojcat të cilat me pjesët e tyre përbërëse vihen në shqyrtim të gjithë bashkëpronarëve, respektivisht aksionarë në selinë e shoqatave që marin pjesë në të bashkuarit, lidhjes, respektivisht ndarjes. Me shpalljen nga paragrafi 1 i këtij neni ceken koha dhe kushtet e tjera të cilat janë me rëndësi secili bashkëpronar, respektivisht aksionar të mund të vërejë.

(3) Në afatin e paragrafit 1 të këtij neni marrëveshja, respektivisht plani për ndarje dorëzohen deri te regjistri tregtar që të kryejë parashënimin. Pas kryerjes së parashënimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" shpallet se është kryer parashënim në regjistrin tregtar dhe se marrëveshja, respektivisht plani për ndarje janë të lejuara për t'i parë.

(4) Nëse me ligj është vërtetuar obligim për të lajmëruar organin kompetent për qëllimin për kryerjen e ndryshimit statutar, marrëveshja, respektivisht planin për ndarje dorëzohet deri te organi kompetent.

Informimi i kreditorëve

Neni 523

(1) Kreditorët e njohur kërkesat e të cilëve kalojnë 10.000 euro në kundërvlerë denarë lajmërohen me shkrim, veçmas, në vendbanimin, nëse kreditori është person juridik në selinë e tij.

(2) Kreditorët të cilët nuk mundin të kërkojnë pastrim të kërkesave pasi që kërkesat nu kanë mbërri nga shoqatat të cilat kanë marë pjesë në të bashkuarit, lidhjes ose ndarjes, të cilët mendojnë se të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht ndarja do ta rrezikojë pastrimin e kërkesave të tyre, dorzojnë kërkesë për sigurim të kërkesave deri të shoqata e cila bashkohet, shoqatat të cilat lidhen dhe shoqata që ndahet, në afat prej tridhjet ditëve prej ditës së shpalljes të lajmërimit nga neni 522 i këtij ligji. Nëse shoqata e cila bashkohet, shoqatat të cilat lidhen dhe shoqata e cila ndahet nuk i përgjigjen kërkesës së kreditorit në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve prej ditës së dorzimit të kërkesës ose nuk e japin sigurimin e kërkuar, kreditori mundet në tetë ditët e ardhëshme të dorzojë propozim deri të gjyqji për të ndaluar procesin e lidhjes, të bashkuarit, respektivisht ndarjes. Nëse gjyqji konstaton se në procesin për bashkim, lidhje, respektivisht ndarje kreditorit nuk i është përgjigjur kërkesës, respektivisht nuk i është dhënë siguri i kërkuar, me propozim të kreditorit, gjyqji mundet përkohësisht ta ndalojë procedurën, deri sa shoqata e cila bashkohet, shoqatat të cilat lidhen dhe shoqata e cila ndahet nuk i dorzojnë gjyqjit në afatin e caktuar dëshmi se është dhënë siguri për kërkesën e kreditorit.

(3) Kreditorët të cilët në rast të falimentimit kanë të drejtë primare për pastrimin nga masa falimentuese, nuk kanë të drejtë të kërkojnë siguri.

Bilanci i gjendjes para ndryshimit statutar

Neni 524

(1) Shoqata para se të bashkohet, lidhet ose ndahet, përpilon llogari vjetore, përfundimisht me afatin e caktuar në marrëveshjen, respektivisht në planin për ndarje.

(2) Afati nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mundet me qenë më i shkurtë se tre muaj prej ditës së lidhjes së marrëveshjes, respektivisht prej ditës të sjelljes së planit, nëse llogaria vjetore e e vitit të fundit afarist nuk është më e vjetër se gjashtë muaj.

(3) Çmimet e treguara në llogarinë vjetore të shoqatës e cila bashkohet, të shoqatave të cilat lidhen ose të shoqatës e cila ndahet transmetohen dhe tregohen paraprakisht në bilanset e shoqatës e cila ndërmer, shoqata e re shfrytëzues dhe shoqata e re e themeluar.

Revizioni i marrëveshjes, respektivisht planit për ndarje

Neni 525

(1) Marrëveshja, respektivisht plani për ndarje duhet ta kontrollojë një ose më tepër revizorë të autorizuar. Revizorët e autorizuar për secilën shoqatë veçmas i emërojnë organet udhëheqëse të shoqatave që marrin pjesë në të bashkuar, lidhjen, respektivisht ndarjen. Revizorët e autorizuar mundet të kryejnë revizion për të gjitha shoqatat që marrin pjesë në të bashkuar, lidhjen dhe ndarjen nëse revizorët e autorizuar janë të emëruar nga gjyqji me prepozimine tyre të përbashkët.

(2) Raporti për kryerjen e revizionit duhet ta përmbajë mendimin e revizorit se indeksi i ndërrimit të aksioneve, respektivisht të pjesëve është i drejtë dhe i kuptueshëm. Në deklaratën revizorët duhet të cekin:

- 1) cila metodë, respektivisht cilat metoda janë përdorur që të vlerësohet indeksi i propozuar për ndërrim dhe cila metodë është primare;
- 2) çfarë raport i ndërrimit do të ndodh me përdorimin e metodave të ndryshme dhe cila është rëndësia relative e secilës, metodë të cilat janë përdorur gjatë vërtetimit të indeksit për ndarje;
- 3) a është metoda e shfrytëzuar, respektivisht metodat janë adekuate për ndërrimin; dhe
- 4) cilat vështërsi, nëse ka pasur, janë paraqitur gjatë vlerësimit dhe gjatë ekryerjes së revizionit.

(3) Secili prej revizorëve të autorizuar ka të drejtë prej organeve udhëheqëse të kërkojë t'i marrë të gjitha informacionet dhe dokumentat e duhura për revizion dhe, nëse duhet, të zbatoj hulumtim të posaçëm.

(4) Në përgjigjësi të revizorëve të autorizuar aplikohen dispozitat e këtij ligji dhe të rregullave tjera me të cilat rregullohet revizioni.

Raporti për ndryshimin statutar

Neni 526

Organet udhëheqëse që e kanë lidh marrëveshjen, respektivisht e kanë sjell planin për ndarje hartojnë raport me shkresë, në të cilën më hollësisht:

- 1) do t'i arsyetojnë shkaqet, respektivisht qëllimet që duhet të arrihen me të bashkuar, lidhjes dhe ndarjes;
- 2) do t'i arsyetojnë çështjet afariste dhe juridike edhe fillet juridike dhe ekonomike të propozuara në bazë të të cilave do të kryhet të bashkuar, lidhja dhe ndarja;
- 3) Do t'i sqarojnë metodat dhe kriteret më të cilët është caktuar raporti sipas të cilit do të kryhet ndërrimi i pjesëve, respektivisht të aksioneve dhe kriteriumet për ndarjen e tyre;
- 4) do ta arsyetojnë përmbajtjen e edokumentit dhe të propozim akteve për të të bashkuar, lidhjes dhe ndarjes;
- 5) do t'i përshkruajnë vështërsitë që janë paraqitur gjatë procesit për vlerësimin e pronës dhe të obligimeve;
- 6) do t'i prezantojnë depozimet jo në të holla si edhe problemet që kanë dalë gjatë vlerësimit të tyre që kryhet sipas nenit 35 të këtij ligji, dhe do të udhëzohet në raportet sipas të cilave këto depozime jo në të holla janë vlerësuar edhe në menyrën sipas të cilës raportet munden të shifen;
- 7) do t'i arsyetojnë ndryshimet e pronës dhe të obligimeve që klanë ndodhur prej ditës së lidhjes së marrëveshjes, respektivisht të sjelljes së planit për ndarje deri në ditën e vendosjes së bashkëpronarëve, respektivisht të mbajtjes të mbledhjes së bashkëpronarëve ose në kuvendin ku do të vendoset për bashkimin, lidhjen dhe ndarjen; dhe

8) do t'i sqarojnë ndryshimet që janë bërë me marveshjen, respektivisht në planin për ndarje për obligimet e tyre të veprojë sipas të dhënave të revizorit të autorizuar.

Përgatitja për thirrjen e mbledhjes së bashkëpronarëve, respektivisht të kuvendit

Neni 527

(1) Më së paku një muaj para ditës së caktuar për vendosje të bashkëpronarëve, respektivisht për mbajtjen e mbledhjes së bashkëpronarëve ose të kuvendit në të cilën duhet të vendoset për vërtetimin e marrëveshjes respektivisht të planit për ndarje, secila shoqatë e cila merr pjesë në bashkimin, lidhjen dhe ndarjen është e obliguar bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve t'u mundësojë në selinë e shoqatës të njoftohen me dokumentacionin për realizimin e të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht ndarjes, sidomos:

- 1) me marrëveshjen, respektivisht me planin për ndarje, me të gjitha shtojcat e tyre;
- 2) me llogarinë vjetore dhe me raportin vjetor për punën e secilës shoqatë e cila mer pjesë në të bashkuarit, lidhjes, respektivisht ndarjes për tre vjetët e fundit, respektivisht për secilin vit prej egzistimit të shoqatës nëse ajo egziston më pak se tre vjet;
- 3) me llogarinë vjetore e përgaditur në pajtim me nenin 524 të këtij ligji;
- 4) me raportin e përgaditur nga organi udhëheqës për të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht ndarjes;
- 5) me raportin e revizorit të autorizuar; dhe
- 6) me informacione të tjera të rëndësishme dhe lajmërime të cilat janë me rëndësi për vendosje për bashkim, lidhje, respektivisht ndarje.

(2) Llogaritë vjetore nga paragrafi 1, pika 2 të këtij neni formohen në pajtim me rregullat të cilat vlenin në kohën kur janë formuar.

Vendimi për ndryshimin statutar

Neni 528

(1) Marrëveshja, respektivisht plani për ndarje bëhet i plotfuqishëm prej kur do të pranojnë bashkëpronarët, tubimi i bashkëpronarëve, respektivisht kuvendi i shoqatave të cilat marin pjesë në të bashkuarit, të lidhurit dhe ndarjes.

(2) Vendimi për konfirmimin e marveshjes, respektivisht të planit për ndarje sjellet në atë mënyrë me të cilin me këtë ligj, me marveshjen e shoqatës, respektivisht me statutin sjellet vendim për ndryshimin e marveshjes së shoqatës, respektivisht të statutit;

(3) Vendimin për vërtetimin e marveshjes, respektivisht të planit për ndarje nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet si vendim për të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht ndarjes.

(4) Bashkëpronarët, respektivisht tubimi i bashkëpronarëve ose kuvendi njëkohësisht me vendimin për të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht të ndarjes me të ndarë me të ndërmarë dhe me të veçuar me të ndërmarësjellin vendim për ndryshim të kontratës për shoqatën, respektivisht për ndryshim të statutit, ndërsa me vendimin për ndarje me të ndarë me të themeluar dhe me të veçuar me të themeluar sjellin vendim për adaptimin e marveshjes për shoqatën, respektivisht të statutit të shoqatave të reja të themeluara.

(5) Procesverbalin nga mbledhja e bashkëpronarëve, nga tubimi i bashkëpronarëve, respektivisht të kuvendit nga paragrafi 1 i këtij neni e udhëheq noteri Marrëveshja, respektivisht plani për ndarje i bashkangjitet procesverbalit të mbledhjes, nga tubimi i mbajtur i bashkëpronarëve, respektivisht të kuvendit të mbajtur si pjesë përbërëse e tij.

Përgjegjësia për dëmin

Neni 529

(1) Antarët e organit udhëheqës, nëse shoqata ka organ mbikqyrës, antarët e këshillit mbikqyrës, respektivisht kontrolluesi i shoqatës që bashkohet, shoqatave të cilat lidhen dhe shoqata e cila ndahet, janë të obliguar si borxhli solidarë ta kompenzojnë dëmin, e cila me të bashkuarit, më të lidhurit, respektivisht me ndarjen e ndjen shoqata e cila bashkohet, lidhet, respektivisht shoqata e cila ndahet me të ndarë me të marrë ose të veçuarit me të marrë për dëmin nuk përgjigjen ata antarë të organit udhëheqës, nëse shoqata ka organ mbikqyrës, ata anëtarë të këshillit mbikqyrës, respektivisht kontrolluesi të cilët gjatë revizionit të gjendjes së pronës së shoqatës dhe gjatë lidhjes së marrëveshjes, respektivisht gjatë sjelljes të planit për ndarje kanë vepruar me kujdes të rregulluar dhe të ndërgjegjshëm të tregtarit.

(2) Kërkesat për kompenzim të dëmit nga paragrafi 1 i këtij neni si edhe për të gjitha kërkesat e tjera që do të jepen për edhe kundër shoqatës e cila bashkohet, lidhet dhe ndahet llogaritet se ajo shoqatë ende egziston.

(3) Ankesa për kërkesat të themeluara në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni, mundet të dorzohet në afat prej pesë vjetëve prej ditës së shpalljes të rregjistrimit për bashkim, lidhje, respektivisht ndarjes në rregjistrin tregtar.

E drejta për kompenzimin e dëmit

Neni 530

(1) Kërkesat për kompenzim të dëmit dhe kërkesat e tjera nga neni 529 i këtij neni, munden të realizohen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të përkohshëm, i cili me propozim të bashkëpronarit, respektivisht të aksionarit ose të kreditorit të shoqatës e cila është bashkuar, lidhur, respektivisht është ndarë e parashtron gjygi i asaj njësie ku është selia e asaj shoqate.

(2) Përfaqësuesi, duke e cekur qëllimin e parashtrimit të tij, duhet t'i thërrasë bashkëpronarët e përparshëm, respektivisht aksionarët dhe kreditorët e shoqatës e cila bashkohet, respektivisht shoqatave të cilat lidhen ose të shoqatës e cila ndahet, në afat i cili zgjat më pak se tridhjetë ditë, e jo më tepër se gjashtëdhjetë ditë, t'i lajmrojnë kërkesat e tyre nga neni 529 i këtij ligji. thirrja bëhet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe më së paku në një gazetë ditore.

(3) Përfaqësuesi i përkohshëm ka të drejtë në kompenzim të harxhimeve si edhe shpërblim për punën e tij nëse bashkëpronarët, respektivisht aksionarët vetë nuk i caktojnë harxhimet dhe shpërblimet, ato i vërteton gjygi veçmas sipas rrethanave të secilit rast dhe cakton në çfarë madhësie duhet të kompenzohen bashkëpronarët e mëparshëm, aksionarët dhe kreditorët që janë të prekur nga ajo.

Kontrolli gjygjësor i krahasimit për ndërrim

Neni 531

(1) Vendimin për bashkim, vendimin për lidhje dhe vendimin për ndarje me të cilën bashkëpronarët, respektivisht tubimi i bashkëpronarëve, respektivisht kuvendi i ka pranuar marveshja, respektivisht plani për ndarje nuk mundet të mohohet pasi që krahasimi për ndërim të pjesëve (kontributeve), respektivisht të aksioneve është matur shumë poshtë. Nëse krahasimi është matur shumë poshtë, gjygyi mundet, me propozim të bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve, të caktojë të plotsohet pagesa e cila nuk mundet të tejkalojnë 10% nga vlera nominale e pjesëve të dhëna, respektivisht aksioneve.

(2) Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni mundet të dorëzohet në afat prej tridhjetë ditëve prej ditës prej kur bashkëpronari, respektivisht aksionari nuk e ka pranuar krahasimin e ofruar nga paragrafi 1 i këtij neni. Shoqata, në bazë të vendimit të gjygyit, u paguan plotësim të pagesës bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve të cilët posedojnë pjesë (kontribute), respektivisht aksione të krahasuara të klasës dhe gjinisë së njejtë, në çmim të cilin e ka caktuar gjygyi.

Bashkimi, respektivisht ndarja në raste të posaçme

Neni 532

(1) Nëse më së paku 90% nga pjesët, respektivisht aksionet në të cilat është e prezentuar masa themelore e shoqatës e cila bashkohet, respektivisht të shoqatës e cila ndahet me ndarje me të marrë ose me të veçuar me të marrë i mban shoqata e cila ndërmer, nuk duhet pëlqim nga bashkëpronarët, tubimit të bashkëpronarëve, respektivisht të kuvendit të shoqatës e cila ndërmer.

(2) Nëse të gjitha pjesët, respektivisht aksionet e shoqatës e cila bashkohet i përmban shoqata e cila ndërmer në marrëveshjen për bashkim, nuk futen të dhënat për ndërim të pjesëve, respektivisht aksioneve dhe nuk kryhet revizioni dhe miratim të marveshjes nga tubimi i bashkëpronarëve, respektivisht nga kuvendi i shoqatës e cila bashkohet dhe shoqatës e cila ndërmer.

(3) Bashkëpronarët, respektivisht aksionarët e shoqatës e cila ndërmer, pjesët e të cilëve, respektivisht aksionet së bashku kanë vlerën 5% prej masës themelore, mundet të kërkojnë të mbahet tubim i bashkëpronarëve, respektivisht kuvend ku do të vërtetohet të bashkuarit. Në masën themelore nuk hyjnë pjesët e veta, respektivisht aksionet e veta të shoqatës e cila ndërmer si edhe pjesët, respektivisht aksionet të cilat i posedon dikush tjetër, por në logari të shoqatës e cila ndërmer.

(4) Shoqata nga paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni është e obligur t'i shpall kushtet për të bashkuarit, preaktivisht të ndarjes me ndarje me të marrë ose të veçuarit me të marrë më së voni tridhjet ditë para ditës së mbajtjes të tubimit të bashkëpronarëve, respektivisht të kuvendit dhe në këtë afat t'ju mundësoj shqyrtim bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve në dokumnetin të cilët me këtë ligj janë të caktuar për realizimin e të bashkuarit, respektivisht të ndarjes.

(5) Bashkëpronarët, respektivisht aksionarët prej shoqatës e cila bashkohet nga paragrafi 1 i këtij neni të cilët nuk janë pajtuar me të bashkuarit i realizojnë të drejtat në pajtim me dispozitat e kësaj kaptine.

Ndalimet për rritjen e masës themelore

Nnei 533

(1) Gjatë zbatimit të të bashkuarit, respektivisht të ndarjes me të ndarë me të marrë ose të veçuarit me të marrë shoqata e cila ndërmer nuk mundet ta zmadhojë masën themlore në rast:

1) se e posedon pjesën, repektivisht aksionet e shoqatës e cila bashkohet, respektivisht e shoqatës e cila ndahet me të ndarë me të marrë ose me të veçuarit ose ndarje me të marrë;

2) se shoqata e cila bashkohet, respektivisht shoqata e cila ndahet me të ndarë me të marrë ose të veçuarit me të marrë posedon pjesë, respektivisht aksione në shoqatën e cila ndërmer; ose

3) se shoqata e cila bashkohet, respektivisht shoqata e cila ndahet me të ndarë me të marrë ose me të veçuarit me të marrë posedon pjesë, respektivisht aksione të shoqatës e cila ndërmer për të cilat nuk janë të paguara në përgjithsi investimet, të cilat janë duhur të paguhen.

(2) Shoqata e cila ndërmer nuk mundet ta zmadhojë masën kryesore, përderisa egzistojnë ndalesat e pragrafit 1 të këtij neni.

(3) Nëse shoqata e cila ndërmer paguan pagesa në të holla, ata nuk munden të kalojnë 10% prej gjith vlerës nominale të pjesëve të dhëna, respektivisht të aksioneve të dhëna në atë shoqatë.

Zmadhimi i masës themlore për shkak bashkimit, respektivisht ndarjes

Neni 534

(1) Nëse shoqata e cila ndërmer e zmadhon masën themlore për zbatimin e të bashkuarit, respektivisht ndarjes me ndarje me të marrë ose të veçuarit me të marrë, nuk aplikohen dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohet zmadhimi i masës themlore që kanë të bëjnë:

1) me ndalimin që masa themlore të zmadhohet, përderisa investimet e shënuara të paguhen në përgjithsi;

2) me kërkesën që në fletparaqitjen për regjistrim në regjistrin tregtar të vendimit për zmadhimin e masës themlore të ceket se cilat investime nuk janë paguar;

3) me kushtet për rregjistrim të investimeve të reja, respektivisht aksioneve; dhe

4) me të drejtën primare për blerjen e pjesëve, respektivisht aksioneve.

(2) Revizioni duhet të kryhet në rast të zmadhimit të masës themlore me investim jo në të holla dhe kur gjyqji do të konstatojë se vlera e investimit jo në të holla nuk e arin vlerën nominale të pjesëve të dhëna, respektivisht aksioneve si edhe në këtë rast të zmadhuarit të masës themlore në pajtim me dispozitat e këtij ligji për kapital të miratuar.

Të drejtat e bashkëpronarëve, respektivisht të aksionarëve

Neni 535

(1) Bashkëpronarit, respektivisht aksionar i cili është deklaruar se nuk don për pjesën e tij, respektivisht aksione për ndërmarje të pjesëve, respektivisht aksione në shoqatën e cila ndërmer, në shoqatë të re shfrytëzues e cila ka ndodhur me të lidhur, në shoqatë të re të themeluar, shoqata është e obliguar t'ia blejë pjesën, respektivisht aksionet sipas çmimit të vërtetuar në vendimin për të bashkuarit, lidhjes, respektivisht ndarjes.

(2) Nëse bashkëpronari, respektivisht aksionari nuk e pranon çmimin e ofruar nga paragrafi 1 i këtij neni, më së voni në afat prej tridhjetë ditëve prej ditës së refuzimit të ofertës, mundet të dorzoj propozim deri te gjygi për ta vërtetuar vlerën e pjesës, respektivisht të aksioneve. Bashkëpronarët, respektivisht aksionari i humb të gjitha të drejtat prej pjesës, respektivisht prej aksioneve, përveç të drejtës për kompenzim të pjesën e tij, respektivisht aksione.

(3) Gjygi, në bazë të raportit për vlerësim, i përgaditur prej vlerësuesit të autorizuar i cili është i emëruar prej gjygjit me vendim, e cakton vlerën e pjesës së bashkëpronarit, respektivisht të aksioneve të aksionarit. Harxhimet bien në shpinë të shoqatës, nëse vlerësusi konstaton se çmimi i pjesës, respektivisht të aksioneve që e ka caktuar shoqata është e njëjtë ose më e vogël prej asaj të cilën e ka vërtetuar shoqata, harxhimet për vlersimin bien në shpinë të bashkëpronarit, respektivisht të aksionarit i cili e ka dorzuar propozimin. Bashkëpronari, respektivisht aksionari, me propozim mundet të kërkojë kamatë.

(4) Shoqata mundet, në bazë të vendimit të gjygjit, t'u paguaj çmim të zmadhuar të gjithë bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve që posedojnë pjesë, respektivisht aksione prej klasës dhe gjinisë së njëjtë në shumë e cila është paguar në bazë të vendimit të gjygjit nga paragrafi 3 i këtij neni.

(5) Pas plotfuqishmërisë së vendimit të gjygjit nga paragrafi 3 i këtij neni, shoqata e cila është ribashkuar, lidhet, respektivisht ndahet e cakton afatin për ngritjen e pagesës që nuk mundet me qenë më i shkurtë se tridhjet ditë. Pas kalimit të këtij afati të hollat dorëzohen te gjygi, pjesët asgjësihen, ndërsa aksionet shpallen të pavlefshme, për çka informohet Depozituesi qendror i letrave me vlerë. Në bazë të pjesëve të asgjësuar, respektivisht aksioneve të shpallura të pavlefshme mundet të meret shuma e cila është e dorëzuar te gjygi në investim.

(6) Bashkëpronari, respektivisht aksionari prej shoqatës e cila ribashkohet, lidhet, respektivisht ndahet nuk mundet të ket kërkesa të tjera prej pronës së shoqatës e cila ndërmer, respektivisht prej shoqatës së re shfrytëzues as edhe prej shoqatës e cila ndërmer pjesë prej pronës dhe prej obligimeve të shoqatës e ndarë me ndarje me të marrë ose të veçuar me të marrë, repsektivisht prej shoqatës së re të themeluar me ndarje të shoqatës me ndarje me të themeluar ose me të veçuar me të themeluar.

(7) Shoqata e cila ndërmerr, shoqata e re shfrytëzues, respektivisht shoqata e re e themeluar e pronarëve të të bashkuarës, të lidhurës, respektivisht të shoqatës së ndarë, duhet t'ua japë të gjitha të drejtat të cilat i kanë pasur në shoqatën që është bashkuar, në shoqatat të cilat janë lidhur, respektivisht shoqata që është ndarë.

(8) Nëse bashkëpronarët, respektivisht aksionarët prej shoqatës e cila bashkohet, respektivisht shoqatat e lidhura ose shoqata e cila ndahet kanë pasur obligim të kryejnë të paguarit në të holla, gjatë të bashkuarit lidhjes, respektivisht ndarjes mundet të regjistrohet ne regjistrin tregtar prej kur gjyqit do t'i dorëzohet dëshmi se të paguarit në të holla është kryer.

Fletëparaqitja për regjistrim në regjistrin tregtar

Neni 536

(1) Secila shoqatë duhet të dorëzojë fletëparaqitje për regjistrim të të bashkuarit, të lidhjes, respektivisht të ndarjes me të marë ose ndarjes me

të veçuar me të marrë në regjistrin tregtar.

(2) Gjatë dorëzimit të fletparaqitjes, udhëheqësi, respektivisht anëtarët e organit udhëheqës, duhet të japin deklaratë se vendimet për të të bashkuarit për të lidhurit respektivisht për ndarje me të marrë ose ndarje me të veçuar me të marrë nuk janë të mohuara në afatin e caktuar ose se mohimi është i refuzuar me vendim të plotëfuqishëm të gjyqit. Fletparaqitjes për regjistrim në regjistrin tregtar të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht të ndarjes me të marrë ose të veçuarit me të marrë në origjinal, duplikat ose kopje e vërtetuar te noteri, i bashkangjiten:

- 1) marrëveshja;
- 2) ndryshimet e kontratës të shoqatës, respektivisht statutit të shoqatës e cila ndërmer, respektivisht kontratës të shoqatës ose statutit të shoqatës së re shfrytëzues që kanë ndodhur me të lidhurit;
- 3) vendimi për vërtetimin e marrëveshjes;
- 4) procesverbalet prej tubimeve të bashkëpronarëve, respektivisht prej kuvendeve në të cilat janë sjellur vendimet për vërtetimin e marrëveshjes dhe janë miratuar ndryshimet e kontratës për shoqatën, respektivisht të statutit të shoqatave të cilat ndërmarin respektivisht kontrata për shoqatën ose statutin e shoqates së re shfrytëzuese që ndodh me të lidhurit, ku janë të emëruar edhe organet udhëheqëse, respektivisht organi mbikqyrës, nëse shoqata ka organ për mbikqyrje;
- 5) raporti i revizorit të autorizuar;
- 6) raporti për të bashkuarit, të lidhurit respektivisht ndarjes me të marrë ose të veçuarit me të marrë;
- 7) lista e bashkëpronarëve respektivisht e aksionarëve të cilët i ndërmer shoqata që ndërmer, respektivisht shoqata e re shfrytëzuese, e nënshkruar nga ana e udhëheqësit, respektivisht të antarëve të organit udhëheqës;
- 8) pëlqimi prej organit shtetëror, respektivisht prej organit tjetër kompetent, për të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht ndarjes me të marrë ose të veçuarit me të marrë ajo është e caktuar me ligj;
- 9) lista e të punësuarëve të cilët kalojnë në shoqatën e cila ndërmerr ose në shoqatën e re shfrytëzuese dhe
- 10) deklaratata e udhëheqësit respektivisht të anëtarëve të organit udhëheqës të shoqatave që marin pjesë gjatë të të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht në ndarjen me të marrë ose të veçuarit me të marrë sipas nenit 32 të këtij ligji.

(3) Fletëparaqitjes për rregjistrim për ndarje të shoqatës me ndarje me të themeluar dhe të veçuar me të themeluar të shoqatave të reja të themeluara, në origjinal, duplikat ose kopje e vërtetuar te noteri, sipas shtojcave nga pikat 5, 7, 8, 9 edhe 10 nga paragrafi 2 i këtij neni bashkangjiten:

- 1) plani për ndarje;
- 2) vendimi për vërtetimin e planit për ndarje;
- 3) procesverbal nga tubimi i bashkëpronarëve, respektivisht nga kuvendi në të cilin është sjellur vendim për vërtetimin e planit për ndarje dhe është miratuar kontrata për shoqatën, respektivisht statuti i shoqatave që themelohen me ndarjen me të themeluar dhe të veçuarit me të themeluar;
- 4) kontrata për shoqatën respektivisht statuti i shoqatës së re të themeluar që themelohet me ndarjen me të themeluar dhe të veçuarit me të themeluar;
- 5) vendim për zgjedhje të udhëheqësit, antarët e këshillit të drejtorëve, respektivisht të organit mbikqyrës të shoqatave që ndodhin me ndarjen me të themeluar dhe të veçuarit me të themeluar nëse ato nuk janë emruar në statutin, respektivisht në kontratën për shoqatën; dhe
- 6) raporti për ndarjen me të themeluar ose të veçuarit me të themeluar.

(4) Fletëparaqitjes për regjistrim në regjistrin tregtar i dorëzohen për secilën të bashkuar, të lidhur, respektivisht shoqatës së ndarë me ndarje me të marrë ose me ndarje me të veçuar me të marrë dhe llogari vjetore e përgaditur dhe e miratuar, më së shumti gjashtë muaj para dites së dorzimit të fletëparaqitjes për regjistrim.

(5) Pas regjistrimit në regjistrin tregtar, mangësitë e procesit të të bashkuarit, të lidhurit, respektivisht ndarjes nuk ndikojnë në vlefshmërinë e të bashkuarit, respektivisht të ndarjes.

Pasojat juridike gjatë regjistrimit

Neni 537

(1) Pasojat juridike nga të bashkuarit, nga të lidhurit, respektivisht nga ndarja veprojnë njëkohësisht prej ditës së shpalljes të rregjistrimit në regjistrin tregtar të të bashkuarit, të të lidhurit, respektivisht të ndarjes.

(2) Me të bashkuarit, pronësia dhe obligimet e shoqatës e cila bashkohet kalojnë në shoqatë e cila ndërmer. Njëkohësisht me regjistrimin e të bashkuarit në regjistrin tregtar, fshihet edhe shoqata e cila bashkohet. bashkëpronarët, respektivisht aksionarët e shoqatës e cila bashkohet, bëhen bashkëpronarë, respektivisht aksionarë të shoqatës që ndërmerr.

(3) Me të bashkuarit, prona dhe obligimet e shoqatave të cilat bashkohen kalojnë në shoqatën e re shfrytëzuese. Njëkohësisht me rregjistrimin e shoqatës së re shfrytëzuese, fshihen shoqatat të cilat janë bashkuar. Në kontratën për shoqatën, respektivisht në statutin e shoqatës së re shfrytëzuese, duhet të ndërmeren kushtet e caktuara të posaçme, harxhimet për themelimin e depozimeve jo në të holla. Bashkëpronarët, respektivisht aksionarët e shoqatave të cilat janë lidhur, me rregjistrimin e të lidhurit bëhen bashkëpronarë, respektivisht aksionarë të shoqatës së re shfrytëzues.

(4) Me ndarjen e shoqatës me të ndarë me të themeluar dhe me të ndarë me të marrë e gjithë prona dhe obligimet kalojnë në shoqatën e re të themeluar, respektivisht në shoqatën e cila ndërmerr. Njëkohësisht me regjistrimin fshihet shoqata e cila ndahet. Bashkëpronarët, respektivisht aksionarët e shoqatës e cila ndahet me të ndarë me të themeluar dhe të ndarë me të marrë bëhen bashkëpronarë, respektivisht aksionarë të shoqatës së re të themeluar.

(5) Me ndarjen e shoqatës me të veçuar me të themeluar dhe të veçuarit me të marrë pjesë nga prona e tij dhe një pjesë nga obligimet e tij kalojnë në shoqatën e cila themelohet, respektivisht shoqatës e cila ndërmer. Shoqata e cila ndahet nuk pushon. bashkëpronarët respektivisht aksionarët e shoqatës e cila ndahet me të veçuar me të themeluar dhe të veçuarit me të marrë, me marrjen e pjesëve, respektivisht aksioneve në shoqatën e re të themeluar, respektivisht në shoqatën e cila ndërmer, bëhen bashkëpronarë të tyre, respektivisht aksionarë.

(6) Kur me ligj është rregulluar realizimi i disa veprimeve të posaçme në shiqim të bartjes të obligimeve, të drejtave dhe materijaleve nga ana e shoqatës e cila ndërmer, shoqata e re shfrytëzuese dhe shoqata e re e themeluar, bartja e tyre ka veprim ndaj personave të tretë kur për bartjen e këtyre obligimeve, të drejtave dhe materijaleve do të kryhen veprimet e rreguluara. këto veprime shoqata duket t'i kryejë në afat jo më të gjatë se gjashtë muaj.

Bashkimi tejkuftar me shoqëri nga Bashkimi Evropian

Neni 537-a

Fushëveprimi i zbatimit

Dispozitat e këtij kreu zbatohen kur bëhet bashkim tejkuftar i shoqërive aksionare ose i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, të themeluara në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të regjistruara në regjistrin tregtar (shoqëri maqedonase) me shoqëri në të cilat përgjegjësia e bashkëpronareve është e kufizuar, për të cilat zbatohet e drejta e shtetit tjetër anëtar të Bashkimit Evropian dhe kanë regjistruar seli, drejtori qëndrore ose vend kryesor për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në vendin anëtar të Bashkimit Evropian (shoqëri të Bashkimit Evropian).

Neni 537-b

Nocioni

(1) Përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, bashkimi tejklufitar është procedua në të cilën:

1) një ose më shumë shoqëri bashkohen (shoqëri/të e/të cila/t bashkohet/en) me shoqëri tjetër (shoqëria e cila ndërmerr) me transfer të tërë pronës dhe të obligimeve të shoqërisë e cila bashkëngjitet, pa u realizuar likuidimi i saj në shkëmbim me emetimin e pjesëmarrjeve, aksioneve dhe letrave të tjera me vlerë nga kryegjëja themelore e shoqërisë që ndërmerr, të bashkëpronarët e shoqërisë që bashkëngjitet dhe nëse është i mundshëm dallimi në para i cili nuk tejkalon 10% nga vlera nominale, ose në mungesë të vlerës nominale 10% nga vlera e kontabilitetit të pjesëmarrjeve, aksione ose letra të tjera me vlerë të pranuar;

2) dy ose më shumë shoqëri bashkohen pa u realizuar likuidimi, me themelimin e një shoqërie të re konsumator në të cilën kalon prona në tërësi dhe obligimet e shoqërive të cilat bashkohen, në shkëmbim me pjesëmarrjet, aksionet, përkatësisht letrat tjera me vlerë në kryegjëne themelore të shoqërisë së re konsumator dhe nëse është e mundur dallimi në para i cili nuk tejkalon 10% nga vlera nominale, ose në mungesë të vlerës nominale 10% nga vlerat e kontabilitetit të pjesëmarrjeve të zbatuara, aksioneve ose letrave të tjera me vlerë të pranuar dhe

3) bëhet bartje universale e pronës dhe obligimeve të një shoqërie pa u realizuar likuidimi i saj, në shoqëri e cila i ka të gjitha ose më së paku 90% nga të gjitha pjesëmarrjet, aksionet, përkatësisht letrat e saja me vlerë.

(2) Në procedurën për bashkim tejkuftar nga paragrafi (2) i këtij neni, doemos duhet të marrin pjesë së paku një shoqëri maqedonase dhe një shoqëri nga Bashkimi Evropian.

Neni 537-v

Dispozitat plotësuese që kanë të bëjnë me fushëveprimin e zbatimit të dispozitave për bashkim tejkuftar të shoqërive

(1) Dispozitat nga neni 537-b, paragrafi (1) i këtij ligji, zbatohen edhe në rast kur ligji i shtetit anëtar i cili zbatohet në shoqërinë e Bashkimit

Evropian e cila në mënyrë tejkuftare bashkohet me shoqërinë maqedonase, mundëson që pagesa me para në dorë nga neni 537-b, paragrafi (1), pikat 1) dhe 2) të këtij ligji, të jetë më e madhe se 10% nga vlera nominale e pjesëmarrjeve, aksioneve, ose letrave me vlerë nga vlera që e përfaqësonë kapitalin e shoqërisë e cila rezulton nga bashkimi tejkuftar, ose nëse nuk kanë vlerë nominale atëherë më e madhe se 10% nga vlera e tyre e kontabilitetit.

(2) Dispozitat për bashkim tejkuftar të këtij ligji nuk zbatohen për kooperativa.

(3) Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për bashkimet tejkuftare të shoqërive për udhëheqje me fonde investuese, përkatësisht shoqërive të cilat bëjnë bashkim të mjeteve monetare të dedikuara për investime të grumbulluara nga persona juridikë ose fizikë të vendit ose të huaj përmes thirrjes publike ose ofertës private, përkatësisht të cilët punojnë në bazë të shpërndarjes së rrezikut dhe posedojnë pjesëmarrje të cilat me kërkesë të poseduesve përsëri blehen ose paguhet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga aktiva i asaj shoqërie.

Neni 537-g

Kushtet tjera për bashkim tejkuftar

(1) Bashkimi tejkuftar me shoqëri e cila i përket shtetit i cili është anëtar i Bashkimit Evropian, është i mundshëm vetëm nëse me ligjin e shtetit anëtar të Bashkimit Evropian i cili vlen për atë shoqëri, lejohet bashkim tejkuftar sipas formave të shoqërive të cilat bashkohen.

(2) Organi kompetent mund ta kundërshtojë çdo bashkim tejkuftare, nëse ai është në kundërshtim me ligjet dhe rregullat tjera dhe interesit publik të përcaktuar me ligj.

(3) Nëse me ligj dhe me rregull tjetër për ndryshim të caktuar statutor kërkohet mendim paraprak ose leje nga organi kompetent, e njëjta është kusht për t'u zbatuar edhe procedura e bashkimit tejkuftar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 537-d

Propozimi i përbashkët me kushtet për bashkim tejkuftar

(1) Organi udhëheqës i shoqërisë maqedonase që merr pjesë në bashkimin tejkuftar, gjithashtu edhe organet udhëheqëse të shoqërive të tjera të cilat marrin pjesë në bashkimin tejkuftar, miraton propozim të përbashkët me kushte për bashkim tejkuftar (në tekstin e mëlutjeshëm: Propozim me kushte).

(2) Propozimi me kushte nga paragrafi (1) i këtij neni, i përfshin të dhënat në vijim:

1) formën, firmën dhe selinë e regjistruar të shoqërive të cilat marrin pjesë në bashkim dhe të shoqërisë e cila krijohet me bashkimin tejkuftare;

2) raportin sipas të cilit bëhet shkëmbimi i pjesëmarrjeve, aksioneve përkatësisht letrave me vlerë në shoqërinë e cila rezulton nga bashkimi dhe shuma e cila do të paguhet me para në dorë, nëse ky është rast;

3) mënyrën e shpërndarjes së pjesëmarrjeve, aksioneve përkatësisht letrave me vlerë të cilat e përfaqësojnë kryegjënë themeloret të shoqërisë

e cila rezulton nga bashkimi tejkufitar;

4) pasojat nga bashkimi tejkufitar për të punësuarit;

5) datën prej kur poseduesit e pjesëmarrjeve, letrave me vlerë ose aksioneve të cilat e përbëjnë kryegjënë themelore të shoqërisë e cila rezulton nga bashkimi tejkufitare, do të mund të realizojnë të drejtën e pjesëmarrjes në fitim duke i përfshirë edhe të gjitha rrethanat e posaçme të cilat janë me rëndësi për realizimin e kësaj të drejte;

6) datën prej kur transaksionet e shoqërive të cilat marrin pjesë në bashkim llogariten për qëllime të kontabilitetit, si transaksione të shoqërisë e cila rezulton nga bashkimi tejkufitar;

7) të drejtat ose kufizimet të cilat rezultojnë nga aksionet ose letrat tjera me vlerë në shoqërinë e cila rezulton nga bashkimi tejkufitar të cilat duhet t'u shpërndahen poseduesve të aksioneve ose të letrave tjera me vlerë në shoqërinë e cila bashkëngjitet, përkatësisht bashkohet, ndërsa të cilat japin të drejta të veçanta, imponojnë kufizime ose parashohin masa të tjera të cilat i prekin të njëjtit;

8) çdo përshtatshmëri të veçantë e cila u jepet revizorëve të cilët e shqyrtojnë propozimin me kushtet për bashkim tejkufitar, anëtarit të organit udhëheqës ose organit të mbikëqyrjes, përkatësisht kontrollorit të shoqërive të cilat marrin pjesë në bashkim;

9) statutin përkatësisht marrëveshjen e shoqërisë e cila rezulton nga bashkimi tejkufitare;

10) informatën për procedurat në pajtim me të cilat të punësuarit do të marrin pjesë në udhëheqjen e shoqërisë;

11) informatën për vlerësimin e pronës dhe obligimeve të cilat transferohen në shoqërinë e cila rezulton nga bashkimi tejkufitare dhe

12) datat e llogarive të cilat janë shfrytëzuar për përgatitjen e propozimit me kushte për bashkim tejkufitar në secilën nga shoqëritë të cilat bashkohen.

(3) Propozimi me kushtet krahas të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të përmbajë edhe disa nga të dhënat e përcaktuara me nenin 520, paragrafi (2) i këtij ligji.

(4) Në rast të bashkimit tejkufitar me shoqëri në të cilën të gjitha aksionet i ka shoqëria e cila ndërmerr, propozimi me kushtet është e domosdoshme që t'i përmbajë të dhënat nga paragrafi (2), pikat 2, 3 dhe 5 të këtij neni.

Neni 537-gj

Publikimi i propozimit me kushtet për bashkim tejkufitar

(1) Propozimi me kushtet e shoqërisë maqedonase, publikohen në internet faqen zyrtare të Regjistrir Qendror, në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb faqen e shoqërisë nëse ka të atillë, më së voni një muaj para ditës së mbledhjes të këshillit të bashkëpronarëve, përkatësisht të seancës së kuvendit të shoqërisë në të cilat do të vendoset nëse do të pranohet ose refuzohet propozimi me kushtet.

(2) Krahas propozimit me kushte, shoqëria nga paragrafi (1) i këtij neni, obligohet që t'i publikojë edhe të dhënat në vijim:

1) formën, emrin dhe selinë e regjistruar të çdo shoqërie e cila merr pjesë në bashkim;

2) regjistrin në të cilin është regjistruar secila nga shoqëritë të cilat bashkohen dhe numri i regjistrimit të regjistrir tyre dhe

3) për çdo shoqëri e cila merr pjesë në bashkim publikohen kushtet sipas të cilave bashkëpronarët pakicë i realizojnë të drejtat e veta, plotësimi i

obligimeve ndaj kreditorëve dhe adresa ku mund të merret informatë e plotë dhe falas për të njëjtën.

(3) Regjistri Qendror i lëshon vërtetim shoqërisë se është bërë publikimi në ueb faqen e tij në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni. Harxhimet për publikim i bart shoqëria dhe ato nuk mund të jenë më të larta se harxhimet administrative të Regjistrat Qendror për publikimin e të njëjtave.

Neni 537-e

Raporti për bashkim tejkufitar i organit udhëheqës

(1) Organi udhëheqës i shoqërisë maqedonase e cila bashkohet tejkufirit, krahas propozimit me kushtet përpilon edhe raport për bashkim tejkufitar në të cilin sqarohen dhe arsyetohen aspektet juridike dhe ekonomike të bashkimit tejkufitar dhe sqarohen pasojat dhe ndikimi i atij bashkimi ndaj bashkëpronarëve, kreditorëve dhe të punësuarve.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni vihet në shqyrtim të bashkëpronarëve dhe të punësuarve personalisht ose të përfaqësuesve të tyre nëse i ka, dhe publikohet në internet faqen e shoqërisë nëse ka të atillë, në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj para datës së mbajtjes së mbledhjes së këshillit të bashkëpronarëve përkatësisht mbajtjes së seancës së kuvendit të shoqërisë, në të cilën do të vendoset për pranimin ose refuzimin e propozimit me kushtet.

(3) Nëse shoqëria nga paragrafi (1) i këtij neni, gjatë kohës derisa zgjat afati nga paragrafi (2) i këtij neni merr mendim nga përfaqësuesit e të punësuarve të vet ose kur nuk ka të atillë mendim nga ndonjë i punësuar, me raportit do t'i parashtrojë edhe ato mendime.

Neni 537-zh

Raport i revizorit të autorizuar për propozim me kushtet

(1) Propozimi me kushtet detyrimisht kontrollohet nga një ose më shumë revizorë të autorizuar i/të cili/ët për atë përgatit/in raport. Revizorët e autorizuar emërohen nga organi i mbikëqyrjes i shoqërisë maqedonase e cila merr pjesë në bashkimin tejkufitar.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, me propozim ose në bazë të vendimit të përbashkët nga organet drejtuese të të gjitha shoqërive të cilat marrin pjesë në bashkim, gjykata mund të emërojë revizor/ë i/të cili/ët do t'i bëj/në revizion propozimit me kushtet të të gjitha shoqëritë të cilat bashkohen në mënyrë tejkufitare. Organet e udhëheqjes të secilët nga shoqëritë që marrin pjesë në bashkimin tejkufitar mund të emërojnë një ose më shumë revizorë të përbashkët ose persona të tjerë profesional në pajtim me ligjet e ndonjërit prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në të cilin bën pjesë ndonjëra nga shoqëritë, të cilat do t'i shqyrtojnë propozimet me kushte të secilës nga shoqëritë dhe do të përgatisin një raport përmbljedhës për të gjitha shoqëritë.

(3) Analizën e propozimit me kushtet nuk është e domosdoshme ta kontrolloj/në revizori/ë nëse ashtu vendosin të gjithë bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët në secilën nga shoqëritë që marrin pjesë në bashkimin tejkufitar.

(4) Raporti për revizionin e kryer të propozimit me kushtet, doemos duhet ta përmbajë mendimin e revizorëve për atë se a është e drejtë dhe e arsyeshme raporti i aksioneve përkatësisht pjesëmarrjeve. Në deklaratë revizorët doemos duhet të theksojnë:

1) çfarë metode, përkatësisht metoda janë përdorur për ta vlerësuar raportin e propozuar në shkëmbimin e aksioneve, përkatësisht pjesëmarrjeve;

2) nëse metoda e shfrytëzuar, përkatësisht metodat janë adekuate për shkëmbim dhe çfarë raporti i shkëmbimit do të ishte krijuar me përdorimin e metodave të ndryshme dhe cila është vlefshmëria relative e secilës nga metodat të cilat janë shfrytëzuar gjatë përcaktimit të raportit të shkëmbimit dhe

3) cilat rrethana vështirësuese, nëse ka pasur, janë paraqitur gjatë vlerësimit dhe gjatë realizimit të revizionit.

(5) Secili nga revizorët e autorizuar ka të drejtë që të kërkojë nga organet udhëheqëse, që t'i dorëzojnë informata dhe dokumente të nevojshme për revizionin e propozimit me kushtet.

(6) Raportin nga paragrafi (4) i këtij neni, revizori ia dorëzon shoqërisë e cila e vë në shqyrtim të bashkëpronarëve dhe të punësuarve personalisht, ose të përfaqësuesve të tyre nëse ka, në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj para datës së mbajtjes së mbledhjes së Këshillit të Bashkëpronarëve përkatësisht mbajtjes së seancës së Kuvendit të Shoqërisë në të cilën do të vendoset për pranimin ose refuzimin e propozimit me kushtet.

Neni 537-z

Marrja e vendimit për lejim të propozimit me kushtet

(1) Në seancën e Kuvendit të Shoqërisë, përkatësisht të mbledhjes së tubimit të bashkëpronarëve të thirrur në mënyrë siç është e përcaktuar me këtë ligj, pasi që do ta shqyrtojnë raportin nga neni 537-e dhe raportin nga neni 537-zh të këtij ligji, aksionarët, përkatësisht bashkëpronarët marrin vendim për miratim ose refuzim të propozimit me kushtet për bashkim tejkufitar.

(2) Propozimi me kushtet bëhen të plotfuqishme pasi që tubimi i bashkëpronarëve, përkatësisht kuvendi i të gjithë shoqërive që marrin pjesë në bashkimin tejkufitar do të marrë vendim për bashkimin e tyre.

(3) Vendimi nga paragrafi (2) i këtij neni për miratim të propozimit me kushtet merret me shumicën e cila është e nevojshme për vendim të ndryshimit të marrëveshjes për shoqërinë, përkatësisht statutin e shoqërisë në pajtim me këtë ligj, me marrëveshjen përkatësisht statutin e shoqërisë.

(4) Vendimi nga paragrafi (2) i këtij neni, konsiderohet si vendim për bashkim tejkufitar.

(5) Bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët bashkë me vendimin për bashkim tejkufitar nga paragrafi (2) i këtij neni, njëkohësisht marrin edhe vendim për ndryshim të marrëveshjes për shoqërinë, përkatësisht për ndryshimin e statudit, përkatësisht vendim për miratimin e marrëveshjes përkatësisht statudit për shoqërinë e cila rezulton nga bashkimi tejkufitar.

(6) Në mbledhjen e tubimit të bashkëpronarëve, përkatësisht në seancën e kuvendit në të cilën është marrë vendimi nga paragrafi (2) i këtij neni, mbahet procesverbal nga ana e noterit i cili pas mbarimit të mbledhjes

përkatësisht seancës e vërteton procesverbalin dhe vendimin nga paragrafi (2) i këtij neni.

(7) Lejimi i bashkimit tejkufitar në mbledhjen e tubimit të bashkëpronarëve, përkatësisht në seancën e kuvendit nuk është i nevojshëm në shoqërinë e cila ndërmerr në bashkimin tejkufitar nëse janë plotësuar kushtet në vijim:

1) shoqëria e cila ndërmerr e ka kryer publikimin në pajtim me nenin 537-d të këtij ligji së paku një muaj para datës në të cilën është dashur të mbahet mbledhja e Këshillit të Bashkëpronarëve, përkatësisht seanca e Kuvendit të Shoqërisë e cila bashkohet dhe e cila duhet të vendosë për pranimin e propozimit me kushtet për bashkim tejkufitar dhe

2) së paku një muaj para datës nga pika 1 e këtij paragrafi, të gjithë bashkëpronarëve në shoqëritë të cilat bashkohen u është mundësuar t'i shqyrtojnë dokumentet në vijim:

- propozimin me kushtet e bashkimit tejkufitare,
- llogaritë vjetore dhe raportet financiare vjetore të shoqërive, të cilat bëjnë bashkim tejkufitar për tre vitet e fundit,
- llogarinë vjetore të shoqërisë duke e përfshirë afatin i cili është përcaktuar në propozimin me kushtet, por i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tre muaj nga dita e miratimit të propozimit me kushtet në rast kur llogaria vjetore për vitin e fundit afarist nuk është më e vjetër se gjashtë muaj dhe
- raportin nga neni 537-e dhe raportin nga neni 537-zh të këtij ligji.

(8) Pas marrjes së vendimit për lejim të propozimit me kushte për bashkim tejkufitar, shoqëria tregtare e cila bashkohet, Regjistrit Qendror i parashtron kërkesë për lëshim të vërtetimit për parabashkim të shoqërisë tregtare dhe me kërkesë do t'i paraqesë të gjitha aktet dhe dokumentet me informatën për veprimet e ndërmarra të cilat i paraprijnë bashkimit.

(9) Regjistri Qendror e lëshon vërtetimin nga paragrafi (8) i këtij neni, në afat prej tre ditësh nga dita kur është pranuar dokumentacioni i kompletuar së bashku me kërkesën.

(10) Në rast kur ligji i vendit anëtar të Bashkimit Evropian, i cili zbatohet në shoqërinë e cila bën bashkim tejkufitar me shoqëri maqedonase nuk ka të përcaktuar procedurë për mbikëqyrje dhe ndryshim të raportit për shkëmbim të aksioneve, pjesëmarrjeve ose letrave të tjera me vlerë, ose nuk ka përcaktuar procedurë për kompensim të aksionarëve pakicë përkatësisht bashkëpronarëve, të cilët janë deklaruar se nuk dëshirojnë që për aksionet ose pjesëmarrjet e tyre në shoqëritë të cilat bashkohen tejkufirit të ndërmarrin aksione, pjesëmarrje dhe letra të tjera me vlerë në shoqërinë e cila ndërmerr, përkatësisht në shoqërinë e re shfrytëzues, dispozitat e nenit 531 ose të nenit 535 të këtij ligji, do të zbatohen në shoqërinë maqedonase e cila ndërmerr, përkatësisht e cila bëhet shoqëri e re shfrytëzuese me bashkim tejkufitar, vetëm nëse shoqëritë tjera të cilat bashkohen me të, gjatë marrjes së vendimit për bashkim tejkufitar nga paragrafi (2) i këtij neni, pa hamendje janë pajtuar me mundësinë që aksionarët, përkatësisht bashkëpronarët në shoqërinë maqedonase të ngrejnë procedurë para gjykatës, në pajtim me dispozitat e nenit 531 ose nenit 535 të këtij ligji.

(11) Në rast kur i është parashtruar propozim gjykatës në pajtim me nenin 531 ose nenin 535 të këtij ligji, Regjistri Qendror mund ta lëshojë vërtetimin për parabashkim me vërejtje se procedura për realizimin e të drejtave nga neni 531 ose neni 535 të këtij ligji, është në vijim. Vendimi i cili do të merret në procedurë për zbatim të nenit 531 ose nenit 535 të këtij ligji, është i obligueshëm për shoqërinë e cila do të rezultojë nga bashkimi tejkufitar, si dhe për të gjithë bashkëpronarët e saj.

(12) Për të drejtat e bashkëpronarëve, përkatësisht aksionarëve dhe të raportit për shkëmbim të pjesëmarrjeve, aksioneve ose letrave të tjera me vlerë, zbatohen dispozitat e nenit 531 ose të nenit 535 të këtij ligji.

Neni 537-x

Përcaktimi gjyqësor i ligjshmërisë së bashkimit tejkufitar

(1) Gjykata e përcakton ligjshmërinë e bashkimit tejkufitar të shoqërive, në pajtim me dispozitat e këtij ligji në procedurë urgjente.

(2) Organi udhëheqës i shoqërisë maqedonase i parashtroi kërkesë për ligjshmërinë e bashkimit tejkufitar, gjykatës kompetente sipas vendit të regjistrimit të selisë së saj në afat prej gjashtë muajsh nga dita e lëshimit të vërtetimit nga neni 537-z paragrafi (9) i këtij ligji.

(3) Krahës kërkesës dhe vërtetimit nga paragrafi (2) i këtij neni, organi udhëheqës i shoqërisë maqedonase, gjykatës ia dorëzon edhe propozimin me kushtet, raportin nga neni 537-e, raportin nga neni 537-zh përveç kur i atillë, në pajtim me nenin 537-zh paragrafi (3) i këtij ligji, nuk është përgatitur, vërtetimi nga neni 537-gj paragrafi (3), procesverbali nga neni 537-z paragrafi (6), vërtetimi për parabashkim nga neni 537-z paragrafi (9) i këtij ligji, si dhe dokumente tjera me rëndësi për bashkimin tejkufitar, të cilat me kërkesë të gjykatës duhet t'i dorëzohen nga shoqëria.

(4) Gjykata pas shqyrtimit të veprimeve dhe dokumenteve të ndërmarra nga paragrafi (3) i këtij neni, merr vendim me të cilin përcakton se veprimet për bashkim tejkufitar të shoqërisë nga paragrafi (1) i këtij neni, janë zbatuar në mënyrë ligjore dhe se propozimi me kushtet janë miratuar nën kushte të njëjta në të gjitha shoqëritë.

Neni 537-i

Regjistrimi në regjistrin tregtar të shoqërisë nga bashkimi tejkufitar i realizuar

(1) Organi udhëheqës në shoqërinë e cila pas realizimit të bashkimit tejkufitar do të ketë seli në Republikën e Maqedonisë, i parashtroi fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar Regjistrin Qendror në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Ligjit për sistem njësportel dhe për udhëheqjen e regjistrin tregtar dhe regjistrin të personave të tjerë juridikë dhe rregullat për sistem njësportel.

(2) Regjistri Qendror lëshon aktvendim për regjistrim në bazë të fletëparaqitjes së dorëzuar nga paragrafi (1) i këtij neni, pasi që vendimi i gjykatës nga neni 537-x paragrafi (4) i këtij ligji, është bërë i plotfuqishëm.

(3) Së bashku me fletëparaqitjen, organi udhëheqës i deponon edhe dokumentet në vijim:

- 1) kopjen e propozimit me kushte nga neni 537-d të këtij ligji;
- 2) raportin nga neni 537-e paragrafi (1) i këtij ligji;
- 3) raportin nga neni 537-zh, paragrafi (1) i këtij ligji përveç kur i atillë nuk kërkohet në pajtim me nenin 537-zh, paragrafi (3);
- 4) procesverbalin nga neni 537-z, paragrafi (6) i këtij ligji;
- 5) aktvendimin e gjykatës nga neni 537-x paragrafi (4) i këtij ligji;
- 6) marrëveshjen për shoqërinë, përkatësisht statutin dhe ku ky është rast

dhe kopje nga ndryshimi i marrëveshjes për shoqërinë, përkatësisht ndryshimi i statutit dhe nga vendimi për miratimin e tyre në pajtim me 537-z, paragrafi (5) i këtij ligji, me tekst të pastruar të marrëveshjes, përkatësisht statutit të shoqërisë;

7) listën e të punësuarve të cilët kalojnë në shoqërinë që ndërmerr ose në shoqërinë e re shfrytëzuese;

8) lejen nga organi shtetëror, përkatësisht nga organi tjetër kompetent nëse kjo është përcaktuar me ligj në pajtim me nenin 537-g paragrafi (3) i këtij ligji;

9) deklaratën e udhëheqësit, përkatësisht anëtarëve të organeve udhëheqëse të shoqërisë sipas nenit 32, paragrafi (3) i këtij ligji dhe

10) vendimin për zgjedhje të udhëheqësit, anëtarëve të organit udhëheqës dhe anëtarëve të organit mbikëqyrës kur nuk janë të emëruar me statutin, përkatësisht marrëveshjen për shoqërinë.

(4) Të gjitha pasojat juridike nga bashkimi tejkufitare, krijohen nga momenti kur Regjistri Qendror do ta lëshojë aktvendimin për regjistrim nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Regjistri Qendror gjatë lëshimit të aktvendimit për regjistrim nga paragrafi (2) i këtij neni, e shlyen nga regjistri shoqërinë maqedonase e cila do të pushojë të ekzistojë për shkak të bashkëngjitjes së saj, përkatësisht bashkimit me shoqërinë e cila rezulton nga bashkimi tejkufitar.

(6) Shoqëria e cila ka rezultuar nga bashkimi tejkufitar dhe është regjistruar në regjistrin tregtar në pajtim me dispozitat e këtij neni, nuk mund të shpallet e pavlefshme. Pas regjistrimit në regjistrin tregtar, mangësitë në procedurën e bashkimit tejkufitar nuk ndikojnë në plotfuqimshmërinë e atij bashkimi, ndërsa të njëjtat mund t'i paraqiten organeve kompetente, në pajtim me dispozitat nga nenet 529, 530, 531 dhe 535 të këtij ligji.

Neni 537-j

Regjistrimi në regjistër

Regjistri Qendror menjëherë e informon regjistrin e vendit anëtar të Bashkimit Evropian ku janë të regjistruara shoqëritë të cilat bashkohen, për çdo regjistrim të shoqërisë e cila rezulton me bashkimin tejkufitar, për shkak të zbatimit të shlyrjes të regjistrimit të vjetër në ato regjistra.

Neni 537-k

Pasojat nga bashkimi tejkufitar

(1) Bashkimi tejkufitar nga neni 537-b, paragrafi (1), pikat 1 dhe 3 të këtij ligji, i ka pasojat juridike në vijim, pas subjektivitetit juridik të shoqërive të cilat kanë marrë pjesë në atë bashkim nga momenti kur Regjistri Qendror do ta lëshojë aktvendimin për regjistrim nga neni 537-i, paragrafi (2) i këtij ligji:

1) tërë prona, të drejtat dhe obligimet e shoqërisë së bashkuar transferohen në shoqërinë e cila ndërmerr;

2) bashkpronarët, përkatësisht aksionarët e shoqërisë e cila bashkohet bëhen aksionarë, përkatësisht bashkëpronarë në shoqërinë e cila ndërmerr dhe

3) shoqëria e bashkuar pushon të ekzistojë.

(2) Bashkimi tejkufitar nga neni 537-b, paragrafi (1), pika 2 e këtij ligji, i ka pasojat juridike në vijim pas subjektivitetit juridik të shoqërive të cilat

kanë marrë pjesë në atë bashkim, nga momenti kur Regjistri Qendror do ta lëshojë aktvendimin për regjistrim nga neni 537-i, paragrafi (2) i këtij ligji:

- 1) prona, të drejtat dhe obligimet e shoqërive të cilat bashkohen i transferohen shoqërisë së re shfrytëzues;
- 2) bashkpronarët, përkatësisht aksionarët e shoqërive të cilat bashkangjiten bëhen aksionarë, përkatësisht bashkëpronarë në shoqërinë e re shfrytëzues dhe
- 3) shoqëritë të cilat bashkohen pushojnë të ekzistojnë.

(3) Të drejtat dhe obligimet të cilat i kanë shoqëritë të cilat marrin pjesë në bashkime tejkufitare dhe të cilat janë krijuar në bazë të marrëveshjeve ekzistuese për punë, ose marrëdhënieve të punës të cilat janë themeluar dhe ekzistojnë deri në momentin e lëshimit të aktvendimit për regjistrim nga neni 537-i paragrafi (2) i këtij ligji, transferohen në shoqërine e cila ka rezultuar nga bashkimi tejkufitar.

(4) Aksionet e shoqërisë e cila ndërmerr nuk mund të shkëmbehen me aksionet e shoqërisë e cila bashkangjitet, kur ato i posedon shoqëria e cila ndërmerr ose cildo person tjetër i cili paraqitet në emër të vet, por në llogari të shoqërisë e cila ndërmerr.

Neni 537-II

Kushtet e veçanta te bashkimi tejkufitar

(1) Gjatë bashkimit tejkufitar kur shoqëria e cila ndërmerr njëkohësisht i posedon të gjitha aksionet dhe letrat e tjera me vlerë, të cilat i japin të drejtë vote në kuvendin e shoqërisë e cila i bashkëngjitet asaj, dispozitat nga nenet 537-d, paragrafi (2), pikat 2, 3 dhe 6, 537-zh dhe 537-k, paragrafi (1), pika 2 të këtij ligji, nuk zbatohen.

(2) Dispozitat nga neni 537-z, paragrafi (1) i këtij ligji, nuk do të zbatohet për shoqërinë/të e/të cila/t bashkëngjitet/en nëse shoqëria e cila ndërmerr njëkohësisht i posedon të gjitha aksionet dhe letrat e tjera me vlerë, të cilat japin të drejtë vote në kuvendin e asaj/atyreshoqërie/ve.

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Likuidimi i shoqërisë

Neni 538

(1) Nëse nuk hapet procedura falimentuese ndaj shoqërisë, pas marrjes së vendimit për shuarjen e shoqërisë zbatohet likuidimi.

(2) Nëse nga dispozitat e këtij ligji ose qëllimi i likuidimit nuk rezulton diçka tjetër, deri në mbarimin e likuidimit zbatohen dispozitat e këtij ligji që vlen për shoqëritë që nuk janë shuar.

Likuiduesit

Neni 539

(1) Likuidimin e shoqërisë tregtare publike e zbatojnë të gjithë bashkëshoqëruesit si likuidues, ndërsa në shoqërinë komanduese dhe në

shoqërinë komanduese me aksione të gjithë komplementarët, nëse me marrëveshje bashkëshoqëruesit nuk ia kanë besuar bashkëshoqëruesve të caktuar. Dy apo më tepër trashëgimtarë të bashkëshoqëruar të vdekur janë të detyruar të caktojnë përfaqësues të përbashkët.

(2) Likuidimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërisë aksionare e zbatojnë anëtarët e organit për menaxhim, përkatësisht drejtuesit e shoqërisë, në cilësi të likuiduesve.

(3) Likuiduesit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, mundën në çdo kohë, të revokohen nga ana e bashkëpronarëve, respektivisht nga tubimi i bashkëpronarëve ose nga kuvendi i shoqërisë.

Likuiduesit e caktuar nga gjyqi

Neni 540

(1) Nëse bashkëpronarët, respektivisht aksionarët nuk kanë caktuar likuidues dhe nëse me këtë ligj përcaktohet se gjyqi zbaton likuidimin e shoqërisë sipas ligjit, gjyqi e cakton likuiduesin.

(2) Me propozim të bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve pjesa e përbashkët e të cilëve, respektivisht aksionet janë sëpaku 20% nga kryegjëja bazë, nëse ka arsye me rëndësi dhe nëse propozuesit i bëjnë të besueshme shkaqet me rëndësi, gjyqi mund të caktojë likuiduesit nga lista e personave të propozuar nga ana e bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve.

(3) Likuiduesit, të caktuar nga ana e gjyqit kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve dhe shpërblim për punën e tyre si likuidues. Nëse nuk pajtohen likuiduesit e caktuar nga gjyqi, gjyqi i përcakton kompensimet dhe shpërblimet.

Regjistrimi në regjistrin tregtar

Neni 541

(1) Likuiduesit e parë dhe autorizimet e tyre paraqiten për regjistrim në regjistrin tregtar. Çdo ndryshim për regjistrim në regjistrin tregtar e paraqesin vet likuiduesit.

(2) Fletëparaqitja për regjistrimin e likuiduesit si dhe çdo ndryshim për shkak të regjistrimit në regjistrin tregtar që e paraqesin vete likuiduesit mund të parashtrohet vetëm në forme elektronike nepermjet sistemit një sportel.

(3) Caktimi dhe shkarkimi i likuiduesve nga ana e gjyqit regjistrohen në regjistrin tregtar me detyrë zyrtare.

(4) Likuiduesit e paraqesin nënshkrimin e vet të verifikuar te noteri, në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, nëse këtë nuk e kanë bërë, si anëtarë të organit të administrimit ose si administrues.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni likuiduesit mund ta dërgojnë nënshkrimin e vet si shtojcë në formë elektronike nëpërmjet sistemit njësportel nëse është nënshkruar me nënshkrim elektronik pa e verifikuar atë te noteri.

Të drejtat dhe obligimet e likuiduesve

Neni 542

(1) Likuiduesit janë të obliguar t'i mbarojnë punët që janë në vijim, t'i arkëtojnë kërkesat e shoqërisë, ta shndërrojnë në monetë pronën tjetër dhe t'i përmbushin obligimet ndaj kreditorëve. Nëse këtë e kërkon likuidimi, ata mund të kontraktjnë punë të reja të shoqërisë në likuidim.

(2) Likuiduesit munden, në pajtim me bashkëpronarët, respektivisht aksionarët dhe kreditorët, të tjetërsojnë objekte të caktuara nga prona likuiduese të aksionarëve të veçantë dhe të bashkëpronarëve, nëse me këtë nuk cenohen të drejtat e bashkëpronarëve të tjerë, të aksionarëve dhe kreditorëve.

(3) Likuiduesit, në kuadër të fushëveprimit të vet, i kanë të drejtat dhe obligimet e organit të administrimit. Nëse shoqëria ka organ mbikëqyrës, likuiduesit janë në mbikëqyrjen e tij.

Përgjegjësia e likuiduesit

Neni 542-a

(1) Likuiduesi është përgjegjës me tërë pronën e vet për dëmin, të cilën do t'ua shkaktojë kreditorëve gjatë procedurës për likuidim. Nëse janë të emëruar më tepër likuidues për dëmin e shkaktuar ata përgjigjen në mënyrë solidare. Likuiduesi nuk do të përgjigjet për dëmin kur kreditorit nuk i është paguar kërkesa të cilën e ka paraqitur pas skadimit të afatit për paraqitjen e kërkesave nga neni 544 të këtij ligji, ndërsa për atë likuiduesi nuk e ka ditur dhe as që ka mundur të di.

(2) Për dëmin të cilin likuiduesi u ka shkaktuar aksionarëve ose bashkëshoqëruesve zbatohen dispozitat e përgjegjësisë për dëmin.

(3) Kërkesa për kompensim të dëmit deri në gjykatë kundër personit i cili ka qenë likuidues, mund të parashtrohet në afat prej një viti pas shlyerjes së shoqërisë nga regjistri tregtar.

(4) Veprimet juridike të cilat janë ndërmarrë në procedurën e likuidimit nuk mund të kontestohen pas shlyerjes së shoqërisë tregtare nga regjistri tregtar.

Përfaqësimi i shoqërisë në likuidim

Neni 543

(1) Likuiduesit e përfaqësojnë shoqërinë.

(2) Nëse caktohen më shumë likuidues, ata shoqërinë e përfaqësojnë kolektivisht, përveç nëse me marrëveshjen për shoqërinë, respektivisht statutin nuk është përcaktuar ndryshe. Nëse ekziston obligimi për dhënien e deklaratës nga personat e tretë ndaj shoqërisë, mjafton ajo të jepet para njërit nga likuiduesit.

(3) Likuiduesit e autorizuar për përfaqësim kolektiv mund të autorizojnë likuiduesin ose likuidues të veçantë për marrjen e punëve të caktuara ose lloje të punëve të caktuara.

(4) Likuiduesi individual mund të autorizojë persona të veçantë për marrjen e punëve të caktuara ose lloje të punëve të caktuara.

(5) Autorizimi për përfaqësim nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, nuk mund të kufizohet.

(6) Likuiduesit nënshkruhen në mënyrë që firmës së shoqërisë i bashkangjesin shtesën "në likuidim".

Shpallja e likuidimit

Neni 544

Likuiduesi, pas regjistrimit në regjistrin tregtar, pa prolongim dhe në interval jo më të shkurtër se shtatë ditë, ndërsa jo më gjatë se 15 ditë nga regjistrimi në regjistrin tregtar, shpall se shoqëria është në likuidim. Shpallja bëhet në ueb faqen e Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë. Me shpalljen thirren kreditorët që t'i paraqesin kërkesat në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes në ueb faqen e Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë. Kreditorët e njohur njoftohen veç e veç dhe në formë të shkruar për likuidimin.

Bilanci për hapjen e procedurës për likuidim

Neni 545

(1) Likuiduesi përpilon bilancin e gjendjes, sipas gjendjes në ditën e fillimit të hapjes së procedurës për likuidim (bilanci fillestar për hapjen e procedurës për likuidim) dhe raportin në të cilin sqaroret bilanci, si dhe raportin për punën e shoqërisë gjatë vitit për të cilin përgatitet llogaria vjetore.

(2) Bashkëpronarët, tubimi i bashkëpronarëve dhe kuvendi i shoqërisë, vendosin për bilancin fillestar, llogarinë vjetore dhe raportin e punës së shoqërisë, për lejimin e punës së likuiduesit.

Shndërrimi në para i pronës së shoqërisë

Neni 545-a

Mënyrën e shndërrimit në para të pronës së shoqërisë në likuidim e përcakton ministri i Ekonomisë.

Ndërprerja e procedurës për likuidim dhe paraqitja e propozimit për hapjen e procedurës për falimentim

Neni 545-b

Nëse likuiduesi në bazë të kërkesave të paraqitura kreditorëve përcakton se prona e shoqërisë në likuidim nuk është e mjaftueshme për kompensimin e detyrimeve ndaj të gjithë kreditorëve së bashku me kamatën, likuiduesi është i detyruar që menjëherë ta ndërpresë procedurën për likuidim dhe të paraqesë propozim për hapjen e procedurës për falimentim.

Shlyerja e shoqërisë tregtare për shkak të kërkesave të paparaqitura nga kreditorët

Neni 545-v

Nëse likuiduesi pas kalimit të afatit për paraqitjen e kërkesave përcakton se nuk ka paraqitur kërkesa të kreditorëve, likuiduesi detyrohet që në afat prej tre ditësh të parashtrojë fletëparaqitje për shlyerjen e shoqërisë tregtare nga regjistri tregtar. Likuiduesi mund ta nënshkruajë fletëparaqitjen për shlyerjen e shoqërisë tregtare nga regjistri tregtar vetëm me nënshkrim elektronik para se atë ta parashtrojë në formë elektronike nëpërmjet sistemit njësportel.

Ndarja e pronës që mbetet pas përmbushjes së obligimeve

Neni 546

(1) Prona që mbetet pas përmbushjes së obligimeve ndaj kreditorëve ndahet ndërmjet bashkëpronarëve, respektivisht ndërmjet aksionarëve.

(2) Prona ndahet sipas raportit të shumave nominale të pjesëve, respektivisht aksioneve, nëse me marrëveshjen e shoqërisë, respektivisht statutin nuk është përcaktuar ndryshe dhe nëse nuk ekzistojnë aksione me të drejta të ndryshme gjatë ndarjes së pjesës së mbetur të pronës së shoqërisë.

Dorëzimi dhe ruajtja e dokumentacionit

Neni 547

(1) Pas mbarimit të likuidimit, likuiduesit e dorëzojnë llogarinë vjetore dhe raportin të bashkëpronarët, tubimi i bashkëpronarëve ose kuvendi i shoqërisë.

(2) Likuiduesit, fletëparaqitjes për shlyerje të shoqërisë nga regjistri tregtar, i bashkangjesin, llogarinë vjetore të miratuar dhe raportin, si dhe përshkrimin e vendimeve të bashkëpronarëve, tubimit të bashkëpronarëve dhe kuvendit të shoqërisë me të cilat lejohet puna e likuiduesve.

Afati për të cilin ndahet prona e cila mbetet pas përmbushjes së obligimeve

Neni 548

(1) Prona e shoqërisë ndahet pas kalimit të gjashtë muajve pas ditës së shpalljes të apelit për kreditorët.

(2) Nëse njëri nga kreditorët e njohur nuk paraqitet, shuma që i është borxh depozitohet në depozitin gjyqësor.

(3) Nëse ndonjë obligim nuk mundet menjëherë të përmbushet ose nëse është kontestues, mund të bëhet ndarja e pronës vetëm nëse kreditorit i jepet siguri.

Paraqitja e pronës pas shlyerjes së shoqërisë

Neni 549

Nëse pas shlyerjes së shoqërisë nga regjistri tregtar, paraqitet pronë e shoqërisë, gjyqi me kërkesë të cilido personi që ka interes juridik, sërish i fton likuiduesit ose cakton të tjerë, të cilët veprojnë sipas dispozitave të këtij ligji për likuidim.

Mbrojtja e të drejtave kundër shoqërisë së shlyer

Neni 550

Nëse ndaj shoqërisë së shlyer realizohet ndonjë e drejtë në gjyq, gjyqi shoqërisë së mëparshme i cakton përfaqësues të përkohshëm. Personat përgjegjës për obligimet e shoqërisë së mëparshme, mundet sipas përgjegjësisë së tyre, të paditen, nëse nuk është në fuqi parashkrimi.

Kushtet me të cilat mund të merret vendim për vazhdimin e ekzistimit të shoqërisë

Neni 551

(1) Nëse shoqëria është shuar me kalimin e kohës, të caktuar me marrëveshjen e shoqërisë, respektivisht me statutin ose vendimin e bashkëpronarëve, tubimi i bashkëpronarëve ose kuvendi i shoqërisë mund të marrin vendim për vazhdimin e ekzistimit të shoqërisë, derisa nuk fillon ndarja e pronës ndërmjet bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve.

(2) Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni merret me pajtimin e të gjithë bashkëpronarëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, respektivisht me dy të tretat e aksioneve të paraqitura me të drejtë vote në kuvendin e shoqërisë.

(3) Likuiduesit e paraqesin vazhdimin e ekzistimit të shoqërisë për regjistrim në regjistrin tregtar. Gjatë paraqitjes janë të obliguar të dëshmojnë se ende nuk ka filluar ndarja e pronës së shoqërisë ndërmjet bashkëpronarëve, respektivisht aksionarëve.

Shpallja e shlyerjes

Neni 552

Pas mbarimit të procedurës së likuidimit, likuiduesi menjëherë paraqet fletëparaqitje për shlyerjen e shoqërisë nga regjistri tregtar, dhe e njofton Depozitorin qëndror për letrat me vlerë, se aksionet e shoqërisë aksionare dhe shoqërisë komanditore me aksione janë të pavlefshme, dhe urdhëron mbylljen e librit të aksioneve.

Procedura e shlyerjes së subjekteve joaktive nga regjistri kompetent

Neni 552-a

(1) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë është i obliguar në afat prej 30 ditëve pas krijimit të kushteve për shlyerjen e subjektit joaktiv dhe shkaqeve të përcaktuara me nenin 552-b të këtij ligji në ueb faqen e vet, të shpallë njoftim për atë dhe të zbatojë procedurë për shlyerjen e tij. Në njoftim shënohet emri i shoqërisë tregtare, NUAS i saj dhe selia shkaku për shlyerje njoftim për pasojat juridike nga shlyerja dhe afati për veprim pas njoftimit. Njëkohësisht me njoftimin ftohen përfaqësuesit ligjorë, respektivisht personat dhe organet e autorizuar për menaxhim, përfaqësim dhe mbikëqyrje të subjektit, bashkëpronarët si dhe të autorizuarit (parashtrues të autorizuar) në afat prej një viti nga dita e shpalljes së njoftimit të miratojnë propozim për falimentim në pajtim me Ligjin për falimentim ose propozim për likuidim në pajtim me këtë ligj dhe për këtë me shkrim ta njoftojnë Regjistrin Qendror të Republikës së

Maqedonisë. Për njoftimin e shpallur Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë e njofton publikun së paku përmes një medie të shtypur e cila del në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në servis publik nacional radio dhe televiziv.

(2) Nëse në afatin e caktuar në paragrafin (1) të këtij neni, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë nuk merr njoftim për propozimin e parashtruar për likuidim, respektivisht propozimin për hapjen e procedurës për falimentim nga ana e parashtruesit të autorizuar, e shlyen subjektin dhe shlyerjen e shpall në ueb faqen e vet, ndërsa kur bëhet fjalë për shoqëri tregtare, në shpallje thirren edhe bashkëpronarët, respektivisht aksionarët e shoqërive të shlyera që ta ndajnë pronën e shoqërisë ndërmjet veti në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

(3) Nëse Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë në afat prej një viti nga skadimi i afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk merr aktvendim për hapjen e procedurës për falimentim, respektivisht nuk është hapur procedurë për likuidim në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë e shlyen subjektin dhe shlyerjen e shpall në ueb faqen e vet, ndërsa kur bëhet fjalë për shoqëri tregtare, në shpallje thirren edhe bashkëpronarët, respektivisht aksionarët e shoqërive të shlyera që ta ndajnë pronën e shoqërisë ndërmjet veti në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

(4) Prona e tundshme e shoqërive tregtare të shlyera në pajtim me nenin 552-a të këtij ligji ndahet në afat prej një viti, nga dita e miratimit të aktvendimit për shlyerje. Mjetet në para dhe prona e patundshme ndahen në afat prej dhjetë viteve nga dita e miratimit të aktvendimit për shlyerje. Nëse pas skadimit të këtyre afateve nuk ndodh ndarja e pronës së shoqërisë, respektivisht ndarja e pronës së sapogjetur e njëjta bartet në pronësi të Republikës së Maqedonisë, me obligim që prona e tundshme të ruhet një vit, ndërsa prona e patundshme dhe mjetet në para dhjetë gjyqësore ta dëshmojnë pronësinë e pronës dhe të kërkojnë kthimin e së njëjtës.

(5) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë çdo muaj në ueb faqen e vet shpall pasqyrë të tregtarëve individë dhe shoqërive tregtare të cilat në pajtim me këtë nen janë shlyer nga regjistri tregtar gjatë muajit paraprak, në bazë të të cilit organet kompetente dhe institucionet veprojnë në suaza të kompetencave të tyre.

Neni 552-b

(1) Në procedurën e përcaktuar në nenin 552-a të këtij ligji nga regjistri tregtar shlyhet tregtari individ dhe shoqëria tregtare nëse është plotësuar njëri nga shkaqet në vijim:

- nuk ka dorëzuar llogari vjetore dhe raporte financiare për vitin e fundit afarist deri në ditën e fundit të punës të vitit rrjedhës dhe
- nuk ka paraqitur regjistrim në adresë të postës elektronike për pranimin e shkresave në pajtim me nenin 21 paragrafi (4) të Ligjit për sistem njësportel dhe për mbajtjen e regjistrimit unik tregtar dhe regjistrimit të personave tjerë juridikë.
- pas skadimit të një viti nga publikimi i regjistrimit në ueb faqen e Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë për regjistrimin e kryer të themelimit në pajtim me nenin 175 të këtij ligji nuk e fut/paguan depozitën themeluese.

(2) Procedurë për shlyerje në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni dhe nenit 552-b të këtij ligji, ngrit Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë me detyrë zyrtare.

(3) Tregtarët individë dhe shoqëritë tregtare për të cilat në pajtim me shkaqet nga paragrafi (1) të këtij neni ka filluar procedura për shlyerje, e njëjta do të ndërpritet nëse për kohëzgjatjen e shpalljes së listës për shlyerje i mënjanojnë s hkaqet për të cilat është ngritur.

PJESA E GJASHTË

BASHKËSIA EKONOMIKE E INTERESIT

Nocioni

Neni 553

(1) Dy ose më tepër persona fizik ose juridik mes vetes për kohë të caktuar ose të pacaktuar mund të themelojnë bashkësi ekonomike të interesit me qëllim që ta lehtësojnë dhe ta përparojnë kryerjen e veprimtarive tregëtare që e përbëjnë lëndën e punës së tyre dhe ta rrisin ose ta përmirësojnë rezultatin e tyre.

(2) Personat nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jenë anëtarë shoqërues në bashkësi përkatëse ekonomike të interesit të themeluar në botën e jashtme.

(3) Bashkësia ekonomike e interesit nuk mund të jetë anëtare e bashkësisë tjetër ekonomike të interesit.

Lënda e punës

Neni 554

Lënda e punës së bashkësisë ekonomike të interesit mund të jetë vetëm lidhur me veprimtaritë tregëtare që i kryejnë anëtarët dhe vetëm mund të jenë vetëm ndihmë të këtyre aktiviteteve.

Qëllime të themelimit

Neni 555

(1) Bashkësia ekonomike e interesit për vete nuk realizon fitim. Fitimi që realizohet si rezultat i punës së saj konsiderohet si fitim i anëtarëve të bashkësisë ekonomike të interesit dhe shpërndahen midis tyre sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen për themelim, e poqëse nuk ka dispozitë të tillë, do të ndahet në pjesë të barabarta.

(2) Të drejtat e anëtarëve e bashkësisë ekonomike të interesit nuk mund të prezentohen me letra me vlerë.

(3) Dispozita në marrëveshjen për themelim ose vendimi që do të jetë i kundërt me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është i pavlefshëm.

Cilësia e personit juridik

Neni 556

Bashkësia ekonomike e interesit fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit në regjistrin tregtar.

Përgjegjësia e anëtarëve

Neni 557

(1) Anëtarët e bashkësisë ekonomike të interesit përgjigjen për obligimet që i ka marrë bashkësia me tërë pronën e saj. Nëse me personin e tretë bashkëkontaktues nuk është kontraktuar ndryshe, përgjegjësia e anëtarëve është solidare.

(2) Kreditori i bashkësisë mund ta kërkojë arkëtimin e kërkesës së bashkësisë ekonomike të interesit nga anëtarët e saj, nëse kërkesën nuk ka arritur ta arkëtojë nga vetë bashkësia.

Përmbajtja e marrëveshjes për themelim

Neni 558

(1) Bashkësia ekonomike e interesit themelohet me marrëveshje për themelimin e bashkësisë ekonomike të interesit (në tekstin e mëtejme: marrëveshje për bashkësinë).

(2) Me marrëveshjen për bashkësinë përcaktohet organizimi i saj. Marrëveshja përpilohet në formë të shkruar dhe botohet në mënyrë të përshkruar për botimin e marrëveshjes për shoqëritë.

(3) Marrëveshja për bashkësinë i përmban dispozitat posaçërisht për:

- 1) emrin e bashkësisë ekonomike të interesit në të cilin në fillim ose në fund përmbahen fjalët "bashkësia ekonomike e interesit", përveç nëse ato fjalë në mënyrë tjetër nuk i përmban emëri i bashkësisë;
- 2) emri, firma ose titulli, forma juridike, selia e shoqërive dhe, nëse ekziston, numri i regjistrimit në regjistrin tregëtar të çdo anëtari të bashkësisë ekonomike të interesit;
- 3) kohëzgjatja e bashkësisë ekonomike të interesit;
- 4) lënda e punës së bashkësisë ekonomike të interesit,
- 5) selia e bashkësisë ekonomike e interesit;
- 6) mënyra e vendosjes;
- 7) organet e drejtimit dhe kompetencat e tyre;
- 8) më përparësisht rregullohet hyrja, tërheqja dhe përjashtimi nga bashkësia ekonomike e interesit; dhe
- 9) kontrolli i punës së bashkësisë ekonomike të interesit.

(4) Të gjitha ndryshimet e marrëveshjes për bashkësinë bëhen dhe shpallen nën të njëjtat kushte si dhe gjatë kontraktimit të marrëveshjes.

Anëtarët dhe pranimi i tyre

Neni 559

(1) Anëtarë të bashkësisë ekonomike të interesit mund të bëhen persona të cilat kryejnë ndonjërin nga veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. Në bashkësinë ekonomike të interesit mund të anëtarësohen edhe persona që merren me profesione të lira, dhe nuk e kanë statusin e tregtarit.

(2) Bashkësia ekonomike e interesit gjatë ekzistimit të saj mund të pranojë anëtarë të ri. Vendimin për pranimin e anëtarë të ri e sjell njëzëri kuvendi i bashkësisë ekonomike të interesit.

(3) Anëtari i ri përgjigjet për obligimet e bashkësisë ekonomike të interesit përfshirë edhe ato që janë krijuar nga puna para pranimin të tij në bashkësinë ekonomike të interesit. Vetëm me vendimin për pranim në bashkësinë ekonomike të interesit anëtari i ri mund të lirohet nga

përgjegjësia e bashkësisë ekonomike të interesit të ndodhura para pranimit të tij.

Tërheqje dhe përjashtimi i anëtarit

Neni 560

(1) Anëtari i bashkësisë ekonomike të interesit mund të tërhiqet në pajtim me kushtet e parapara me marrëveshjen për bashkësinë dhe me kusht t'i ketë përmbushur obligimet e parapara me marrëveshjen për bashkësinë ose me aktet e kuvendit. Nëse në marrëveshjen e bashkësisë nuk janë paraparë kushte për tërheqje nga bashkësia ekonomike e interesit, tërheqja bëhet me marrëveshje, me kontratë të veçantë.

(2) Anëtar i bashkësisë ekonomike të interesit mund të përjashtohet për shkaqe të përcaktuara në marrëveshjen për bashkësinë, por, gjithsesi, nëse bën lëshim serioz në përmbushjen e obligimeve të t'ia ose nëse shkakton ose inicon ndërprerje serioze të punës. Me kërkesë të anëtarëve tjerë në bashkësinë ekonomike të interesit, vendim për përjashtim sjell gjykata në procedurë jashtëgjyqësore.

Kuvendi

Neni 561

(1) Anëtarët e bashkësisë ekonomike të interesit për punët e përbashkëta vendosin në kuvendin e bashkësisë ekonomike të interesit.

(2) Kuvendi mund të vendos në seanca ose virtualisht përmes internetit, me votim përmes postës elektronike ose me shkrim, me faks ose përmes telefonit. Mënyra e konvokimit, puna, vendosja, evidentimi i vendimeve të kuvendit përcaktohet në marrëveshjen për bashkësinë.

(3) Kuvendi është i autorizuar t'i sjell të gjitha vendimet përfshirë edhe vendimin për shpërbërje të parakohshme ose për vazhdimin e ekzistimit të bashkësisë ekonomike të interesit sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen për bashkësinë.

(4) Me marrëveshjen për bashkësinë mund të parashihet që të gjitha vendimet ose disa prej tyre të sjellen me kuorum dhe shumicë që janë të përcaktuara me të. Nëse me marrëveshjen për bashkësinë nuk janë përcaktuar kuorumi ose shumica me të cilën vendoset, vendimet sjellen njëzëri.

(5) Me marrëveshjen për bashkësinë mund të përcaktohet që disa anëtarëve t'ju jepen edhe më shumë vota, me kusht që një anëtar të mos mund të ketë shumicë votash. Nëse marrëveshja për bashkësinë nuk ka për këtë dispozita, çdo anëtar është i përfaqësuar me një votë.

(6) Kuvendi është i obliguar të tubohet me kërkesë të sëpaku 10% të numrit të anëtarëve të bashkësisë ekonomike të interesit.

Administrimi

Neni 562

(1) Me bashkësinë ekonomike të interesit administron ose më tepër administratorë që zgjedhen në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen për bashkësinë.

(2) Kuvendi e organizon administrimin me bashkësinë ekonomike të interesit dhe zgjedh administrator dhe i përcakton autorizimet dhe kushtet për revokimin e tij, vetëm nëse me marrëveshjen për bashkësinë nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Administrator nuk mund të zgjedhet person fizik i cili sipas këtij ligji nuk mund të jetë administrator, anëtar i organit të administrimit ose i organit të mbikqyrjes në shoqërinë tregëtare.

Përfaqësim

Neni 563

(1) Në marrëdhëniet me persona të tretë bashkësia ekonomike e interesit paraqitet përmes administratorit, të përcaktuar me marrëveshjen për bashkësinë.

(2) Administratori nga paragrafi 1 i këtij neni mund të realizojë të drejtë dhe të ndërmarrë të drejta dhe obligime në qarkullimin juridik në kuadër të lëndës së punës në bashkësinë ekonomike të interesit.

(3) Për obligimet që i ka ndërmarrë administratori në raport të personave të treta pa përkufizime përgjigjet bashkësia ekonomike e interesit.

Mbikëqyrja mbi punën

Neni 564

(1) Anëtarët e bashkësisë ekonomike të interesit mbikqyrjen mbi punën e bashkësisë e bëjnë përmes kuvendit dhe në mënyra tjera, të përcaktuara me marrëveshjen për bashkësinë.

(2) Çdo anëtar ka të drejtë të marrë informacione për punën e bashkësisë ekonomike të interesit nga organi i administrimit dhe t'i kontrollojë librat afaristë dhe dokumentet tjera të bashkësisë.

Pushimi i bashkësisë ekonomike të interesit

Neni 565

Bashkësia ekonomike e interesit pushon me:

- 1) Skadimin e kohës për të cilën është themeluar;
- 2) realizimin ose shuarjen e lëndës së saj të punës;
- 3) vendimin e anëtarëve të saj sipas kushteve të parapara në marrëveshjen për bashkësinë; dhe
- 4) vendim të gjykatës.

Likuidim

Neni 566

(1) Ndërprerje e bashkësisë ekonomike të interesit tërheq likuidimi i saj. Subjektiviteti juridik i bashkësisë ekonomike të interesit mbetet për nevojat e likuidimit.

(2) Likuidimi realizohet me kushtet dhe në mënyrë të përcaktuara në marrëveshjen për bashkësinë.

(3) Nëse marrëveshja për bashkësinë nuk përmban dispozita për kushtet dhe për mënyrën e likuidimit, kuvendi i anëtarëve të bashkësisë ekonomike të interesit cakton likuidator. Nëse kuvendi nuk mund t'i qaset emërimit të tij, likuidatorin e cakton gjykata.

(4) Pas pagesës së borxheve, teprica e aktivës ndahet midis anëtarëve, me kushtet e parapara me marrëveshjen për bashkësinë.

(5) Nëse marrëveshja për bashkësinë nuk përmban dispozita për mënyrën në të cilën bëhet likuidimi, ndarja bëhet në pjesë të njejta.

PJESA E SHTATË

SHOQËRIA SEKRETE

Bashkëpjesëmarrës sekret dhe deponimi

Neni 567

(1) Shoqëria sekrete krijohet me marrëveshje me të cilën një person (bashkëpjesëmarrës sekret) deponon, përkatësisht merr pjesë me deponim në të holla dhe deponim tjetër në ndërmarrjen e personit tjetër ndërmarrës bashkëpjesëmarrës publik dhe në sajë të depozitit fiton të drejtën të marrë pjesë në fitimin dhe në humbjen e ndërmarrjes.

(2) Depoziti i bashkëpjesëmarrësit sekret hyn në pronën e sipërmarrësit bashkëpjesëmarrësit publik.

Subjektivitet i shoqërisë

Neni 568

(1) Shoqëria sekrete nuk ka subjektivitet juridik dhe nuk ka firmë.

(2) Shoqëria sekrete ekziston vetëm në marrëdhëniet midis bashkëpjesëmarrësit sekret dhe sipërmarrësit bashkëpjesëmarrësit publik dhe nuk paraqitet në marrëdhëniet me persona të tretë.

(3) Sipërmarrësi paraqitet në qarkullimin juridik dhe është bartës ekskluziv i të gjitha të drejtave dhe obligimeve nga puna.

Rregullimi marrëveshës i marrëdhënieve

Neni 569

(1) Bashkëpjesëmarrësit lirisht merren vesh për qëllimet, format dhe përmasat e interesave dhe kushteve të punës së shoqërisë sekrete.

(2) Sipërmarrësi dhe një ose më tepër bashkëpjesëmarrës sekret në kryerjen e obligimeve janë të obliguar të veprojnë me atë kujdes që ua kushtojnë punëve të tyre.

Marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve

Neni 570

(1) Marrëdhëniet midis bashkëpjesëmarrësve rregullohen me marrëveshje.

(2) Në marrëdhëniet midis sipërmarrësit dhe bashkëpjesëmarrësit sekret që nuk janë të rregulluara me marrëveshjen nga paragrafi 1 të këtij neni dhe me dispozitat e kësaj pjese të ligjit, aplikohen dispozitat e Ligjit për marrëdhënie obligatore me të cilat rregullohet marrëveshja për ortakëri.

Depozit i bashkëpjesëmarrësit sekret

Neni 571

Bashkëpjesëmarrësi sekret nuk është i obliguar ta rrisë depozitin ose ta plotësojë nëse depoziti zvogëlohet për shkak të humbjes së shoqërisë sekrete.

Mbulimi i humbjes

Neni 572

(1) Nëse nuk është kontraktuar ndryshe, bashkëpjesëmarrësi sekret merr pjesë në mbulimin e humbjes së sipërmarrësit.

(2) Bashkëpjesëmarrësi sekret në humbjen merr pjesë vetëm deri në shumën e paguar ose deri në depozitin ende të paregjistruar. Për shumën e humbjes që i takon bashkëpjesëmarrësit sekret zvogëlohet depoziti i bashkëpjesëmarrësit sekret.

(3) Nëse pjesa e bashkëpjesëmarrësit sekret në fitimin edhe në humbjen nuk është përcaktuar me marrëveshje, në rast kontesti e përcakton gjykata në procedurë jashtëgjyqësore.

Përlllogaritja e fitimit, respektivisht e humbjes

Neni 573

(1) Në fund të çdo viti afarist sipërmarrësi përlllogarit fitimin, respektivisht humbjen e shoqërisë sekrete dhe bashkëpjesëmarrësit sekret i paguan fitimin që i takon.

(2) Bashkëpjesëmarrësi sekret nuk është i obliguar që fitimin e pranuar ta kthejë për shkak të humbjeve të mëvonshme. Me përjashtim, nëse deponimi është zvogëluar për shkak të humbjes, fitimi përdoret për rritjen e deponimit të bashkëpjesëmarrësit sekret deri në lartësinë e deponimit të përcaktuar në marrëveshjen.

(3) Fitimi, të cilin bashkëpjesëmarrësi sekret nuk e ka marrë, nuk e rrit depozitin e tij.

E drejtë për transkripcion dhe inspektim në librat dhe aktet

Neni 574

(1) Bashkëpjesëmarrësi sekret ka të drejtë të kërkojë kopje të llogarive vjetore dhe kontrollimin e vlefshmërisë dhe rregullshmërisë së tyre me krahasimin me librat dhe aktet.

(2) Me kërkesë të bashkëpjesëmarrësit sekret, në procedurë jashtëprocesore, në çdo kohë, do t'i urdhërojë sipërmarrësit bashkëpjesëmarrësit publik t'i jepen bashkëpjesëmarrësit sekret llogaritë

vjetore ose t'i jepen sqarime tjera si dhe t'i jepet në inspektim librat dhe aktet.

(3) Të drejtat e bashkëpjesëmarrësit sekret nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund me marrëveshje, as të përjashtohen e as të kufizohen.

Marrëdhëniet me persona të tretë

Neni 575

Emëri i bashkëpjesëmarrësit sekret nuk guxon të gjendet në firmën e sipërmarrësit, por nëse gjendet në të, e këtë bashkëpjesëmarrësi sekret e ka ditur ose patjetër është dashur ta dijë, u përgjigjet kreditorëve për obligimet nga puna e shoqërisë sekrete në mënyrë të pakufizuar dhe solidare me sipërmarrësin.

Kushte për pushim

Neni 576

(1) Shoqëria sekrete pushon me:

- 1) kalimin e kohës për të cilën është kontraktuar marrëveshja për shoqërinë sekrete;
- 2) marrëveshje të sipërmarrësit dhe bashkëpjesëmarrësit sekret;
- 3) realizimin e qëllimeve për të cilat është kontraktuar marrëveshja për shoqërinë sekrete ose, nëse realizimi i qëllimeve bëhet e pamundshme, pa marrë parasysh nëse marrëveshja është kontraktuar për kohë të caktuar apo të pacaktuar;
- 4) vdekjen e sipërmarrësit, respektivisht me pushimin e punës së sipërmarrësit; dhe
- 5) hapjen e procedurës falimentuese mbi shoqërinë në të cilën sipërmarrësi është bashkëpjesëmarrës publik ose mbi bashkëpjesëmarrësin sekret.

(2) Në rastet e referuara në paragrafin (1) të këtij neni deri në përfundimin e një shoqërie të fshehtë vjen me forcën e ligjit, përveç nëse me marrëveshjen e shoqërisë nuk përcaktohet ndryshe.

(3) Në rast të vdekjes së partnerit sekret shoqëria pushon, përveç nëse marrëveshja parashikon ndryshe.

Rregullimi i marrëdhënieve kur shoqëria nuk ka pushuar me falimentim

Neni 577

Nëse shoqëria sekrete ka pushuar për shkaqe tjera, e jo për shkak të hapjes së procedurës falimentuese në të cilën sipërmarrësi është bashkëpjesëmarrës publik, sipërmarrësi është i obliguar të bëjë përlogaritje me bashkëpjesëmarrësin sekret dhe kërkesën e tij ta paguajë në para, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.

Falimentim mbi sipërmarrësin

Neni 578

(1) Nëse hapet procedurë falimentuese mbi shoqërinë në të cilën sipërmarrësi është bashkëpjesëmarrës publik, bashkëpjesëmarrësi sekret

është i obliguar ta regjistrojë pjesën e arritur e deponimit.

(2) Nëse pjesa e humbjes e tejkalon pjesën që i takon bashkëpjesëmarrësit sekret, kreditor falimentues mund ta realizojë kërkesën e tij nga deponimi i futur ose me hapjen e procedurës falimentuese nga deponimi tanimë i arritur.

(3) Pjesa e deponimit, e cila deri në hapjen e e procedurës falimentuese mbi shoqërinë ende nuk ka arritur, bashkëpjesëmarrësi sekret, pa marrë parasysh pjesën e humbjes që bie mbi të, nuk duhet patjetër ta regjistrojë në masën e falimentimit.

PJESA E TETË

SHOQATA E JASHTME TREGTARE DHE TREGTAR I JASHTËM - INDIVID

KAPITULLI I PARË

SHOQATA E JASHTME DHE TREGTARI I JASHTËM - INDIVID

Koncept

Neni 579

(1) Shoqatë e jashtme tregtare, sipas këtij ligji, është çdo shoqatë tregtare e themeluar sipas të drejtës në vendin ku e ka regjistruar selinë (në tekstin e mëtutjeshëm: shoqatë e jashtme).

(2) Tregtar i jashtëm "individ" sipas këtij ligji, është çdo person fizik të cilit, ajo cilësi i është pranuar jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, në vendin shtetas i të cilit është, ku e ka regjistruar selinë dhe ku e zhvillon punën e ndërmarrjes.

Kritere për përkatësi

Neni 580

(1) Shoqatë tregtare selia e të cilës, me marrëveshjen për shoqatën apo me statutin, është vendi i caktuar jashtë Republikës së Maqedonisë, në kuptim të këtij ligji ka, përkatësi të shtetit në të cilin e ka selinë.

(2) Kur selia e shoqatës, në pajtim me alinenë 1 të këtij neni nuk gjendet në Republikën e Maqedonisë, shoqata llogaritet e vendit kur me të vërtetë me të udhëhiqet nga vendi në Republikën e Maqedonisë ose kur ajo merret me kryerjen e veprimtarisë tregtare që terësisht apo në masë më të madhe realizohet në Republikën e Maqedonisë.

(3) Shoqatë tregtare, selia e të cilës nuk është caktuar me marrëveshjen për shoqatën, përkatësisht me statutin, ka përkatësi të shtetit në të cilin gjendet vendi prej ku në mënyrë të drejtë udhëheqet me të.

Pozita e punës

Neni 581

(1) Shoqatat e jashtme dhe tregtarët e jashtëm individ punojnë sipas kushteve të caktuara me ligj dhe në punë janë të barazuar në territorin e Republikës së Maqedonisë me personat e vendit fizik dhe juridik, përveç nëse me marrëveshje ndërkombëtare ose me ligj për disa lloje të shoqatave dhe për tregtarët e jashtëm individ me lëndë të caktuar të punës nuk është caktuar në mënyrë tjetër.

(2) Shoqëria e huaj tregtare ose tregtari i huaj individ detyrohet që të organizojë filial për kryerjen e veprimtarisë në territorin e Republikës së Maqedonisë nëse ka regjistruar seli, administratë qendrore ose vend kryesor për kryerjen e veprimtarisë në vend tjetër e drejta e të cilit kërkon nga shoqëritë tregtare dhe tregtarët individual të regjistruar në regjistrin tregtar të organizojnë degë që të mund ta kryejnë veprimtarinë në territorin e saj.

Rregulla për shoqatat e përbashkëta

Neni 582

(1) Shoqatave të jashtme, forma e të cilave nuk është rregulluar me këtë ligj, në mënyrë përkatëse aplikohen dispozitat që kanë të bëjnë me shoqatat me forma më të përbashkëta. Ngjashmëria vlerësohet posaçërisht sipas mënyrës në të cilën bashkëshoqëruesit i investojnë shumat në shoqatë, sipas mënyrës dhe vëllimit të përgjegjësisë të bashkëshoqëruesve për obligimet edhe sipas organizatës.

(2) Nëse shoqata e jashtme nuk mundet të vendoset në asnjë formë të shoqatës tregtare të paraparë me këtë ligj, aplikohen dispozitat me të cilat është rregulluar shoqata aksionare.

Subjektiviteti juridik

Neni 583

(1) Aftësia juridike dhe afariste (subjektiviteti juridik) të shoqatës së jashtme vlerësohet sipas ligjeve të shtetit të cilës shoqatë I takon.

(2) Aftësia afariste nuk mundet të jetë më e madhe, kurse përgjegjësia nuk mundet të jetë më e vogël nga ajo që rregullat ligjore të Republikës së Maqedonisë ua pranojnë, përkatësisht ia imponojnë shoqatave të vendit nga forma e njejtë apo për të ngjashme dhe lëndë të punës, as shoqata e jashtme mundet, në pikëpamje të punëve juridike që I kontraktuar apo që është e detyruar t'i kryejë në Republikën e Maqedonisë, të thirret në paaftësinë e vet nëse në të nuk mundet të thirret as shoqata e vendit nga forma e njejtë apo e përbashkët dhe të lëndës të punës.

Aplikimi i së drejtës

Neni 584

(1) Në punën e vetme në Republikën e Maqedonisë shoqata e jashtme punon sipas ligjeve të Republikës së Maqedonisë.

(2) Llogaritjet se shoqata e jashtme, e cila ndërmarrje në Republikën e Maqedonisë është e regjistruar në regjistrin tregtar, në pikëpamje të punëve juridike që i ka kontraktuar apo që patjetër duhet t'i kryejë në Republikën e Maqedonisë, ka aftësi juridike dhe afariste si edhe personi juridik i vendit nga forma e njejtë apo e përbashkët dhe lënda e punës,

edhe pse sipas ligjeve të shtetit të cilit i takon nuk do të ekzistonte apo nuk do ta kishte atë aftësi afariste.

KAPITULLI I DYTË

FILIJALAT DHE NDËRMARRJET E PERSONAVE TË JASHTËM

Filijalat dhe ndërmarrjet të shoqatave të jashtme

Neni 585

(1) Shoqata e jashtme ka të drejtë të organizojë degë dhe ndërmarrje si njësi të veta organizative ose në mënyrë tjetër të kryejë punë të caktuara dhe të merr obligime, të realizon të drejtë të çasjes para gjyqjeve dhe organeve tjera të Republikës së Maqedonisë me kushtet e caktuara me ligj.

(2) Ekzistimi juridik dhe vëllimi i aftësisë së vet juridike në rast të dyshimit apo mohimit e dëshmon shoqata e jashtme.

Seksioni 1

NDËRMARRJA E PERSONAVE TË JASHTËM

Themelimi i ndërmarrjeve

Neni 586

(1) Shoqata ka të drejtë, përmes ndërmarrjes së vet, t'i kryejë, sipas formës dhe lëndës së punës, të gjitha punëve, të fitojë dhe të merr obligim, të drejtë të çasjes para gjyqjeve dhe organeve tjera të Republikës së Maqedonisë nën kushtet e njejta si edhe shoqatat e vendit nga forma e njejtë apo e përbashkët dhe të lëndës së punës, nëse vetëm me ligj nuk është caktuar në tjetër mënyrë.

(2) Shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm, mundet me vendim në formën me shkrim të organizojë ndërmarrjen në Republikën e Maqedonisë vetë nëse është e regjistruar në regjistrin e shtetit në të cilin ka seli.

(3) Tregtar i jashtëm individ mund të organizojë vetëm një ndërmarrje.

Regjistrim në regjistrin tregtar

Neni 587

(1) Shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ e paraqet organizimin e ndërmarrjes së vet për shkak të regjistrimit në regjistrin sipas selisë së degës.

(2) Me fletë paraqitjen dorëzohen:

1) Certifikatë prej regjistrit ku është regjistruar shoqata e huaj, përkatësisht tregtari i jashtëm individ i cili e organizon degën, prej së cilës duket edhe data e regjistrimit;

2) Kopja nga marrëveshja për shoqatën apo statute, përkatësisht akt tjetër përkatës i këtyre akteve, sipas legjislaturës të vendit të huaj, të

vërtetuar nga ana e organit shtetëtor i cili është i autorizuar për atë sipas rregullave të shtetit të cilit shoqata i takon si dhe vërtetim nga autoritetet e jashtme se marrëveshja apo statuti i paraqitur përkatësisht akt tjetër përkatës i këtyre akteve, sipas legjislaturës të vendit të huaj akoma është në fuqi. Nëse sipas ligjeve të shtetit të cilit shoqata i takon nuk kërkohet marrëveshje apo statut me shkrim, përkatësisht akt tjetër përkatës i këtyre akteve sipas legjislaturës të vendit të huaj, paraqitet certifikat nga përfaqësia kompetente diplomatike konzulare në Republikën e Maqedonisë se shoqata e ekziston, për atë të cilët janë aksionerë, përkatësisht ndërmarrjes dhe si përgjigjen për obligimet, kurse për tregtarin e jashtëm individ se nuk është shlyer nga regjistri;

3) Lista e personeve të cilëve u është besuar udhëheqja e shoqatës së jashtme dhe tregtarit të jashtëm individ në Republikën e Maqedonisë, me shënimin e mbiemrit dhe emrit të tyre, numrit personal (EMBG) përkatësisht numrin e pasaportit për personat e jashtëm fizik, të shtetësisë së tyre dhe të vendbanimit. Listës i paraqitet edhe dëshmi se ata persona në mënyrë të rregull janë emëruar sipas akteve të shoqatës dhe rregullave ligjore të shtetit të cilit shoqata i takon;

4) Vendimi i organit kompetent të shoqatës së jashtme dhe tregtarit të jashtëm individ për organizimin e degës;

5) Raporti për bonitetin e shoqatës së jashtme dhe tregtarit të jashtëm individ, i dhënë nga organi kompetent shtetëtor ose nga revizori i autorizuar, sipas rregullave të shtetit të cilit i takon shoqata e jashtme dhe tregtari i jashtëm individ;

6) Përshkrimi i veprimtarisë dhe punës që do t'i kryejë ndërmarrjes; dhe

7) nëse me ligj është caktuar paraqitja e lejës, aprovimit ose aktit tjetër me fletë paraqitjen jepet edhe ajo dëshmi.

(3) Pra regjistrimit të ndërmarrjes në regjistrin tregtar, personi që ka sjellur vendim për organizimin e ndërmarrjes në Republikën e Maqedonisë nuk guxon të punojë përmes ndërmarrjes.

(4) Regjistrimi i llojeve tjera të njësive organizative bëhet në mënyrën dhe sipas kushteve - të caktuara në aktin prej nenit 586 alineja 2 të këtij ligji.

(5) Ndërmarrja është e obliguar ndryshimet dhe plotësimet të të dhënave të regjistruara në regjistrin tregtar, përkatësisht të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur te shoqata e huaj, përkatësisht te tregtari i huaj - individ që e kanë organizuar ndërmarrjes t'i paraqes përshkak të regjistrimit në regjistrin tregtar.

(6) Filijala është e detyruar çdo vjet t'i paraqesë raportet financiare vjetore të shoqatës së huaj tregtare, përkatësisht tregtari i jashtëm - individ që e kanë organizuar ndërmarrjen së paku në një gazet ditore dhe t'i paraqes në regjistrin Qëndror.

Më shumë filijala

Neni 588

(1) Nëse shoqata e jashtme në Republikën e Maqedonisë themelon më shumë filijala, në vetë paraqitjen për regjistrim në qendrën tregtare shënohet dega e cila në pikëpamje të punës në Republikën e Maqedonisë llogaritet degë kryesore (Qendra Maqedonase).

(2) Degët tjera të cilat i oragnizon shoqata e jashtme në Republikën e Maqedonisë llogariten si degë të degës kryesore.

(3) Në firmën e degës shënohet se cila është dega kryesore, përkatësisht shënohet numri rendor i degëve tjera sipas renditjes së tyre.

Pjesëmarrje në qarkullimin juridik

Neni 589

Filijala merr pjesë në qarkullimin juridik në emër dhe në llogari të shoqatës së jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ, me ç'rast është i detyruar ta përdor firmën dhe selinë të shoqatës së jashtme, përkatësisht tregtarin e jashtëm individ si edhe emrin e degës.

Përgjegjësi në qarkullimin juridik

Neni 590

(1) Për obligimet e shkaktuara me punën e ndërmarrjes, shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ përgjigjet me tërë pasurinë e tij.

(2) Nëse shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ i cili e ka organizuar degën është regjistruar në regjistrin e shtetit në të cilin e ka selinë më pak se dy vjet prej ditës të paraqitjes të kërkesës për organizimin e degës, deri në skadimin e dy viteve prej ditës të organizimit, për obligimet e shkaktuara nga puna e degës, përveç përgjegjësisë nga alineja 1 të këtij neni, në mënyrë të pakufizuar dhe solidare përgjigjen themeluesit të shoqatës së huaj, përkatësisht tregtari i huaj individ.

Përfaqësues

Neni 591

(1) Për çdo ndërmarrje, shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ emëron një apo më shumë përfaqësues, të cilët, të cilët në atë pikëpamje të asaj dege, e përfaqësojnë në punën e tij në Republikën e Maqedonisë. Shoqata e jashtme mundet përfaqësuesit e njejtë t'i emërojë edhe për shumë degë tjera.

(2) Në pajtim me këtë ligj, përfaqësuesit e degës kryesore janë përfaqësues të degëve tjera edhe kur për ata janë emëruar edhe përfaqësues tjerë.

Libra tregtare

Neni 592

(1) Shoqata e jashtme sipas formës dhe lëndës të punës, përkatësisht tregtari i jashtëm individ, janë të detyruar që për punën e vet në Republikën e Maqedonisë, përmes degës, të udhëheqin libra tregtare.

(2) Dega e shoqatës së jashtme, përkatësisht të tregtarit të jashtëm individ, është i detyruar t'i paraqesë, çdo vjet, llogarinë vjetore dhe raportin e revizorit, shënimet në regjistrin tregtar apo në regjistër tjetër përkatës të cilët kanë të bëjnë në të dhëna të shënuara në regjistër, kurse të cilat janë ndryshuar, në sanim, falimentim apo për gjëra tjera të cilat janë të rëndësishme për gjendjen financiare të shoqatës së jashtme, përkatësisht të tregtarit të jashtëm individ.

Pushimi i ndërmarrjes

Neni 593

(1) Dega e shoqatës së jashtme, përkatësisht të tregtarit të jashtëm individ ndërpritet kur do të pushojë shoqata e jashtme ose kur do të skadojë afati në cilin është themeluar.

(2) Gjyqi, me propozim të personit i cili ka interes juridik, mund të vendos që ndërmarrja të ndërpritet edhe pse:

1) vërteton se shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ në shtetin të cilit i takon prej çfarëdo shkaqëve ndërpritet ose i është ndaluar kryerja e lëndës të punës që e kryen në Republikën e Maqedonisë ose të ndërmarrjes i është ndaluar ta kryej veprimtarinë nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë.

2) shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ për 3 muaj nga ftesa e gjyqit nuk emëron përfaqësues të ndërmarrjeve sipas rregullave, sipas statutit apo marrëveshjes për shoqatën ose sipas lejës;

3) shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ është dashur të investoj mjete, por nuk i ka investuar ose është tërhequr në tërësi apo pjesërisht nga investimi; dhe

4) kreditori dëshmoi se kërkesën e vet, e cila del nga puna e shoqatës së jashtme përkatësisht tregtarit të jashtëm individ që e kanë organizuar ndërmarrjen në Republikën e Maqedonisë, nuk mundet ta paguajë.

(3) Nëse ndërpritet ndërmarrja kryesore, kurse vazhdojnë me punë degët tjera, shoqata e jashtme përcakton ndërmarrjes të re kryesore dhe e paraqet për regjistrim në regjistrin tregtar.

Likuidimi i ndërmarrjes

Neni 594

(1) Nëse shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ nuk emëron likvidator, likuidimin e degës e zbatojnë përfaqësuesit.

(2) Kreditorët të cilët kanë kërkesa ndaj shoqatës së jashtme përkatësisht ndaj tregtarit të jashtëmindivid, nga puna e tyre përmes ndërmarrjes që është ndërprerë, në likuidim kanë përparësi në përmbushje para kreditorëve tjerë.

(3) Likuidimi i ndërmarrjes së shoqatës së huaj, përkatësisht tregtarit të jashtëm individ nuk është patjetër të zbatohet nëse ndërmarrja me mbarë pasurinë në Republikën e Maqedonisë për 6 muaj pas ndërprerjes së shoqatës së jashtme transformohet në shoqatë tregtare me formë të caktuar me këtë ligj dhe selinë në Republikën e Maqedonisë ose nga ana tjetër, në afatin e njejtë, e ndërmerr, me të njejtën pasuri e cila ka qenë juridike përkatësisht person fizik në Republikën e Maqedonisë.

Përgjegjësi për dëm

Neni 595

(1) Dispozitat prej këtij ligji për përgjegjësinë për dëm që aplikohen në shoqatat e brendshme sipas formës së tyre në mënyrë përkatëse aplikohen edhe në ndërmarrjet të shoqatave të huaja, përkatësisht tregtarit të jashtëm individ. Përfaqësuesit dhe likvidatorët, në pikëpamje të përgjegjësisë janë barazuar me anëtarët e organit të udhëheqjes, përkatësisht të drejtuesit dhe likvidatorëve.

(2) Dispozitat prej këtij ligji për përgjegjësi të anëtarëve të organit të udhëheqjes, udhëheqësit, përkatësisht likvidatorët në mënyrë përkatëse aplikohen edhe likvidatorët të ndërmarrjes të shoqatës së jashtme.

(3) Personat të cilët si përfaqësues i shkelin dispozitat të këtij ligji përgjigjen për dëmin në mënyrë solidare. Me ta në mënyrë solidare përgjigjet edhe shoqata e jashtme, përkatësisht tregtari i jashtëm individ.

Seksioni 2

NDËRMARRJA

Neni 596

(1) Shoqata e jashtme, e cila ka të drejtë të kryejë veprimtari tregtare sipas legjislaturës nacionale mund të organizojë përfaqësi tregtare në Republikën e Maqedonisë.

(2) Përfaqësia nuk ka cilësi të personit juridik dhe nuk mundet të kryejë veprimtari tregtare.

(3) Mënyra, procedura e regjistrimit dhe organi tek i cili bëhet regjistrimi i ndërmarrjes i paraqet Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Pjesa e nëntë

KONTROLI DHE MBIKËQYRJA

Neni 597

Kontrolli dhe mbikëqyrja ndaj tregtarit individ, shoqatat tregtare bashkësia ekonomike e interesit dhe ndërmarrja e organizuar nga shoqatat e jashtme, përkatësisht nga tregtari i jashtëm individ e bëjnë shërbimet e inspektionit në kuadër të kompetencave të caktuara me ligj.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes shërbimet inspektuese nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, nëse është kryer shkelje lidhur me dispozitat e këtij ligji. Kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje parashtrohet edhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë.

(3) Procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Komisioni për Kundërvajtje i formuar nga drejtori i Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin për Regjistrimin Qendror, nëse është kryer shkelje lidhur me dispozitat nga nenet 477 paragrafët (4) dhe (5), 482 paragrafët (1) dhe (2) dhe 506 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji.

(4) Në procedurën nga paragrafi (3) i këtij neni, njoftimet dhe dorëzimi i shkresave kryhet në adresë të postës elektronike për pranimin e shkresave të shoqërisë tregtare të regjistruar në regjistrin tregtar.

(5) Nëse shoqëria nuk ka adresë të postës elektronike të regjistruar për pranimin e shkresave, njoftimi shpallet në ueb faqen e Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë.

(6) Njoftimi i shpallur në ueb faqen e Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë konsiderohet se është kryer me rregull pas skadimit të afatit prej tetë ditësh nga dita e shpalljes.

Neni 597-a

Nese inspektori kompetent percakton se tregtari individ fillon me kryerjen e veprimtarisë para se të regjistrohet në regjistrin tregtar do të miratojë aktvendim për ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 15 ditësh (neni 14 paragrafi (1)).

Pjesa e dhjetë

SANKSIONE PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 598 **32**

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje tregtari individ nëse:

- 1) regjistron më shumë se një firmë (neni 14 alinea 4);
- 2) bartja e firmës personit të tretë do ta bëjë në anën tjetër të dispozitave të këtij ligji (neni 16 aliena 2) dhe të njëjtin nuk e regjistron në regjistrin tregtar (neni 16 alinea 4);
- 3) ndërprerjen e punës nuk e paraqet në organin kompetent edhe para të marrjes të lejes nga organi kompetent për të ardhura publike (neni 17 alinea 1) dhe nuk paraqet fletparaqitje për shluerjen e regjistrimit në regjistrin tregtar (neni 18 alinea 2);
- 4) fillon me kryerjen e veprimtarisë para se të regjistrohet në regjistrin tregtar (neni 14 paragrafi (1)).
- 5) fillon me kryerjen e veprimtarisë para marrjes së lejes nga organi kompetent për plotesimin e kushteve të percaktuara për kryerjen e veprimtarisë (neni 63 paragrafi (1));
- 6) nëse merr punë dhe veprime juridike jashtë lëndës së punës, të regjistruar në regjistrin tregtar (neni 64 alinea 1);
- 7) nuk udhëheq apo në mënyrë të drejtë nuk i udhëheq librat tregtare (neni 471 alinea 1 dhe neni 472 alinea 3);
- 8) nuk i ruan në mënyrë përkatëse dhe të drejtë dokumentet tregtare dhe të tjera (neni 474);
- 9) nuk përpilon, nuk shpall dhe nuk paraqet llogari vjetore (neni 476 alinea 1 dhe neni 477 alinea 1, 4 dhe 7).

Neni 598-a

Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë deri në tre vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet tregtarit individ për kundërvajtje nga neni 598 paragrafi (1) pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 599

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqata tregtare nëse:

- 1) fillon me kryerjen e veprimtarisë para regjistrimit në regjistrin tregtar dhe para marrjes të lejes nga organi kompetent për përmbushjen e kushteve të paraqitura për kryerjen e asaj veprimtarie nëse ajo është caktuar me ligj (neni 63);
- 2) nëse nuk i kryen informacionet e pranueshme në pajtim me nenin 10.
- 3) gjatë punës së vet firma nuk e përdor ashtu siç duhet është regjistruar në regjistrin tregtar (neni 52 alinea 1) ose përdor titull të shkurtuar të firmës, ndërsa i njëjti nuk është regjistruar në regjistrin tregtar (neni 52 alinea 3);
- 4) pa pajtimin e shprehur të bashkëvepruesit dalës apo të trashigimtarëve të tij e përdor firmën e vjetër (neni 53);
- 5) nuk e paraqet ndërrimin e selisë në regjistrin tregtar (neni 61 alinea

3);

6) nuk harton, nuk shpall dhe nuk dorëzon llogari vjetore, përkatësish edhe llogari të konsoliduara vjetore, raporte financiare dhe raporte të konsoliduara financiare, kur kanë obligime për atë me këtë ligj (neni 476 alineja 1; neni 477 paragrafët (1), (4), (5), (8) dhe (12), neni 482, alineja 1 dhe 2 neni 504 neni 506, alineja 4 dhe 5);

7) nuk paguan dividendë në afatin e përcaktuar me nenin 487, paragrafi (5) i këtij ligji;

7-a) vendimi për pagesën e dividendit nuk i përmban të dhënat e përcaktuara me nenin 490 paragrafi (1) të këtij ligji.

8) nuk kryen pagesë të depozitimit në para në afatin e caktuar me këtë ligj (neni 186 paragrafi (5)) dhe

9) nëse nuk zgjedhin drejtor, respektivisht organ të menaxhimit ose mbikëqyrjes në afatin e caktuar me këtë ligj (neni 233 paragrafi (2)).

(2) Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë tregtare do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë tregtare për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 599-a

(1) Sanksioni për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje deri në tre vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet shoqërisë për kundërvajtje nga neni 599 paragrafi (1) pikat 1, 3, 5, 6 dhe 7 të këtij ligji.

(2) Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e detyrës deri në një vit, duke e konsideruar nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet personit përgjegjës për kundërvajtje nga neni 599 paragrafi (1) pikat 1, 3, 5, 6 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 600

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqata nëse:

1) kryen veprimtari e cila, si profesion, mundet ta kryejë person i cili ka kualifikim përkatës, kurse midis bashkëvepruesit apo të punësuarit nuk ka person me kualifikim përkatës (neni 113);

2) bashkëvepruesit të cilët nuk janë udhëheqës i shlyen nga të drejtat me nenin 132;

3) nëse nuk e paraqet për regjistrim në regjistrin tregtar ndërprerjen e shoqatës (neni 147);

(2) Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë publike, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë publike për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 600-a

Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë publike për kundërvajtje nga neni 600 paragrafi (1) pikat 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 601

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqata me përgjegjësi të kufizuar nëse:

1) harxhimet dhe shpërblimet për pjesëmarrje në themelimin e shoqatës nuk paguhen nga fitimi në pajtim me nenin 180 alineja 3;

- 2) nëse çdo ndryshim i të dhënave, çdo qasje dhe dukje të bashkëvepruesit nga shoqata nuk e paraqet për regjistrim në regjistrin tregtar me fletparaqitje (neni 182 alineja 4);
- 3) pasuria e shoqatës, që është e nevojshme për ruajtjen e pjesës kryesore i paguhet bashkëvepruesit (neni 192 alineja 2);
- 4) nuk udhëheq libra të pjesëmarrjeve, në pajtim me nenin 195 alineja 1, përkatësisht librin e pjesëmarrjeve nuk e udhëheq në mënyrë të drejtë dhe të saktë (neni 195 alineja 2);
- 5) në bazë të vendimit të gjyqit, në një afat prej 3 ditë nga dita e pranimit të vendimit, nuk e zbaton vendimin dhe nuk e paraqet regjistrimin në librin për destinime (neni 196) alineja 4);
- 6) Nuk e paraqet raportin nga revizioni i kryer na revizor të autorizuar në tubimin e bashkëvepruesve (neni 230 alineja 3);
- 7) organi drejtues është përbërë në kundërshtim të nenit 231;
- 8) nuk përgatishin llogari vjetore, raport financiar dhe raport vjetor për punën e shoqatës nga viti i mëparshëm afarist ose edhe nëse janë përgaditur, e nuk i paraqesin në tubimin e bashkëvepruesve, përkatësisht në kuvendin në afatet e caktuara me këtë ligj (neni 240 alineja 2);
- 9) këshilli mbikëqyrës, përkatësisht kontrollori janë përbërë në kundërshtim të nenit 246;
- 10) në paraqitjet e veta afariste dhe të rregullave me përmendjen e rritjes të pjesës kryesore para shpalljes të vendimit në regjistrin tregtar (neni 257 alineja 4);
- 11) kryen pagesën bashkëvepruesve në bazë të zvogëlimit para regjistrimit të ndryshimeve të marrëveshjes për shoqatën në regjistër tregtar (neni 264 alineja 1);
- 12) nuk e paraqet për regjistrim në regjistrin tregtar ndërprerjen e shoqatës (neni 269 alineja 1);
- 13) nuk paraqet flet paraqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të transformimit të shoqatës nga njëra në formën tjetër (neni 514 alineja 1);
- 14) shoqëria ka ngelur pa drejtor, kurse bashkëpronarët në shoqëri nuk kanë mbajtur mbledhjen e bashkëpronarët dhe nuk kanë zgjedhur drejtor të shoqërisë në afatin e caktuar në nenin 233 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 601-a

(1) Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për kundërvajtje nga neni 601 paragrafi (1) pikat 2, 6, 8 dhe 12 të këtij ligji.

(2) Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri për kundërvajtje nga neni 601 paragrafi (1) pikat 2, 6, 8 dhe 12 të këtij ligji.

Neni 602

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje kundërvajtje shoqatës aksionare nëse:

- 1) para regjistrimit të themelimit të shoqatës në regjistrin tregtar ka dhënë aksione (neni 302) alineja 1);
- 2) nuk i ruan aktet dhe dokumentet në selinë e shoqatës të parapara me nenin 319;

- 3) i izolon akconerët nga e drejta e informimit (neni 320);
- 4) iu premtan apo iu paguan kamatë aksionerëve (neni 328 alineja 2);
- 5) njoftimi për blerjen e aksioneve nuk shpallet në "Gazetën Zyrtare të RM", (neni 339 alineja 5);
- 6) vendimi i kuvendit për zgjidhjen e këshilltarit të drejtorëve apo të këshillit mbikëqyrës nuk e paraqet për regjistrim në regjistrin tregtar (neni 344 alineja 5);
- 6-a) anëtarët e bordit të drejtorëve, përkatësisht bordit mbikëqyrës nuk kanë vepruar në pajtim me nenin 347 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.
- 7) obligimin, në rast të humbjes, ringarkimit apo paaftësisë për pagesë e kryen në pajtim me nenin 354 alineja 4);
- 8) nuk paraqet fletparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të anëtarëve të revokuar apo të zgjedhur nga këshilli i drejtorëve apo këshillit mbikëqyrës (363 alineja 5);
- 9) Këshilli drejtues nuk paraqet fletparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të anëtarëve të këshillit drejtues të autorizuar për përfaqësim të shoqatës (neni 377 alineja 3);
- 9-a) aksionari nuk merr njoftim në pajtim me nenin 406 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 9-b) ftesa përkatësisht thirrja publike nuk i përmban të dhënat nga neni 388 paragrafi (1) i këtij ligji;
- 9-v) materialet nuk janë të arritshme për aksionarët në pajtim me nenin 388 paragrafi (3) të këtij ligji.
- 10) Organi drejtues nuk ia paraqet Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë vendimin e plotfuqishëm që të regjistrohet në regjistrin tregtar (neni 415 alineja 1);
- 11) nuk e paraqet rritjen e kryer të pjesës kryesore për shkak të regjistrimit në regjistrin tregtar (nenet 433 alineja 1; 435 alineja 2; 438 alineja 1 dhe 2 dhe 441 alineja 1);
- 12) nuk e paraqet vendimin për zvogëlimin e pjesës kryesore dhe zvogëlimin e kryer të pjesës kryesore për shkak të regjistrimit në regjistrin tregtar (neni 444 alineja 1 dhe 451 alineja 1);
- 13) nuk paraqet fletëparaqitje përshkak të regjistrimit në regjistrin tregtar në vendimin për ndërprerjen e shoqatës (neni 453 alineja 1);
- 14) nuk paraqet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të transformimit të shoqatës nga njëra në formë tjetër (neni 514 alineja 1).

(2) Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë tregtare do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 602-a

(1) Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për kundërvajtje nga neni 602 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 7, 13 dhe 14 të këtij ligji.

(2) Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri në një vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet personit përgjegjës të shoqërisë për kundërvajtje nga neni 602 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 7, 13 dhe 14 të këtij ligji.

Neni 602-b

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të organit të

menaxhimit, nëse:

- 1) raporti vjetor për punën e shoqërisë nuk i përmban të dhënat e përcaktuara me nenin 337 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 2) nuk e konvokojnë kuvendin vjetor në pajtim me nenin 384 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 3) raporti vjetor për punën e shoqërisë nuk i përmban të dhënat e përcaktuara me nenin 384 paragrafi (7) të këtij ligji;
- 4) nuk e konvokojnë kuvendin me kërkesë të aksionarit në pajtim me nenin 385 të këtij ligji;
- 5) nuk e konvokojnë kuvendin në pajtim me mënyrat e konvokimit nga neni 387 të këtij ligji;
- 6) nuk e vënë në rend dite kërkesën nga neni 390 paragrafi (6) i ligjit, përveç në rastet nga paragrafi (7) i këtij neni;
- 7) nuk veprojnë në pajtim me nenin 390 paragrafi (9) dhe paragrafi (10) të këtij ligji dhe
- 8) nuk kanë kontrolluar nëse aksionarët e paraqitur të listës, janë evidentuar në librin e aksionarëve në pajtim me nenin 391 paragrafi (3) të ligjit.

Neni 602-v

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve joekzekutivë të bordit të drejtorëve përkatësisht anëtarëve të bordit mbikëqyrës së shoqërisë aksionare, nëse:

- 1) nuk e konvokojnë kuvendin vjetor në pajtim me nenin 384 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 2) nuk e konvokojnë kuvendin me kërkesë të aksionarit në pajtim me nenin 385 të këtij ligji;

Neni 602-g

(1) Gjobë në shume prej 1 500 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje anëtarit ekzekutiv të bordit të drejtorëve, përkatësisht anëtarit të bordit administrativ të shoqërisë aksionare, nëse:

- 1) me kërkesë të aksionarit nuk i lëshon kopje të procesverbalit nga kuvendi i aksionarëve në pajtim me nenin 407 paragrafi (4) të këtij ligji.

Neni 602-d

Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet për kundërvajtje personave nga neni 457 të ligjit, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 459 të këtij ligji.

Neni 603

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje Depozitarit qendror nëse aksionarit nuk i mundëson inspektim në librin e aksionarëve, përkatësisht nuk i jep fotokopje nga të dhënat e regjistruara në librin e aksionarëve të shoqërisë (neni 283, paragrafët (6) dhe (7)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës të Depozitarit qendror në pajtim me nenin 283 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji.

Neni 604

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqata komanditore nëse;

1) regjistrimi i shoqatës komanditore me aksione në regjistrin tregtar është bërë në kundërshtim të nenit 464;

2) nuk paraqet fletëparaqitje për regjistrim në regjistrin tregtar të transformimit të shoqatës nga njëra formë në tjetrën (neni 514 alineja 1).

(2) Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë komanditore do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 604-a

(1) Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet shoqërisë komanditore me aksionet për kundërvajtje nga neni 604 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje deri në një vit, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës të shoqërisë për kundërvajtje nga neni 604 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 605

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së huaj tregtare nëse kryen veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë pa themeluar filial, ndersa ka qenë i detyruar ta organizojë në pajtim me dispozitat e nenit 581 paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë tregtare të huaj do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 605-a

Gjoba në shumë prej 2.500 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë aksionet e së cilës kuotojnë në bursë, dhe shoqërisë e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është me detyra të veçanta për njoftim, nëse në faqen zyrtare të saj të internetit, nuk i shpall të dhënat e përcaktuara në nenin 387 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Komisioni për letra me vlerë mund të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje nga ky nen.

Neni 605-b 33

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë, nëse aksionet e fituara në pajtim me nenin 335 paragrafi (1) i këtij ligji, paraprakisht nuk kanë qenë të ofruara për shitje në afatin nga neni 335 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë nga paragrafi (1) të këtij neni, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni. 34

(2) Gjobë në shumë prej 2.500 deri 5.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës në shoqërinë nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 605-b

(1) Gjobë në shumë prej 2.500 deri në 5.000 euro do t'u shqiptohet anëtarëve të organeve të menaxhimit të shoqërisë që kanë votuar për miratimin e transaksionit me palën e interesuar , në kundërshtim me dispozitat e neneve 460-a paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Komisioni i letrave me vlerë mund të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjet nga ky nen.

Neni 605-v

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro do t'i shqiptohet shoqërisë aksionare që ka realizuar transaksion me palën e interesuar para se të marrë mendim nga revizori i autorizuar për të këtë, në kundërshtim me dispozitat e nenit 460-a paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Komisioni për letra me vlerë mund të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje nga ky nen.

Neni 605-g

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik, respektivisht tregtarin individ, kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

PJESA E NJËMBËDHJETË

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Aplikimi i këtij ligji

Neni 606

(1) Me ditën e fillimit të aplikimit të këtij ligji, tregtarët ekzistues individ, shoqata tregtare, bashkësit ekonomike interesi dhe ndërmarrjet e organizuara nga shoqata të jashtme, përkatësisht nga tregtar të jashtëm individ vazhdojnë me punë në mënyrën dhe me kushtet me të cilat janë regjistruar ne regjistrin tregtar.

(2) Aktet e tregtarëve individ, marrëveshjet për shoqatën, deklarata për themelimin e shoqatës me përgjegjësi të kufizuar nga një person, statutet e shoqatave, kontratat për bashkësi ekonomike interesi dhe aktet tjera të përgjithshme të shoqatave të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat të këtij ligji, me ditën e fillimit të aplikimit të këtij ligji nuk aplikohen në pjesët të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat e tij, përveç shumës të madhësisë të pjesës kryesore.

(3) Me përjashtim të alinesë 2 të këtij neni, pyetjet të cilat, në pajtueshmëri me këtë ligj, rregullohen me marrëveshje për shoqatën, deklarata për themelimin e shoqatës me përgjegjësi të kufizuar nga një person, statutin të shoqatës, marrëveshjen për bashkësinë ekonomike të interesit dhe akt tjetër të përgjithshëm të shoqatës, tregtarët ekzistues individ, shoqata tregtare, bashkësitë ekonomike interesi bashkësi dhe

ndërmarrje, të organizuara nga shoqata të jashtme, përkatësisht nga tregtar të jashtëm individ, kurse nuk janë në pajtim me këtë ligj munden të aplikohen përfundimisht me 30.06.2005.

(4) Dispozitat nga neni 469, alineja 2 dhe 3 të këtij ligji do të aplikohen për raportet financiare dhe të raporteve të konsoliduara financiare për vitin 2004.

Procedura të filluara para ditës të aplikimit të ligjit

Neni 607

(1) Procedurat për themelimin, ngjitjen, ndarjen dhe transformimin të shoqatave tregtare, të filluara para ditës të fillimit të aplikimit të këtij ligji, vazhdojnë në pajtueshmëri me dispozitat nga ky ligj.

(2) Pas flet paraqitjeve për regjistrim në regjistrin tregtar që janë paraqitur në gjyq para ditës të fillimit të aplikimit të këtij ligji gjyqi, do ta përfundojë procedurën sipas rregullave të cilat kanë qenë në fuqi në kohën flet paraqitjet i janë paraqitur atij gjyqi.

Regjistrimi unik tregtar

Neni 608

I fshirë 35

Paraqitja dhe shpallja në regjistrin unik tregtar në formë elektronike

Neni 609

(1) Deri në vendosjen e regjistrit unik tregtar në formë elektronike, regjistrimi në regjistrin tregtar ka veprimtari juridike ndaj personave të tretë nda dita e ardhshme nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare në Republikën e Maqedonisë", nëse me këtë apo ndonjë ligj tjetër nuk është caktuar ndryshe. Pas vendosjes të regjistrit të vetëm tregtar në formë elektronike dhe të paraqitjes së tij opinionit, regjistrimi në regjistrin tregtar do të ketë veprimtari juridike ndaj personave të tretë nga dita e regjistrimit në regjistrin tregtar.

(2) Shpalljet dhe kontributet të cilat në pajtueshmëri me këtë ligj, janë përcaktuar se shpallen në tërësi, pjesërisht apo në përmbledhje në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" prej 1.01.2006 do të kryhen përmes regjistrit tregtar në formë elektronike.

Regjistrimi i ndryshimeve

Neni 610

Deri në vendosjen e regjistrit unik tregtar nëse:

- 1) Për shkak të ndërrimit të selisë të subjektit ndryshohet edhe gjyqi, atëherë flet paraqitjen për regjistrim të ndërrimit të selisë dhe e njofton gjyqin në të cilin deri atëherë ka qenë i regjistruar subjekti. Pas marrjes së njoftimit, gjyqi menjëherë ia paraqet përmbledhjen e rregullave të reja;
- 2) Subjekti i regjistrimit u bë me bashkimin të dy apo më shumë subjekteve të cilët janë regjistruar në gjyq tjetër apo subjektet të regjistrimit bashkangjiten drejt subjektit tjetër, përkatësisht

bashkangjitet e bën gjyqi sipas selisë të subjektit të ri, përkatësisht gjyqit ku është regjistruar subjekti në regjistrim të cilin e ka bashkuar subjektin tjetër. Kopje nga vendimi i gjyqit paraqitet gjyqit në të cilin deri atëherë kanë qenë të regjistruar subjektet ashtu që gjyqi me anë të detyrës zyrtare e vëren regjistrimin të subjektit të ri, Gjyqi tek i cili ka qenë i regjistruar subjekti merr vendim për shlyerjen e subjektit që bashkangjitet, përkatësisht ngjitet; dhe

3) me ndarjen e një subjekti dalin subjekte të reja të cilët me seli janë në kompetenca të gjyqit tjetër, atëherë gjyqi në të cilin deri atëherë ka qenë i regjistruar subjekti që ndahet, merret vendim për regjistrim për themelimin e subjektit të ri. Gjyqi paraqet kopje të vendimit në gjyqin ku është selia e subjektit të ri. Pasi që gjyqi do t'i pranojë njoftimet se të gjitha subjektet janë regjistruar, sipas detyrës zyrtare, në bazë të fletparaqitjes tanimë të paraqitur nga ana e subjektit që ndahet, merr vendim për shlyerjen e subjektit që ndahet dhe do ta vërejë regjistrimin e subjekteve të reja.

Neni 611

I fshirë 36

Aksione që japin të drejtë në shumë vota

Neni 612

Aksionet e dhëna që japin të drejtë në më shumë vota në pronësi të Republikës së Maqedonisë mbeten në pronësi të saj sipas kushteve nën të cilat janë dhënë. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, këto aksione nuk mundën të barten tek personat e tretë, përveç nëse barten si aksione të rëndomta.

Harmonizimi me dispozitat të këtij ligji

Neni 613

(1) Shoqatat me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqatat aksionare në pronësi të shtetit janë të obliguar që aktet e veta t'i harmonizojnë me dispozitat të këtij ligji më së voni deri më 31 dhjetor të vitit 2004.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë vendos për harmonizimin e shoqatave në pronësi të shtetit dhe për të pasur ndikim, përkatësisht aksioneve në shoqatat të caktuara me këtë ligj dhe i realizon të gjitha të drejtat dhe obligimet të Republikës së Maqedonisë si bashkshoqërues, përkatësisht si aksionar.

(3) Mbi shoqatën nga alineja 1 të këtij neni që nuk do të veprojnë sipas sipas dispozitave nga alineja 1 të këtij neni, zbatohet procedura për likuidim dhe shoqata shlyhet nga regjistri tregtar. Procedurën për likuidim e fillon gjyqi sipas detyrës zyrtare, kurse likuidimi zbatohet sipas dispozitave të këtij ligji.

Harmonizimi me dispozitat e këtij ligji të personave të regjistruar juridik në regjistrin tregtar dhe juridik

Neni 614

(1) Personat juridik të regjistruar në regjistrin gjyqësor, të cilët ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk harmonizohen sipas dispozitave nga Ligji për shoqata tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë",

numër 28/96, 7/97, 21/98/37/98, 63/98, 39/99, 37/2000, 31/2001, 50/2001, 6/2002, 61/2002, 4/2003, 51/2003) shlyhen nga regjistri gjyqësor në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen nëse në një afat prej 6 muaj nga dita e aplikimit të këtij ligji nuk harmonizohen me këtë ligj. Shlyerjen e këtyre personave juridik e zbaton gjyqi, sipas detyrës zyrtare.

(2) Shoqatat tregtare dhe tregtarët individ llogaritë e të cilëve janë bllokuar dhe dërguar në institucione për bllokimin e llogarive shlyhen nga regjistri tregtar në mënyrën dhe sipas kushteve të caktuara në këtë nen nëse prej afat prej 6 muaj prej ditës të aplikimit të këtij ligji nuk e zhblokon llogarinë e bllokuar.

(3) Nëse në afatet nga alineja 1 dhe 2 të këtij neni nuk paraqitet kërkesë nga kreditorët gjyqi, sipas detyrës zyrtare, i shlyen personat juridik prej alinesë 1 të këtij neni edhe shoqatat tregtare dhe tregtarët individ nga alineja 2 në këtë nen të gjyqit, përkatësisht nga regjistri tregtar.

(4) Nëse nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni bëhet paraqitja e kërkesës nga kreditori, gjyqi me anë të detyrës zyrtare, fillon procedurë për likuidim në pajtueshmëri me këtë ligj, përkatësisht procedurë për falimentim në pajtueshmëri me ligjin për falimentim. Harxhimet për zbatimin e likvidimit apo falimentimit bijnë në barë të personit juridik, tregtarit individ, shoqatës tregtare nëse nga pasuria e tyre nuk mundën të sigurohen mjete për kompenzim të harxhimeve, dallimi i mjeteve për mbulimin e harxhimeve personalisht, pakufizuar dhe solidare, me mbarë pasurinë e vet, e kompenzon drejtuesi, përkatësisht anëtarët e organit të udhëheqjes.

Miratimi i akteve nënligjore

Neni 615

Aktet nënligjore të paraparë me këtë ligj do të miratohen në një afat prej nëntëdhjetë ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ndërprerja e validitetit

Neni 616

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për shoqatat tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 28/96, 7/97, 21/98, 37/98, 63/98, 39/99, 81/99, 37/2000, 31/2001, 50/2001, 6/2002, 61/2002, 4/2003, 51/2003) si dhe Ligji për shoqatat tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 58/2002, 98/2002, 42/2003 dhe 85/2003).

Hyrja në fuqi e këtij ligji

Neni 617

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/2007):

Neni 29

Me statutin e shoqërisë aksionare mund të përcaktohet themelimi i fondit nga i cili të punësuarit mund të fitojnë aksione të shoqërisë aksionare falas ose me çmim të volitshëm. Fondi dhe aksionet që të punësuarit mund t'i fitojnë nga fondi, mund të jenë më së shumti deri në një të dhjetën nga kryegjëja bazë e shoqërisë aksionare.

Me statutin e shoqërisë aksionare rregullohet organizimi dhe administrimi i fondit, si dhe shfrytëzimi dhe mënyra e ndarjes së mjeteve të dedikuara për aksionet e të punësuarve. Në rastin e themelimit të fondit nga paragrafi (1) i këtij neni, kuvendi i shoqërisë miraton programin sipas të cilit të punësuarit do të mund të fitojnë aksione.

Vendimin për emetimin e aksioneve të dedikuara për fondin nga paragrafi (1) i këtij neni, për kriteret e ndarjes së tyre dhe për ndarjen e aksioneve nga fondi për fitimin e aksioneve për të punësuarit, e merr kuvendi i shoqërisë. Vendimin, kuvendi e merr me shumicë votash që nuk mund të jetë më pak se dy të tretat e aksioneve me të drejtë vote, të prezantuara në kuvendin e shoqërisë, përveç nëse me statut nuk është përcaktuar shumicë më e madhe.

Aksionet nga paragrafi (1) i këtij neni, fondi mund t'i fitojë nga aksionet pronësore të shoqërisë aksionare ose nga rezerva e përgjithshme dhe fitimi i akumuluar i shoqërisë aksionare në pajtim me këtë ligj.

Neni 30

Shoqëritë aksionare, janë të obliguara që t'i harmonizojnë aktet e tyre dhe punën e tyre me dispozitat e këtij ligji më së voni deri më 30 qershor 2007.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/2007):

Neni 31

Dispozitat nga neni 29 i këtij ligji do të zbatohen nga 1 janari 2012.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2008):

Neni 30

Ministri i Financave do ta miratojë dispozitën për mënyrën dhe kushtet për parashtrimin e llogarisë vjetore në formë elektronike në afat prej 30 ditësh nga dita hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ministri i Ekonomisë do ta miratojë dispozitën për mënyrën e shndërrimit në para të pronës së shoqërisë në likuidim në afat prej 15 ditësh nga dita hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 31

Personat juridikë, tregtarët-individë dhe shoqëritë tregtare të regjistruara në regjistrin e gjykatës, të cilët deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk janë të harmonizuara me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 28/2004, 84/2005 dhe 25/2007) dhe personat juridikë, tregtarët-individë dhe shoqëritë tregtare të cilat janë

regjistruar në regjistrin tregtar, llogaritë e të cilëve nuk janë të bartur në bankat afariste dhe nuk janë bllokuar, shlyhen nga regjistri përkatës në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me këtë ligj.

Procedurën për shlyerje e zbaton Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë përmes sistemit një sportel.

Neni 32

Drejtoria e të Hyrave Publike, në afat prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi të këtij ligji, Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë do t'i paraqesë propozim për shlyerje nga Regjistri qendror të personave juridikë, tregtarëve-individë dhe shoqërive tregtare nga neni 31 të këtij ligji dhe për të njëjtët do t'i paraqesë Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë pasqyrë në formë elektronike. Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë pas futjes së të dhënave nga kontrolli i paraqitur në bazën e vet të të dhënave, publikon shpallje në ueb faqen e vet me të cilën thirren drejtuesit e tyre, organet e menaxhimit dhe kreditorët që në afat prej 30 ditësh të parashtrojnë propozim për hapjen e procedurës për likuidim ose likuidim mbin personat juridikë, tregtarët-individë dhe shoqëritë tregtare nga neni 31 i këtij ligji. Për propozimet e parashtruara për hapjen e procedurës për likuidim ose falimentim, parashtruesit janë të detyruar ta njoftojnë Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë në formë të shkruar.

Pas skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë do t'i shlyejë nga regjistri përkatës të gjithë personat juridikë, tregtarët-individë dhe shoqëritë tregtare për të cilët nuk do të paraqiten propozime për hapjen e procedurës për likuidim ose falimentim.

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë në ueb faqen e vet e shpall shlyerjen e personave juridikë, tregtarëve-individë dhe shoqërive tregtare dhe të njëjtën në formë elektronike e dërgon deri të Drejtoria e të Hyrave Publike për shkak të shlyerjes së tyre nga baza e të dhënave të Drejtorisë së të Hyrave Publike.

Mjetet për zbatimin e shlyerjes nga ana e Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 33

Pas mbarimit të procedurës për shlyerje, të gjitha mjetet nga llogaritë e personave juridikë të shlyer barten në llogarinë e arkës së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 34

I fshirë 37

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2008):

Neni 35

(1) Dispozitat nga nenet 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19 i këtij ligji do të zbatohen nga dita e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 36

Dispozitat nga nenet 84 paragrafi (2) dhe 85 paragrafi (6) do të zbatohen nga dita kur Regjistri qendror i Republikës

së Maqedonisë do të fillojë ta zbatojë nënshkrimin elektronik përmes sistemit njësportel në pajtim me Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik dhe dispozitave për sistemin një sportel.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/2010):

Neni 13

Gjoha në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë aksionet e së cilës kuotojnë në bursë, dhe shoqërisë e cila në pajtim me Ligjin për letra me vlerë është më detyra të veçanta për njoftim, nëse në faqen zyrtare të saj të internetit nuk i shpall të dhënat e përcaktuara në nenin 4, me të cilin shtohet nen i ri 388-b, nenin 6 me të cilin shtohet neni i ri 391-b paragrafi (6), nenin 8 me të cilin shtohet neni i ri 392-a paragrafi (7) dhe nenin 10 me të cilin shtohen neni 401-a paragrafi (3) të këtij ligji. 38

Neni 14

Gjoha në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 me të cilin shtohet nen i ri 388-a, nenin 8 me të cilin shtohen nenet e reja 392-b paragrafi (3) dhe 392-v paragrafi (2) të këtij ligji.

39

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/2010):

Neni 15

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji me të cilin plotësohet neni 32 paragrafi (1) nga Ligji për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 28/2004, 84/2005, 25/2007 dhe 87/2008) do të fillojnë të zbatohen nga dita kur Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, do të fillojë ta aplikojë nënshkrimin elektronik nëpërmjet sistemit njësportel, në pajtim me Ligjin për të dhënat në formën elektronike dhe nënshkrimin elektronik dhe dispozitat për sistemin njësportel.

Neni 16

Dispozitat e neneve 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2011.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 48/2010):

Neni 27

Gjobë në shumë prej 5 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë e cila nuk do të organizojë shërbim për revizion të brendshëm si njësi e pavarur organizative në shoqëri, në pajtim me nenin 10 të këtij ligji me të cilin shtohet seksion i ri "SEKSIONI 6-a Shërbimi për Revizion të Brendshëm" dhe katër nene të reja 415-a, 415-b, 415-v dhe 415-g. 40

Gjobë në shumë prej 2 500 deri 5 000 euro në

kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe çdo anëtar i organit mbikëqyrës të shoqërisë, nëse nuk ka marrë vendim me të cilin është organizuar shërbimi i brendshëm organizativ për revizion të brendshëm si njësi e pavarur organizative në shoqëri, në pajtim me nenin 10 të këtij ligji me të cilin shtohet seksion i ri "SEKSIONI 6-a Shërbimi për Revizion të Brendshëm" dhe katër nene të reja 415-a, 415-b, 415-v dhe 415-g.

Neni 28

Rregullat nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Dispozitat nga neni 1 paragrafi (2) i këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 29 paragrafi (6), për parashtrim të deklarates në formë elektronike nëpërmjet sistemit njësportel do të zbatohen nga dita kur Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë do të fillojë ta zbatojë nënshkrimin elektronik nëpërmjet sistemit njësportel në pajtim me Sistemin për e-regjistrim dhe rregullat për sistemin njësportel.

Dispozitat e nenit 2 të këtij ligji me të cilin shtohen dy nene të reja 29-a dhe 29-b, do të zbatohen nga dita kur Regjistri Qendror do ta lëshojë në funksion sistemin elektronik për udhëheqjen e regjistrimit të personave të cilët nuk mund të themelojnë dhe të udhëheqin me shoqëri tregtare në Republikën e Maqedonisë.

Neni 30

Dispozitat nga neni 17 të këtij ligji me të cilat ndryshohet neni 469, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e standardeve ndërkombëtare për njoftim financiar të subjekteve të vogla dhe të mesme do të zbatohen pas publikimit të standardeve ndërkombëtare për njoftim financiar të subjekteve të vogla dhe të mëdha në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Deri në publikimin e standardeve për njoftim financiar të subjekteve të vogla dhe të mesme, tregtarët nga neni 469 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, obligohen që të mbajnë kontabilitet në pajtim me këtë ligj dhe me parimet për kontabilitet të miratuara në bazë të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 48/2010):

Neni 31

Dispozitat e nenit 10 të këtij ligji me të cilin shtohet seksion i ri "SEKSIONI 6-a Shërbimi për Revizion të Brendshëm" dhe katër nene të reja 415-a, 415-b, 415-v dhe 415-g, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2011.

Neni 32

Dispozitat e nenit 5 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 284, paragrafi (1) për lëshimin e obligacioneve të cilat sigurojnë të drejtë për përparësi të blerjes së aksioneve të cilat shoqëria i emeton, do të fillojnë të zbatohen nga dita kur Republika e Maqedonisë do të fitojë status të anëtarit fuqplotë në Bashkimin Evropian.

Neni 33

Dispozitat e nenit 434 të këtij ligji për realizimin e të drejtës së përparësisë nga ana e aksionarëve gjatë rritjes me kusht të kryegjësë themelore, do të fillojnë të zbatohen nga dita kur Republika e Maqedonisë do të fitojë status të anëtarit fuqplotë në Bashkimin Evropian.

Neni 34

Dispozitat e nenit 25 të këtij ligji me të cilat rregullohet bashkimi tejkuftar me shoqëri nga Bashkimi Evropian, do të fillojnë të zbatohen nga dita kur Republika e Maqedonisë do të fitojë status të anëtarit fuqplotë në Bashkimin Evropian.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2011):

Neni 56

Akti nenligjor nga neni 31 paragrafi (3) i këtij ligji do të miratohet në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/2012):

Neni 8

Tregtarët – individë dhe shoqëritë tregtare që udhëhiqen si të bllokuara në Drejtorinë e Hyrave Publike shlyhen nga regjistri përkatës në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me këtë nen me përjashtim të shoqërive me interes të veçantë ekonomik për Republikën e Maqedonisë.

Në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Drejtoria e të Hyrave Publike, Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë në formë elektronike i dorëzon pasqyrë të tregtarëve individë të bllokuar dhe shoqërive tregtare të bllokuara. Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë do të krijojë regjistër të veçantë të subjekteve të bllokuara në të cilin i fut tregtarët individë të bllokuar dhe shoqëritë tregtare të bllokuara të përmbajtura në pasqyrën e marrë nga Drejtoria e të Hyrave Publike.

Pas zbatimit të veprimit nga paragrafi 2 i këtij neni, nga Drejtoria e të Hyrave Publike, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë në afat prej tetë ditësh publikon njoftim në ueb faqen e vet, me të cilin i fton të gjithë kreditorët dhe personat dhe organet e autorizuar për menaxhim, përfaqësim dhe mbikëqyrje të tregtarëve individë të bllokuar dhe shoqërive tregtare të bllokuara, që në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të njoftimit të paraqesin propozime për falimentim të tyre në pajtim me Ligjin për falimentim dhe për këtë me shkrim ta njoftojnë Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe njëkohësisht do të publikojë pasqyrë me emrat e të gjithë tregtarëve individë të bllokuar dhe shoqërive tregtare të bllokuara.

Nëse në afat prej 30 ditësh nga dita kur e ka publikuar njoftimin nga paragrafi 3 i këtij neni nuk merr njoftim me shkrim për propozimin e parashtruar për hapjen e procedurës falimentuese ndaj tregtarit individë të bllokuar, përkatësisht shoqërisë tregtare të bllokuar,

Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë do ta shlyejë nga evidenca e vet dhe këtë e publikon në ueb faqen e vet.

Nëse në afat prej 60 ditësh nga dita e skadimit të afatit nga paragrafi 3 i këtij neni nuk merr aktvendim për hapjen e procedurës falimentuese, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë e shlyen tregtarin individ të bllokuar, përkatësisht shoqërinë tregtare të bllokuar nga regjistri i veçantë i përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni dhe këtë e shpall në ueb faqen e vet. Në shpallje ftohen bashkëpronarët, përkatësisht aksionarët e tregtarëve individë dhe shoqërive tregtare të bllokuara që ta ndajnë pronën e shoqërisë ndërmjet veti në pajtim me nenin 546 paragrafi (2) të këtij ligji.

Nëse në afat prej një viti nga dita e shlyerjes së subjektit të bllokuar nuk ndodh ndarja e pronës së shoqërisë, përkatësisht në rast se bëhet fjalë për pronë të re të gjetur në afat prej një viti nga momenti i gjetjes së pronës së tillë, ajo evidentohet si pronë në pronësi të Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

Neni 11

Shoqëritë, përkatësisht subjektet e regjistrimit të cilat deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë kanë status "joaktiv" për shkak se nuk e kanë konfirmuar autenticitetin e të dhënave të bartura nga forma në letër në formë elektronike në regjistrin unik tregtar në pajtim me nenin 67 të Ligjit për sistem njësportel dhe për mbajtjen e regjistrit tregtar dhe regjistrin të personave tjerë juridikë, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë do t'i shlyejë nga regjistri në pajtim më mënyrën siç është përcaktuar me nenin 552-a të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/2012):

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2013, përveç dispozitave të nenit 3 që do të fillojnë të zbatohen nga 16 marsi 2013.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 120/2013):

Neni 2

Dispozita nga neni 1 i këtij ligji ka të beje edhe me procedurat e filluara të propozimeve për falimentim në pajtim me Ligjin për falimentim dhe shlyerjen e subjektit nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/2014):

Neni 14

Procedurat për shlyerjen e subjekteve joaktive të filluara

para miratimit të këtij ligji, do të përfundohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 15

Afati i paraparë në nenin 10 i cili ka të bëjë me nenin 552-a paragrafi (3) ka të bëjë edhe me subjektet mbi të cilat tanimë janë parashtruar propozime për falimentim në pajtim me Ligjin për falimentim, ose propozime për likuidim në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/2014):

Neni 16

Dispozitat nga neni 3 me të cilin ndryshohet neni 29 paragrafi (2) pika 5, neni 4 me të cilin ndryshohet neni 29- a paragrafi 1, neni 6 me të cilin ndryshohet neni 197 paragrafi (7), neni 8 me të cilin ndryshohet neni 477 paragrafët (10), (11), (12) dhe (15), neni 9 me të cilin ndryshohet neni 477-a paragrafi (8), neni 11 me të cilin shtohet nen i ri 552-b dhe neni 12 me të cilin ndryshohet neni 597 paragrafët (2), (3), (4), (5) dhe (6) të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2015.

Ligj për plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kushtit për njohjen e gjuhës së huaj që do të fillojë të zbatohet dy vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/2015):

Neni 36

Dispozitat e neneve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 13, 14, 16, 19 dhe 30 të këtij ligji do të zbatohen nga 1 nëntori 2015.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/2015):

Neni 37

Të dhënat nga neni 82 paragrafi (3) të bartura në formë të shkruar nga gjykatat regjistruese në pajtim me nenin 67 të Ligjit për sistem njësportel dhe për mbajtje të regjistrit tregtar dhe regjistrit të personave tjerë juridikë ruhen në formë në letër. Të dhënat nga regjistrimet e kryera pas 1 janarit 2006 sipas fletëparaqitjes së parashtruar në formë me shkrim si dhe shtojcat ndaj saj ruhen në formë në letër dhe në formë elektronike. Të dhënat nga regjistrimet e kryera në bazë të fletëparaqitjes elektronike për regjistrim dhe shtojcat ndaj saj ruhen në formë elektronike nëse janë të hartuara në formatin PDF dhe janë të verifikuara me nënshkrim elektronik të

agjentit regjistruar apo parashtruesit të autorizuar, përkatësisht edhe në formë në letër nëse këto konvertohen nga forma me shkrim në formë elektronike dhe verifikohen me nënshkrim elektronik të agjentit regjistruar. Të dhënat për regjistrimet e kryera në regjistrin tregtar unik për subjektet që nuk janë të përfshira me këtë ligj ruhen në letër.

Neni 38

Shoqëritë nga neni 498 të këtij ligji, që kanë fituar pjesëmarrje, përkatësisht aksione në shoqërinë e vet zotëruese, detyrohen t'i tjetërsojnë aksionet në shoqërinë zotëruese në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2016):

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".